

**ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**68**



**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNII**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TE  
SHQIPËRISE**



ЕНВЕР НОХИА



**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH**

# **ENVER HOXHA**

**VELLIMI**

**68**

**SHTATOR 1978 – NËNTOR 1978**

**SHTËPIA BOTUESE «S NËNTORI-**  
**TIRANË, 1989**

## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 68-TË

Vëllimi i 68-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin materiale që i përkasin periudhës shtator-nëntor 1978, një pjesë e mirë e të cilave botahej për herë të parë.

Ndër problemet qendrore që trajtohen në këtë vëllim janë ato që lidhen me zhvillimin e ekonomisë e të mbrojtjes së vendit, sidomos detyrat për të realizuar me sukses planin e prodhimit në bujqësi e industri në luftë me vështirësitë dhe pengesat që rridhnin nga rrëthimi imperialisto-revisionist dhe nga prerja e ndihmës dhe e kredive nga udhëheqja revisioniste kinezë. Planet tona ishin hartuar duke pasur parasysh edhe marrëveshjet e përbashkëta me qeverinë kinezë. Por në kushtet e krijuara nga shkelja e këtyre marrëveshjeve, siç vihet në dukje në vëllim, situata bëhej edhe më e vështirë, por jo e pakapërcyeshme. Në realizimin e planeve, siç ka theksuar kurdoherë Partia jonë, kryesorë dhe vendimtarë janë faktorët e brendshëm. Për të përballuar me sukses vështirësitë e krijuara duhej të mbështeteshim tërësisht në forcat tona për të sigruar ritme sa më të larta zhvillimi, para së gjithash, përmes shfrytëzimit në mënyrë sa më rationale e më të plotë të bazës materialo-teknike ekzistuese. Krahë kësaj ishte e domosdoshme të bëhej një lidhje dhe

*bashkërendim sa më i mirë midis akumulimit, investimeve dhe forcave të reja të punës. Më shumë se çdo herë tjetër dilte në plan të parë edhe rritja e rendimentit në të gjithë sektorët.*

*Kësaj çështjeje autor i kthehet e i rikthehet disa herë në diskutimet e tij në forume të ndryshme të Partisë. Duke u ndalur veçanërisht në detyrat e bujqësisë, theksohet se për këtë sektor duhet të shqetësohen e të kontribuojnë të gjithë. Intensifikimi dhe rritja e rendimenteve në bujqësi e blegtori, vihet në dukje në vëllim, nuk mund të kuptohet pa thellimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor edhe në këtë sektor. Ato kërkojnë, gjithashtu, që problemet e razonizimit e të shpërndarjes së bimëve, problemet e përqendrimit e të specializimit në bujqësi e blegtori të shihen kurdoherë në mënyrë dinamike. Kjo arrihet duke njobur mirë jo vetëm kushtet e çdo rrithi, por edhe të çdo ekonomie e sektori në veçanti dhe, në bazë të tyre, të bëhen eksperimentimet e studimet përkatajse e të nxirren konkluzionet e nevojshme. Këtu ndikon edhe vendosja e një raporti sa më të drejtë në mes centralizmit e demokracisë. T'u lihet iniciativë sa më e madhe bazës, rritheve, kooperativave, porosit autorë, dhe jo të caktohen nga qendra bimët që do të mbillen në këtë apo atë kooperativë, por duke nxitur iniciativën krijuese të masave, të bëhen propozime e sugjerime dhe, kur ato janë të drejta, të ngulet këmbë për vënien e tyre në jetë.*

*Interes të veçantë në materialet që i përkasin kësaj periudhe paraqesin fjalimet e mbajtura në Këshillin e Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqi-*

përisë dhe para zgjedhësve të zonës elektorale. Duke trajtuar problemet e konsolidimit të mëtejshëm të pushtetit, nëpërmjet shprehjes së vullnetit të lirë të masave e karakterit thellësisht demokratik të zgjedhjeve te ne, autori vë në dukje se ato në vendin tonë nuk janë vetëm të shkruara në letër, por zbatohen konkretisht në jetë, në kundërshtim me të ashtuquajturat liri e demokraci borgjeze, për të cilat bëhet aq shumë zhurmë në botën kapitalisto-revisioniste. Duke u ndalur konkretisht te demokracia e gjerë që gjëzojnë masat te ne, autori thekson se demokracia proletare është demokracia e vërtetë dhe se ajo zhvillohet e përsoset vazhdimisht në procesin e ndërtimit të socializmit.

Mbështetur si kurdoherë në parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, në disa nga shkrimet e kësaj periudhe shoku Enver Hoxha analizon edhe mjafit probleme ndërkombëtare e të politikës së jashtme të vendit tonë. Por në mënyrë të sintetizuar ato trajtohen në fjalimin para zgjedhësve ku pasqyrohet politika e jashtme, e pavarur e konstruktive e Partisë dhe e shtetit tonë socialist. Konsekvente në rrugën e saj parimore internacionliste, Partia jonë ka përkrahur e përkrah luftërat nacionalçlirimtare të popujve dhe revolucionin, por në asnjë mënyrë nuk mbështetet në njërin imperializëm për të luftuar tjetrin, siç teorizinin e vepronin revisionistët kinezë.

Vend të rëndësishëm në këtë vëllim zë vepra e shquar teorike e shokut Enver Hoxha «Vetadministri mi jugosllav — teori dhe praktikë kapitaliste», vepër për të cilën vetë autori ka shkruar: «... e kam përga-

titur për të analizuar librin e revizionistit titist Eduard Kardel me titull: «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vëtadministrimit socialist». Në këtë vepër madhore, shoku Enver Hoxha, përmes një analize të thellë klasore, me logjikë të hekurt e argumente të shumta, vërteton se vëtadministrimi jugosllav nuk është gjë tjetër veçse një teori dhe praktikë kapitaliste, e veshur me frazeologji marksiste. Në të, gjithashtu, zbulohen thelbi antimarksist e kundërrevolucionar, burimet teorike dhe rrënjet klasore të titizmit, si variant i parë i revizionizmit modern në pushtet, dhe njëkohësisht jepet gjithë procesi i lindjes e i zhvillimit të këtij korrenti revizionist që vendosi kapitalizmin në Jugosllavi.

Duke ballafaquar tezat e revizionistëve jugosllavë me tezat marksiste-leniniste dhe me pasojat negative që ka sjellë zbatimi i sistemit të vëtadministrimit në fushën ekonomike e politike të Jugosllavisë, shoku Enver Hoxha mbrojnë dhe zhvillon më tej teorinë dhe praktikën e socializmit shkencor, argumenton bindshëm një varg tezash themelore të marksizëm-leninizmit, siç janë ato për socializmin e vërtetë, për diktaturën e proletariatit dhe sistemin e saj, për pronën shoqërore, për rolin vendimtar të klasës punëtore e të pararojës së saj, partisë komuniste, në kalimin nga kapitalizmi në komunizëm, për rrugët e zgjidhjes së çështjes kombëtare, për problemet e organizimit e të drejtimit të ekonomisë sociale, duke u mbështetur në ligjet ekonomike objektive të socializmit e të tjera.

Vetë realiteti i sotëm jugosllav, si dhe zhvillimet aktuale në Bashkimin Sovjetik e në vendet e tjera të Evropës Lindore vërtetojnë katërcipërisht idetë e rën-

dësishme dhe parashikimet largpamëse të shokut Enver Hoxha se ku do t'i conte këto vende kursi revisionist i partive pseudokomuniste që bënин ligjin në to.

Mësimet e çmuara, përgjithësimet e thella me vlerë të pazëvendësueshme teorike e praktike që gjallojnë në materialet e këtij vëllimi, si në të gjitha Veprat e shokut Enver Hoxha, janë një pasuri tjetër e madhe për edukimin e mëtejshëm marksist-léninist të masave tona punonjëse dhe frymëzuese për vënien në jetë të detyrave që shtron Partia.

Vëllimi është i pajisur me tregues.



**JEMI TË PERGATITUR PËR KOHË LUFTE,  
KUR STËRVITEMI E PUNOJMË MIRE  
NË KOHË PAQEJE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**1 shtator 1978**

*Pasi shoku Hekuran Isai raportoi për problemin e mbrojtjes civile, që u trajtua në plenumin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit në muajin gusht, shoku Enver Hoxha tha:*

Problemet e mbrojtjes janë të rëndësishme, prandaj duhet të zbatohen në jetë, sepse në rast lufte, puna nuk pret. Për këtë arsy, edhe në mbledhjet që zhvillohen për çështjen e mbrojtjes, është e domosdoshme të jepen detyra, të caktohet koha dhe të merrren masa sidomos për strehimin e popullsisë. Kur të jepet shenja e alarmit, menjëherë të fillojë vrapit, por çështja është për ku do të vrapojnë njerëzit, ku do të mbahen këmbët. Kjo ka rëndësi të madhe. Në kohë paqeje relativisht është lehtë të vrapohet. Në rast alarmi u thuhet njerëzve: «Ecni në këtë apo në atë rrugë», ose «shuanidritat» etj. Por, kur për zbatimin e

këtyre detyrave ka zvarritje, ka javashllök të madh, ka mosinteresim në kushtet e paqes, po në rast lufte? Merret me mend se ç'mund të ndodhë.

Të marrim problemin e mbrojtjes nga avionët e armikut. Në këtë rast kërkesë e domosdoshme është errësimi. Për të bërë errësimin duhet të përdoret perde e zezë ose të lyhen xhamat me bojë të zezë. Mirëpo, a janë marrë masat për këtë gjë? Janë sigruar e depozituar gjithë sasia e perdeve ose e bojës së zezë që nevojitet për këtë rast? Po furçat që duhen për lyerjen, janë sigruar? Janë prerë shiritat që përdoren për t'ua vënë dritareve, që të mos thyhen në rast bombardimi me avion? Pra, janë përgatitur vallë të gjitha këto? Jo, nuk janë përgatitur. Atëherë çfarë është bërë? Nuk po flas këtu për strhimet, se ky problem është edhe më i vështiri. Në vendstrehimet që kemi bërë mund të rrish gjysmë ore, por mund të rrish edhe dy ditë e dy net, kështu që duhet pasur parasysh edhe furnizimi, se atje do të qëndrojnë edhe fëmijë, që nuk durojnë dot pa ngrënë, qoftë edhe për një ditë. Mundet që njerëzit të marrin diçka edhe nga shtëpia, por në ato momente, kur papritur bëhet alarmi, të gjithë nxitojnë për në strehim e s'e kanë mendjen tek ushqimet. Si këto ka edhe çështje të tjera.

Mua më duket se për këto probleme flitet, edhe vendime të përgjithshme merren, por çështja është që ato të vihen në zbatim dhe janë pikërisht rrethet ato që duhet të mendojnë e të punojnë seriozisht në këtë drejtim.

Çështja tjetër është plani i prodhimit i kohës së luftës. Bazën materiale për realizimin e këtij plani,

rrethet duhet ta kenë, por ka rëndësi edhe evakuimi. Vendet janë caktuar, por duhet të bëhen edhe bazamentet, se tornoja, tezgjahu etj., kur të nxirren nga reparti, nuk do të vendosen mbi baltë. Këto gjëra në letër janë caktuar me kohë, por q'bëjnë Partia dhe pushteti në këtë drejtim? Mund të flasim vazhdimisht për këto probleme, po çështja është që njerëzit tanë të mësohen për të zbatuar çdo vendim që merret. Si të mos e dinë shokët e uzinës «Enver», për shembull, se në ç'vend do t'i vendosin tornot e caktuara për kohë lufte? Ose si të mos e dinë drejtuesit e uzinës «Dinamo» se ku duhet të transportohen ato reparte, të cilat me prodhimet e tyre do t'u shërbejnë tankeve në kohë lufte? Në kohë të tilla nuk mund të bëhet fjalë për frigoriferët, por do të përqendrohet vëmendja tek ato makineri e pajisje që kanë të bëjnë me fatin e njerezve dhe të vendit tonë.

Ne duhet të përgatitim mbrojtjen e atdheut, të çdo skaji të tij, dhe të bëjmë që çdo njeri të kuptojë thellë se ne do të mbrohem me këto forca e mjete që kemi. Nga asnjë vend nuk do të na vijnë armë e municione. Kjo është më se e qarë. Prandaj, po na u prishën uzinat që kemi, po nuk i futëm pajisjet e makineritë atje ku duhet, që t'i përdorim edhe për rast lufte, atëherë kjo do të jetë në dëmin tonë. Po nuk u kuptua në këtë mënyrë çështja e mbrojtjes, atëherë ajo që thuhet se «mbrojtja e atdheut është detyrë mbi detyra», mbetet vetëm një slogan. Jemi të përgatitur për kohë lufte, kur stërvitemi e punojmë mirë në kohë paqeje. Në luttë nuk duhen vetëm fishekë dhe predha për topat, se këto do të harxhohen, ose një pjesë do të dëmtohet,

dhe lind nevoja që të prodhohet gjithçka që harxhet, të zëvendësohet apo të riparohet çdo gjë që është dëmtuar. Mirëpo për këto çështje është e nevojshme të merren masa me kohë, në bazë të vendimeve që kemi. Për këtë të punojnë mirë vetë rrethet, të gjithë njerëzit e caktuar me këto detyra. Natyrisht, ne kemi një përgjegjësi të madhe si për çdo problem, edhe për çështjen e mbrojtjes, por për të zbatuar ato që vendos Byroja Politike, përgjegjësi kanë të gjithë kuadrot në bazë, sepse duhet t'i vënë në jetë vendimet e Partisë dhe për këtë qëllim ata i kanë të gjitha mjetet dhe forcat. Kjo të kuptohet mirë. Ne kemi përgjegjësi për të kërkuar llogari që të zbatohen vendimet e marrë, kurse kuadrot në dikastere e në rrethe kanë përgjegjësi të madhe për vënien e tyre në jetë. Përderisa vendimet e detyrat janë të qarta, atëherë përsë nuk zbatohen? Këtu është gjithë problemi dhe pikërisht këtu duhet ndalur, se ky është një problem kyç.

Është e domosdoshme të kuptohet që për mbrojtjen të punojë mirë baza, se kur të shpërthejë lufta, Komanda e Përgjithshme do të japë urdhra lakinikë, sa të jetë e mundur më rrallë, prandaj, për zbërthimin e urdhrit do të duhet të punojë mendja e shokëve në bazë, që nga komandanti e deri tek ushtari. Komanda nuk duhet të zbërthejë deri në një urdhrat dhe udhëzimet e saj, sepse e mëson keq bazën, i bën vartësit automatë. Prandaj është e nevojshme që baza të punojë vazhdimesht dhe t'i zhvillojë vetë udhëzimet që u ka dhënë Komanda.

Stërvitja fizike e njerëzve tanë që në kohë paqeje ka rëndësi të madhe. Ajo duhet të jetë intensive, saqë,

si i thonë fjalës, njeriu të jetë në gjendje që sa hap e mbyll sytë të vejë në majë të malit, pra të vrapojë pa u lodhur me shpejtësinë e sorkadhes, për të shpëtuar nga rrethimi i armikut, të kapërcejë malin e Tomorit brenda një kohe shumë të shkurtër, të dijë të përdorë skitë, automobilin, të notojë etj., etj. A bëhen të gjitha këto? Është e kuptueshme se Komanda nuk mund t'i parashikojë në detaje të gjitha këto gjëra, ndryshe atyre të bazës çfarë u mbetet të bëjnë? Dikush mund të thotë: ku do t'i gjejnë të gjitha ato çka duhen përkëtë lloj stërvitjeje? Çështja nuk duhet të shtrohet se më mungon kjo apo ajo pajisje, por kur jepet urdhri e caktohet detyra, menjëherë duhet të fillohet nga puna për zbatimin e tyre. Në radhë të parë puna fillon me ato që ke, pra me kalitjen e stërvitjen fizike, me ushtrime, vrapime, me kapërcime e me ngjitje, pastaj me të tjerat. Dhe të gjitha këto do të bëhen në punë e sipër, me vendosmëri, me zgjuarsi. Për shembull, në vend që të presësh telin, i cili mund të japë korrent ose sinjal, fare mirë mund të hidhesh e ta kapërcesh dhe ta kryesh detyrën që të është caktuar.

Për këto çështje repartet ushtarake, shtabet e rretheve, njerëzit e caktuar me këtë detyrë, atje në bazë, duhet të mendojnë seriozisht, në të gjitha drejtimet.

Na vihet detyrë që situatat t'i përballojmë dhe do t'i përballojmë me mjetet dhe armët tonë. Për këtë kërkohet t'i njohim mirë gjendjen, terrenin, mjetet dhe ta kemi të qartë se situata nuk mund të përballohet pa marrë të gjitha masat e domosdoshme. Po të përgatitemi si duhet, le të vijë sa të dojë armiku edhe me avionë të shpejtë. Natyrisht, ai do të na djegë, do

të na dëmtojë, por nuk do të mund t'i vrasë dot një-rëzit tanë, as në tokën tonë nuk do të shkelë dot. Edhe po shkeli në ndonjë sektor, me mjetet moderne që disponon ai nuk mund të veprojë si të dëshirojë, sepse edhe ne kemi mjete për të luftuar kundër tij. Ne rrimë në gatishmëri dhe e presim armikun me gishtin në shënjestër.

*Pastaj biseda u zhvillua rreth problemeve që kishin dalë në ndërtimin e Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit, si dhe për respektimin e afateve të ndërtimit të veprave dhe objekteve të pesëvjeçarit. Lidhur me këto shoku Enver Hoxha tha:*

Sa për rreziqet e furrnaltës, ajo që ka rëndësi, mendoj unë, është që të gjithë ata që punojnë në metalurgji duhet të jenë të ndërgjegjshëm për profesionin e metalurgut, që nuk është i lehtë, por shumë i komplikuar. Fakt është se aksidente ngjasin edhe në kombinatet e mëdha metalurgjike e siderurgjike të botës, ku punojnë specialistë «me mjekër», si i thonë fjalës, me eksperiencë të madhe, që kanë një traditë disa qindravjeçare në këtë degë të industrisë së rëndë. Ja, për shembull, para pak kohësh, në kombinatin metalurgjik të Tarantos në Itali, pikërisht në furrnaltë ndodhi një aksident, u vranë edhe punëtorët brenda saj, për arsyе se gazi u mblodh, pastaj plasi, gjë që shkaktoi vdekjen e njerëzve që ishin duke punuar.

Është e nevojshme që njerëzit tanë, specialistë të metalurgjisë, t'i futen mirë studimit të proceseve të ndryshme, të rregullave e normave, që këto të zbatohen si duhet. Ne, natyrisht, nuk i kuptojmë këto, kurse ata i kuptojnë. Megjithatë edhe ata nuk i dinë

si duhet të gjitha dhe nuk zbatojnë në kohën e përshtatshme rregullat e normat e caktuara, prandaj ndodhin edhe avari. Këto, avaritë, duhet të evitohen sa më shumë, prandaj të gjithë specialistët dhe teknikët që punojnë atje të jenë jashtëzakonisht të kujdeshshëm. Eksperiencia e fituar të bëhet mësim. Dihet që ngjitje në muret e furrnaltës do të ketë, një gjë e tillë do të ndodhë vazhdimi, për arsy se furrnalta vazhdon të punojë dhe djegia e krijon këtë. Në qoftë se vazhdohet të prishet muri, do të ndërpritet puna në furrnaltë dhe do të detyrohem i tij bëjmë remontin kapital të objektit. Një gjë e tillë nuk duhet të na ndodhë, se ndërprerja e prodhimit për një kohë të gjatë na dëmon.

Ky problem duhet studiuar. Specialistët t'u futen thellë proceseve të punës, jo vetëm fenomeneve të përgjithshme, me qëllim që të zbulojnë përse shkaktohen avari e aksidente. Ndonjëri mund të thotë se këto janë të pacvituveshme. Dakord, por ata duhet të dinë përse shkaktohen dhe në sa kohë shkaktohen, që t'u dilet përparrat situatave dhe jo të pritet sa të zihet vrima e furrës dhe të detyrohen që, për ta hapur, të futin një sasi të madhe dinamiti, gjë që është krejt e palejueshme, sepse dëmon muret e furrnaltës. Unë po perifrazoj këtu, duke u bazuar në ato që na thuhen. Mendimi im është se nga të gjitha degët e industrisë që kemi ne, metalurgjia është më kryesorja dhe më e komplikuara. Aksidente edhe mund të ndodhin, se ata që punojnë tanë në metalurgji janë të rinj, me gjithatë, duhet të bëjnë kujdes të madh që t'i parandalojnë sa të jetë e mundur më shumë aksidentet.

Sic u tha edhe këtu, në metalurgjik ka një entuziazëm të papërshkruar dhe punëtorët morën zotime se do t'i realizojnë planet, pavarësisht nga vështirësitet e krijuara nga kinezöt. Natyrisht, këto zotime nuk do të realizohen në një ditë, se për to ka afate të caktuara, të cilat duhet të respektohen medocemos. Për këtë problem duhet ndalur seriozisht për të parë cilat makineri do të bëhen këtu e cilat jo. A mendohet që tashti se si do të veprohet? Këtu nuk është fjala për të gjetur treg për një palë këpucë, por për të blerë makineri të tillë për një repart të tërë. Pra, është çështja nëse do ta ndërtojmë apo nuk do ta ndërtojmë repartin. Ky është një problem.

Ne do ta thajmë shllamin, domethënë do ta koncentrojmë, pastaj do ta eksportojmë atë, sic kemi shitur edhe bakrin, por do ta shesim të koncentruar, me qëllim që të marrim një vlerë më të madhe, sigurisht, jo sa vlerën e kobaltit të pasruar, por diçka më tepër sesa po të shitej ky material i pakoncentruar. Dhe jemi të detyruar që këto para t'i depozitojmë. Mendimi im ka qenë që për kontingjentet që do të shesim, paratë e marra duhet t'i depozitojmë, që të jemi në gjendje t'u përgjigjemi kërkesave të importit.

Çështja e respektimit të afateve të caktuara për ndërtimin e objekteve të mbahet më mirë parasysh. Ne duhet ta kuptojmë se pa vështirësi nuk bëhen këto ndërtiune, por të ngulim këmbë që objektet të mbarojnë në afatet e caktuara. Detyra është të mobilizohet mirë administrata shtetërore. Partia të bëjë të ndërgjegjshëm njerëzit për vendimet që merren. Para se të merret një vendim, të shikohet mirë gjendja.

çfarë duhet bërë e kush do t'i bëjë. Kjo është një punë paraprake e domosdoshme, ndryshe nuk mund të punohet me plan dhe me disiplinë.

Për sa u përket pajisjeve e makinerive që duhet të importojmë, medoemos të mendohet e të mendohet mirë nga Kryeministria, nga Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe nga të gjitha dikasteret e tjera e të gjy-kohet me kujdes se sa mund të na kushtojnë, cilin shtet do të preferojmë, ç'do të bëjmë po të na kushtojnë më shumë, çfarë do të sigurojmë sivjet apo mot etj., etj.

Të sigurohet mirë mobilizimi i masave, të mos pritet gjithmonë urdhër nga lart për çdo punë, por të veprohet me iniciativë. Në, në qendër, jemi për t'u dhënë ndihmë organeve më të ulëta, por jo «për t'i ushqyer me lugë». Ne do të dërgojmë në rrethe ato që duhen, pra, kripën e miellin, por bukën ta gatuajnë vetë. Përse i ka siguruar Partia gjithë këta kuadro, gjithë këta inxhinierë, kryeinixhinerë, drejtore, specialistë etj.? Që këta të bëjnë jo vetëm bullonin, por edhe projektin, të vrashin mendjen derisa t'ia arrijnë qëllimit. Natyrisht, nuk mund të themi se njerëzit tanë nuk e vrashin mendjen, por sjala është të punohet më shumë në këtë drejtim.

Mua më duket se kuadrot drejtues të rretheve që raportojnë, nuk janë nü lartësinë e kuadrove e të specialistëve të bazës. Ju keni kontakt më shumë nga unë me ta, kështu që mund edhe të gabohem në këtë mendim që jap, sidoqoftë duhet parë kjo çështje. Dhe të jemi të qartë se në fund të fundit punën në ndërmarrje nuk e bëjnë as kryetari e sekretari i komitetit

ekzekutiv, as edhe sekretari i komitetit të Partisë të rrethit, por e bëjnë punëtorët, organizatat e Partisë. Drejtuesit e Partisë dhe të pushtetit në rreth duhet të përgjigjen deri në një për realizimet e mosrealizimet, ta ndihmojnë vërtet bazën. Punonjësit e bazës venë kërkojnë ndihmë në komitetin ekzekutiv dhe në atë të Partisë, por shtrohet çështja që edhe kryetari i komitetit ekzekutiv, edhe sekretari i komitetit të Partisë duhet të venë ta pyesin shesin e industrisë pranë komitetit ekzekutiv të rrethit, për shembull, në Elbasan, drejtorin e ndërmarrjes etj., se si i kanë punët. Po pse të venë? Sepse në këtë mënyrë, kur ky apo ai do të kërkojë të dijë përse nuk realizohet plani, do të ndeshet edhe përpara ndonjë kritike ose kërkese: pa na jep ato që na takojnë! Kështu duhet ta krijojmë ne këtë bashkëpunim e kontroll reciprok; me udhëheqje nga lart, por edhe me kontroll nga poshtë.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

# SUBJEKTIVIZMI DHE KULTI I PERSONIT JANË KURDOHERË SHUMË TË RREZIKSHËM

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

4 shtator 1978

Në këtë takim shoku Enver Hoxha vuri në dukje rolin e masave dhe të individit në histori dhe pastaj u ndal në artikullin e botuar në «The Worker», organ i Partisë Komuniste të Britanisë (marksiste-leniniste), si dhe në artikullin e «Zhenminzhibaos»: «Mbi falsitetin e Lin Biaos: Çdo sfjali është e vërtetë».

Partia jonë, duke u mbështetur në shkencën marksiste-leniniste, ka luftuar dhe gjithmonë do të luftojë kundër kultit të personit. Por, historia duhet të shkruhet realisht në mënyrë që të vihet në dukje, në radhë të parë, veprimtaria e madhe e popullit me Partinë në krye, dhe pastaj veprimtaria e udhëheqësve ose e njerëzve të veçantë, sepse edhe këta kanë luajtur dhë luajnë një rol të madh, si dje në luftën për çlirimin e vendit, ashtu edhe sot në ndërtimin e socializmit.

Natyrisht, janë masat ato që bëjnë revolucionin, por rëndësi kanë edhe udhëheqjet, që përsaqësohen

nga njerëz të fryshtuar e të edukuar nga Partia, të cilët kanë treguar aftësi të rralla organizative e drejtimi dhe besnikëri ndaj vijës së Partisë e të popullit, duke dhënë kështu kontributin e tyre në revolucion. Në raste të caktuara, ky kontribut duhet të dalë në pah, për arsyen se edhe masat, populli, e duan këtë. Partia jonë e ka orientuar kurdoherë drejt popullin në këtë çështje.

Eshtë e qartë se lufta nuk mund të bëhet nga një njeri, nga dy ose tre njerëz. Ajo nuk mund të bëhet as edhe nga një brigadë e veime, qoftë edhe nga dy ose tri brigada. Ajo bëhet, siç u bë te ne, nga një masë e madhe populli, e udhëhequr nga Partia, me një vijë të qartë, të drejtë dhe parimore marksiste-leniniste. Me thirrjen e Partisë populli u ngrit në këmbë, u organizua në çeta e më vonë në batalione, brigada etj. derisa erdhi një kohë kur gati të gjithë banorët e qytetit e të fshatit morën pjesë në luftën për çlirimin e atdheut.

Unë nuk them se këto çështje nuk vihen në dukje në shkrimet e ndryshme. Ato vihen, por kur shkruhet për to, duhet të mos shkruhet në prizmin subjektiv. Kjo duhet mbajtur mirë parasysh, sepse ta shkruash historinë në mënyrë subjektive, ose duke marrë parasysh kultin e disa personave, do të thotë të mos e edukosh mirë popullin, pse një gjë e tillë mund të ketë dhe ka, në teori e në praktikë, pasoja të rënda, shumë të dëmshme. Këtë çështje unë e kam theksuar edhe herë të tjera dhe kjo duhet të na preokupojë vazhdimiشت.

Partia është një forcë e madhe në rritje e në

zhvillim dhe kurdoherë e re. Kjo është dialectike. Sot, në sajë të punës, të cilën na e ka çmuar Partia, duke na caktuar ne në detyra me përgjegjësi, përpinqemi, luftojmë, japim sa mundim dhe kështu do të punojmë deri në fund, me të gjitha forcat tona, për të mirën e Partisë e të popullit. Por, natyra ka ligjet e saj, mosha bën punën e vet. Pas nesh do të vijnë shokë të tjerë udhëheqës. Ne do të punojmë qysh tash që ata të njihen nga masat e popullit, në mënyrë që kur të vijë koha të vdesë njëri ose tjetri nga ne, njerëzit të mos fillojnë nga të qarat. Ca më tepër të qarat e dëshpëruara nuk i shërbejnë çështjes sonë.

Për marksistë-leninistët është e qartë se vija e Partisë mbrohet nga e gjithë Partia, nga i gjithë populli. Në radhët e Partisë, në masat e gjera të popullit, punojnë dhe luftojnë me vëtëmohim gjithë njerëzit tanë. Por këto çështje dhe të tjera si këto kanë të bëjnë edhe me ligjet e natyrës. Prandaj ritheksoj se ato duhen pasur vazhdimesh parasysh. T'ju them të drejtën, nuk më erdhi aspak mirë dhe nuk m'u duk fare e drejtë që, kur lexova një artikull që ishte botuar në gazeten «Ushtima e maleve» me rastin e 34-vjetorit të çlirimtës së Dibrës, emri i Haxhi Lleshit nuk zihej me gojë. Mirëpo, të gjithë e dinë se Haxhiu ka qenë një nga luftëtarët tanë më të shquar të Luftës Nacionalçlirimtare, sidomos në atë rreth, dhe kontributi i tij në luftën për çlirimin e territorit të rrethit të Dibrës ka qenë i madh.

E kështu me radhë mund të flasim edhe për të gjithë shokët e tjerë, për të cilët, në raste të tillë, duhet folur.

Këto çështje të trajtohen si duhet nga Partia dhe ne i kemi të gjitha mjetet e mundësítë e shtypit e të propagandës pér ta bërë më së miri këtë punë. Nuk është e drejtë që këto gjëra të konsiderohen pa rëndësi, siç ndodh në disa raste kur konstatohen qëndrime subjektive.

«Ti i cilës brigade je?», e pyesin njërin. «Jam i filan brigade...» përgjigjet ai. «Mirë, na shkruaj një artikull!» e porositin. Dhe ai i futet punës dhe e shkruan artikullin. Por, kur botohet, shohim se aty ai më shumë se brigadën e shokët ngrë veten e tij, pra, ka shkruar si ka dashur.

Këtë çështje shtypi ynë duhet ta shikojë në mënyrë të ekuilibruar. Në një brigadë, fjala vjen, ca kanë luftuar më mirë, ca kanë luftuar më pak; ca janë treguar më aktivë e kanë luftuar më me trimëri e guxim, kurse, ka pasur edhe nga ata që janë treguar më të mëfshtë. Kështu ka ndodhur edhe në batalionet e në njësítë e tjera: njëri ka qenë më i hedhur, kurse tjetri më i ngathët në veprime. Të gjitha këto janë të natyrshme dhe ndodhin në jetë, prandaj, kur shkruhet, duhet të shkruhet pér të gjitha këto dhe me saktesi e paanësi.

Ja, është shkruar, pér shembull, pér marshimin e Brigadës së Parë Sulmuese. Unë e kam lexuar dytri herë librin e botuar pér këtë brigadë. Por autorii aty ka harruar të shkruajë edhe një gjë me shumë rëndësi, që Shtabi i Përgjithshëm e çau rrethimin e armikut para se të arrinte kjo brigadë në ndihmë. Përse duhet ta thoshte ai edhe këtë? Duhet ta thoshte,

për arsyec se Shtabi i Përgjithshëm me të vërtetë u rrethua, por për të dalë nga rrethimi, atë e ndihmoi populli pa arritur akoma Brigada e Parë dhe kjo është një çështje shumë e rëndësishme.

Në këtë ngjarje ka kontribuar populli i Dibrës, i Çermenikës, i Martaneshit dhe i të gjitha krahinave të tjera përreth. Pra, ishin njerëzit e popullit që na ndihmuani, ndryshe do të na kishin kapur. Kjo duhej thënë në librin e botuar. Në libër duhej vënë në dukje gjithashtu se Shtabi i Përgjithshëm e bëri detyrën e vet. Pse duhej vënë në dukje? Sepse kur nuk e thua këtë, tjetri ka të drejtë të pyesë: «Epo mirë, ç'u bë ky Shtabi i Përgjithshëm? E shpëtuat ju? Mirëpo, ju shkuat deri atje, po nuk morët kontakt me të, sepse Shtabi, kur arritët ju, kishte dalë nga rrethimi. Pastaj ju kaluat në Pezë për të luftuar, por kjo është një punë tjetër».

Kush e nxori, kush e ndihmoi Shtabin e Përgjithshëm ta çante rrethimin? Për krahja dhe lufta e popullit. Të gjithë pjesëtarët e Shtabit shkuan nga një zonë në tjetrën, në fshatrat e Dibrës e, prej andej në ato të Martaneshit; pastaj në Çermenikë, në Valës e gjekë, derisa dolën përfundimisht nga rrethimi. Ai që shkruan për marshimin e Brigadës së Parë Sulmuese, patjetër që duhet t'i përmendë të gjitha këto fakte historike. Por për Shtabin aty nuk thuhet asnjë fjalë. Këto çështje duhen parë me kujdes e të mos shkruhet pa u thelluar, se kanë shumë rëndësi për Partinë!

---

1. Në këtë kohë nuk njihej akoma veprimtaria armiqësore e Mehmet Shehut, por, pavarësisht nga kjo, kritika në fjalë i

Pasqyrimi real i njëjarjeve të ndryshme dhe me frysë partie i shërben pozitivisht edukimit të njerëzve, çështjes sonë. Subjektivizmi, ashtu si edhe kulti i personit, janë kurdoherë shumë të rrezikshëm, prandaj çdo gjë duhet bërë me masë dhe aq sa e do interesni i Partisë. Kështu duhen gjykuar problemet nga secili. Sot populli ka në gjirin e tij plot njerëz të ndershëm, të edukuar nga Partia e të zotë për të udhëhequr. Udhëheqësit duhen, sepse ata kanë rolin e tyre, mbasi as lufta nuk mund të bëhet pa udhëheqës, as edhe një shtet nuk mund të qëndrojë në këmbë pa udhëheqës. Edhe një ministri nuk mund të kryejë detyrat që i ngarkohen pa drcjtues. Po kështu, edhe Komitet Qendror nuk mund të ketë pa udhëheqës e të tjera, e të tjera. Kjo është e natyrshme. Prandaj, atyre që janë dalluar e dallohen në luftë e në punë, me raste, duhet t'u vihet në dukje veprimtaria e tyre e mirë.

*Pas kësaj, në takim u bisedua për luftën që ka zhvilluar Partia jonë kundër revizionizmit modern. Duke folur për këtë problem, shoku Enver Hoxha tha:*

Me të gjithë revisionistët ne, vazhdimi, kemi

---

takon drejtpërdrejt atij. Të nxitur nga M. Shehu, jo vetëm në librin për të cilin bëhet fjalë këtu, por dhe në shkrime e botime të tjera, i thurej lavdi «inkursionit» të Brigadës së Parë Sulmuese, gjoja sikur ajo kishte bërë tërë ato sakrifica e heroizma, për t'i ardhur në ndihmë Shtabit të Përgjithshëm, që qe rrrethuar, kurse e vërteta ishte krejt ndryshe. Shtabi i Përgjithshëm doli nga rrëthimi me ndihmën e përkrahjen e popullit. Përkundrazi, M. Shehu i vërtiti forcat e kësaj brigadë për dy javë në zona të vështira për të komplikuar gjendjen e, nga ana tjetër, atij t'i rritej fama si «luftëtar i shquar» e «strateg i madh ushtaraku».

qenë dhe jemi në luftë për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit.

Mbrëmë lexova një artikull të «Zhenminzhibaos» në të cilin kritikoheshin Lin Biaoja dhe «banda e të katërve». Në këtë artikull thuhet se «çdo fjali që thotë kryetari Mao, është e vërtetë dhe mban një peshë të tillë sa për dhjetë mijë fjalë të zakonshme». I tënë ky artikull është përgatitur kundër nesh, se Lin Biaoja përdoret vetëm si kokë turku. Po të lexohet me kujdes dallon se ky artikull puqet plotësisht me artikullin e gazetës angleze «The Worker», për të cilën kam folur edhe më parë. Ky artikull është botuar më 10 gusht të këtij viti në organin e Partisë Komuniste të Britanisë. Kur ishte këtu, përsaqësuesi i saj pati biseduar me shokun Ramiz, i cili ja tha mendimet që kishte lidhur me vërejtjet që ky shok kishte bërë për librin «Imperializmi dhe revolucioni». Kur iku, ai i la me shkrim pikëpamjet e tij.

Kur isha me pushime në Pogradec, meqenëse porishikoja librin «Imperializmi dhe revolucioni», kërkova të, më dërgonin mendimet që kanë shprehur rreth këtij libri shokët e partive marksiste-leniniste, të cilëve ua dhamë për ta lexuar. Unë i lexova me kujdes të gjitha vërejtjet e bëra prej tyre. Por, kur lexova ç'kishte thënë anglezi, vura duart në kokë. Kuptova se ai ishte shumë larg nesh. Ai del kundër kritikës që i bëhet Mao Ce Dunit. «Pse e shkruani ju këtë material, — pyet ai, — a ju takon juve ta bëni këtë?». Dhe më poshtë vazhdon: «Unë i njoh, se jam takuar me Mao Ce Dunin e me Çu En Lain dhe më kanë lënë përshtypje të mira». Pak më poshtë ai vazhdon: «Po pse merreni

ju me fantazmat?». Domethënë, sipas tij, të tërë këta, që nga Stalini, nga shokët e Kominternit e deri edhe Mao Ce Duni, pa ia zënë emrin në gojë, sipas tij, janë fantazma, janë njerëz të vdekur etj.

Vërejtjet e bëra nga ky «komunist» anglez tregojnë se ai është një njeri i maskuar, një revizionist. Pasi u njoha me vërejtjet e tij, i shkrova nga Pogradeci një letër të gjatë Ramizit<sup>1</sup>, ku i analizoja të gjitha ato ç'kishte thënë anglezi.

Pra, siç ju thashë më lart, artikulli i tij u botua në gazeten angleze «The Worker». Ç'përbajtje ka ky artikull redaksional? Në fillim thuhet se pushteti i sovjetëve ishte pushteti i parë i proletarëve, i themeluar dhe i udhëhequr nga Lenini, rrugën e të cilit e vazhdoi Stalini, që e drejtoi popullin punonjës të Bashkimit Sovjetik drejt fitoreve socialiste dhe luftës kundër fashizmit etj. Kjo ishte njëkohësisht një fitore e madhe për gjithë klasën punëtore dhe për revolucionin botëror, thotë artikulli. Pastaj atje hidhen poshtë përpjekjet e ca intelektualëve borgjezë revisionistë, shërbëtorë të fundit të imperializmit, për të rehabilituar grupin e Buharinit e të antimarksistëve të tjerë që janë përpjekur të errësojnë veprën e Stalinit të madh, i cili udhëhoqi popujt në luftën e tyre për çlirim etj. Dhe, pavarësisht nga tradhtia e revisionistëve hrušovianë, thotë artikulli, pushteti i sovjetëve dhe vepra e madhe e Lenin-Stalinit mbetet e pashlyeshme, e pamohueshme. Mirë deri këtu.

Një fitore tjetër e madhe, e pamohueshme për kla-

---

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 67, f. 381.

sën punëtore dhe për revolucionin, shkruhet më poshtë në këtë artikull, është lufta e popullit shqiptar, i cili pa ndihmën e kurrikujt mposhti armiqëtë, bëri këtë dhe atë vepër, ndërtroi socializmin, kështu e ashtu etj.

Në artikull flitet edhe për Kinën. Populli kinez, nën udhëheqjen e Mao Ce Dunit, thuhet atje, luftoi për çlirimin e vendit nga agresioni imperialist, bëri revolucionin dhe Kina 800 milionëshe zhduku urinë, shporri varfërinë, sëmundjet e të gjitha të këqijat e tjera.

Dhe më në fund vjen «buketa»: «Duke pasur parasysh situatat që kanë kaluar, domethënë daljen në skenë të revisionistëve në Kinë, do të jetë një punë armiqësore që të akuzohen Mao Ce Duni dhe Çu En Lai se nuk kanë qenë në rrugën marksiste-leniniste; kjo është një shpifje e madhe», thekson ai. «Ata që bëjnë një gjë të tillë, ideologjikisht hyjnë në radhën e elementeve buharinistë, të inteligjencies së re revizioniste, që është vënë në shërbim të kapitalit» etj. Dhe konkluzioni i gjithë artikullit është ky: «shokët rusë dha shokët kinezë na kanë hapur rrugë të reja, nëpër të cilat do të ecim të gjithë ne!».

Duket qartë, i shkrova Ramizit në letrën që i dërgova nga Pogradeci, që ky anglez është një variant i Hillit të Australisë, që të dy janë agjentë të borgjezisë, së cilës i duhen të tillë njerëz, asaj i intereson ta mbrojë Mao Ce Dunin.

Të kthehem prapë te artikulli i «Zhenminzhibaos», që u dha dje nga agjencia HSINHUA. Është po kjo pikëpamje. Kinezët shtrojnë problemin që marksizëm-leninizmi dhe idetë e Mao Ce Dunit janë një; që marksizëm-leninizmi dhe maocedunideja është një sis-

tem i plotë dhe integral dhe, kush e ndan këtë në fraza e nö fjali, ai, sipas tyre, është antimarksist. Domethënë, marksizëm-leninizmi e maocedunideja, sipas këtij artikulli, janë një e tërë, ku pjesët përbërëse janë lidhur ngushtë njëra me tjetrën në një unitet organik. Dhe këtë të tërë duhet ta njoħe njerëzimi, vë nö dukje artikulli, se nö bazë të saj do të ndërtohet bota e re. Prandaj kjo nuk mund të copëtohet, se shkatérrohet.

Pastaj revizionistët kinezë citojnë Leninin, i cili, lidhur me veprën e Marksit dhe të Engelsit, nö luftë me përpjekjet e oportunistëve e të buharinistëve për t'i hequr filozofisë marksiste materializmin historik, ka thënë:

*«Nga kjo filozofi e marksizmit e derdhur nö një bllok të vetëm çeliku, nuk mund të heqësh asnjë premisë themelore, asnjë pjesë të rëndësishme pa u larguar nga e vërteta objektive, pa rënë nö prehrin e gjenjeshtrës reaksionare borgjeze»!*

Dhe, gjoja, këtë çelik të vetëm mü kot u pérpeq ta copëtonte Buharini! Shiko, doli prapë Buharini, por këtë herë nö artikullin e kinezëve. Kjo do të thotë se kinezët kanë marië dijeni pér ekzistencën e librit «Imperializmi dhe revolucioni», por mcqë nuk mund të na sulmojnë drejtpërdrejt, pér arsy se del nö shesh e vërteta se ku e mësuan këtë, ia kanë veshur Lin Biaos, duke thënë plot gjëra kundër tij, se ai nuk ka qenë marksist, por një idealist, një puçist e akuza të tjera ç'të duash si köto.

Pastaj kinezët Lin Biaon dhe «bandën e të katërve» i akuzojnë si pragmatistë dhe eklektikë. Pra, doli edhe këtu çështja e pragmatizmit dhe e eklektizmit, që trajtohen nga Partia jonë. Por, ato trajtohen edhe në librin «Imperializmi dhe revolucioni». Në artikull del po ashtu edhe problemi tjetër që në Kinë nuk po ndërtohet socializmi, që e kemi thënë edhe ne e të tjera, e të tjera, që të mos i përsëris tani.

Domethënë ata, pasi thonë gjithë ato akuza për Lin Biaon, që ka thënë kështu e ka thënë ashtu, me këtë artikull u dalin përparrë pikëpamjeve tona, pikëpamje që vërtetohen në realitet. Dhe, duke shtruar, problemin që marksizëm-leninizmi dhe maocedunideja janë një, theksojnë se nuk duhet të mbështetemi në një fjali të Mao Ce Dunit, se ky ka folur edhe për ekonominë, edhe për çmimet, edhe për atë, edhe për këtë, në kohë të ndryshme, duke vënë në dukje herë një aspekt e herë një tjetër.

Pastaj artikulli, pasi gjoja polemizon, vjen në konkluzionin tjetër, i cili na drejtohet neve, duke vënë në gojë të Mao Ce Dunit fjalët: «Në qoftë se ndokush pretendon se ekziston ndonjë shok i Komitetit Qendror që i kuption plotësisht ligjet e revolucionit kinez, ai gabon». Me këtë ata duan të thonë se nuk i kishin kuptuar ligjet e revolucionit. Kjo është thënë kështu nga vetë Mao Ce Duni. Me fjalë të tjera, ata duan të thonë me këtë se nuk dinin si bëhej revolucioni, se çfarë revolucioni po bën, prandaj ecën nga disfata në fitore, nga fitorja në disfatë e përsëri nga disfata në fitore, derisa arriten në çlirim, në fitoren e revolucionit demokratik, në vendosjen e shtë-

tit të demokracisë populllore. Pastaj, pas çlirimit, partia iu fut procesit të njohjes së ligjeve që drejtojnë revolucionin socialist!

E gjithë kjo tregon se udhëheqësit kinezë janë në dijeni të analizës që u kemi bërë ne këtyre problemeve në materialin tonë dhe duan ta shpjegojnë këtë me mënyrën e zhvillimit antagonist të gjërave, domethënë: fitore-disfatë, disfatë-fitore, eksperiencë praktike, nxirr ligje, siç ka thënë Mao Ce Duni, turbulloje ujin etj., etj. Është e vërtetë, vazhdon artikulli, se Lin Biaoja dhe «banda e të katërve» kanë bërë shumë gjëra të köqija gjatë Revolucionit Kulturor. Kështu, për shembull, thënien e Maos në vitet pesëdhjetë se «rreziku kryesor është empirizmi», gjoja për të kundërshtuar empirizmin idealist, ata e paskan përdorur në vitet shtatëdhjetë për të kundërshtuar kuadrot revolucionarë që kishin eksperiencë të madhe. Kuptohet qartë se me këtë revizionistët kinezë duan të thonë se empiristë idealistë nuk janë këta që kanë ardhur në fuqi, por Lin Biaoja me «katërshen»; se pragmatistë nuk janë këta, por Lin Biaoja me shokë.

Kjo tregon se ata janë në dijeni të goditjeve tona drejtuar kundër teorisë së Mao Ce Dunit, që është eklektizëm me brirë. Udhëheqësit aktualë kinezë përpilen t'i shpjegojnë gjérat me procesin e zhvillimit të kontradiktave, me të famshmet kontradikta vulgare të Mao Ce Dunit! Pra këto gjëra, për të kapur hallkën kryesore në ngjarjet që zhvillohen, për ecjen në këtë mënyrë të revolucionit kinez, derisa të gjejë vend, si pas tyre, na qenkan normale!

Tashët çështjen e kam këtu që renegati anglez në

artikullin e «The Worker»-it mban qëndrim kundër udhëheqësve aktualë kinezë që kanë devijuar nga marksizmi. Ai thotë se ata janë tradhtarë, por nga ana tjetër del pro Mao Ce Dunit me shokë, të cilët, sipas tij, janë të gjithë marksistë-leninistë. Po kështu edhe Lenin me Stalinin janë marksistë të mëdhenj, kurse udhëheqësit e sotëm revizionistë sovjetikë janë tradhtarë, thotë ai. Pra, bën analogji dhe vazhdon: «Cilët janë ata që kanë sharë Leninin e Stalinin? Buharinistët. Kështu është edhe tani: ata që kritikojnë Mao Ce Dunin janë buharinistë». Pra, sipas anglezit, ne qenkemi buharinistë! Po ne e dimë fort mirë se ç'është buharinizmi dhe ç'thotë Lenini për buharinistët. Por, sulmi i këtij rencgati e ka burimin te çështja se ne i kemi thënë atij dhe kemi shkruar në librin «Imperializmi dhe revolucioni» që sindikatat aktuale në vendet borgjeze janë nën drejtimin e kapitalit, të borgjezisë dhe të aristokracisë. «Nuk jam dakord, — na tha neve ai, — për këtë gjë ju jeni kundër organizimit të klasës punëtore, jeni buharinistë» etj.

Lufta tani do të bëhet rreth kësaj çështjeje: këta, Ten Hsiao Pini me shokë u dogjën, prandaj duhet mbrojtur maocedunideja. Kjo i duhet borgjezisë ta ruajë për qëllimet e veta, sepse kjo është tani e vetmja teori revizioniste e veshur me rroba marksiste për të gjënjyer proletariatin dhe botën. Revizionizmi sovjetik është demaskuar; titizmi po kështu është demaskuar, siç është demaskuar edhe eurokomunizmi. Edhe revizionizmi i Hua Kuo Fenit po demaskohet me të gjitha këto gjëra që bëjnë ai me shokë, prandaj, maocedunideja duhet ruajtur. Kjo është parulla e amerika-

nëve dhe e kapitalit. Hilli është në bllok me Hua Kuo Fenin dhe me Mao Ce Dunin. Anglezi dhe kilianët ndahen në këtë çështje: ata janë pro Mao Ce Dunit, pra, nuk janë dakord me ne, ata janë dhe kundër «katershes».

Që të ruhet maocedunideja, nga borgjezia po përdoren e do të përdoren të gjitha mënyrat. Për të përçarë lëvizjen punëtore dhe partitë marksiste-leniniste do të gjendet patjetër një arsy, ja, siç po kafen tanë pas Mao Ce Dunit. Për këtë ata do të bëjnë edhe paralelizma absurdë. «Ashtu si hrushovianët sulmuani Stalinin, edhe ju po sulmoni Mao Ce Dunin», do të na thonë. Hrushovi ishte revizionist, por edhe Ten Hsiao Pini me Hua Kuo Fenin janë revizionistë dhe kjo është e qartë. «Po, pas këtyre, ne ndahemi me ju, — vazhdojnë ata, — sepse ju sulmoni Mao Ce Dunin, gjë që nuk duhet ta bëni». «Pse i sulmoni ju këto fantazma?», na thonë. «A ju takon juve të merrni këtë barrë të rëndë mbi vete? — thotë anglezi. Dale, se ju jeni të vegjël! Pse filloni ta atakoni ju Mao Ce Dunin?».

Eshtë e qartë se tash kinezët e panë që Hilli u dogj dhe nuk e dëgjon më njeri. Prandaj ata i thanë anglezit: «Dil në skenë, se mbapse frenohen shqiptarët, mbasi ty të kanë mik!».

Nuk duhet menduar kurrë që ky «mik» i thoshte sinqerisht ato gjëra që na këshillonte, se gjoja po na qante hallin! Jo, jo! Ai është njeri i borgjezisë, i sindikatave të drejtuara nga borgjezia angleze. Sa mafifete përdor borgjezia për të realizuar qëllimet e saj! Për një moment, për të shkaktuar një përçarje, ajo e nxjerr tjetrin sikur është marksist-leninist i kulluar.

Pastaj, prapë bën të sajën, ja, siç po bën, për shembull, me artikullshkruesin e «The Worker»-it.

Një gjë e tillë kërkon që ne të jemi shumë vigjilëtë. Me shokët e partive marksiste-leniniste të jemi shumë të kujdeshi, të matur e të duruar, sepse midis tyre ka shokë të mirë, por ka edhe shokë që akoma nuk e kanë të qartë, në tërësinë e tij, rrezikshmërinë e revizionizmit kinez. Ka pastaj edhe njerëz si rengati anglez, që erdhi në vendin tonë, i cili duket se është i lidhur me borgjezinë. Por, mund të ketë edhe njerëz që nuk janë agjentë të borgjezisë, por që kanë mbetur prapa dhe nuk e kuptojnë mirë teorinë shkenccore të marksizëm-leninizmit. Ne u themi këtyre se në Kinë janë bërë gjithë këto gjëra që nuk janë në rrugën marksiste-leniniste edhe kur në krye të partisë ishte vetë Mao Ce Duni. Pra, si u bënë këto? Po ata mund të thonë se edhe në Bashkimin Sovjetik ngjanë gjithë ato që ngjanë. Po atje si u bënë tërë ato?

Është e qartë se edhe në Bashkimin Sovjetik lindja e revizionizmit ka shkaqet e veta. Por Stalini nuk ka lidhje fare me usurpatorët që erdhën pas tij, sepse teoria e Stalinit, lufta dhe qëndrimet e tij ishin për mbrojtjen dhe pastërtinë e marksizëm-leninizmit. Kështu është realiteti, kjo është diçka e argumentuar, prandaj ta marrin vesh mirë të gjithë këtë. Stalini u rrethua nga një burokratizëm i atillë, kundër të cilit ai nuk mundi të bënte gjë. Por, ai u pati thënë hrushovianëve që «ju do ta shisni Bashkimin Sovjetik». Vetë Hrushovi e ka pohuar këtë që ua ka thënë Stalini. Pra, gjithë vija e Stalinit as që mund të krahasohet me atë të Mao Ce Dunit. Por disa elementë, që nund të mos

jenë të djallëzuar, bëjnë krahasime të tilla të kota, krahasime jo të mbështetura. «Hrushovi sulmoi Stalinin, kurse shqiptarët, — thonë ata, — sulmojnë Maon. Pse ta sulmosh Maon, ky është njeri i mirë». Por edhe vetë kinezët, që shkruajnë këta artikuj e që janë kundër nesh, po e gudulisin Maon, derisa në një moment do të dalin hapur kundër tij. Sidoqoftë, hëpërhë ata nuk dalin hapur, që të thonë pikërisht se Partia e Punës e Shqipërisë gabon duke e demaskuar Maon. «Ç'është ky Mao që po demaskojnë?! Ata që bëjnë këtë janë revizionistë, janë të shitur tek imperializmi, kurse Mao Ce Duni ka qenë marksist-leninist!». E shikoni se ç'taktikë mund të luajnë këta njerëz?

Ose, mund të ndodhë që njerëzit e grupit të Ten Hsiao Pinit mund të janë më ekstremistë se të tjera: ata nuk e kundërshtojnë Maon, sepse masat e popullit e kanë pasur atë pak a shumë si perëndi. Kulti i Maos kishte arritur në Kinë deri aty sa të gjithë e mbanin fotografinë e tij në gjoks, dhe librin e Maos siç mbajnë myslimanët Kuranin e të krishterët Biblën.

Pra, për interesat e revizionizmit e të kapitalizmit ata mund ta fshijnë edhe fare Mao Ce Dunin, por, tani për tani, idetë e tij, borgjezisë i interesojnë që të qëndrojnë në këmbë, prandaj vihen të tillë elementë si renegati anglez që të na thonë: «Ju, shqiptarët, a jeni në vete që flisni kundër Mao Ce Dunit? Në të vërtetë kështu ju viheni në një vijë me Hua Kuo Fenin e me të tjerë si ai, që janë kundër tij. Kështu që kontradiktat tuaja me kinezët janë për punën e pesë plaçkave, pse ata ju prenë kreditë, prandaj dolët kundër Mao Ce Dunit». Për këto arsyë, nga ana jonë duhet të

bëhet kujdes, sepse borgjezia dhe imperializmi do t'i luajnë të tëra kartat.

Ne duhet të bëjmë një luftë shumë të kujdeshme e të jemi gjithnjë vigjilentë në këtë drejtim. Të punojmë pér t'i bindur ata shokë të partive marksiste-leniniste që nuk janë të qartë pér këtë apo atë problem; t'i kuptojmë mirë pyetjet që bëjnë ose ndonjë shpjegim që na kërkojnë. Ata kanë të drejtë të bëjnë pyetje. Ne mund të mos na duken të mira, por të tëra këto nuk duhet t'i marrim kallëp, se kjo varet edhe nga fakti se ashtu i kuptojnë ata problemet në vendet e tyre. Bie fjala, mund të ketë shokë që janë të bindur se nuk mund të organizohet lufta në qytete, po vetëm në fshatra. Ata e shikojnë luftën më të mundshme pér t'u organizuar në fshat, pér arsy se atje është një çikë më lehtë të veprojnë. Por t'ia lësh borgjezisë milionët e klasës punëtore që vuajnë dhe të merrosh vetëm me fshatarët nëpér pyje, kjo nuk është aspak e drejtë. Në fshat komunistët do të shkijnë; ata do të punojnë patjetër edhe me fshatarësinë, ashtu siç kemi bërë edhe ne duke i ngritur ata në këmbë me ideologjinë e klasës punëtore.

Pastaj fshatarësia jonë kishte karakteristika të tjera. Por, edhe sikur të kishte vetëm ndjenjën nationale, revoltën kundër okupatorit, prapë Partia do të luftonte ta kishte me vete fshatarësinë, ashtu siç luftoi, e ta ndriçonte me idealet e klasës punëtore, me teorinë marksiste-leniniste. Klasa punëtore duhet të luajë rolin udhëheqës ndaj fshatarësisë, pavarësisht nga numeri. Në vendin tonë klasa punëtore ishte e vogël në numër në krahasim me fshatarësinë, kurse në vendet

ë tjetra ajo është shumë më e madhe, prandaj duhet punuar shumë me të. «Por ka terror të egër në qytete», mund të thonë disa. Natyrisht, ta merr mendja që ka terror, por ne duhet të bëjmë luftë kundër terrorist, si kundër terroristit të bardhë, ashtu dhe kundër terroristit «të kuq». Ne jemi kundër këtyre formave të luftës. Çështja është të luftohet në bazë të një platforme e të një plani të studiuar mirë. Nuk duhet të veprohet, siç vepron renegati anglez, që merret me sindikatat në Angli. Kur i thuhet atij ajo që ka thënë Engelsi në kohën e tij në një letër që i dërgonte Marksit, se vetë klasa punëtore angleze po borgjezohet, pa lëre pastaj aristokracia e kësaj klase, ai na thotë se unë nuk jami dakord. Por ne nuk jemi kundër klasës punëtore, por kundër aristokracisë së klasës punëtore dhe kundër shtypjes që i bën kapitalizmi kësaj klase. Prandaj themi se punëtorët duhet të luftojnë për të arritur fitore politike dhe ekonomike, por sidomos fitore politike. Kështu duhet të veprojnë punëtorët dhe të bëhen të ndërgjegjshëm për forcën e tyre, se një grevë e madhe e punëtorëve të qomyrit u bë në Angli dhë atje u paralizua gjithëjeta e vendit. Po sikur të ngrihen në grevë edhe sektorë të tjerë? Po t'i zaptojë fabrikat e kapitalistëve klasa punëtore dhe t'u thotë atyre që këto nuk ua lëshojmë, pa të shikojmë se ç'bëhet pastaj!

*Botohet për herë të parë, sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

## PËR EKSPORT-IMPORTIN TË MENDOJNË TË GJITHË, NË QENDER DHE NË BAZË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

8 shtator 1978

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shoku Prokop [Murra] kishte mendimin, dhe ne qemë dakord, që të të thërrisnim këtu, në këtë takim, ty, shoku Nedin<sup>1</sup>, për të na vënë drejtpërdrejt në dijeni për disa probleme kryesore që ekzistojnë në tregtinë e jashtme, se, siç e di, punët e këtij sektori kanë një rëndësi të madhe për Partinë dhe për ekonominë e vendit tonë.

Eshtë e kuplueshme se në situatat e krijuara ne gjejmë vështirësi. Por, siç thotë Stalini kur flet për planin, vështirësi do të ketë, porse nuk duhet të qajmë, por ti kapërcejmë ato. Edhe ne të përpinqemi t'i kapërcejmë vështirësitë që na dalin në rrugën tonë për realizimin me sukses të detyrave, si në sektorin e tregtisë së jashtme, ashtu edhe në ndonjë sektor tjeter të ekonomisë. Natyrisht ne kemi vështirësi brenda ve-

---

1. Nedin Hoxha, në atë kohë ministër i Tregtisë së Jashtme.

ndit, por kemi edhe vështirësi të jashtme dhe, që të kapërcehen këto, është e rëndësishme të kuptohet:

Së pari, që vështirësitë e brendshme janë kryesoret, se, siç e kemi thënë, po të prodhohen mallra me cilësi të mirë, atëherë puna juaj do të lehtësohet dhe përpjekjet që do të bëni ju në tratativat me vendet e tjera do të janë më të suksesshme. Shtetet kapitaliste e revizioniste, me të cilat ne bëjmë tregtli, duan në radhë të parë të na dobësojnë politikisht. Por ata përpiken të na dëmtojnë edhe ekonomikisht dhe të përfitojnë sa më shumë nga ne, të na japin sa më pak dhe sa më me vonesë, sa më shtrenjtë e mundësisht të na fusin edhe mallra të vjetra, në qoftë se ne do të mbyllim sytë.

Së dyti, që vështirësitë e jashtme do të kapërcehen, por kjo do të bëhet me një punë shumë aplikë!, shumë të kujdeshme, të punonjësve të ministrisë suaj dhe të të gjithë funksionarëve që kanë lidhje me jashtë. Në këtë drejtim duhet të ndihmojnë edhe ambasadat tonë të akredituara në vende të ndryshme të botës, gjë që e kemi thënë shumë herë.

Këtë hyrje të vogël po e bëj për të theksuar se ç'rol të madh luan e duhet të luajë organizata e Partisë në ministri, që drejton e konkretizon këto probleme, por sidomos Partia në bazë, atje ku prodhohet për eksportin. Komiteti Qendror edukon, nxit, kontrollon dhe u kërkon illogari organave dhe organizatave të Partisë në rrëthe e në bazë për zbatimin e planeve, ashtu siç bën, nga ana e saj, edhe Qeveria, e cila ndihmon, in-

---

1. Nga frëngjishtja — të studiuar.

strukton e kontrollon organet varëse shtetërore dhe merr masa që planet të zbatohen në të gjithë zërat. Por çështë Partia në rrethe e në bazë që duhet të udhëheqë e të ndjekë zbatimin e törë detyrave.

Çështja është se si nga ne, ashtu dhe nga ju, duhet të kuptohet mirë kjo gjë. Të törë jemi anëtarë partie dhe përgjigjemi përpara Partisë për kryerjen e detyrave që na ka caktuar ajo në këtë ose në atë sektor. Por përgjegjësitë që kemi nuk janë të prera me thikë, secili ka përgjegjësinë e vet pra, kjo është përgjegjësia jote, tjetra është përgjegjësia ime. Shpesh thuhet se plani i tregtisë nuk u realizua se nuk u mobilizua si duhet Partia. Mirë, kjo qëndron, por, gjithashtu, duhet thënë se ai nuk u realizua edhe për shkakun se ka çaluar puna edhe nga ana shtetërore, për shkak të organizimit të dobët, se drejtoria apo gjithë ata kontrollorë që merren me këto punë nuk kanë punuar si duhet etj., etj. Kështu që ka përgjegjësi të përbashkët, por secili ka edhe përgjegjësi të veçantë.

Thuhet se këto çështje nuk mund t'i ndash, por, në fakt, ato cdhe duhen ndarë, se nganjëherë, kur nuk ecën mirë puna, punonjësit e organeve shtetërore thonë: «E po ja, nuk mobilizohet Partia», kurse, nga ana tjetër, nga Partia na thuhet që nuk po ecin mirë ministritë, nuk po ecin si duhet komitetet ekzekutive etj. Pra, ia kalojnë përgjegjësinë njëri-tjetrit. Në të vërtetë secili ka përgjegjësinë e vet dhe kjo duhet përcaktuar qartë.

Me këtë dua të vë në dukje faktin që aparatet e Komitetit Qendror, të Kryeministrisë dhe të ministrive të jenë në kontakte të vazhdueshme me njëri-tjetrin,

por dhe me bazën. Një gjë e tillë, siç e kam theksuar edhe herë të tjera, nuk duhet bërë në asnjë mënyrë për t'u prerë hovin drejtuesve kryesorë të institucioneve, të fabrikave e të ndërmarrjeve, sa ata të kthchen në automatë, domethënë të mos jenë në gjendje të veprojnë vetë me iniciativë për zgjidhjen e problemeve që u dalin dhe për çdo gjë të thonë: «Ta bëjmë këtë, por dale të pyesim më parë aparatin e Komitetit Qendror, të Kryeministrisë apo të ministrisë». Jo. Një pikëpamje dhe një veprim i tillë, më duket mua, nuk është në rrugë tonë. Ai që drejton fabrikën, për shembull, mund dhe duhet të pyesë për diçka që nuk është në kompetencën e tij, por kur e ka në kompetencë, duhet të mbajë përgjegjësi dhe të japë llogari për atë që duhet të bënte. Nuk ecet përpara duke pyetur për çdo gjë të tjerët para se të veprohet. Pse të pyetet për çdo gjë, kur kompetencat janë, direktivat e Partisë dhe vendimet e urdhëresat e Qeverisë, gjithashtu, janë? Drejtuesit të ndërmarrjes ose të institucionit i vihet detyrë të veprojë vetë dhe të kërkojë në ministri ose në komitetin e Partisë të dalin para përgjegjësisë ata që e pengojnë ndërmarrjen e tij të realizojë planin. Dhe në qoftë se ministri ose sekretari i komitetit të Partisë ngul këmbë në një gjë të padrejtë, atëherë ky drejtore të vijë edhe këtu, në aparatin e Komitetit Qendror, për të parashtruar gjendjen, me qëllim që problemi të marrë zgjidhje.

Këto punë kështu bëhen, por duhet të bëhen edhe më mirë. Për këtë, çështjet duhet të kuptohen drejt. Jo vetëm, Nedini, për shembull, të vijë vazhdimesht këtu, në aparatin e Komitetit Qendror, por edhe ne të vemi

atje, në ministri. Po përse të vemi atje? Sigurisht kur atje ka ndonjë problem të madh. Të mos harrojmë se ne këtu jemi në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë, nën drejtimin e të cilët janë të gjitha komitetet e Partisë të rretheve që kanë nën drejtimin e tyre komitetet, byrotë dhe organizatat-bazë të ndërmarrjeve e kooperativave ku prodhohen të mirat materiale, ku zbalohet konkretisht vija e Partisë. Mua më duket se ne të Komitetit Qendror jemi më të favorizuar se dikasteret, sepse kemi burime të dyanshme, edhe prej tyre, edhe prej rretheve. Kjo nuk do të thotë që, kur të vejë Nedini në Shkodër, për shembull, të mos marrë kontakt e të mos bisedojë me sekretarët e komitetit të Partisë për problemet e realizimit të planit të prodhimeve për eksport, për cilësinë e tyre etj. Ministrat mund dhe duhet t'u ngrenë probleme komiteve të Partisë të rretheve, aq më tepër kur ata janë edhe anëtarë të Komitetit Qendror. Por edhe sikur as anëtarë partie të mos janë, se mund të takojë që një ministër të mos jetë, ata kanë kompetencat e tyre dhe mund t'u ngrenë probleme komiteve të Partisë për ndërmarrjet e rrethit, me qëllim që të merren masat e nevojshme.

Eshtë e domosdoshme që midis aparatit të Komitetit Qendror dhe ministrive të ketë një bashkëpunim të ngushtë. Por nga ne duhet ndihmuar veçanërisht ministria e Tregtisë së Jashtme. Dhe kjo ndihmohet kur ne të kemi ndihmuar e të kemi kontrolluar edhe ato ministri, edhe Partinë në ato rrethe e ndërmarrje që punojnë për eksport. Prandaj, në radhë të parë, ne t'u kërkojmë llogari ministrive të tjera ose ndërmarrjeve përkatëse, pastaj Ministrisë së Tregtisë së Jashtme, për-

se nuk u prodhua ky apo ai mall, pse nuk erdhi nga importi kjo apo ajo. Ministria e Tregtisë së Jashtme do të thotë se ky artikull, kjo makineri apo pajisje nuk erdhi për arsy se ndërmarrjet tonë, prodhimet e tyre për eksport i kanë dërguar me cilësi të dobët, prandaj nuk i blen kush dhe kështu nuk realizuam devizën që duhet për të importuar ato që na nevojiten. Ose ne i kërkojmë llogari Ministrisë së Tregtisë së Jashtme pse nuk ka realizuar të ardhurat nga eksporti i domates, sepse ajo u shit me çmim më të ulët. Atëherë ajo na përgjigjet se është Ministria e Bujqësisë ajo që nuk i dorëzoi domatet në kohë dhe në cilësinë e duhur, sipas kushteve të kërkuar. Natyrisht, Ministria e Bujqësisë ka përgjegjësinë e saj për këtë, por përgjegjësi kanë edhe rrëthet, që kanë në administrim serrat e domateve, si rrëthi i Tiranës, i Elbasanit ose ndonjë tjetër dhe organizatat-bazë të Partisë të kolektivave të këtyre serrave.

Ose të marrim Kombinatin e Tekstileve në Berat. Punëtorët atje duhet të punojnë që të prodrojnë tekstile të atij lloji e të asaj cilësie që është vendosur, ndryshe këto prodhime nuk na i blejnë konsumatorët e jashtëm dhe as të brendshmit. Drejtuesit e këtij kombinati tekstili vërtet kërkojnë pambuk të mirë, të cilin mezi e gjejmë, por edhe prodhimet duhet t'i nxjerrin të asaj cilësie që mund e duhet t'i nxjerrë ai lloj pambuku. Po kush do t'i vërë këto organe në lëvizje? Do t'i vënë Partia dhe komitetet ekzekutive në këto rrëthe. Prandaj, thashë më lart, që kemi përgjegjësi të gjithë për këto probleme.

Nuk është e domosdoshme që ju, shokët e apara-

teve qendrore të Partisë dhe të pushtetit, të thërrisni kurdoherë ministrin për një problem të caktuar, por edhe sekretarët e komiteve të Partisë të rretheve, të cilëve u kërkohet si janë me detyrat e eksportit, ç'prodhime u merr ministria dhe pse nuk ua merr ndonjë artikull. Gjithashtu atyre t'u kërkohet llogari përse nuk i nxjerrin prodhimet për eksport sipas standardeve të përcaktuara. Duke u kujtar atyre që t'i lënë justifikimet, t'u thuhet se plani që është aprovuar duhet mendemos të realizohet. Në këtë mënyrë, mendoj unë, do ta kemi më të qartë situatën pse nuk realizohet plani i eksport-importit. Nga këto takime mund të dalë edhe që Ministria e Tregtisë së Jashtme, për shkak të punës burokratike në aparatin e vet ose për shkaqe të tjera, nuk e tërheq një mall edhe pse është i cilësisë së mirë. Por këto shkaqe ajo t'i evidencojë. Pra duhet praktikuar edhe thirrja e shokëve të rretheve e jo vetëm e ministrave.

Po kështu ministri i Tregtisë së Jashtme, për she mbull, për problemet që i dalin, mund të thérresë jo vetëm kryetarin e komitetit ekzekutiv të një rrethi, shefin e tregtisë, por edhe shefin e seksionit të bujqësisë, megjithëse ky varet nga Ministria e Bujqësisë. E mira është që këtë ta thérresë Ministria e Bujqësisë, por nuk është keq që ta bëjë këtë punë edhe ajo e Tregtisë së Jashtme, bie fjala, për t'u informuar se ç'po bëhet për sigurimin e domateve të hershme, pasi këto nuk po dorëzohen për eksport sipas grafikut të vendosur. Për një problem të tillë, ministri mund të kërkojë që kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit të thirret në Qeveri që të japë llogari, sepse po pengohet realizimi i planit të eksportit.

Pra, ju, Nedin, mund dhe duhet të merrni kontakt edhe me sekretarët e komiteteve të Partisë, por, në radhë të parë, thërrisni sidomos ata që janë përgjegjës drejtpërdrejt për problemet që ju preokupojnë. Kjo është një formë pune, por jo e vetmja, se mund të ekzistojnë edhe forma të tjera.

Ne vëmë re se ashtu siç interesohen dikasteret në rrethe për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që u dalin, duke i marrë shpeshherë kuadrot drejtues atje në telefon, ashtu edhe ata të rrtheve lidhen me dikasteret, kërkojnë si u bë kjo, si u bë ajo çështje, pse nuk erdhi ky material ose pse nuk erdhi kjo lëndë e parë, etj. Ndërsa me aparatin e Komitetit Qendror, shokët e rrtheve nuk lidhen, nuk i marrin në telefon sekretarët e Komitetit Qendror, kuptohet edhe për probleme të rëndësishme. Për shembull, sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Matit nuk kujtohet të marrë në telefon Komitetin Qendror e të bisedojë për problemet që lidhen, fjala vjen, me fabrikën e ferrokromit. Jo, kjo nuk bëhet nga ai. Kështu është çështja edhe me shokët e rrtheve të tjera. Po atëherë ç'bëhet kështu? Këtë gjë ne nuk mund ta lejojmë. Duhet parë seriozisht kjo punë, ndryshe nuk ecet. Ka ndodhur, për shembull që ndonjë sekretar i parë rrethi të ka marrë në telefon ty, Prokop, fjala vjen, për të të thënë se «era tundi një çikë grurin» dhe s'kujtohen të informojnë për probleme të tjera më shumë të rëndësishme! Dhe e di ti pse ka marrë ai në këtë rast? Që nesër të shfajësohet për mosrealizimin e planit të drithërave, kur, në realitet, ka pasur shkaqe të tjera që nuk është realizuar prodhimi i parashikuar.

Kur informohemi drejtpërdrejt nga rrethi dhe ndërhyjmë për të ndihmuar, duhet të mos ndërhyjmë një çikë, po shumë, sepse e dimë se si është situata në përgjithësi. Unë, për shembull, dua të di disa gjëra:

E para, nëse kontratat, marrëveshjet, që kemi bërë me shtete ose me firma të ndryshme, na i realizojnë ata apo po na nxjerrin pengesa?

E dyta, ka përparime nga ana e predhuesve tanë për prodhimin në kohë e me cilësi të lartë të artikujve të ndryshëm të eksportit? Domethënë, politika e drejtë, mobilizuese dhe frysmezuese e Partisë sonë, qëndrimet e drejta të saj, që kanë ngritur në këmbë masat e gjera të popullit, kanë bërë ndonjë efekt në prodhim, kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë dhe në shpejtësinë e nxjerrjes së këtyre prodhimeve apo jo?

E treta, ju keni dërguar delegacione jashtë, që kanë marrë kontaktet e para me ato firma, me të cilat ne mund të bëjmë tregti. Sido që këto janë kontaktet e para dhe ju akoma mund të mos keni nxjerrë dot konkluzione, por dua të di, a e keni në vijë këtë punë?

Duke u nisur nga ato të dhëna që ju kanë sjellë shokët që kanë vajtur jashtë, duhet të bëni një studim të thellë për të parë konkretisht ç'mund të marrim, kur mund t'i marrim, ç'mundësi kemi për t'i marrë, sa na kushtojnë këto gjëra, ç'ndryshime ka këtej, ç'ndryshime ka andej etj., etj. Ky është një studim mjaft i gjerë që mund të bëhet nga ana e ministrisë suaj, derisa të stabilizojmë disa tregje. Në këtë punë kurdoherë të kemi parasysh koniunkturat e çmimeve dhe koniunkturat politike, të cilat ndryshojnë vazhdimi siht. Në të gjitha këto kërkime të vazhdueshme, se, natyrisht këto nuk

bëhen në një ditë, sipas situatave, ministria duhet të dijë se ku mund ta shesë me leverdi më të madhe këtë apo atë mall e të mos ndodhet para të papriturave që sjellin humbje.

A mund të na thuash ti, Nedin, në përgjithësi, nëse ndihmohet Ministria e Tregtisë së Jashtme nga benda me furnizim apo nuk ndihmohet. A mblidheni ju ministrat e bisedoni kokë më kokë me njëri-tjetrin për problemet që s'ju ecin? Për shembull, kur në realizimin e planit ju ka penguar Ministria e Bujqësisë, a bisedoni me Themijen, para se të shkoni në mbledhjen e Qeverisë, se si qëndrojnë punët? Se, natyrisht, në mbledhjen e Qeverisë do t'u thuhen të katër të vërtelat në sy, atje do të dalë se ku është përgjegjësia e organeve të pushtetit dhe e çdo dikasteri për mangësitë që kritikohen. Edhe në mbledhjen e Byrosë Politike do të themi se ku është përgjegjësia e Partisë që plani i eksportit, fjala vjen, nuk u realizua. Por, para se të shkohet në këto forume, unë mendoj se duhet t'i sheshoni më parë me njëri-tjetrin këto gjëra. Është kështu më mirë, apo e kam gabim?

Tashti ti, Nedin, pa humbur kohë, na fol shkurt, në vija të përgjithshme, për problemet e import-eksportit. Ne do të flasim këtu për orientimet e pesëvjeçarit, por ti na thuaj diçka, sepse eksport-importi është një nga hallkat kryesore të bilancit.

*Pasi shoku Nedin Hoxha bëri një pasqyrë të problemeve të eksport-importit, e mori përsëri fjalën shokë Enver Hoxha:*

Kur është fjala për realizimin e kontratave në tregtinë e jashtme, duhet pasur parasysh se i huaji nuk të

pret. Prandaj duhet ndërhyrë fort dhe me kohë, si nga ana shtetërore, ashtu edhe nga Partia, për t'u ndalur konkretisht e jo në përgjithësi, në ato fabrika ose ndërmarrje që nuk e furnizojnë në rregull ose në kohën e duhur eksportin. Në këtë rast, gjithashtu, të therriten këtu në Komitet Qendror, që nga drejtori, kryeinxhini i dëri te ministri përkatës, t'u tërhiqet vëmendja se me këto pengesa që po i krijojnë ekonomisë ata nuk e kanë kuptuar si duhet rëndësinë e eksportit në kushtet e vendit tonë dhe të porositen që të marrin masa për shëndoshjen e gjendjes, ndryshe ata do të nxirren para përgjegjësisë.

Kështu duhet vepruar nga ana juaj, energjikisht, mendojmë, sepse kemi të bëjmë me një problem delikat politik. Të kuptohet mirë se në interes të shtetit tonë socialist, që është i rrethuar nga të katër anët me shtete kapitalisto-rezisioniste, ne duhet të luftojmë që të rrisim eksportin dhe të ulim importin sa më shumë që të jetë e mundur.

Lidhur me mosrealizimin e të ardhurave në eksportin e bimëve medicinale unë mendoj se shkaku që nuk grumbullohen këto bimë, nuk është vetëm pakujdesia, siç u tha këtu. Çështja është se për grumbullimin e këtyre bimëve nuk bëhet një punë e organizuar dhe e drejtuar mirë, por është lënë kryesisht në përpjekjet individuale të kooperativistëve. Por kooperativisti ka prirjen t'i grumbullojë këto bimë për interesin e tij personal, sepse, në qoftë se i mbledh për kooperativën, atij nuk i intereson. Prandaj të mendohet një organizim më i mirë për këtë problem. Çdo kooperativë mund të krijojë skuadra të veçanta për bimët mjekësore, si skua-

drat që janë krijuar për plehun, për viçat etj. dhë se cila duhet të ketë pasqyrën e saktë të bimëve medicinale që rriten në rajonin e saj. Dihet që mbledhja e bimëve medicinale nuk bëhet në një kohë për të gjitha, por secila ka periudhën e saj të veçantë të arritjes së pjekurisë. Për shembull, sherbela, shqemja etj., etj., nuk lulëzojnë të tëra në një kohë, që të themi: oburra, të shkojmë një ditë dhe t'i mbledhim. Jo, prandaj është i nevojshëm një organizim i studiuar mirë për këto punë, sepse kështu siç veprohet deri tanë, kooperativisti mund të thoë se atij i duhet të punojë në arë që të marrë ditët e punës dhe nuk i mbetet kohë për të mbledhur bimët medicinale. Por në fakt, ai i mbledh ato për t'i shitur privatisht.

Prandaj të shihet mirë ky problem, se për tërë ekonominë tonë bimët medicinale janë një pasuri e madhe. Nga eksporti i tyre ne marrim valutë. Prandaj kooperativat të tregojnë interes të madh. Në qoftë se ato e organizojnë punën siç thashë më lart, duke pasur parasysh edhe interesin e kooperativistit, domethënë që këtij të mos i zbritet ditë-puna kur vete për të mbledhur bimë medicinale, ose me këtë punë të merren njerëz të specializuar, atëherë ne do t'i grumbullojmë këto bimë me vlerë dhe do të realizojmë të ardhura të mira, si për shtetin, për kooperativën dhe për kooperativistin. Por, ky problem duhet marrë mirë në dorë, të sqaronhen kooperativistët për leverdinë e një punc të tillë të organizuar, ndryshe, le t'u bëhen letra nga ana e Qeverisë, bimët medicinale nuk do të grumbullohen.

Po ashtu duhet bërë kujdes edhe për shtimin e prodhimeve industriale për eksport, veçanërisht duke sy-

nuar në kursimin e lëndës së parë dhe të lëndëve dje-gjëse nëpërmjet uljes së normativave të harxhimit të tyre, uljes së fuqisë punëtore dhe sidomos nëpërmjet ngritjes së rendimentit.

Lidhur me shpërndarjen e mallrave që vijnë nga importi, kjo duhet të bëhet me përgjegjësi, sepse kemi të bëjmë këtu me probleme të mëdha shtetërore. Prandaj, përgjegjësi i rezervës listën e mallrave që janë në depot e shtetit duhet ta bëjë me përgjegjësi të madhe, duke kontrolluar mirë sasinë e çelikut, të kobaltit, të iksit e të ipsilonit, të të gjithë artikujve kryesorë dhe t'i japë ministrisë një pasqyrë ekzakte. Ministria, natyrisht, ka specialistët e saj dhe thotë: «Kjo rezervë që kam mund të më shërbejë vetëm për dy muaj, jo për më shumë.» Atëherë Qeveria, sipas gjendjes dhe nevojave, vendos t'i japë ose jo, pra duke gjykuar në mënyrë të studiuar.

Edhe në këtë drejtim të bëjmë një punë shkencore, një punë me plan dhe në interes të shtetit. Të mos dëgjojmë vetëm ç'thotë drejtori i kësaj apo i asaj depoje dhe që nuk e di mirë gjendjen e mallrave, por të vëmë në lëvizje e të shohim çfarë thotë edhe kontrolli punëtor për këtë problem. Grupet e kontrollit punëtor duhen dëgjuar gjithmonë me vëmendje, se ky kontroll është i paanshëm. Them kështu se, nga disa artikuj që kam lexuar në gazetë, më duket që akoma nuk është kuptuar si duhet kontrolli punëtor. Pse nuk vë në lëvizje kontrollin punëtor organizata-bazë e Partisë e një qendre pune, Hekuran? «Po pse ta vërç në lëvizje kontrollin punëtor organizata-bazë, ajo është vetë aty brenda», do të thotë ndokush. Ashtu është, por këtu e

kemi fjalën kur ajo nuk është në pozita luftarake dhe kërkon ta mbulojë të keqen. Në këtë rast dërgohet të ushtrojë kontroll atje një grup punëtorësh, që s'kanë lidhje fare me atë magazinë apo ndërmarrje. Kontrolli nxjerr në shesh të vërtetën, nxjerr ose të palarat, ose rregullin. Jam dakord që kontrolli punëtor udhëhiqet nga Partia, por mua më duket se edhe këtë, Hekuran, nuk e kanë kuptuar mirë kudo. Si udhëhiqet kontrolli punëtor nga Partia? Organizata-bazë e kësaj depoje, për shembull, ka krijuar një grup punëtorësh dhe i ka specializuar këta që të kontrollojnë jo vetëm këtë depo, por edhe disa të tjera. Kur komiteti i Partisë dërgon një grup punëtorësh të metalurgjisë për të kontrolluar atje, ai i cakton atij detyra konkrete, ta zëmë, të kontrollojë se si bëhet administrimi i çeliqeve dhe i hekurit ose i ndonjë artikulli tjetër. Grupi i kontrollit punëtor duhet t'uа vëré këmbët në një këpucë drejtorit, administratës dhe atyre komunistëve e punëtorëve që nuk punojnë mirë, në vend që vetëm të themi pse nuk e vë në lëvizje organizata-bazë kontrollin punëtor. Po pse ta bëjë ajo këtë? Që t'i heqë petët byrekut. Prandaj të gjitha punët duhen bërë mirë, çdo gjë të jetë në rregull, në vendin e vet dhe të dihet me saktësi gjendja konkrete e depos së ndërmarrjes apo të fabrikës.

Për sa i përket importit të pajisjeve që s'mund t'i bëjmë dot në vend, Nedin, a bëhet fjalë që tani? Keni udhëzime ju nga Qeveria për të parë një çikë për këtë apo atë makineri që ka mbetur në mes të rrugës, për plotësimin me pajisje të kësaj apo asaj fabrike që na ka mbetur përgjysmë, ose për një linjë të tërë, nëse mund ta blejmë dot apo jo? Pra, paraprakisht, them,

keni udhëzime të tilla? Për këto gjëra duhet të keni edhe inxhinierë e specialistë. Vërtet ne i hoqëm nga prodhimi 2 000 inxhinierë e teknikë që të merrin më drejtpërdrejt me zgjidhjen e problemeve që na dalin në fushën e revolucionit tekniko-shkencor, por ndërmarrjeve të Ministrisë së Tregtisë së Jashtme tani duhet t'u japim një grup ose disa grupe të shëndosha me inxhinierë e teknikë të degëve të ndryshme për t'i konkretizuar këto gjëra. Është kështu, apo jo? Ndryshe, me kë do t'i bëjë ajo këto punë, me atë që shet cigare?! Me atë specifikim që bëjnë dikasteret shkohet jashtë për të kontraktuar e për të blerë. Mirëpo ai që do të vejë atje duhet të dijë çfarë do të kërkojë dhe të jetë në gjendje ta kuptojë qartë specifikimin që i kanë dhënë. Por i huaji mund t'i thotë: «Po përse e kërkon këtë makineri me kapacitet 30 kuintalë, kur unë prodhoj makineri që kanë kapacitet më të madh, deri 400 kuintalë në 24 orë?» Po specialisti ynë i shpjegon se ne jemi vend i vogël, nevojat na i plotëson edhe ajo pajisje që ka kapacitet të vogël. Ndonjë makineri mund të jetë edhe një çikë e vjetër, por atë kemi mundësi ta blejmë, sepse të tjerat që janë prodhuar sipas teknologjisë së re, kushtojnë shumë. Pra, si ky problem ka dhe shumë të tjerë, prandaj ka bërë mirë Qeveria, mendoj unë, që ka dhënë udhëzime.

Punën për marrëdhëni me jashtë duhet ta vini në baza të mira organizative, në çdo gjë, që nga lart e deri poshtë. Vendimet që marrin Qeveria, Byroja Politike apo Komiteti Qendror për probleme të ndryshme, janë të përgjithshme. Ato pastaj duhen konkretizuar, duhen zbirthyer nga njerëzit që keni për problemet që bëhet

fjalë dhe për këto gjëra duhet të kemi specialistë kompetentë.

Problemin e kuadrove të ministrisë e të ndërmarrjeve të tregtisë së jashtme duhet ta shohim mirë e me kujdes. Ta shohim atë lidhur edhe me degën e gjuhëve të huaja në Universitet. Nga kjo degë kanë dalë plot kuadro që janë mësues. Ka prej tyre që dinë edhe dy gjuhë të huaja dhe që kanë një stazh të mirë pune. Ministrisë së Tregtisë së Jashtme i duhen veçanërisht kuadro që të dinë anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Dhe ashtu është, siç thotë Nedini, nga të katër anët kërkohen të tillë njerëz. Edhe për të përkthyer, por edhe për të punuar. Në Ministrinë e Tregtisë së Jashtme kërkohen kuadro që jo vetëm ta zotërojnë mirë gjuhën, por që të jenë të mirë edhe në çdo drejtim, se do të venë jashtë, ku edhe gjuhën e huaj duhet ta flasin mirë e të dinë të komunikojnë me të huajin, por të jenë edhe korrektë, me formim të shëndoshë idcopolitik e me kulturë të gjerë. Nedini ngriti këtu problemin që mund të marrë edhe disa kuadro që kanë punuar më parë në tregtinë e jashtme, por që kanë qarkulluar jashtë Tiranës. Ky problem të shihet, se edhe ndonjë shok me eksperiencë e që nuk është implikuar në veprimtari armiqësore mund të merret përsëri, se tregtia e jashtme ka nevojë dhe vështirësi për kuadro. Pra, kjo çështje të mbahet parasysh që ta forcojmë Ministrinë e Tregtisë së Jashtme me kuadro të astë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga bisedat  
e incizuar që gjendet në AQF*

# **DEMOKRACIA PROLETARE ËSIITË DEMOKRACIA E VËRTETË**

*Fjalim i mbajtur në mbledhjen e Këshillit  
të Përgjithshëm të Frontit Demokratik  
të Shqipërisë*

**20 shtator 1978**

Shokë dhe shoqe,

Siq jeni në dijeni Presidiumi i Kuvendit Popullor ka shpallur dekretin mbi zgjedhjet e deputetëve të Kuvendit Popullor për legjislaturën e nëntë, të cilat do të zhvillohen më 12 nëntor të këtij viti. Në këtë mbledhje të Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik ne do të shqyrtojmë detyrat që i dalin organizatës sonë për organizimin e fushatës së zgjedhjeve dhe përfundimin me sukses të tyre.

Zgjedhjet për Kuvendin Popullor janë një ngjarje e madhe politike, që intereson drejtpërdrejt të gjithë qytetarët e republikës sonë, sepse ata do të zgjedhin deputetët për organin më të lartë shtetëror, i cili përsaqëson dhe shpreh vullnetin dhe sovranitetin e popullit.

Në vendin tonë zgjedhjet për Kuvendin Popullor kanë qenë kurdoherë një manifestim i fuqishëm i uni-

tetit të popullit, i bashkimit të tij rrëth Partisë, i vendosmërisë për mbrojtjen e atdheut dhc çuarjen përpara të çështjes së socializmit në Shqipëri. Këto karakteristika të shquara do të shprehen me një forcë akoma më të madhe edhe në zgjedhjet e reja.

Fronti Demokratik e ka për detyrë që, nën udhëheqjen e Partisë, ta kthejë këtë fushatë në një veprimtari të gjithanshme politike, ekonomike e kulturore të masave të gjera punonjëse. Fushata e zgjedhjeve të bëhet një nxitje e madhe për të rritur entuziazmin e hovin në punë të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste e të inteligjencies popullore, për realizimin e detyrave në të gjitha fushat, sidomos për të mbyllur me sukses planin e shtetit të këtij viti dhe për t'u përgatitur sa më mirë për vitin e ardhshëm.

Populli shqiptar vjen në zgjedhjet e reja i bashkuar më tepër se kurrë rrëth vijës marksiste-leniniste të Partisë, me besim të patundur në drejtësinë e saj dhe i vendosur ta zbatojë atë deri në fund. Popullin tonë e karakterizon një frymë e shëndoshë patriotike, një dashuri e pafund për atdheun socialist, një vendosmëri i patundur për ruajtjen e lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të tij.

Aprovimi unanim dhe përkrahja e mbarë popullit shqiptar të qëndrimit të Partisë e të Qeverisë sonë ndaj veprimeve kundërrrevolucionare e antishqiptare të udhëheqjes revizioniste kineze tregojnë edhe një herë lidhjet e tij të ngushta me Partinë, vendosmërinë e tij për të përballuar çdo vështirësi për të çarë çdo bllokadë e rrethim imperialisto-revizionist.

Zgjedhjet e nëntorit e gjejnë vendin tonë me një

ekonomi të fortë, me një ekonomi të stabilizuar, dinamike dhe në zhvillim harmonik e të pandërprerë. Kjo është rezultat i vijës së drejtë të ndjekur nga Partia dhe Qeveria për zhvillimin e përparimin e gjithanshëm të vendit.

Duke vënë në jetë direktivat e Kongresit të 7-të të Partisë, janë arritur suksese në zhvillimin e mëtejshëm të industrisë, të ndërtimeve e të komunikacionit. Me punën e palodhur të klasës punëtore, të teknikëve dhe të inxhinierëve tanë të talentuar, janë ngritur e ngrisen uzina e fabrika, prodhohen artikuj që më parë importoheshin, projektohen e ndërtohen me forcat tona pajisje komplete e makineri të reja. Vazhdojnë punimet në Kombinatin Metalurgjik, në Hidrocentralin e Fierzës e në të gjitha veprat e tjera që u dëmtuan rëndë nga prerja e pabesë e ndihmave kinezë. Në kundërshtim me qëllimet armiqësore të revisionistëve kinezë, Partia ka marrë masa që të gjitha ato vepra të përfundojnë së ndërtuari me sukses.

Përparime të mëdha ka bërë bujqësia jonë sociale. Si rrjedhim i punës së madhe të fshatarësisë koperativiste, të ndihmës së shtetit të diktaturës së proletariatit dhe të kujdesit të veçantë të Partisë, janë rritur sipërsfaqet e punueshme, është zgjeruar sistemi ujites, është shtuar përdorimi i plehrave kimike, janë mekanizuar mjafit procese të punës bujqësore e blegtorale. Mbi këtë bazë janë rritur rendimentet e prodhimeve të të gjitha bimëve. Bujqësia jonë, që tashmë e prodhon gjithë bukën në vend, gjithnjë e më mirë po i plotëson nevojat e popullit e të industrisë me prodhime bujqësore e blegtorale.

Dëshmi e gjendjes së shëndoshë të vendit tonë është jeta e gëzuar e optimiste e popullit, rritja e mirëqenies, ngritja e nivelit arsimor, kulturor e shëndetësor të tij.

Zgjedhjet për deputetët e Kuvendit Popullor e gjenë vendin tonë më të fortë se kurrë. Ne kemi sot një mbrojtje të pathyeshme. Direktiva e Partisë që mbrojtja e atdheut është detyrë mbi detyrat, po zbatohet përherë e më mirë. Gjithë populli ynë, me një frymë të lartë atdhedashurie, është përgatitur dhe përgatitet ushtarakisht që të jetë në gjendje të përballojë çdo situatë. Kufijtë tokësorë, detarë dhe ajrorë të Shqipërisë janë e do të janë të paprekshëm.

Shqipëria socialiste gëzon sot një prestigj të lartë në botë, ajo ka simpatinë e përkrahjen e revolucionarëve të vortctë, të miqve e të dashamirëve të shumtë në të gjitha vendet. Kjo është rezultat i politikës së Jashtme të drejtë, parimore e konsekuente që ka ndjekur dhe ndjek Partia dhe shteti ynë, i luftës së vendosur që ka zhvilluar populli shqiptar kundër imperializmit, socialimperializmit, revisionizmit modern të të gjitha ngjyrave e reaksionit.

Zgjedhjet e reja të Kuvendit Popullor do të forcjnë edhe më shumë pushtetin popullor, i lindur nga Lufta e lavdishme Nacionalçirimitare dhe i kalitur në betejat e ashpra për ndërtimin e socializmit. Me votën e tij të lirë e demokratike populli shqiptar do të shprehë vendosmërinë për ta ruajtur gjithnjë të pastër e të fuqishme diktaturën e proletariatit, armën e sigurt për mbrojtjen e fitoreve të arritura, nën udhëheqjen e Partisë, garancinë e madhe për ta çuar gjithnjë përpara çështjen e socializmit në Shqipëri. Këto zgjedhje do t'i

shërbejnë, si gjithnjë, zgjerimit e forcimit të mëtejshëm të demokracisë sonë socialiste, që është një nga tiparet themelore të pushtetit dhe të gjithë jetës sonë.

Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë dhe shoqëria jonë socialiste ndryshojnë kryekëput nga shtetet dhe shoqëritë kapitalisto-revizoniste të vendeve të ndryshme të botës. Ku qëndron ky ndryshim? Në radhë të parë, në bazën ekonomike, në strukturën e shoqërisë dhe në superstrukturën që pasqyron këtë bazë. Në shoqëritë kapitaliste e revizioniste baza dhe superstruktura kanë ndërtim të brendshëm antagonist, kurse në shoqërinë tonë socialiste këto janë të lira nga antagonizmat klasorë dhe, si të lilla, përsosën vazhdimisht.

Në kuptimin e bazës dhe të superstrukturës, që karakterizojnë çdo formacion ekonomiko-shoqëror, ne udhëhiqemi nga parimet teorike që na kanë lënë trashëgim Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Partia jonë i ka përvetësuar dhe i ka zbatuar drejt, teorikisht dhe praktikisht, këto parime, prandaj vendi ynë çshtë transformuar nga një vend dikur i varfër ekonomikisht dhe i prapambetur nga ana kulturore e arsimore, në një vend të lirë, të pavarur e sovran, me ekonomi të zhvilluar socialiste, me kulturë, me arsim dhe me shkencë të përparuar, me një mbrojtje të fortë dhe me një politikë të jashtme të drejtë e parimore.

Lidhja dhe bashkëveprimi i bazës me superstrukturën, ku roli kryesor i përket bazës ekonomike, si dhe

revolucionarizimi i vazhdueshëm i superstrukturës sönü socialiste, kanë krijuar bindjen te njerëzit tanë, për rrugën e drejtë të përparimit të shoqërisë socialiste. Në rrugën e ndërtimit të socializmit ka udhëhequr klasa punëtore, pararoja e saj marksiste-leniniste, prandaj në këtë rrugë janë arritur suksese të mëdha.

Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe punonjësit e tjerë e ushtrojnë pushtetin nëpërmjet organeve përfaqësuese, si edhe drejtpërsëdrejti. Këtu masat marrin pjesë aktivisht në qeverisjen e vendit, në drejtimin e ekonomisë, në diskutimin e ligjeve dhe të planeve ekonomike, në kontrollin për veprimtarinë e organeve të pushtetit etj. Ato kanë të drejtë të shprehin lirisht mendimet e tyre për të gjitha problemet me interes shoqëror ose vetjak. Këto të drejta ua ka sigruuar atyre Partia me Kushtetulë, prandaj vetëm në Shqipërinë socialiste mund të flitet, me tërë kuptimin e fjalës, për një demokraci të vërtetë, të shpallur jo vetëm me fjalë, por të sigruuar realisht. Këto të drejta i shpallin formalisht edhe kushtetutat borgjeze e rezisioniste, por ato, në të vërtetë, nuk sigurojnë premisat për t'i vënë në jetë të drejtat e shpallura. Duke ata-kuar mashtrimin e borgjezisë mbi të ashtuquajturën barazi të të drejtave në shtetin kapitalist, Stalini ka shkruar se ata

*«Flasin për barazi të qytetarëve, por harrojnë se nuk mund të ketë barazi të vërtetë midis padronit dhe punëtorit, midis çifligarit dhe fshatarit, derisa të parët kanë pasuri dhe pe-*

*shë politike në shoqëri, ndërsa të dytët s'kanë as njërën as tjetrën; derisa të parët janë shfrytëzues dhe të dytët janë të shfrytëzuar»<sup>1</sup>.*

Te ne, në interes të masave të gjera të popullit, ndërtohet me sukses socializmi në fushat ekonomike, kulturore, arsimore, shkencore, të mbrojtjes etj. Në Shqipëri ecet kurdoherë drejt shoqërisë së përparuar socialiste dhe ruajtjes së pacenuar të sovranitetit të popullit. Në Kushtetutën tonë thuhet: «I gjithë push-teti shtetëror në Republikën Popullore Socialistë të Shqipërisë buron nga populli punonjës dhe i përket atij».

Partia ka punuar dhe punon që vendi ynë të jetë i lirë nga çdo drejtim ndaj të huajve, që vendi ynë të jetë plotësisht i pavarur nga jashtë dhe të mos rrezikohet kurrë nga ato klasa, që revolucioni ynë ua ka hequr fuqinë ekonomike, politike dhe morale.

Partia jonë marksiste-leniniste frymëzohet dhe ushqehet nga ideologja marksiste-leniniste dhe ka përqëllim të vetëm të ngrëjë mirëqenien e popullit, të realizojë ndërtimin e socializmit nën diktaturën e proletariatit. Një sistem ekonomiko-shoqëror socialist nuk mund të rrojë pa demokracinë e vërtetë proletare, pa një bashkëpunim të ngushtë e të çiltër midis shtresave të ndryshme të masave punonjëse, që i bën të ndërgjegjshme Partia. Shoqëria jonë dallohet pse qeverisët nga ligjet e diktaturës së proletariatit e të demokracisë socialiste, ajo është e ndërgjegjshme se të drejtat dhe detyrat e shtetasve janë ndërtuar mbi bazën e paj-

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 14, f. 61.

timit të interesave të shoqërisë dhe të individualit, duke i dhënë prioritet interesit të përgjithshëm. Prioriteti i interesit të përgjithshëm duhet të udhëheqë mendimet dhe aspiratat e gjithsecilit. Që të mund të prijë interesin i përgjithshëm dhe të realizohen të mirat që sjell sistemi ynë socialist, kërkohet absolutisht një pjesëmarrje e gjerë e masave punonjëse në drejtimin e shtetit të diktaturës së proletariatit dhe të ekonomisë.

Ne mund të themi me krenari se vendi ynë është me të vërtetë socialist. Nuk ka në botë një vend tjetër si yni, ku shtetasit të jenë kaq të barabartë përpara ligjit, ku diferenca e pagave në mes punëtorit e nëpunësit të jetë kaq e vogël. Raporti i pagës së punëtorit me atë të funksionarit më të lartë është një me dy. Të huajt vënë pyetjen: Si është e mundur që funksionari i lartë të ketë një diferençë kaq të vogël page në krahasim me punëtorët? Përgjigja e kësaj pyetjeje nuk është e vështirë. Te ne ndodh kështu sepse shteti i diktaturës së proletariatit, me ligjet e tij të drejta, ka sanksionuar parimet marksiste-leniniste mbi pagat. Duke folur për këtë problem, Lenini ka shkruar se kthesa nga demokracia borgjeze në demokracinë proletare është

*«...heqja... e të gjitha privilegjeve financiare që gjëzonin funksionarët, ulja e rrogës së gjithë funksionarëve në nivelin e një «page të barabartë me atë të punëtorit»»<sup>1</sup>.*

Një ndër masat që mori Komuna e Parisit dhe që Marks i ka vënë në dukje, ka qenë pikërisht ulja e pagës së

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 496.

funkcionarëve. Ne nuk lejojmë abuzime në zbatimin e parimit të shpërblimit sipas punës, prandaj këtu nuk është krijuar dhe nuk do të krijohet kurrë ndonjë shtresë punonjësish që ta vërë veten mbi të tjerët dhe të marrë vendime sipas dëshirave dhe interesave të saj.

Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë jo vetëm u është prerë rruga me ligj prirjeve revizioniste, por po bëhet një punë e madhe edukuese për ngritjen e ndërgjegjes së njerëzve që çdo punonjës të marrë sipas sasisë dhe cilësisë së punës që bën. Përveç disa njerëzve të degjeneruar, shumica dërrmuase e pjesëtarëve të shoqërisë sonë e konsideron si një detyrë të madhe spastrimin e ndërgjegjes nga mbeturinat kapitaliste. Te ne është arritur forcimi i dashurisë dhe i respektit të njeriut për njeriun. Shoku bën përpjekje me durim të ndihmojë shokun që të korrigjojë gabimet që bën dhe ta dënojë gjestin e tij, kur ky shkel ligjet që rregullojnë marrëdhëniet juridike e normat socialiste të shoqërisë sonë.

Kjo situatë revolucionare është arritur për arsyet se te ne zbatohen me konsekuençë liria e fjalës, diskutimi i thellë dhe i gjerë i masave për problemet më të ndryshme, demokracia e vërtetë proletare. Kështu shpjegohet situata jonë.

Le të thonë ç'të duan ata që mendojnë se në Shqipëri nuk ekzistoka liri për shtetasit, nuk ekzistoka demokraci, nuk ka shumë parti dhe diskutime pa fund në parlament. Te ne ekziston në format më të përshtatshme dhe më demokratike liria e plotë për masat punonjëse,

ndryshe nuk mund të lulëzonte vendi, siç po lulëzon, nuk mund të arrihej uniteli monolit i popullit me Partinë. Pikërisht këtu, në unitetin Parti-popull, është kyçi i fitoreve tona, prandaj këtë kyç të artë duan të ndryshkin armiqitë kapitalistë dhe revizionistë, duke shpifur në mënyrën më cinike.

Po të dëgjojë ndonjë i huaj, borgjez ose revizionist qoftë, diskutimet e përfaqësuesve të popullit në Kuvendin tonë Popullor, mund të thotë: «Këtu nuk paska debate si në parlamentet tona, kjo nuk është normale». Është e vërtetë që në Kuvendin Popullor nuk ka debate për debate, por kjo nuk do të thotë se mungon debati. Problemi politik ose ekonomik, që ka ardhur për shqyrtim në Kuvendin Popullor, më përpëra ka qenë objekt debatesh, diskutimesh e sugjerimesh të zjarrta e konstruktive në vëtë gjirin e masave punonjëse e të organizatave të tyre, që deputetët i ndjekin për të dëgjuar zërin e masave dhe marrin pjesë aktive në debat. Asgjë s'është arritur si në gjalpë, në qelësi, si ka dashur njëri apo tjetri, ose me diktat nga lart, por gjithçka është parë me syrin e interesit të përgjithshëm. Për sa kohë që problemet janë rrahur e shoshitur, para se t'i paraqiten për aprovim organit më të lartë të pushtetit shtetëror, përsë u dashka të bëhen diskutime për diskutime, klithma e çjerrje në Kuvend «për të manifestuar demokracinë» si në parlamentet borgjeze?

Në organet tona të pushtetit shtetëror, qoftë në Kuvendin Popullor, ose në këshillat popullorë të të gjitha instancave, nuk është e vërtetë që s'ka debate. Jo më në organet e pushtetit, por edhe në mbledhjet e pu-

nonjësve, kur diskutohet mbi një plan ose një ligj, bëhen diskutime të shumta, që karakterizohen nga një debat i madh popullor, që gërmon të priturat dhe të pariturat për të gjetur zgjidhjen më të arsyeshme. Këto debate nuk ndeshen në asnjë vend të botës kapitalisto-revizoniste. Pra, edhe në këto drejtime duket epërsia e madhe e shoqërisë së re socialiste për zhvillimin, fuqizimin dhe mbrojtjen e së cilës duhet të punojmë gjithnjë siç na mëson ideologjia marksiste-leniniste. Janë kjo shoqëri dhe kjo ideologji që krijojnë mundësitë për zhvillimin e virtuteve të njerëzve, që krijojnë kuqshet më të përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë në interesin e përgjithshëm dhe jo të një klase shfrytëzuesish. Shoqëria socialiste dhe marksizëm-leninizmi na mësojnë rrugën si të gjemë vazhdimisht metodat e administrimit më të përsosur të vlerave materiale dhe morale të popullit dhe si t'i vëmë këto vlera në shërbim të atdheut.

Në të gjitha formacionet ekonomiko-shoqërore jo-socialiste, në të gjitha shtetet kapitaliste dhe revolucioniste, shoqëria nuk udhëhiqet nga klasa punëtore dhe, rrjedhimisht, as nga partia e saj revolucionare e ushqyer me teorinë e Marksit dhe të Leninit. Atje ekzistonjë klasa të ndryshme antagoniste, që udhëhiqen nga partitë e tyre, të cilat nuk përfaqësojnë interesat e vërtetë të masave, por të aristokracisë punëtore ose të aristokracisë së madhe borgjeze. Këto parti hiqen sikur në veprimtarinë e tyre politike ndeshen me njëra-tjetrën dhe zhvillojnë gjoja një luftë «demokratike» parlamentare, por në parlamentet borgjeze

*«...vetëm lloмотитин, duke пасур си ёlliм тë  
посаçëm тë масhtrojnë «popullin e thjeshtë»»<sup>1</sup>.*

Shtetet, që sundohen nga partitë politike të borgjezisë, edhe pse mbulohen me emërtime që vetëqulhen «demokratike», në fakt në veprimtarinë e tyre nuk kanë asnje fije demokracie dhe lirie të vërtetë individuale apo shoqërore.

«Demokracia» në disa nga vendet josocialiste shprehet formalisht në organizimin e shumë partive, të cilat, gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare, duke ushtruuar një ndikim të fuqishëm mbi masat punonjësc, duke i mashtruar ato, si dhe duke manipuluar procedurën e zgjedhjeve e rezultatet e tyre, arrijnë të kenë secila nga një grup deputetësh në parlament. Deputetët e këtyre partive nuk janë tjetër veçse politikanë të regjur e të specializuar për të mbrojtur rendin në fuqi, për të forcuar pozitën shtetërore kapitaliste të trusteve dhe të monopoleve. Në parlament ato paraqiten gjoja sikur u kanë dhënë vendit dhe popullit «liri» dhe «demokraci». Sido që deputetët borgjezë bluanë si mulliri pa kokrra për «të drejtat e njeriut», në fund të fundit atje sundon kapitalizmi, sundon borgjezia e madhe, e cila herë pas here e ndan pushtetin me borgjezinë e mësme dhe i mban nën sundim proletariatin, fshatarësinë e varfér, si dhe pjesën tjetër të punonjësve, siç janë artizanët e intelektualët e varfér, që papunësia dhe uria i kanë këtandisur në një shtresë shoqërore revolucionarish të

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 501.

dobët. Këta zgjedhës të mjeruar vendosin, siç thotë Marks,

*«...në tre a gjashtë vjet... kush nga anëtarët e klasës sunduese duhej të përfaqëson dhe të shtypte popullin në parlament...»<sup>1</sup>.*

Partitë politike, në pushtet ose në opozitë, kanë organizuar sindikatat e tyre, që i drejtojnë me forma gjoja demokratike për të bërë protesta ose rivendikime. Të gjitha protestat dhe rivendikimet e nxitura nga këto parti nuk kanë karakter politik, nuk orientohen drejt rrëzimit të rendit kapitalist, që i shfrytëzon pa mëshirë punonjësit, por synojnë disa reforma ekonomike që janë të një shkalle aq pa rëndësi, sa nuk i prishin shumë punë borgjezisë (prandaj ajo herë pas here edhe i pranon këto kërkesa) dhe nuk i sjellin asnje fitim të ndjeshmë proletariatit e shtresave të tjera të shtypura e të shfrytëzuara. Por këto «kërkesa» kanë rëndësi për mbrojtësit e rendit borgjez, sepse nëpërmjet tyre synojnë të krijojnë përshtypjen e rreme në opinion, sikur klasa punëtore dhe punonjësit e tjerë e thonë fjalën e tyre «lirisht» në kapitalizëm. Për t'u bindur sa mashtruesc janë këto veprime, mjafton të kujtojmë që kur masat me kërkesat e tyre kapërcejnjë orientimet e partive politike dhe ngulin këmbë në sigurimin e vërtetë të lirive dhe të të drejtave që u takojnë, atëherë ndërhyjnë forcat e mbrojtjes së rendit kapitalist dhe i mbytin në

---

1. K. Marks e F. Engels, Vepra të Zgjedhura, vëll. I, f. 548. Tiranë, 1975.

gjak. Historia botërore njeh shumë fakte të tilla, që nuk numërohen dot.

Tezën mashtruese, se në sistemin e tyre shoqëror ka «demokraci», kapitalistët përpinqen ta vërtetojnë me arsyetimin bajat që atje partitë politike kanë shtypin e tyre, ku mund të shprehin pikëpamjet e veta të ndryshme për problemet e vendit, për pushtetin dhe për njërezit e tij. Duke demaskuar «lirinë e shtypit» që pretendohet nga borgjezia, Lenini ka shkruar:

*«Kapitalistët... quajnë «shtyp të lirë» një gjendje të tillë, kur hiqet censura dhe të gjitha partitë botojnë lirisht çfarëdo gazetash.*

*Në të vërtetë kjo nuk është liri shtypi, po liri për të mashtruar masat e shtypura dhe të shfrytëzuara të popullit nga pasanikët, nga borgjezia»<sup>1</sup>.*

Po ç'është nç të vërtetë demokracia borgjeze? Ajo është një formë e sundimit të borgjezisë, kurse të drejtat dhe liritë që shpallen «për të gjithë», atje kanë absolutisht karakter formal e të gënjeshtërt, sepse, në kushtet e ekzistencës së pronës private, mungojnë mjetet socialekonomike që sigurojnë zbatimin efektiv të tyre. Me këtë demokraci borgjeze mund të kritikosh në gazetë, në mbledhje të ndryshme, osc në parlament njërin osc tjetrin, mund të kritikosh një parti ose një qeveri që vjen në fuqi, mund të bësh muhabet sa të duash, por nuk mund të ndryshosh asgjë, ti je i detyruar

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 444.

të mbetesh vetëm te fjalët, për arsyen se pushteti ekonomik dhe politik kapitalist, me aparatet e tij, është i përgatitur të sulet si bishë ndaj cilitdo që hidhet me veprat kundër klasës sunduese, kundër oligarkisë financiare. Duke kujtaruar ashpërsinë me të cilën borgjezia franceze goditi punëtorët pas Kryengritjes së Qershoret të vitit 1848, F. Engelsi shkruan:

*«Borgjezia tregoi për herë të parë se me çfarë egërsie të tërbuar hakmerret kundër proletariatit, kur ai guxon të ngrihet kundër saj si një klasë më vete, me interesat dhe me kërkesat e veta!»*

A mund ta quajmë «demokraci» formën e pushtetit të borgjezisë, që mbështetet në parimin e nënshtrimit të shumicës nga pakica? Në asnjë mënyrë. Kjo është demokraci vetëm për emër, që nuk u sjell asnjë dobi masave të popullit. Kjo «demokraci» nuk i siguron popullit asnjë liri të vërtetë, nuk e bën vendin të pavarur ndaj shteteve të tjera më të fuqishme në politikë, në ekonomi, ose në fushën ushtarake. Ndodh kështu sepse kjo farë demokracie është pleksur me «demokraci» të tjera kapitaliste më të fuqishme, që imponojnë vullnetin e tyre. Kapitali, qoftë kombëtar apo ndërkombëtar, u imponon masave të gjera punonjëse vullnetin, dëshirat dhe pikëpamjet e tij. Kur paraqitet diçka në vendet kapitaliste ose revizioniste si «vullnet i masave

punonjëse», prapa saj duhet kuptuar se, në të vërtetë, fshihet vullneti i aristokracisë punëtore dhe i borgjezisë së madhe.

Ligjet që aprovojen në parlamentet borgjeze e revisioniste, shprehin vullnetin e klasës sunduese dhe mbrojnë interesat e saj. Nga këto ligje përfitojnë partitë e kapitalit, që formojnë shumicën në parlament. Por nuk mbeten pa përfituar as ato parti, që gjoja janë në opozitë dhe që shpeshherë përfaqësojnë interesat e aristokracisë punëtore e të kulakëve. Këto parti «opozitare», që gjoja janë në kundërshtim me partitë që kanë fituar shumicën e vendeve në parlament dhe që mbështetin kapitalin e madh, bëjnë zhurmë, «kritikojnë» etj., por zhurma e tyre nuk i shuan papunësinë, emigracionin dhe inflacionin. Sido që thërret e çirret opozita në parlament, çmimet ngrihen,jeta çoroditet e degjenerohet, krimet e vrasjeve nëpër rrugë, të vjedhjeve e të grabitjeve, ditën dhe natën, bëhen gjithnjë e më tepër shqetësuese. Këtë kaos e rrëmujë, këtë liri të keqbërësve për të kryer krime, kapitalistët dhe revisionistët e quajnë «demokraci të vërtetë»!

Në këtë kompleks amoral vërtitet i fanishmi pushtet demokratiko-borgjez, që sundohet nga shumë parti borgjeze në shtetet kapitaliste, ose nga një parti anti-marksiste, si në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavinë titiste dhe në disa vende të ish-demokracisë populllore, që janë kthyer në vende kapitaliste.

I ashtuquajturi pluralizëm, deri në kohën e përhapjes së revisionizmit modern, titist dhe hruščovian, kufizohej me pjesëmarrjen në pushtetin shtypës kapitalist të partive pseudodemokratike, si<sup>q</sup> janë partitë ra-

dikale, socialiste, socialdemokrate e shumë parti të tjera me emra të tillë. Kur Bashkimi Sovjetik i Leninit dhe i Stalinit u shkatërrua nga revizionizmi hrushovian, kur titizmi hodhi bazat e regjimit kapitalist në Jugosllavi, partitë e tjera komuniste, me përjashtim të Partisë së Punës të Shqipërisë, degjeneruan dhe u kthyen në parti revizioniste, në parti reformiste, në parti që kërkonin bashkëpunim të ngushtë me partitë e kapitalit, për qeverisjen e shoqërisë borgjezo-kapitaliste. Këtë qëllim e kanë shprehur haptas aktualisht partitë revizioniste të Francës, të Italisë, të Spanjës, të Belgjikës etj.

Nuk ka nevojë për asnjë shpjegim që të vërtetohet se pjesëmarrja në pushtet e shumë partive borgjeze, kapitaliste, revizioniste e fashiste në vendet kapitaliste e imperialiste, si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës etj., nuk i ka shndërruar aspak shoqëritë e tyre nga reaksionare në progresive. Përkundrazi, në imperializëm bëhet kthesa nga demokracia drejt reaksionit. Nuk është një shoqëri e përparuar dhe as demokratike ajo që mbron rendin shfrytëzues dhe mbështetet në të. Edhe ekzistenca e një partie të vetme në pushtet, kur kjo parti nuk ndjek një vijë marksiste-leniniste, domethënë nuk është parti e proletariatit, nuk mund të cojë kurrë në ndërtimin e socializmit. Përkundrazi, një parti e tillë, sidomos që t'ia vëré emrin vetes, «marksiste» apo «marksiste-leniniste», në të vërtetë është parti e borgjezisë ose një parti fashiste, që ka për detyrë të financojë pronën private ose shtetërore kapitaliste, përtë ushqyer një klasë të re sunduesish.

Një partie të tillë i duhet të ruajë disa forma gjoj<sup>a</sup>

marksiste; edhe pushtetit që ajo udhëheq, përpinqet t'i japë forma dhe emërtime socialiste, por thelbin dhe qëllimet e saj dhe të shtetit ajo i ka antisocialiste, sepse synon të realizojë transformimin regresiv të vendit dhe rivendosjen e kapitalizmit. Borgjezia e re, në këtë rast, gradualisht e bën pushtetin të vetin në dëm të proletariatit dhe të aleatëve të tij të natyrshëm. Ky proces është vërtetuar në Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik dhe në shumë vende të tjera të ish-demokracisë popullore, ku nuk ekziston pluralizmi i partive. Në këto vende, në forma të ndryshme, është rivendosur kapitalizmi, po ngjallet dhe po merr forcë klasa e shfrytëzuesve të rinj. Në qoftë se vendi që pëson nga ky regres, është i madh, për sa u përket territorit, popullsisë dhe potentialit ekonomik, shteti i tij kthehet në socialimperialist; në qoftë se, përkundrazi, vendi është i vogël, atëherë kthehet në një satelit të kapitalizmit botëror, në një shtet që sundohet nga kapitalet e huaja e neokolonializmi, të cilët shfrytëzojnë pasuritë e vendit dhe djersën e popullit. Pra, të gjitha shtetet e ashtuquajtura demokratike, qofshin me sistemin e pluralizmit apo me sistemin e sundimit të një partie të vetme, që s'është marksiste-leniniste, nuk duan ta zëvendësojnë shoqërinë e vjetër kapitaliste shfrytëzuese me shoqërinë e re sociale. Në këtë shoqëri të vjetër, ku ekzistojnë prona private dhe sundimi kapitalist, nuk mund të ketë liri, demokraci, pavarësi dhe sovranitet të vërtetë të popullit.

*«Vetëm diktatura e proletariatit, — na mëson Lenini, — është në gjendje ta çlirojë njerëzimin nga zgjedha e kapitalit, nga gënjeshtra,*

*falsiteti, hipokrizia e demokracisë borgjeze, e kësaj demokracie për të pasurit, vetëm ajo është në gjendje të vendosë demokracinë për të varfrit, domethënë të bëjë që të mirat e demokracisë t'i gëzojnë në fakt punëtorët dhe fshatarët e varfër...»<sup>1</sup>.*

Shfrytëzimi kapitalist nuk mund të realizohet pa një propagandë politike intensive, që të shërbujejë për të çoroditur mendjet e njerëzve, dhe pa një sërë ligjesh të hekurta që t'i kufizojnë në maksimum të drejtat e punonjësve. Aparati i madh propagandistik në dispozicion të borgjezisë zhvillon orë e çast propagandë kundër proletariatit dhe diktaturës së tij, kundër popujve që janë hedhur në luftë për të mbrojtur të drejtat e tyre. Tërë potenciali ekonomik dhe politik në shoqëritë kapitalisto-revisioniste ndodhet në duart e një grushti manjatësh, pasanikësh, të cilët kanë krijuar një rrjet të gjerë e të fuqishëm mekanizmash shtetërorë, për të mbajtur në këmbë me dhunë pushtetin e tyre. Këtij qëllimi i shërbejnë ushtria, policia, agjentët, gjykatat dhe organe të tjera të sundimit klasor, që ndëshkojnë rreptë çdo kundërshtim, qoftë ky individual ose kolektiv, nga ana e proletariatit dhe e punonjësve të tjerë, e që shtypin revoltat popullore.

Mbrojtësit borgjezë e revisionistë të shtetit kapitalist e paraqesin nacionalizimin e disa sektorëve ekonomikë, të transportit etj. si shenjë të «shndërrimit» të sistemit kapitalist. Ky proces «transformimi», sipas

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 28, f. 424-425.

tyre, mund të shkojë edhe më tej, në rast se proletariati bëhet «i arsyeshën», «i matur» dhe «i urtë» në kërkesat e veta, në rast se ai u bindet partive politike tradhtare dhe sindikatave që manipulojnë ato. Këta «teoricienë» janë reformistë, se pretendojnë kthimin e shtetit kapitalist në shtet socialist nüpërmjet reformave. Reforma strukturore janë bërë nga kapitali në vende të ndryshme kapitaliste, revizioniste e imperialiste, por këto nuk kanë sjellë fitoren e revolucionit dhe të revolucionarëve, përkundrazi, kanë krijuar atë situatë që e ka shpëtuar kapitalin nga përblysja, e ka ruajtur klasën shfrytëzuese nga varrmihësit e saj.

Revizionizmi modern ka në rendin e ditës reformizmin, që përbën thelbin e pikëpamjeve, të teorive dhe të praktikave të tij. Reformizmi është kundër ideologjisë marksiste-leniniste dhe shembjes së kapitalizmit me anë të revolucionit me dhunë. Motori i revolucionit proletar është lufta e pamëshirshme e klasave, e klasës së proletariatit dhe e aletëve të saj, fshatarësisë së varfër dhe shiresave të tjera të shtypura, kundër borgjezisë, kapitalit monopolist shitetor, kapitalit finanziar, kurse reformizmi mohon luftën klasore, revolucionin socialist dhe diktaturën e proletariatit.

Pra, reformizmi është varrmihësi i revolucionit. është antiteza e marksizëm-leninizmit, prandaj e kanë përqafuar partitë revizioniste të vendeve të ndryshme që nga Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia, Kina, vendet ish-socialiste dhe partitë e tjera revizioniste të vendeve e të kontinenteve të botës. Duke pasur si qëllim shuarjen e revolucionit dhe deformimin e tezave bazë

të marksizëm-leninizmit, disa parti, që e kanë quajtur veten eurokomuniste, e hodhën tej pa dorashka teorinë marksiste-leniniste. Këto parti, me Partinë Komuniste të Spanjës në krye, kanë braktisur leninizmin. Partia Komuniste e Spanjës ka arritur gjer atje sa hoqi edhe emrin «leniniste» për t'i dhënë të kup-tojë borgjezisë se tanimë qenka kapërcyer periudha kur pretendohet përmbyssja e kapitalizmit dhe marrja e pushtetit me dhunë nga ana e proletariatit, se partitë revizioniste janë në periudhën e shndërrimit të tyre në parti të borgjezisë dhe janë gati të jepin çdo provë tjetër për të fituar besimin e kapitalit vendës dhe të atij ndërkombëtar.

Edhe çështja e përparimit në teknologji e në shkencë nuk mund të ngatërohet me shndërrimin revolucionar të shoqërisë, me çlirimin e proletariatit e të mbarë punonjësve nga sistemi i vjetër shfrytëzues që me arritjen në sistemin e ri socialist. Teknologja që shkenca e përparuar janë frysht i mendjes së njerezve, i punëtorëve dhe i intelektualëve, por në rendet shoqërore shfrytëzuese teknika dhe shkenca vihen në shërbim të klasave sunduese për të forcuar pozitat e tyre ekonomike, politike dhe ideologjike brenda dhe jashtë vendit. Zhvillimi i shkencës e i teknikës dhe rritja e numrit të specialistëve nuk mund t'i zhdukin plagët e kapitalizmit, siç pretendojnë ideologët borgjezë e revizionistë. Eksperiencia tregon se, sido që të zhvillohen forcat prodhuese dhe të përparojnë teknika e shkenca, revolucioni socialist me dhunë për kalimin nga kapitalizmi në socializëm mbetet i pazëvendësueshëm.

Teoria jonë marksiste-leniniste e ka bërë krejtësisht të qartë se nuk mund të shkohet në shoqërinë socialiste duke qëndruar brenda kuadrit të rendit kapitalist, por duke përmbysur që nga themellet këtë rend dhe institucionet e tij, duke ngritur pushtetin e proletariatit, që udhëhiqet nga pararoja e tij — partia komuniste marksiste-leniniste.

Politika e Partisë dhe e shtetit tonë mbron të shtypurit që ngrihen në revolucion dhe lufton shtypësit, që janë të destinuar të zhduken si klasë. Partia jonë e thotë haptazi se zhdukja e shfrytëzuesve nuk mund të arrihet ndryshe veçse me luftë, me revolucionin me dhunë dhe jo me reforma, qofshin këto të strukturave apo të superstrukturave. Që të arrihet çlirimi i plotë e i vërtetë i klasës punëtore dhe i mbarë punonjësve të botës, duhet përmbysur nga themellet pushteti i vjetër dhe në vend të tij të vendoset pushteti i ri i proletariatit.

Ne jemi kundër decentralizimit të ekonomisë sociale dhe në luftë të papajtueshme me teorinë kapitaliste të revisionistëve jugosllavë «të vetadministrit», «të vetëqeverisjes së ndërmarrjeve» që kërkonin të na i futnin fshehtazi këtu titizmi dhe miqtë e tij, nëpërmjet tradhtarëve Beqir Balluku, Abdyl Këllezi, Koço Theodhosi etj. Ekonomia sociale e vendit tonë zhvillohet në baza shkencore, sipas planit unik të përgjithshëm, me qëllim që të përbushen nevojat materiale e kulturore të shoqërisë. Në Kushtetutën tonë thuhet: «Shteti organizon, drejton e zhvillon tërë jetën ekonomike e shoqërore me plan unik e të përgjithshëm...».

Shteti ynë e ka të drejtë dhe detyrë të mbikë-

qyrë zbatimin e këtij plani në të gjitha hallkat e treguesit. Kjo mbikëqyrje realizohet nëpërmjet kontrollit punëtor e fshatar, nëpërmjet kontrollit shtetëror dhe nëpërmjet kontrollit të Partisë e të organizatave të masave, që janë forma të kontrollit proletar.

Ky kontroll efektiv, natyrisht, mbështetet në lirinë e plotë të kritikës dhe në ndërgjegjen e lartë auto-kritike, që shërbejnë për mbarëvajtjen e punës, për kuptimin e drejtë të detyrave dhe për edukimin komunist të njerëzve. Kontrolli i zbatimit të detyrave të planit është një problem kompleks i shtetit të diktaturës së proletariatit, i politikës së Partisë, i ideologjisë sonë marksiste-leniniste, që gërshtohet në vepren e madhe që udhëheq Partia.

Borgjezia kapitaliste dhe revisionistët na atakojnë ne pse mbështetemi fuqimisht në diktaturën e proletariatit. Ata na akuzojnë ne komunistët se gjoja në shoqërinë tonë nuk përfillet personaliteti i njeriut! Kjo akuzë është një shpisje trashanike që ka për qëllim të fshchë shtypjen mizore të proletariatit dhe të popullit punonjës nga ana e kapitalit. Ekzistencë e klasave antagoniste është baza e shtypjes së personalitetit të njeriut dhe të masave punonjësc. Përkundrazi, në qoftë se ka një sistem shoqëror që e çliron me të vërtetë njeriun nga brengat, nga mërzitë, nga ndjenjat meskine, nga mbeturinat e vjetra idealiste, ky është vetëm sistemi shoqëror socialist, që realizon zhdukjen e klasave shfrytëzuese, të pronës private dhe i jep fund shfrytëzimit të njeriut prej njeriut.

Shkallmimi i pushtetit të klasave shfrytëzuese, që dominojnë barbarisht mbi punonjësit, dhe vendosja e

pushtetit të klasës punëtore e çliron dhe e ngre njëriun në piedestal, e bën atë të punojë me vrull, të drejtojë me ndërgjegje të pastër, të kritikojë kur duhet dhe të lavdërojë kur duhet. Socializmi e vë njeriun në pozita të tilla që ai të shohë dhe ta ndiejë se nuk është i veçuar nga bota, por është pjesëtar i një shoqërie të re, e cila ka për qëllim përparimin e individit në kuadrin e zhvillimit të shoqërisë. Në këtë shoqëri njeriu ngrihet në vendin që i takon, në bazë të aftësive dhe të punës që kryen, ai është i lirë të punojë dhe të gjëzojë frytet e punës së tij. Lirinë e individit në shoqërinë tonë nuk mund ta kuptojnë as borgjezi, as kapitalisti, as revizionisti, sepse ata e matin personalitetin me kutin e tyre të standardizimit dhe të manipulimit të njerëzve.

Klasat shfrytëzuese, duke pranuar pavarësinë e individit nga shoqëria, synonin të krijonin privilegje për njerëzit e klasës së tyre, t'u jepnin atyre dituri, liri dhe kompetenca për të sunduar dhe për të drejtuar të tjera. Regjimi ynë ia ka këputur rrënjet individualizmit borgjez dhe u ka krijuar mundësi të pëkufizuara individit dhe shoqërisë për të zhvilluar aftësitë dhe për të gjuar të gjitha të drejtat dhe liritë kushtetuese.

Kapitalizmi dhe propaganda e tij, natyrisht, janë dhe do të jenë në luftë me realitetin tonë socialist, me diktaturën tonë të proletariatit, pse nuk mund të pajtohen me moralin tonë, që nuk lejon të shfrytëzohet njeriu ekonomikisht, politikisht e moralisht dhe të merrin nëpër këmbë liritë e tij. Por realitetin tonë socialist nuk mund ta errësojë asnje propagandë ose

«teori» idealiste, qoftë kjo kapitaliste apo revizioniste.

Bota kapitaliste është futur në një krizë të madhe. Avokatët e rendit borgjez, ekonomistët dhe sociologët e borgjezisë, të detyruar nga realiteti, e shikojnë se tezat e Marksit dhe të Leninit për kapitalizmin dhe imperializmin nuk janë vjetruar, se në shoqërinë aktuale kapitaliste vërehet procesi i kalbëzimit të kapitalizmit dhe të imperializmit, ashtu siç e kanë parashikuar ata, por, për të dalë nga kriza, këta mbrojtës të rendit të vjetër ngrenë me të madhe «luftën kundër terrorizmit», ndalimin e revoltave e të revolucionit të masave punonjëse kundër rendit kapitalist, ose kundër «turbullirave», siç i quajnë ata. Ndryshe, pohojnë të dëshpëruar këta sociologë dhe ekonomistë të borgjezisë, kapitalizmi nuk mund të dalë nga kriza dhe të «stabilizojë» sistemin e tij.

Vendet kapitaliste dhe revizioniste, ku pretendohet se njeriu gjoja gjëzon liritë demokratike e çdo «të mirë» tjetër, ziejnë nga protestat e masave. Në qoftë se atje paska me të vërtetë liri dhe masat gjëzojnë të gjitha të mirat materiale, siç thuhet, atëherë përsë dalin vazhdimisht nëpër rrugë miliona njerëz dhe përleshen me policinë e borgjezisë? Është e qartë se masat protestojnë për arsyen se jeta e tyre nuk është e mirë, se ato vuajnë nga ana ekonomike, politike dhe në shumë drejtime të tjera, prandaj përpiken ta rrëzojnë shtetin që është kundër demokracisë së vërtetë.

Shteti borgjez i periudhës së sundimit të kapitalizmit monopolist shtetëror kërkon të japë përshtypjen sikur atje ligjin e bën parlamenti, ku përfaqësohen partitë e ndryshme, të zgjedhura gjoja me vota të për-

gjithshme. Por është e njohur botërisht se sistemi i zgjedhjeve dhe kufizimet e shumta që janë vënë me ligj, bëjnë që shumicën në parlament ta kenë kurdoherë ato parti politike që janë kolonat më të forta të kapitalit. Loja parlamentare në këto vende është një maskaradë, është një mjet që i shërbën pushtetit të borgjezisë për të dhënë përshtypjen e rreme sikur atje ka «demokraci» dhe për ta paraqitur demokracinë e rreme për të vërtetë. Në organet e larta të pushtetit shtetëror dhe të administratës shtetërore kapitaliste e revizioniste bëjnë pjesë «të dcleguarit» e atij pushteti të pasanksionuar me ligj, që formalisht qëndron jashtë qeverisë, por që, në fakt, është në fuqi. Ky është pushteti i kapitalistëve të mëdhenj, të cilët, duke përdorur fuqinë e parasë, kanë çuar, qoftë në qeveri, qoftë në parlament faktotumet<sup>1</sup> e tyre të përshtatshme për të mbrojtur interesat e veta nga «turbulluesit», nga ata që ngrenë krye dhe që duan të fitojnë të drejtat e rrëmbyera nga kapitalistët. Gjithë këtij kompleksi mbrojtësit e kapitalizmit e të revizionizmit i kanë vënë emrin «demokraci e vërtetë».

Lenini ka folur se në raste të caktuara tribuna e parlamentit borgjez mund të shfrytëzohet nga revolucionarët si një nga format e punës së tyre legale për të demaskuar sistemin kapitalist. Por, njëkohësisht, ai theksonte se kjo punë nuk duhet të krijojë, te komunistët e te masat, iluzionin se pushteti mund të merret me rrugë parlamentare.

---

1. Nga latinishtja — shërbëtorë që shfrytëzohen për të bërrë çdo lloj pune.

Në shoqërinë borgjezo-kapitaliste dhe revizioniste «kretinizmi parlamentar» është ajo formë «demokracie» që borgjezia e përdor për të fshehur natyrën shtypëse të pushtetit të saj shtetëror, të cilin e dominon nëpërmjet shumicës së vendeve që siguron në zgjedhjet. Por, përveç pushtetit shtetëror, borgjezia dominon edhe pushtetin e fuqishëm jashtështetëror, domethënë monopolet, trustet, shoqërítë e përbashkëta dhe investimet e tyre brenda dhe jashtë vendit. Ky pushtet i pronës së madhe private përbën forcën ekonomike që përvetëson djersën e punonjësve brenda dhe jashtë vendit dhe është në gjendje të fuqizojë superstrukturën që i përshtatet më tepër sundimit të egër kapitalist. Superstruktura borgjeze synon realizimin e një politike skllavërucese mbi popujt, të një force ushtarake, ideo-logjike dhe politike kundër proletariatit, fshatarësisë së varfër dhe intelektualëve punonjës; ajo synon, gjithashtu, të degjenerojë dhe të shkatérrojë normat e moralit proletar për të përhapur moralin e ulët borgjez në kuqtimin e vërtetë të fjalës.

Parlamenti borgjez hap dyert e tij për «të zgjedhurit», por diktatura e borgjezisë bën punën e vet; atje bëhen diskutime pa mbarim e votime pas votimesh dhe puna vazhdon të ecë ashtu sikurse dëshirojnë ata që bëjnë ligjin, pasanikët, pronarët e trusteve, të monopoleve dhe të bankave, pushteti i të cilëve, shteti i dytë kapitalist, manipulon parlamentin dhe qeverinë, pavarësisht se ky manipulim nuk parashikohet në kushtetutat në fuqi. Duke u nisur nga këto arsyen, Lenini ka shkruar:

«...në çfarëdo vendi parlamentar... punën e vërtetë «shtetërore» e bëjnë prapa skenës dhe e kryejnë departamentet, zyrat, shtabet»<sup>1</sup>.

Në Shqipëri këshillat nacionalçlirimtarë, që u krijuan nën udhëheqjen e Partisë në kohën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe që u forcuan pas Çlirimt dhe gjatë periudhës së ndërtimit të socializmit, janë organe të diktaturës së proletariatit të zgjedhura nga populli dhe që përfaqësojnë vullnetin dhe dëshirat e popullit punonjës. Organet përfaqësuese të popullit në pushtetin shtetëror janë Kuvendi Popullor dhe këshillat popullorë. Në bazë të Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë «organet përfaqësuese drejtojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë e të gjitha organeve të tjera shtetërore, të cilat përgjigjen para tyre dhe u jasin llogari».

Demokracia te ne nuk është lojë për të mashtruar masat, por gjen zbatim në praktikë. Këtu nuk ka dy pushtete, njëri i njohur me ligj dhe tjetri *de facto*, por ka një pushtet unik shtetëror, që buron nga populli dhe i përket atij. Shteti ynë është shtet i diktaturës së proletariatit, që ka krijuar ligjet dhe aparatet e veta revolucionare, metodën dhe stilin e ri të punës dhe që shpreh e mbron interesa e punonjësve.

Në vendin tonë nuk është dhuna ajo që i bën njërit të zbatojnë ligjet e vendosura nga shteti i diklaturës së proletariatit, por është bindja e plotë se zbatimi

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 25, f. 500.

i ligjeve është në dobi të tyre dhe të shoqërisë. Populli ynë i zbaton ligjet në mënyrë të ndërgjegjshme, sepse vëtë ai merr pjesë fuqimisht në hartimin e tyre.

Në vendet kapitaliste e revizioniste ligji zbatohet nëpërmjet dhunës së egër të borgjezisë; atje nuk mund të pretendohet realizimi i vullnetshëm i ligjit nga populli për sa kohë që përbajtja e tij është në kundërshtim të hapët me interesat e popullit. Duke folur për padrcjtësinë e ligjit borgjez, Marks i thotë:

*«Çdo paragraf i kushtetutës përmban në vetvete të kundërtën e vet... në frazën e përgjithshme — lirinë, në rezervën — zhdukjen e lirisë»<sup>1</sup>.*

Shtetasi në këto vende është një plaçkë dhe trajtohet tamam si plaçkë, kurse te ne çdo shtetas i republikës vlerësohet lart, ai luan rol të madh në shoqëri. Që shtetasi ta luajë këtë rol në mënyrë më aktive, duhet që ai të ngrihet akoma nga ana ideopolitike, kulturore e shkencore dhe të bëhet i ndërgjegjshëm për rolin e tij.

Shoqe dhe shokë,

Frontit Demokratik i takon detyra të luftojë pareshtur për ruajtjen e zhvillimin e demokracisë sonë, kësaj fitoreje të madhe të Partisë e të popullit për zbatimin e ligjeve e të normave që rregullojnë jetën socialiste.

Ai duhet të punojë pareshtur për të tjerheçur gjithnjë e më mirë mendimin e masave të gjera pu-

1. K. Marks e F. Engels, Vepra të Zgjedhura, vëll. I, f. 265. Tiranë, 1975.

nonjësc, të ndihmojë që ato të thonë fjalën e tyre për të gjitha problemet shtetërore e shoqërore, që punëtorët e fshatarët të ushtrojnë kontrollin e vet mbi organet shtetërore, ekonomike etj.

Fronti ynë Demokratik nuk është një organizatë amorfë, pa shpirt. Për kundrazi, është një organizatë me një dinamizëm politik të atillë që çdo problem e shikon me syrin revolucionar dhe gjen format më të përshtatshme për ta zbatuar atë në jetë në mënyrë revolucionare.

Fronti Demokratik udhëhiqet nga Partia e Punës e Shqipërisë, domethënë nga pararoja e klasës punëtore dhe shpreh ato mendime, ato aspirata dhe atë politikë që janë në të mirën e popullit shqiptar, ndërsa demaskon e lufton çdo gjë që mund t'i bëjë keq atdheut tonë socialist. Politika e Frontit, pra, është një politikë monolite, e pandarë, mbasi në të nuk ekzistojnë rryma politike antagoniste, nuk ekzistojnë parti të ndryshme që të mbrojnë interesa të klasave të ndryshme. Lufta politike e Frontit përputhet plotësisht me politikën e Partisë, me politikën e shtetit tonë socialist. Politika e Frontit Demokratik të Shqipërisë pasqyron dhe mbështet ligjshmërinë revolucionare të Republikës sonë Popullore Socialiste.

Arrijtë e vendit tonë jashtë mendojnë se politika e Frontit Demokratik të Shqipërisë është një politikë e sfatur, stereotipe dhe pa përbajtje. Ata dëshirojnë që politika e Frontit tonë të jetë një politikë konfuzë dhe kontradiktore, produkt i rrymave të ndryshme, me botëkuptime e me qëllime të ndryshme, pse vetëm kjo, mendojnë ata, është demokratike. Këta

kundërshtarë të organizatës së Frontit tonë revolucionar nuk janë në gjendje të kuptojnë se një popull i bashkuar, si populli ynë, mundet dhe ka një pikëpamje politike të drejtë, të qartë dhe unike në parimet dhe në qëllimet dhe, kur themi unike, jo një politikë pa shpirt e shabllone, por një politikë që di t'u ja përgjigje e zgjidhje, me anë debatesh e diskutimesh, të gjitha problemeve, qofshin këto probleme të komplikuara të brendshme, qofshin probleme shumë të komplikuara të jashtme.

Nga i vjen Frontit Demokratik një forcë dhe një pjekuri e tillë? Pikërisht nga fakti se përbajtja e kësaj organizate është me të vërtetë demokratike, pse Fronti ynë është një organizatë e gjërë masash që udhëhiqet nga një Parti marksiste-leniniste, që përfaqëson demokracinë më të përsosur, demokracinë e vërtetë të proletariatit. Proletariati dhe Partia e tij janë kurdoherë në luftë dhe në revolucion për ndërtimin e një shoqërie të lumtur për popullin, të një shoqërie të lirë, të një shoqërie demokratike, të një shoqërie që çdo ditë ngrihet gjithnjë e më lart nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, intelektual, e dijeve dhe e moralit të shëndoshë proletar. Dhe kjo bëhet nëpërmjet një lufte të vazhdueshme krijuese, që lyp përpjekje e debate demokratike.

Fronti ynë Demokratik ndjek këtë politikë dhe lufton për të arritur këto qëllime. Zbatimin e një politike të tillë nuk mund ta bëjë një organizatë e krijuar vetëm sa për sy e faqe, për të mashtruar masat e popullit brenda e jashtë vendit se gjoja ekziston një organizatë politike, kur kjo është diçka e paqenç.

Si e shikon zhvillimin botëror Fronti ynë Demokratik? Fronti ynë e shikon në mënyrë realiste këtë zhvillim. Domethënë ai orientohet nga dialektika materialiste, nga materializmi historik, ai bazohet në ideologjinë tonë shkencore, në marksizëm-leninizmin. Është kjo që e bën politikën e Partisë, të cilën e ndjek edhe Fronti, që të mos jetë një politikë pa bazë, një politikë e lëkundshme, një politikë pragmatiste, një politikë joparimore. Politika e Frontit Demokratik është, pra, një politikë me karakter klasor dhe, kur themi me karakter klasor, ajo mban parasysh dhe ka në bazë luftët e klasave brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare.

Fronti ynë Demokratik ushqen një daskuri të sin-qertë për popujt e botës, në radhë të parë për popujt që kërkojnë çlirim, për popujt që vuajnë nën robërinë dhe thundrën e kapitalit. Kjo politikë e Frontit mbëshitet me të gjitha forcat aspiratat e këtyre popujve. Me fjalën e vet vazhdimesh të drejtë, të qëndrueshme, humanitare dhe revolucionare, Fronti ynë Demokratik nuk ua fsheh kurrë të vërtetën e zhvillimit materialist të historisë popujve dhe klasave të shtypura e të shfrytëzuara të botës, që aspirojnë për liri, për demokraci të vërtetë dhe për sovranitet; ai nuk ua fsheh atë që fitoret e tyre nuk mund të arrihen pa një luftë të ashpër klase, pa përpjekje, disa herë edhe të përgjakshme, me shtypësit dhe me shfrytëzuesit e tyre kapitalistë. Kjo është baza e politikës marksiste-leniniste e Frontit Demokratik, që është e njëjta bazë edhe e politikës së Partisë sonë të Punës.

Politika e Frontit është, pra, një politikë që mbështet dhe përputhet me interesat e luftës që bëjnë në

çdo vend proletariati botëror, fshatarësia e vuajtur dhe e shtypur; ajo është përkrah luftës së njerëzve të varfër të qyteteve, të inteligjencies përparimtare, të rinnisë, të të gjithë popujve që dëshirojnë të sigurojnë një jetë plot dinjitet, një jetë të ndershinë, një jetë ku të fitohet çdo gjë me djersë, por që kjo djersë të mos shkojë në xhepin e hajdutëve, të kapitalistëve.

Këto janë parime që nuk lëvizin në politikën tonë. Pra, Fronti ynë Demokratik i do popujt e botës. Edhe ata e duan popullin shqiptar. Është një shembull tipik që Shqipëria, me gjithëse një vend i vogël, gjzon një simpati të madhe kudo në botë. Shqipëria është një vend që ndërton socializmin me forcat e veta, që «liganiset me dhjamin e saj», siç themi ne shqiptarët. Ajo nuk ka synime të shkaktojë luftëra, të zaptojë vende e popuj, përkundrazi, populli i saj dëshiron të rrojë në miqësi me popujt e tjerë, prandaj simpatia e tyre ndaj popullit shqiptar është e madhe, është e dukshme, është e prekshme.

Mirëpo popujt e ndryshëm të botës jetojnë në vende me regjime të ndryshme nga yni. Ata nuk qeverisen nga regjime të tillë siç është diktatura e proletariatit e vendosur në vandin tonë. Qeveritë e këtyre vendeve nuk ndjekin të njëjtën politikë si ajo jona. Prandaj, shteti ynë i diktaturës së proletariatit, dhe si konsekunçë edhe Fronti ynë Demokratik, pa lëvizur nga parimet bazë, është në gjendje që, me Partinë në udhëheqje dhe me frymëzimin e saj të shëndoshë, të bëjë analizat e nevojshme të zhvillimit të situatave në botë, të karakteristikave të veçanta të shteteve të ndryshme, të qëllimeve dhe të objektivave të këtyre shteteve ndaj

popujve të tyre, ndaj popujve të tjerë dhe në mënyrë të veçantë ndaj popullit tonë. Kjo analizë lejon që të ndërtohet një politikë e drejtë, e shëndoshë dhe jo një politikë koniunkturore. Partia jonë dhe Fronti Demokratik, duke u bazuar në këto parime të përgjithshme, dinë të dallojnë shkallën e dashamirësisë së një shteti borgjez nga shkalla e dashamirësisë së një shteti tjetër borgjez karshi Shqipërisë dhe karshi popujve të vegjël në përgjithësi; dinë të dallojnë rrezikshmérinë e një fuqie të madhe kapitaliste ndaj një fuqie tjetër të madhe kapitaliste, si dhe rrezikshmérinë e tyre ndaj shteteve të tjera kapitaliste më të vogla dhe shtetit tonë, dinë të dallojnë rrezikshmérinë e madhe të përgjithshme të supersfuqive imperialiste dhe socialimperialiste dhe për të gjitha këto mbajnë qëndrimet e duhura. Këto qëndrime që mbajnë Partia jonë, shteti ynë socialist dhe Fronti Demokratik i Shqipërisë, nuk janë qëndrime oportuniste, të paargumentuara dhe astë diktuar nga dikush, por janë qëndrime parimore, të bazuara e të sinqerta. Ato janë qëndrime të ashpra dhe të papajtueshme ndaj armiqve, por dashamirëse e korrekte ndaj atyre shteteve që ndjekin një politikë miqësie me Shqipërinë sociale dhe që brenda vendit të tyre u përbahen disa parimeve demokratike, lejojnë të bëhen disa reforma etj. Ne kemi mendimet tona si për «demokracinë» që ekziston në këto vende, ashtu edhe për këto lloj «reformash», për përbajtjen e tyre e qëllimin përsë bëhen ato. Kjo është një e drejtë jona, të cilën askush nuk mund të na e mohojë, ashtu siç nuk mund të na ndalojë të shfaqim mendimin tonë lirisht. Pikërisht këtë gjë ne e bëjmë kur

ua shpjegojmë popujve, teorikisht e politikisht, brendinë e «demokracisë» e të «reformave» në një shtet borgjëz, kufizimet e karakterin e tyre etj. Por këtë e bëjmë pa ndërhyrë në punët e brendshme të të tjerëve, sepse, në fund të fundit, janë vetë popujt e vendeve të ndryshme zotër të vendosin për vlerat e këtyre fenomeneve në shtetin e tyre.

Sidoqoftë, Partia jonë dhe Fronti Demokratik bëjnë diferencime dhe këto i bëjnë jo vetëm për të mbrojtur interesat e popullit dhe të vendit të tyre, por edhe ato të popujve të tjerë, pse vendin dhe popullin e tyre ato nuk i ndajnë kurrë nga interesat e përgjithshëm të popujve të botës e të proletariatit botëror. Këtu qëndron e vërteta e madhe dhe e fuqishme që shpreh politika e Partisë sonë dhe e Frontit Demokratik, këtu e ka burimin përkrahja që gjen në botë politika e shtetit tonë.

Politika jonë nuk ngjet me politikën e shteteve kapitaliste borgjeze dhe revisioniste, që lëkundet si fleta e verdhë në erën e vjeshtës. Jo. Politika jonë nuk është lëkundur dhe kurrë nuk do të lëkundet nga pari-mi që me popujt ne duhet dhe do të jemi vëllezër, me popujt duhet të jemi të bashkuar për të njëjtat qëllime, që janë liria, demokracia, sovraniteti dhe pavarësia e vërtetë; me popujt ne na lidh lufta kundër atyre që shtypin dhe që shfrytëzojnë popujt, na lidh lufta kundër atyre që nxitin e përgatitin luftërat imperialiste grabitqare, që bëhen në kurrizin e popujve. Nga kjo politikë ne nuk lëvizim kurrë, kjo politikë nuk ndryshon kurrë te ne, pavarësisht se nga ç'formë qeverie drejtohet njëri ose tjetri popull.

Prandaj, kur Shqipëria socialiste deklaron se me

popujt fqinjë, veçanërisht, dëshiron të rrojë në miqësi të mirë dhe i konsideron këta popuj si vëllezër, kjo është një e vërtetë e pashlyeshme. Ne kënaqemi kur shohim se disa udhëheqje të këtyre vendeve e të vendeve të tjera, odhe pse nuk kanë një rend shoqëror si yni, ndjekin një politikë dashamirëse ndaj vendit tonë. Edhe shteti proletar shqiptar ndjek nga ana e tij një politikë dashamirëse, të interesit reciprok, domethënë bën atë diferencim që duhet me ato shtete të ndryshme borgjeze, por progresiste dhe dashamirëse ndaj tij. Këtë gjendje ne dëshirojmë ta kemi me të gjitha ato shtete, të vogla ose më të mëdha, por që kanë respekt për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe që dëshirojnë të kenë marrëdhënie miqësore ekonomike e kulturore me vendin tonë, pavarësisht se janë në kundërshtim me të për një sërë problemesh, siç jemi edhe ne në kundërshtim me ta për një sërë çështjesh parimore.

Ne themi se marrëdhëni me qëllime të këqija janë kurdoherë të dëmshme e të rrezikshme dhe është zor të maskohen. Vetëjeta dhe historia e njerëzimit e kanë mësuar popullin tonë që ndaj marrëdhënieve, prapa të cilave fshihet pabesia, të jetë kurdoherë vijgjilent. Tashmë janë shumë ata, qoftë individë ose qarqe zyrtare jashtë, që e dinë se populli shqiptar kurdoherë e ka dënuar pabesinë, e cila nuk ka qenë dhe as është në karakterin e tij. Ne dënuam pabesinë dhe tradhtinë ndaj marksizëm-leninizmit të titistëve, të revisionistëve sovjetikë, edhe të udhëheqësve revisionistë kinezë. Prishja jonë me këto grupe reaksionare-revisioniste erdhi për arsyet e thella ideologjike, politike dhe

jo për çështje të vogla. Ato s'kishin vetëm karakter kombëtar, sepse nuk cenonin vetëm interesat ekonomikë të Shqipërisë, jo, por kishin dhe kanë më shumë karakter ndërkombe, për arsyen se prçknin ato parime të mëdha, për të cilat luftojnë popujt, për të cilat lufton proletariati botëror dhe njerëzimi përparimtar.

Politika e Partisë dhe e Frontit tonë ka qenë dhe është e njohur nga i madh e i vogël brenda vendit, por ajo është e njohur edhe jashtë dhe nuk është nevoja që në këtë fjalim të hyj në detaje. Por desha vetëm të theksoj për disa rrethe jashtë, se politika e Partisë sonë dhe e Frontit Demokratik të Shqipërisë nuk do të lëkundet kurrë dhe nuk do të ndryshojë asnjë grimë nga paramet e drejta të caktuara dhe të përhershme që bazo- hen në marksizëm-leninizmin. Politika jonë do të jetë kurdoherë një politikë klasore, parimore, që u përgjigjet interesave të lartë të vendit tonë, të socializmit dhe të luftës çlirimtare të popujve. Populli ynë do të luftojë kurdoherë pa u lëkundur kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik e gjithë reaksionarëve; askush të mos ketë as iluzionin më të vogël se Shqipëria socialiste do të ndryshojë qëndrim ndaj tyre. Po ashtu Partia e Punës e Shqipërisë dhe shteti shqiptar do të luftojnë dhe do të demaskojnë socialimperializmin kinez, i cili është vënë përkrah imperializmit amerikan dhe reakcionit botëror, në luftë kundër popujve dhe veçanërisht kundër socializmit në Shqipëri.

Nga ana tjetër, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë ka ndjekur e ndjek një politikë dashamirëse me ato shtete që janë dashamirëse ndaj shtetit tonë, që nuk kërkojnë t'i bëjnë këtij keq, siç veprojmë edhe

ne që nuk përpinqemi dhe as që kemi kurrë ndër mend t'u bëjmë keq popujve të tyre, por duam të jemi kurdoherë në harmoni e në bashkëpunim për qëllimet e larta dhe me dëshirat e zjarrta të të gjithë popujve të botës që aspirojnë për çlirim, për liri, demokraci, pavarësi, sovranitet dhe socializëm.

Shokë,

Fushata për zgjedhjet e deputetëve të Kuvendit Popullor është një aksion i madh politik për organizatën tonë të Frontit Demokratik. Së bashku me të gjitha organizatat e tjera të masave, të vëmë të gjitha forcat që të shkojmë në zgjedhjet e deputetëve të Kuvendit Popullor me sa më shumë rezultate në punë. Me bësim të patundur në vijën e drejtë të Partisë dhe në perspektivat e shkëlqyera që i janë hapur popullit tonë, le të shpërthejnë fuqishëm edhe në këtë fushatë entuziazmi politik dhe mobilizimi i punëtorëve, i fshatarëve, i rinisë, i gruas, i intelektualëve, i tërë punonjësve tanë, për t'i kurorëzuar me sukses të plotë këto zgjedhje.

Rroftë populli ynë heroik!

Rroftë Partia!

Rroftë Fronti Demokratik!

*Botuar për herë të parë në  
gazeten «Zeri i popullit»,  
nr. 228 (9401), 21 shtator 1978*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për Pushtetin  
Populler» (Përbledhje vep-  
rash), f. 578*

# TRE POLITIKANË DHE PROBLEMET E LINDJES SË MESME

Shënimë

22 shtator 1978

Më 18 shtator agjencia e lajmeve Asosiejted Pres dha nga Uashingtoni tekstin e marrëveshjeve<sup>1</sup> që u arritën në Kemp Dejvid në takimin midis Xhimi Karterit, Anvar el Sadatit dhe Menaem Beginit për problemin e Lindjes së Mesme, problem që është me rëndësi të madhe jetike për popujt arabë e që njëkohësisht i intereson shumë edhe imperializmit amerikan.

Imperializmi amerikan në Lindjen e Mesme i ka futur thonjtë thellë dhe bën një politikë përqarëse mes popujve arabë, të cilët nuk e kanë gjetur dhe nuk po e gjejnë me njëri-tjetrin fjalën e përbashkët edhe në këto momente kaq të vështira për të gjithë komunitetin arab... Reaksiuni botëror bën çdo përpjekje që këtë rajon ta mbajë të përqarë dhe shtetet e ndrysh-

---

1. a. — Marrëveshja për «një plan paqeje në Lindjen e Afërt».

b. — Marrëveshja për «një plan mbi përsundimin e një traktati paqeje midis Egjiptit dhe Izraelit».

me arabe të rrojnë vazhdimisht në kontradikta me njëri-tjetrin. Domethënë reaksiuni botëror synon t'i mbajë këta popuj nën zgjedhë, në interes të dinastive që mbretërojnë në këto vende, në varfëri, në robëri, bile mesjetare, dhe t'i detyrojë të shesin pashurinë e tyre të madhe, naftën, për të nxjerrë prej saj përfitimi përrallore.

Në këto situata Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që janë xhandari dhe padroni kryesor, si me thënë, i këtij pellgu, ndjekin vazhdimisht politikën «përçë e sundo». Ato vënë njërin shtet kundër tjetrit, grupojnë disa shtete kundër shteteve të tjera, nxitin e zhvillojnë luftëra lokale mes Izraelit dhe Egjiptit, mes Izraelit dhe Sirisë, mes Sirisë e marionetave libaneze, mes irakianëve e sirianëve, mes Arabisë Saudite e Jemenit të Veriut ndaj Jemenit të Jugut, krijojnë mosmarrëveshje në Gjirin Persik e të tjera komplate të tilla djallëzore.

Veçanërisht Izraelin imperializmi amerikan e ka përdorur si xhandar të vërtetë në shërbim të tij. Ky xhandar ka arritur të shkaktojë deri luftëra të përgjakshme me Egjiptin, Sirinë, Libanin, Jordaninë etj. Imperializmi amerikan e mbështet fuqimisht Izraelin me armë nga më modernet, bile, siç thuhet, i ka dhënë edhe bombën atomike. Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë ndihmuar Izraelin, gjithashtu, edhe nga ana logjistike, për arsyen të peshës së madhe dominuese që kanë qarqet reaksionare financiare sioniste në ekonominë kapitalisto-imperialiste botërore. Pra, imperializmi amerikan e ka bërë Izraelin veglën e tij më të përshtatshme. Në momentet kur Shtetet e Ba-

shkuara të Amerikës acarohen me vendet arabe për naftën, për çështjen e furnizimit e të çmimit të saj, në-përmjet veglës së tyre, Izraelit, krijojnë, sikurse kanë krijuar, incidente të përgjakshme që kanë vajtur deri në luftë. Këto luftëra i kanë dhënë mundësi Izraelit të pushtojë territorë egjiptiane, siriane e jordanze, si: Sinain, Cisjordaninë, Golanin, rripin e Gazës dhe as lëviz më që andej pa e detyruar.

Me gjithë rezolutat e panumërtë që janë marrë në Organizatën e Kombave të Bashkuara kundër vprimeve të Izraelit, megjithëse shtetet e botës e kanë ngritur me të madhe zërin kundër tij, Izraeli ka vazhduar veprimtarinë e vet agresive. Ai jo vetëm ka pushuar territorë arabe, por në to, duke pranuar çifutë emigrantë nga Polonia, nga Rumania, sidomos nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vende të tjera të Evropës, ka krijuar koloni çifute.

Më tepër nga të gjithë popujt arabë po vuan populli heroik palestinez, i cili ka dekada të tëra që mban mbi shpinë mjerimin më të madh që ka parë njerëzimi. Ai rron si muhaxhir, duke u strehuar nëpër kasolle dhe në tenda të shkretëtirës, sepse ka humbur atdheun e tij, që ia kanë pushtuar izraelitet dhe s'ia lëshojnë. Prandaj populli palestinez është ngritur në luftë të pamëshirshme, deri tash pa kompromis. Pavarësisht se brenda në lëvizjen çlirimtare palestinezë ka grupe me pikëpamje të ndryshme, në përgjithësi të gjithë dëshironë çlirimin e vendit të tyre nga sionistët izraelitë.

Ku nuk e gjen popullin palestinez që rron i shpërndarë në të tëra vendet arabe: në Liban, ku ai është i vendosur në fshatra që janë qendra luftarake; në

Egjipt, ku ka jetuar si muhaxhir dhe si luftëtar; në Siri, ku herë lejohet të luftojë, herë nuk lejohet; ka jetuar e jeton edhe në Jordani, ku është shtypur barbarisht; në Irak, në Arabinë Saudite, në Jemen, në Emiratet e Gjirit Persik, bile edhe në Francë etj. Ai është një popull trim, luftëtar, që s'e ka pushuar rezistencën e vet asnje ditë...

Tash, në këto situata të vështira dhe pak a shumë paqësore që Shtetet e Bashkuara të Amerikës krijuan në mes Egjiplit dhe Izraelit, pas shumë diskutimesh, manovrash, prapaskenash e dredhish të panumërtë, të tre këta u mblodhën në Kemp Dejvid, gjoja për të rregulluar gjendjen e Lindjes së Mesme. Ata diskutuan kokë më kokë trembëdhjetë ditë. Bile Xhimi Karteri u bë pjesëtar aktiv i këtyre bisedimeve, domethënë bisedimet nuk zhvilloheshin më midis Sadatit dhe Beginit, por midis Karterit, Sadatit dhe Beginit. Karteri u quajt kështu si një partner i tretë i këtyre bisedimeve për të vendosur gjoja paqen në Lindjen e Mesme. Natyrisht nga e gjithë kjo «punë» «mali polli një mi». Ky mi përfaqëson atë qka «fitoi» osc nuk fitoi populli palestinez dhe në përgjithësi popujt arabë. Në Kemp Dejvid, sipas komunikatës, imperializmi amerikan arriti «të përfundonte» njëfarë pajtimi në mes Izraelit të Beginit dhe Egjiplit të Sadatit për një paqe të përkohshme, për një rregullim të përkohshëm të zonës së Cisjordanisë, të rripit të Gazës dhe të shkretëtirës së Negevit.

Në të vërtetë asgjë konkrete nuk u arrit. Mund të themi se u përcaktua vetëm që brenda 5 vjetësh duhet të veprohet në atë mënyrë që pjesërisht Izraeli të tër-

hiqct nga bregu perëndimor i lumbit Jordan (Cisjordania) dhe nga Gaza, me qëllim gjoja që aty të vendoset shteti autonom i palestinezëve të këtyre zonave. Administrata palestinezë autonome, natyrisht, «do të garantohet» nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kurdoherë e indirekt do të jetë nën sundimin ose nën vëzhgimin e Izraelit, të Egjiptit dhe të Jordanisë.

Egjiptit iu dhanë edhe disa satisfaksione të vogla. Kështu, për shembull, u ra në marrëveshje për njëfarë tërheqjeje të Izraelit nga një pjesë e gadishullit të Sinait. E gjithë kjo është një manovër djallëzore e imperializmit amerikan dhe e agjentëve të tij. Për imperializmin amerikan kjo është, si me thënë, një fitore e përkohshme, sepse, siç thashë më lart, është caktuar që brenda 5 vjetëve gjoja do të punohet për të arritur në një shtet të «vctëqeverisur» në bregun perëndimor të lumbit Jordan dhe në rripin e Gazës. Ky i ashtuquajtur shtet i vctëqeverisur gjatë kësaj kohe do të ketë njëfarë force poliore të vetën, por aty kurdoherë do të jenë të pranishme forcat ushtarake e poliore izraelite për të ruajtur kufijtë, si dhe forcat jordance. Kështu palestinezët, natyrisht, do të kenë vëtëm hapëset e kashtës. Dhe në rast se arrihet një statuko e tillë, siç u vendos në Kemp Dejvid, atëherë mund të nënshkruhet një marrëveshje paqeje midis Egjiptit dhe Izraelit. Gjithë synimi është që gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare imperializmi amerikan të ketë njëfarë qelësie për ta shtrydhur mirë «lopën» arabe, që nafta të rrjcdhë me lehtësi në cisternat dhe në naftësjellësit amerikanë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të zhvillojnë një fushatë intrigash në të gjitha shtet-

tet arabe për të pranuar vendimet e Kemp Dejvidit dhe për të arritur në një konkluzion të përbashkët rreth një paqeje gjoja të përgjithshme. Mirëpo populli palestinez me të drejtë asgjë nuk pranon në gjithë këtë dallavare të Sadatit, të Beginit dhe të Xhimi Karterit, sepse, në fakt, nuk fiton asgjë. Atdheu i tij është i pushtuar, prandaj me të drejtë ai do të luftojë deri në fund për çlirimin e tokave të atdheut të vet dhe përvendosjen e një qeverie të vërtetë të popullit palestinez, pa ndërhyrje dhe pa tutelë të armiqve të tij të përhershëm.

Por është për t'u çuditur se me paturnësinë më të madhe në komunikatë thuhet se marrëveshja e arritur bëhet edhe me pjesëmarrjen e Jordanisë, kurse kjo nuk ishte fare në Kemp Dejvid. Qeveria jordanese c mbreti Hysein, megjithëse dihet ç'janë, deklaruan se s'kanë asnjë angazhim për sa është vendosur në Kemp Dejvid.

Marrëveshjen e Kemp Dejvidit nuk e pranoi Siria. E cila e quan Sadatin tradhtar të kombit arab, nuk e pranuan as Algjeria, Maroku, Libia, të gjitha vendet e tjera arabe. Bile kundër foli edhe mbreti i Arabisë Saudite. Pra, e gjithë kjo dallavere u bë vetëm në mes tre personave.

Natyrisht, për të bindur ata që kundërshtuan, Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë këtyre 5 vjetëve do të bëjnë dallavere të tjera të panumërtë, bile këto filluan. Në fakt, pas botimit të komunikatës sekretari i Departamentit të Shtetit, Sajrus Vens, u nis për në Lindjen e Mesme që të bisedojë me mbretin Saud, me mbretin Hysein, me Asadin e të tjerë, me qëllim që si e si t'i bindë, t'u bëjë presione osc t'u japë «këste» që

të pranojnë zgjidhjen e përkohshme që i dha kësaj çështjeje Xhimi Karteri. Kështu do të vejë kjo punë.

Në këtë mes Kina batoi në shtypin e saj një njoftim përmarrëveshjen e Kemp Dejvidit. Tani përmali nuk mban qëndrim të hapët, por kuptohet se ajo qëndron në anën e imperializmit amerikan dhe të Sadatit. Më vonë do ta shfaqë më hapur këtë mbështetje, sepse ajo lufton përmarrëveshjen aktuale në Lindjen e Mesme, domethënë që atje të sundojë imperializmi amerikan e jo vetëm atje, po kudo në botë, bile edhe afër saj në Japoni, në Kore, në Tajvan e gjelkë dhe Kina të përfitojë nga lëmoshat e nga kreditë e tij përmarrët bërë superfuqi. Dhe tërë kjo politikë bëhet përmarrë arsyesh se gjoja luftohet socialimperializmi sovjetik.

Natyrisht, edhe socialimperializmi sovjetik përsiston nga këto situata dhë ndodhet automatikisht në krah të regjimeve të tjera, gjoja të fortë, që mbajnë qëndrim kundër marrëveshjes Sadat-Begin...

*Botuar përmarrëveshjen e parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Shënime përmarrëveshjen e  
Lindjen e Mesme», f. 180*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Shënime përmarrëveshjen e  
Lindjen e Mesme», f. 180*

# **HARTIMIN E PLANIT DIIE REALIZIMIN E TIJ TA SHONIM TË LIDIUR NGUSHTË ME SITUATAT**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**25 shtator 1978**

Në rendin e ditës kemi si pikë të parë skicidenë që na është paraqitur nga Qeveria dhe Komisioni i Planit të Shtetit për planin e shtatë pesëvjeçar. Siç theksohet në të, kjo është vetëm një skicide, nuk është as para-projekt, as plan. Prandaj çështja është që në këtë mbledhje të na jepet një ide e përgjithshme për vijat që duhen ndjekur, pastaj të shfaqim mendime për të, të cilat të shërbejnë si bazë për hartimin e projekt-planit. Me këtë dua të them që sot nuk kemi për të vendosur konkretisht, në kuptimin që duhet të bëhet kjo apo ajo vepër. Të aprovuara janë objektet që janë vendosur në Kongresin e 7-të për planin e sivjetshëm dhe për dy vjetët e ardhshëm. Për të tjerat që mendoj-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua relacioni «Mbi skicidenë paraprake të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës për pesë-vjeçarin e shtatë 1981-1985».

më të bëjmë në të ardhmen, duhet të punohet akoma. Prandaj, kush ka ndonjë vërejtje mund ta bëjë, pa kërkuar të vendosim kaq shpejt. Është kështu apo jo? Natyrisht, për orientimet do të flasim, nëse janë të drejta apo nuk janë të drejta, pra, për to të diskutojmë dhe të japim mendime, pa vendosur çfarë do të bëjmë, pse materiali akoma duhet përpunuuar.

Mund të lindë pyetja se përse i sjellim ne në Byronë Politike, dy vjet më përpara, këto çështje? Këtë e bëjmë me qëllim që brenda një viti, ose brenda totë muajve pas kësaj mbledhjeje të mundim të përgatitim një projektplan më të saktë. Ne mund të themi sot që, sipas nevojave që na dalin, këto objekte duhen ndërtuar, se e duan interesat e zhvillimit ekonomik të vendit, prandaj të shtrëngohemi ca në këtë sektor, ca atje etj. Kjo nuk ekskludon dhënien e mendimeve e të themi që këto apo ato vepra janë të nevojshme të ndërtohen, se të tëra na duhen. Pra, këto mund t'i themi, por për të vendosur sot është e zorshme të prononcohem. Shokët le të thonë mendimin e tyre, por mendimi im kështu është. Atëherë kush ka për të diskutuar?

*Pasi diskutuan shokët e pranishëm në këtë mbledhje, e mori fjalën përsëri shoku Enver Hoxha:*

Të gjithë shokët që folën i ngritën drejt problemet. Megjithatë dëshiroj të shpreh edhe unë disa mendime.

Qysh nö fillim dua të theksoj se situata aktuale e vendit tonë, me tradhtinë e revisionistëve kinezë, që iu shtua tradhtisë të të gjithë revisionistëve të tjerë, bëhet e vështirë. Natyrisht kjo nuk është një situatë

e dëshpëruar, por është e domosdoshme të kuptojmë se ajo është e vështirë. Me këtë nuk dua të them të mos jemi optimistë, por ama jo optimistë pa baza.

Tani kërkohet që të merren në studim shumë probleme, por veçanërisht problemet ekonomike, që na janë vështirësuar mjaft. Kjo lyp që ne të forcojmë kudo, në radhë të parë, punën politike dhe ideologjike me punonjësit tanë; të forcojmë organizimin e kontrollin e zbatimit të detyrave që t'i realizojmë ato plotësisht, pse fjalët e premtimet pa baza nuk të nxjerrin në ato caqe që kemi caktuar në bazë të mundësive që kemi.

Gjithashtu, të gjithë të jemi të bindur se detyrat që ka caktuar Partia janë plotësisht të realizueshme. Këtë e them për arsyen se përparime kemi kudo. Por, në të njëjtën kohë, duhet thënë se në shumë degë e sektorë kemi edhe mosrealizime. Pavarësisht nga vështirësitë e reja që na kanë krijuar revizionistët kinezë, me punën e kryer nga njerëzit tanë ne nuk kemi kapërcyer shumë nga ato vështirësi që kanë qenë të mundshme dhe duhej medoemos të kapërceheshin. Në qoftë se nuk njobhim këtë realitet, do të bëjmë gabime. Prandaj, përpara se të aprovojmë skicidenë dhe të përgatitim planin e shtatë pesëvjeçar të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit për vitet 1981-1985, duhet t'i vëmë detyrë vetes që planin e gjashtë pesëvjeçar, që kemi aprovuar në Kongresin e 7-të të Partisë, ta realizojmë medoemos. Kjo do të jetë një provë e madhe e forcës së Partisë sonë, e vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste, e aftësive të saj organizative dhe drejtuese për të realizuar me siguri edhe planin e ardhshëm pesëvje-

çar. Unë mendoj që për të ardhmen duhet të përpique mi të hartojmë një plan real e të ngjeshur, në mënyrë që ekonomia jonë, si deri tash, edhe në të ardhmen, të cёë përpara pa u ndalur.

Gjithashtu është e nevojshme të mbahet mirë parasysh se vështirësitë tona, për të cilat fola më lart, sapo kanë filluar. Mendimi im është se vështirësitë do të vijnë vazhdimisht duke u shtuar, sidomos nga ana politike. Por, si konsekencë, do të na shtohen edhe ato në fushën e zhvillimit të ekonomisë, për arsy se ne nuk kemi një ekonomi autarkike, gjë që do të ishte e gabuar të mendohej dhe e pamundur të realizohet në praktikë. Në këto kushte, kuptohet që një pjesë të madhe të investimeve për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë sonë ne jemi e do të jemi të detyruar ta realizojmë nëpërmjet marrëdhënieve tregtare me shtetet kapitalisto-revizioniste. Ta kemi mirë të qartë se këto shtete nuk do të na i lehtësojnë neve punët për realizimin e synimeve tona. Për kundrazi, ato do të përpiken të na e vështirësojnë gjendjen në çdo drejtim, sepse kanë dhe do të kenë kontradikta me vendin tonë. Disa prej tyre do të mundohen t'i frenojnë fort marrëdhëni e tyre me ne e, disa të tjera, pak më fort. Por do të ketë edhe nga ato që do të ushqejnë shpresë e ëndrra dhe, si rrjedhim, do të përpiken të bëjnë një politikë më clastike me ne.

Të gjitha këto koniunktura ne i kemi dhe duhet t'i kemi vazhdimisht parasysh. Por ato nuk janë të tilla që të na pengojnë për të hartuar një plan të ri pesëvjeçar të shëndoshë dhe më të përparuar në krasim me planet e tjera pesëvjeçare. Vççse hartimin e

planeve dhe realizimin e tyre këtej e tutje ne duhet ta shohim në lidhje të ngushtë me tregtinë tonë të jashtme, që, natyrisht, varet shumë nga politika dhe nga koniunkturat ndërkontrollat. Por, në radhë të parë, ajo varet nga ne, këtu brenda, domethënë nga realizimi në sasi, në cilësi dhe në kohën e duhur i detyrave që caktojmë. Në qoftë se ne do të bëjmë me vendet e tjera trataliva për të blerë ato objekte që mendojmë të ndërtojmë ose për eksportin e mallrave tona, me qëllim që të sigurojmë devizë me kliring ose devizë të lirë, atëherë kërkohet medoemos që planet tona jo vetëm t'i realizojmë, por t'i realizojmë edhe para kohe.

Unë jam dakord që ne më parë duhet të sigurojmë valutën për të gjitha ato mallra që do të blejmë jashtë; bile të parashikojmë që të kemi një rezervë të dyfishtë, sepse kështu do të mund të jemi të sigurt për importimin e atyre mallrave që kemi nevojë, pra, që ne të kemi valutë me se t'i mbulojmë. Mund të ndodhë që partnerët e huaj, në marrëdhëni tregtare që do të zhvillojnë me ne, të mbyllin sytë dhe ne të jemi me një saldo pasive ndaj tyre. Kjo, efektivisht, do të thotë që ne të marrim kredi prej tyre, gjë që në asnjë mënyrë nuk duhet ta lejojmë. Këtë çështje të mos e harrujmë kurrë dhe kjo varet vetëm nga ne.

Situatat e vështira që po kalojmë duhet të kuptohen qartë nga të gjithë, nga i madh dhe i vogël, te ne. Ato do t'i kapërcejmë medoemos, sepse në radhë të parë ekziston vija e drejtë e Partisë. Ne kemi një Parti të shëndoshë, marksiste-leniniste, kemi një popull patriot, të lidhur fort rrëth saj, që ka një eks-

periencë të pasur në ndërtimin dhe në mbrojtjen e socializmit. Gjithashtu, tani kemi krijuar një ekonomi të shëndoshë dhe kemi përgatitur një armatë të madhe kuadrosh për çdo sektor. Të gjithë këta faktorë na krijojnë mundësi të mëdha për realizimin e detyrave dhe këto mundësi shtohen vazhdimisht, dita-ditës. Vettëm se për këtë duhen ndryshuar metoda e stili i punës dhe i drejtimit, duhet të forcohen ndihma, kontrolli dhe dhënia llogari.

Siq e thashë dhe në fillim, kjo skicide është një punë fillestare që do të shërbejë për studimin dhe për hartimin e planit të ri të shtatë pesëvjeçar. Derisa ky të marrë formën përfundimtare si paraprojekt, pastaj edhe si plan pesëvjeçar, duhet të na vijë disa herë për ta shqyrtuar e për ta diskutuar në Byronë Politike.

Mendoj se të gjitha çështjet që parashtronen në skicide janë të realizueshme, bile për disa prej tyre unë jam plotësish dakord që ato të marrin rrugë qysh tani. Fjalën e kam për ndërtimin e disa objekteve që, në fakt, janë të vogla, por ekonomisë i sjellin të ardhura të mëdha. Prandaj të mos zvarritet realizimi i tyre, siç është rasti, për shembull. i shtimit të siperfaqeve të serrave. Pse duhet të presim planin tjetër për të filluar nga kjo punë? Neve na duhet qysh tani të sigurojmë sa më shumë devizë, prandaj mund të fillojmë menjëherë nga ndërtimi i tyre. Kështu të vepojmë edhe për disa vepra të tjera: t'i ndërtojmë sa më parë që të jetë e mundur.

Për sa u pörket objekteve kryesore që parashikohen në skicide mendoj që sot të mos i marrim në diskutim një për një. Në përgjithësi, mund të them se ato

janë të tëra të nevojshme të ndërtohen, veçse më parë për to duhet të bëhen mirë llogaritë. Mund të jenë pikërisht ato që duhet të ndërtojmë, por mund të jetë nevoja edhe për më shumë. Në duhet të shohim, gjithashtu, se cilat prej tyre do të bëhen më parë dhe cilat nië vonë. Prandaj them se idetë që u shfaqën këtu nga shokët që diskutuan kanë të gjitha vlerë.

Në objektet që kemi vendosur të përfundohen në pesëvjeçarin e gjashtë, si për shembull, në Hidrocentralin e Fierzës, ku na nevojitet turbina e katërt, që na e janë në mes të rrugës revizionistët kinezë, ose në ndonjë objekt tjeter, puna të mos ndërpritet. Prandaj të bëjmë të gjitha përpjekjet për t'i sigruuar makineritë dhe pajisjet e nevojshme. Për këtë të bëhen përpjekje për t'i blerë në vende të tjera. Po kështu të mendohet që tani për të sigruuar turbinat e pajisjet e tjera që do të na duhen për Hidrocentralin e Komani, që do të ndërtojmë në pesëvjeçarin e ardhshëm, si dhe për gjithë objektet e tjera të rëndësishme. Kërkesat të parashtrohen njëkohësisht në disa vende dhe të zgjedhim ofertat më të mira e më të leverdissë për ne, duke e parë çështjen nga të gjitha anët, nga ana politike dhe ekonomike. Bile kuadrot tanë, inxhinierë e teknikë, të fillojnë punën për projektimin e këtyre objekteve; pastaj se sa dhe cilin objekt do të vendosim të ndërtojmë, kjo është një çështje tjetër. Pra, puna në këtë drejtim jo vetëm nuk duhet të ndalohet, por të punohet më shumë intensitet në të gjitha drejtimet.

Mendimi im është se skicideja paraprake për zhvilimin e ekonomisë dhe të kulturës gjatë pesëvjeçarit të shtatë na jep një përfytyrim të saktë për mundësittë

që ekzistojnë dhe për drejtimet kryesore të zhvillimit të ekonomisë sonë. Ajo është e mbështetur tërësisht në forcat tona, në burimet e brendshme njerëzore, materiale e financiare dhe flet qartë për mundësitet që ka në vjetvete ekonomia jonë populllore për të ecur përparrë në rrugën e ndërtimit të socializmit, pavarësisht nga pengesat e vështirësitet e reja që na janë krijuar nga tradhtia e revisionistëve kinezë.

Hartimi i një plani sa më shkencor e real të zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit, në kushtet e rrethanat e krijuara, merr një rëndësi të posaçme. Prandaj të bëjmë përpjekje që në të të gjejnë aplikim të plotë parimet themelore të marksizëm-leninizmit, ligjet ekonomike objektive të socializmit, orientimet e direktivat kryesore të Partisë për ndërtimin e socializmit dhe për zhvillimin me plan të ekonomisë sonë.

Gjatë punës për ndërtimin e socializmit ne kemi hasur dhe përsëri do të hasim në vështirësi të reja, por duhet të luftojmë me të gjitha forcat për t'i kapërcyer ato, pa u tërhequr përparrë asnjë sakrifice, sepse, siç thoshte Stalini,

*«... vështirësitet ekzistojnë për bolshevikët jo për të qarë e lebctitur, por për t'i kapërcyer»<sup>1</sup>.*

Duke njobur mirë mundësitet tona ekonomike, forcën e madhe krijuese dhe hovin revolucionar në punë të klasës sonë punëtore, të fshatarësishë kooperativiste dhe të inteligjencies populllore, si dhe duke mbajtur

---

1. J. V. Stalin, Veprat, vëll. 10, f. 257.

mirë parasysh vështirësitë e pengesat suplementare që na janë krijuar nga revizionistët kinczë, mendoj se në vija të përgjithshme mund ta aprovojmë këtë skicide si një variant të mundshëm. Ajo, sipas mendimit tim, mund të ishte edhe më e përbledhur, treguesit dhe veprat e reja mund të mos jepeshin kaq hollësisht.

Po të na jepeshin disa variante, për të cilat Byroja Politike të shfaqte mendimet dhe aprovimin e vet, do të ishte cdhe më mirë. Por, megjithatë, cdhe për këtë skicide është bërë një punë e frytshme, e cila duhet thelluar më tej. Është mirë që studimet e mëvonshme për këtë qëllim të paraqiten për t'u shqyrtuar në Byronë Politike pjesë-pjesë dhe me variante, sepse do të jenë bazë për projektplanin e pesëvjeçarit të ri, që do të shqyrtojmë në të ardhmen. Shqetësime ka dhe nuk duhet të kalohen lichtë, por është e nevojshme të thuhen shkoqur se ku janë ato.

Riprodhimi i zgjeruar socialist, këtej e tutje, do të bëhet plotësish me forcat tona. Çështja është të studiohen më thellë mundësitë dhe rrugët që ekzistojnë për të pasur ritme më të kënaqshme e më të larta zhvilimi të prodhimit nga ato që pàrashikohen në skicide. Natyrisht, në kushtet e vështirësive e të pengesave të mëdha që i krijohen ekonomisë së vendit tonë nga armiqjtë imperialistë e revizionistë, nuk është e lichtë që ritmet e zhvillimit të qëndrojnë siç i kemi pasur. Por neve na bie detyra historike që këto ritme t'i zhvillojmë edhe më tej. Në asnjë mënyrë nuk duhet të qëndrojmë në vend, pse e tillë është rruga jonë revolucionare.

Ku duhet t'i kërkojmë e t'i gjemë ne mundësitë

dhe rrugët për të siguruar ritme më të larta zhvillimi nga ato që parashikohen në skicide?

Para së gjithash, ne duhet të shfrytëzojmë në mënyrë sa më racionale e më të plotë bazën materialo-teknike ekzistuese, aftësitë prodhuese të ndërmarrjeve industriale e minerare që kemi dhe të intensifikojmë më tej prodhimin bujqësor e blegtoral. Kur Partia thekson që vendi ynë i ka mundësitë materiale për të ecur përpara, ka parasysh pikërisht mbështetjen më fuqimisht te kjo bazë materialo-teknike që kemi krijuar.

Këtu duhen marrë në shqyrtim një nga një të tëra llojet e makinerive në çdo sektor, repart e ndërmarrje ekonomike. Është e domosdoshme të llogaritet me ekzaktësi se sa përqind shfrytëzohen sot kapacitetet e tyre, me sa turne punohet në to, ku na intereson ta shlojmö prodhimin, ku do të kalohet në punën me dy dhe tri ndërresa etj.

Pas kësaj, të shikohen nga çdo kolektiv mundësitë e brendshme për rikonstruksione, për adaptim, për zëvendësimin e teknologjisë ekzistuese me një teknologji më të përparuar, për shfrytëzimin sa më racional të sipërsaqeve prodhuese ekzistuese pa bërë ndërtime të reja. Drejtimet kryesore të rritjes së prodhimit, pra, duhet të jenë kudo këto që përmenda. Natyrisht, ne do të bëjmë edhe ndërtime të reja, por baza, siç thashë, duhet të jetë ajo ekzistuesja.

Në projektplanin që do të hartohet të bëhet llogari se sa do të jetë shtesa e prodhimit nga ndërmarrjet e makineritë ekzistuese dhe sa nga ndërmarrjet e repartet e reja. Kjo duhet mbajtur mirë parasysh edhe kur

të llogaritim shtesën e prodhimit në industrinë e naftës e në minierat ekzistuese në krahasim me të rejat etj. E theksojmë këtë sepse jo kurdoherë është pasur mirë parasysh kjo çështje në skicidenë.

Kështu, rritja e prodhimit të kromit, bakrit, qymyreve apo hekur-nikelit që parashikohet në skicide mbështetet kryesisht në hapjen e në vënien në shfrytëzim të minierave të reja, ndërsa dihet se Kongresi i 7-të i Partisë ka dhënë direktivën që zhvillimi i industrisë nxjerrëse të mbështetet, në radhë të parë, në zgjerimin e vendburimeve dhe të minierave të njobura. Hapja dhe venia në shfrytëzim e 21 minierave të reja, kundrejt 7 minierave që zgjerohen, rrit në një shkallë të lartë investimet, si dhe koston për 1 ton prodhim. Kjo krijon probleme edhe për ndërtimin e qytezave të reja për minatorët, për organizimin e shtrirjen e shërbimeve tregtare e socialkulturore etj.

Rezerva të brendshme për të shtuar prodhimin ka në çdo ndërmarrje e kolektiv punonjës. Tani më shumë se çdo herë tjetër detyra është që këto rezerva t'i zbulojmë e t'i vëmë në dobi të shoqërisë. Kjo jo vetëm do të na lehtësojë nga kërkesat për investime më të mëdha, por edhe për të zënë më mirë njerëzit në punë dhe për të sigruar rendiment më të lartë.

Do të ishte mirë që kjo çështje të bëhet e qartë edhe për bujqësinë, se sa ndërmarrje e sektorë të rinj do të ngrihen, me ç'destinacione e me çfarë aftësish prodhuase do të jenë etj., ashtu siç veprohet edhe për sektorët e tjera, sepse nuk është e mjaftueshme të thuhet vetëm se do të hapen kaq ose aq toka të reja, se do të shtohen kaq ose aq krerët e bagëtive në tërësi etj.

Dihet se në epiqendrën e planeve tona është e duhet të jetë njeriu i shoqërisë sonë socialiste. Zënia me punë e të gjitha forcave të reja lidhet drejtpërdrejt me ritmet e zhvillimit të ekonomisë, ashtu sikurse shtimi i këtyre forcave, si dhe rritja e rendimentit të punës ndikojnë drejtpërsëdrejti në ritmet e zhvillimit të saj e në mënyrë të veçantë në të ardhurat kombëtare.

Të sistemosh të gjithë njerëzit e aftë në punë të dobishme shoqërore e me efektivitet, të arrish të mbash nivelin e jetesës që është arritur dhe, në disa drejtime mundësish ta ngresh atë, ashtu siç parashikohet në skicide, do të thotë të arrish një sukses të madh. Prandaj kjo çështje të na preokupojë më seriozisht.

Por më duket se me shkallën e njohjes e të studimeve që janë pasur parasysh për këtë çështje kur është hartuar skicideja, nuk u jepet përgjigje e rrugëzgjidhje ashtu si duhet disa problemeve që ka nxjerrë e që do të nxjerrë jeta në të ardhmen. Për këtë kërkohet të bëhet një lidhje dhe bashkërendim më i mirë midis akumulimit, investimeve dhe forcave të reja të punës. Një pjesë e madhe e forcave të pazëna aktualisht me punë dhe e forcave të reja janë gra e vajza, prandaj duhet menduar më mirë për frontet e punës ku do të tërhiqen ato. Në disa zona ka kërkesa më të mëdha për fuqi punëtore, ndërsa në disa të tjera më pak. Të bëjmë kujdes më të madh në shpërndarjen e punonjësve në sektorin shtetëror e kooperativist, veçanërisht sipas sferave të prodhimit, duke i dhënë prioritet absolut sferës prodhuese e, brenda saj, shtimit të njerëzve që punojnë drejtpërdrejt në prodhim, pavarësisht nga fakti se vendi ynë ka raporte shumë më të drejta nga çdo vend

tjetër në shpërndarjen e punonjësve në sferën prodhuese e joprodhuesc.

**Problemi i rritjes së rendimentit të punës tanë del në evidencë më shumë se kurdoherë. Të dhënat që jepen në skicide për rritjen e tij mund të rishikohen edhe një herë. Themelore këtu është që parashikimet që bëjmë në këtë fushë të vihen në jctë, të zbatohen, sepse, edhe për pesëvjeçarin në vazhdim, nuk i kemi bërë keq, por çështja është se shtesa e prodhimit industrial po vjen vetëm ose kryesisht nga shtimi i fuqisë punëtore, ndërsa rritja e rendimentit të punës ka pasur dhe ka një ndikim fare të vogël. Kështu po na ndodh edhe në disa degë të tjera të ekonomisë. Këtu kërkohet të bëhet një bilanc më i plotë, të studiohen e të gjenden rrugët më efektive për rritjen kudo të rendimentit të punës.**

**Revolucioni tekniko-shkencor të synojë e të vihet më drejtëpërdrejt në funksion të rritjes së rendimentit jo vetëm në industri e në ndërtim, por edhe në bujqësi, ku angazhohen forca të mëdha njerëzore, si dhe në të gjitha degët e tjera të ekonomisë. Edhe industria nga ana e vet të vihet më mirë në shërbim të bujqësisë. Thellimi i revolucionit tekniko-shkencor dhe shfrytëzimi më i mirë i bazës materialo-teknike që kemi, shtrojnë nevojën që problemet e ngritjes arsimore e tekniko-professionale të punonjësve të shikohen më me kujdes.**

**Problem i rëndësishëm për pesëvjeçarin e ardhshëm do të jetë akumulimi. Rritja e normës së akumulimit në kushtet kur zhvillimi i ekonomisë sonë mbështetet vetëm në burimet e brendshme materiale dhe financiare, është një domosdoshmëri objektive. Siç e**

shohim në skicide, kjo normë parashikohet të arrijë në 36 për qind, kundrejt 26 për qind që është nivecli më i lartë i realizuar deri tani me burimet e brendshme (duke zbritur kreditinë). Ky hop i madh që do të duhet të bëjmi, shtron para Partisë, organeve të pushtetit dhe të ekonomisë mjaf problemë.

Para së gjithash këtu duhet të kapet, si i thonë, demi për brirësh, problemi i uljes së kostos së prodhimit. Shtesa e akumulimit nga ulja e kostos në pesëvjeçarin e ardhshëm, afro dyfish në krahasim me planin e këtij pesëvjeçari, shtron detyrën që të caktohen masa të qarta dhe të gjenden rrugë reale për rritjen e rendimentit, për rishikimin dhë uljen e normativave të harxhimit të materialeve e të lëndëve të para, për të përdorur me efektivitet sa më të lartë fondin e pagave dhe për të forcuar kudo regjimin e kursimit. I theksoj këto sepse faktet e dy vjetëve të këtij pesëvjeçari, në këto drejtime, nuk i mbështetin si duhet konkluzionet që parashtrohen në skicide. Cilat janë këto fakte? Të ardhurat kombëtare nuk po ecin me ritmet e planifikuara; shtesa e tyre sigurohet pothuajse tërësisht nga shtesa e fuqisë punëtore; një pjesë të mirë të të ardhurave na e hanë ndërmarrjet që ende vazhdojnë të dalin me humbje; jo kurdoherë arrihen shifrat e parashikuara për uljen e kostos; disa ndërmarrje të sektorit shtetëror të bujqësisë, me humbjet që kanë krijuar, janë shndërruar në thithëse të akumulimit; tregtia e jashtme po kështu nuk ka ende efektivitetin që kërcohët etj., etj.

Për të gjitha këto kërcohët të forcohet planifikimi financiar dhe kontrolli me anë të lekut. Të merren ma-

sa që në drejtimet e mësipërme, në vend që këto të ardhura të na humbasin, të na sigurohen. Shembull për këtë është caktimi i detyrave të forta për rritjen e rendimentit të bimëve bujqësore.

Gjithashtu, është e nevojshme që parashikimet për rritjen e disa burimeve të akumulimit socialist dhe të të ardhurave të buxhetit të shtetit të shikohen më me kujdes, në mënyrë që të vihen në përpjesëtim të drejtë me treguesit e tjerë të zhvillimit të ekonomisë. Për t'i arritur këto është e domosdoshme që kur të hartohet plani të mbahen mirë parasysh ulja e kostos dhe rritja e akumulimit të brendshëm socialist, duke mbajtur raport të drejtë dhe jo të bëhen këto në kurri zë normës së konsumit, pra, duke ruajtur nivelin e arritur të mirëqenies së popullit, bile, në disa drejtime, ashtu siç parashikohet në skicide, të ketë përmirësimë. Po ashtu, kur planifikohet prodhimi i artikujve të rinj, të parashikohet se kur do të kryhet rikonstruksioni i kësaj ose i asaj ndërmarrjeje a reparti, kur do bëhen ndërtimet të reja etj.

**Asgjë nuk duhet të prodhohet pa destinacion dhe asgjë të mos mbeten në depo.** Sot vendi ka nevojë më tepër se kurrë për më shumë prodhime, që të plotësojmë nevojat e popullit, të ekonomisë e të nbrojtjes, të prodrojmë me kosto sa më të ulët, me cilësi sa më të lartë, të sigurojmë një furnizim të rregullt të tregut të brendshëm dhe të kemi treg të jashtëm të garantuar.

**Destinacionet kryesore të fondit të akumulimit të brendshëm socialist kanë qenë dhe mbeten investimet kapitale.** Duke pasur parasysh edhe mosrealizimet e deficitet e krijuara në tre vjetët e këtij pesëvjeçari, del

që për të ardhmen na mbetet mjaft punë për t'u bërë. Një rritje e tillë e investimeve duhet parë me kujdes, si nga pikëpamja e mbulimit finansiar e valutor, ashtu edhe nga mundësitë materiale të kryerjes së tyre.

Mendoj, gjithashtu, se edhe struktura e investimeve, sipas karakterit prodhues e joprodhues dhe sipas degëve, ka vend të shqyrtohet me vëmendje më të madhe. Duke parë mirë mundësitë dhe kushtet tona, investimet joprodhuese në ndonjë drejtim mund të pakësohen. Vëmendje kërkon veçanërisht rritja e efektivitetit të përdorimit të tyre. Kjo do të shihet në kompleks, por mua më tërroqi vëmendjen sidomos asati i gjatë i ndërtimit të disa veprave. Synimi të jetë që investimet e bëra të na japid sa më parë prodhim; çdo gjë me precedencë, të na kthejësondet që harxhohen dhe të mos kemi tahma derisa të na thyhet shtylla kurrizore. Veçtëm kur janë vepra shumë të vështira për t'u ndërtuar, voluminoze dhe të domosdoshme nga pikëpamja e interesit të përgjithshëm ose me karakter strategjik, mund të lejohen asate pak më të gjata. Sidomos në kushtet aktuale, po gozhduam fondet monetare e materiale, ne do të dëmtohemi rëndë dhe do t'u hapim shteg shfaqjeve negative e me pasoja.

Praktika e deritanishme e vënicës në shfrytëzim të veprave me fazë, ka vërtetuar epërsinë që ka kjo mënyrë pune; e kundërta e ka dëmtuar ekonominë.

Kushtet e rrethanat konkrete në fushën e investimeve e të ndërtimeve shtrojnë edhe një varg problemesh të tjera që kërkojnë studime e rrugëzgjidhje sa më rationale. Për veprat që kemi në ndërtim e sipër, për ato që na i lanë në mes të rrugës revolucionarët ki-

nezë, si dhe për shumë nga veprat e reja e rikonstruktionet që do të kryhen, do të duhet të prodhohen në vend mijëra ton makineri, pajisje komplekte e pjesë ndërrimi. Për mundësitë e prodhimit të tyre në vend, Partia ka krijuar një bazë shumë të fuqishme mekanike. Njerëzit tanë, gjithashtu, janë rritur mjaft për nga aftësitë dhe dijenitë tekniko-profesionale, me gjithë detyrat e mëdha që na mbeten përparrë në këtë fushë. Por këtu më duket se pengon mjaft edhe organizimi i pamjaftueshëm i forcave, mungesa e një bashkërendimi e kooperimi të përsosur të punës. Po ashtu kërkohet që planifikimi i këtij kooperimi nga poshtë deri lart të vihet nibi baza më të shëndosha shkencore, sepse, në qoftë se për disa objekte të mëdha ky kooperim ecën diçka më mirë, për objekte e çështje të tjera, të një rangu të mesëm e të vogël, ka mjaft spontaneitet e vështirësi. Komisioni i Planit të Shtetit, dikasteret qendrore dhe rrëthet ta marrin më mirë në dorë këtë punë. Një rol të veçantë duhet të luajnë në këtë fushë sektorët që u krijuan në rrëthe dhe në qendër për të ndjekur më nga afër problemet që nxjerr zhvillimi e thellimi i revolucionit tekniko-shkencor.

Ky kompleks problemesh që ka të bëjë me përsosjen e organizimit e të kooperimit në kushtet aktuale duhet kuptuar në lidhje të ngushtë me zhvillimin në gjerësi e në thellësi të ekonomisë sonë e ta ndjekë atë dialektikisht. Çdo prapambetje dhe formë e vjetruar pune e organizimi në rastin konkret bën që ne të mos shfrytëzojmë në shkallën e duhur ato epërsi të mëdha që ka dhe që krijon rendi ynë ekonomiko-shoqëror socialist.

Në kushtet aktuale, në industrinë mekanike kërkohet të zbatohet më me konsekuencë orientimi i Partisë që ajo të futet më gjërësisht në rrugën e prodhimit në vend të më shumë makinerive, pajisjeve e fabrikave komplete, sepse, me gjithë hapat që kemi bërë përpara, pesha e makinerive dhe e pajisjeve ndaj prodhimit të përgjithshëm industrial në vitin 1980 do të arrijë vetëm 2,5 për qind, ndërsa sipas skicidesë në vitin 1985 para shikohet të arrijë 3,5 për qind. Mendoj se këto shifra janë të ulëta dhe nën mundësitë tona. Prandaj të rishikohen edhe një herë, me synim që të rriten.

Kur flas përfutjen më gjërësisht të industrisë mekanike në rrugën e prodhimit në vend të më shumë makinerive, pajisjeve e fabrikave komplete, në të njëjtën kohë kam parasysh detyrat e mëdha që duhet t'i vëmë vetes përfundimtare të mirëmbajtur dhe përfundimtare sa më racionalisht bazën materialo-teknike që kemi krijuar. Nuk do të kishte kuptim, përfshembull, të prodhojmë disa traktorë të rinj dhe të lëmë pa shfrytëzuar ose t'i nxjerrim jashtë përdorimit para kohe mijëra traktorë që mezi i kemi blerë me valutë. Po kështu duhet menduar edhe përfundimtare të tjera. Prandaj, të dyja këto detyra të shikohen të lidhura ngushtë e organikisht me njëratjetrën.

Si në ndërmarrjet e reja që do të projektohen e do të ndërtohen, ashtu edhe në ato ekzistueset, kërkohet të punohet më mirë përfundimtare kapërcyer plotësisht fazat artizanale. Të zbatohen në shkallë më të gjerë mekanizimi e automatizimi, elektrifikimi e kimizimi i prodhimit, si dhe teknologjitë e reja. Këto të jenë drejtimet kryesore të revolucionit tonë tekniko-shkencor dhe të

mos pranohen justifikimet pa baza që nxirren disa herë lidhur me vështirësitë e pengesat që krijon bllokada e që nënvleftësojnë astësitë e mëdha të njerëzve tanë.

Rëndësi të veçantë ka parapërgatitja qysh tani për objektet dhe veprat që parashikohet të ngrihen në pësëvjeçarin e ri, sepse në praktikë ka ngadalësi për studimin dhe hartimin e projekteve. Pesëvjeçari i ri po troket në derë dhe ne duhet të hyjmë në të sa më të përgatitur.

Për sa i përket disa degëve të tjera të industrisë, vëmendje e madhe të tregohet sidomos për sigurimin e rezervave minerare. Këtu të mos bëhet asnjë hap përrapa pa pasur të garantuar perspektivën. Në disa lloj mineralesh, për të cilat, siç del nga skicideja, rezervat janë të garantuara për një kohë të gjatë, mund të parashikohet nxjerra e një prodhimi më të madh.

Në qendër të vëmendjes të jenë kërkimet e studimet për gjetjen e qymyrgurit të koksifikueshëm, sepse, siç e shohim edhe nga bilanci valutor, importi i tij dhe i koksit thith një pjesë të rëndësishme të valutës sónë. Po kështu të bëhen të gjitha përpjekjet për të zëvendësuar shumë nga lëndët e para të importit me lëndë të para të vendit ose duke ngritur ndonjë fabrikë për prodhimin në vend të këtyre lëndëve të para.

Zhvillimin e bujqësisë Partia e ka pasur kurdoherë në qendër të vëmendjes. Por, sikurse është theksuar në Kongresin e 7-të të Partisë dhe në plenumet e kohëve të fundit të Komitetit Qendror, në kushitet aktuale ky sektor merr një rëndësi të jashtëzakonshme. Kjo të kuptohet mirë nga të gjithë. Detyrat në bujqësi ne duhet t'i realizojmë medocemos, ashtu sikurse edhe

kërkesat ndaj saj do të vazhdojmë t'i rritim. Prandaj realizimi i detyrate të parashikuara në skicide do t'i jepte një hov të ri zhvillimit të të gjithë ekonomisë, do të siguronte një furnizim të kënaqshëm të tregut dhe do të realizonte më shumë të ardhura nga eksporti.

Edhe në qoftë se për një kohë do të na mungojë ndonjë artikull industrial, nuk është ndonjë kiamet i madh, por me artikujt ushqimorë, me drithërat, me perimet, me yndyrnat, me patatet, me sheqerin e me qumështin, populli ndeshet përditë. Çdo lëkundje e çrrëgullim në treg në këta artikuj krijon jo vetëm shqetësime ekonomike, por ato mund të bëhen edhe probleme politike. Kujtoni se çfarë situate e vështirë u krijua këtë vit për perime e patate! Do të vazhdojmë ta lejojmë ne këtë situatë? Ne i kemi të gjitha mundësitë që popullin ta furnizojmë normalisht në të gjitha stinët e vitit me perime, patate e fruta, me qumësht, me mish dhe me vezë.

Mund të jemi ca më të shtrënguar për furnizimin e popullit me yndyrna, oriz, sheqer, përderisa nuk i kemi siguruar të gjitha në vend. Por për të tjerat, për asnjë arsy e asnjëherë nuk duhet të ketë mungesë. Prandaj kjo çështje të mbahet mirë parasysh edhe në hartimin e projektplanit të ri pesëvjeçar.

Nga ana tjetër, të mos harrojmë se burimi kryesor për akumulimin e brendshëm socialist janë industria e bujqësia, veçanërisht bujqësia, sepse edhe industria e lehtë e ushqimore një pjesë të madhe të akumulimit të vet e krijon nga produktet bujqësore dhe nga përpunimi i tyre. Po nuk u bënë ulliri e lulja e diellit, atëherë jo vetëm do të mungojnë yndyrnat në treg, por

edhe akumulimi nuk do të realizohet. Po nuk u realizuaz pambuku, s'ka as tekstile dhe as akumulim prej tyre. Po nuk u bë panxhari i shqerit, s'ka as sheqer e as akumulim prej tij.

**Produktet bujqësore e blegtoriale, të papërpusnura ose të përpunuara, zënë rreth 35 për qind të të gjithë eksporteve tonë. Prandaj çdo boshllëk e mosrealizim në bujqësi krijon lëkundje të forta në tërë ekonominë. Kështu duhet kuptuar realizimi i planit dhe i detyrave në bujqësi.**

Mendoj se toka të reja mund të hapim më shumë. Për këtë të mos ngurrohet e të mos bëhet pengesë çështja e rendimenteve të biniëve bujqësore. Rendimentet mund edhe të diferencohen. Rëndësi ka të shtohet prodhimi. Gjithashtu mendoj se duhet parashikuar të hapen më shumë toka edhe për të mbjellë më tepër ullinj, pemë frutore, vreshta etj.

Për sa u përket përmirësimi të tokës dhe rritjes së pjellorisë së saj, në projektplanin e ri detyrat të jenë më konkrete, më të qarta e më të kontrollueshme. Fjalën e kam që në pesëvjeçarin e ardhshëm të dimë se çfarë do të bëhet me të, sa do të sistemohet, sa sipërfaqe do të përmirësohen nga tokat acide, të kripura, ranore etj. Në këtë kuadër të rishikohet edhe puna e drenazhimit, për të cilën bëhet fjalë në skicide, nje synim që ta rritim sipërfaqen që parashikohet për drenazhim. Me ritmet që janë parashikuar për drenazhimin e tokës vetëm zona fushore kërkon 25 vjet. Mirëpo, kur eksperiencia tregon se ky është një faktor i rëndësishëm për kullimin dhe për rritjen e garantinin e

rendimenteve të larta e të qëndrueshme, atëherë përse të mos e shfrytëzojmë më shpejt këtë mundësi?

Një vëmendje më e madhe i duhet kushtuar edhe shtimit e përdorimit të plehrave organike. Pa e bërë këtë, nuk mund të rritet as efektiviteti i plehrave kimike. Partia ka këmbëngulur me të drejtë për sigurimin në vend të fosforiteve dhe në skicide parashikohet që lënda e parë për uzinën e supersosfatit të sigurohet nga mineralet e vendit. Por, në kushtet kur rendimetet në bujqësi ende nuk janë të qëndrueshme dhe disa proj tyre janë akoma të ulëta, mendoj se duhet të shikohet mundësia që t'i jepen më shumë plehra fosfatike bujqësisë.

Në bujqësi ne kemi një bazë të fuqishme materialo-teknike. Kjo është një garanci dhe mbështetje e madhe për realizimin e detyrate që kemi përpara. Por këtë bazë ta shfrytëzojmë më mirë. Nga sa jam informuar, del se jo e tërë sasia e ujit që sigurojmë përdoret si duhet dhe, akoma më keq, nuk përdoret me efektivitetin e nevojshëm. Në ndonjë rreth hidrovoret punojnë edhe në behar për derdhjen e ujërave në det, sikur të ishte dimër. Kjo duhet parë me shumë kujdes. Shteti për këtë qëllim ka bërë investime kolosale. Edhe efektiviteti i plehrave kimike është ende i vogël, sidomos në ato rrethe e ekonomi bujqësore që marrin akoma rendimente të ulëta. Një kujdes më i madh të tre gohet gjithashtu për gjeljen e llojeve të farërave që u përshtaten më mirë kushtevë klimatike e tokësore të vendit. Prandaj Komisioni i Planit dhe Ministria e Bujqësisë, në hartimin e projektpolanit të ri pesëvjeçar, të bëjnë një punë më të thelluar, të kryejnë studime e të

gjejnë rrugë për të rritur më tej efektivitetin e tyre. Sepse nuk është e drejtë që të kërkojmë e të bëjmë investime të tjera, pa shfrytëzuar mirë e plotësisht këto investime që kemi bërë. Investimet e reja duhet me doemos të garantojnë arritjen e rendimenteve të larta dhe plotësimin e detyrave të prodhimit.

Në skicide parashikohet të dyfishohet sipërfaqja e ujitshme me impiante në formë shiu. Mendoj se kjo është e parakolishme dhe duhet kufizuar. Do të mendoj që për ujitjen e bimëve bujqësore të gjenden rrugë më të leverdishme, sepse, më duket që nuk është ekonomike që në Fier, për shembull, të gozhdohen 200 traktorë dhe të harxhojmë naftë për të ujitur në formë shiu. Përderisa në Korçë prodhohen elektropompa, ose në uzinën «Traktori» mund të sigurohen motora stacionarë, atëherë të shikojmë mundësinë që të shtrihen linjat elektrike edhe gjatë fushës dhe, në vend të naf-tës, të përdorim kryesisht energji elektrike, e cila tani, në pjesën dërrmuese të saj, edhe në periudhën e verës sigurohet nga hidrocentralet. Sidoqoftë ujitja me brazda duhet të jetë kryesorja.

Për sa i përket blegtorisë kam mendimin se në të gjitha llojet e bagëtive, por sidomos në gjedhe dhe në të imëta, ka mundësi të shtohen më tej numri i kërëve dhe prodhimitaria e tyre.

Zhvillimi i gjithanshëm i bujqësisë dhe shndërrimi i vazhdueshëm i ekonomive bujqësore në ekonomi moderne të prodhimit të zgjeruar socialist kërkon gjithashtu që edhe problemet e rajonizimit, të shpërndarjes së bimëve bujqësore e të blegtorisë, problemet e përqendrimit dhe të specializimit në bujqësi t'i shikoj-

në kurdoherë në mënyrë dinamike. Puna e bërë deri tani, me të mirat dhe të metat e saj, të analizohet në mënyrë kritike dhe të çohet më tej. Prodhimi bujqësor nuk mund të vihet plotësisht mbi baza shkencore, pa zgjidhur në mënyrë shkencore edhe këto probleme. Zgjidhja e tyre të gjejë pasqyrim sa më të mirë në planet perspektive, që nga baza e rrethet e deri në shkallë republike.

Problem i një rëndësie të madhe do të jetë në pësëvjeçarin e ardhshëm edhe tregtia e jashtme, rritja e eksportit dhe përmirësimi i strukturës së importit. Kjo ka të bëjë drejtpërdrejt me përpjesëtimet kryesore të zhvillimit të ekonomisë dhe me sigurimin e rimeve të zhvillimit. Çështja e balancimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve në valutë, duke krijuar një bilanc aktiv, përbën sot një ndër hallkat themelore për përballimin e të gjitha nevojave, duke u mbështetur plotësisht në forcat tona.

Për të realizuar këtë detyrë me rëndësi jetike përfatet e ndërtimit të socializmit në vendin tonë, është e nevojshme që organct dhe organizatat e Partisë, organct shtetërore dhe të ekonomisë t'i kushtojnë vëmendje më të madhe dhe të ndjekin hap pas hapi problemet që lidhen me tregtinë tonë të jashtme. Në këtë kuadër mendoj se duhet parë mundësia e rritjes më shumë të eksportit dhe për këtë të mos ketë ngurrime duke u nisur ndoshta nga kjo gjendje që është krijuar tani në tregtinë e jashtme.

Duhet thelluar më tej puna e nisur për seleksionim dhe vendosjen e radhës dhe të prioriteteve në importimin e produkteve më të domosdoshme, duke ve-

çuar ato produkte, makineri e pajisje të tjera, të cilat, edhe po të mos importohen, për arsyet e fondeve të kufizuar, nuk do ta pengonin e nuk do ta dobësonin zhvillimin e ekonomisë dhe fuqizimin e aftësisë mbrojtëse të vendit.

Në kushtet e krizës së thellë që ka pushtuar botën kapitalisto-revisioniste, ku çmimet dhe tregjet pësojnë luhatje përditë, llogaritjet e eksport-importit të bëhen sa më afër çmimeve të vërteta, përndryshe pa sojat do të ndihen myftë edhe në ekonominë tonë. Në duhet të ruajni të ardhurat kombëtare që krijojnë klasa jonë punëtore dhe fshatarësia kooperativiste që të mos na i rrëmbejnë të tjerët me anë të çmimeve më të ulëta të mallrave të eksportit tonë. Gjithashtu të rritim vazhdimesht rezervën në valutë dhe ta ekonomizojmë fort atë.

Në rrethanat në të cilat punojmë e luftojmë ne për ndërtimin e socializmit, kërkon që edhe problemet e mbrojtjes të gjejnë një pasqyrim sa më të plotë në projektplan. Këtu çështja nuk duhet parë vetëm në aspektin e prodhimit të industrisë ushtarake ose të investimeve për fuqizimin e mbrojtjes, por në një kuadër më të gjerë, duke e parë dhe duke e ingranuar tërë ekonominë lidhur ngushtë me mbrojtjen e vendit.

**Sfera socialkulturore, sidomos fusha e arsimit dhe e ngritjes tekniko-profesionale të punonjësve, kërkon një punë shumë më të thelluar. Këtu nuk është fjala vetëm që të vendosen disa shifra për problemi të shitet në kompleks. Prandaj ritmet e vendosura në skicidë për përgatitjen arsimore e tekniko-profesionale të njerëzve tanë të analizohen më thellë e të lidhen më**

ngushtë me detyrat e statit aktual e perspektiv të zhvillimit të vendit.

Në përfundim dëshiroj të theksoj se punën për hartimin e projektplanit të ri pesëvjeçar, veçanërisht në këto kushte, duhet ta marrë më mirë në dorë gjithë Partia, qdo organizatë-bazë e komitet partic, gjithë organet shtetërore dhe ekonomike. Pesëvjeçari i ri do edhe intensitet, metoda pune, koncepte e praktika më të përparuara e më progresive. Hartimi i një projektplani sa më të studiuar, shkencor e revolucionar, me variantet më të mundshme, do të jetë një bazë e shëndoshë për zbulimin dhe për shfrytëzimin sa më të mirë të rezervave të pashtershme që fshihen në gjirin e ekonomisë dhe të punonjësve tanë, për vënien në jetë të parimit të madh marksist-leninist të mbështeljes plotësisht në forcat tona. Kjo është edhe forca e planit tonë, e organizimit, e kontrollit dhe e zbatimit në rendin tonë ekonomiko-shoqëror socialist, që e kapërcen dhe e mund forcën e ligjeve të tregut që sundojnë në ekonominë kapitaliste e borgjezo-revizoniste, me gjithë pasojat e tyre shkatërrimtare. Prandaj, ta marrim me tërë seriozitetin e duhur këtë punë kaq të rëndësi shme në shërbim të fuqizimit të atdheut tonë socialist.

Këto ishin disa nga mendimet e mia të përgjithshme për skicidenë që na është paraqitur. Meqë Byroja Politike ka dhënë orientimin për hartimin e projektplanit, të vazhdohet puna. Të procedohet sipas rregullave që ekzistojnë; të bëhet parapërgatitja e para-projectplanit, pastaj të na riparaqitet këtu, në Byronë Politike. Themelore është të mos harrojmë se klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste dhe gjithë punonjësit

e tjerë, nën udhëheqjen e Partisë, duhet të mobilizohen totalisht që të realizojnë në radhë të parë planin që kenë aprovuar.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PPSH që gjendet në AQP*

## PËRVJETORET E LINDJES SË SHOKËVE JANË FESTA TË GËZUESHME

*Fjala në takimin e organizuar me rastin e ditëlindjes së shokut Haxhi Kroi dhe të disa shokëve të tjerë, punonjës të aparatit të KQ të PPSH*

26 shtator 1978

Të dashur shokë dhe shoqe,

Shoku Hekuran [Isai] foli për aktivitetin e gjatë e frytdhënës në punë të shokëve Haxhi Kroi e Hulo Tartale, që mbushën 60 vjeç, Stavri Rali, Pandi Kërthi dhe të shoqes Stamata Morava, që mbushën 50 vjeç, të cilët kanë punuar pa u lodhur në detyrat e ngarkuara nga Partia në aparatin e Komitetit Qendror. Kjo mblehdje e organizuar për të uruar shokët me rastin e përvjetorëve të lindjes është edhe një festë e gëzueshme. Festa të tilla do të bëjmë pérherë.

Unë i njoh të gjithë këta shokë që dekorohen dhe kam respekt për punën e secilit prej tyre, por shokun Haxhi Kroi e njoh më nga afër, se kam punuar me të për një kohë të gjatë. Siç e dini, shoku Haxhi është një nga komunistët e parë, të vitit 1941, të asaj kohe të

lavdishme kur u themelua Partia jonë heroike. Që nga koha e themelimit të Partisë e deri sot kanë kaluar gati 37 vjet, por kujtimet e asaj periudhe historike i kemi të freskëta.

Para se të vinim këtu, po i tregoja Nexhmijes për njohjen time të parë me Haxhiun. Ishte koha e luftës kur qëndronim në ilegalitet. Një ditë, kur po kaloja rrugës, bashkë me Kozma Nushin, andej nga Tirana e vjetër, pamë Haxhiun, për të cilin Kozmai tha: «Ky është mësues, është një shok yni». Dhe vërtet koha tregoi se Haxhiu ishte shoku ynë.

Pas Kongresit të Parë të Partisë, shokun Haxhi Partia e ngarkoi të punonte pranë udhëheqjes. Nga ajo kohë e gjer më sot ky ka punuar vazhdimisht pranë meje<sup>1</sup>. Kudo që kam qenë unë, Haxhiu më është ndodhur pranë.

Me shokun Haxhi kemi bashkëpunuar ngushtë, me besnikëri e vetëmohim si dy komunistë, si dy ushtarë të Partisë. Haxhiu është një nga punëtorët më të vjetër të aparatit të Komitetit Qendror.

Që në ditët e para të punës në aparatin e Komitetit Qendror unë pasqë te Haxhiu një ndihmës të aftë, një shok me kulturë dhe me kualitete të larë morale e politike, siç janë vetëmohimi dhe besnikëria për çështjen e Partisë, gjykim i urtë, i drejtë dhc objektiv, gjakftohtësia në mendime e në veprime, thjeshtësia shembullore, konspiracioni, rregulli dhe disiplina pro-

---

1. Shoku Haxhi Kroi për një kohë të gjatë ka qenë chef i Sektorit të Përgjithshëm në aparatin e KQ të Partisë dhe sekretar personal i shokut Enver Hoxha.

Ietare në punë e në jetë e shumë virthyle të tjera që duhet t'i ketë çdo komunist.

Bashkëpunimi i Haxhiut, orë e çast, me mua, me shokët e tjerë anëtarë të Byrosë Politike dhe me ju, shokë punonjës të aparatit të Komitetit Qendror, ka qenë frytdhënës dhe i dobishëm. Detyra që iu besua shokut Haxhi ka qenë delikate. Përveç atyre kualiteve që përmenda, ajo kërkonte edhe zgjuarsi e vigjilencë të lartë politike, sepse në duart e Haxhiut kanë kaluar çështjet më sekrete të Partisë. Këtë përgjegjësi ky e ka mbajtur si një bolshevik dhe detyrën e ka ushtruar, gjithashtu, si një bolshevik.

Të gjithë shokët e udhëheqjes dhe veçanërisht unë, që jam më afër me të, kemi pasur kurdoherë dhe kemi respekt të madh për punën e palodhur e plot sakrifica të Haxhiut, të cilët shpeshherë i ka takuar të rrijë net të tëra pa gjumë për ta kryer punën sa më mirë, sepse detyra e tij për të punuar me dokumentet e Partisë, që merren si shembull në çdo drejtim, kërkonte kapacitete kulturore, arsimore e drejtshkrimore.

Duke e gjykuar në tërësi punën prej disa dekadash të shokut Haxhi, mund të them se ky ka qenë një shok jashtëzakonisht i zellshëm dhe i vullnetshëm, është përpjekur që çdo gjë të dilte e pastër nga duart e tij dhe ia ka arritur qëllimit. Mua Haxhiu më ka ndihmuar shumë, por ndihma e tij ka qenë e vlefshme edhe për bashkëpunëtorët e tij, të cilët kanë gjetur në personin e Haxhiut një shok me eksperiencë, gojëmbël e të sjellshëm, por edhe të rrëptë ndaj të metave e dobësive në punë. Natyrisht, në punë e sipër vërehen edhe gabime, mungesa e lëshime, por në raste të tillë komu-

nisti ua vë në dukje të metat shokëve, duke i ndihmuar me eksperiencën dhe pjeturinë e tij dhe duke shprehur haptazi pikëpamjet, mendimet e kritikat. Të tillë e njo-hin shokët edhe Haxhiu.

Për të gjitha këto arsyet, sipas mendimit tim, mund të thuhet se shoku Haxhi i meriton respektin dhe dashurinë që ushqen Partia për të. Këtë respekt e dashuri ai nuk i gëzon vetëm për arsyet se punon pranë meje, por sepse është i njohur për kryerjen me ndershmëri të punës që i ka besuar Partia.

Këtu në mes nesh ka shokë e shoqë që janë të rinj. Ky fakt na gjëzon, sepse kur Partia ka në radhët e saj shokë e shoqë të rinj, bëhet akoma më e fortë. Është një fakt i lumtur që ne të vjetrit punojnë bashkë me të rinjtë. Partia ka nevojë për eksperiencën e të vjetërve dhe për gjallërinë e të rinjve. Detyrat e Partisë kërkoijnë kontributin e përbashkët të të dyja palëve, prandaj komunistët e vazhdojnë aktivitetin e tyre si militantë politikë e shoqërorë edhe kur ligjërisht u takon e drejta e pensionit të pleqërisë. Për sa i përket Haxhiut, unë jam i mendimit që ky të mos dalë në pension, por shokët më të rinj, që punojnë bashkë me të, të kenë kujdes për t'ia lehtesar punën. Edhe unë ndihmohem shumë nga shokët sekretarë të Komitetit Qendror, nga shoku Haxhi dhe nga të gjithë ju, shokë punonjës të aparatit, që me punën e pastër që bëni (dhe këtë e them me plot gojën dhe me plot bindje) na e kenë lehtesar detyrën mua edhe gjithë shokëve të tjerrë të udhëheqjes. Të gjithë duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin që punët e Partisë të kryhen sa më mirë.

Ti, Haxhi, je dakord me mua që ta vazhdosh punën?

**SHOKU HAXHI KROI:** Patjetër, shoku Enver, me gjithë qejf.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Veçanërisht unë, që të kam njojur nga afër në punë, për 30 vjet, jam shumë i lumtur e i gjuar që asistoj sonte në ceremoninë e 60-vjetorit të ditëlindjes dhe në dekorimin tënd. Gjithashtu jam shumë i lumtur e i gjuar që asistoj në përvjetorin e ditëlindjes dhe në dekorimin e shoqes Stama të shokëve Hulo, Pandi e Stavri që janë, gjithashtu, komunistë të vendosur dhe ushtarë besnikë të Partisë dhe që kanë eksperiencë të madhe në punë. Edhe për këta shokë, për punën e tyre, mund të thuhen fjalë shumë të mira.

Urdhrat dhe medaljet akordohen nga Presidiunii i Kuvendit Popullor me raste të ndryshme, siç janë edhe përvjetorët e lindjeve të punonjësve, për rezultatet shumë të mira që ata kanë arritur në punë, për merita në drejtimin dhe në organizimin e sektorëve të ndryshëm të ndërtimit socialist etj. Kur dekorohen shokët për punën e tyre të lavdërueshme në shërbim të Partisë, të popullit dhe të socializmit, është një kënaqësi e veçantë jo vetëm për vetë ata, por edhe për rrëthin familjar, për shokët e miqtë e tyre, për kolektivin punonjës ku militojnë. Prandaj edhe ne jemi shumë të gjuar sonte dhe ju urojmë që t'i mbani me shëndet dekoratat, tëjeni kurdoherë të rinj në shpirt, të shkathët në punë, të nprehtë në gjykime dhe, në radhë të parë, besnikë të vijës së drejtë të Partisë, të popullit dhe të çështjes së madhe të socializmit.

Me këtë rast të gjueshëm, të gjithë ne urojmë me gjithë shpirt shokun Haxhi dhe shokët e tjerrë të kenë jetë të gjatë e të lumtur. Ma do zemra që kur Haxhiu të dekorohet përsëri me rastin e 100-vjetorit të lindjes, unë, megjithëse po mbush 70 vjeç, të vij këtu e ta uroj nxehësisht. Njeriu vërtet nuk jeton gjithmonë, por komunistët, që e duan jetën, punojnë vazhdimisht për zbulimin e saj, rrojnë me ndër dhe janë gati të sakrifikohen për ideale të larta, për popullin e atdheun e tyre socialist, për fitoren e revolucionit proletar e për ndërtimin e shoqërisë komuniste në botë. Mosha bën punën e vet, por komunistët nuk plaken kurrë nga shpirti; ata punojnë tërë jetën, që, edhe kur të mos ekzistojnë më fizikisht, vepra e tyre, e vazhduar nga pasardhësit, të mbetet e pavdekshme.

Çështja e Partisë është kryesore, prandaj Partinë duhet ta mbrojmë me të gjitha forcat e mundësítë, me tërë zjarrin e shpirlit tonë revolucionar. Në shërbim të Partisë të vëmë zotësinë e diturinë, përpjekjet tona fizike. Aftësitetë tona fizike e mendore të dimë t'i organizojmë si duhet dhe t'i kanalizojmë për vënien në jetë të direktivave të Kongresit të 7-të të Partisë, të vendimeve të plenumeve të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike e të Sekretariatit.

Sic e dini, armiqjtë e komunizmit, të marksizëm-le-ninizmit, të revolucionit dhe sidomos armiqjtë e Partisë sonë, janë të egër. Ata kurdoherë kanë qenë të tillë, por aktualisht, me tradhtinë e revisionistëve kinezë, radhët e tyre u shtuan. Në të vërtetë revisionistët kinezë nuk kanë tradhtuar tash; ka kohë që ata janë bërë renegatë

të marksizëm-leninizmit, por koha bëri punën e vct, ajo u çori maskën.

Partia jonë ka meritën e madhe se diti t'i gjykojë dhe t'i analizojë dialektikisht mendimet dhe veprimet e udhëheqjes revizioniste të Partisë Komuniste të Kinës dhc, prej kësaj analize, diti të dalë me konkluzione të drejta se vija e kësaj partie, që në kohën e Mao Ce Dunit, nuk ka qenë marksiste-leniniste, por një vijë demokratike borgjeze revolucionare, që e kanë maskuar më sloganë të majta. Marksizëm-leninizmi nuk e duron tradhtinë, prandaj Partia jonë, që zbaton me besnikëri këtë teori shkencore, bën shumë përpjekje për të ndrequr me durim ata që gabojnë, qofshin individë, organizata apo një parti e tërë, por nuk pajtohet me renegatët.

Tradhtia e udhëheqjes kineze, natyrisht, ka krijuar situata të vështira për Partinë tonë dhe për partitë e vërteta marksiste-leniniste, por komunistët e vërtetë nuk tremben nga vështirësitë. Ata janë të gatshëm t'i kapërcejnë pengesat dhe t'i ngjiten malit përpjetë, paravësisht se do t'u kullojnë djersa dhe gjaku. Para forcës sonë armiqtë e marksizëm-leninizmit dhe të popujve do të thyhen. Shqipëria socialiste do të vazhdojë pa u lëkundur, si gjer më sot, rrugën e saj të drejtë.

Qëndrimet tona kundër udhëheqjes revizioniste kineze, siç e dini, kanë pasur një jehonë të madhe pozitive te komunistët, te proletariati dhe te popujt e botës. Ata i konsiderojnë të drejta këto qëndrime dhc i mbështesin fuqimisht.

Në botë është krijuar një gjendje shumë e shëndo-shë, shumë optimiste në përkrahje të Partisë sonë dhc

të shtetit të diktaturës së proletariatit në Shqipëri. Edhe ata që nuk na duan, përpara logjikës së fortë marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe përpara unitetit tonë nuk kanë si gjejnë të çara për të na thyer. Armiqtë tanë, që nga imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, imperializmi kinez, kapitalizmi botëror, e dëri te kleri etj., luftojnë në bllok kundër nesh, sepse ata janë antikomunistë dhe i bashkon idcologjia e antikomunizmit. Sido që na urrejnë, armiqjtë janë të detyruar të njohin faktin e pamohueshëm se Shqipëria, me Partinë e Punës në krye, qëndron e patundur dhe pa devijime në vijën e saj të kulluar marksiste-leniniste. Natiyrish, ata duan që në Partinë tonë të ketë devijime, dhe nuk u vjen mirë që nuk gjjejnë të çara, por ne do të bëjmë që dëshirat e tyre të mos realizohen kurrë dhe do të luftojmë që armiqjtë të mos depërtojnë dot asnjëherë në radhët tona.

Të gjithë ne, si punonjës të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, e kemi për detyrë të vazhdojmë punën akoma më me zell, të luftojmë me një hov akoma më të madh revolucionar, duke bërë edhe sakrifica për të mirën e Partisë e të popullit. Të mos e kursejmë veten nga lodi, pse puna e mirë kërkon lodi të madhe. Pas lodhjes vjen satisfaksi i thellë që ndiejmë kur ia arrijmë qëllimit. Ky satisfaksion e mposht lodjen fizike. Kur komunisti shikon se Partia e tij forcohet, se armiqjtë demaskohen dhe dobësohen, i shtohen dhe i shumëfishohen forcat. Në qoftë se fjala e Partisë sonë dhe e Shqipërisë dëgjohet sot me simpati në të gjithë popujt e botës, kjo vjen sepse politika, lufta dhe puna janë kanë qenë të drejta e parimore.

Po i përfundoj këto pak fjalë, duke u shprehur, edhe një herë, bashkëpunëtorit tim të ngushtë, shokut Haxhi dhe shokëve të tjerë urimet më të përzemërta me rastin e përvjctorëve të lindjes dhe të dëkorimit të tyre.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

# PËR RUAJTJEN E KUFIRIT DUILLET PUNUAR VAZIDIMISHT ME NJEREZIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

27 shtator 1978

Nuk dëshiroj të zgjatem, për arsyen, se si nga raportet që na u dhanë, ashtu edhe nga diskutimet që bënë shokët, me të cilët jam dakord, problemi u trajtua mirë. Unë dëshiroj të vë në dukje çështjen se përtej kufirit tonë me Jugosllavinë, në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni jetojnë në trojet e veta më se një milion e gjysmë vëllezër të një gjaku. Ata, siç e dimë, ushqejnë ndjenjat e një dashurie të thelië për Shqipërinë. Përveç kësaj duhet të kemi parasysh se shumë nga ata shqiptarë, që banojnë në zonat fare afër kufirit me vendin tonë, sidomos, kanë njerëz të tyre të afërt, në Shqipëri, ashtu sikurse shumë nga njerëzit tanë kanë atje farefis etj. Të dyja palët janë të interc-

---

1. Pika e parë e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje ishte: «Mbi punën e organeve e organizatave-bazë të Partisë dhe të organeve shtetërore për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kufirit».

suara të mbajnë lidhje me njëra-tjetrën. Ky është një problem që duhet t'ju bëjë ju, shokë të komiteteve të Partisë të rretheve kufitare, të thelloheni e ta merrni në studim. Askush të mos mendojë që zgjidhja e këtij problemi me rëndësi të madhe politike është një detyrë vetëm e një ose e dy funksionarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Nga sa doli këtu kjo çështje, që ka një rëndësi të madhe politike për ne, juve, shokëve të Tropojës, nuk ju ka preokupuar aq sa duhet. Po ju, shokë të rretheve kufitare, e dini që lidhjet e tropojanëve, të kuksianëve e të dibranëve janë jashtëzakonisht të ngushta me kosovarët e me shqiptarët e Maqedonisë. E dini që njëri ka motrën andej, kosovari ose dibrani ka motrën ose vëllanë këlej, babën, farefisin e kështu me radhë, shumë njerëz të afërt të tjerë? Prandaj komiteteve të Partisë u bie detyra ta studiojnë këtë çështje dhe të nxjerrin konkluzione nga vajtjet dhe ardhjet e shqiptarëve të përtej kufirit në rrethet e tyre dhe nga bisedat që bëjnë ata me njerëzit tanë etj.

Një efekt të madh politik tek ata që vijnë te ne bën pritja e ngrohtë e vëllazërore nga ana e mikpritësve shqiptarë. Kjo ndihmon shumë që miqtë, të cilët vijnë në shtëpitë e njerëzve tanë, ta duan Shqipërinë, ashtu sikurse e duam edhe ne atë pjesë të popullit shqiptar që jeton në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi, sepse të gjithë këta janë bij të një nëne.

Nga bisedat që bëhen me të ardhurit, kurdoherë në mënyrë patriotike, njerëzit tanë duhet dhe mund të mësojnë prej tyre shumë për metodat dhe prapësitë që bëjnë revisionistët jugosllavë, shovinistët serbë ose ma-

lazezë kundër gjithë shqiptarëve në të tëra ato vise që banohen nga shqiptarë.

Në radhë të parë ne duhet të mësojmë, nëpërmjet këtyre vizitave, për gjendjen moralo-politike që ekziston te shqiptarët e Jugosllavisë, për fryshtat patriotike e gjendjen arsimore e kulturore të popullsisë me kombësi shqiptare dhe për pengesat e çfarëdolloji që i sillen asaj popullsie në Jugosllavi, për goditjet e pengesat e çfarëdolloji që u bën atyre pushteti revisionist titist për të mos ushtruar as ato pak të drejta që kanë brenda asaj farë kushtetute që është atje në fuqi. Kjo punë, shokë, i takon Partisë ta bëjë dhe është e natyrshme që këtë duhet ta bëni edhe ju në rrëthim tuaj.

Pastaj, në mënyrë të vazhdueshme, ju duhet të mbani në korent popullin e rrëthit për këto probleme, se kështu do të ngrihet e do të mprehet vigjilanca e njerëzve tanë, ndryshe s'ka se si të kuptohen këto probleme. Ju, krahas punës së vazhdueshme për të luftuar kundër mbeturinave mikroborgjeze që ekzistojnë akoma te njerëzit tanë, kundër të cilave ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë dhe të përpinqemi t'i spastrojmë, duhet njëkohësisht të keni parasysh dhe të punoni që banorët e zonave kufitare të njojin mirë edhe gjendjen e vështirë të vëllezërve tanë kosovarë, dibranë etj., pse, në fakt, ata vuajnë atje, jetojnë si në robëri. Kjo gjende duhet t'u thuhet qartë njerëzve tanë, që jetojnë këtu të lirë e të lumtur.

Nga bisedat që bëjnë me ta njerëzit tanë, në të gjitha rastet, të nxjerrim konkluzione. Që t'i arrihet këtij qëllimi, është e nevojshme që sidomos populli i zonave kufitare, si në Tropojë, Kukës, Peshkopi etj., ashtu si-

kurse në Jug, në zonën e Partizanit apo në krahinat e tjera, duhet të mbahet në korent edhe për gjendjen politike në vendet fqinje. Ashtu sikurse është e domosdoshme që, si mbarë populli ynë, punonjësit e krahinave kufitare të bëhen të qartë për çështje shumë të rëndësishme politike dhe ideologjike, siç janë ato që ngrihen në Letrën e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë sonë drejtuar revisionistëve kinezë, si dhe për probleme të tjera të rëndësishme të kësaj natyre, po ashtu ata duhet të vihen në dijeni edhe si është gjendja në Jugosllavi, në Greqi, në Itali etj. Kjo punë të bëhet nga Partia, dhe të bëhet mirë.

Krahas kësaj, siç thashë, banorët tanë të krahinave përkatëse kufitare të Veriut duhet të jenë në dijeni të plotë për situatën në të cilën jetojnë vëllezërit shqiptarë në Jugosllavi. E theksoj këtë se kam përshtypjen që masave tona punonjëse të rrtheve kufitare nuk u flitet në këtë drejtim. Kjo është vetëm një përshtypje, prandaj mund edhe të gabohem. Çështja është se duhet t'u flitet njerëzve tanë se çfarë ndodh në Kosovë, në Dibër të Madhe, në gjithë Maqedoninë, në Mal të Zi, si veprohet nga ana e revisionistëve jugosllavë ndaj vëllezërve tanë atje etj. Në përgjithësi dihet që veprohet keq ndaj popullsisë shqiptare, po çështja është t'u flitet edhe konkretisht, me fakte e argumente të kohës.

Fizikisht dhe materialisht ne nuk kemi çfarë të bëjmë për ta ndihmuar gjithë këtë masë të madhe popullsie, por me anë të propagandës duhet të ndihmojmë që të ruajnë dashurinë për Shqipërinë, të ruajnë gjuhën, zakonet, të luftojnë për të drejtat e tyre etj. Këtë punë, në përgjithësi, e bëjmë, por rezultate të mëtej-

shme e bindëse mund të arrihen në qoftë se e përmirësojmë më tej edhe propagandën tonë gojore, duke vënë mirë në dukje jo vetëm sukseset e vendit tonë etj., por edhe kontradiktat tona të mëdha ideologjike, politike dhe ekonomike që kemi me tilistët, duke u folur edhe për ambicjet e revisionistëve të Beogradit dhe për armiqësinë e tyre kundër vendit tonë dhe kundër shqiptarëve që jetojnë në trojet e tyre në Jugosllavi. Kjo nuk është aspak ndërhyrje në punët e brendshme të Jugosllavisë. Mysafirëve që vijnë prej andej ne nuk u themi asgjë - si të luftojnë, as u diktojmë çfarë të bëjnë, se ata i dinë vëlë situatat. Ne u flasim për t'u forcuar atyre moralin dhe patriotizmin, u flasim për unitetin e mbarë kombit shqiptar, për ruajtjen e gjuhës, të traditave, për unitetin ndërmjet tyre etj.

Ja, për shembull, kur dikujt i vjen këtu vëllai nga Kosova dhe ky i tregon, fjala vjen, se shqiptarët në Jugosllavi nuk guxojnë të flasin, mbasi në çdo qoshe ka njerëz të UDB-së që i përgjojnë, atij i duhet bërë e qartë se këto vështirësi ekzistojnë, por duhet punuar e luttuar për t'i kapërcyer. Të mos guxosh të flasësh kundër padrejtësive, pavarësisht nga vështirësitë që ekzistojnë atje, është një politikë disfatistic, një politikë tmerri e frike që me qëllim e përhap UDB-ja për të ulur fryshten patriotike dhe rezistencën e shqiptarëve për të drejtat e tyre. Sidomos kundër elementeve shqiptarë të shitur, që vihen në shërbim të UDB-së, nuk duhet heshtur, por disa njerëz të guximshëm nga populli t'u dalin përpara, t'i demaskojnë mirë e mirë përpara syve të të gjithëve dhe, si t'u japid një dush të mirë, t'u bëjnë thirrje të mos bëhen vegla të verbra, të mos bëjnë të

këqija kundër shqiptarëve. Ky do të jetë një shembull për të gjithë ata që janë vënë verbërisht rë shërbim të regjimit të Titos. Natyrisht, kjo punë kërkon të marrësh parasysh çdo sakrificë, pse ata që do të veprojnë kështu, mund të futen edhe në burg, por një gjë e tillë do të bëjë bujë në popullsinë shqiptare, do të ushtrojë një influencë jashtëzakonisht të madhe edhe në vetë qeverinë jugosllave që të mos i shtojë masat represive kundër patriotëve shqiptarë, të cilët janë në të drejtën e tyre. Pra nuk duhet qëndruar pasivë kundër spiunëve që kërkojnë t'ju bëjnë të këqija.

Dihet se situatat për shqiptarët e Jugosllavisë janë të rënda, mbasi kundër tyre ushtrohet një terror i egër. Është e vërtetë që nuk është e lehtë të veprosh në këto situata të rënda, por edhe guxim duhet të ketë më shumë nga ana e popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Dhe këtë guxim, jam i bindur, që shqiptarët nuk e kanë humbur, por ata duhet të veprojnë me zgjuarsi dhe të dinë se kur dhe në ç'rast duhet ta tregojnë guximin e tyre.

Ne duhet ta mendojmë më mirë e më thellë këtë problem. T'i shikojmë mirë njerëzit që na vijnë nga përtejkufirit, të përpinqemi të futemi në botën e tyre të brendshme, të njohim shpirtin e ndjenjat e tyre, pse kjo punë është me vlerë të madhe për ne. Ne e dimë se kush vjen nga Kosova dhe te kush shkon përvizitë, prandaj posaçërisht me pritësit duhet të bëhet një punë e menduar mirë që më parë nga ana jonë, duke i sqaruar ata për shumë probleme që mund t'u dalin e duke u dhënë edhe orientimet e nevojshme për punën propagandistike që duhet të bëjnë me vi-

zitorët. Kështu, mendoj unë, forcohet edhe vija e kufirit.

Konkluzionet që do të nxjerrë komiteti i Partisë I rrrethit nga kjo punë duhet t'ua japë edhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, edhe Drejtorisë së Kufirit, punonjësit e të cilëve të mos i futin ato në xhep, sepse nuk janë çështje specifike si ato që ndjekin këto organë, por janë probleme propagandistike, politike dhe ideologjike. Rëndësi ka që kufitarët tanë të mësojnë për gjendjen e shqiptarëve të përtej kufirit dhe të rrisin vigjilencën.

Kur ne shohim se vëllezërve tanë që jetojnë atje titistët u bëjnë gjithë ato poshtërsi për të shuar patriotizmin e tyre, për të dobësuar ndjenjat e tyre të pastra të dashurisë, dëshirën për të forcuar unitetin e kombit tonë etj., etj. atëherë q'mund të presim nga ata, veç të këqijave kundër vendit tonë? Prandaj, siç e theksova edhe në fillim, ta shtojmë vigjilencën, të rrimë natë e ditë me syrin pishë e me gishtin në shënjestër.

Materialet e Partisë duhet të shfrytëzohen për të bërë një punë më të madhe e më të kualifikuar, politike dhe ideologjike që t'i shërbejë forcimit gjithnjë e më shumë të vigjilencës së kufitarëve tanë. Për këtë qëllim me kufitarët dhe me gjithë banorët e krahinave kufitare është e domosdoshme të bëhet vazhdimesht një punë e veçantë edukative, që ata të jenë në dijeni për gjendjen moralo-politike dhe ekonomike të të gjithë vendit, sepse mbi këtë bazë do të forcohet bindja e tyre për të kryer si duhet detyrat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e kufirit.

Çështja që të mos e zërë gjumi kusitarin është një çështje fizike, stërvitjeje, kalitjeje, por ajo është edhe çështje politike, sepse, kur kufitari ynë e shikon situatën e vendit fqinj me një frysme të vërtetë realiste, atëherë ai do të tendosë të gjitha forcat e tij mendore e fizike dhe për asnjë çast nuk do ta zërë gjumi. Sigurisht, stërvitjet me kufitarët duhet të bëhen në mënyrë të tillë që ato të japid rezultate pozitive në punë, por, për të qëndruar kurdoherë vigjilëntë, rol të madh luan, në radhë të parë, ngritja e nivelit politik të tyre.

Për ruajtjen e kufirit nga armiqta duhet punuar konkretisht dhe vazhdimisht me njerëzit, për t'i vënë ata në dijeni, në çdo kohë e në çfarëdo koniunkturash, edhe për situatat sidomos në vendet fqinje. Kufitari ynë në kufi me Greqinë, për shembull, duhet të jetë i qartë dhe ta kuptojë që aktualisht marrëdhëniet e shtetit tonë me këtë vend janë përmirësuar, por kjo nuk do të thotë që atë ta zërë gjumi kur ngarkohet të bëjë detyrën e rojës. Jo, ai duhet ta kryejë shërbimin njëlloj dhe kurdoherë i mobilizuar totalisht. Ai ta dijë se në Greqi ka edhe që veprojnë kundër nesh. Por, që kufitari ynë të mos ketë parasysh politikën që ndjek aktualisht Partia jonë me atë shtet, përsëri do të ishte gabim. Në qoftë se në ndonjë rast kufitari grek që ka përballë, i buzëqesh kufitarit tonë, ky duhet të jetë edhe vigjilent ndaj tij, edhe korrekt, se ai e bën këtë edhe sepse e di që tanë ka ndryshuar politika e qeverisë greke ndaj Shqipërisë. Në kufi bëhet një politikë specifike, që është pjesë e pandarë e politikës së gjithë shtetit tonë, por aktualisht kufitarët tanë nuk mund

të sillen me kufitarët grekë njëloj si në kohën e qeverisë së Calderosit ose të Metaksait. Tani situata është ndryshe dhe këtë kufitarët tanë duhet ta kuptojnë dhe pa bërë asnjë lëshim në kryerjen e detyrave, pa humbur vigjilencën, edhe sjellja korrekte me fqinjët luan një rol me rëndësi në punën e tyre.

Të gjitha këto kërkojnë që Partia të punojë më mirë në zonat kufitare, të flitet dhe ta dinë kufitarët tanë, për shembull, faktin që i gjithë populli grek u ngrit në këmbë me vajtjen dy herë atje të Ansamblit tonë të Këngëve e të Valleve Popullore. Pse për sy e faqe i shprehën punonjësit grekë ato ndjenja simpatike në mënyrë aq entuziaste për Shqipërinë? Jo, shokë. Populli grek nuk mund të mbante një qëndrim të atillë aq dashamirës ndaj artistëve tanë për sy e faqe. Ne vëmë re se në Greqi është krijuar tani një opinion i favorshëm për Shqipërinë. Mirëpo një gjë e tillë nuk krijohet dot brenda një dite, apo vetëm që kurse fola unë në mars në Gjirokastër<sup>1</sup>. Ne jemi të bindur se te populli grek ka ciklistuar prej kohësh një ndjenjë miqësie e dashamirësie ndaj Shqipërisë. Këtë ne duhet ta mbajmë mirë parasysh. Partia dhe Komiteti Qendror i saj e kanë pasur kurdoherë parasysh këtë, prandaj qëndrimet e mbajtura nga ana jonë kanë bërë që qeveria aktuale greke të tregohet më sësive në politikën e saj ndaj Shqipërisë. Kjo i ka shërbyer forcimit të marrëdhënieve tona me Greqinë.

Një gjë e tillë nuk ngjet në Jugosllavi. Atje titistët i kanë vënë nën këmbë kosovarët dhe shqiptarët me

---

1. Në mitingun e Grapshit, në datën 22 mars 1978.

banim në Maqedoni e në Mal të Zi, i kanë shtypur dhe vazhdojnë t'i shtypin. Për këto veprime të padrejta është e domosdoshme që vetë shqiptarët e atjeshmë të mos ulin kokën, në mënyrë që organet drejtuese titiste të mos guxojnë të bëjnë të tilla veprime. Shqiptarët e atjeshëm të jenë të sigurt se edhe Shqipëria do të flasë në favor të tyre, do t'i mbështetë.

Karteri sot flet «për të drejtat e njeriut». Për një grua tradhtare shqiptare të arratisur, që ka marrë nënshitetësi të huaj dhe erdhi nga Belgjika në Shqipëri si turiste, e cila u zbulua dhe u arrestua nga ana jonë, bënë bujë shtetet borgjeze, kjo u bë problem ndërkombëtar, kurse për gjakun e derdhur lumë në Nikaragua e në sa e sa vende të tjera të botës as që e çajnë kokën fare. E po mirë atëherë, për një popull të tërë prej afro dy milionësh, që rron nën thundrën jugosllave, ne nuk paskemi të drejtë të flasim? Kemi, bilekimi shumë të drejtë.

Po kthehem përsëri te çështja që në kufi, veç punës politike dhe ideologjike, është e domosdoshme të bëhet një punë e veçantë, të cilën duhet ta shohim në shkallë të gjerë, deri edhe tek edukimi profesional i kufitarëve. Edhe në këtë drejtim Partia duhet të punojë mirë në kufi. Nuk ka pse të dërgojmë komunistë nga gjelkë në pikat dhe postat tona kufitare. Pranë tyre ne kemi organizatat-bazë të Partisë të fshatrave kufitare, kemi organizata rinie, nga radhët e të cilave pranohen elementë të rinj në Parti, prandaj edhe terneni duhet t'i japë kusirit një ndihmë efektive politike, ideologjike dhe informative, përveç punës që organizon Ministria e Punëve të Brendshme, në linjën

e vet, që është një tjetër çështje, pse ka karakter special, të veçantë.

Kisha dhe diçka tjetër lidhur me sa thuhet në relacionin që na jepet nga Ministria e Punëve të Brendshme. Mendoj se nuk është reale ajo që thuhet në relacion se vendet kufitare me vandin tonë i kanë shtuar forcat e tyre në kufi<sup>1</sup>.

*Pikëpamjes së armikut të kamufluar Feçor Shehu se rritjen e forcave të armiqve në kufijtë tanë ai e sheh në kuadrin e manovrave të tyre, shoku Enver Hoxha iu përgjigj:*

Kur bën manovra armiku, mund të të sjellë një divizion të tërë edhe në kufi, po ai sa mbaron manovrën, divizionin e largon menjëherë. Sigurisht këto manovra na bëjnë ne që të jemi vigjilentë gjatë gjithë kohës që zhvillohen ato.

Në materialin që na është dhënë nga ministri i Punëve të Brendshme thuhet se përtej kufirit «në një situatë të tillë bëhen stërvitje të të arratisurve në brczin tonë kufitar»! Që bëhen stërvitje me ta, është e qartë për ne, por ato bëhen një çikë në thëllësi, kurse në relacion thuhet se «bëhen në brczin kufitar».

1. Armiku Feçor Shehu e keqinformonte udhëheqjen e Partisë, me qëllime të caktuara. Ai e bënte këtë për të çorientuar e për të alarmuar dhe këto qëllime i maskonte me pretekstin që «të mbahet ngritur vigjilanca». Kur u kritikua rreptë për këtë, armiku Feçor Shehu përpinqej të justifikohet duke thënë: «Forcat armike nuk janë shtuar, po këtë problem ne e shikojmë në kuadrin e manovrave, në kuadrin e stërvitjeve që bëjnë armiqtë e ndryshëm pranë kuiflave tanë, e jo në kuptimin e rritjes së forcave armike në kufi».

Armiku i jashtëm i ka përgatitur dhe i përgatit të arratisurit. Po ku? Në zona të thella të territorit të vjet dhe në momentin e duhur ai t'i sjell ata brenda natës. Prandaj në asnjë mënyrë dhe për asnjë çast ne nuk duhet të na zërë gjumi, të jemi kurdoherë shumë vigjilentë.

Të gjitha qëndrimet e vendosura politike dhe ideo-logjike, të drejta, të arsyeshme e marksiste-leniniste, që mban Partia jonë ndaj armiqve, duhet të forcojnë entuziazmin e vullnetin për punë të palodhur në drejtim të mbrojtjes, të forcojnë patriotizmin e lartë socialist të njerëzve tanë dhe në realitet kështu ndodh. Në asnjë mënyrë nuk duhet të mendojmë se, duke atakuuar armiqtë me taktilën dhe me strategjinë tonë, këta i kanë lëshuar pendët, i kanë hedhur tej armët. Përkundrazi. Të gjithë duhet ta kuptojmë mirë që armiqtë janë egërsuar më shumë dhe punojnë intensivisht kundër nesh. Sa më fort që i atakojmë ne, aq më shumë përgatiten ata për kundërsulme të fshehta, por edhe për sulme të hapëta në drejtimin tonë.

Prandaj nuk ka vend pör qetësi dhe shkujdesje, pör njëfarë vetëkënaqësie lidhur me ndryshimet në politikën e fqinjëve, që mund të rrjedhin nga drejtësia e vijës sonë. Vija e drejtë e Partisë dhe e Qeverisë sonë nuk mund t'i pëlqejë qeverisë jugosllave, përkundrazi ajo rrit egërsinë kundër nesh. Është tjetër punë se sa manifestohet, si manifestohet tani dhe në ç'kohë do të manifestohet më shumë apo më pak dhe për ç'arsye nuk manifestohet në këtë apo në atë rast kjo armiqësi kaq e egër dhe e thellë e titistëve ndaj nesh. Kjo ka shumë arsyе. Por, po të mendojmë, si disa

njcrëz, që «ne jemi të fortë, prandaj armiqtë s'kanë ç'na bëjnë», do të thotë të na zërë gjumi në dafina, gjë që nuk duhet të ngjasë kurrë. Prandaj punonjësit e Partisë, si kudo, edhe në kufi, duhet ta kuptojnë se është e nevojshme të bëhet një punë e dendur politike dhe ideologjike me kufitarët dhe me gjithë punonjësit e tjerë.

Ka sot dy gjëra që ndryshojnë njëra nga tjetra, por që konvergojnë në krijimin e një gjendjeje të favorshme për Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Është qëndrimi patriotik në rritje i shqiptarëve që rrojnë në Jugosllavi, të cilët janë pjesë e pandarë e kombit tonë, si dhe rritja e simpatisë së popullit grek për vendin tonë. Si me popujt e Jugosllavisë, edhe me popullin grek ne duam të jetojmë në miqësi e vëllazëri. Regjimet në këto dy vende fqinje, siç dihet, janë kapitaliste. Por, pa humbur kurrë vigjilencën, ne ndjekim një politikë të drejtë, efikase dhe me rezultate të favorshme për vendin tonë. Në këto situata, që janë koniunkturale për jugosllavët dhe për grekët, nga ana jonë duhet të mbahen qëndrime të menduara mirë, që të përfitojmë sa më shumë nga këto koniunktura që janë krijuar, sidomos me këto dy shtete.

Në Jugosllavi dihet që ndodhet një pjesë e kombit tonë. Atje ka vështirësi të mëdha dhe shtypja është e egër, pasi revizionistët jugosllavë hiqen si marksistë-lininistë, maskohen me këtë perde në shtypjen që u bëjnë shqiptarëve të atjeshëm, që jetojnë në një zgjedhë të dyfishtë.

Udhëheqja kosovare në Jugosllavi, që është pro Titos, përhap parullën, sipas së cilës «në qoftë se ne kemi fituar disa të drejta dhe kemi arritur të realizoj-

më disa përmirësime, bile edhe me kushtetutë, këto i kemi bërë në sajë të Titos, prandaj ju shqiptarë, kuptojeni situatën tonë, kuptojeni situatën e vëllezërve tuaj, mos e atakoni Titon, mos e sulmoni Jugosllavinë, sepse po na prishni punë». Këta palo udhëheqës, që shprehin të tilla kërkesa ndaj nesh, janë shërbëtorë të Titos. Ata nuk kuptojnë se është qëndrimi ynë ai që ka luajtur dhe luan një rol të madh në politikën që Jugosllavia titiste detyrohet të ndjekë ndaj popullsisë shqiptare dhe këtë rol ne do ta luajmë edhe në të ardhmen. Politika e drejtë e shtetit socialist shqiptar do të vazhdojë t'u qëndrojë si shpata e Damokleut titistëve jugosllavë, sepse këta janë kapitalistë dhe nuk mund të ndjekin dhe nuk ndjekin ndaj pakicave kombëtare një politikë tjetër, veç politikës shtypëse, skllavëruese, shfrytëzuese e diskriminuese. Kështu kanë vepruar dhe veprojnë ata ndaj popullsisë shqiptare atje. Kurse ne, si vend socialist që jemi, mbrojmë lirinë, demokracinë, sovranitetin e vërtetë, mbrojmë, në të njëjtën kohë, edhe vëllezërit tanë, popullin shqiptar që jeton në Jugosllavi. Natyrisht, këtë e bëjmë në bazë të parimeve marksiste-leniniste.

Kosovarët dhe gjithë shqiptarët e tjerë që jetojnë në Jugosllavi duhet ta kuptojnë se Shqipëria, me qëndrimet që mban, i ndihmon dhe nuk i dobëson ata. Politika e Shqipërisë dobëson vetëm ata që luajnë kartën e Titos dhe jo interesat e shqiptarëve të Jugosllavisë. Rritja e rezistencës së shqiptarëve atje i dedikohet edhe politikës që ndjek Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë. Çështja e kombësive, në këtë situatë të vështirë që po kalon Jugosllavia dhe në

situata akoma më të vështira që do të kalojë ajo në të ardhmen, do të luajë një rol të madh në instabilitetin e këtij vendi. Duan s'duan shovinistët titistë, kjo është diçka objektive. Vetëm socializmi, dhe asnje rend tjetër politiko-shoqëror, i zgjidh çështjet nacionale si duhet drejt deri në fund. Në shoqëritë me klasa antagonistë këto çështje qëndrojnë vazhdimisht pa u zgjidhur, ato mbeten plagë të shëmtuara të përhershme në regjimet reaksionare, siç është edhe ai i Jugosllavisë revizioniste.

Në situatat aktuale është e vërtetë dhe duhet të njohim se nuk është më si dikur ai popull kosovar, ai popull shqiptar që jeton në trojet e veta në Kosovë, në Maqedoni e në Mal të Zi. Sot ky popull është ngriitur politikisht, e kupton më drejt shtypjen që i bëhet, kupton edhe mënyrat se si duhet të veprojë. Këtë nuk ua themi ne, ata janë vetë në gjendje të gjejnë rrugët e shpëtimit dhe të flakin tej gjithë renegatët shqiptarë që luajnë kartën e Titos, që bëjnë ato që u dikton ai. Askush nga ne këtej nuk mund t'u thotë shqiptarëve që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi bëni kështu e bëni ashtu, ata e njojin vetë situatën dhe dinë e do 13 dinë si të veprojnë. Por edhe ne mund dhe duhet t'i ndihmojmë në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Me këtë ne bëjmë detyrën, por edhe vigjilentë duhet të jemi, sepse në Kosovë ka njerëz që janë në shërbim të titizmit dhe ndonjë i tillë mund të vijë edhe te ne, gjoja për t'u takuar me të asfërmit e vet. Prandaj Partia, në mënyrë të veçantë në rrethet kufitare, duhet të jetë zgjuar, të veprojë me shkathësi, të mos jclë as liberalë, as sektare.

*Duke folur për emigrantët shqiptarë që vijnë si mysafirë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Vëllai apo motra, djali apo vajza, fjala vjen, jetojnë larg atdheut, po mund t'i harrojmë ne këta njerëz? Në qoftë se i harrojmë, s'është e drejtë. Atëherë ç'na lidh ne me një element përparimtar nga Hondurasi, me të cilin tregohemi internacionalistë, kur ndaj njeriut tonë të afërt të një gjaku e të një gjuhe mbajmë një qëndrim të tillë? Këtu, në Shqipëri, na vijnë shokë e miq nga të katër anët e botës dhe ne i shëtitim të shikojnë Shqipërinë. Atëherë si të mos takoheni me vëllezërit dhe me motrat tona, për të cilët kemi të dhëna se qëndrojnë mirë? Vallë bëjmë mirë, siç ndodh në ndonjë rast, që të mos i pranojmë të vijnë, ose kur vijnë të mos i takojmë? Jo. Personi që u përmend këtu, që u përpoq t'i shmangej takimit me motrën e vet të ardhur nga emigracioni, mund të jetë njeri i mirë, por opinioni i formuar keq për këtë çështje ka ndikuar negativisht tek ai. Mirëpo të veprohet ashtu siç veproi ai, nuk është aspak e drejtë. Kjo çështje, më duket mua, duhet parë me kujdes, se nuk është me vijën e Partisë opinioni i krijuar te disa elementë që njerëzit tanë të mos takohen me të afërmimit, të cilët u vijnë nga Jugosllavia etj. Ka disa elementë në popull që thonë: «Mos e prit këtë apo atë, se do të të ndjekë Sigurimi». Në asnjë mënyrë nuk i ndodh gjë nga ana e Sigurimit të Shtetit një njeriu i cili pret vëllanë apo motrën që i vjen nga përtejkufirit ose nga emigracioni. Sigurimi, natyriskt, do të bëjë punën e vet, po kundër atyre që vijnë dhe veprojnë me qëllime të këqija. Pse do të lörë Sigurimi ndonjë nga

këta elementë që vijnë sa për formën të takohen me njerëzit e vet, kur në fakt shihet se përpinqen «të lihadhisin»?

Në përgjithësi mund të themi që as patriotizmi, as burrëria, as besnikëria ndaj Shqipërisë nuk kanë humbur te kosovarët dhe te gjithë shqiptarët që jetojnë në trojet e veta në Jugosllavi. Titistët janë detyruar t'i njojin këto cilësi të tyre.

Të gjitha organizatat e Partisë në rrethet kufitare, por edhe Ministria e Punëve të Brendshme, mendojnë, këto që thashë, të cilat më duket se në përgjithësi janë parimore, duhet t'i kenë parasysh në punën e tyre. Këto kisha dëshirë të vija në dukje me këtë rast, shokë.

*Botuar për herë të parë,  
me shkurttime, në librin:  
Enver Hoxha, «Gjithmonë  
vigjilencë» (Përbledhje  
veprash), vell. 2, f. 522*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga procesverbalit i mbledhjes  
së Sekretariatit të KQ të  
PPSH që gjendet në AQP*

# **PROJEKTET E STUDIMET KANE VLERË KUR NDIQET EDHE ZBATIMI I TYRE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**27 shtator 1978**

Kalojmë në pikën e dytë të rendet të ditës të kësaj mbledhjeje. Për këtë problem na janë paraqitur materiale nga komitetet e Partisë të rretheve të Tiranës, të Lushnjës dhe të Fierit.

Shoh se këtu kanë ardhur edhe shokë nga këto rrethe. Tirana ka më shumë përsaqësues se, në fakt, edhe institute ka më shumë.

Edhe shokët e Tiranës, siç thashë, na kanë paraqitur një raport për këtë problem, por, në të ka shumë fjalë të përgjithshme dhe shumë gjëra nuk trajtohen në mënyrë konkrete. Prandaj, do të jetë mirë, që këta shokë të na japin një pasqyrë të shkurtër, por konkre-

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për përvojën e situar dhe për masat që duhen marrë për të rritur rolin udhëheqës të organizatave të Partisë në institucionet kërkimore-shkencore në zhvillimin e shkencës.

te, të zhvillimeve shkencore, të lidhura ngushtë me problemet jetike të vendit në bazë të planeve tona.

Mos ua preva gjë hovin me këtë që thashë? Megjithëse nuk e besoj një gjë të tillë, se një kritikë të vogël bëra, mos ma vini re! Unë e di që këto institucionë kërkimore-shkencore kanë punuar dhe punojnë shumë pür zgjidhjen e një varg problemesh të rëndësishme që ka diktuar zhvillimi ynë.

Ndërsa në materialin që kanë paraqitur shokët e Lushnjës, çështjet trajtohen më konkretisht. Ata thonë shkurt se çfarë kanë bërë, ç'rezultate kanë pasur dhe cilat kanë qenë të metat e vështirësitet e punës shkencore të Institutit të Kërkimeve Bujqësore. Mundet që ata e kanë pasur më të lchtë, se vetëm ky institut është atje, kurse këtu në kryeqytet janë shumë. Kështu që shokët e Tiranës, kur kanë përgatitur raportin, nuk kanë ditur nga ç'institut të fillojnë dhe cilin problem të kapin e të trajtojnë aty.

Por, po të kishit pyetur një çikë shokun Aleks [Buda]<sup>1</sup>, ai do t'ju orientonte mirë, do t'ju mësonte se si të përgatitnit një material sa më të qartë e sa më konkret. Them kështu sepse shoku Aleks, kur diskuton, i shpjegon shumë mirë problemet, e kap demin nga bri-rët, siç i thonë një fjale. Në këtë mënyrë duhet vepruar që ne të kemi një ide sa më të plotë të zhvillimit të shkencës në këto institute.

Tani, ju, shokë specialistë, punonjës të këtyre instituteve shkencore, ngrihuni e diskutoni pa kurrsarë druajtjeje, sepse ne nuk i njohim aq thellë sa ju këto

---

1. Kryetar i Akademisë së Shkencave të RPSSH.

probleme, prandaj, me diskutimet tuaja, do të na ndihmoni shumë. Dhe, që të flitni për këto probleme, besoj se ju nuk e keni aq të vështirë, siç mund ta kishte, për shembull, ndonjëri prej nesh për të folur për gjecologjinë. Natyrisht, diçka në mënyrë të përgjithshme dhe ne mund të themi, kurse ju mund të flitni më me kompetencë për problemet e kësaj apo të asaj degë të shkencës, bile, të na jepni edhe mendime se çfarë duhet bërë në të ardhmen për një punë akoma më të mirë.

Kisha edhe një vërejtje të vogël lidhur me këtë material. Është e drejtë të thuhet që organizata-bazë e Partisë, ka përgjegjësinë e saj për mbarëvajtjen e gjithë punës. Por, atje është edhe një shtab i tërë, një bürthamë shkencore që përgjigjet nga ana shtetërore për këto punë. Mirëpo, në material ai nuk zihet fare në gojë. Shokët e Tiranës, që kanë përgatitur raportin, mund të jenë nisur nga mendimi që, meqenëse problemi do të analizohet në Sekretariat të Komitetit Qendror të Partisë, atëherë të themi se organizata-bazë nuk ka punuar mirë në këto institute që puna shkencore të ecte më mirë. Sigurisht, ajo nuk e ka bërë siç duhet detyrën e saj, përderisa ka mosrealizime; por problemi duhet parë se si është punuar edhe nga ana shtetërore. Ç'vështirësi ka? Edhe për këtë anë duam të dimë ne.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Mund të flasë shoku Lazar Xhajanka, i cili ka mjaft eksperiencë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ku punon tani, shoku Lazar Xhajanka?

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Drejtor në Institutin e Studimeve dhe Projektimeve Mekanike.

**SHOKU ENVER HOXHA:** (*Duke iu drejtuar Lazar Xhajankës.*) Më duket se më përpara ke punuar në kombinatin e tekstileve «Stalin»?!

**SHOKU LLAZAR XHAJANKA:** Po, shoku Enver, aty kam qenë. Për këtë mbledhje kam përgatitur diçka.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe pa u përgatitur me shkrimi, ti mund të flasësh se i njeh mirë problemet. Pra, dhe pa kartë ti je në gjendje të diskutosh. Për punën tënde kemi dëgjuar fjalë të mira.

*Pasi foli shoku Lazar Xhajanka për punën e institutit që drejton, shoku Enver Hoxha tha:*

Deshalbe të pyes edhe për diçka tjeter: në projektimet e makinave e pajisjeve që keni kryer, keni bërë modifikime? Kuptohet, fjalë është për përmirësimë të standardeve të vjetra, për të ngritur efikasitetin e makinës.

**SHOKU LLAZAR XHAJANKA:** Po, kemi bërë dhe nga kjo ekonomia ka pasur një leverdi të madhe.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ja, le të shikojmë konkretisht projektet e makinave që do të përdoren përzgjerimin e Fabrikës së Sheqerit në Maliq, se këto të tjerat nuk i keni mbaruar akoma. A mund të më thuash ti se çfarë përmirësimë e ndryshimesh do të bëhen në këtë pjesë të re që po ndërtojmë në Fabrikën e Sheqerit, në krahasim me të vjetërën? Nuk dua të m'i thuash në detaje, por në përgjithësi, në ç'drejtime do të ketë përmirësimë?

**SHOKU LLAZAR XHAJANKA:** Kemi bërë përmirësimë, për shembull, në impiantin e prodhimit të gëlqeres, duke marrë parasysh cilësitetë më të mira të impianteve të tjera. Dhe kështu, si të thuash, kemi bërë një

impiant tonin, i cili ka rendiment shumë më të madh dhe një tregues termik shumë më të leverdishëm.

**SHOKU ENVER HOXHA:** A studioni vazhdimisht materiale me të dhëna të reja të shkencës? Pra, a e keni ndjekur ju zhvillimin e shkencës e të teknikës, nëpërmjet njohjes e studimit të revistave të ndryshme shkencore, për çdo gjë që ka lidhje me makineritë, me standardet e tyre, me rendimentet dhe me lëndët e para që përdorin ato? Ju pyes për këtë, se, siç dihet, shkenca ecën përpara e pasurohet me të dhëna të reja, më të avancuara se ato të mëparshmet. Kështu, për shembull, një vegël që më përpara, fjala vjen, bëhej me bimetal, që kushton shtrenjtë, tani mund të bëhet me një aliazh shumë më të lirë dhe që është po aq rezistent.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Azhurnoheni ju me literaturë të re, lidhur me këtë çështje?

**SHOKU LLAZAR XHAJANKA:** Po, vazhdimisht. Çdo projektim e studim e kryejmë duke u mbështetur në literaturë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duke u nisur nga eksperiencia juaj dhe nga eksperiencia jote personale, shoku Lazar, a mund të na japësh ndonjë mendim konkret se si mund të drejtohet industria mekanike që kemi ne? Domethënë, që e tërë kjo të shihet si një sistem i plotë ku të kemi mundësi për të ushtruar një kontroll rigoroz të kryerjes së detyrave. Pra, a është i mjaftueshëm dhe me efektivitet ky drejtim që kemi? Vetë praktika e përditshme ju ka mësuar, si të mirat, ashtu edhe vështirësitë që ekzistojnë në drejtimin aktual të bazës mekanike në vendin tonë. Që industria mekanike ka rëndësi të madhe për zhvillimin e ekonomisë, kjo

dihet; por a është menduar se kjo industri, sidomos në vitet e ardhshme do të përbëjë një potencial shumë më të madh në ekonominë tonë? Unë kam dëgjuar që ju i keni thënë mendiniet tuaja në ministri, por ajo ndoshta nuk ua ka vënë veshin atyre, për arsyen subjektive ose objektive. Pastaj, ka dhe mungesa organizimi etj., etj.

*SHOKU LLAZAR XHAJANKA:* Disa sektorë, siç mund të janë, për shembull, uzinat mekanike që kanë dikasteret e tjera, mund të përqendrohen në një dorë, se kështu përvoja mund të përhapet më mirë, problemet mund të zgjidhen më drejt edhe specializimi bëhet më lehtë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po të jetë fjala për të porositur një gjilpërë apo një gozhdë nga importi, gati janë ata të ministrisë ta bëjnë porosinë. Por, po t'u themi: «Hajdeni tani dhe grumbulloni këto baza mekanike që janë këtu e atje, i përqendroni dhe bëni kërkесат e planit», jo, nuk e duan një gjë të tillë. Pra, këtu ka qëndrime kontradiktore. Këto probleme nuk shikohen me atë sy që duhet të shikohen në këto situata.

Duhet mbajtur parasysh edhe kjo: në shumë sektorë të industrisë mekanike mendoj se duhet bërë patjetër përqendrimi i disa bazave. Por, dhe këto, duhet të janë nën drejtimin e ministrisë.

Mendoni për këto gjëra, shokë, Juve, specialistëve, unë ju rekomandoj që për të gjitha çështjet që i përkasin sektorit të gjithsecilit, të çdo natyre qofshin ato, të diskutoni mbarë e mbrapsht. Aktualisht, bie fjala, çështë vendosur të ecet kështu dhe vazhdohet të punohet në atë mënyrë. Por, gjatë punës ju mund të

nxirrni disa konkluzione të reja. I diskutoni ato dhe pastaj jepni mendime. Të mos niseni nga parimi që për çdo gjë do të vendosë ministria. Ju duhet ta dini se shokët e dikasterit do të dëgjojnë edhe çka do t'u thoni ju, pasi mendimet tuaja kanë dalë nga një diskutim i shëndoshë politik, teknik e organizativ.

Prandaj, ju të vrisni mendjen e të punoni jo vetëm për projektimin e makinerive e të pajisjeve, por edhe kur të vihen ato në punë të shikoni se si shfrytëzohen, sepse në këtë drejtim mund të ketë edhe pengesa. Atëherë duhet menduar për një organizim të ri të punës dhe, pasi të studiohet e të diskutohet për këtë, të bëhen edhe propozime konkrete. Një gjë të tillë ju ndoshta e bëni, nuk them se jo; megjithatë ka vend pér një organizim akoma më të mirë. Pér këto duhet marrë mendimi i gjithë specialistëve dhe i masës së gjerë të punonjësve, se nuk mundet që një apo edhe dy-tre veta të gjykojnë e të vendosin pérherë drejt.

**SHOKU LLAZAR XHAJANKA:** Kjo është shumë e nevojshme të bëhet edhe pér faktin se kështu siç është vepruar deri tani, që çdo dikaster të punojë pér llogari të vet, projektet dhe studimet nuk kryhen në mënyrë racionale. Mjafton të përmend shembullin e zgjerimit të uzinës «Tirana» pér prodhimin e blçikletave: po të bëhej studimi jo vetëm nga ky dikaster, por në një shkallë më të gjerë, do të porositeshin makineri të tjera, me rendiment më të lartë e që do të jepnin rezultate më të mira.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Atëherë, pse t'i lejojmë këto gjëra? Pse dashka kjo apo ajo ministri që këto t'i bëjë vetëm shtabi i saj?! Jo, kështu nuk duhet

vepruar! Përderisa mund të bëheshin porosi për makineri të tjera, më të lira dhe më rentabël, pse të mos bëheshin, kur dhe puna nuk pengohej? Unë nuk mund ta kuptoj dot përsë veprohet në këtë mënyrë, duke e parë ngushtë nga ana dikasteriale: që kjo çështje është në kompetencën time e ajo është në kompetencën tën-de. Mirë, kompetencat vërtet të janë dhënë, por për të dalë puna sa më e pjkur, është mirë të shkëmbesh mendime e të koordinosh veprimet dhe me të tjerët e në radhë të parë me specialistët. Pasi merren mendimet e tyre s'ka asgjë të keqë që të konsultohesh edhe me specjalistët e dikastereve të tjera, sepse edhe ata kanë se ç'të thonë për këtë çështje. Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një konkluzion i përbashkët e i pjkur për të blerë, për shembull, makina më të lira e më rentabël, fjala vjen, për prodhimin e biçikletave që përmende ti. Këto gjëra neve nuk duhet të na kalojnë më, sepse tani çdo gjë e bëjmë me forcat tona. Kjo të kuptohet në tërë gjerësinë e thellësinë e saj. Pra, kur japim një mendim të kemi mirë parasysh edhe situatën.

**SHOKU LLAZAR XHAJANKA:** Në Kryeministri është një komision qeveritar që merret kryesisht me problemet e pjesëve të ndërrimit dhe me kooperimin, po si problem të veçantë, këtë çështje, deri më sot nuk e kemi parë. Këtë e them se jam edhe unë anëtar i këtij komisioni.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po atëherë, çfarë bëni konkretisht ju, anëtarët e këtij komisioni qeveritar për problemin e pjesëve të ndërrimit dhe për kooperimin, kur dihet se këto janë çështje me rëndësi kaq të ma-

dhe?! Pse nuk e keni marrë në analizë, pse nuk e keni studiuar dhe pastaj të dilnit edhe me një vendim qeveric, i cili mund t'u dërgohej të gjitha dikastereve përkatëse që u duhet medoemos të kooperohen ose pasi të studiohej mirë gjendja, të merrej një vendim që të «rrafshoheshin» menjëherë të gjitha ato uzinat e vogla mekanike që prodhojnë me rendimente të ulëta, me çmime të larta e që nuk i kontrollon dot etj., dhe të përqendrohen në një dorë të vetme? Përse nuk vendoiset që këto pjesë të bëhen në këtë uzinë; disa pjesë në një uzinë tjetër e kështu me radhë? Pra, pse nuk merreni me studime të tilla dhe të dilni edhe me vendime, kur është e nevojshme? Po të veprohej kështu, ministritë apo edhe ndërmarrjet, natyrisht që do ta planifikonin edhe kooperimin.

*Pasi diskutuan edhe pjesëmarrësit e tjera në këtë mbledhje për punën shkencore në sektorët e bujqësisë, të gjeologjisë e të naftës, shoku Enver Hoxha tha:*

Falënderojmë shokët diskutantë për këtë pasqyrë që na dhanë mbi punën që bëhet në institucionet kërkimore-shkencore. Në këtë mënyrë ata na pasuruan njohuritë rreth çështjes që morëm në analizë në këtë mbledhje të Sekretariatit.

Për organizimin e për drejtimin sa më mirë të vepritarisë shkencore, ju shokë, që punoni në këto institute, duhet të thelloheni më shumë, të zgjeroni njohuritë teorike dhe të ndiqni zbatimin praktik të projekteve e të studimeve që bëni. Për këtë të mbani lidhje të ngushta me zhvillimin botëror progresiv të shkencës e me Akademinë tonë të Shkencave, të kërkoni ndihmën e shokëve të Akademisë dhe të mobilizoni

mirë masat punonjëse të instituteve dhe të ndërmarrjeve. Po ritheksoj edhe një herë atë që na porosit vazhdimisht Partia: të nxitni iniciativat, të bëni propozime e sugjerime dhe, kur ato janë të drejta, të ngulni këmbë për vënien e tyre në jetë; t'i doni dhe t'i respektoni drejtuesit, por edhe ata t'ju respektojnë ju; midis jush, në diskutimet për problemet e ndryshme, të ekzistojë një bashkëpunim i ngushtë dhe një frysme shoqërore për të mirën dhe interesin e përbashkët të atdheut dhe të ndërtimit të socializmit. Të mos harrojmë se ne ndërtojmë socializmin në kushte të vështira, tërësisht me forcat tona. Në rast se ne realizojmë planet dhe studimet që kemi në duar, perspektiva jonë është e qartë, mundësitet për ndërtimin e socializmit me forcat tona janë të mëdha, vetëm duhet punuar.

Prandaj, ju duhet ta konsideroni veten tuaj me të vërtetë në postin drejtues, post që ka përgjegjësi jo vetëm për mbarëvajtjen e gjithë punës shkencore, por edhe në zbatim. Se ju jeni specialistë, jeni kompetentë për këto punë. Kështu që ju do të dini t'i shpjegoni avantazhet e këtij apo atij projekti dhe do të bindni edhe të tjerët për leverdinë e zbatimit të tij. Pastaj edhe të tjerët do të gjykojnë nëse ju e keni drejt ose jo, nëse janë mundësitet etj., etj. Këtë përgjegjësi, këtë shqetësim për punën duhet ta kenë të gjithë shokët.

*Botohet për herë të parë, sipas tekstit të nxjerrë nga proces-verbal i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

# **SI I SHIKOJNË DISA PARTI KOMUNISTE TË AMERIKËS LATINE GABIMET DII FAJET E MAO CE DUNIT**

**Shënim**

**29 shtator 1978**

Po konstatojmë se midis disa partive komuniste, marksiste-leniniste, të vendeve të Amerikës Latine disa probleme aktuale të komunizmit ndërkombe të, veçanërisht për sa i përket deviacionit revizionist kinez, ka që i kuptojnë, po ka edhe që nuk i kuptojnë.

Se ç'është udhëheqja e sotme kineze, pas vdekjes së Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait, ato e vlerësojnë drejt. Domethënë ato po e shohin se klika e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit e kanë tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe po e çojnë Kinën drejt një vendi revizionist, kapitalist, po e bëjnë një superfuqi social-imperialiste. Me fjalë të tjera mjaft nga këto parti e dënojnë qëndrimin aktual të Kinës së sotme të Hua Kuo Fenit e të Ten Hsiao Pinit. Kjo do të thotë se historinë e Kinës ose marksizëm-leninizmin në këtë vend ata e ndajnë në dy: para vdekjes së Çu En Lait dhe të Mao Ce Dunit dhe pas vdekjes së tyre. Para vdekjes së Mao Ce Dunit dhe të Çu En Lait Kina, sipas tyre, ka

qenë një vend socialist, Mao Ce Duni ka qenë një marksist-leninist dhe Partia Komuniste e Kinës një parti marksiste-leniniste, kurse pas vdekjes së tyre, përkëto parti, udhëheqja e re që mori fuqinë në dorë në Kinë është një udhëheqje renegate, revisioniste, që ka devijuar nga marksizëm-leninizmi. Prandaj ato e dënojnë gjithë veprimtarinë politike, ekonomike dhe ushtarake të Kinës së sotme dhe veçanërisht teorinë e «tri botëve». Për këtë teori, si edhe për problemet e tjera, po veçanërisht për këtë, këto parti janë plotësisht dakord me Partinë tonë, meqë kjo e atakoi për herë të parë këtë teori antimarksiste. Mund të themi pra, se luftën kundër kësaj teorie deri diku ato e kanë kuptuar dhe këtë teori po e luftojnë.

Por këto parti nuk thelohen, ose edhe mund të mos kenë sa duhet të dhëna për t'u thelluar më shumë dhe për të gjetur origjinat e vërteta të këtij devijimi antimarksist të Partisë Komuniste të Kinës, prandaj periudhën e sotme të tradhtisë e presin si me thikë, sikur kjo ka lindur brenda ditës dhe pa pasur asnjë burim të mëparshëm. Këtu qëndron gabimi, ose si me thënë mosthellimi nga ana e tyre. Kjo ose merret lehtë, ose ato nuk duan t'i atakojnë Partinë Komuniste të Kinës dhe Mao Ce Dunin për gabimet që ky ka bërë dhe që kanë sjellë pasojat e sotme.

Siq e kam thënë edhe herët e tjera, një taktikë të këtillë ndjek edhe borgjezia kapitaliste, e cila, përtë luftuar marksizëm-leninizmin, mbron ata persona që janë quajtur ose janë hequr e njojur si marksistë-leninistë dhe kanë fituar njëfarë fame. Në realitet koha vërtetoi se Mao Ce Duni dhe Çu En Lai nuk

ishin të tillë, por vetëm revolucionarë përparimtarë, jo marksistë-leninistë. Borgjezisë kapitaliste i intereson që këta persona të vazhdojnë të quhen marksistë-leninistë dhe komunistë. Ajo mbështetet në pseudoteorinë e këtyre të ashtuquajturve marksistë-leninistë, domethënë mbështetet në një teori që s'është marksiste-leniniste. Në këtë mes, në rast se marksistë-leninistët nuk thellohen në problemet dhe nuk i shohin me syrin klasor marksist-leninist këto dhe evenimentet, atëherë fiton kauza e kapitalizmit.

Kjo ngjet, pra, për sa i përket çështjes së Partisë Komuniste të Kinës dhe personalisht të Mao Ce Dunit.

Udhëheqësit e këtyre partive bëjnë disa krahasime mekanike me hrushovizmin dhe me luftën që Hrushovi i bëri Stalinit dhe e barazojnë këtë situatë me atë të Kinës. Kështu, sipas tyre, Mao Ce Duni ka qenë një marksist-leninist, i cili sot sulmohet nga banda e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit që nuk janë përvçëse revizionistë si hrushovianët. Pra Mao Ce Duni na qenka një marksist-leninist si Stalini, kurse Hua Kuo Feni me Ten Hsiao Pinin janë revizionistë si Hrushovi.

Në qoftë se bëhet një paralelizëm i tillë shumë i gabuar dhe antimarksist, atëherë është e pamundur t'i shohësh ngjarjet në prizmin e marksizëm-leninizmit e të dialektikës marksiste-leniniste. Stalini ka qenë një marksist-leninist dhe nuk ka gabuar as në teori, as në praktikë. Ai ka mbrojtur teorinë leniniste për partinë, për ndërtimin e socializmit, për diktaturën e proletariatit, për luftën e klasave dhe për zbatimin e normave marksiste-leniniste në parti. Në bazë të leninizmit ai nuk lejoi që në parti të mbretëronin fraksionet dhe

krijoi unitetin parti-popull. Në kohën e tij në Bashkimin Sovjetik ekzistonte diktatura e proletariatit dhe ishte në fuqi klasa punëtore në aleancë me kolkozianët. Kurse në Kinë punët nuk qëndrojnë kështu. Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist. Ai ka qenë një demokrat borgjez përparimtar revolucionar që udhëhoqi luftën e çlirimit, bëri disa reforma, por dhe këto mbetën në mes të rrugës. Maoja, pra, filloi të zbatonte disa reforma për të ecur në rrugën drejt socializmit, por rruga që ndoqi ai nuk çonte në ndërtimin e vërtetë të socializmit. Ajo ishte rruga e një «demokracie të re», siç e quajti ai. Kjo ndodhi për arsyen se Mao Ce Duni nuk e shikonte partinë e tij si një parti marksiste-leniniste, nuk e ndërttoi atë në bazë të teorisë marksiste-leniniste, në parti nuk ekzistonin normat leniniste. Maoja predikonte se në partinë e tij ekzistonin dy vija që ishin në luftë të vazhdueshme me njëra-tjetër; predikonte se revolucioni nuk do të merrte fund kurrë, as për 10 mijë vjet. Në çdo periudhë, që bile ai e përcaktonte me vite, në 7 ose në 8 vjet një herë, do të kishte, sipas tij, revolucion, pastaj kundërrevolucion dhe kështu pa mbarim.

Megjithëkëtë, udhëheqësit e disa partive të vendeve të Amerikës Latine njohin disa gabime të Mao Ce Dunit, por përciptazi dhe nuk thellohen për origjinën e tyre. Për shembull, ata thonë se Mao Ce Duni ka bërë gabim që priti Niksonin dhe këtë e quajnë si një pritje thjesht kortezie dhe nuk thellohen të gjejnë se pritja e Niksonit është ndërrimi i një strategjie ose vazhdimi me një forcë më të madhe i strategjisë së Mao

Ce Dunit dhe të Partisë Komuniste të Kinës drejt afri-  
mit me imperializmin amerikan.

Pra Mao Ce Duni dhe Çu En Lai nuk e pritën Niksonin, si me thënë, sa për ta pritur, por për të lidhur një aleancë të ngushtë me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror, me synimin e ndërtimit të Kinës me ndihmën e imperializmit amerikan dhe për të përgatitur një luftë kundër socialimperializmit sovjetik tok me imperializmin, me kundërrevolucionarët dhe me imperialistët e tjera.

Për sa u përket «botës së tretë» dhe aleancës së kësaj bote me dy «botët» e tjera, pra teorisë së «tri botëve», udhëheqësit e disa partive të vendeve të Amerikës Latine gjykojnë pa u thelluar sa duhet se nuk është Mao Ce Duni që e ka predikuar këtë teori, por Ten Hsiao Pini. Në qoftë se pranohet që Mao Ce Duni ka bërë gabim që ka pritur Niksonin dhe nuk thellohen arsyet pse e priti atë, ngjarje kjo që solli pasojat e mëvonshme, atëherë mund të thuhet që teoria e «tri botëve» është e të tjerëve dhe jo e Maos. Por, në fakt, kjo teori është e Maos, jo vetëm sepse vetë ky i ka predikuar këtë teori dhe këtë aleancë, por pritja e Niksonit dhe marrëveshja e arritur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë prova që vërtetojnë se kjo ishte teoria e Mao Ce Dunit.

Çështje tjetër: udhëheqësit e këtyre partive dënojnë ekzistencën e dy vijave në Partinë Komuniste të Kinës. Por, derisa këta e dënojnë ekzistencën e këtyre dy vijave në parti atëherë duhet t'i fuqen thellë kësaj çështjeje dhe t'i gjenden rrënjet se ç'do të thotë të lejosh dy vija në parti. Por këtu nuk është çështja vetëm

e dy vijave. Këtu është çështja e shumë vijave, e «shumë luleve», e «shumë shkollave» që Mao Ce Duni ka pasë predikuar të lulëzonin; është çështja e pluralizmit të partive dhe e kompetencave të barabarta të partive të borgjezisë me partinë komuniste në pushtet, pas çlirimt të Kinës.

Të gjitha këto q'vërtetojnë? Ato vërtetojnë se Mao Ce Duni nuk ndiqte rrugën marksiste-leniniste në ndërtimin e partisë, nuk ndiqte vijën e proletariatit. Pra në Kinë nuk ishte në fuqi proletariati, partia e tij, por ishin përfaqësues të shumë partive që përfaqësonin klasa dhe shtresa të ndryshme. Kështu problemi i fshatarësisë në pushtet dhe në udhëheqje nuk është një fjalë boshe, por është një teori e tërë që ka mbrojtur dhe ka zbatuar Mao Ce Duni gjatë gjithë jetës së tij, kurse proletariati për Maon ka qenë aleati i fshatarësisë. Pra, në qoftë se analizohen deri në fund këto çështje, del se Mao Ce Duni nuk ka qenë një marksist-leninist, po një demokrat borgjez përparimtar.

Shokët e partive të disa vendeve të Amerikës Latine thonë se Mao Ce Duni ka gabuar që caktoi Lin Biaon si zëvendësin e tij dhe që e vuri këtë edhe në statutin e partisë. Domethënë, ata pranojnë se ky ishte një gabim teorik dhe organizativ, që nuk përputhet me demokracinë proletare të një partie komuniste. Atëherë ky caktim i Lin Biaos si zëvendës i Mao Ce Dunit prej këtij vetë shpreh një botëkuptim të tërë; ai pasqyron një botëkuptim të veçantë për normat e partisë, për demokracinë proletare, pasqyron se çfarë konsiderate ka ai për partinë e proletarëve. Të caktosh zëvendësin e partisë, se kështu ta dashka qej-

fi, kjo nuk është një normë marksiste-lcniniste dhe pikërisht këtë duhet ta thellojnë shokët e disa partive marksiste-leniniste të vendeve të Amerikës Latine dhe jo vetëm të thonë që ky ishte një gabim.

Në këtë mënyrë ata numërojnë një sërë gabimesh, por, kur e bëjnë këtë nuk thellohen. Kjo do të thotë se ata ose nuk kanë atë logjikë të fortë marksiste-leniniste që t'u venë çështjeve deri në fund, ose nuk janë të ngritur teorikisht, ose me ndërgjegje nuk duan të thellohen. Natyrisht këtë ne do ta shohim gjatë veprimtarisë së mëtejshme të tyre, po kur i pyet ata përsë është Mao Ce Duni marksist-leninist, të përgjigjen: «Eshtë märksist-leninist për arsy se ndihmoi në çlirim e popujve të botës» e të tjera gjëra të tillë, ndërsa, në fakt, nuk ishte Mao Ce Duni që ka ndihmuar në çlirim e popujve të botës. Natyrisht, lufta e pollit kinez ka pasur influencë pozitive në çlirim e popujve, por ideologjia e Mao Ce Dunit dhe teoria e tij nuk e ndihmuani këtë çlirim. Po ta analizojmë çështjen e çlirimt të popujve, do të shohim se influenca politiko-ideologjike e Kinës, për të mos thënë ekonomike ose ushtarake, nuk ka qenë ndonjë ndihmë kushedi se si e se çfarë, për arsy se Mao Ce Duni dhe Partia Komuniste e Kinës nuk kanë qenë kundër imperializmit amerikan.

Një arsy që përdorin këta shokë për të vërtetuar tezën e tyre në favor të Mao Ce Dunit është ajo sipas së cilës ai është autor i pikëpamjes që brenda në revolucionin proletar duhet të vazhdohet revolucioni. Në Kinë kjo pikëpamje nuk shpreh një realitet të shëndoshë marksist-leninist, për arsy se i ashtu-

quajturi Revolucion i Madh Kulturor nuk ishte një revolucion me karakteristikat e një revolucioni klasik kundër borgjezisë që kishte marrë fuqinë. Përkundrazi, Revolucioni Kulturor nuk u udhëhoq nga partia, qoftë edhe ashtu siç ishte kjo parti. Ky revolucion ishte vepra e Mao Ce Dunit dhe e grupit të tij, i cili, duke u mbështetur në autoritetin e Maos, ngriti studentët, rininë në një ecje të pandalshme, me sloganë e me dacibao dhe urdhëroi likuidimin e shtabeve të partisë e të organizatave të masave. Me një fjalë, për interesin e grupit të tij, ai likuidoi të gjithë ata që e pengonin të ecte ashtu siç kishte vendosur. Ata kundër të cilëve Mao Ce Duni ngriti rininë në Revolucionin Kulturor ishin edhe më të djathtë e më reaksionarë se vetë Maoja me grupin e tij.

Prandaj, po të analizohet në një prizëm të shëndoshë Revolucioni Kulturor, në të nuk shihet ndonjë gjë me të vërtetë marksiste-leniniste, po përsëritja e traditës së vjetër kineze e luftës për pushtet nga ana e grupeve të ndryshme, luftë që ka ekzistuar para, gjatë dhe pas luftës nacionalçlirimtare. Pra lufta filloj dhe u vazhdua jo në një rrugë revolucionare marksiste-leniniste, por përkundrazi në kritere puçiste. Një botëkuptim i tillë për revolucionin vazhdoi edhe më vonë, pse prapë për të marrë pushtetin me puç luftuan edhe Ten Hsiao Pini, Hua Kuo Feni e të tjera shokë të tyre që rrëmbyen pushtetin në Kinë. Ata mund të thonë fare lehtë që po ndjekin vijën e Mao Ce Dunit, domethënë se po vazhdojnë revolucionin brenda revolucionit proletar.

Në fakt, në Kinë nuk ekziston rendi proletar, por

një rend demokratiko-borgjez, i cili aktualisht po merr karakter të theksuar kapitalist, që po e shndërron gjithë ekonominë e këtij vendi në një ekonomi kapitaliste. Ndërsa jashtë, duke u bashkuar në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe m.e të gjithë kapitalizmin botëror, Kina lufton për të shuar revolucionin dhe përgatitet për t'i shpallur luftë superfuqisë së dytë, Bashkimit Sovjetik. Qëllimi është që Kina të bëhet një forcë e madhe kapitaliste në botë.

Këtë nuk po e kuptojnë akoma shokët e disa partive komuniste marksiste-leniniste të vendeve të Amrikës Latine. Natyrisht, ne duhet të kemi durim. Të kemi durim do të thotë të mbrojmë pikëpamjet e Partisë sonë për këto çështje dhe të mos bëjmë lëshime; të kemi durim do të thotë gjithashtu të bëjmë përpjekje për t'u argumentuar shokëve të këtyre partive me fakte, me të dhëna, me analiza marksiste-leniniste, se pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre për këto çështje nuk janë të bazuara. Pikëpamje të tillë, që janë të cekta ose sentimentale, mund të lidhen me faktin se këto parti, kur u formuan (sepse ato u formuan në kohën e Revolucionit Kulturor), kanë mbajtur pozita pro Kinës dhe pro Mao Ce Dunit. Po të jetë kështu, atëherë ka mundësi që ato të gjejnë forca e ta kapërcejnë këtë gjendje në mënyrë revolucionare, marksiste-leniniste, ashtu siç e kapërceu Partia jonë.

Edhe Partia jonë për një kohë ka konsideruar se Kina ndërtonte socializmin, se ajo ishte shtylla e revolucionit botëror, se Mao Ce Duni ishte një marksist-leninist i madh. Por, kur ajo pa se këto konsiderata nuk kishin baza, kur pa se në Kinë nuk ndërtohej sò-

cializmi dhe Mao Ce Duni nuk ishte një marksist-leninist, pa lëre i madh, atëherë kërkoj të shpjegohej me ta, të shprehte pikëpamjet e veta. Udhëheqësit kinezë nuk i pranuan takimet me Partinë tonë dhe kishin arsyetë mos i pranonin, sepse do të ndesheshin me ne dhe nuk do të binim dakord. Prandaj edhe ne mbajtëm qëndrimet tona e i kapërcyem këto situata.

Shokët tanë duhet t'i sqarojnë me fakte e argumente shokët e partive motra, në mënyrë që ata të binden se Partia jonë nuk ia imponon kujt pikëpamjet e saj, por këto pikëpamje që ka ajo i mbron. Në të njëjtën kohë Partia jonë është nga ato parti që, kur të tjerët ia argumentojnë se një pikëpamje e dhënë prej saj nuk ka baza, nuk është marksiste-leniniste, ajo, domethënë Partia jonë, është e gatshme, ta njohë dhe ta korrigjojë atë. Por shokët e disa partive të vendeve të Amerikës Latine, për sa u përket Kinës dhe Mao Ce Dunit nuk japid arsyetë të kundërtë që të na vërtetojnë neve se Mao Ce Duni ishte një marksist-leninist i madh, dhe se në Kinë para vdekjes së Maos ndërtohenj socializmi, kurse pas vdekjes së tij ndryshoi gjithë situata. Prandaj ne duhet të vazhdojmë të punojmë me durim me këta shokë, pse armiku imperialist, kapitalist e revisionist lufton me forma të ndryshme kundër socializmit dhe kundër teorisë marksiste-leniniste.

Aktualisht është ngritur një fushatë e madhe kundër Leninit dhe leninizmit dhe kjo ka arsyet e saj. Autorët e kësaj fushate, e konsiderojnë Marksini si filozof të një epoke të vjetër, kurse sot ata pretendojnë se bota ka ndryshuar, domethënë imperializmi është

forcuar, se tash, pra, është epoka e imperializmit të fortë. Mirëpo këtë epokë të imperializmit Lenini e ka analizuar dhe ka treguar rrugët e vërteta se si duhet ta kuptojë atë proletariati dhe si duhet ta luftojë ai imperializmin. Lenini, me mësimet e tij të pavdekshme, na udhëheq në këtë fazë dhe na tregon qartë se si proletariati duhet të ecë në revolucion dhe të rrëzojë pushtetin e kapitalit. Pikërisht për këtë arsyeborgjezia kapitaliste ia ka frikën dhe përpinqet të mbrohet nga Lenini dhe leninizmi, pikërisht për këtë arsyeboftë në programin e revizionistëve modernë të të gjitha rrymave, qoftë në vçprimtarinë e socialdemokracisë ndërkombe, u është shpallur luftë leninizmit dhe Leninit, duke e quajtur teorinë leniniste të revolucionit si një teori të paqenë, si një teori që nuk mund të zbatohet aktualisht.

Disa thonë se ajo u zbatua në Bashkimin Sovjetik në periudhën e paraluftës, ndërsa aktualisht, pas Luftës së Dytë Botërore, bota paska ndryshuar, e, bashkë me të, kanë ndryshuar edhe botëkuptimet e proletariatit dhe se në shoqërinë aktuale janë bërë edhe shumë ndryshime të tjera. Prandaj, thonë ata, duhen gjetur teori dhe forma të reja lufte për të shkuar në socializëm. Dhe një nga këto forma të reja është vë-administrimi jugosllav, janë teoritë e reja që po ndërtojnë revizionistët sovjetikë dhe adeptët e tyre, është maocedunideja dhe teoria e «tri botëve», ose forma dhe mënyra e botëkuptimit dhe e organizimit të pseudosocializmit në Kinë, domethënë qëndrimi në vend, ruajtja e statukuosë dhe e kapitalizmit botëror.

Partia jonë dhe gjithë marksistë-leninistët duhet

të ngrihen në një luftë të ashpër për t'i demaskuar këta renegatë, këta armiq dhe për të mbrojtur teorinë tonë të pavdekshme, marksizëm-leninizmin.

*Marrë nga libri: Enver Hoxha,  
«Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm),  
nr. 11, f. 328*

## PËR MOSREALIZIMET NË BUJQËSI KANË PËRGJEGJËSI TË GJITHË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

7 tetor 1978

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pashë të dhënrat e realizimit të planit të grurit për se cilin rreth. Kjo punë, siç rezulton, nuk ka ecur mirë sidomos në disa rrethe, si Durrësi dhe Lushnja. Por, deficite kanë gjithashtu edhe Kruja, Mati, Saranda, Vlora, Elbasani, Korça etj. Ky është një problem shqetësues për ne. Desha të di se ç'po bëhet në të gjitha këto rrethe pas kësaj gjendjeje, pra ç'po bën Partia atje për ta kapërcyer situatën e krijuar.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Para disa ditësh u bë një aktiv në Fier, për të parë rezultatet e arritura në prodhimin e grurit.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ç'doli nga kjo analizë? Cilat janë shkaqet që kanë ndikuar negativisht në realizimin e planit të grurit? Këto shkaqe kanë qenë objektive apo nuk kanë qenë tilla? Në qoftë se analizën e gjendjes nuk e bëjmë si duhet, me plot përgje-

gjësi (dhe këtu e kam fjalën edhe për përgjegjësi të rënda që kanë drejtuesit e Partisë dhe të pushtetit në rrethe), atëherë kemi rrahu ujë në havan. Pse t'i mësojmë njerëzit që, në mbledhjet që bëjnë për këtë ose për atë problem, të mjaftohen vetëm me konstatime, duke thënë se kemi deficite në realizimin e planit, për këtë e për atë arsyen, dhe të mos ndalen të ndajnë shapin nga shqeri, siç i thonë një fjale, duke u kërkuar llogari deri më një atyre shokëve që përgjigjen direkt për këtë çështje, me qëllim që vitin e ardhshëm të mos kemi më deficite të tilla? Mua më duket se vëlëm duke vepruar në këtë mënyrë, pra duke vënë mirë pikat mbi i, merren me të vërtetë masa të arsyeshme e të domosdoshme për përmirësimin e gjendjes.

Në Lushnjë kemi edhe plot kuadro me arsim të lartë e të mesëm, specialistë të mirë të bujqësisë, që mbajnë përgjegjësi për mosrealizimet e planit. Atje kemi, gjithashtu, një institut studimesh bujqësore; kemi edhe kooperativa bujqësore nga më të dalluarat e vendit tonë. Prandaj situata në këtë rreth duhet të analizohet me një fryshtë kritike serioze; të shihet konkretisht se sa kanë qenë dëmet e shkaktuara nga breshëri, nga shirat, nga erërat e nxchta të jugut, nga ajo e nga kjo. Përveç këtyre, duhet parë edhe se sa kanë qenë deficitet për shkak të organizimit të dobët të punës, të mosrespektimit të disiplinës shkencore etj. Mua më duket se për deficitet e krijuara ka përgjegjësi jo vetëm një njeri, jo vetëm sekretari i parë i komitetit të Partisë, kryetari i komitetit ekzekutiv ose vetëm shefi i sektionit të bujqësisë në rreth, por, siç thashë, kanë përgjegjësi të gjithë specialistët e

kuadrot e bujqësisë, se edhe ata janë njerëz të Partisë. Në qoftë se nuk shtrohet kështu problemi në bazë, nuk zgjidhet gjë konkretisht. Prandaj edhe na ndodh që të njëjtat të meta që kritikohen sivjet, dalin në pah edhe vitin tjetër.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Kjo është e drejtë, shoku Enver. Ja, në kooperativa ka brigada që për vite me radhë nuk e realizojnë planin, sepse nuk ka kërkosë llogarie. Në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit të Durrësit nuk qe bërë asnjë kritikë për kryetarët e kooperativave bujqësore, të cilët i kanë ndërruar nga katër, pesë, bile edhe gjashtë herë shifrat për rezultatet e pritshme.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po atëherë, ç'tregon kjo? E kam fjalën këtu, që ç'do të presësh nga ata kryetarë kooperativash bujqësore që i ndërrojnë gjashtë herë shifrat e dhëna për rezultatet e pritshme?! Një gjë e tillë tregon se ata as që interesohen fare për grurin. Ndërrimi kaq herë i shifrave tregon edhe se ata nuk e njojin situatën, se atje nuk ka seriozitet në punë dhe se ekziston familjaritet i sëmurë e liberalizëm. Kjo, gjithashtu, do të thotë se ai kryetar që i ndërron shifrat e dhëna si pa të keq, nuk i peshon hiç as ata që i kërkojnë llogari. Po pse? Sepse ai nuk është një kuadër i formuar si duhet politikisht, nuk respekton disiplinën në punë, disiplinën e planit e disiplinën shtetërore; atij i mungon edhe ndërgjegjja komuniste. Mund të ndodhë që ky ose ai të gabojë një herë, por jo të gabojë pesë ose gjashtë herë. Të tillë njerëz duhet të vihen para përgjegjësisë, se këto qëndrime nuk janë të mira dhe na dëmtojnë. Prandaj, siç thashë më

lart, në mbledhjet e në analizat që bëjmë, duhet të ndahet mirë shapi nga sheqeri e të mos bëjmë mbledhje për mbledhje.

«Plani mund të realizohet me hamulloret», na thuhet kur s'realizohet gruri. Jo, problemi nuk shtrohet kështu, por të punohet e të djersitet që të realizojmë planin dhe të kemi deficite minimale se, kur është fjala për mosrealizime të tilla, kushdo e ka të qartë se të tërë këtë grurë nuk e prishi shiu ose breshëri. Ja, për shembull, të paktën në Elbasan nuk kam dëgjuar të jetë bërë ndonjë katastrofë e madhe nga moti i keq, siç u bë gjoja në Lushnjë. Atëherë ç'janë këto deficite në planin e grurit të këtij rrithi?!

**SHOKU PROKOP MURRA:** As panxharin dhe misrin nuk do ta realizojë Elbasani.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E po, në këtë mënyrë nuk ecet, shokë. Edhe nga ana e Partisë, edhe nga ana e shtetit për të tilla qëndrime duhet të merren masa serioze. Këtë mendim e kam thënë dhe e kam përsëritur shumë herë. Atë unë nuk e kam shprehur kot, por sepse për këto e për shumë probleme të tjera, ka e duhet të ketë përgjegjësi të dyfishtë, shtetërorc dhe partie. Pra, nuk ka përgjegjësi vetëm Partia që plani i grurit, për shembull, nuk u realizua në Lushnjë, në Durrës e gjetkë. E theksoj përsëri këtë gjë, sepse në disa raporte që na jepen, si edhe në raportin e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tiranës për rritjen e rolit udhëheqës të organizatës së Partisë në institucionet shkencore, vura re se që nga kreu e deri në fund atje thuhej: «organizata-bazë nuk ka bërë këto; organizata-bazë nuk ka bërë ato; se ajo nuk është treguar në

lartësinë e duhur në këtë dhe në atë rast» etj. Mirë, jam dakord që organizata-bazë ka përgjegjësi të mëdhe për dobësitë që vërchen në çdo qendër pune, pra edhe në institucione. Por ajo ama përbëhet vetëm prej 15 ose 20 vetash, kurse gjithë kolektivi mund të ketë shumë më tepër. Përveç kësaj, atje ka edhe një këshill shkencor që përgjigjet drejtpërdrejt për këtë problem. Atëherë, gjithë këta të tjerët janë të larë nga përgjegjësia?! Prandaj, në ato materiale që përmenda kam shkruar nja dy fjalë: «Ka përgjegjësi Qeveria dhe ai që merret me këtë problem apo nuk ka?». Shpesh thuhet vetëm që ka përgjegjësi Partia. Unë jam dakord që Partia ka përgjegjësi, se ajo udhëheq, po përgjegjësinë e organeve shtetërore ta shuajmë fare? Po si mund ta shuajmë ne atë, kur dihet se Qeveria është leva e Partisë, është zbatuesja e direktiveve të saj? Pra edhe ajo mban përgjegjësi. Me këtë nuk them se shokët e Qeverisë nuk e njojin përgjegjësinë, por dua të kuptohet dhe, bile, të kuptohet mirë, që kjo përgjegjësi është e përbashkët. Partia t'i bëjë të ndërgjegjshme masat për zbatimin e orientimeve të dhëna, por edhe ai që është drejtor në një ndërmarrje ose shef seksioni në komitetin ekzekutiv të rrethit duhet t'i zbatojë ligjet e shtetit në mënyrë rigorozë. Dhe këtë gjë ne si Parti do t'ua themi atyre.

Prandaj, kur nuk zbatohet orientimi ose direktiva, atyre do t'u kërkohet llogari, se kanë përgjegjësi edhe ata dhe jo të përpiken t'ia hedhin të gjitha Partisë.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Vihet re dhe diçka tjetër, shoku Enver, gjë që ju e keni thënë vazhdimisht,

që me fjalën Parti kuptohet sikur është vetëm komiteti i Partisë, kurse Partia është kudo.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, ashtu është, Partia është kudo. Partia është edhe në pushtet, bile ai që është drejtor, edhe sikur të mos jetë anëtar partie, prapë është njeri i Partisë, që ndjek e zbaton vijën e saj dhe, nga ana shtetërore, i kërkon tërë kolektivit punonjës që drejton ta zbatojë këtë vijë të Partisë.

Pas aktivit që u bë në Fier, për mosrealizimet e planit të grurit duhet të bëhen nëpër rrethe medomos analiza të thella e të forta, si nga Partia, ashtu edhe nga pushteti. Ky është një problem me rëndësi të madhe. Këtu bëhet fjalë për bukën dhe këtë ta kemi të qartë. Analizën, siç thashë, duhet ta bëjmë që të shohim nëse gjithë këto mosrealizime kanë ndodhur për shkaqe subjektive apo objektive. Në qoftë se deficitet kanë ndodhur për shkaqe objektive, atëherë planin nuk duhet ta bëjmë kaq të madh, por të përgatisim një plan tjetër më real, në mënyrë që edhe kooperativisti të ketë kënaqësi për punën që bën; po kështu të kenë kënaqësi edhe shokët e Partisë e të pushtetit. Por, në qoftë se këto ndodhin për shkaqe subjektive, pra për arsyet e organizimit të dobët, të mos-përdorimit të të gjitha mjeteve që ka vënë shteti në dispozicion etj., etj., atëherë të ndalet konkretisht e të merren masa për ta forcuar situatën dhe të mos lejojmë më që ajo të na përsëritet. Duhet gjetur se ku janë dobësitë që kanë ndikuar në krijimin e deficiteve nga ky apo ai rrëth, kooperativë ose brigadë.

Kam mendimin se, po të pyesim se ç'u bë pas aktivitet të Fierit, asnjeri nuk do të jetë në gjendje të

thotë se si u zbërthyen ato probleme që u trajtuan me seriozitetin më të madh nga ata që vajtën atje. Prandaj, është e domosdoshme që menjëherë pas kësaj punë, gjithë Partia dhe pushteti, duke e koordinuar mirë veprimtarinë e tyre, të zbërthejnë problemet që dolën në atë aktiv e të marrin masa për zbatimin e detyrave që u caktuan atje. Po si t'i zbërthejnë? T'i zbërthejnë me hollësi në çdo kooperativë, brigadë e skuadër. Të ndalen në mënyrë të veçantë tek ajo brigadë a skuadër që u bë pengesë për mosrealizimin e planit, së cilës mund t'i thuhet se, duke mos punuar mirë, ajo i ka sjellë kaq dëm shtetit. Ajo mund të nxjerrë njëqind justifikime, por ato t'i hidhen poshtë me argumente e t'i vihet në dukje se ajo nuk e shfrytëzon kohën e punës si duhet, nuk respekton disiplinën shkencore etj., etj., prandaj jep edhe rezultate kaq të ulëta. Kurse brigadës ose skuadrës që e realizoi ose edhe e tejkaloj planin, t'i shtrëngojnë dorën, t'i japid edhe ndonjë stimul moral, duke i thënë se pikërisht ky është rezultati i zbërthimit të atyre problemeve që me aq forcë i kemi shtruar si Parti dhe si pushtet. Kështu, më duket mua, korrigohen gabimet dhe ecet përpëra. Ndryshe, po e lamë punën vetëm me një mbledhje, nuk bëhet gjë.

Tani do t'ju them diçka që nuk lidhet me këtë çështje. Dje mora vesh se në Qeveri kishin vendosur të bëjnë një sesion shkencor për revolucionin tekniko-shkencor, ku përvèç referatit do të mbahen edhe ca kumtesa. Mirë, u thashë unë, le të bëhet ky sesion shkencor, drejt është menduar.

Ishe dhe ti, Prokop, atje, kur u vendos kjo, por me vajtjen tënde në mbledhjen e Qeverisë unë nuk

kuptoj një prani formale, domethënë të mendohet që ja, me këtë rast, ishte atje dhe një sekretar i Komitetit Qendror, se edhe ata të Qeverisë, pothuajse të tërë anëtarë të Komitetit Qendror e të Byrosë Politike janë.

Por më parë se të merrej vendimi, problemi duhej të shikohej më thellë. Kur thuhet se do të bëhet një sesion shkencor për një problem të caktuar, presupozohet një punë e madhe përgatitore. Nuk është çështja të bëhet një referat sa për të kaluar radhën. Jo. Se vërtet e përgatiti Ramizi referatin, që mbajti tani në sesionin shkencor që organizoi Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste<sup>1</sup>, por ai ishte rezultat i një pune që kishte filluar prej kohësh.

*SHOKU RAMIZ ALIA:* Më falmi që po ju ndërpres, shoku Enver, por desha të them se ka tamam dy vjet që ka filluar puna për të. Unë kam një fletore të tërë me data, ku, sa më vinte një ide në mendje lidhur me problemin që do të trajtonim në sesion, menjëherë e shkruaja aty.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Atë dua të them edhe unë. Kështu është, për dy vjet me radhë njerëzit e caktuar punuan seriozisht për sesionin. Shokët e komisionit menduan, studiuan, prandaj, sipas mendimit tim, ky sesion, që zhvilloi punimet para pak ditësh, doli shumë i mirë. Pastaj, problemi i revolucionit tekniko-shkencor nuk është një problem i ri, por një problem i përhershëm. Për këtë, dyshoj se mos ky sesion do

1. Është fjala për sesionin shkencor për «Probleme të zhvillimit të sotëm botëror», që u zhvillua në Tiranë, më 2-4 tetor 1978, ku shoku Ramiz Alia mbajti referatin «Revolucioni — çështje e shtruar për zgjidhje».

të dalë diçka formale, i thashë Mehmetit [Shehut]. Kjo kërkon të mendohet një çikë më gjërë, se nuk është aq e thjeshtë çështja. Grupet e punës i ngritën tani, kështu që nuk kanë filluar akoma mirë nga puna. Por ja, edhe sikur të supozojmë se këto kanë bërë diçka, prapëseprapë mund të ndodhë që në kumtesat që do të mbahen në sesion të thuhen gjëra që nuk kanë dalë nga një eksperiencë e gjatë pune, nga një luftë me vështirësitë që hasin këto grupe nga ana teorike, praktike, financiare, nga ana e koordinimit etj., etj. Pra, ka një varg problemesh, të cilat duhen pasur parasysh. Qëllimi është që këto referate e kumtesa të bëhen siç u bënë ato të sesionit shkencor që u zhvillua për problemet e zhvillimit të sotëm botëror. Ua përmend këtë sesion se është një shembull i mirë; referatet dhe kumtesat që u mbajtën atje ishin të bazuara në vijën e Partisë dhe pasqyronin saktë, qartë dhe drejt luftën e ashpër të Partisë sonë me armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm.

Pastaj, siç e thashë, problemi i revolucionit tekniko-shkencor nuk është diçka që ne e shtruam dje, kur krijuam grupet e punës. Jo, revolucioni tekniko-shkencor ka ecur dhe po ecën. Edhe këto grupe po përparojnë dhe, megjithëse koha ka qenë e shkurtër, ato prapë mund të kenë realizime. Tashti është detyra e Qeverisë që ta organizojë punën në mënyrë të atillë që ky sesion shkencor të dalë sa më i mirë. Nuk është fjala që të përgatitim një referat duke mbledhur disa të dhëna, por të bëhet një thellim i mëtejshëm në punën për zgjidhjen e problemeve të revolucionit tekniko-shkencor.

Që të bëhet një referat i mirë, mendoj se atje duhet të flitet e të vihet theksi në rëndësinë e revolucionit tekniko-shkencor, për një kuptim më të gjerë e më të thellë të përbajtjes politiko-ideologjike, ekonomike dhe shkencore të tij. Të vihet në dukje, gjithashtu, se Partia duhet të luajë një rol të madh në këto punë.

Sekretarëvc të komiteteve të Partisë dhe disa shefave të seksioneve, si për shembull atyre të industrisë, pranë komitetevc ekzekutive të rretheve (sigurisht jo të tëra rretheve, por të atyre ku kërcohë konkretisht një zhvillim sa më i madh dhe i domosdoshëm i revolucionit tekniko-shkencor, se atje janë caktuar dhe tematikat), pra, mund t'u thuhet me kohë që do të bëhet një sesion shkencor për këtë problem, prandaj të mendojnë e të punojnë seriozisht për këtë. Natyrisht, kumtesat e referatet do t'i paraqitin njerëzit që janë caktuar, por ata duhet të bashkëpunojnë me shumë spezialistë të tjerë. Dhe Partia, nëpërmjet dy apo tre spezialistëve, anëtarë partie, që janë atje, të punojë që ata që do të venë në këtë sesion ta kuptojnë mirë dhe si duhet rëndësinë e problemit dhe të paraqesin në materialet që do të lexohen eksperiencën e tyre me seriozitetin më të madh. Kjo, do t'u thotë komunisti specialist shokëve të tij, të trajtohet në prizmin e marksizëm-leninizmit. Referatet e kumtesat duhet të zhvishen krejt nga llafet e tepërtë e nga sloganet, sepse në to trajtohen çështje teknike, prandaj duhet folur konkretisht për mineralet, për hekurin, për nikelin, për plumbin, për punën që duhet bërë për projektimin e një makinerie etj., etj. Ky është sesion shkencor dhe kjo duhet të mbahet mirë parasysh, prandaj kërkon

përgatitje teorike e teknike. Problemet të paraqiten realisht, me vështirësitet që ndeshen, me mungesat që ekzistojnë, me koordinimet që duhen bërë e me të gjitha.

Akoma më thellë duhet të trajtohen këto probleme nga ana e Partisë në bazë. Fjala vjen, kumtesat që do të mbahen në sesion, duhet të diskutohen në grupe e të kontrollohen, të shikohen një herë nga ana teknike e pastaj mund të raportohet edhe në byronë e rrethit se këto e këto probleme do të trajtohen në kumtesat.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Në vendimin e Sekretariatit të 27 tetorit të vitit të kaluar «Mbi masat për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor» jepet porosia për një aktiv kombëtar ose sesion shkencor për zhvillimin e mëtejshëm të revolucionit tekniko-shkencor. Afati për këtë sesion është fundi i këtij viti, ose tremujori i parë i vitit 1979.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Afati është i shkurtër. A mund të na thuash ti Prokop, se ç'është bërë në bazë, për këtë problem lidhur me vendimin e Sekretariatit?

**SHOKU PROKOP MURRA:** Shokët e disa rretheve janë porositur dhe po punojnë që në materialet e tyre të trajtojnë ato probleme që ata aktualisht i kanë nëpër duar. Ne kemi biseduar, për shembull, me shokët e Korçës, të cilët po studiojnë dy probleme të mëdha, të nikel-silikateve dhe të boksiteve, që të trajtojnë disa tema. Edhe me shokët e Ballshit kemi biseduar konkretisht për temat.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Për problemin e nikel-silikateve është folur edhe herë të tjera dhe këtë e

dimë të tërë. Tani, e rëndësishme dhe me interes do të jetë që ata që po punojnë atje të nxjerrin një sërë konkluzionesh për mineralet e tjera, për lidhjet që mund të krijohen etj. Një gjë e tillë mendoj se do të që me vlerë. Po kështu edhe për kuarcitet e për të tjera e të tjera është folur. Tani fjalën e kemi për një thellim të mëtejshëm në studimin e tyre.

Mua më duket se as nga ana e Partisë dhe as nga ana e Qeverisë nuk është bërë një punë e thelluar përgatitore për këtë sesion. E kam fjalën këtu që, përdërisa u vendos të bëhet një sesion shkencor për këtë problem, të bëhet ç'është e mundur që ai të zhvillohet sa më mirë. Është e qartë se këtë punë do ta bëjmë së toku. Shokët e Qeverisë kanë anën shtetërore, teknike etj., kurse ne kemi anën politike dhe ideologjike. Kjo do të thotë se ne duhet ta kombinojmë punën me njëri-tjetrin. Më përpara të vemi ne, të përgatisim terrenin për fillimin e punës. Pastaj, përnjëherë të shkojnë edhe ata të Qeverisë për të marrë masat e duhura nga ana shtetërore.

Pse të veprohet kështu? Kaq herë e kemi theksuar që të gjitha vendimeve e problemeve t'u shkohet deri në fund, duke i zbërthyer dhe duke i zbatuar deri në një. Këtë kemi thënë edhe për problemet e ndryshme të bujqësisë dhe përsëri shikojmë se ka zvarritje në këtë drejtim.

Të përgatitësh një sesion shkencor është një punë me përgjegjësi, prandaj për këtë duhet punuar me seriozitetin më të madh. Po nga kush? Nga Akademia e Shkencave, nga ministria përkatëse, nga shokët përgjegjës për këtë punë në Kryeministri, pastaj, edhe nga

sektori përkatës këtu në aparatin e Komitetit Qendror të Partisë. Përse? Për të parë ç'po bëhet, a po zbatohen orientimet e dhëna? Çfarë u ka ardhur nga ministria e nga Qeveria? A preokupohet ministri apo jo për këtë problem? Se, vemi nga vemi e prapë kthehem i organizata-bazë e Partisë, duke thënë: «Ajo e ka fajin!». Po dale, pse e ka fajin organizata-bazë?! Po ministrat, që marrin pjesë në mbledhjen e Qeverisë e në mbledhje të tjera të rëndësishme, kanë apo nuk kanë faj për mos-marrjen në kohë të masave për vënien në zbatim të vendimeve të dhëna?! Pse nuk e organizojnë punën këta me shtabin e tyre? Pra, më parë se organizata-bazë, këto probleme duhet t'i ngrëjë ministri e zëvendësmnistri, të cilët kanë marrë pjesë në mbledhjet e Qeverisë, mund të kenë asistuar dhe kanë marrë direktiva në Byronë Politike ose në Sekretariat, kurse sekretari i organizatës-bazë nuk ka qenë në këto mbledhje. Prandaj i bie për detyrë ministrit që me shtabin e tij, ku do të jetë edhe sekretari i organizatës së Partisë të dikasterit dhe dy-tre komunistë specialistë, ta shtrojë problemin e më pas, të diskutojë së toku rrëth tij, duke e zbërthyer vendimin e dhënë nga ana politike dhc nga ana teknike. Pastaj, sekretari vete në organizatën e Partisë dhe e shtron qartë çështjen, duke thënë, fjala vjen, se në bazë të vendimit të këtij apo të atij forumi të lartë u diskutua ky problem dhe organizatat-bazë t'i vënë mirë shpatullat punës e veçanërisht të kenë kujdes që komunistët të jenë në ballë e të punojnë në këtë dhe në atë drejtim, që të vënë në lëvizje dhe të udhëheqin me shembullin e tyre punonjësit e paorganizuar në Parti. Ai u thekson komunistëve se përgje-

gjësia është e madhe dhe se ajo që u vendos t'u bëhet e njojur të gjithëve që të realizohet. Për këtë të përderen forma të përshtatshme punc, të bashkëpunohet me aparatin shtetëror, të Qeverisë, të ministrisë apo të uzinës. Këto gjëra edhe kështu bëhen, por ka mundësi të bëhen akoma më mirë.

T'ju them të drejtën u çudita kur mora vesh se sa dëmtime, vjedhje, prishje e shpërdorime të pronës kishte në disa rrethe të vendit. E them këtë kur shikoj gjithë këta shokë që drejtojnë institucionet e ndërmarrjet, ndërmjet të cilëve ka shumë kuadro të pjekur, të kulturuar e me ndërgjegje të lartë. Atëherë, bëj pyetjen: Pse të ngjasin këto gjëra? Pse të dëmtohet kaq shumë pasuria e përbashkët socialiste? Këtu diçka nuk ecën. Të lëmë ndërgjegjen e atyre personave që i bëjnë këto veprime, e cila, natyrisht, ka efektin e saj, por të shikojmë atë që e kemi ne në dorë, organizimin dhe drejtimin e punës, rregullat administrative e dispozitat ligjore, ushtrimin e kërkesës së llogarisë e të kontrollit të thellë e të vazhdueshëm. Ne flasim që aty këtu ka edhe liberalizëm. Po pse ka liberalizëm? Sepse ka një drejtim të sipërfaqshëm. Po kështu ka edhe kontroll e kërkesë llogarie të sipërfaqshme.

Njeriu me funksion përsaqëson Partinë e pushtetin atje ku ai drejton. Për këtë një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar marrëdhënieve që ekzistojnë midis kua-drove dhe masave. Të jemi shokë sa të duash, të qeshim e të bisedojmë për hallet e për nevojat e njëri-tjetrit, por, në punë, si përgjegjës, unë të kërkoj llogari, njëloj si gjithë të tjerëve. Këtë frymë të krijojmë në çdo kolektiv pune. Domethënë, drejtuesin e ndërmarrjes apo

përgjegjësin e turnit punëtori ta dojë jo pse qeshin, shoqërohen dhe shëtisin bashkë, por edhe sepse ai i kërkon llogari, ashtu si edhe drejtuesi e do punëtorin ose nëpunësin, sepse edhe ai i kërkon llogari këtij. Një mentalitet i tillë duhet krijuar kudo, prandaj, shokë, ta shikoni e ta vini mirë në vend këtë problem.

*Botohet për herë të parë sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

# FOLKLORIN TA RUAJMË DIIE TA PASUROJME

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

10 tetor 1978

Folklori është një pasuri e madhe që i përket gjithë popullit. Ai është i kuptueshëm dhe i dashur njëlloj për të gjithë, për fshatarët, për qytetarët, për punëtorët, për rininë, për gruan e të tjerë.

Kemi dëgjuar të thuhet nganjëherë, për shembull, se kjo këngë apo kjo veshje etj. është arkaike, në kuptimin që është tamam e vjetër. Ruajtja me fanatizëm e formave arkaike nuk është diçka e rekomandueshme, për arsyse se jeta ecën, zhvillohet, socializmi realizon ndryshime në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë këtu edhe folklorin. Natyrisht, këto ndryshime duhet të bëhen, në radhë të parë, në brendinë socialiste, sidomos në art dhe në kulturë, si dhe në formën nacionale. Brendia socialiste nuk shfaqet vetëm në fjalët e bukura, shprehëse, në fjalët e trimërisë, ose në ato që tregojnë zhvillimin e madh të vendit tonë, të kulturës. Natyrisht, këto flasin për një brendi të tillë, por këtë e gjejmë, gjithashtu, edhe në muzikë, edhe në valle. Sot,

kur përpunohet një valle popullore, kompozitori dhe koreografi e pasurojnë atë duke i shtuar ndonjë element të ri, vetëm se shtesa duhet të bëhet me vend e jo të jetë ndërhyrje arbitrale dhe pa kompetenca, sepse kjo është e rrezikshme.

Duhen studiuar historikisht të gjitha periudhat, të cilave u takojnë këngët, vallet, kostumet, qëndismat etj., në mënyrë që këto të ruhen e të zhvillohen më tej jo vetëm nga populli, por edhe nga Instituti i Folklorit. Për shembull, kala si ajo e Gjirokastrës ne nuk bëjmë tashti, por ama atë e ruajmë dhe e restaurojmë. Ose një shtëpi si atë të Zekatëve nuk e ndërtojmë më tash-ti, por e ruajmë edhe këtë shtëpi karakteristike, ku është derdhur mjeshteria e popullit tonë artist. Këto objekte i ruajmë që njerëzit tanë të artit e të kulturës, piktorët, skulptorët, arkitektët e të tjerë t'i studiojnë dhe të frysmezojnë prej tyre. Po kështu veprohet edhe për këngët e vallet. Instituti i Folklorit i grumbullon ashtu siç kanë qenë në periudhat të cilave u takojnë, i skicon, bën krahasimin me të tashmen dhe shikon evolucionin e tyre etj.

Në bazë të atyre vërejtjeve të drejta që bëri Hekurani [Isai], dua të them se në lëvizjen artistike amatore, për shembull, të një rrëthi si Gramshi, që ka vallet e tij, mund të ekzekutohet edhe një valle e Vlorës që pëlqehet. E pse të mos ekzekutohet kjo valle? Mos do t'i thotë Vlora Gramshit pse ma more këtë?! Përkundrazi, një valle apo një këngë të bukur të një rrëthi duhet ta përhapim edhe në rrëthe të tjera, sepse njerëzit nga ajo më e bukura do të influencoohen, e në këtë mënyrë edhe kombëtarja bëhet më unike.

Unë mendoj se njerëzit tanë, studiues të artit e të kulturës, nuk duhet të influencohen nga mendimi i të huajve që mbivlerëson këngët apo vallet e vjetra, arkaike, dhe nënvleftëson të përpunuarat. Ne medoemos do ta përpunojmë artin tonë, sepse nuk do të qëndrojmë në vend. Por, edhe atje ku e kanë çuar artin popullor të tjerët, ne nuk e çojmë. Folklorin e ruajmë si një thesar të madh dhe do ta zhvillojmë e do ta pasurojmë konkretisht. Populli do të vazhdojë gjithmonë të krijojë, se ka krijim këtu; për shembull, në një nga vallet e Tropojës, megjithëse është e përpunuar, shprehen tamam ato karakteristikat e vjetra të valles «mëmë», si të thuash, pra, spikat elementi original, të duket sikur po kërcejnë majat e maleve. Ose të marrim vallen e shqipeve, që është e stilizuar, kjo është inspiruar nga «vallja» e shqiponjave. Është një bukuri e rrallë të shikosh kur e kërcejnë atë valltarët tanë. Atëherë, si të mos futim në kulturën e gurrës së madhe popullore një gjë të bukur që e pasuron dhe e bën akoma më të pëlqyeshme? Ne nuk e lejojmë as të prishet, as të deformohet ky art. Baza mbetet gjithnjë ajo që ka qenë, por elemente të bucura, shprehëse etj., asaj do t'i ngjiten medoemos, edhe po të mos duash ta lësh.

Pra, folklori do të pasurohet, evolucioni do të bëhet, por ne s'duhet të lejojmë në asnje mënyrë që zhvillimi i tij të bëhet kuturu.

Aktualisht kanë marrë një zhvillim të vrullshëm qëndismat. Ato sot janë më të bucura, jo vetëm se ka zhvillim intelekti, por edhe se tani këto punime bëhen edhe në mënyrë kolektive. Puna e përbashkët ka bërë që njerëzit të mos mjaftohen vetëm me një apo dy mo-

dele, por të kërkojnë, të përpinqen për më shumë e më të bukura. Nga ana tjetër, skulptura, piktura e gjini të tjera të artit u kanë hapur horizont artizanëve tanë, të cilët, figurat e bukura të tyre duan t'i shprehin edhe në qëndismën, në xhamadanin etj. Dhe ato ruhen atje, nuk humbasin.

Mbrëmë pasqë në televizor konkurrimin e grupit të Kolonjës në festival. Më bëri përshtypje veshja e tyre me shkabën të qëndisur në kurriz. Rrallë kemi parë një gjë të tillë. Andej nga anët tonë kishte pllaka të qëndisura me figura të ndryshme.

Më erdhi keq që nuk pasqë tri a katër grupe që konkurruan në mëngjes. Unë harrova fare që ishte e diel dhe jepej shfaqje edhe në mëngjes. Nga koncertet që u dhanë në mbrëmje më pëlqeu grupei Tropojës. Ky rreth, le që i kishte të bukura vallet, por edhe gjithë koncerti ishte vënë në skenë në një mënyrë ndryshtë nga të tjerët, pastaj kishte edhe gjëra të reja. Popullore ishin të gjitha këto, por nuk i kishim parë, dhe kjo tregon se është bërë një punë e mirë për të gërmuar e për të gjetur gjëra kaq të bukura në thesarin e pashtershëm të popullit tonë artist. Kishte plot gjëra të bukurë, si vallja e tepsisë, ku spikaste një mjeshtëri e madhe, kënga e djepit etj. Po ata kalamanët?! Sa të mrekullueshëm ishin! Edhe dibranët u paraqitën shumë bukur me ata fëmijë aq të gjallë e të zgjuar.

U bë një traditë e mirë organizimi i Festivalit Folklorik. Një gjë e tillë ka bërë përshtypje të madhe në popull, sepse populli ynë, si artdashës që është, e vlerëson drejt një aktivitet kaq të rëndësishëm kombëtar si festivali, ku sheh e dëgjon vallet dhe këngët e tij të

mrekullueshme të interpretuara nga bijtë e tij, bujq e bujkesha kooperativiste, punëtorë e të tjerë. Është një thesar i madh ky që populli e pasuron vazhdimesht. Ai menjëherë i bën vargjet, bile edhe vallen. Po fjalët, sa të bukura, sa të forta, me ç'mprehtësi politike i gjen populli figurat: «Shtatë male, shtatë kongrese!»

Prandaj, të gjitha këto këngë e valle, që janë një pasuri e madhe, duhet të rrojnë shumë, duhet të ruhen me kujdes!

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Për shkencën» (Përmble-  
dhje veprash), vëll. II,  
f. 183*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Për shkencën  
(Përmbledhje veprash),  
vëll. II, f. 183*

**PUNONJESIT E ARTIT TA PËRVETËSOJNË E TA  
PËRPUNOJNË THESARIN E POPULLIT  
DHE T'IA JAPIN PËRSERI ATIJ**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**13 tetor 1978**

*Biseda e sekretarëve të Komitetit Qendror të Partisë në këtë takim, u zhvillua rrreth Festivalit Folklorik Kombëtar që u bë në Gjirokastër nga 6-12 tetor 1978. Shoku Ramiz Alia, që kishte ndjekur nga afër një pjesë të këtij festivali, foli për disa nga përshtypjet e tij. Pastaj e mori fjalën shoku Enver Hoxha, i cili ndër të tjera tha:*

Dy-tri ditë më parë shfaqa disa mendime për folklorin<sup>1</sup>. Edhe sot dua të vazhdoj disa ide për këtë çështje.

Folklori duhet kuptuar thellë, nga pozitat e materializmit historik. Historinë vërtet e shkruajnë disa, por atë e bën populli. Dhe një burim i madh, nga i cili mëson shumë për historinë e një populli, është

---

1. Shih në këtë vëllim, f. 180.

folklori. Nuk mund të shkruash për historinë e popullit shqiptar, pa njohur, pa ndjekur, pa zhvilluar dhe pa studiuar folklorin e tij, i cili pasqyron dialektikën e zhvillimit të historisë. Të gjitha ngjarjet e historisë së popullit tonë në shekuj, në momente luftërash, përpjekjesh, gëzimesh e hidhërimesh janë ruajtur brez pas brezi në folklorin popullor. Jehonën e tyre e gjen të pasqyruar në folklor jo vetëm me fjalë, të fiksuar në këngë, por edhe me muzikë, me daulle, me fyell, me të qarë, me të qeshur e me të kërcyer.

Historiani ynë duhet të bëhet i ndërgjegjshëm dhe të niset nga parimi marksist-leninist, që, kur të bëjë një libër historic, ta pasqyrojë me vërtetësi historinë e popullit. Dhe, që ta shkruajë si duhet këtë dhe ta japë në një mënyrë sa më konkrete, sa më bindëse e të bazuar në realitetin, atë e ndihmon vetë populli me pasurinë e larminë e madhe të vargjeve të këngëve të tij të bukura, që krijon vazhdimisht dhe që u përkasin periudhave të ndryshme. Sa këngë ka?! Sa të duash, e në sa e sa variante. Për shembull, disa këngë gjirokastrite ndryshe i di unë, ndryshe këndohen tanë. Kjo s'do të thotë se kanë ndryshuar bazën, pse baza është po ajo që ka qenë edhe në kohën e rinasë sonë, por populli i shton fjalë më të bukura, e pasuron vargun apo këngën, duke reflektuar në to jetën e tij në zhvillim të pandërprerë, sepse tanë ai i kupton problemet shumë më mirë se përpara, është më i zhvilluar.

Aktualisht te ne ka një zhvillim të madh folklori. Ai pasqyron flakë për flakë dhe me një bukuri të rrallë jetën, realitetin e vendit tonë, sepse njerëzit e popullit vetë marrin pjesë dhe punojnë në veprat e mëdha

që ndërtohen, si në hidrocentralin «Drita e Partisë», në Kombinatin Metalurgjik, në ndërtim brezaresh e rezervuarësh etj., ku kanë luftuar me shiun, me borën, me furtunën dhe për këto luftëra e përpjekje kanë krijuar këngë, që ne, kur i dëgjojmë, mallëngjehemi nga emocioni prej fjalëve e frazave aq shprehëse dhe të forta. Një periudhë të gjatë aktiviteti, për të cilën një historiani do t'i duhej shumë kohë që ta pasqyronte, populli e pasqyron menjëherë shumë bukur, në këngët e tij; bile shpeshherë vetëm me një varg, ai na jep me shumë vërtetësi një periudhë të tërë, për arsyen se i jeton vetë ngjarjet, merr pjesë vetë drejtësorejt në to. Prandaj edhe nga kjo anë duhet shikuar folklori.

Folklori evoluon. Në këtë proces ne shohim dhe duam traditën, por duam gjithashtu edhe zhvillimin, të renë. Për shembull, përpara luftohej me shpatë, po partizanët kanë luftuar me pushkë, mitraloz etj. Përpara luftohej me fustanella; tani luftohet me rroba ushtarake e kështu me radhë. Gjithç këtë zhvillim populli patjetër e përjetëson në artin e tij. Këto krijime janë të gjitha pasuri e popullit, që duhen ruajtur si sytë e ballit. Ato kanë vlerë të madhe për të njojur mirë edhe historinë, që dhe sikur ta kishim tërësisht të shkruar, e bile me dokumentacione të shumta, prapëseprapë historia nuk mund të shprehë kurrë plotësisht e në mënyrë aq të gjithanshme ndjenjat e popullit ashtu siç shprehen në folklor. Por, siç e shohim, edhe këtu ka zhvillim, që folklori e pasqyron në kushte të reja.

Kostumet popullore kanë gjithashtu domethënien e tyre. Çdo vizatim në një kostum është i lidhur me

gjendjen ekonomike e shpirtërore të të parëve tanë të kohës kur ky kostum është krijuar për herë të parë. Disa krahina kanë veshje të zeza dhe kjo ka arsyen e vet, disa të tjera i kanë pasur veshjet me kryqe si, fjala vjen, në Mirditë, kurse në kostumet e Dropullit vihet re diçka karakteristike e popullit grek.

Çështjen e kam që këto krijime tradicionale duhen ruajtur si një thesar i madh, se bartin në vete tiparet e periudhës së cilës i takojnë. Me kalimin e kohës, ato e ruajnë në thelb tabanin e tyre të vërtetë, por edhe ndryshojnë. Periudhat që vijnë pas, qoftë në formë, qoftë në brendi, futin diçka të re, sepse këtë e kërkon jeta, e kërkon zhvillimi. Kostumet e vjetra kombëtare te ne ruhen, por diçka e re atyre u shtohet kohë pas kohe.

Por folklori nuk duhet parë vetëm në një aspekt, në aspektin artistik, muzikor, por edhe në aspektin historik, siç thashë, të zhvillimit materialist të historisë. Në këtë drejtim duhet ta studiojnë atë historianët tanë e jo të ndodhë që të mblidhen disa dokumente dhe të rrinë në rafte. Këto gjëra duhet të përhapen, domethënë të vihen në dispozicion të njerezve, që marrin pjesë gjerësisht në festivale. Kjo pjesëmarrje është shprehje direkte e vijës së Partisë. Ne kemi kënduar të gjithë që ç'ke me të edhe në kohën e Zogut këngë labe, kolonjare etj., nëpër rrugë e sokaqe. Me këngë të tillë, si «Ç'kanë malet që rënkojnë» etj., ne shprehni ndjenjat dhe realitetin e asaj kohe. Po kush kujdesej për organizimin e sistemimin e këtyre këngëve e vjershavë atëherë? Askush!

Tani kësaj çështjeje Partia i ka dhënë jo vetëm

rëndësi, por edhe një përbajtje të re, socialiste, të organizuar në shkallë të gjerë. Njëri rreth merr eksperiençë nga folklori i Shkodrës, tjetri nga i Gjirokastrës, e kështu me radhë dhe bëhen disa kompozime. Këto janë motive në zhvillim, ecin përpala, duke ruajtur njëkohësisht karakteristikat e periudhave që përfaqësojnë.

Edhe në artin botëror shikojmë karakteristikat e periudhave. Kështu, në kohën e Revolucionit Francez këndoheshin këngë, si «Karmanjola», «Allez à l'enfer»<sup>1</sup>, domethënë këngë dhe valle me veshje popullore të Provansës, të Marsejës, të Sen Klusë e të tjera.

Ose të shikojmë karakteristikat e muzikës gjermane. Muzika e Wagnerit, për shembull, përfaqëson epokën e ringjalljes së nacionalizmit dhe të junkerëve gjermanë. Në një periudhë tjetër të mëparshme shikojmë krijues të muzikës, si Bahu e të tjerë, meloditë e të cilit nuk janë si ato të operave të Wagnerit, po kuartete nëpër kështjella, ku spikat edhe njëfarë misticizmi. Muzika e Bahut ishte një muzikë e natyrës kishtare, që u kushtëzua nga koha kur jetoi ky kompozitor.

Karakteristikat e periudhës përkatëse ruajnë edhe operat e Verdit në muzikën italiane. Ky i ka krijuar veprat e tij muzikore në një periudhë kur nga ana e masave të popullit italian, të udhëhequr nga Garibaldi, bëheshin luftëra e përpjekje kundër austriakëve për unitetin e vendit të tyre. Të gjitha këto ngjarje, të shprehura edhe në artin muzikor, i frysmezuan ma-

---

1. Frëngjisht — shkofshi në ferr.

sat e gjera popullore italiane në luftën e tyre nacionallçirimi. Megjithëse më vonë arriti një kohë, si tani, që arti dhe kultura në Itali kanë degjeneruar, krijimet e asaj kohe mbeten me vlerë ashtu siç ishin, ato i rezistuan degjenerimit të përgjithshëm, bastardimit që pësuan arti dhe krijimtaria popullore. Kurse në vendin tonë një gjë e tillë nuk mund të ngjasë kurrë, se nuk e lejon Partia.

Duke ruajtur formën kombëtare, artistët tanë e zhvillojnë artin më tej edhe me përbajtje socialiste. Në këtë drejtim duhet parë edhe çështja e folklorit.

Folklori ka rëndësi të madhe për edukimin e njerezve, prandaj aktivitetet folklorike duhet të organizohen në mënyrë masive dhe krijimtaria e bukur popullore të bëhet e përdorshme nga të gjithë. Nuk mjafton vetëm të themi që disa vëllime të përgatitura nga Instituti i Folklorit, tok me disa vëllime «Visaret e kombit», të botuara që në kohën e Zogut, përbëjnë një pasuri të madhe. Këto janë vërtet një thesar i paçmuar, por botimet që ka nxjerrë instituti shpeshherë rrinë nëpër rafte, në vend që të gjitha këto këngë, të krijuara dhe të kënduara nga vetë populli gjatë shkujve, të futen edhe në tekstet përkatëse shkolllore, nëpër antologji, të shfrytëzohen në orët e mësimit të letërsisë, të historisë etj., që fëmijët tanë, nëpërmjet këtyre krijimeve kaq të bucura, të njihen me historinë e popullit, me trimërinë e bijve të tij në epoka të ndryshme. Një gjë e tillë është e domosdoshme të bëhet, sepse, nëpërmjet këngëve të trimërisë dhe krijimeve të tjera që përbëjnë një sintezë të historisë së popullit, nxënësi do të njohe rrugën e zhvillimit të po-

pullit të vet, do të shikojë pcriudhat, luftërat, jetën e përditshme. Kjo nuk është vështirë të realizohet, po nuk është bërë mirë, se nënvleftësohet.

Në drejtim të muzikës duhet të vazhdojë prirja pozitive e brezit të ri për t'i përvetësoj dhe për t'i përhapur në të katër anët e vendit këngët e krahinave të ndryshme, ashtu siç i ka kënduar populli. Brezi i ri, aktualisht, në përgjithësi i këndon këto këngë, ai kërcen kudo me mjeshtëri edhe valle popullore të krahinave të ndryshme. Valltarët sot janë të lichtë si pendë, mund të thotë ndonjë, kurse përpara kërcenin më ngadalë, më rëndë. Për shembull, kur kërcchet sot vallja e Devollit, valltarët i japid asaj një gjallëri akoma më të madhe sesa ia jepnin baballarët e tyre, që e kanë kërcyer atë dikur, dhjetëra vjet përpara. Duhet thënë se edhe kjo ka domethënien e saj, kur ke shumë halle mbi kokë, është e qartë, mezi të vjen të hedhësh valle apo të këndosh. Ja, pra, se si përmirësohet e pasurohet vallja.

Arti gjithmonë është mbështetur te folklori. I kemi dëgjuar të gjitha këngët myzeqarc të përpunuara nga Tish Daija e të kënduara aq bukur nga Vaçe Zela. Këto janë këngë jashtëzakonisht melodioze, janë më të plotësuara e më të pasura se këngët e fshatrave të Myzeqesë. Dëgjova në festival disa këngë popullore, me motive aq të bukurë, saqë artistëve tanë duhet tani t'u punojë mendja për të bërë me to vepra të bukura muzikore. Por, që t'u punojë mendja, vetë ata, në radhë të parë, duhet ta kenë në dorë këtë thesar të madh, ta njohin dhe ta përpunojnë.

Të marrim konkretisht Festivalin Folklorik Kom-

bëtar që u zhvillua këto ditë në Gjirokastër. Artistët tanë që asistuan gjatë zhvillimit të kësaj ngjarjeje me rëndësi të madhe kulturore, duhej të grumbullonin, secili sipas profilit të vet, ato materiale që u interesonin. Kështu, dikush mund të shkruante dhe të shkruajë me shkronjat e alfabetit fjalët e këngëve që i pëlqen, një tjetër mund të shkruante apo të shkruajë me notat e muzikës, pra ky nuk dëgjon vetëm fjalët e pjesës, po edhe melodinë; ai i valleve interesohet për lëvizjet e trupit, të këmbëve, të duarve etj. dhe secili t'i përdorë ato menjëherë në krijimet e tij. Në këtë mënyrë artistët tanë duhet t'i bëjnë jehonë artit të mrekullueshëm të popullit tonë të talentuar. Kjo praktikë duhet të futet thellë në shpirtin e shkrimtarëve, të artistëve, të skenografëve, të të gjithë punonjësve të artit, që ta përvetësojnë tërë këtë thesar të popullit, ta përpunojnë dhe t'ia japid përsëri popullit.

Pra, jo vetëm të kënaqemi duke konstatuar se e bëmë festivalin, ky na doli mirë dhe ta lëmë punën me kaq, se këto gjëra nuk bëhen për herë të parë te ne, të tilla festivale janë bërë edhe më parë. Ky festival vërtet pati një nivel më të lartë nga çdo pikëpamje, por tani duhet të ketë një ngritje në të gjitha fushat, në të gjitha drejtimet, që nga shkrimi i historisë, i novelave, i muzikës, i këngëve, i pikturës etj. Pra festivali duhet të nxitë medoemos një hop përrpara, të shërbejë si një shtytje e mëtejshme në krijimtarinë e punonjësve tanë të artit dhe të kulturës.

Artistët, shkrimtarët, historianët e të tjerë duhet të mendojnë se si ta shfrytëzojnë pasurinë e madhe artistike të popullit, edhe ata shokë që janë në vende

kyç t'i edukojmë që të gjykojnë drejt mbi krijimet e tyre. Kështu, ndonjëri që ka prirje për të shkruar, po që se nuk është i afirmuar, është vështirë t'i botohet ajo që ka krijuar. Mbrëmë po ndiqja në televizor emisionin për pionierët. U fliste fëmijëve një vajzë, e cila nuk foli mirë. Ajo numëroi një varg të pambaruar tituj librash, gjë që s'kishte lidhje fare me programin. Kurse shoqja tjetër foli konkretisht. Ishte më e re, po foli jashtëzakonisht mirë. Ajo tregoi se si duhet të përpinqen të shkruajnë fëmijët, i inkurajonte, i këshillonte këta të mos dëshpérohen, në rast se në fillim hasin në vëشتirësi etj. Dukej qartë se njihej me shkrimet e fëmijëve, me psikologjinë dhe me ndjenjat e tyre, prandaj dhe i konkretizonte shumë mirë ato që thoshte. Ai i djeshmi ishte emision për fëmijët, për krijimtarinë e tyre, dhe këta me siguri mezi e pritnin, kurse ajo që fliste numëronte titujt e librave, në vend që të thoshte përbajtjen e një libri, të tërhoqte vëmendjen e të prekte ndjenjat me ndonjë gjë të bukur nga këta libra. Atëherë ç'i nxjerrin njerëz të tillë të edukojnë pionierët kur nuk dinë?

Në këto drejtime që thamë duhet t'i frymëzojmë më mirë njerëzit.

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Raporte e fjalime 1978-  
-1979», f. 129*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Raporte e fjala-  
lime 1978-1979», f. 129*

# JETA DHE LUFTA JONË JANE TE LIDHURA NGUSIITE ME JETËN DHE LIRINË E POPUJVE

*Nga biseda<sup>1</sup> me shokun Zhao Amazonas dhe  
udhëheqës të tjerë të Partisë Komuniste  
të Brazilit*

15 tetor 1978

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë se na erdhët, shokë. Faleminderit shumë për këtë vizitë që po më bëni. Këta janë fëmijët e mi, dy djemtë dhe nuset e tyre, si dhe vajza me dhëndrin. Të vegjlit janë nipërit dhe mbesa. Ky këtu afër është Ermali, djali i djalit të madh; kurse kjo është Valbona, vajza e djalit të vogël, e cila mban emrin e një lumi që ndodhet në veri të Shqipërisë. Përveç kësaj, Valbona është edhe një nga pseudonimet e mia të kohës së luftës. Kurse ky më tej është Dritani, djali i vajzës. Kemi edhe një nip të vogël, shoku Amazonas, që e quajnë Shpati. Edhe ky emër është një nga pseudonimet e mia të kohës së luftës. Të tre

---

1. Në këtë bisedë me shokët brazilianë, e cila u zhvillua në shtëpinë e shokut Enver Hoxha, mërrnin pjesë edhe shokët Ramiz Alia dhe Nexhmije Hoxha.

fëmijëve të mi u them se kam dëshirë të shikoj 9 deri në 12 nipër dhe mbesa në shtëpi.

*Mbas prezantimit dhe pasi gjithë të pranishmit do-lën në fotografi, fëmijët u larguan. Shoku Enver Hoxha vazhdoi bisedën me shokët brazilianë:*

Jam i prekur dhe nuk do ta harroj kurrë këtë vizitë, shoku Amazonas, shoku Arruda dhe shoku Desio. Në të njëjtën kohë, jam i gëzuar që shikoj se shoku Amazonas është shumi mirë me shëndet. Gëzohem gjithashtu që shoh me këtë rast shokun Arruda, që duket kurdoherë i ri, po kështu edhe shokun Desio që vjen nga Brazili dhe na sjell me vete këtu fryshtat luftarakë, inkurajuese të komunistëve e të popullit trim brasili.

**SHOKU ZHOAO AMAZONAS:** Shoku Enver, sot ne deshëm të shprehim gjëzimin tonë të madh më rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes suaj, duke ju takuar personalisht ju, shoqen dhe familjen këtu, në shtëpinë tuaj.

Kremitimi i 70-vjetorit të ditëlindjes së shokut Enver Hoxha është një ngjarje me rëndësi të madhe për popullin shqiptar dhe për shokët e tij, sepse gjithë jetën dhe veprimtarinë e tij ai ia ka kushtuar kauzës së madhe të marksizëm-leninizmit, duke u bërë shembull shumë i madh fryshtimi për të gjithë. Kur flasim kështu, ne kemi parasysh kontributin e madh që ai ka dhënë në thesarin e marksizëm-leninizmit, në lëvizjen komuniste botërore. Flamuri i marksizëm-leninizmit dhe i revolucionit valëvitet gjithmonë lart në Shqipëri dhe shoku Enver Hoxha është ai që e ngrë këtë flamur në një nivel të lartë.

Partia jonë i vlerëson shumë virtytet e shokut

Enver Hoxha, si njeri modest. Ai gjithmonë ka treguar dhe tregon një kujdes të madh për popullin dhe për Partinë, duke u kushtuar atyre një vëmendje të madhe. Ky është një aspekt njerëzor i personalitetit të shokut Enver. Në mënyrë të veçantë ne vlerësojmë preokupimin e vazhdueshëm që i ka kushtuar ai ndërtimit të Partisë.

Ne, brazilianët, mendojmë se sot problemi i fitores së revolucionit në vendin tonë varet kryesisht nga zgjidhja drejt e problemeve të partisë. Mësimet e shokut Enver Hoxha për këtë çështje, për çështjet e revolucionit dhe për zhvillimin e situatave të sotme në botë kanë vlerë të madhe. Ne e çmojmë lart thellësinë e mendimeve të tij.

Prandaj nga zemra, shoku Enver, dëshirojmë t'ju shprehim urimet tona me rastin e 70-vjetorit të ditelindjes suaj. Ju urojmë jetë të gjatë, gjë që është kaq e rëndësishme dhe e nevojshme për çështjen e revolucionit në botë!

Disa nga mendimet tona për ju, ne i kemi shprehur edhe në një mesazh që dëshirojmë t'jua dorëzojmë me këtë rast.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ju faleminderit, shokë të Partisë Komuniste të Brazilit, për këtë mesazh që më dhatë me rastin e 70-vjetorit të ditelindjes sime.

Ajo që bashkon kaq ngushtë dy partiitë tona është ideologjia jonë e përbashkët, marksizëm-leninizmi. Partia jonë ka bërë ç'është e mundur dhe vazhdimisht do të punojë me të gjitha forcat që revolucioni proletar të fitojë në shkallë botërore. Ky revolucion do të triumfojë si rezultat i luftës së përbashkët që bëjnë e do të

bëjnë të gjitha partitë marksiste-leniniste në krye të proletariatit ndërkombe të mbarë popujve të botës. Për këtë partitë tona janë plotësisht të sigurta, pavarësisht nga vështirësitet e mëdha të përkohshme që janë hasur dhe do të hasen në rrugën e revolucionit. Ne ato i kemi kapërcyer dhe do t'i kapërcejmë kurdoherë me sukses.

Partia jonë i do dhe i respekton të gjitha partitë e vërteta marksiste-leniniste që ndjekin një rrugë të drejtë. Ne jemi të lumtur që edhe ato e duan po me zjarr revolucionar Partinë tonë. Klasikët tanë të mëdhenj na mësojnë se, për të arritur në fitore, mund të përdoren taktika të ndryshme, duke pasur parasysh situatat, por kurdoherë të punojmë që të mos lëvizim nga rruga që na tragon marksizëm-leninizmi dhe të kemi parasysh që të gjitha taktikat tona t'i shërbejnë strategjisë së revolucionit.

Jeta, lufta jonë, janë të lidhura ngushtë me jetën dhe me lirinë e popujve tanë, por edhe me lirinë dhe jetën e popujve të tjerë.

Dëshiroj t'ju falënderoj ju edhe për urimet që më bëtë me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes sime. Ju thatë fjalë të mira për mua, fjalë që dalin nga zemra juaj, prandaj ato janë të sinqerta, janë fjalë të dashura, prej shokësh të një lufte të madhe. Por dua t'ju them se të gjitha ato që thatë ju në adresën time, i takojnë Partisë sonë, sepse ajo u ka mësuar të gjithë anëtarëve të saj, pra edhe mua, të jenë ushtarët e saj besnikë sa të kenë jetën. Të gjithë ne që u hodhëm në luftë për çlirim e vendit nga pushtuesit fashistë, për të flakur tej robërinë dhe mjerimin e madh të popullit, ishim nje-

rëz të popullit dhe ndoqëm me besnikëri rrugën e të parëve tanë, që kishin si moto: «Ja vdekje, ja liri». Në luftë ne mësuam shumë, na mësoi Partia, e cila, me gjithëse e vogël në numër, e udhëhoqi popullin në rrugën e drejtë, pa zigzag e pa koinpromise, deri në fitoren e plotë. Prandaj mund të themi se nuk ka rëndësi ana numerike e partisë. Për të dalë fitimtarë në luftë, rëndësi, në radhë të parë, ka ideologjia nga e cila udhëhiqet ajo. Partia jonë ishte e vogël, por ajo ishte mbrujtur me ndjenjat fisnike të popullit dhe me teorinë e proletariatit, me marksizëm-leninizmin, me idetë e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit. Lufta na mësoi dhe na kaliti, ne dhe popullin tonë. Lufta sjell edhe cilësinë, edhe sasinë, ajo flak tej plehrat. Në këtë mënyrë partia forcohet më shumë, radhët e saj shtrëngohen më fort, ajo bëhet e çeliktë. Ata që kanë tradh-tuar, i ka likuiduar historia, siç likuidohen e do të likuidojë cilindo që largohet nga rruga marksiste-leni-niste.

Si gjithë anëtarët e Partisë së Punës të Shqipërisë, edhe unë çdo gjë ia dedikoj Partisë dhe e konsideroj veten si ushtar të saj. Po të ndjekim rrugën marksiste-leniniste, atëherë mund të thuhet se jemi njerëz të mirë, po të largohemi nga kjo rrugë, nuk kemi gjë. Natyrisht, si marksistë-leninistë që jemi, ne e vlerësojmë edhe rolin e individit në histori, por është e qartë se një, dy, apo pesë njerëz nuk bëjnë dot gjë; forca e individit qëndron në unitetin e Partisë, të udhëheqjes së saj dhe në unitetin e partisë me popullin. Të gjitha këto që janë bërë në Shqipëri, i ka bërë Partia, i kanë bërë komunisët dhe populli ynë, klasa punë-

tore e fshatarësia, të bashkuar grusht me njëri-tjetrin. Edhe ne, udhëheqësit, kemi vënë një gur në themele dhe këtë nuk mund ta mohojmë, për këtë duhet të jemi realistë, por nuk është vetëm ky gur që formon themellet e forta të Partisë e të të gjithë Shqipërisë.

Ne do të bëjmë detyrën tonë deri në fund për ta ruajtur Shqipërinë socialiste dhe për të bashkëpunuar ngushtë me partitë e tjera marksiste-leniniste. Në luf-tën tonë të përbashkët kundër armiqve të lirisë, të paravësisë, të socializmit dhe të komunizmit, forcat tona duhet të bashkohen ngushtë me njëra-tjetrën. Duhet të kemi parasysh se lufta do të jetë e gjatë dhe e vësh-tirë, por armiqtë tanë me siguri do të thyhen në mos nga brezi ynë, nga brezat e ardhshëm medoemos. Këta breza do ta bëjnë këtë gjë patjetër. Revolucioni dhe komunizmi nuk fitohen lehtë, kjo është e qartë për këdo që mbështetet në shkencën e marksizëm-leninizmit, megjithatë, ai do të fitojë në fund të fundit. Por fitorja nuk vjen vetë. Prandaj detyra jonë është ta vazhdojmë luftën dhe t'u hapim rrugën brezave të rinj, t'i ndihmojmë ata të luftojnë më mirë se ne, duke u ndriçuar kurdoherë nga drita e diellit të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit.

Sic e thatë edhe ju, tash, duke pasur parasysh si-tuatën aktuale, partive të vërteta marksiste-leniniste u duhet të janë më të përgatitura se kurrë. Tehu i luf-tës sonë po drejtohet me forcë tani kundër revizionis-tëve kinezë, por ne për asnjë moment nuk i harrojmë dhe nuk duhet t'i harrojmë revizionistët e tjerë, të cilët kanë qenë dhe janë gjithashtu armiq të egër. Ne kon-statojmë se tash revizionizmi kinez është bërë një ar-

mik dinak, i pacipë dhe i egër, aq sa nuk mban as maskën më të vogël për të atakuar marksizëm-leninizmin dhe partitë e vërteta marksiste-leniniste. Siç e dini, revizionistët kinezë bëjnë thirrje për bashkim me imperializmin amerikan gjoja për të luftuar socialimperializmin sovjetik. Të gjithë e dimë pse e bëjnë këtë, por edhe njerëzit e thjeshtë nuk mund të gënjen lehtë nga sloganet bajate që ata përdorin.

E keqja üshtë se të gjithë ne, kush më shumë e kush më pak, kemi menduar dhe gjykuar një çikë në mënyrë sentimentale dhe jo të argumentuar në vlerësimin që i kemi bërë Partisë Komuniste të Kinës. Kjo ka pasur edhe një arsy, se ne, si marksistë-leninistë, kemi shpresuar që një vend i madh si Kina, në rast se do të ecte në rrugë të drejtë, do të kontribuonte shumë në dobi të revolucionit. Kjo, natyrisht, do të ishte një fitore e madhe për çështjen tonë. Por, siç duket, pikëpamjet dhe veprimet e udhëheqësve kinezë nuk ishin analizuar si duhet. Për ne, komunistët shqiptarë, kjo nuk është bërë sa duhet edhe për shkak të mungesës së kontakteve të nevojshme, të largësisë, por edhe për arsyen e disa taktikave false të Mao Ce Dunit dhe të udhëheqjes kinezë në disa periudha kyç të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Sidoqoftë, fakt është se Partia jonë, qysh në kontaktet e para që pati me Mao Ce Dunin në Pekin në vitin 1956, kur u bë Kongresi i 8-të i Partisë Komuniste të Kinës; një vit më vonë, në Mbledhjen e Moskës të vitit 1957, si dhe në disa mbledhje e takime të tjera që u bënë më pas, konstatoi se për disa çështje udhëheqësit kinezë nuk ishin në rrugën tonë, ata ecnin në të ku-

ndërtën ose qëndronin në mes të rrugës. Natyrisht, këto qëndrime të tyre neve na bënin përshtypje jo të mirë, megjithatë kishim shpresë sepse në disa momente ata mbanin edhe disa qëndrime që të krijonin përshtypjen se ishin të drejta. Mirëpo, rrjedha e kohës na bëri të mendojmë se edhe kur adaptionin ndonjë qëndrim që n'a dukej disi i mirë, udhëheqësit kinezë ndiqnin qëllime të këqija. Kështu, gradualisht, filloj të forcohet te ne mos-besimi ndaj tyre, ndaj atyre që deklaronin me fjalë dhe që nuk i realizonin në praktikë, në jetë.

Nga njëra anë, ne ditë për ditë atë që konstatonim për Partinë Komuniste të Kinës, e shkruanim dhe jepnim njëfarë gjykimi në bazë të atyre faktave që dispononim. Mundet që jo çdo gjë të ishte ashtu si mendonim ne, për arsyen se e kishim të vështirë përmungesë faktesh të kuptionim e të interpretionim plotësisht ashtu si duhej të gjitha ngjarjet që vërtetoheshin në Kinë. Sidoqoftë, ne mbanim shënim dhe njëkohësisht shprehnim mendimin tonë. Këtë e bënim edhe për arsyen të shpresës që kishim te Kina, duke menduar se do të vihej në rrugë të drejtë. Për një gjë të tillë krijon bindje po të studiosh historinë e Partisë sonë, dokumentet e saj. Kur vinin këtu Çu En Lai dhe kuadro të tjerë të udhëheqjes kineze, ose kur shkonin shokët tanë në Kinë, si në njërin rast, ashtu edhe në tjetrin, ne ua shprehnim hapur kinezëve mendimin tonë përkëtë ose atë problem, duke u thënë se ky qëndrim ishte i drejtë, tjetri na dukej i gabuar etj. Nga ana tjetër, ne pohonim rolin e madh të Kinës dhe të Mao Ce Dunit por këto ishin taktika dhe duhet të njohim që nuk patëm sukses në përpjekjet tona për t'i vënë në rrugë të

drejtë udhëheqësit kinezë. Me pikëpamjet e qëndrimet e tyre, ata vërtetuan se ishin armiq të marksizëm-le-ninizmit dhe aq megalomanë saqë të gjitha ato që u thoshim, nuk u bënин asnje përshtypje,asnje efekt pozitiv. Përkundrazi, ata bënин të kundërtën e atyre që deklaronim ne.

Tani që po e studiojmë më thellë rrugën e Mao Ce Dunit, arrijmë në konkluzionin e bazuar se ajo ka qenë rrugë antimarksiste. Mao Ce Duni, sipas mendimit tonë, del që nuk ishte marksist-leninist, por një demokrat borgjez përparimtar.

Në gjithë historinë e Partisë Komuniste të Kinës ne shikojmë që largohet një mareshal dhe në vend të tij vjen një tjetër. Erdhi Vu Tehu, pastaj u përpdqen të vënë një tjetër, iku Pin De Huaja, erdhi Lin Biaoja, më pas vunë edhe Ten Hsiao Pinin. Kjo është një çështje si e zotërinjve të luftës. Këta kanë qenë dhe kanë sunduar si mbretër në provinca. Me të tillë udhëheqës dukej se ç'ishte kjo parti dhe këtu është gjithë katastrofa e Kinës. Qysh në fillim dhe vazhdimesht, gjatë gjithë kohës, atje nuk u arrit dot të kristalohej një bërrhamë marksiste-leniniste. Fraksione mund të dalin në një parti, por, kur ekziston kolona vertebrore marksiste-leniniste ajo vazhdon të jetojë, kurse në Partinë Komuniste të Kinës një kolonë e tillë nuk ka ekzistuar asnjëherë. Edhe pas shpalljes së Republikës Popullore të Kinës, borgjezia atje ka ekzistuar dhe ka vepruar si dhe më parë.

Çu En Lai u pa që në fillim se kush ishte, kurse Maoja paraqitej i kamufluar. Ky ishte një ëndërrues, budist, konfucist. Ata që e rrëthonin, megjithëse në

dukje mbanin flamurin e tij, vepronin siç donin vetë. Maoja vetë ishte në pozita të lëkundura dhe të tjerët, në luftën që bënин për pushtet, kapeshin pas ndonjë formule të tij sa për të gënjer.

Për sa i përket të ashtuquajturit Revolucion Kulturor Proletar, mund të themi se ai nuk ishte proletar, përderisa u ngritën studentët t'i mësonin proletariatit si të proletarizohet! Mirëpo ka edhe nga ata që thonë se Mao Ce Duni nuk paska faj për këtë!

Disa të tjerë mendojnë dhe pyesin: «Po pse, nuk ka asgjë të mirë Mao Ce Duni?». Në qoftë se më lejoni, shokë, për të shprehur mendimin rreth kësaj pyetjeje që bëhet, desha të përdor një figurë. Anët e mira të Mao Ce Dunit janë si uji i një lumi të turbullt plot me baltë që zbret me vrull nga lartësitë, shtrihet në fushë, krijon moçalishte dhe kthehet në ujë të ndenjur. Mirëpo uji i ndenjur qelbet dhe, siç dihet, në moçalishte lindin, zhvillohen e rrojnë gjarpërinj, bretkosa, mushkonja, «njëqind lule», «njëqind shkolla». Pastaj uji përsëri gjen nië tej një shteg, bie prapë më poshtë me rrëmbim dhe po kështu në fushën e dytë krijohen moçale të tjera me ujë të qelbur, ku përsëri fillojnë jetën e tyre mushkonjat, bretkosat, gjarpërinjtë e gjithfarë kriesash të tjera. Dhe një gjë e tillë, sipas Maos, do të vazhdojë për 10 mijë vjet me radhë. Ja, të tilla janë pikëpamjet maoiste «dialktike, revolucionare». Pikëpamjet e tij të kujtojnë pikëpamjet e gjermanit Hekel. Dhe në fakt kështu ka ngjarë në Kinë, ec, ndalo në vend, ec përsëri dhe prapë ndalo. Prandaj, ne komunistët do të bënim krim po të mos e thoshim këtë të

vërtetë, që është e qartë si drita e diellit. Ne kemi thënë që Mao Ce Duni është marksist-leninist, por, nga një studim i thellë që po i bëjmë veprës së tij, del se ai nuk është i tillë.

Tani ka disa njerëz që thonë se Hua Kuo Feni është i poshtër, kurse Mao Ce Duni s'ka qenë i tillë. Ne, komunistët shqiptarë, mendojmë se Mao Ce Duni nuk ka qenë marksist-leninist. Gjithë politika e Hua Kuo Fenit ka një bazë, ka një burim, i cili bën që Kina të ecë sot me të katër drejt kapitalizmit.

Disa të tjerë Mao Ce Dunin e krahasojnë me Stalinin. Mendimi ynë është se në asnjë mënyrë nuk mund të bëhet krahasim midis tyre. Stalini ishte marksist-leninist i shquar, ai i luftoi pa mëshirë trockistët, buharinistët e gjithë armiqtë e tjerë të marksizëm-leninizmit, por burokratizmi që kishte zënë vend në parti dhe në pushtet, bëri të mundur lindjen e revizionizmit në Bashkimin Sovjetik. Kurse Mao Ce Duni nuk ishte marksist-leninist dhe partia që udhëhiqte ai nuk ishte marksiste-leniniste. Populli kinez luftoi dhe u çlirua. Në Kinë, në fillim, u ndërmorën disa reforma mbi bazë «socialiste», por Mao Ce Duni nuk ishte për ndërtimin e socializmit, përderisa atje u lanë në fuqi rentat, fshatarët e pasur, pronarët e mëdhenj të tokave e të ndërmarrjeve etj., etj. Ky ishte një veprim antimarksist jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Prandaj nuk mund të themi që Mao Ce Duni ka bërë luftë parimore. Në Kinë është bërë vazhdimit luftë për pushtet personal, për pushtetin e grupeve. Për këtë flet qartë ekzistenca e dy vijave në parti.

Mao Ce Duni, gjithashtu, teorizonte se partitë e tjera do të zhduken vetëm në komunizëm, kur do të zhduket edhe partia komuniste. Këto pikëpamje nuk e mbrojnë Mao Ce Dunin, përkundrazi ato vërtetojnë se ai ka qenë element antimarksist. Mao Ce Duni ka bërë autokritikë, i ka përgënjeshtuar ose ka bërë sikur i ka hedhur poshtë këto pikëpamje, megjithatë përsëri ka gabuar. Prandaj nuk është e drejtë të thuhet se Mao Ce Duni është marksist-leninist i madh. Ky pohim i intereson vetëm kapitalizmit. Bile borgjezët kapitalistë dhe reaksiioni sot kërkojnë të mbrohet Mao Ce Duni, të mos digjet kjo kartë, se hrushovizmi, titizmi dhe euro-komunizmi u dogjën. Atyre u duhet tani një maskë tjetër për të mashtruar popujt. Dhe këtë ata e kanë gjetur te Mao Ce Duni dhe te maoccdunideja. Prandaj Partia jonë mendon të hapet zjarr kundër tyre.

Megjithatë, ne kemi ecur dhe do të ecim me kujdes në këtë drejtim. Këtu qëndron pjekuria e partive tona. Po pse duhet të ecim me kujdes? Për të mirën e revolucionit, sepse ka në botë edhe shumë shokë të mirë që akoma nuk e kanë kuptuar tradhtinë e revolucionisteve kinezë, ka edhe nga ata që e kanë kuptuar përgjysmë, ka të tjerë që do ta kuptojnë nesër, por ka edhe nga ata që mund të mos e kuptojnë fare. Pra, për ta demaskuar dhe për ta mposhtur armikun, duhet ecur me kujdes dhe me maturi.

E vërteta është se revisionistët kinczë janë armiq të mëdhenj. Nuk e di në qoftë se jeni në dijeni të asaj çka pohonte Agjencia Japoneze e Lajmeve, sipas së cilës Ten Hsiao Pini ka deklaruar: «Ne do të hyjmë në

luftë për të mbrojtur një popull dhe, në qoftë se nuk futemi në luftë për këtë, atëherë duhet të ngrihet populli kinez të rrëzojë qeverinë tonë». Këtu ai e ka fjalën për të mbrojtur Kamboxhian kundër Vietnamit. Të tilla gjëra na thoshte edhe Mao Ce Duni: «Në qoftë se Kina do të bëhet një vend kapitalist ose dhe më keq, fashist, duke e parë çështjen në aspektin e të kundertave, ju duhet të hidheni në luftë kundër Kinës».

Ne kemi bindjen se jemi në rrugë të drejtë, se problemi i Kinës e gjykojmë drejt. Përpara nesh qëndron një detyrë e madhe, të sqarojmë njërcëzit me fakte, me dokumente për të fituar sa më shumë prej tyre në anën tonë. Për këtë arsyen duhet të bëjmë përpjekje të studiojmë në mënyrë të thelluar çdo gjë që ka të bëjë me Kinën. Dhe ne marksistë-leninistët nuk studiojmë sa për të studiuar, nuk jemi njerëz thjesht të bibliotekave. Ne i duam e i respektojmë shumë librat me vlerë dhe i studiojmë ata, por jemi edhe njerëz të aksionit, të revolucionit dhe udhëhiqemi nga marksizëm-leninizmi. Kur Partia jep një mendim të peshuar mirë, pra pasi mat, siç thotë populli, «7 herë dhe pret një herë», atëherë edhe masat e gjera të popullit tonë e kuptojnë, e mbështetin dhe ecin në rrugën që u tregon ajo. Ja, pra, ku qëndron forca jonë, tck uniteti i popullit rreth Partisë.

Për Partinë e Punës së Shqipërisë është, gjithashtu, kënaqësi e madhe që në këtë drejtim ajo është në unitet të plotë me partitë e tjera të vërteta marksiste-leniniste. Partitetona kanë probleme shumë të mëdha për të zgjidhur në luftën kundër revizionizmit kinez,

kundër rrymës së cgër të revizionizmit modern, që është mbështetësi kryesor i imperializmit dhe i kapitalizmit botëror në luftën kundër popujve.

Prandaj, shoku Amazonas, pavarësisht se vitet kalojnë e mosha bën punën e vet, ne e ndiejmë veten të rinj, sepse të tillë na bën ideologja jonë, lufta jonë. Është forca e ideologjisë sonë, që na bën të mos ndiejmë as lodhjen, as moshën.

Problemet që trajtojmë në shkrimet tona janë çështje të mëdha për Partinë dhe për vendin tonë të vogël. Duhej të flitej për revolucionistët kinezë medoemos, por edhe për revolucionistët e tjerë, që populli ynë të kuptonte thellë drejtësinë e vijës së Partisë. Edhe për Kim Ir Senin do të flasim ne, se veprimet e tij dhe ato që janë thënë për të si një «hero legjendar i kohës sonë» etj., etj., janë me të vërtetë skandaloze.

Në një artikull të fundit të gazetës zyrtare koreane «Rodon Shimbun», shkruhej se Marks i Engels kanë qenë revolucionarë, por për kohën e tyre; ata nuk e kanë parashikuar dot ndërtimin e socializmit. Lenini ka qenë gjithashtu revolucionar, por edhe ai ka qenë i tillë për kohën e tij, për periudhën e daljes së imperializmit dhe të ndërtimit të socializmit. Kurse aktualisht ekziston lufta për pavarësi dhe në këtë periudhë është Kim Ir Seni, janë «idetë çuçe» të tij ato që duhet të udhëheqin sot botën! Sipas tij, mësimet e Marks-it dhe të Engelsit qenkan vjetruar, po ashtu edhe ato të Leninit, kurse Mao Ce Dunin ai nuk e zë fare në gojë.

Çështje të rëndësishme, që Partia jonë i ka analizuar dhe për të cilat i është dashur të shkruajë, kanë

qenë ndër të tjera edhe problemet e Vietnamit, të Kamboxhias e të Jugosllavisë.

Tani po botojmë edhe një libër<sup>1</sup> kundër vetadministrimit jugosllav, kundër librit të Eduard Kardelit: «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetëqeversjes socialiste». Po e bëjmë një gjë të tillë për të demaskuar pikëpamjet antimarksiste të këtij titisti, i cili bazohet në teoritë anarkosindikaliste. Sot kapitalizmi botëror po e popullarizon vetadministrimin jugosllav si një sistem gjoja marksist dhe këtë e bën për kapërcimin e kësaj faze të vështirë ku ndodhet ky sistem i kalbur. Teoria jugosllave e «vetadministrimit socialist» është gjithashtu një armë që po përdor revizionizmi në momentet revolucionare, të vështira për të, kur ai e shëh se nuk po del dot nga situata. Në këto kushte, ai adopton këtë armë gjoja si teori socialiste. E parë në këtë prizëm, çështja e titizmit ka rëndësi të studiohet dhe të kuptohet në tërë thellësinë e gjerësinë e saj.

Librin e renegatit Kardel, si dhe fjalimet e diskutimet e ndryshme të Titos, ne i demaskojmë duke u bazuar te Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Ky demaskim që i bëjmë teorisë titiste të vetadministrimit nuk është i panjohur, por libri i ri që po botojmë do të jetë një ndihmë tjeter për Partinë tonë.

Në librin e Eduard Kardelit thuhet pak a shumë se sistemi jugosllav është më i afërt me demokracinë amerikane sesa me ndonjë nga demokracitë perëndi-

---

1. Në tetor 1978 u botua dhe u vu në qarkullim në shqip dhe në disa gjuhë të huaja libri i shokut Enver Hoxha «Vetadministrimi jugosllav — teori dhe praktikë kapitaliste».

more<sup>1</sup>. Kurse Mao Ce Duni ka thënë se kinezët do të shkojnë në socializëm duke u frymëzuar nga «demokracia» amerikane. Ata janë duke ndërtuar një sistem që, sipas mendimit tonë, është një shkrirje e «demokracisë» amerikane me vetadministrimin jugosllav dhe me sistemin ekonomik të Japonisë. Sipas këtij sistemi kinez, presupozohet që Kina të ruajë specifikën feudale, të ruajë edhe pozitat sunduese të ushtrisë. Pra, revisionistët kinezë do të bëjnë një kombinim të atyre që thashë, duke u munduar njëkohësisht të jepin përshtypjen se në Kinë po ndërtohet gjoja socializmi. Kina përpinqet të bëhet kështu një superfuqi imperialishte me maskë socialiste. Aktualisht ajo është e angazhuar, në rrugën që ka zgjedhur, kryesisht me Japoninë dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe me Francën, Anglinë etj. Udhëheqësit kinezë mendojnë si megalomanë të tërbuar kur shohin se Japonia u bë një fuqi e madhe pas lufte. «Po ne, që jemi 800 milionë, nuk mund të bëhem si ajo?» mendojnë ata. «Prandaj përse të mos ndjekim edhe ne rrugën e saj? Për ndërtimin e socializmit ne do të mbështetemi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se edhe Japonia u mbështet shumë tek ato dhe u bë një fuqi e madhe».

Vajtja e Hua Kuo Fenit në Jugosllavi, shkëmbimi i delegacioneve të rangjeve të ndryshme midis Jugosllavisë dhe Kinës janë bërë për dy qëllime nga ki-

1. Eduard Kardel «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetëqeverisjes socialiste», Rilindja, Prishtinë, 1978, botimi shqip, f. 235.

nezët: Të marrin diçka nga ky sistem vetadministri-mi dhe të trashëgojnë «lëvizjen e të paangazhuarve», që e ka shpikur Titoja. E gjithë kjo bëhet që Kina të krijojë në botë baza dhe zona influence, sepse, kuptohet, ajo zhvillon një luftë të ethshme për dominim, për hegjemoni botërore. Vizita e Hua Kuo Fenit në Rumani dhe në Jugosllavi ka qenë dhe një provokacion, një intrigë kundër popujve të Ballkanit, sidomos kundër Shqipërisë, pavarësisht se Jugosllavinë e përdorin edhe sovjetikët.

Eurokomunizmi, që duket sikur është një rrymë me pikëpamje të ndryshme nga rrymat e tjera revizioniste, në të vërtetë, në vetvete mbështetet në pikëpamjet e Bakuninit, të Prudonit, në vetadministrim jugosllav etj., kuptohet aq sa ia lejon aleanca që ai ka me kapitalin.

Në këto drejtime, veç veprimeve konkrete kundër revizionizmit, që janë të domosdoshme, Partia na ka vënë për detyrë t'i studiojmë këto rryma, që të mos gabojmë dhe as të mos gënjejehemi prej tyre. Ne i hoqëm në kurrizin tonë ca kohë të këqijat e titizmit, derisa arritëm t'i njihnim kush ishin revizionistët jugosllavë. Kështu na ndodhi edhe me Bashkimin Sovjetik, pas vdekjes së Stalinit. Ne i vazhduam marrëdhëni me sovjetikët, duke menduar në fillim se udhëheqësit e Partisë Komuniste dhe të shtetit sovjetik ndiqnin rrugën e Stalinit, por, kur i pamë se kush ishin, i demaskuam dhe i braktisëm. Në të njëjtën mënyrë vepruam kur pamë ç'ishin edhe kinezët tash së fundi. Nga gjithë kjo luftë ne kemi nxjerrë mësimë.

Për sa i përket aktit arbitrar të prerjes së ndih-

mave e të kredive nga ana e kinezëve ju ju vuri në dijeni me hollësi shoku Ramiz. Ndihamat kineze kanë qenë ndihma materiale të jashtme. Por, për disa nga këto ndihma, derisa u realizuan, neve na është dashur të bëjmë shumë luftë, sidomos me Çu En Lain dhe me Li Hsien Nienin, dy antimarksistë dhe antishqiptarë. Tani me veprimin që ndërmorën, udhëheqësit e rinj kinezë na i kanë lënë në mes shumë objekte. Megjithatë, ne do t'i përfundojmë këto me forcat tona të brendshme dhe për këtë i kemi bërë me kohë të gjitha llogaritë, sepse e parashikonim që mund të na ngjiste një gjë e tillë. Akti i tyre antimarksist nuk na erdhi përnjëherë, fare papritur. Javash-javash, me forcat tona, ne do t'i ndërtojmë të gjitha objektet e lëna përgjysmë nga kinezët, si dhe objekte të tjera të pafilluara akoma, për arsy se tani kemi një industri mekanike më të zhvilluar, kemi edhe kuadro të përgatitur mirë. Disa makineri e pajisje që nuk i prodhojmë dot vetë, do t'i blejmë jashtë me para në dorë, me devizë apo me kliring, po kurrë me kredi.

Ne vetë do të ndërtojmë jo vetëm këto që kemi pasë kontraktuar me kinezët, por kemi bërë llogari që për planin e ri pesëvjeçar që fillon në vitin 1981, duke u bazuar konkretisht në mundësitet tona, me llogari jofantaziste, por reale, mund të ndërtojmë të tjera vepra të reja për ta çuar gjithnjë përpara ndërtimin socialist të vendit.

Industria jonë do të përparojë më tej në pesëvjeçarin 1981-1985, por vëmendje ne do t'i kushtojmë veçanërisht edhe përparimit të bujqësisë. Kjo ka rëndësi të madhe se është baza e industrisë. Bujqësia

nuk ka nevojë për të bërë investime që varen nga jashtë; ajo ka nevojë për investime të tilla që kanë të bëjnë me përmirësimin e tokës, me ujitjen, me mekanizimin, me farëra të zgjedhura, me një organizim më të mirë të punës etj. Dhe të tëra këto mundësi në kohën e tanishme i kemi, por mbi të gjitha ne kemi patriotizmin e zjarrtë të popullit tonë. Nuk janë, pra, kinezët që na kanë mbajtur me bukë me ato që na kanë dhënë. Edhe ne u kemi dhënë atyre.

**SHOKU ZHOAO AMAZONAS:** Ndërtimi i socializmit në Shqipëri ka rëndësi shumë të madhe politike dhe ideologjike, sepse tregon që është e mundur të ndërtohet socializmi edhe në një vend kaq të vogël, duke u mbështetur krejtësisht në forcat e veta. Një gjë e tillë ka rëndësi për të gjitha vendet e tjera, të vogla e të mëdha. Ajo ka rëndësi edhe për perspektivat e luftës sonë sepse tashti bëhet fjalë për një vend të vogël që është duke ndërtuar socializmin, ndërsa më parë thuhej që Kina ndërtonte socializmin, por ajo është vend i madh. Ne mendojmë se shembulli i ndërtimit të socializmit në Shqipëri do të luajë rol të madh në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Të gjitha partitë e vërteta marksiste-leniniste ndjekin me vëmendje të veçantë zhvillimin e Shqipërisë. Ne gjithmonë kemi ndjekur me kujdes qëndrimin e shokëve shqiptarë ndaj ngjarjeve me rëndësi botërore dhe shpëgjinjet që japid ata rrëth tyre dhe jemi shumë të kënaqur se mënyra si shtrohen çështjet nga ana e tyre na hap neve rrugë të reja.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Vështirësi për ndërtimin e socializmit në vendin tonë ka pasur, ka dhe do

të ketë, por për kapërcimin e tyre me sukses rëndësi vendimtare kanë së pari, uniteti në parti, së dyti, patriotizmi i masave. Populli ynë është i thjeshtë dhe pa pretendime. Ai ecën përpëra dhe e kupton që përmirësimi i mëtejshëm i jetës së tij do të arrihet vetëm në rrugën e Partisë. Kjo ka rëndësi të madhe për ne. Gjithashtu, Partinë tonë e ka preokupuar kurdoherë çështja që me rrugën që ndjekim, të fitojmë besimin e shokëve e të miqve jashtë, me qëllim që, me aq sa të mundim, të kontribuojmë në mënyrë modeste në atë që thoni ju. Pra, me shembullin tonë, jo vetëm me qëndrimet politike, por edhe me realizimet ekonomike, të tregojmë se një vend i vogël si Shqipëria, pa ndihmën materiale të kurkujt, por vetëm me forcat e veta dhe me mbështetjen miqësore, morale, politike, ideologjike të marksistë-leninistëve dhe të popujve përparrimtarë të botës, është duke ndërtuar socializmin.

*Pastaj, shoku Zhao Amazonas foli për rëndësinë e Kongresit të 7-të të PPSH, për hallkat e dobëta të kapitalizmit, si dhe për perspektivat e revolucionit në botë. Mbası vlerësoi lart veprën «Imperializmi dhe revolucioni» të cilën ai e kishte lexuar, fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:*

Këtë libër ne do ta botojmë edhe në gjuhë të huaja, mbasi nisemi nga parimi që çështjet e trajtuara në të na takojnë jo vetëm neve, por edhe gjithë marksistë-leninistëve në botë. Ne nuk mund të batojmë gjëra që i përkasin tërë lëvizjes komuniste, pa u konsultuar më parë me shokët e partive marksiste-leniniste. Kjo është çështje që na përket të gjithëve, ajo ka të bëjë me ideologjinë tonë të përbashkët. Kështu e

mendojmë ne këtë çështje. Prandaj, për botimin e librave të tillë si ky, ne dëshirojmë të konsultohemi, të kemi edhe mendimin e shokëve marksistë-leninistë, për të partive të tjera motra për çështjet që ngrihen në të dhe konkluzionet që do të nxirren, duhet të bëhen armë e fuqishme për të gjithë në rrugën tonë revolucionare.

Me ju, shokë, ne kemi për të biseduar edhe për shumë probleme të tjera, siç janë problemet e Evropës dhe të Jugosllavisë, ku vdekja e Titos do të ketë konsekuenca, për problemet e eurokomunizmit, të aleancave etj., etj. Tani ne nuk diskutojmë dot gjerësisht për këto çështje, por kur të vini herë tjetër, do të kemi kohë të bisedojmë.

Dëshiroj t'ju falënderoj edhe një herë, shokë, për vizitën që më bëtë. Jam i gjuar që erdhët sot tek unë dhe bashkërisht shkëmbbyem mendime. Të fala shokëve! Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

## **NE TË GJITHË JEMI USHTARE TË PARTISË**

*Nga biseda gjatë darkës në Pallatin e Brigadave  
me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes*

**16 tetor 1978**

**SHOKU ENVER HOXHA:** O! Miha! Gëzohem që  
të shoh!

**SHOKU MIHA LAKO:** Të rroni sa malet!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Faleminderit! Të rrojë  
Partia!

**Një grup punëtorësh e uron shokun Enver në  
emër të klasës punëtore:** «Të na rroni sa malet e ju pa-  
çim sa jeta!».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si je more Kristo?

**SHOKU KRISTAQ FUNDO:** Paçi jetë të gjatë e  
lumturi! Urimet më të mira!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Faleminderit shumë.  
Gëzuar!

Ky është shoku im i vjetër i Liceut të Korçës,  
Kristo Fundoja, matematikan i shquar. Për këtë kemi  
pasur respekt të madh, se që i vogël ishte shumë i zoti  
në matematikë.

Gëzuar, Violetë!<sup>1</sup> Moj, «teto Ollgë»! (Të qeshura.)  
Gëzuar!

Gëzuar, Dritëro!

**SHOKU DRITËRO AGOLLI:** Të na rroni ju, shoku  
Enver!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ku je moj Jorgji! Gëzuar!

**SHOQJA JORGJIA TRUJA:** Gëzuar! Të rroni sa  
malet!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Faleminderit shumë!  
Të rroni ju!

Oo, Xhevati! Pa afrohu, more Xhevat! E solle dhe  
magjen. Të them të drejtën shfaqja juaj në festival më  
pëlqeu.

**SHOKU XHEVAT AVDALLI:** Në festivalet e tje-  
ra do ta bëjmë edhe më mirë akoma, me bukë e me  
të gjitha. Të na rrosh sa malet!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rrojë Partia!

Si je Avdi? Gëzohem shumë që erdhe e që të shoh,  
në këtë mbrëmje, se më duket sikur shoh gjithë ma-  
lësinë.

**SHOKU AVDI BAJRAMI:** Të uroj 70-vjetorin në  
emër të të gjithë malësorëve të Tropojës. Të urojmë të  
rrosh edhe shumë vjet, për Partinë e për Shqipërinë!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rrojë Shqipëria! Të  
rrojë populli! Gëzuar! Pleqëri të bardhë!

(*I drejtohet shoqes Ela Gjikondi.*)

Gëzuar! Si është Leleja?<sup>2</sup> I bëni shumë të fala.

1. Violeta Manushli, Artiste e Popullit, që interpreton Oll-  
gën në komedinë «Zonja nga qyteti» të Ruzhdit Pulahës.

2. Vangjel Gjikondi.

Hajde Qazim. Duke të shtrënguar dorën ty, më duket sikur ua kam shtrënguar të gjithë shokëve të mi të ushtrisë. Ta kemi të çeliktë ushtrinë tonë heroike!

**SHOKU QAZIM KONDI:** Për shëndetin tuaj!

(Afrohen për të uruar grupi i pionierëve dhe i rinisë.)

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këta janë më të mirët, më të bukurit!

**NJË PIONIER:** Në emër të pionierëve të Shqipërisë. ju urojmë të rroni sa malet tonë, i shtrenjti xha-xhi Enver!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rroni ju, brezi i ardhshëm!

**NJË I RI:** Në emër të brezit të ri të Shqipërisë, ju urojmë «Të rroni sa malet! Do të jemi vazhdues të rrugës suaj!».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rroni ju, fidanishtja e Partisë! Me ju nuk po e ngremë gotën, se ju nuk pini. (Të qeshura.)

**NJË E RE:** Po mua më njihni, shoku Enver?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po si nuk të njoh! Ty, vajzë, të kam parë në televizor dhe jam kënaqur shumë për zgjuarsinë, për shkathtësinë dhe për shpirtin tënd luftarak. Të lumtë!

**E REJA:** Faleminderit. Ne mësojmë e do të më-sojmë nga ju gjithmonë, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të bëheni bija dhe bij të denjë të këtij populli dhe të kësaj partic. Hajde të bëjmë një fotografi bashkë me Nexhmijen. Kështu, pra, të mësosh sa më shumë dhe të vazhdosh të flasësh në televizor.

**E REJA:** Të punojmë dhe të mësojmë më shumë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** E shikon! Thuaj pastaj që nuk e ka kokën plot kjo vajzë! Më korrigjoi menjëherë!

Besoj se nuk ka më njeri për të ardhur? Pastaj, edhe po të ketë, le të vijnë! Tani dua të them edhe unë dy fjalë, po do të ngrihem në këmbë. Do të flas në këmbë, se dua t'i nderoj gjithë këta miq e shokë që kanë ardhur sonte në këtë mbrëmje.

*Pas fjalës<sup>1</sup> që mbajti me këtë rast, shoku Enver shkoi sallë më sallë e i uroi me radhë, në çdo tavolinë, gjithë të ftuarit.*

Gëzuar, shokë! Për shëndetin tuaj! Për shëndetin e Partisë! Për shëndetin e popullit!

Si je, Papakristo? Je mirë?

**SHOKU SOTIR PAPAKRISTO:** Mirë jam, sidomos tashti që të pashë. Doja të takoja edhe një herë e të shkëmbeja dy fjalë me ty, pastaj le të vdes.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ja, u takuam. U gëzo-va shumë që erdhe sonte. Hajde Sulo, na bëj një fotografi me profesor Papakriston. Qofsh mirë, Papakristo! Pleqëri të bardhë!

Gëzuar ju, shokë! Gëzuar!

Si je ti, Elmaz Çani?

Të rrojë Partia! Të rroni ju!

Ku je more Mihal?

**SHOKU MIHAL DHIMA:** Këtu jam, këtu. Ku je ti, more trim i trimave! Të na rrosh sa malet, sa të jetëjeta të rrosh!

---

1. Shih në këtë vëllim, f. 222.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po si je, Mihal, mirë ke qenë?

**SHOKU MIHAL DHIMA:** Mirë jam, mirë jemi të gjithë! Nuk e përshkruaj dot gëzimin që ndiej sonte në këtë mbrëmje të ditëlindjes tënde.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Edhe gëzimi im është i madh. Pleqëri të bardhë!

Si je Polikseni, mirë je?

**SHOQJA POLIKSENI THEOHARI:** Mirë jam. Të na rrosh sa malet! Gëzohem shumë që e arritëm këtë ditë. Të arrijmë edhe në 100-vjetorin!

*Pastaj shoku Enver këndon një këngë gjirokastrite me Xhevrat Avdallin, me shokun Hysni Kapo e shokë të tjerë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si je, more Neshat? Nëma dorën këtu! Ngaherë e kujtoj pritjen e përzemërt të babait tënd.

**SHOKU NESHAT HYSI:** Të na rrosh sa mali i Tomorit, shoku Enver!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rroni ju! Në gëzime, në shtëpinë e në fëmijët tuaj! Edhe lufta jote ka mbetur e paharruar. Hajde, ngrije gotën, gëzuar!

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Kjo është vajza e Adem Rekës dhe dëshiron t'ju takojë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Hajde këtu, hajde. Si je, ku je?

**SHOQJA SHPRESA REKA:** Mirë! Jam studente.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa fëmijë jeni?

**SHOQJA SHPRESA REKA:** Kam një motër të madhe studente dhe dy vëllezër.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shumë mirë. Vepra

heroike e babait tuaj do të mbetet e pavdekshme. Shumë të fala i bëni mëmës.

**NJË PUNONJËS I KINOSTUDIOS:** Shoku Enver, ne ju urojmë nga ana e punonjësve të Kinostudios dhe të Televizionit, të të kemi sa malet! Jetë të gjatë!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Faleminderit. Urime juve, që po krijoni vepra aq të bukura, të shumta e me cilësi të lartë. Në filmat që keni përgatitur, keni nxjerrë mirë bukuritë e vendit dhe të popullit tonë, me të cilat njihet edhe bota jashtë.

Si je moj Sabrije, je mirë? Sa fëmijë ke?

**SHOQJA SABRIJE OSMANI:** Pesë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** A më të lumtë! Kjo është motra e Adem Osmanit.

A je, Ali Gjura? Si e ke shëndetin?

**SHOKU ALI GJURA:** Mirë, shumë mirë, shoku Enver, të na rrosh sa malet!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ju si jeni?

**SHOKU SADIK JONUZI:** Shumë mirë. Që para 10 vjetësh në Fratar të Përmetit nuk jemi takuar. E kishte marrë malli zemrën time.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të rrosh ti! Paç pleqëri të bardhë!

**SHOKU SADIK JONUZI:** Të dëgjofsha të mirën gjithmonë, se jam 90 vjeç dhe nuk besoj të arrij më.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Do të arrish, do të vesh 110 vjeç, se Partia na jep fuqi. Pa më shiko mua; pse dukem unë që kam 70 vjeç? Si të duket ty?

**SHOKU SADIK JONUZI:** Si i ri më duke!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Të fala bëju të gjithëve nga Mallakastra.

Pasi qëndron edhe pak, shoku Enver largohet duke përshëndetur me këto fjalë:

Mbeçi me shëndet! Të rrojë Partia! Të rroni ju të gjithë!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura gjatë  
kësaj bisede që gjenden  
në AQP*

# **PRANË ÇDO KOMUNISTI RREH ZEMRA TRIME E POPULLIT TONE TË MREKULLUESHËM**

*Fjala në darkën e dhënë në Pallatin e Brigadave  
me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes*

**16 tetor 1978**

Të dashur shokë dhe shoqe,

Ndjenjat tuaja komuniste që shprehët këtu, në këtë darkë shoqërore, me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes sime, më prekën pa masë. Unë falënderoj me përzemërsinë më të madhe Partinë tonë heroike dhe ju, shoqet dhe shokët e mi të dashur të luftës që të ndërtimit të socializmit, për ndjenjat e thella të dashurisë që tregoni ndaj meje dhe për vlerësimin e punës sime në shërbim të Partisë dhe të popullit.

Dëshiroj të theksoj se meritat e mia, për të cilat ju folët këtu, janë meritat e gjithë Partisë dhe të të gjithë shokëve të udhëheqjes. Në punën time unë nuk kam qenë i vetëm dhe asnjë rezultat nuk mund të arrihet e nuk do të arrihej me punë të vëtmuar. Por kam qenë vazhdimesht në unitet të plotë me shokët e mi të dashur të Byrosë Politike, të Komitetit

Qendror, si dhe me shokët e tjerë të Partisë, me komunistë të thjeshtë, kam bashkëpunuar ngushtë me ta çdo ditë e çdo orë. Është ky unitet, është kjo dashuri e sinqertë revolucionare, është ky qëndrim i hapët dhe i çilltër në mes nesh, që ka siguruar unitetin e çeliktë në udhëheqje e në Parti, gjë që ka pasur, ka e do të ketë kurdoherë një rëndësi të madhe e jetike për Partinë e për popullin tonë.

Në gjithë veprimtarinë time, në ato që kam mësuar dhe për mënyrën si kam punuar, më ka udhëhequr dashuria për popullin, për këtë popull kaq të mirë, që ka parë shumë e ka vuajtur shumë! Sado të kemi luftuar e punuar, sado të luftojmë e të punojmë, nuk ka qenë e nuk është e mjaftueshme e aq sa meriton populli ynë, që na rriti, që na mbrojti në zjarrin e Luftës Nacionallirimi, që vazhdoi e vazhdon të na mbështetë në të gjitha të përpjetat e monopatet për ndërtimin e socializmit, për të ruajtur të paprekura lirinë, pavarësinë, sovranitetin e fitoret e socializmit. Gjatë gjithë këtyre viteve, ne dhe gjithë Partia kemi ndier mbështetjen e fuqishme e ngrohtësinë e gjirit të popullit, të klasës heroike punëtore, të fshatarësisë patriote, të inteligjencies popullore, të burrave e grave, të pleqve e të rinjve.

Dua t'ju them, shokë e miq, që Partinë e ka bërë të fortë e të guximshme edhe kjo dashuri e madhe që tregon populli, mbështetja që i bën ai vijës së drejtë të saj dhe vendosmëria me të cilën lufton për ta zbatuar atë në jetë. Desha, gjithashtu, t'ju them se në çdo kohë, të mirë a të keqe, unë dhe shokët e mi kemi ndier afér nesh të rrahë zemra trime e popu-

llit tonë të mrekullueshëm. Kjo na ka bërë, mua dhe shokët e mi, të kapërcejmë me guxim dhe me besim çdo vështirësi.

Partia që ne formuam së toku në zjarrin e luttës, që e ndërtuam në mes stuhish e furtunash dhe që e mbajtëm të pastër, që po e kalitim vazhdimisht me ideologjinë e lavdishme të marksizëm-leninizmit, është vepra historike e të gjithë komunistëve, të vjetër e të rinj; ajo lindi nga gjiri i klasës punëtore e i njerëzve të punës, u rrit e rrethuar nga dashuria e besimi i popullit shqiptar, dhe u kalit në luftën për çlirim dhe në atë të ndërtimit të socializmit.

Gjatë Luftës Nacionallirimtare shumë shokë na ranë në fushën e nderit, shumë krahina na u bënë shkrumb e hi, por nga zjarri i luftës u ngrit vigane Partia, e cila u vu në krye të popullit dhe e transformoi atdheun e djegur e të përvëluar, e bëri si një nuse të re, të bukur e të fortë. Partia ishte dhe është busulla dhe organizatorja e të gjitha fitoreve, që u arriten jo me lehtësi, por me mundime e me sakrifika, me gjak e me dwersë, me guxim e me pjekuri. Një vepër e tillë kaq kolosale u ndërtua me themele e me mure të çelikta. Partia jonë ishte, mbeti dhe do të jetë përgjithmonë një Parti marksiste-leniniste, Parti që do të ndjekë dhe do të zbatojë me besnikëri teorinë e lavdishme të proletariatit, mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit.

Vepër e madhe dhe e pavdekshme e Partisë së është edhe fakti që ajo dititë ta edukonte vetveten, ta kaliste e ta zhvillonte me këtë ideologji, me këtë shkencë dhe këto t'i rrënjoshte në mendjen dhe në ze-

mrat e klasës punëtore dhe të të gjithë popullit. Pa Partinë as që mund të çlirohet dhe as që mund të rronte i lirë populli shqiptar, as mund të bëhet i pavarur e të ndërtonte socializmin për veten e tij dhe për brezat e ardhshëm. Pa Partinë gjaku i popullit shqiptar do të qe derdhur kot, Shqipëria, atdheu ynë i dashur, që në shekuj ka bërë sakrifica të mëdha, nuk do të shijonte lumturinë, dritën, diturinë, socializmin, por do të rronte vazhdimisht në robëri, në shtypje, në varfëri e në errësirë, do të mbetej skllave e fuqive të huaja imperialiste. Prandaj Partia është kaq e dashur për ne komunistët, anëtarët dhe ushtarët e saj besnikë, është kaq e dashur për klasën punëtore, për fshatarësinë kooperativiste, për intelektualët popullorë, për rininë, për gratë, me një fjalë për gjithë popullin tonë.

Një popull i vogël jemi ne, por jemi një popull që ka rezistuar si shkëmb graniti, që e kanë rrahur valët e tmerrshme të historisë, por që nuk e kanë shkulur dot, që nuk e kanë thërmuar dot dhe as e kanë shpërngulur e shpërndarë. Populli ynë në shekuj u ka rezistuar dhe po u reziston stuhive. Kjo është një e vërtetë e pashlyeshme që habit popuj dhe shtete, të cilët dinë se si gjatë historisë popuj të tërë janë zhdukur, se si janë shtypur e shtypen shtete dhe si skllavërohen popuj, kurse një vend i vogël si Shqipëria socialiste shohin që qëndron i fortë, i pamposhtur dhe lulëzon.

Pse ngjet kjo, pyesin ata. Dhe janë shumë ata që tashmë e dinë e përgjigjen se kjo ndodh ngaqë shqiptarët janë trima, janë të fortë, nuk përkulen.

Dhe kjo është e vërtetë. Por shqiptarët janë edhe të pjekur, sepse i kanë kalitur vuajtjet, hallet, luftërat. Bota edhe këtë e di. Por ka dhe shumë që nuk e kanë kuptuar ose nuk u leverdis ta pohojnë se populli shqiptar, që u ka rezistuar në shekuj furtunave, doli në dritë, rindërtoi vendin, ndërton socializmin dhe u bën ballë fuqive kolosale të armiqve imperialistë, revisionistë dhe gjithë reaksionit botëror, për arsy se ai është në fuqi; se popullin tonë e solli në fuqi Lufta e drejtë Nacionalçlirimtare, e cila u udhëhoq nga një parti e lavdishme marksiste-leniniste, u udhëhoq nga teoria e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit. Kjo teori e mbrugji popullin shqiptar me një brumë të veçantë dhe u bashkua me eksperiencën e madhe të revolucionit botëror, të sintezave të mëdha që klasikët tanë të lavdishëm nxorën dhe ligjëruan nga rrjedha e historisë njerëzore, duke u bashkuar gjithashtu me virtytet e tij të larta shekulllore.

Partia jonë trashëgoi meritat e virtytet më të larta të popullit tonë. Ajo mësoi gjithashtu nga historia e revolucioneve çlirimtare të popujve në botë. Partia jonë ndoqi me besnikëri teorinë e marksizëm-leninizmit dhe në bazë të ligjeve të materializmit dialektik dhe historik peshoi me kujdes çdo situatë, çdo ndryshim. Ajo kurrë nuk ka menduar se puna e lufta e saj do të zhvilloheshin si në një kopsht me lule. Jo. Partia e dinte se do të haste në rrugë vështirësi të ndryshme e të panumërtë, të mëdha dhe të vogla, të brendshme dhe të jashtme, të ndara nga njëra-tjetra ose të lidhura në mes tyre kundër rrugës së Partisë. Prandaj përpjekjet e saj kanë qenë titanike në çdo drejtim.

Partisë i është dashur të studiojë me thellësi situatat, por pa shkelur kurrë parimet; asaj i është dashur të ndryshojë taktika, por duke ndjekur kurdoherë taktika revolucionare dhe pa e ndryshuar asnjëherë strategjinë e saj revolucionare.

Ju të gjithë, shokë, e dini se në shumë raste, gjatë jetës dhe veprimtarisë së saj, Partia ka treguar pjetëkuri dhe urtësi të madhe. Dhe ne, marksistë-leninistët, me bindje të plotë nuk i krahasojmë ato me qetësinë false të ujit të ndenjur, por me atë ujin e vrullshëm, të pastër e të kulluar, që zurret nga alpet, nga bjeshkët tona dhe përlan vjetërsirat e ferrat që i dalin në pér këmbë popullit tonë trim dhe liridashës, që duan ta pengojnë në marshimin e tij fitimtar.

Shokë,

Sot Partia e Punës, populli dhe Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë janë në ndeshje dhëmb pér dhëmb me imperializmin amerikan, me social-imperializmin sovjetik e socialimperializmin kinez, me shumë imperialistë të tjera e revisionistë dhe me reaktionin botëror. Kjo është një luftë titanike që po bëjnë komunistët shqiptarë dhe populli shqiptar. Kjo luftë po zhvillohet nga Partia jonë me sukses dhe vendi ynë ka fituar simpatinë e njerëzve dhe të popujve liridashës e përparimtarë. Ne do ta ndjekim deri në fund këtë rrugë, do të fitojmë dhe do të meritojmë kështu besimin dhe respektin që kanë ndaj Partisë së Pünës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore Socia-

liste të Shqipërisë revolucionarët, partitë marksiste-leniniste dhe gjithë popujt që luftojnë për liri, pavarësi e për një jetë më të mirë.

Sot në botë nuk ka qetësi, ka edhe rreziqe të mëdha që na turren neve, por që u turren edhe popujve të tjerë, me të cilët jemi lidhur. Partia jonë është e lidhur me partitë e tjera marksiste-leniniste dhe klasa punëtore është e lidhur me proletariatin botëror për një qëllim, për revolucionin dhe për shembjen e botës së vjetër kapitaliste, revizioniste e imperialiste.

Çdo vështirësi, sado e madhe që të jetë, kapërcehet me mendime e qëndrime të pjekura dhe të guximshme. Ne s'kemi pasur kurrë frikë nga vështirësitë e mëdha që na kanë krijuar armiqjtë. Partia jonë, e kallitur në beteja klasore, të brendshme e të jashtme, ka ditur të gjykojë drejt për ngjarjet edhe kur ato nuk kanë qenë akoma shumë të kristalizuara. Që nga lindja e vazhdimit, gjatë gjithë jetës së saj, Partia jonë është ndeshur me tradhtarë të brendshëm e të jashëtm, me tradhtarë të atdheut, të popullit, të Partisë e të marksizëm-leninizmit. Populli ynë kurrë nuk i ka falur tradhtinë e tradhtarët. Këtë virtut trashëgoi edhe Partia jonë, që lindi nga gjiri i këtij populli.

Parti e popull kurrë nuk kanë pushuar luftën kundër armiqve e tradhtarëve të brendshëm, ashtu edhe kundër armiqve të jashtëm imperialistë e socialimperialistë, kundër revizionistëve modernë, hrushovianë, titistë, eurokomunistë e tanë së fundi edhe kundër revizionistëve kinezë. Kjo luftë ka pasur rëndësi jetike për Partinë dhe për vendin tonë, sepse, në radhë të

parë, ka armatosur udhëheqjen e Partisë me një eksperiencë të tillë të shëndoshë, që i ka dhënë mundësi të njohë që në embrion shfaqjen e sëmundjes së revizionizmit, nën çfarëdo maskash ose lulkash që të jetë mbuluar. Ja, aktualisht, ne po ndeshemi me revizionistët kinezë, që disa herë i quajmë revizionistë të rinj, por që në fakt janë të vjetër, të dalë ndoshta më parë edhe nga revizionistët jugosllavë, sepse oportunizmi e revizionizmi i sotëm kinez i ka rrënjet e vjetra në idetë eklektike e pragmatiste të Maos.

Sic rezulton, Maoja nuk ka qenë dakord me Kominternin e me Stalinin dhe nuk është mbështetur në filozofinë materialiste të Marksit, por në filozofinë idealiste të Konfucit dhe të disa idealistëve të tjerë. Ai nuk ndoqi rrugën e mësimet e Leninit për zhvillimin e revolucionit dhe për ndërtimin e socializmit, por me teoritë e tij fantaziste dhe eklektike, pra aspak marksiste, e la Kinën në një gjendje kaotike dhe e futinë një rrugë të tillë që populli kinez do të humbasë edhe ato pak gjëra që fitoi nga revolucioni demokratik antiimperialist. Kina po kthehet në një shtet krejt kapitalist dhe udhëheqja kineze po shpejtohet me ethe për ta bërë atë një superfuqi të tretë në botë nga pikëpamja politike, ekonomike dhe ushtarake.

Duhet thënë se konceptet tona për shfaqjet revizioniste të udhëheqjes kineze e aq më shumë përmbytja antimarksiste e maocedunidesë, nuk u kristalizuan në një ditë, por në bazë të një analize dialektike në proces të ngjarjeve që zhvilloheshin në Kinë dhe të qëndrimeve të udhëheqjes kineze për këto ngjarje e për zhvillimin e situatës ndërkombëtare, si edhe-

për gjendjen e problemet në lëvizjen komuniste e punëtore në botë.

Tradhtia e udhëheqjes kineze, aleancat e saj me imperializmin amerikan e të tjerë, me kapitalin monopolist e reaksionin më të zi në botë, po krijojnë vësh-tirësi të reja për lëvizjen komuniste e punëtore, për partitë e vërteta marksiste-leniniste, për të ardhmen e revolucionit proletar.

Partia jonë do të luftojë jo vetëm për demaskimin e plotë të imperializmit, të revizionizmit modern të çdo kallëpi e të reaksionit botëror, por ajo do të mbështetë pa rezerva veprimtarinë revolucionare të partive të vërteta marksiste-leniniste. Ajo do të përpinqet që në fryshtë e internacionalist proletar të japë kontributin e saj, sado të vogël, për mëkëmbjen e lulëzimin e këtyre forcave të reja. Partia jonë do të bëjë ç'është e mundur që të sqarojë drejt dhe me përgjegjësi situatat që krijojen vazhdimisht, t'u japë problemeve një shpjegim sa më të drejtë, sa më revolucionar dhe kështu, tok me komunistët e vërtetë në botë e me partitë e tyre, të forcojë unitelin e proletariatit në revolucion kundër forcave të errësirës, të imperializmit, revizionizmit modern të të gjitha ngjyrave dhe gjithë reaksionit në botë.

Gjithë kjo eksperiencë lufte kundër revizionistëve modernë bëri që në Parti e në popullin tonë, kur u mor vendimi për t'i çjerrë maskën kësaj rryme të re e të rrezikshme revizioniste, imperializmit të ri kinëz që po ngrihet, nuk u ndie as lëkundja më e vogël. Këtë ne duhet ta konsiderojmë si një nga fitoret më të mëdha. Kjo është një tjetër betejë e madhe që fi-

tuan Partia dhe populli ynë. Por lufta s'ka mbaruar, ajo duhet fituar betejë pas boteje e në çdo front.

Natyrisht, prerja e pabesë e ndihmave ekonomike nga ana e udhëheqësve revisionistë kinezë krijoj disa vështirësi të përkohshme, por që me siguri ato po kapercchen e do të kapercchen plotësisht. Ne të gjithë jemi dëshmitarë të shpërthimit të një entuziazmi të ri e mobilizimi të madh për të kapercyer vështirësitë, për të realizuar e tejkaluar planet ekonomike, për të forcuar mbrojtjen e vendit, shtetin e diktaturës së proletariatit e unitetin e popullit rrëth Partisë. Gjithë vendi zien nga puna, zien nga kënga, se popullit i qesh buza e i këndon zemra, se çshtë i lirë, çshtë në fuqi, është i lumtur dhe i sigurt për të ardhmen e vet dhe të brezave të rinj.

Shokë, të tëra llogaritë na vërtetojnë se Shqipëria socialiste, si me potencialin e saj të madh moralopolitik, me forcën e ideologjisë që e udhëheq, me unitetin Parti-popull, me unitetin në Parti e në udhëheqje, ashtu edhe me potencialin ekonomik që ka krijuar, ka mundësi që me planin e ardhshëm të studiuar mirë, të realizojë jo vetëm të gjitha veprat që i qenë dhënë me marrëveshje e kredi nga Kina duc që u lanë në mes, duke ndërprerë dërgimin e makinerive, por të ndërtojë dhe do të ndërtojë edhe vepra të tjera të reja, të cilat do ta fuqizojnë akoma më shumë ekonominë e saj socialiste. Dhe ky sukses do të arrrihet me forcat tonë, duke mos marrë asnjë kredi nga jashtë.

Partia jonë do t'i tregojë botës se forca e socializmit është e tillë që bën të mundur të ndërtojmë një jetë të lumtur, të denjë, të kulturuar, të sigurojmë

një mbrojtje të fuqishme për atdheun tonë dhe ky të bëhet shembull për popujt e tjerë.

Pavarësisht nga vështirësitë, pavarësisht nga rrënimet, nga djegiet e nga luftërat shkatërruese që mund t'i shkaktohen një populli, mund të rindërtohet me sukses edhe një vend i shkatërruar, mund të rinohet e të fuqizohet një popull dhe të krijohet njeriu i ri, mund të ndërtohet një jetë e re, jeta socialiste pa klasa shfrytëzuese dhe kundër të gjithë armiqve, sado të fuqishëm që të janë këta, kur ai vend ndriçohet dhe udhëhiqet nga teoria jonë fitimtare, marksizëm-léninizmi.

Këto janë detyra të mëdha që shtrohen para nesh, komunistëve dhe popullit shqiptar, detyra ndaj atdheut tonë e ndaj popujve të tjerë, ndaj revolucionit e socializmit. Dhe ne këto detyra do t'i kryejmë me ndërgjegje të plotë komuniste, me vetëmohim, pa marrë parasysh asnjë sakrificë.

### Shokë dhe shoqe të dashura,

Në këtë ditë të 70-vjetorit të ditëlindjes sime, unë i them Partisë dhe popullit se sa të rroj do ta vë jetën time në shërbim të tyre dhe asnjëherë e për asnje grimë nuk do të tërhiqem nga llogoret e para të luftës ku qëndroj edhe unë krah për krah me ju, shokët e mi të shtrenjtë, që kemi luftuar e punuar, që do të lutojmë e punojmë gjithë jetën për këto ideale të larta.

Si çdo komunist revolucionar edhe unë asgjë nuk mund të bëj pa bashkëpunimin e ngushtë revolucionar,

marksist-leninist, të përditshëm e të përorshëm me shokët, pra me ju. Së toku ne kemi luftuar, kemi puanuar, kemi menduar, kemi krijuar, kemi zbatuar, kemi gabuar, kemi korrigjuar dhe, si ushtarë të revolucionit, kemi vënë gurë në themelitë dhe në ndërtesën e Partisë e të Shqipërisë së re.

Ky unitet mendimi dhe veprimi, i udhëhequr nga teoria jonë marksiste-leniniste, ka krijuar këtë situatë të mrekullueshme që ekziston në radhët e Partisë dhc në popull dhe ka dhënë këto rezultate që gjëzojmë sot.

Të dashur shokë,

Këto ditë kam marrë shumë letra me urime, me përshëndetje si dhe me zotime për realizime të reja në frontin e punës e të luftës së madhe politike që zhvillon Partia dhe Republika jonë Popullore Sociale. Edhe tani, në këtë darkë, ju, shokët e mi të dashur të luftës e të punës, shprehët ndjenjat e dashurisë ndaj meje dhe folët për meritat e mia. Por meritat që më atribuoni, janë edhe tuajat, janë në radhë të parë meritat e Partisë sonë të Punës. Neve komunistëve, puna dhe lufta jonë kurrë nuk na ushqen ndjenjat e fodullëkut e të kryelartësisë, përkundrazi, përpjekjet dhe meritat e gjithsecilit i konsiderojmë si kontribute të një pune kolektive në luftën tonë të përbashkët, për një qëllim të përbashkët.

Me këtë rast, ju lutem juve, shokë e miq që ndodheni sone të këtu, veteranë të luftërave për liri, vete-

ranë të Luftës së madhe Nacionalçlirimtare, përsaqësues të klasës sonë punëtorë, të fshatarësë kooperativiste, përsaqësues të pushtetit populor, të ushtrisë, të organizatave të masave e të organeve të diktaturës së proletariatit, përsaqësues të frontit të arsimit, të kulturës, të arteve dhe të shkencës, edhe ju mësues e shokë të shkollës e të rinisë sime, të çoni të falat, përshëndetjet e falënderimet e mia më të përzemërtë në qendrat, në qytetet, fushat e malet ku jetoni e punoni.

Dëshiroj t'ju them se puna dhe lufta ime janë pjesë e pandarë e punës dhe e luftës së Partisë, të gjithë anëtarëve të saj. Funksionet që më ka ngarkuar Partia kanë rritur tek unë më shumë ndjenjën e përgjegjësisë, dhe këtë gjë jam përpjekur ta mbaj mëndër dhe po kështu, e me besnikëri ndaj popullit dhe marksizëm-leninizmit do të përpinqem ta mbaj deri në fund të jetës sime.

Partia dhe populli na zgjedhin ne në udhëhcqje të Partisë e të shtetit, sepse gjykojnë që gjatë një periudhe lufte kemi fituar eksperiencë më të madhe nga disa shokë të tjerë. Nga ana tjetër, Partia dhe populli kanë bindje të plotë se këtë eksperiencë dhë besnikëri të patundur ndaj marksizëm-leninizmit ne do të dimë ta vëmë në shërbim të atdheut, të socializmit e të revolucionit proletar dhë do të bëjmë përpjekje me ndjenjën e një përgjegjësie të madhe, me thjeshtësi e me urtësi marksiste-leniniste, për të dhënë kontributin tonë në zbatimin e detyrave.

Sigurisht demokracia jonë proletarc në parti vepron si në bazë, ashtu edhe në udhëhcqje. Ata që

nuk punojnë mirë duhet të bëjnë përpjekje të punojnë mirë, kurse ata që bëjnë gabime sigurisht duhet të ndreqen, të tjerë që mendojnë gabim duhet të sqarohen dhe atyre që bëjnë fajc, t'u hiqet veshi. Sa për ata që tradhtojnë kauzën e madhe të Partisë dhe të popullit të gjithë jemi të një mendimi, ata duhen dënuar pa mëshirë.

Pra ne, shokët tuaj, që Partia na ka zgjedhur në udhëheqje, kemi një përgjegjësi shumë të madhe. Këtë përgjegjësi e kemi mbajtur dhe do ta mbajmë me nder, derisa Partia do të gjykojë se e kemi merituar plotësisht. Ne nga ana jonë deri në fund, derisa të kemi jetë, duhet të punojmë me të gjitha forcat, me ndërgjegje të pastër dhe me vetëmohim për të kryer detyrat e rënda që na janë ngarkuar.

Unë siguroj Partinë, popullin, ju, shokë të mitë dashur, se derisa të rroj, do të jem një ushtar besnik, i thjeshtë dhe i guximshëm në shërbim të atdheut socialist, të ndërtimit të socializmit dhe të fitores së revolucionit proletar. Do të vë të gjitha forcat e mia për të mbrojtur parimet e pavdekshme të mësuesve tanë të mëdhenj, të Marksit, të Engelsit, të Leninit e të Stalinit e do të luftoj gjithë jetën, duke i pasur ata drithë e armë të luftës sonë revolucionare.

Sot, në 70-vjetorin e ditëlindjes sime, unë i them Partisë se çdo gjë që kam është e saj. Jeta ime, gjaku im, mendimet dhe ndjenjat e mia, forca ime fizike, të gjitha unë ia kushtoj Partisë dhe do t'i vë në shërbim të saj derisa të jem gjallë, sepse është Partia ajo që më rilindi, që më rriti e më mësoi, më dha drithë e

gjallëri dhe jam gati, në çdo moment, të jap jetën për të dhe për popullin.

Të rrojë e të forcohet Partia!

Të rrojë e të përparojë popullit

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

# **POLITIKA E «KATËR MODERNIZIMEVE» — POLITIKË SUPERFUQIE**

**Shënimë**

**17 tetor 1973**

Problemi i Kinës tash është krejtësisht i qartë. Kina e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit, haptazi, pa druajtje, pa dorashka, e tashmë edhe gati pa demagogji, është bërë dhë vepron si një shtet imperialist.

Këtë situatë e sheh e gjithë bota, e cila ka po këtë mendim që unë shpreh këtu. Kur them se ka këtë mendim, një gjë të tillë nuk e imagjinoj, por e bazoj në fakte. Në kontaktet e herëpashershme që kanë ambasadorët tanë me ambasadorë të shteteve të ndryshme të botës, konstatojnë se te këta është i rrënjosur ky mendim dhe ka arsyet e jetë i rrënjosur, sepse me shtetet borgjeze kapitaliste e imperialiste Kina zhvillon një veprimtari intensive e të shumanshme politike, ekonomike dhe ushtarake. Këtë ajo e bën me qëllime të caktuara për të realizuar të ashtuquajturat katër modernizime, në bazë të të cilave synon të ndërtojë një ekonomi moderne, të ndërtojë një shtet modern, një bujqësi dhe një ushtri moderne. E që t'i bëjë këto, Kina

e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit ka hyrë në marrëveshje të plotë dhe të hapët, në radhë të parë, me imperializmin amerikan e me atë japonez dhe pastaj me të gjitha shtetet kapitaliste, që nga Anglia, Franca, Gjermania Perëndimore dhe të gjitha vendet e tjera të industrializuara, që janë të gatshme t'i jasin asaj kredi.

Kina kapitaliste aktualisht i ka vënë vetes si detyrë që t'ia hapë dyert e saj kapitalit botëror nëpërmjet kredive të shumta që merr prej tij etj. Në fillim udhëheqja kineze thoshte se këto kredi nuk do t'i merrte në rrugë shtetërore, por gjoja në formë private dhe nga banka private, megjithëse dihet që të tilla banka në kohën tonë nuk cekzistojnë, por ekzistojnë kapitalet e mëdha financiare të çdo shteti, të ndërthurura dhe në rivalitet me njëri-tjetrin, që ndodhen nën kontrollin e trusteeve financiare dhe të bankave të mëdha, të cilat janë përfaqësuese të shteteve të tyre. Tash Kina u detyrua të deklarojë se këto kredi i pranon edhe nga shtetet kapitaliste e imperialiste, me përjashtim të Bashkimit Sovjetik. Kjo ka qenë prej kohësh dëshira e saj.

Pra, aktualisht në Kinë vërhojnë kapitalet e huaja. Deri tashti, nga sa dimë dhe nga sa po deklarojnë zyrtarisht agjencitë e ndryshme të lajmeve të botës kapitaliste, këto janë jo më një miliard, por me dhjetëra miliardë dollarë, franga franceze, franga zvicerane, sterlina etj.

Grupe të mëdha shkencëtarësh, ekonomistësh, politikanësh, ushtarakësh dhe me dhjetëra delegacione tëncë kanë bredhur vitin e fundit në shumë vende

kapitaliste për të studiuar dhe për të kontraktuar teknologji të re, armatime të reja, ndërtimë kombinatesh të fuqishme metalurgjike, kimike dhe reaktorë atomikë. Pra Kina e Hua Kuo Fenit, vazhduesja e Kinës së Mao Ce Dunit, po bëhet një supersfuqi. Vetëm se kjo super-sfuqi e re që po ngrihet është nën kontrollin e imperializmit amerikan, të atij japonez dhe të Tregut të Përbashkët Evropian, të cilët do të bëjnë dhe po bëjnë ligjin në Kinë, do t'i diktojnë kësaj politikën e tyre dhe do ta ndihmojnë deri në atë shkallë që atyre do t'u leverdisë nga ana ekonomike. Ata do të shfrytëzojnë pasuritë e mëdha që ka Kina për t'i thithur gjakun popullit kinez dhe për t'i krijuar mundësi klasës së borgjezisë kapitaliste në këtë vend që të lidhet ngushtë me borgjezinë e madhe kapitaliste të tyre dhe të bëhet një armë në duart e kapitalizmit ndërkombëtar, në luftë kundër socialimperializmit sovjetik.

Furnizuesit e teknologjisë moderne, pra, ata që kanë marrë përsipër fuqizimin e industrisë, të bujqësisë, të ushtrisë kineze etj., kanë të dhëna të shumta e të gjithanshme për Kinën. Këto të dhëna ata i bazojnë në gjithë ato studime që kanë bërë rrëth saj, bile kanë institutë të veçanta për këtë qëllim, ku studiohet historia e Kinës, karakteri i saj, karakteri i kinezit si individ dhe si popull, ndjenjat e aspiratat e tij, ngjithë politike, ideologjike, intelektuale etj. Natyrisht, të gjitha këto të dhëna ata do t'i kenë kurdoherë parasysh në ndihmën që do t'i jepin Kinës, që kjo të jetë gjithmonë në shërbim të kreditorëve e të investitorëve.

Megjithatë, mendoj se kjo nuk do të thotë që imperializmi amerikan, japonez, Tregu i Përbashkët Ev-

ropian etj. do të bëjnë me Kinën si të duan. Do të ketë edhe përkëdhelje, edhe shfrytëzim të egër nga ana e tyre, por do të ketë edhe kontradikta, të cilat, natyrisht, do të shtohen më vonë, atëherë kur kreditë që merr Kina do të bëjnë efekt, pra, kur të rritet potentiali i saj ushtarak, ekonomik, industrial e veçanërisht ai bujqësor.

Duke pasur parasysh karakteristikat e Kinës, të udhëheqjes së saj dhe karakterin e kinezëve, është e qartë se në të ardhmen megalomania e shtetit të madh nuk do ta pranojë zgjedhën ashtu siç duan partnerët e saj aktualë. Edhe këta nga ana e tyre nuk do të vazhdojnë ta ndihmojnë dhe ta financojnë Kinën ashtu siç do ajo vëtë. Prandaj, më vonë, do të lindin fërkime, që do ta kenë burimin në qëndrimet politike kapitaliste të Kinës dhe të partnerëve të saj. Edhe ajo maskë e hollë, që Kina mban duke u lëqur se gjoja është një vend socialist, shpejt do të bjerë, në mos sot, me siguri nesër. Bile që tash mund të themi se kjo maskë është çjerrë në treçerekët e saj dhe të gjithë e dinë e të gjithë thonë se Kina ka ndryshuar rrugë, ajo nuk është më socialistë, por kapitaliste. Dhe këtu nuk gabohen. Këtë nuk e fsheh edhe vëtë udhëheqja kineze, e cila ka kohë që ecën në këtë rrugë.

Kjo udhëheqje tashmë i është nënshtruar fare hapur kapitalit të madh ndërkombëtar. Duhet thënë se në politikën e saj vihet re një agresivitet i madh kundër Shqipërisë e Vietnamit. Për sa i përket qëndrimi ndaj Shqipërisë, këtë e kemi analizuar dhe po shohim se çdo ditë që kalon qëndrimi kinez po bëhet shumë i egër. **Ten Hsiao Pini**, në një bisedë që ka pasur me ga-

zefarë japonezë, ka thënë se ai ishte i mendimit që me Shqipërinë Kina duhej t'i kishte prerë marrëdhëniet me kohë, «por nuk më dëgjuan, u shfajësua Teni, më thanë të presim dhe ca». Kurse lidhur me Vietnamin, ai i deklaroi agjencisë japoneze të lajmeve Kiodo se qeveria kineze do të ndihmojë një popull, i cili rrezikohet nga një popull tjetër. Ai nuk përmendi emra, por kuptohet se është fjala për Kamboxhian, që gjoja rrezikohet nga Vietnami. Pastaj shtoi se «në rast se Kina nuk e ndihmon këtë popull (pra Kamboxhian), që sulmohet nga një popull tjetër, atëherë unë i bëj thirrje popullsisë kineze që jeton atje (pra në Vietnam), të ngrihet dhe ta rrëzojë këtë qeveri aktuale». Por Ten Hsiao Pini «harron-të shtojë çështjen tjetër: Në radhë të parë, ai që duhet të ngrihet është populli kinez, i cili duhet të rrëzojë qeverinë fashiste që sundon në Kinë e që sulmon një popull tjetër, popullin vietnamez, sepse, në fakt, Kina e ka vetëm një pretekst çështjen e Kamboxhias. Ndaj Vietnamit heroik ajo mban një qëndrim të hapur agresiv. Çdo ditë avionët kinezë shkelin hapësirën ajrore të Vietnamit. Me mijëra milicionerë dhe ushtarë kinezë me bajoneta e me pushkë në duar, kapërcejnë kufirin, përleshen e vrasin vietnamezë. Lufta nuk është deklaruar, por kjo është një luftë e heshtur, e vazhduese shme dita-ditës. Nga ana tjetër, Kina ka vënë të gjitha forcat dhe po e ndihmon udhëheqjen fashiste kamboxhiane të kryejë veprime mizore të mëdha ndaj popullit të saj, por veçanërisht ndaj Vietnamit.

Kina është bërë një shtet agresiv dhe e nxit këtë luftë për arsyen se dëshiron të dominojë Vietnamin, Laosin, Kamboxhian, Tajlandën, Filipinet, Singaporin,

**Malajzinë, me një fjalë gjithë Azinë e jo vetëm atë.** Siç e kam theksuar edhe në shkrime të tjera, ajo ka oreks të madh e nuk ngopet vetëm me Azinë, por kërkon të krijojë edhe në Ballkan një aleancë të saj, pra të krijojë boshtin Kinë—Jugosllavi—Rumani.

Udhëheqja kineze është një udhëheqje dinake, hipokrite, mendjemadhe, por jo e zgjuar. Ajo mendon se popujt e tjerë do t'u binden pikëpamjeve të saj jo vetëm të parealizueshme, por shumë herë pa baza dhe pa kurrsfarë logjike. Ajo akoma nuk e ka kuptuar se ç'është titizmi, se sa dinak e ç'pehlivan është Titoja që luan në litar, që nuk i ha kollaj as planet, as propozimet e Hua Kuo Fenit. Ai e di mirë se nuk mund të hapë dot zjarr kundër Shqipërisë, sepse atëherë do të digjej e do të përvëlohej për veten e vet, por s'mund të hapë dot zjarr kurrë as edhe kundër Bashkimit Sovjetik revizionist.

Plani i kinezëve kalon edhe më larg. Ata në Evropë kanë ndërmarrë një politikë të gjerë nënshtrimi dhe vartësie ndaj Tregut të Përbashkët Evropian, të cilit i buzëqeshin, nënshkruajnë me të kontrata të miëdha me kredi të shumta dhe me kamata të rënda për Kinën, domethënë sakrifikojnë pavarësinë, lirinë dhe sovranitetin e Kinës, duke e bërë atë një vend të varur nga Perëndimi. Nga ana tjetër, Kina me vendet e tjera, ku nuk ka asnjë interes për të marrë kredi, si me Greqinë, me Turqinë etj., buzëqesh me atë buzëqeshjen e saj hipokrite, që nuk gënjen njeri.

Një politikë të tillë zhvillon Kina në Evropë, kurse në Lindjen e Mesme, ku sundojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Izraeli, Arabia Saudite dhe sovjetikët, ajo indirekt, nëpërmjet një vargu shtetesh arabe, luan rolin

e tellallit. Më kujtohet nga koha e vogëlisë, kur dilte tellalli nëpër qytet e thërriste me sa zë që kishte, duke lajmëruar se të nesërmen duhcj të mblidheshin njerëzit përpara bashkisë se do të bëhej, bie fjala, festë për Ditën e Flamurit. Pra Kina, ku drejtpërdrejt, ku tërthorazi vepron në vendet arabe për të mbështetur politikën amerikane dhe atë izraelite, duke u hequr një-kohësisht si mikesha e popujve arabë, sidomos mikeshë e Iranit, e Emirateve të Gjirit Persik, dhe duke u përpjekur të lidhë miqësi me Arabinë Saudite e me Irakun. Të gjitha këto i bën, në radhë të parë, për të fituar kredi, që të krijojë njësarë influence si një shtet gjoja në zhvillim, dhe që mund t'ju lërë edhe këtyre vendeve fushë penetrimi në Kinë. Por ajo i bën këto sidomos për të krijuar një influencë të tillë që këto vende të forcojnë lidhjet e tyre me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të bëhen një barrierë kundër invadimit të mundshëm sovjetik. Në qoftë se kontradiktat arrijnë deri në atë shkallë sa sovjetikët ta shohin pisk, ata, duke e ditur se Lindja e Mesme është një nga pikat më të dobëta të imperializmit amerikan, mund të çajnjë drejt Turqisë, Kaukazit, Irakut, Iranit dhe të dalin në Oqeanin Indian, duke prerë krejt rrugët e nastes. Në këtë rast preken drejtpërdrejt interesat e kapitalit amerikan, burimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të të gjitha shteteve kapitaliste të zhvilluara. Kjo do të bëjë që të dilet nga kuadri i luftërave lokale dhe të shpërthejë lufta botërore.

Kur Naseri<sup>1</sup> kundërsulmoi Izraelin dhe kur Franca

1. Gamal Abdel Naser (1918-1970), ish-president i Egjiptit

me Anglinë sulmuan Suezin, Ideni, kryeministër i Anglisë, i tha Hrushovit se ju, sovjetikët, nuk duhet të ndërhyni në Lindjen e Mesme, se atëherë do të ketë luftë botërore. Në fakt kjo zonë është një pikë shumë nevralgjike dhe sovjetikët këtë e kanë si një atú. Se sa do të mundin ata t'ua prishin planet Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Izraelit dhe Egjiptit, këtë do ta shohim, por ata punojnë intensivisht në këtë drejtim dhe baza e tyre kryesore, dashur pa dashur, është Sira, por nuk mbeten pas as Algjeria e Libia.

Pra, në këtë pellg Kina sapo ka filluar të futë hundën, por hundën e ka shumë të shkurtër dhe popujt arabë janë zgjuar e i kuptojnë synimet e saj. Nga ana tjetër, udhëheqjet e këtyre vendeve, pavarësisht si janë, e dinë se fitimet e tyre nga Kina janë të pakta, kurse nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe nga Bashkimi Sovjetik janë më të shumta dhe më konkrete. Tani Kina i bie vetëm trumbulekut dhe nuk dihet se sa do të rritet influenca e saj në të ardhmen në këto vende. Unë mendoj se kjo do të rritet në mënyrë shumë proporcionale dhe ky proporcionalitet do të vlerësohet menjihmat ekonomike e ushtarake që Kina duhet t'u japë këtyre shteteve, por kjo do të bëhet kur ajo të krijojë mundësitë, sepse aktualisht akoma nuk i ka krijuar.

Mund të themi se e njëjta gjë ngjet edhe në Afrikë. Edhe këtu Kina po i bie daulles, sepse nuk gjen vend të lirë. Që të mund të infiltrohet, asaj i duhet të dëbojë dikë, në qoftë se e lënë të lirë ato fuqi të mëdha kapitaliste, të cilat me investimet e tyre edhe aktualisht e kanë në dorë këtë kontinent. Ato do ta lejojnë Kinën-

të bëjë disa investime të vogla pa prishur interesa e tyre, do ta lënë, gjithashtu të bëjë propagandë sa të dojë kundër Bashkimit Sovjetik, të bëjë propagandë edhe për pseudosocializmin e saj, sepse kapitalistët e dinë mirë që s'është socializëm ai i Kinës, pra s'u prish punç, veç u ndreq. Për këtë arsyet e mbrojnë Kinën dhe ideologjinë e saj gjoja socialiste, e mbrojnë Mao Ce Dunin dhe maocedunidenë, sepse e dinë mirë që si Kina dhe ideologjia e saj nuk kanë asgjë marksiste-leniniste, nuk janë për revolucionin, por për kënetën, për bataku, për ruajtjen e kapitalizmit, të atyre formave kapitaliste që popujt të mos mundin dot kurrë t'i thyejnë zinxhirët e robërisë, të mos hidhen në revolucion, të mos fitojnë lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e vërtetë të tyre, të mos kenë asnjë mundësi të ndërtojnë jetën e denjë e të lumtur socialiste.

Prandaj, aktualisht, me këtë politikë në Afrikë, Kina, si me thënë, i ka këmbët në kënetë dhe hëpërhe s'i ngre dot nga llumi ku është futur. Ndërsa të tjerët që sundojnë në Afrikë janë «të motorizuar», kanë dollarë, kanë rubla, kanë klika, kanë aeroplani etj., Kina akoma nuk i ka krijuar kushtet për të pasur nga këto. Më vonë mund edhe t'i krijojë, po do të shohim se si do të zhvillohet situata më tej.

Sidoqoftë, udhëheqja aktuale kineze duhet të vëré rregull dhe disiplinë në shtëpinë e vet, sepse atje rregulli dhe disiplina janë zhdukur e mbretëron kaosi. Organizatës së partisë atje i ka mbetur vetëm emri; partia është ndarë, është bërë pjesë-pjesë. Secili është pjesëtar i një grupei dhe çdo grup vepron sipas interesave të atyre zotërinjve që e udhëheqin. Këto grupe

nuk përfaqësohen vetëm në parti, por edhe në qytete, edhe në provinca e në fshatra. Nga sa dëgjojmë e lexojmë, ka pakënaqësi të madhe për politikën e udhëhcqjes kincze, vçanërisht nëpër fshatra, ku fshatarët i mashtrojnë duke u premtuar se gjoja do të zhvillohet bujqësia, por në fakt u është vënë kujdes kryesish zhvilimit dhe modernizimit të ushtrisë e të industrisë, sidomos të industrisë së rëndë.

Udhëhcqjes kincze i duhet të vendosë disiplinë të hekurt, të tipit kapitalist në punë dhe, brenda, në shtet e në popull, i duhet të krijojë njëfarë «autoriteti» të së ashtuquajturës Parti Komuniste dhe të të ashtuquajturave parti demokratike, parti të borgjezisë që janë rë bashkëpunim me atë komuniste, të cilat, siç jemi informuar, kanë afishuar në të katër anët e Kinës portretet e Sun Jat Senit. Prandaj, ajo, formalisht, po shpejton të riorganizojë organizatën e gruas, organizatën e rinisë e bashkimet profesionale. Aktualisht këto janë organizata formale, por edhe kështu formale vleinë për demagogji e mashtrim, sepse ligjin në Kinë, natyrisht, e bën shkopi, e bën pushka, e bëjnë terrori e burgu dhe jo ideologjia. Atje ideologjia marksiste-leniniste nuk ekziston, por ekziston diktatura borgjeze dhe pikërisht kjo diktaturë krijoi «organizatën e gruas», zgjodhi pa bujë edhe udhëhcqjen e saj. Nuk jam sa duhet në dijeni mbi ç'u tha e ç'u bë në këto mbledhje të mëdha dhe në fjalimet lumë të kongresit të rinisë etj., por u interesoja pak se ç'probleme u shtruan në kongresin e bashkimeve profesionale dhe, meqë nuk pati të dhëna nga HSINHUA-ja, i kërkova ambasadoret tonë të më dërgonte një informatë mbi fjalimin

e Ten Hsiao Pinit në këtë kongres dhe ai ma dërgoi.

Në datën 11, më duket, u çel kongresi i 9-të i bashkimeve profesionale të Kinës, ku bashkë me pjesëtarët e tjërë të Byrosë Politike merrte pjesë edhe Vu Tehu. Përvendetjen në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe të qeverisë e mbajti Ten Hsiao Pini. Ja disa vërejtje rrreth fjalimit të Tenit:

Në këtë fjalim nuk flitet gjëkundi për rolin hegjemon të klasës punëtore në shtetin socialist, as për sindikatat si leva të partisë, por vetëm për «edukimin komunist të punëtorëve». Kjo, natyrisht, është vazhdimësia e vijës së përhershme të Mao Ce Dunit, sipas të cilët sindikatat nuk janë leva të partisë, as transmetuese të vijës së partisë në masat. Po kështu asgjëkundi nuk flitet për marksizëm-leninizmin dhe arsyja është e qartë. Atje ekziston maocedunideja. Por edhe emri i Mao Ce Dunit dhe teoria e tij vetëm një herë u përmendën.

Në planin ndërkombëtar Ten Hsiao Pini flet vetëm për «pavarësinë kombëtare», për «emancipimin» e klasës punëtore, por aspak për revolucionin, për marrjen e pushtetit, për përparimin e njerëzimit. Marrjen e pushtetit nga ana e klasës punëtore ndërkombëtare revisionistët kinezë e kanë lënë për në kalendat greke.

Ten Hsiao Pini i quan të drejtë, pra rehabilitohen, kongresin e 6-të, të 7-të e të 8-të të bashkimeve profesionale të Kinës, që kanë qenë kryesisht revisioniste e ku mbizotërojnë via e Liu Shao Çisë, pra edhe e Ten Hsiao Pinit. Me sa duket rehabilitimi i vijës së Liu Shao Çisë dhe i këtij vetë individualisht është vënë në rrugë.

Në qendër të të gjithë fjalimit të Ten Hsiao Pinit qëndrojnë, natyrisht, «katër modernizimet» dhe lufat kundër «katërshes». Në të gjithë fjalimin duken qartë fund e krye pikëpamjet krejtësisht revisioniste e kapitaliste, ekonomiste e teknokrate të Tenit dhe asgjë politike. «Katër modernizimet» Ten Hsiao Pini i quan një revolucion që do ta nxjerrë Kinën nga prapambetja, revolucion, i cili në shumë drejtime duhet të ndryshojë marrëdhëniet në prodhim, superstrukturën, formën e administritimit në ndërmarrje dhe administratën shtetërore gjithashtu etj. Të gjitha këto ide janë krejtësisht kapitaliste e revisioniste.

Ai parashtron çështjen e ndryshimit të sistemit shoqëror, bën thirrje për transformime të mëdha në fronte të ndryshme të ekonomisë, jo vetëm lidhur me teknikën, por edhe me sistemin e drejtimit e të organizimit dhe kërkon që sindikatat të ndihmojnë energjikisht në këtë drejtim, që punëtorët të kenë disiplinë, të pranojnë lehtë transformimet etj., etj. Me fjalë të tjera, Ten Hsiao Pini kërkon që punëtorët t'u binden lehtë urdhreve të tij e të klikës së tij.

Teni kërkon që ndërmarrjet të respektojnë sistemin e përgjegjësisë nga drejtori apo administratori (kllakorit, siç i quan ai ala amerikanë), nën «udhëheqjen» e komiteteve të partisë. Natyrisht, ai kërkon nga ndërmarrjet një sistem të fortë për drejtimin e prodhimit dhe një udhëheqje administrative thellësisht të centralizuar dhe me pushtet të plotë në sistemin komandues të prodhimit. Me një fjalë drejtori për Ten Hsiao Pinin është tiran absolut.

Për demagogji revisioniste, punëtorëve, sipas këtij

fjalimi, u njihet e drejta të zgjedhin shefat e reparateve, siç ndodh në vetadministrimin jugosllav me sistemin e të dëleguarve. Teni thotë se sindikatat duhet të mbrojnë mirëqenien e punëtorëve, por thickson se kjo nuk do të arrihet shpejt. Do të duhet një kohë që përmirësimi i kushteve të punës, të jetesës, të higjienës dhe ndihma reciproke midis punëtorëve të vijnë në rrugën që gjoja dëshiron Teni.

**Fjalimi i Ten Hsiao Pinit** është një platformë anti-marksiste, antiproletare, revizioniste borgjeze, që i kandidis sindikatat në leva të klasës borgjeze revizioniste në fuqi, për skllavërimin e klasës punëtore, kurse kuadrot sindikalë i kthen në xhandarë dhe në pjesëtarë të aristokracisë punëtore. Ky kongres i bashkimeve profesionale nuk ka karakter marksist-leninist, as nuk bëhet për qëllime politike dhe ideologjike marksiste-leniniste, pra nuk bëhet për të vendosur hegemoninë e klasës punëtore. Përkundrazi, në Kinë bashkimeve profesionale u imponohet një pikëpamje e huaj, një administrim i huaj, josocialist, dhe kërkohet prej tyre një punë me një disiplinë të fortë të pandërgjegjshme, të imponuar, disiplinë që synon ta bëjë Kinën një vend të fuqishëm socialimperialist. Që Kina të bëhet e tillë, punëtorët duhet të vuajnë, udhëheqja kineze të realizojë akumulim të madh në kurriz të punëtorëve siç po bën Japonia, për të modernizuar ushtrinë, teknologjinë dhe tok me shpenzimet e investimet e huaja, të krijojë mundësi të mëdha për të larë borxhjet e shumta dhe për t'u shitur vendeve të së ashtuquajturës botë e tretë armët e vjetra, ashtu siç kanë bërë socialimperialistët sovjetikë. Pra, u shet të tjerëve vjetërsirat

dhe ushtrinë e vet e pajis me armatim të ri modern.

Nga sa vihet re, e, kohët e fundit, kjo u duk edhe në kongresin e bashkimeve profesionale, ku Ten Hsiao Pini mbajti fjalim, në hierarkinë kineze po forcohet tendencia e Tenit për të qenë udhëheqës kryesor mbi Hua Kuo Fenin. Aktualisht ky e mban tufën, mundet më vonë ta përqendrojë fuqinë plotësisht në duart e veta, por është Ten Hsiao Pini ai që po jep direktiva të prera. Siç na njofton ambasadori ynë, që e ndoqi kongresin edhe në televizion, Teni duket shumë i shqetësuar, pavarësisht se në të gjitha postet po vë njerëzit e tij; kryetarin e bashkisë së Pekinit e likuidoi, gjithashtu likuidoi komandantin e garnizonit të Pekinit dhe vuri një njeri të tijin etj. Sidoqoftë, në udhëheqjen kineze ekzistojnë rryma e grupe të ndryshme që janë në grindje me njëri-tjetrin dhe ndonjë mëngjes do të pëlcasë përsëri një pseudorevolucion, një përbysje tjetër e rrufeshme.

*Marrë nga libri: Enver Hoxha,  
«Ditar për çështje ndërkombëtare» (botim i brendshëm),  
nr. 11, f. 380*

# **DY SUPERFUQITË DHE PRETENDENTËT E TJEË PËR HEGJEMONI BOTËRORE RREZIKOJNË POPUJT**

**Shënimë**

**21 tetor 1978**

Po konstatojmë se imperialistët e ndryshëm dhe, në radhë të parë, imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik, socialimperializmi kinez, militarizmi japonez dhe revanshizmi gjerman janë në aktivitet të madh. Këto fuqi imperialiste janë duke konsoliduar pozitat e tyre strategjike, duke u vënë rëndësi armatimeve të sofistikuara, zhvillimit të ekonomisë dhe të teknologjisë, përgatitjes njëkohësisht të luftës me armë moderne si dhe përgatitjes së prapavijave të veta.

Prandaj ndërmjet tyre po zhvillohet një garë marrëveshjesh, ka filluar ndarja e zonave të influencës ose përcaktimi në konkretisht i zonave të influencës së këtyre imperializmave kryesorë dhe njëkohësisht rrëmbimi ose neutralizimi nga njëri e nga tjetri i disa zonave, siç janë: Afrika, Lindja e Mesme, Azia, Paqësori etj.

Konstatojmë, gjithashtu, se, në kundërshtim me pikëpamjen kineze, e cila është një pikëpamje e gë-

njeshtërt, reaksionare, imperializmi amerikan është në sulm, kurse socialimperializmi sovjetik në rrethanat e krijuara, më tepër po del në mbrojtje. Prandaj, në trativat që thashë më lart, rolin kryesor në botë aktualisht e luan imperializmi amerikan, i cili dominon ekonomikisht dhe ushtarakisht. Po ashtu ky imperializëm përpinqet të ruajë aleancat e vjetra dhe të krijojë aleanca të reja në favor të tij dhe në disfavor të socialimperializmit sovjetik ose të imperialistëve dhe militaristëve të tjerë që mund të kërcënojnë fuqinë imperialiste amerikane.

Në NATO, natyrisht, Shtctet e Bashkuara të Amerikës kanë një potencial dhe një influencë të madhe ushtarake, politike dhe ekonomike. Por ne shohim se me gjithë unitetin e saj, brendapërbrenda, kjo organizatë ka filluar të diferencohet nga pikëpamja e influencës së një shteti mbi të tjerët.

Republika Federale e Gjermanisë po forcohet çdo vit e më shumë në NATO. Forca e saj ekonomike e politike dhe tregtia që bën ajo me armë i kapërcejnë kufijtë e Tregut të Përbashkët Evropian dhe mund të themi se Gjermania Perëndimore gjithnjë e më hapur po kërkon të krijojë zonat e veta të influencës. Kjo, natyrisht, nuk u vjen në osh as Anglisë, as Francës, dy partnereve kryesore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në NATO.

Veçanërisht me Kinën Republika Federale e Gjermanisë po zhvillon marrëdhënie shumë të afërtë dhe lidhjet e saj me të zënë vendin kryesor për sa u përket vendeve kapitaliste të Evropës Perëndimore. Këto lidhje nuk ekzistojnë vetëm në fushën ekonomike. Gjer-

mania Perëndimore është furnizuesja më e madhe dhe më e fuqishme e Kinës edhe në kredi, në teknologji e në armatime moderne të sofistikuara.

Anglia dhe Franca, po ashtu, kanë interesa në Kinë, prandaj po i zhvillojnë marrëdhëniet me të, mirëpo Kina, si partnere besnikë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka interesa më të mëdhenj me Bonin. Kështu që Anglia dhe Franca shohin të Republika Federale e Gjermanisë një rrezik brenda në aleancë, pse kjo mund të dominojë akoma më shumë mbi partnerët e tjerë të aleancës. Prandaj konstatojmë se qoftë qeveria angleze, qoftë ajo franceze, flasin për miqësinë dhc për marrëdhëniet me Kinën, por nuk harrojnë të theksojnë se dëshirojnë të zhvillojnë më tej marrëdhëniet ekonomike dhe miqësore edhe me sovjetikët. Bile, haptazi dhe në kundërshtim me pikëpamjet kineze, flasin se në Evropë është larg lufta në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dome-thënë në mes Bashkimit Sovjetik dhe NATO-s. Me këtë ata duan t'i thonë Bashkimit Sovjetik se nuk kanë arsyë të sulmojnë vende të Traktatit të Varshavës, përkundrazi, dëshirojnë të vazhdojnë miqësinë me to. Këtë e thotë edhe Boni, mirëpo ky po i zhvillon me shpejtësi marrëdhëniet me Kinën, e cila paraqitet si armikja kryesore e Bashkimit Sovjetik. Kështu Bashkimi Sovjetik e shikon Gjermaninë Federale jo njësoj si Francën dhe Anglinë. Nga ana tjeter, vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në gjithë lojën e tyre strategjike, nuk i acarojnë lidhjet me Bashkimin Sovjetik. Ato vazhdojnë tratativat SALT me të, pavarësisht se Kartëri deklaroi se do t'i prodrojë bombat me neutron. Me-

gjithatë, në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik duket një tendencë për ruajtjen e statukuosë.

Pra, në këtë drejtim shohim që SHBA dhe NATO përpinqen të ruajnë statukuonë me Bashkimin Sovjetik, natyrisht, me gjithë kontradiktat që kanë me njëri-tjetrin, por këto kontradikta janë larg predikimeve kineze se lufta në Evropë është iminente.

Imperializmi amerikan në të njëjtën kohë e mbështet Kinën që të fuqizohet ushtarakisht dhe ekonomikisht. Me fjalë të tjera, kapitalet amerikane po vërshtojnë në Kinë, ku bëhen investime të shumta me kredi prej bankave të niëdha amerikane, por dhe prej shtetit amerikan. Aktualisht Kina merr kredi jo vetëm nga bankat, por njëkohësisht merr kredi edhe nga shtetet dhe jo vetëm nga Japonia e Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por nga të gjitha shtetet e mëdha kapitaliste të industrializuara.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kartën e Kinës po e luajnë me kujdes, bile fort. Ato vazhdojnë, gjithashtu, të luajnë kartën e tyre të strategjisë botërore me Japoninë dhe duan që me këtë vend t'i kenë ujërat të qeta, ndërsa ndihma ndërmjet tyre të jetë reciproke. Japonia, sipas amerikanëve, duhet të forcohet dhc të bëhet një Izrael në Lindjen e Largme, në Pacifik dhe në Azinë Juglindore dhe pse jo, më vonë edhc Kundër Kinës.

Në këtë situatë e nënshkroi Kina Traktatin e miqësisë dhe të bashkëpunimit me Japoninë<sup>1</sup>. Por ky Tra-

---

1. U nënshkrua në muajin gusht 1978.

ktat Kino-Japonez i miqësisë bart dhe do të bartë në të ardhmen edhe një rrezik me përpjesëtime të mëdha, të shumanshme e të shëmtuara për fatet e botës. Do të ndodhë kështu për arsyen se në mes Japonisë dhe Kinës do të stabilizohet një unitet ekonomiko-ushtarak me synime për krijimin e sferave të influencës, të veçanta dhe të përbashkëta sidomos në të gjithë Azinë, Australinë dhe në pellgun e Paqësorit. Ky unitet, natyrish, do të fillojë nën hijen e aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe i propaganduar kundër socialimperializmit sovjetik. E vërteta është se kjo aleancë kino-japoneze ka për qëllim kryesor mbijtjen e socialimperializmit sovjetik dhe likuidimin e tij nga Azia, Siberia, Mongolia e gjetkë, por edhe zhdukjen e influencës së tij në të gjithë Azinë dhe në Oqeani, në të gjitha vendet e ASEAN-it.

Kjo është strategjia e madhe e imperializmit amerikan, po njëkohësisht edhe e imperializmit kinez dhe e militarizmit japonez. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të përpiqen ta ruajnë në favor të tyre balancën e fuqisë kineze dhe të asaj japoneze që po ngrihet, por një mëngjes kjo balancë do t'u shpëtojë amerikanëve nga duart. Kështu, uniteti imperialist militarist kino-japonez do të bëhet njëkohësisht rrezik edhe për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe për Bashkimin Sovjetik, për arsyen se interesat e Japonisë dhe të Kinës, të dy këtyre vendeve të mëdha imperialiste aziatike, puqen për dominimin e kësaj sfere të madhe të influencës dhe për dobësimin njëkohësisht si të imperializmit amerikan, ashtu edhe të socialimperializmit sovjete.

tik. Ne do të asistojmë, pra, në një zhvillim relativisht të shpejtë të shumë ndryshimeve në këtë zonë...

Shtetet e Bashkuara të Amerikës përpinqen e do të përpinqen të ndihmojnë Kinën dhe Japoninë me qëllim që t'i mbajnë nën drejtimin e tyre, të forcojnë aleançën me to dhe t'i hedhin kundër Bashkimit Sovjetik. Kjo është njëra mundësi. Por ekziston edhe mundësia që të vijë një ditë kur politika djallëzore, hipokrite, perandorake, pa parime dhe në frysme imperialisto-militariste e këtyre dy fuqive të mëdha që u ndihmuat të mëkëmbeshin, të dalë kundër vetë SHBA-së ashtu siç bëri dikur Gjermania e Vejmarit, e cila, pasi u bë një fuqi e tmerrshme fashiste, sulmoi alcatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vetë ato në kohën e Hitlerit. Edhe këto dy «superfuqi» që po krijohen në Azi, i rrezikojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ne do të asistojmë, gjithashtu, në shtimin e kontradiktave midis vendeve të ASEAN-it, si dhe në mes Japonisë e Kinës, së toku dhe të veçuara nga njëra-tjetra, në mes këtyre të dyave dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe në mes këtyre të dyave e Bashkimit Sovjetik.

India, që është një vend i madh e me potencial të madh njerëzor, duke u ndihmuar nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, do të përpinqet të kthehet në një superfuqi me bomba atomike. Ajo do të përpinqet të rritë më tej edhe potencialin e vet ushtarak e teknologjik në konkurrencën midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik dhe do të jetë një pikësynim i rëndësishëm për të dyja superfuqitë, të cilat kanë interesat e çantë

dhe të përbashkët për një të ardhme në rrjedhën e ndryshimeve të alcancave që mund të ngjasin.

Aktualisht Kina nuk ka asnjë influencë në Indi, përkundrazi. Por ajo dëshiron të fillojë të ketë marrëdhënie diplomatike disi më të mira me të. Nga ana tjetër, pretendimet e Indisë ndaj Tibetit janë të mëdha. India do të luftojë ta likuidojë edhe atë influencë të paktë që mund të ketë Kina në Pakistan, për arsyë se Pakistani është, gjithashtu, një vend strategjik në krah të Iranit e të Afganistanit dhe këtu fillon interesimi për pellgun e madh të vajgurit të Lindjes së Mesme. Natyrisht, në Lindjen e Mesme dominon imperializmi amerikan, ndërsa Kina vetëm sa ka futur majën e gishtit, por si zor të depërtojë atje. Ajo do të bëjë një politikë kundër interesave të popujve arabë dhe pro interesave amerikanë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta ndihmojnë Kinën që tok me vende si Irani. Arabia Saudite etj. të bëhen një barrierë e fuqishme kundër një depërtimi politiko-ekonomik dhe ushtararak sovjetik në këtë zonë jetike për imperializmin amerikan dhe për imperializmin evropian, pse edhe «Evropën e Bashkuar», të lidhur me NATO-n, ne mund ta quajmë si një grupim të ri imperializmi në krijim e sipër, me gjithë kontradiktat e shumta brenda.

Si përfundim duhet të themi se aktualisht ekziston imperializmi amerikan, ekziston, gjithashtu, socialimperializmi sovjetik, por ekziston edhe «Evropa e Bashkuar» e lidhur në NATO me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vendet e «Evropës së Bashkuar» kanë tendenca imperialiste jo të koncentruara, por të veçanta, dhe, nga ana politiko-ushtarake, po ta lypë nevoja, si-

kurse edhe imperialistët e tjerë, mund të bëhen një rrezzik botëror.

Nga ana tjeter, shohim imperializmin kinez që po ngrihet, si dhe militarizmin japonez që është ngritur. Këta dy imperializma po lidhen në aleancë me njëri-tjetrin për të formuar një fuqi imperialiste në kundërshtim me të tjerët dhe pastaj, në të ardhmen, do të ngrihet edhe India, e cila do të ketë edhe ajo preten-dimet e veta për zonat e influencës të të tjerëve, sidos-mos në Azi. Në këto kushte shtohet rreziku i madh i luftës botërore.

Aleancat aktuale ekzistojnë, por këto do të shkojnë duke u zhvilluar ose duke u dislokuar. Ato do të vijnë duke u dislokuar në kuplimin e ndryshimit të drejtimeve, por jo të brendisë së tyre. Fuqitë imperia-liste që numërova më lart, gjer në zhdukjen e tyre do të mbeten imperialiste e luftënxitëse dhe përpinqen e do të përpinqen ta futin botën në një luftë të madhe atomike.

Kina socialimperialiste aktualisht lufton në shumë drejtime. Së pari, në drejtimin e brendshëm për të krijuar një unitet fals dhe për të sigruuar dominimin e borgjezisë kapitaliste kineze mbi popullin kinez, dhe këtë përpinqet ta bëjë me kërbaç, me shtypje. Këtij uni-leti ajo do t'i japë një formë demokratike të gënjeshtërt, pasi të ketë unifikuar ushtrinë dhe prapavijat që t'u shërbejnë planeve të saj invaduese e shtypëse.

Taktika aktuale e imperialistëve është që të gjë-njejnë njerëzimin përparimtar, të gjënjejnë popujt dhe të përhapin frikën e një luste të re të përgjakshme, të shtypin çfarëdo rezistence popullore, çfarëdo lufte

nacionalçlirimtare, me pretekstin se gjoja çdo akt revolucionar qenka një akt banditesk, qenka një akt terrorist që prish «paqen», «qetësinë» dhe del nga kuadri i demokracisë, natyrisht, i demokracisë borgjeze. Këtë teori të tyre ata e mbështetin edhe në veprime të nxitura dhe të organizuara nga qendrat e «sigurimit» të vendeve imperialiste, si CIA, KGB-ja, «sigurimikinez, «sigurimi» japonez etj. Të gjitha këto pjella të kapitalit organizojnë banda terroristësh që vrasin e presin dhe u dalin përpara clementëve revolucionarë të popujve, marksistë-leninistëve për t'i diskredituar dhe për t'i goditur.

Të gjithë imperialistët, së toku dhe vec e vec, kanë gjetur forma të ndryshme për të mbajtur nën zgjedhë, për të shtypur dhe për të diskredituar revolucionin, teorinë marksiste-leniniste të tij dhe veçanërisht leninizmin, që është teoria marksiste e vërtetë e në veprim në epokën e sotme të imperializmit në kalbëzim, në epokën e revolucioneve proletare.

Është e qartë për ne dhe për të gjithë popujt se rruga e revolucionit nuk është e lehtë. Shumë forca regresive veprojnë kundër tij në botë. Këto forca në çdo vend kanë vënë maska, të jashtme e të brendshme dhe janë në unitet e në divergjenca me njëra-tjetrën. Janë në unitet për mbajtjen e popujve nën zgjedhën e kapitalit botëror e vendës, por janë edhe në divergjenca për nxjerrje fitimesh, sa më shumë për vete, nga djersa e popujve dhe nga huatë skllavëruese që më të fuqishmit u japid më të dobtëve.

Është e vërtetë që e gjithë kjo strategji globale e imperializmit botëror ndiqet nga fuqi të mëdha e me

potencial të madh ekonomiko-ushtarak dhe politiko-demagogjik. Por ekziston edhe strategjia jonë e lavdishme e revolucionit, ekziston teoria e madhe e marksizëm-leninizmit. **Zjarri i revolucionit zien kudo në zemrat e popujve të shtypur, që dëshirojnë të fitojnë lirinë, demokracinë, sovranitetin e vërtetë, të marrin fuqinë në duart e tyre dhe të shkojnë në rrugën e socialistëve, duke shkatërruar fuqitë imperialiste dhe shërbëtorët e tyre vendës.**

Ne, marksistë-leninistët, që jemi në ballë të luftës revolucionare, e cila po zhvillohet sot në mes proletariatit e popujve të shtypur që aspirojnë për liri, nga njëra anë, dhe imperialistëve të egër e gllabérues, nga ana tjetër, duhet të kuptojmë mirë qëllimet, takтикat, mënyrat dhe format e luftës së armiqve tanë të përbashkët dhe të armiqve të veçantë të çdo vendi. Këtë gjë ne nuk mund ta shohim si duhet, në rast se nuk mbështetemi në teorinë tonë marksiste-leniniste të revolucionit, në qoftë se nuk shohim se, në situatat aktuale dhe në situatat e ardhshme që do të zhvillohen, ekzistojnë një sërë hallkash të dobëta të zinxhirit kapitalist botëror. Revolucionarët dhe popujt, veç e vç e së bashku, duhet të zhvillojnë një veprim të pandërrerë, një luftë të organizuar, të paepur e të guximshme, që të çahen hallkat e zinxhirit njëra pas tjetrës. Kjo, natyrisht, kërkon punë, luftë, sakrifica e vetëmohim. Popujt dhe njerëzit e guximshëm, të udhëhequr nga interesat e revolucionit, të shikuara në prizmin e teorisë sonë marksiste-leniniste që u çel popujve rrugën për realizimin e aspiratave të tyre, mund dhe do t'u bëjnë ballë këtyre forcave të mëdha të imperializ-

mit e të reaksionit që po ngrihen, që po lidhen me njëra-tjetërën nü aleanca të reja, që po kërkojnë zgjidhje nö situatat e vështira që u krijohen. Situatat e vështira këtyre forcave regresive ua krijojnë popujt, ua krijon demaskimi që u bëjnë marksistë-lininistët teorive dhe veprimeve të ndryshme imperialiste në të gjitha shtetet dhe në të gjitha kontinentet në përgjithësi.

Prandaj veprimet dhe mendimet tona duhet t'i shfaqim haptazi, pa druajtje, me guxim dhe pa marrë parasysh sakrificat. Kështu ne kontribuojmë nö atë lufë të madhe që zhvillojnë e duhet të zhvillojnë popujt kundër shtypësve të tyre kapitalisto-imperialistë, të cilët nö asnë moment nuk duhet t'i lëmë të livadhisin sipas qejfit të tyre dhe të kurdisin plane e intriga në kurriz të popujve të botës.

Revisionistët modernë sovjetikë, titistë, kinezë, eurokomunistë luajnë një rol makiavelik në ndihmë të imperializmit e të kapitalizmit botëror. Prandaj ne duhet t'i demaskojmë edhe këta me po atë forcë e vazhdimisht, në çdo veprim të tyre. Asgjë të mos na duket e ekzagjeruar në luftën tonë dhe të nisemi nga mendimi i gabuar se, meqë jemi një shtet dhe një parti e vogël, nuk duhet të flasim e të themi të vërtetën, sepse të tjerët do të na quajnë mendjemëdhenj! Me siguri që ata do të na quajnë mendjemëdhenj, sepse nuk u leverdisin e vërteta dhe drejtësia e mendimeve që shprechin Partia e Punës e Shqipërisë dhe shteti shqiptar. Ata kanë shumë shigjeta në kukurën e tyre për të na goditur, vetëm se ne kemi një mburojë shumë më të fortë kundër shigjetave të tyre të helmatisura. Kjo mburojë jona është e do të jetë uniteti i Partisë, uniteti

i popullit me Partinë, është e do të jetë marksizëm-le-ninizmi që na udhëheq vazhdimisht në luftën tonë titanike.

*Etuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Supersuqitë», f. 463*

*Etohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Supersuqitë».  
f. 463*

## **TUFËZIMI I BAGËTIVE TË OBORRIT, TË BËHIET VULLNETARISIIT, ME BINDJE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**30 tetor 1973**

*Në këtë takim u bisedua për tufëzimin e bagëtive  
dhe për një punë më të mirë e më të studiuar për rajoni-  
zimin, specializimin e përqendrimin e bimëve bujqësore.*

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Në Berat e kishin organi-  
zuar mirë punën për tufëzimin e bagëtive, bile po i  
shihnin edhe të mirat kësaj forme organizimi. Mua më  
thanë se nga bagëtitë e tufëzuara sivjet kishin marrë,  
përveç të tjerave, nga 40 kilogramë djathë dhe 4 kilo-  
gramë gjalpjë për familje. Këtë punë ata e kishin bërë  
që vjet dhe të tërë ishin të kënaqur. Vajta edhe në To-  
moricë ku, një fshatar, si duke qeshur, më tha: «Kemi  
kokën e fortë ne, shoku Ramiz, s'na hyn kollaj e  
reja!».

**SHOKU ENVER HOXHA:** Duhet kuptuar mirë një  
gjë, shokë. Bagëtitë e oborrit kooperativist janë një  
pasuri e madhe në shkallë republike dhe kanë rëndësi  
politike dhe ekonomike për gjithç vandin.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të këtij problemi, Byroja Politike e Komitetit Qendror në kohën e duhur mori një vendim shumë të drejtë dhe të përshtatshëm. Ajo dha njëkohësisht edhe orientimet e nevojshme që, si Partia, ashtu edhe organet e pushtetit të marrin masa që të zbatohet si duhet ky vendim.

Cilat janë këto orientime? Tufëzimi i bagëtive të oborrit kooperativist, në radhë të parë, të bëhet vullnetarisht, pra me bindje. Me këtë ne kemi pasur parasysh dëshirën e secilit kooperativist për të tufëzuar bagëtitë e oborrit që mban sipas statutit, qoftë të tëra, qoftë gjysmën apo një të tretën e tyre; ose, po nuk deshi, edhe asnjë. Gjithashtu, të mos harrojmë se vërtet oborret kanë bagëti të imëta, lopë e shpendë, por në vendim nuk bëhet fjalë as për pula, as për pata e as për gjela deti, pra, vetëm për të imëtat, lopët e derrat.

Mendoj se nuk është e drejtë të shkohet me fushata në këtë çështje. Fushata mund të pranohet vetëm në rast se opinioni përgatitet mirë që më parë politikisht dhe merren me kohë të gjitha masat organizative që kooperativisti të shohë konkretisht se vendimi i Byrosë Politike është i drejtë dhe shumë i leverdishëm për të. Duhet të bëhet e qartë që i zoti i bagëtive, edhe pas tufëzimit, ka të drejtë të tërheqë kur të dojë, për nevojat e veta një ose dy krerë kur dëshiron që t'i therë. Anëtari i kooperativës për bagëtinë që ka tufëzuar ka të drejtë gjithashtu të marrë qumështin, gjalpin e leshin por, natyrisht, duke paguar për këtë, në rregull, shpenzimet përkatëse të mbajtjes së tyre

në tufë. Domethënë, shpenzimt që bëhen për ruajtjen e bagëtive, për trajtimin e qumështit etj., duhet t'u mbahen kooperativistëve, kurse resti i të ardhurave t'i jepet të zotit në prodhime blegtore.

Kjo punë duhet të organizohet në një mënyrë të atillë që të vendoset bashkërisht nga të zotët e tufëzimit se ç'do të bëhet me prodhimin e përgjithshëm të qumështit: sa do të bëhet djathë, sa gjalpë, sa do të merrret qumësht i freskët etj. E tërë kjo punë duhet të mbahet me llogari. Jashtë statutit apo mbi statut asnjë gjë nuk duhet të lejohet të bëhet.

**Tokat që kemi vendosur t'u shkurtohen oborreve duhet të mbillen me foragjere, pikërisht për të ushqyer këto bagëti të tufëzuara, sepse nuk ka vende të tjera se ku t'i ushqejë kooperativa. Në rast se kooperativa ka akoma hapësira të lira për kullotë, të merren masa edhe në këtë drejtim.**

Për zbatimin e vendimit që është marrë nga Byroja Politike ne duhet të kërkojmë llogari nga Ministria e Bujqësisë dhe ajo të na japë një raport se deri në ç'shkaillë është arritur tani me tufëzimin, punë kjo që do të realizohet me etapa.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Sigurisht që kjo punë do të ecë shkallë-shkallë. Në fillim, duke mos qenë sa duhet të qartë e të bindur, nuk do të pranojnë gjithë fshatarët, ashtu siç na ndodhi edhe me futjen në kooperativat bujqësore, të cilat nuk u ngritën të tëra menjëherë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pra, kështu do të ngjasë edhe me tufëzimin, pse këtu kemi të bëjmë me pronën private, ekzistencën e së cilës ne e kemi pranuar

deri në njëfarë mase në fshat dhe atë e kemi pranuar me vetëdije, si diçka të domosdoshme në këtë periudhë kalimtare.

Për këtë problem neve nuk na mjafton vetëm një raportim i thjeshtë nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe nga Partia. Jo, këto duhet të na thonë nëse është bërë kjo punë mbi baza të drejta apo nuk është bërë; është punuar mirë politikisht apo nuk është punuar; mbahen mirë llogaritë e bagëtive të tufëzuara apo nuk mbahen; bëhen abuzime apo nuk bëhen. Të jemi realistë se në kooperativat bujqësore aktualisht, ka abuzime në pronën e përbashkët. Atëherë, a nuk bëhen edhe në pronën private, në bagëtitë e tufëzuara abuzime? Prandaj nuk duhet ia flemë mendjen se me t'u bërë tufëzimi, çdo gjë shkon mirë. Aty duhet të ketë kontroll të fortë nga Partia. Nuk mund të mos e kemi syrin hapur në drejtim të kësaj pune, për arsyet se e dimë dhe *a priori* që ekzistojnë akoma mbeturina të vjetra në ndërgjegjen e njerëzve në fshat, sidomos ato të ndjenjës së pronës private. Prandaj, po të na thuhet që çdo gjë shkon në rregull me tufëzimin, këtë nuk ta beson njeri, se nuk kemi arritur akoma në atë shkallë. Kjo punë ka rëndësi të madhe dhe duhet vëzhguar e ndjekur me kujdes, natyrisht, jo dita me ditë, por të dihet kur bëhet dhe si punohet. Të mbajmë parasysh që të dy raportet që do të na bëhen, në rrugë shtetërore e në rrugë partie, duhet të puqen si nga ana politike e organizative, ashtu edhe nga ana teknike e nga mënyra e trajtimit, me një fjalë, nga të tëra anët që të dimë se çfarë po bëhet.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Ndryshe mund të na kri-

johen edhe probleme politike me këtë masë që është marrë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, sigurisht, po të mos ndiqet me kujdes kjo çështje, derisa të marrë mirë rru-gë, atëherë mund të na krijojen edhe probleme politike.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Pastaj, duhet pasur para-sysht edhe një gjë tjetër. Në kooperativa nuk kuptohet akoma mirë se bagëtitë e oborreve kooperativiste, janë pjesë përbërëse e pasurisë nationale, prandaj për to duhet treguar po aq kujdes, sa ç'tregohet edhe për bagëtinë e kolektivizuar.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Drejt, ashtu është, bagëtitë e oborreve, të marra në shkallën e gjithë vendit, përbëjnë një pasuri të madhe. Bile, pjesën më të madhe të bagëtive si republikë e kanë oborret kooperativiste.

Me tufëzimin e bagëtive, mund të dalin edhe probleme të tjera, siç është ai i sipërfaqes së oborrit. Në kooperativat që po tufëzojnë bagëtitë mund të lindë pyetja: «Ç'do të bëhet tani me oborrin kooperativist, me këtë sipërfaqe toke, që deri tani i shërbente në një masë të madhe edhe sigurimit të ushqimit të kësaj bagëtie?».

Mendoj se ajo duhet të destinohet për gjëra të tjera. Po për çfarë do të thotë ndonjëri? Për zarzavate apo për misër, fjala vjen. Çështja është që tani, kjo si-përfaqe toke të ndihmojë në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë bujqësore, pra të përdoret për të plotësuar nevojat e vetë kooperativistëve dhe të mos lejohet ta mbjellin atë me destinacion për t'i shitur privatisht prodhimet, se pastaj do të futemi në një labirinth që nuk është në rrugën tonë.

*SHOKU HYSNI KAPO:* Një kooperativist në Fier mbillte në tckën e oborrit fshesa e kastraveca dhe shkonte i shiste ato në Korçë me çmime spekuluese. Po vepruan kështu, anëtarët e kooperativës do t'i largohen punës në pronën e përbashkët.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Natyrisht që do t'i largohen.

Këtu ka një gjë: tani bagëtitë po tufëzohen. Mirëpo, kur kjo ndodh në një kooperativë fushore, ku të gjitha tokat janë të tëra të mbjella, qoftë edhe me foragjeret për bagëtitë e kooperativës, atëherë ka rrezik që bagëtitë e tufëzuara t'i lënë pa i ushqyer si duhet, për arsy se për foragjeret nuk tregohet akoma kujdesi i nevojshëm; ato, midis bimëve të tjera, trajtohen si vrima e fundit e kavallit. Tani, me tufëzimin e bagëtive të oborreve në një kooperativë shtohen për të ushqyer, ta zëmë, edhe 2 000 krerë të tjera. Mirëpo, me se do të ushqehen ato? Kjo vë detyrën që, në radhë të parë, të shtohet prodhimi i foragjereve. Mirë, por mund të dalë që prodhimi i foragjereve, pavarësisht nga rritura e rendimenteve të tyre, prapë të jetë i pamjaftueshëm. Atëherë duhen kërkuar rrugë të reja. Për shembull, duhen llogaritur se sa janë sipërfaqet e oborreve dhe duhet parë se çfarë mbjellin në to anëtarët, tani që bagëtitë u janë tufëzuar. Në qoftë se vihet re, që një anëtar mbjell në oborrin e tij, ta zëmë, misër e një tjetër grurë mund t'u thuhet se ç'u duhen këto, kur bukën ua garanton kooperativa? Pse nuk e mbillni gjysmën e kopshtit me zarzavate dhe gjysmën tjetër me misër hamullor ose me bimë të tjera foragjere për bagëtinë, për të përballuar me ushqim nevojat e bagëtisë

së tufëzuar?! Kjo punë, pra, duhet bërë me llogari dhe me organizim, se nuk është një çështje aq e thjeshtë: «Oburra, hajde të bëjmë tufëzimin!» ose, «ejani të bëjmë një mbledhje për ushqimin e bagëtive të tufëzuara», vetëm sa për të thënë disa fjalë. Rëndësi ka që ata të binden pse e bëjmë këtë tufëzim. Mund t'u thuhet, për shembull, se tani, me grumbullimin në tufa të gjithë këtyre bagëtive të oborreve, kemi në dorë një ekonomi shumë më të madhe nga pikëpamja numerike se ai i bagëtive që kishte secili, prandaj të përpinqemi bashkërisht t'i gjejmë zgjidhje edhe sigurimit të ushqimit të tyre.

Në qoftë se nuk tufëzohen bagëtitë, mund t'u thuhet të zotërve të tyre, se ato nuk do të lejohen të futen në tokat e kooperativës, prandaj, po të doni i mbani, por vetëm se keni për t'i ushqyer me prodhimet që do të siguroni nga oborri, gjetkë jo. Pra, parimi i vullnetarizmit, si kurdoherë qëndron në fuqi: po deshi anëtarë e tufëzon bagëtinë që ka, po nuk deshi nuk e tufëzon. Por, në qoftë se ai nuk e tufëzon, do të duhet ta mbajë në oborrin e vjet dhe të mos i sjellë dëme kooperativës.

Në qoftë se një anëtar është dakord ta tufëzojë bagëtinë, ato do t'i futen në llogari. Që nga koha e tufëzimit ai do të marrë qumështin që i takon; do të marrë edhe viçin, kecin apo qengjin, të cilët do t'i ushqehen me kaq ose aq shpenzime. Pastaj, kur të arrijnë peshën e caktuar, do t'i thuhet që këtë viç, kec apo qengj, po të dojë, mund t'ia shesë kooperativës me para, ose mund ta hajë vetë mishin, por nuk mund ta mbajë në oborr mbi statutin. Përveç lopës që ka tufëzuar, ai nuk ka të drejtë të mbajë tjetër, se bie në ku-

ndërshtim me statutin. Kështu, viçin ose delen a dhinë e tepërt, mund t'ia blejë kooperativa, por në treg vëtë nuk duhet ta shesin. «Po pse, — mund të thotë ndonjëri, — kjo është pasuria ime dhe unë e bëj si të dua». Vërtet pasuria e tij është, por të mos harrojë se kooperativa atij po i bën shumë favore, prandaj nuk është e drejtë që ai të dalë në pazar dhe ta shesë privatisht se ky do të ishte spekulim. Anëtari mund t'ia shesë mishin kooperativës me çmimet që janë caktuar sipas kategorisë së mishit. Po të bjerë fshatari dakord kështu, atëherë nuk ka arsyq ta marrë prapë lopën apo delen nga tufa. Në qoftë se do të mbajë lesh, posa, ta mbajë, se mbasë ka nevojë të bëjë çorape apo triko për fëmijët.

Të tëra këto çështje duhet të shikohen me kujdes të madh, se janë probleme delikate e të rëndësishme. **Atje ku është bërë tuftëzimi e nuk është marrë parasysh dëshira e anëtarëve, ky veprim duhet të pezullohet.** Padrejtësia ose imponimi që u është bërë kooperativistëve duhet të vihet në vend. Atje ku është vepruar kështu, duhet të shkojnë shokë nga qendra, të mbledhin tërë anëtarët e kooperativës dhe t'u thuhet që këtu bagëtitë nuk janë tufëzuar në bazë të udhëzimeve të Komitetit Qendror dhe t'u zbërthehen edhe një herë të gjitha orientimet për sqarim. Po të veprohet sipas këtyre orientimeve dhe po të sqarohen mirë këto, atëherë do të ndodhë ndryshe, kooperativistët do të vepronin me bindje.

Orientimet e Partisë e thonë qartë se për t'u bërë tufëzimi duhet marrë më parë aprovimi i vëtë kooperativistëve e pastaj të veprohet. Unë do të thosha se në

një kooperativë të madhe mund të veprohej edhe ndryshe. Në shtëpinë e kulturës, vendosej që më parë për disa ditë me radhë një material i shkruar, ku të shpjetoheshin qartë se cilat janë kushtet apo orientimet e dhëna për tufëzimin dhe renditeshin me radhë të gjitha ato që përmenda më lart. Kështu që këtë material të shkruar mund ta lexonte çdo ditë secili anëtar i kooperativës.

*SHOKU HYSNI KAPO:* Duhet t'i dijë mirë çdo fshatar këto çështje, në mënyrë që edhe po të vejë ndonjë tjeter e t'i shtrembërojë me qëllim udhëzimet, secili të jetë i qartë dhe në gjendje që t'i thotë se udhëzimet e Partisë janë kështu si po them unë dhe jo si po na i shtrembëron ti.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, po! «Ja si është puna, t'i thotë, çdo gjë është shkruar qartë dhe me gjerma të mëdha në një material te shtëpia e kulturës!».

Pse, more shokë, nuk i bëjmë kështu këto gjëra? Çështja e fshatarësisë është shumë delikate dhe atë duhet ta marrim ashtu siç është, se ajo nuk ka arritur akoma në atë shkallë ndërgjegjeje që duam, bile kjo ndodh edhe te klasa punëtore e jo më te fshatarësia.

Këto probleme, siç thashë dhe më parë, nuk janë të vogla, por të mëdha. Natyrisht, ka shumë punë korente që duhen ndjekur nga Ministria e Bujqësisë e nga Partia në bazë, si dhe nga vetë kooperativat bujqësore. Por, në bujqësi ka edhe mjaft probleme të tjera të rëndësishme që duhen zgjidhur dhe që kanë një karakter nacional, të cilat, në një kohë të caktuar, duhet t'i bëjmë objekt të një studimi që të dimë se ku jemi me to.

E mbani mend mirë, se për një kohë ne flisnim vazhdimisht që të mos ujitej me përmbytje, po me brazda, për ekonomizimin e ujit dhe për të mos dëmtuar bimët. «Kjo është një punë shkencore, — na thuhej, — është kështu e është ashtu». Bukur. Dhe ne kemi diskutuar e kemi marrë vendime për të gjitha këto. Tani vallë, a nuk ia vlen të na bëhet një raport se ku jemi me ujiten dhe ç'duhet bërë më tej për këtë problem? Si ujiten sot bimët bujqësore, njëlloj si më parë apo janë bërë përparime, sipas të dhënave të fundit të shkencës? Po tokat si janë sistemuar për t'i shërbyer këtij qëllimi? etj. Se ne tani dëgjojmë vetëm të na thuhet që morëm këtë apo atë rendiment në këtë apo atë bimë, nga kjo apo ajo brigadë e dalluar etj. Mirë, dakord, të na flitet edhe për rendimentet, edhe për brigadat e dalluara, se edhe këto na interesojnë shumë, por duhet të na flitet edhe për të gjitha problemet e tjera për të cilat janë dhënë orientime e janë marrë vendime me rëndësi të madhe për bujqësinë. Po pse nuk na jepen? S'duan vallë të na i japin? Jo, kjo nuk është e vërtetë! Çështja është se kuadrot i rrëmbejnë punët korente të shumta të bujqësisë.

Po ç'kemi ndonjë gjë tjeter nga rrethi i Dibrës shoku Hekuran? Problemët ekonomike, në përgjithësi, si qëndrojnë atje? Çfarë thonë shokët e këtij rrethi për deficitin në drithëra?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Tokat që mbillen me misër atje i kanë në nivelin që i kap bryma vit për vit. Në fushë, nuk ka mundësi ta mbjellin, se e kanë të zënë kryesisht me grurë. Kështu që duke i kapur tokat

bryma gati çdo vit, marrin shumë pak prodhim, në krahasim me atë që planifikojnë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ku janë këto toka?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Në Steblevë, në Klenjë dhe në Kala të Dodës, ku denbabaden kanë pasë mbjellë vetëm thekér e patate.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po pse nuk mbjellin patate dhe thekér në ato toka që tani i mbjellin me misër?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Patatja te ne, në shumë raste i është lënë spontaneitetit; po ra shi, do të marrësh prodhim, ndryshe kjo bimë nuk rritet.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në rrethin e Dibrës mund të mos marrin as në fushë patate, mbasi edhe atje nuk ra shi. Meqenëse na thuhet që denbabaden, në këtë apo atë zonë është mbjellë patatja, pse të mos shikohen një çikë statistikat e reshjeve, për disa vjet me radhë, në Kalanë e Dodës, fjala vjen?

**SHOKU HYSNI KAPO:** Sipas mendimit tim, çështja është se në rrethin e Dibrës kanë bërë spostimin e bimëve bujqësore në kundërshtim me kërkesat klimaterike të këtyre bimëve. Atje me sa duket kanë ngarkuar fushën më shumë me grurë, kurse misrin e kanë spostuar lart, në zonat malore, ku ai nuk arrin të piqet në kohë. Mendoj se në ato lartësi nuk duhet të mbillet misër, siç veprohet në lartësi të tillë në rrethin e Korçës. Në këto zona mund të mbillet grurë, patate e thekér. Kjo çështje të shikohet mirë, se lugina e Dibrës ka qenë dëgjuar denbabaden për prodhimin e mbarë të misrit. Atje janë marrë rendimente të larta. Pastaj, varet edhe se sa ia bëjnë shërbimet patates atje, sepse s'ka asnjë arsy që

të mos zhvillohet, derisa bëhet në Shishtavec të Kukësit, që është një zonë edhe më e lartë se Kalaja e Dodës.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë jam dakord me atë që thua ti, Hysni, se shpërndarja e bimëve në mënyrë të studiuar ka rëndësi të madhe, bile shumë të madhe. Bic brymë në Kalanë e Dodës, thotë ai i Dibrës, dhe kjo është e vërtetë, se ata e dinë nga eksperienca e tyre këtë gjë. Atëherë, pse të rrimë ne me zemër të ngrirë dhe të ndjekim nëse ra apo s'ra bryma? Të mbjellim atje ato bimë nga të cilat jemi qind për qind të sigurt se do të marrim prodhim.

Këto që po themi nuk duhet të mbeten këtu. Të thirren sa më parë shokët e rrethit të Dibrës dhe të diskutohet me ta për këtë problem, si dhe me shokë të tjerë të aparatit e me specialistë nga Ministria e Bujqësisë. Kjo çështje të diskutohet deri në fund, në mënyrë që për vitin e ardhshëm të bëhen ndryshimet e nevojshme për t'i mbjellë bimët në kushtet e përshtatshme sipas zonave, sepse me muhabete nuk ecin këto punë. Në qoftë se duhet të mbjellin thekër në zonat e larta, ta mbjellin, por jo që të marrin vetëm tre-katër kuintalë për hektar, po 25, siç merr Korça, sepse kemi nevojë edhe për thekër.

Nuk kemi marrë ne këtu vendime për një rregullim dhc harmonizim sa më të përshtatshëm të bimëve bujqësore? Sigurisht që kemi marrë; kemi bërë edhe studime për këto çështje. E po atëherë, kështu do të vazhdohet? Përditë duhet të flasim për këto probleme? Nuk piqet misri se e zë bryma, thotë dibrani. Mundet që e zë edhe bryma. Po kush duhet ta studiojë

këtë çështje atëherë dhe të marrë masa që atje të mbjellin ato bimë të cilave nuk u bën dëm bryma, siç është patatja, për shembull, sepse dihet që në ato zona ka tërë jetën që bie brymë, qysh në muajin shtator. Kjo gjë duhet të bëhet. Iniciativa e bazës këtu është e domosdoshme, sepse, duke e lënë këtë çështje kështu, nuk merr fare prodhim. Atëherë, si është më mirë të marrësh ca patate dhe thekér apo të mos marrësh asnje kokërr misër? Po mirë, pse nuk i bëjnë ata këto gjëra? Duket që disa kuadro nuk kanë iniciativë.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Pse e kemi shtruar ne çështjen e rajonizimit, të specializimit dhe të përqendrimit të bimëve bujqësore? Disa gjëra ka kohë që i kemi caktuar dhe, derisa shohim se në disa raste nuk kemi rezultate, atëherë duhet të bëjmë korrigimet përkatëse.

Nuk ka logjikë që të fillojム që nga Shkodra e deri në Sarandë të mbjellim oriz, prandaj mendoj se mund të vendosim të mbillet vetëm në dy rrethe si në Shkodër dhe në Lezhë. Po kështu duhet të veprojmë edhe me lullediellin etj.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** 500 hektarë lulledielli i janë caktuar për të mbjellë rrelshit të Matit dhe nga kjo sipërfaqë atje mezi marrin farën, kurse rrethi i Krujës shkon shumë mirë me këtë bimë.

Atëherë, përsë të mos ia japim Krujës edhe këta 500 hektarë sipërfaqe toke që ia kemi caktuar Matit dhe këtu të mbjellim misër në vend të lullediellit. Pra, fjalën e kisha se ka shumë gjëra të tillë, që duhen parë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Për këto çështje, ne kemi marrë vendime prandaj t'i ndreqim çrregullimet që vërehen.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Unë jam dakord me ato që u thanë. Rrethi i Dibrës në vend të misrit që nuk jep rezultat, mund të mbjellë thekër e patate në zonat e larta, sepse e ka klimën të përshtatshme për këto prodhime. Në Steblevë, për shembull, marrin 110 kuintalë patate, kurse misër vetëm 15 kuintalë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** 110 kuintalë patate për hektar në ato lartësi, është një rendiment që duhet konsideruar i pranueshëm. Patatja është ushqim shumë i mirë, përdoret si bukë dhe si gjellë njëkohësisht.

Nga sa di unë, patatja është një bimë që kërkon mjaft punë. Në qoftë se është kështu, atëherë atje ku kultivohet kjo bimë, duhet të sigurohen më shumë forma pune. Këto probleme shokët e këtij rrethi mund t'i nxjerrin dhe pastaj, po të vendosim që në vend të misrit të mbjellin patate, mos na thonë se s'kanë njerëz në Kalanë e Dodës, prandaj nuk mund të mbjellim dot patate. Duhet menduar mirë edhe për këto gjëra.

Pra, në këtë rreth, kemi një problem me rëndësi që nuk na shkon. Po ministria, çfarë bën për t'i zgjidhur këto çështje? Po ja, jemi duke e studiuar, të thonë shpesh, kur i pyet për ndonjë problem të tillë. Kurse unë dua të di konkretisht se çfarë ka bërë kjo ministri në rrethin e Dibrës për këtë çështje.

Mendoj se ministria mund t'i vërë në zbatim këto detyra, në mos sivjet të paktën pas dy vjetësh, pasi ta ketë studiuar mirë këtë çështje, duke marrë edhe masat përkatëse: Për shembull, mund t'ia heqë grurin rrëthit të Dibrës dhe t'ia ngarkojë një rrethi tjeter që e di se i ka mundësitë për të marrë 45 kuintalë për hektar. Misrin Dibra ta mbjellë në Luginën e Drinit, kurse

në zonat e larta të mbjellë patate. Kështu mendoj se duhet ta studiojnë dhe ta zbatojnë vendimin që kemi marrë, ndryshe do të thotë të flitet pa përgjegjësi.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Domethënë, planin e përgjithshëm të prodhimit, për të gjitha bimët, në shkallë republike, ne nuk e cenojmë, përkundrazi, duke vepruar në këtë mënyrë, do të kemi më shumë prodhim, sepse kështu do të ngrihet rendimenti.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Këto janë punë shkençore, shokë, po shumë nga kuadrot tanë i shohin vetëm në një drejtim, nuk i shohin edhe në drejtime të tjera, pra, nuk i konceptojnë në mënyrë të gjithanshme. Shkenca e përparuar sot të nxjerr grurë me bisht të shkurtër dhe të trashë që të mos rrëzohet në ato vende ku e rreh shumë era e fortë. Llojet e grurit me bisht më të gjatë i mbjellin atje ku ka më pak erëra. Këto gjëra ne i dimë e i themi, por jo kurdoherë interesohemi që t'i zbatojmë. «Prodho lulcedielli në luginen e Matit», u thuhet nga lart shokëve të këtij rrethi, në vend që ta mbushin atë luginë me misër që bëhet shumë mirë, siç janë mbushur edhe kodrinat përreth. «Jo, thotë ai i Komisionit të Planit ose i Ministrisë së Bujqësisë, se kështu e kemi bërë planin ne». Po si e bënë planin ata pa pasur parasysh këto veçori? Partia ka orientuar që në planifikim të mbahet parasysh edhe njëfarë rajonizimi, rajonizim ky që nuk bëhet për një vit; prandaj duhet ta ndjekim vazhdimesht këtë çështje, të shohim nëse ecën apo nuk ecën. Kemi ndonjë raport të dërguar nga dikasteri për këto çështje apo jo?

**SHOKU PROKOP MURRA:** Na erdhi njëherë një raport nga Ministria e Bujqësisë për rajonizimin e pro-

dhimeve bujqësore, nëpërmjet Kryeministrisë, po ai i trajtonte çështjet në mënyrë shumë të përgjithshme.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ç'e duam atëherë ne një të tillë raport? Pse nuk ia kthyet Qeverisë dhe Ministrisë së Bujqësisë? Nuk i thonë rajonizim këtij!

Kjo punë, pra, duhet të bëhet e koordinuar me shokët që do të thërriten nga rrethi. Unë jam dakord me këtë që thamë për rrëthin e Dibrës, të bëhen ndryshimet e nevojshme në mbjelljen e bimëve, sipas kushteve klimaterike, po kjo punë të bëhet e studiuar mirë dhe e akorduar me të gjitha detyrat e tjera. Mendimet që themi, në këto takime që bëjmë çdo ditë këtu, mund të mos jenë të tëra të drejta. Por, këtu i kemi drejtoritë e Komitetit Qendror, të cilat duhet të ngarkojnë instruktorët që të venë në bazë e të verifikojnë jo vetëm zbatimin e atyre që kemi vendosur, po edhe mendimet që japid kohë pas kohe, për të parë nëse janë të drejta apo jo. Por duhet parë edhe mënyra se si e ndjekim zbatimin e detyrave. Unë mendoj se në fillim duhet vajtur atje ku e kanë bërë mirë punën dhe prej andej pastaj të shkohet në ato ekonomi ku nuk e kanë kryer detyrën. Pasi të udhëzohen edhe këto se ç'duhet të bëjnë, të ngarkohen njerëz që t'i kontrollojnë se si i zbatuan detyrat që u dhanë.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Ja, ne morëm në slujdim drenazhimin dhe për këtë qëllim bëmë vrojtime në ndërmarrjen bujqësore të Levanit, e cila ka tre vjet që ka dalë nga prapambetja. Është nga të vetmet ekonomi në republikë që ka punuar me intensitet për realizimin e kësaj detyre duke arritur në drenazhimin e gati 60 për qind të sipërfaqes.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kjo ndërmarrje është vetëm një «dallëndyshe», prandaj duhet punuar që eksperiencia e saj të përgjithësoshet.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Edhe unë këtu e kisha fjalën që tani të organizojmë mirë punën e të marrim masa që këtë përvojë ta realizojmë edhe në ekonomitë e tjera bujqësore.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po çfarë pritet dhe përsë nuk merren këto masa? Nuk ka pse të qëndrohet në pritje për këto çështje. Ja, për shembull, ju bëtë mbledhje në kooperativën e Donofrosës që merr prodhime shumë të mira në luledielli. Tani, problemi kryesor është ajo që tha Hysni: përsë të mbillet luledielli në 16 kooperativa? Sa më shpejt, bile brenda javës, të bëhet një planifikim tjetër që kjo bimë të përqendrohet në më pak ekonomi bujqësore. Këto janë probleme që nuk presin, që nuk durojnë humbje kohe. Pastaj, drenazhimi është çështje tjetër. Më parë mund të caktojmë të drenazhojmë, ta zëmë, fushën e Myzeqesë, kooperativat e këtij apo të atij rrathi, të cilave u caktojmë si detyrë që të bëjnë drenazhimin në masën 60-70 për qind të sipërfaqes, brenda dy vjetëve. Pra, duhet diskutuar në sa kohë do ta bëjë çdo ekonomi kooperativiste këtë detyrë.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Biseduam pardje me Prokopin, lidhur me pemëtarinë. Çfarë të thuash për këtë sektor? Prodhohen fidanë, po këta shpërndahen nga pak e nga pak në të katër anët, me qëllim që t'i mbjellin sa më parë. Mirë, këta të mbillen, po duhet treguar kujdes edhe për t'i rritur.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ne vërtet prodhojmë

fidanë e i mbjellimi ata, po jo kurdoherë realizojmë zënien e tyre. Duhet ta mendojmë seriozisht këtë çështje, se po nuk realizuam zënien e fidanëve, do të thotë se po bëjmë shpenzime që shkojnë fare kot. Prandaj këta do t'i dërgojmë për t'u mbjellë atje ku ka mundësi të mbijnë, e ku mund të caktohen edhe njërež që të merren me këtë punë, pra që të kujdesen e të bëjnë përpjekje që në kohën e parashikuar pemët e mbjella të jatin prodhim. Ne kemi krijuar, për she-mbull, një fidanishte për prodhim fidanësh kumbulle në Tropojë. Atëherë, në radhë të parë, ne të plotësojmë nevojat e këtij rrethi për të tillë fidanë, sepse është vendi i kumbullave, pastaj, po të teprojnë, mund t'i japim edhe Pogradecit. Kështu, mendoj unë, duhet vepruar fjala vjen, edhe për mollët; t'i jepen në radhë të parë rrethit të Dibrës, që po i mbjell në plantacione të gjera, pastaj rretheve të tjera dhe të mos shpërnda-hen 500 andej, 500 këndej, se kështu, në sipërfaqe të ngushta, eksperienca na ka mësuar që nuk tregohet kujdes për to.

**SHOKU RAMIZ ALIA:** Te disa kuadro drejtues të rretheve ekziston mentaliteti që «rrethi im ka mbetur prapa nga rrethi tjetër në pemëtarin» dhe për këtë edhe ai vetë përpinqet të bëjë diçka. Nuk shikohen këto çështje në planin e një ekonomie të madhe, siç është sot ekonomia jonë, por shkohet akoma me pikë-pamjet për ekonomitë e vogla artizanale që t'i jepen pesë këtij e pesë atij, domethënë dominon akoma idëja e «ndarjes proporcionale», në vend që tani të mendohet ndryshe. Edhe për atë që thoni ju, për anën shkencore të problemit, ndodh që disa gjëra mbeten në

mes të rrugës. Kështu ka ndodhur, për shembull, me përvojën e Plasüs.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Pastaj, këto probleme duhen ndjekur vazhdimisht.

Të vijmë tani te çështja e duhanit. Dihet se kjo bimë sjell të ardhura të mira. Për këtë u mendua që t'u jepnim të gjitha rretheve për të mbjellë një sipërfaqe të caktuar me duhan jo vetëm për të plotësuar nevojat e tyre, por edhe për të rritur të ardhurat e kooperativave. Por, a është e nevojshme të vazhdohet të bëhet një gjë e tillë tash, kur bujqësia jonë po zhvillohet në mënyrë intensive e ku çdo pëllëmbë toke jona është flori? Në rrethin e Korçës, ku gati po dyfishojmë kapacitetin e fabrikës së sheqerit kemi vënë detyrë që të mbillet përsëri duhan? Po kështu edhe rrethit të Pogradecit, i cili në fillim mori 10 kuintalë për hektar, kurse tani ka arritur 5, bile edhe 4 kuintalë për hektar. Vallë a na leverdis neve të vazhdojmë të kultivojmë duhan në këto rrethe dhe të marrim rendimente kaq të ulëta, në vend që në këto toka të mbjellim panxhar, nga i cili mund të marrim deri 300 kuintalë për hektar?! Mua më duket se në mjaft raste vazhdohet të punohet me të vjetrën. Në këto kushte, unë mendoj se ne duhet t'ia heqim duhanin si Korçës edhe Pogradecit. Shokët e këtyre rretheve thonë se duhanin e kanë mbjellë në kodër, mirëpo në kodër ata le të mbjellin më mirë elbin distik. Kështu ndodh me ekonomitë e vogla: mbill një sipërfaqe të vogël me këtë bimë, një çikë nga ajo tjetra dhe, në fakt, nuk marrin hiçgjë prej tyre. Këto gjëra duhet

t'i shikojmë me kujdes, se përbëjnë probleme të mëdha për bujqësinë tonë.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Varet edhe nga ajo se si i caktojmë që në plan këto probleme. Ja, për shembull, tani po mendoj për drenazhimin: përsë të shkojnë tubat që nga Vlora deri në Dibër, kur ne mund të drenazhojmë më parë tokat e ndërmarrjeve bujqësore?

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirëpo shteti e ka në dorë, s'jep tuba, nuk i planifikon. Prandaj kooperativat të vazhdojnë ta bëjnë këtë punë ashtu si e kanë bërë deri tani dhe të presin për tuba, derisa të janë satruar kërkuesat e të tjerëve që janë më urgjente. Këto tuba shteti i prodhon për nevojat e gjithë ekonomisë sonë populllore, gjë që ka për qëllim rritjen e prodhimit, që të merret sa më shumë grurë, luledielli, panibuk etj. Në qoftë se kooperativa nuk dëshiron ta bëjë drenazhimin me këtë mënyrë, le të mos e bëjë; t'ia bëjmë të qartë se për tuba ajo do të presë kur t'i vijë radha.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Investimin e fondeve monetare shteti do ta bëjë më parë atje ku mund të merrin prodhime më shumë. ,

**SHOKU IIEKURAN ISAI:** Për zonat e Veriut qëndron edhe problemi i farërave.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Studimin për farërat e ndryshme dhe klimat që u përshtaten atyre, ne nuk mund ta kërkojmë që të bëhet matematikisht. Farërat ndiqen me gjeneracione: i dyti, i treti, dhe ato duhen zëvendësuar njëra pas tjetrës.

Çështja është që parimin e planifikimit ta zbatojmë drejt. Cili është ky parim? Planet te ne bëhen nga baza, nga prodhimi e pastaj miratohen nga organet

më lart. Atëherë, specialistët e Tropojës, në Veri, ta zëmë, duhet të mendojnë për ta zbatuar këtë parim. Kur vjen koha e hartimit të planit, të mbledhen njëherë këta specialistë dhe të diskutojnë për problemet e shumta të bujqësisë sonë, për farërat, për rajonizimin, për rritjen e rendimenteve etj., etj. Pra, ata duhet të mbledhen jo vetëm kur është puna për të zgjedhur deputetin apo këshilltarin, por edhe për të diskutuar për probleme të ndryshme, sidomos për çështje jetike si këto që po diskutojmë edhe ne sot. Në këto mbledhje të rrihen mendime se kjo zonë është e tillë; në këtë krahinë ne duhet të mbjellim këtë lloj misri, në atë tjetrën këtë varietet gruri; në këtë zonë duhet të bëjmë drenazhimin sivjet, në këtë tjetrën pas dy vjetësh etj. Pse të mos i mësojmë ne njerëzit tanë të punojnë në mënyrë të organizuar? Kështu të hartohet plani nga baza, po ai, natyrisht, të aprovohet edhe nga lart.

Qendra, këtu lart, ia dikton bazës se ç'duhet të bëjë, sepse shikon interesin e përgjithshëm. Por, po të shikojë se këtë shqetësim e ka parasysh edhe vetë baza, nuk ka arsyë që të mos e aprovojë. Ne themi, për shembull, se duhet të mbjellim 20 mijë hektarë me lulëdielli. Por, lidhur me këtë, përveç sipërfaqes që duhet ta sigurojmë, kemi edhe çështjen që kjo bimë të rajonizohet. Mirëpo, ku të rajonizohet? Ne japim udhëzim, fjala vjen, që të mbillet në Berat. Pas kësaj, vetë beratasit duhet të vrasin mendjen se në cilat kooperativa do ta mbjellin këtë bimë. Kështu të veprojmë edhe për orizin e për bimët e tjera. Këto çështje, pra, duhet t'i bëjmë ne këtu lart, duhet t'i bëjë Qeveria.

**SHOKU HYSNI KAPO:** Në shkallë republike ne

nuk i prekim sipërfaqet e bimëve që kemi planifikuar, por, problemi shtrohet që t'i përqendrojmë ato atje ku jadin prodhime më shumë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Tamam kështu, atje duhet t'i përqendrojmë bimët bujqësore, ku mund të rriten më mirë dhe ku jadin më shumë prodhim. Këto gjëra duhet të na i thonë vetë rrethet, kur na dërgojnë planet, për të cilat do të gjykojmë, se edhe ne këtu kemi specialistë. Ne u themi specialistëve që kemi në qendër: «Kjo që mendojnë specialistët e Tropojës ose të Dibrës a është e drejtë?». «Po, është e drejtë, kështu mendojmë edhe ne», mund të pohojnë këta. Atëherë ne, pasi i shoshitim çështjet, vendosim ta bëjmë këtë ose atë gjë që propozohet nga specialistët e bazës dhe të qendrës.

I tillë duhet të jetë mekanizmi i një planifikimi socialist shkencor, plani vjen nga baza dhe pranohet lart, ku interesat e secilit rreth centralizohen e harmonizohen me interesat e përgjithshëm të republikës.

Punët e bujqësisë e të industrisë duhet të koordinohen shumë ngushtë me organizimin e Partisë; pastaj, paralel me këtë, të shikojmë edhe propagandën. Në qoftë se Partia nuk i kupton problemet e organizimit si duhet, do të thotë se nuk po ecim në mënyrë konvergjente, po në të kundërtën, në mënyrë divergjente, ose ecim paralelisht si hekurudha, dy vijat e së cilës nuk bashkohen kurrë me njëra-tjetrën.

*Botohet për herë të parë, sëpas  
tekstit të nxjerrë nga biseda  
e incizuar që gjendet në AQP*

## VETADMINISTRIMI JUGOSLLAV — TEORI DHE PRAKTIKË KAPITALISTE

*Kundër pikëpamjeve antisocialiste të E. Kardelit, të shprehura në librin: «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetadministrimit socialist»*

**Tetor 1978**

Vitin e kaluar në Jugosllavi u vu në qarkullim dhe po i bëhet një publicitet i madh një libri të «teorienit» kryesor të revizionizmit titist, Eduard Kardelit, me titull: «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetadministrimit socialist».

Idetë antimarksiste të këtij libri u vunë në themel të të gjitha punimeve të Kongresit të 11-të të partisë revisioniste jugosllave, së cilës titistët, për t'i maskuar karakterin borgjez, i kanë vënë emrin «Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë».

Sistemin e vetadministrimit titistët dhe kapitalizmi ndërkomboëtar, siç vuri në dukje Kongresi i 7-të i PPSH, e propagandojnë si «një rrugë të gatshme të sprovuar të socializmit» dhe e përdorin si një armë të preferuar në luftën kundër socializmit, revolucionit dhe luftërave çlirimtare.

Duke pasur parasysh këtë rrezikshmëri, e ndiej

të nevojshme të shpreh disa mendime rreth këtij libri.

Në Jugosllavi, siç dihet, është vendosur plotësisht kapitalizmi, veçse ky kapitalizëm maskohet me marifet. Jugosllavia hiqet sikur është një shtet socialist, por i një lloji të veçantë, që nuk e paska parë bota gjer më sot! Titistët, bile, mburren që shteti i tyre nuk ka asgjë të ngjashme me shtetin e parë socialist që doli nga Revolucioni Socialist i Tetorit dhe që e themeluan Lenini e Stalini në bazë të teorisë shkencore të Marksit e të Engelsit.

Renegatët jugosllavë qysh në fillim janë shmanjur nga teoria shkencore e marksizëm-leninizmit mbi shtetin socialist dhe kanë punuar që të mos vendosej diktatura e proletariatit, që Jugosllavia të ecte në rrugën e kapitalizmit.

E kam shprehur edhe herë tjetër se, si përpara, edhe pas çlirimit të Jugosllavisë, grapi renegat titist, që ishte i maskuar, që hiqej si përkrahës i sistemit socialist të vendosur në Bashkimin Sovjetik, që trumbetonte se do të ndërtonte socializmin në bazë të teorisë shkencore të marksizëm-leninizmit, në të vërtetë ka qenë kundër kësaj ideologjic dhe kundër përvjoes revolucionare sovjetike. Ky konkluzion i drejtë del qartë edhe nga përbajtja e librit të Kardelit.

## 1. — Një vështrim i shkurtër historik rrugës së revisionistëve titistë

Lufta Nacionalçirimi tare e Jugosllavisë, e udhëhequr nga Partia Komuniste e Jugosllavisë, kishte në

vetvete, përveç trimërisë dhe guximit të popullit, edhe ndershëmërین e komunistëve të vërtetë jugosllavë. Por gjatë kësaj lufte në udhëheqjen jugosllave duke-shin disa prirje të dyshimta që të bënин të mendoje, sikurse doli qartë më vonë, se në qëndrimin ndaj aleancës antifashiste të Bashkimit Sovjetik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Anglisë, grapi titist anonte nga anglo-amerikanët. Në atë kohë ne shikonim se udhëheqja titiste mbante lidhje shumë të ngushta me aleatët perëndimore, veçanërisht me anglezët, nga të cilët merrte ndihma financiare dhe ushtarake të mira. Gjithashtu na binte në sy një afrim politik i dukshëm në mes Titos e Çercillit dhe emisarëve të tij, në një kohë kur Lufta Nacionalçirimi-tare e Jugosllavisë duhej të lidhej ngushtë me luftën çlirimtare të Bashkimit Sovjetik, sepse shpresat e çlirimtë të gjithanshëm për tërë popujt, për sa i përket faktorit të jashtëm, ishte pikërisht kjo luftë.

Prirjet e udhëheqjes titiste kundër Bashkimit Sovjetik u dukën më qartë në pragun e fitores kundër fashizmit, kur Ushtria e Kuqe, duke ndjekur këmba-këmbës ushtrinë gjermane, u fut në Jugosllavi për të ndihmuar Luftën Nacionalçirimtare. Sidomos në kohën kur u bënë konkluzionet e kësaj lufte të madhe në mes shteteve të mëdha e të vogla ndërluftuese, doli sheshit se Jugosllavia titiste mbështetet nga imperializmi anglez dhe amerikan. Në këtë kohë fërkimet diplomatike e ideologjike midis Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë ranë më tepër në sy. Këto mos-marrëveshje, përveç të tjerave, ishin edhe për çështje territoresh. Jugosllavia rivendikonte toka në veri, si-

domos në kufi me Italinë. Por ajo heshtte për kufijtë në jug, veçanërisht për ato me Shqipërinë, për Kosovën dhe për tokat shqiptare në Maqedoni e në Malin e Zi. Titistët nuk mund të flisnin për këto, sepse do të cenonin platformën nacionaliste shoviniste serbe.

Tashmë dihet mirë se mosmarrëveshjet e udhëheqjes jugosllave me Stalinin kishin rrënje të thella. Pikëpamjet revisioniste të grupit udhëheqës jugosllav kanë qenë të kristalizuara shumë kohë përpara çlirimt, mundet që në ato kohë kur Partia Komuniste e Jugosllavisë bënte pjesë në Komintern dhe ndodhej në ilegalitet të thellë nën regjimin e kralëve serbë. Që atëherë udhëheqja e saj ka pasur pikëpamje deviacioniste, trockiste, të cilat Komintern i ka pasë dënuar kur janë shfaqur. Dënimet e Kominternit më vonë Titoja i «ka shlyer», derisa edhe ish-sekretarin e përgjithshëm të Partisë Komuniste të Jugosllavisë Gorkicin, deviacionistin më të madh, e rehabilitoi.

Pas çlirimt të Jugosllavisë, dilte një problem me rëndësi të madhe: ç'drejtim do të merrte Jugosllavia? Ky drejtim, natyrisht, do të varej shumë nga botëkuptimi marksist-leninist ose revisionist i udhëheqësve të Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Ata hiqeshin sikur ishin marksistë-leninistë. Në fillim kështu besonim edhe ne. Mirëpo në fakt, nga veprimtaria e tyre, jo vetëm në përgjithësi, por edhe nga qëndrimet konkrete ndaj nesh, konstatuam se shumë gjëra të tyre nuk përputheshin me teorinë shkencore të marksizëm-leninizmit. Ne pamë se ata largoheshin, sa të ishte e mundur më shumë, nga eksperiencia e ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik.

Tendenca e grupit udhëheqës jugosllav me Titon, Kardelin, Rankoviçin e Gjilasin në krye, që vihcj re qysh gjatë kohës së ilegalitetit, por sidomos pas çlirimt të Jugosllavisë, ishte që Partia Komuniste e Jugosllavisë të mos dilte haptazi me emrin e saj, por të maskohej, siç u maskua, nën peçkun e të ashtuquajturit Front Popullor i Jugosllavisë. Ky ilegalitet përligjej me pretekstin se «alarmohej e frikësohej borgjezia e madhe dhe borgjezia e vogël e qyteteve dhe e fshatrave», se «largohej ajo nga pushteti i ri i dalë nga revolucioni», se «trembeshin nga komunizmi aleatët anglo-amerikanë». Bëheshin përpjekje për ta bindur borgjezinë se komunistët nuk ishin në fuqi, se partia komuniste vërtet ekzistonte, por ajo ishte, si të thuash, pjesëtare e një fronti të gjerë, ku mund të bënин pjesë edhe njerëzit e Mihailloviçit, edhe njerëzit e Nediçit, edhe njerëzit e Stojadinoviçit e të viçërve të tjerë reakcionarë në Jugosllavi.

Titoja formoi edhe një qeveri të përkohshme me Subashiçin, ish-kryeministrin e qeverisë mbretërore të mërguar në Londër, por nuk e la të qeveriste për shumë kohë, e likuidoi nën presionin e vazdueshëm të popullit. Ai pretendonte atëherë se Subashiçin nuk e dëshironte, por ia kishin imponuar alcatët, kurse më vonë akuzoi Stalinin për këtë çështje. E vërteta është se Titoja e pranoi Subashiçin për hatrin e Çërcillit, se Stalinin ai nuk e donte.

Pikëpamjet e Titos dhe të shokëve të tij që në fillim të linin të kuptoje se ata nuk ishin «marksistë të ashpër», siç i quan borgjezia marksistët konsekuentë, por «marksistë të arsyeshëm», që do të bashkëpunonin

ngushtë me të gjithë politikanët, të vjetër e të rinj, borgjezë e reaksionarë të Jugosllavisë.

Partia Komuniste e Jugosllavisë, megjithëse hiqej sikur ishte në ilegalitet, vepronte legalisht. Por Rankoviçi me Titon nuk i dhanë asaj atë forcë dhe atë rol udhëheqës që duhej të kishte, sepse nuk ishin për ndërtimin socialist të Jugosllavisë. Titoja dhe Rankoviçi i shtrembëruan normat marksiste-leniniste të ndërtimit e të rolit të partisë. Partia Komuniste e Jugosllavisë qysh në fillim nuk qe ndërtuar mbi bazat dhe mësimet e marksizëm-leninizmit. Ajo, që gjoja ishte e shkrirë në «Frontin Popullor të Jugosllavisë», bënte ligjin tok me ushtrinë, me Ministrinë e Brendshme dhe me Sigurimin e Shtetit. Kjo parti, që kishte udhëhequr luftën e popujve jugosllavë, pas luftës u kthye në një detachment të organeve represive shtetërore, që ishin ushtria, Ministria e Brendshme dhe UDB-ja. Bashkë me këto ajo u bë një organ shtypës i masave punonjëse, në vend që të ishte pararojë e klasës punëtore.

Nga propaganda që bëhej dhe nga autoriteti që kishte fituar partia gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe në hapat e parë të ndërtimit të Jugosllavisë pas luftës, klasa punëtore jugosllave kishte përshtypjen sikur kjo parti ishte në pararojë. Në të vërtetë ajo nuk ishte pararoja e klasës punëtore, por e një klase të re borgjeze që kishte filluar të afismohej, që mbështetë fort në prestigjin e Luftës Nacionalçlirimtare të popujve të Jugosllavisë për qëllimet e veta kundërvolucionare, kurse perspektivat e ndërtimit të shoqërisë së re i errësonte. Një parti e tillë e degjeneruar do ta çonte Jugosllavinë titiste në monopate antimarksiste.

Rruja antimarksiste e titistëve jugosllavë, e grupit Tito-Kardel-Rankoviç, ra dhe s'kishte si të mos binte në kundërshtim të hapët me marksizëm-leninizmin, me partitë komuniste, me Bashkimin Sovjetik, me Stalinin dhe me të gjitha vendet e demokracisë populllore që u krijuan pas Luftës së Dytë Botërore. Natyrisht, kjo ndeshje u zhvillua në mënyrë graduale, gjersa erdhi çasti kritik kur shapi u nda nga sheqeri.

Eshtë fakt i pamohueshëm që popujt e Jugosllavisë luftuan. Jugosllavia bëri sakrifisa të mëdha, si-kurse edhe Shqipëria. Udhëheqësit antimarksistë jugosllavë spikuluan nën maskën e kësaj lufte. Ata shfrytëzonin për opinionin e brendshëm dhë të jashtëm edhe vlerësimin që i bënte Jugosllavisë Bashkimi Sovjetik, i cili e konsideronte këtë vend një alcat të rëndësishëm në rrugën marksiste-leniniste të socializmit.

Titistët nuk vonuan të manifestonin, në marrëdhëniet me shtetet e demokracisë populllore të porsakrijuara, tendenca dominuese, ekspansioniste dhe hegemoniste, që u vërtetuan kudo, por veçanërisht në marrëdhëniet me vendin tonë. Ata, siç e dimë, u përpdqën të na impononin pikëpamjet e tyre politike, ideologjike, organizative e shtetërore antimarksiste. Arritën gjer atje sa të bënин orvatje të urryera për ta shndërruar Shqipërinë në një republikë të Jugosllavisë. Në këtë ndërmarrje të pasuksesshme dhe të turpshme, titistët hasën në kundërshtimin tonë të vendosur. Në fillim rezistenca jonë ishte e pakristalizuar, për arsy se nuk kishim dyshuar që udhëheqja jugosllave të ishte futur në rrugën kapitaliste dhe revisioniste. Por me kalimin e disa vjetëve, kur prirjet hegemoniste dhe

ekspansioniste të saj u shfaqën qartë, ne lu kundërvumë asaj në mënyrë të rreptë dhe pa asnjë rezervë.

Titistët u përpinqën të na impononin vullnetin e tyre duke përdorur presione e shantazhe nga më të ndryshmet. Për këtë qëllim organizuan edhe komplotin e Koçi Xoxes. Këtë praktikë imperialiste, ndonëse në një masë më të vogël, ata e zhvilluan edhe ndaj vendeve të tjera, si Bullgaria, Hungaria e Çekoslovakia. Të gjitha këto akte të shëmtuara treguan qartë se Jugosllavia nuk ecte në rrugën e socializmit, por ishte bërë një vegël në shërbim të kapitalizmit botëror.

Çdo ditë që kalonte shihej më mirë se në Jugosllavi nuk po ndërtohej një shoqëri socialiste e tipit leninist, por po zhvillohej kapitalizmi. Ndërkaq, hapat që bëheshin në këtë rrugë kapitaliste maskoheshin me kërkimin gjoja të një forme të re specifike të «socializmit». Pikërisht për këtë qëllim udhëheqja revolucioniste jugosllave me Titon, Kardelin dhe Rankoviçin në krye, duke u përpjekur për të përligjur disi «teorikisht» tradhtinë e saj, mori hua ide nga më të ndryshmet prej arsenalit të revolucionistëve të vjetër dhe forcoi kështu me të gjitha mjetet shtetin e saj të tipit fashist. Ushtria, Ministria e Brendshme, UDB-ja u bënë të plotfuqishme.

Megjithëse po vendoste kapitalizmin, udhëheqja revolucioniste jugosllave mundohej të krijonte në masat e popullit mendimin se në Jugosllavi nuk po tradhtoheshin qëllimet e luftës, se atje ekzistonte një shtet me orientim socialist, në udhëheqje të të cilit ishte një parti komuniste që mbronte marksizmin dhe gjoja pikë-

risht pse vepronte kështu kishte rënë në kundërshtim me Bashkimin Sovjetik, me Stalinin, me partitë komuniste dhe me vendet e demokracisë popullore.

Për të mbrojtur pozitat myftë të lëkundura që shkaktoi demaskimi i tyre në opinionin e brendshëm dhe në lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, titistët, në vijim të politikës së tyre mashtruese, shpallojn se do të ndërmerrnin aksione «serioze» për ndërtimin e socializmit në fshat, për kolektivizimin e bujqësisë sipas parimeve leniniste, prandaj formuan të ashtuquajturat zadruga. Sa serioze ishin qëllimet e renegatëve titistë për ndërtimin e socializmit në fshat, myfton të kujtojmë se zadrugat u shkatërruan pa u krijuar mirë dhe kolektivizimit të fshatit jugosllav nuk i ka mbetur as nami as nishani.

Deri në vitin 1948, kur u shkaktua prishja përfundimtare në mes Bashkimit Sovjetik, vendeve të demokracisë popullore e lëvizjes komuniste ndërkombëtare nga njëra anë, dhe Jugosllavisë, nga ana tjetër, kjo e fundit ndodhej në fazën fillestare të kapitalizmit kaotik, në një gjendje politike, ideologjike, ekonomike të çoroditur, në një situatë jashtëzakonisht të rëndë. Kjo e shtyu grupin e Tito-Kardel-Rankoviçit të vepronte më hapur, të afrohej më ngushtë me kapitalizmin botëror, sidomos me imperializmin amerikan, për të ruajtur pushtetin dhe për të ndryshuar gjendjen në favor të tij.

Pas vitit 1948 Jugosllavia, e zhytur në një krizë të rëndë politike, ideologjike dhe ekonomike, u gjend në rrugëkryq, për arsyen të devijimit antimarksist të udhëheqjes së saj. Renegatët titistë donin të qëndronin,

si të thuash, në dy karrige. Në «karrigen» e mark-sizëm-leninizmit donin të qëndronin vetëm për dukje, vetëm për formë, kurse në «karrigen» tjetër kapitalisto-revisioniste, donin të vendoseshin mirë, por, për të realizuar këtë qëllim, u duhej medoemos njësarë kohe. Periudha që nga viti 1948 e këtej është e turbullt dhe e trazuar fort nga kriza e madhe, nga çoroditja e rrëmuja.

Për grupin renegat Tito-Kardel-Rankoviç shtrohej çështja: si të mund ta mbante pushtetin dhe të shtypte çdo rezistencë të proletariatit e të popujve të Jugosllavisë, që luftuan për socializmin në miqësi e në unitet të plotë me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e demokracisë popullore. Për këtë qëllim revisionistët jugosllavë punuan, në radhë të parë, që të likuidonin çdo gjë, sadopak marksiste-leniniste, që mund të kishte mbetur në partinë e tyre dhe ta shndërronin këtë në një instrument të ideologjisë e të politikës së tyre borgjezo-revisioniste, ta zhvishnin nga çdo funksion drejtues, kurse klasën punëtore ta kthenin në një masë inerte, që të mos kishte mundësi të shikonte tradhtinë e të kundërvepronte si forca politike vendimtare e revolucionit. Normal e centralizmit demokratik në parti u shkelën. Partia u vu në varësi të UDB-së, e cila u përdor nga titiset si një mjet për të shtypur gjithë elementët që nuk ishin për kthesën regresive anti-marksiste. Partia «u spastrua» nga gjithë njerëzit besnikë të socializmit. Pavarësisht se ajo ruajti në aparençë disa norma zgjedhjesh, mbledhjesh, konferencash, në realitet udhëheqja e saj burokratike e përqendroi në duart e veta tërë pushtetin në këtë parti gjøja

marksiste-leniniste, e shndërroi këtë në një zbatuese të thjeshtë të urdhërave të saj e të Sigurimit të Shtetit. Partia Komuniste e Jugosllavisë e ndryshoi kështu kryekëput pamjen e vet dhe humbi çdo tipar të partisë pararojë të klasës punëtore, si forcë politike udhëheqëse e shoqërisë. Kjo ishte një fitore e madhe për kapitalizmin, për borgjezinë e jashtme dhe atë të brendshme.

Për të shpëtuar sundimin e vet, renegatët titistë duhej të likuidonin pa zhurmë pushtetin që doli nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe të ndërtonin një pushtet tjetër, një diktaturë të egër fashiste.

Me fjalë të tjera, grapi udhëheqës Tito-Kardel-Rankoviç ndërmori likuidimin e të gjitha tipareve marksiste-leniniste të revolucionit dhe u vu në kërkim të rrugëve gjoja të reja «socialiste», në të vërtetë kapitaliste, në fushën ekonomikë, në politikën e brendshme dhc të jashtme, në arsim e në kulturë dhe në të gjithë sektorët e jetës. Në këto situata, organet e Sigurimit të Shtetit dhe ushtria jugosllave u bënë armë e preferuar dhe e egër në duart e këtij grushti rengatësh, që ndëshkonte në mënyrë drakoniane cilindo që guxonë të denonconte tradhtinë. Filluan persekutimet dhe vrasjet në masë të të gjithë elementëve të shëndoshë marksistë-leninistë. Kampet e tmerrshme të përqendrimit, një nga të cilët ishte edhe ai i Goli Otokut, u mbushën me të burgosur dhe të internuar.

Gjendja ekonomike në këtë kohë në Jugosllavi paraqitej shumë e rëndë për shkak të shkatërrimit të ekonomisë gjatë luftës, për shkak të politikës së çorditur të udhëheqjes jugosllave, për shkak se, pas prerjes së të gjitha marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik,

Jugosllavia nuk vazhdonte të merrte më ato ndihma të konsiderueshme që mori në vitet e para të pasçlirimt, gjithashtu për shkak se ajo nuk mund të grabiste më pasuritë e vendeve të demokracisë popullore, si të Shqipërisë, nëpërmjet shoqërive «të përbashkëta», të ndërtuara mbi baza jo të drejta, që ishin në dobi vetëm të njërsë palë, Jugosllavisë.

Sigurisht, renegatët jugosllavë nuk mund të dilnin nga kriza vetëm me terror. Si agjenturë e kapitalizmit botëror, e përpunuar me kohë, ajo iu drejtua menjëherë atij për ndihmë dhe ky, sidomos imperializmi amerikan, u tregua plotësisht i gatshëm t'u jepte Titos me shokë gjithë ndihmat e mbëshqetjen e nevojshme për t'u shpëtuar lëkurën dhe për t'i bërë ata një vegël të rëndësishme në luftën kundër socializmit, revolucionit dhe lëvizjeve çlirimitare. Fuqitë imperialiste e prisnin me padurim një kthesë të tillë, sepse ato për këtë ishin përgatitur që gjatë luftës. Prandaj jo vetëm nuk munguan t'u jepnin «ndihma» të mëdha ekonomike, por u dhanë edhe një përkrahje të fuqishme politiko-ideologjike. Ato i furnizuan edhe me armë e me pajisje të ndryshme ushtarake, i lidhën edhe me NATO-n nëpërmjet Paktit Ballkanik.

Në periudhën e parë, veçanërisht në industri dhe në bujqësi, Jugosllavia «u ndihmua» nëpërmjet investimeve të kapitaleve të shoqërive të huaja.

Në fushën e industrisë, ku u tregua veçanërisht «bujar» imperializmi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, puna filloi me «ndihmat» për mëkëmbjen e fabrikave të vjetra ekzistuese, që këto të viheshin pak a shumë në gjendje prodhimi dhe që ky prodhim të ishte

i mjaftueshëm për të mbajtur në këmbë regjimin borgjezo-revisionist që po kristalizohej dhe që e kishte kthyer fyttyrën nga kapitalizmi botëror.

Regjimit titist i duhej të likuidonte edhe atë sistem gjysmak të kolektivizimit të bujqësisë, që ishte ngritur në një numër ekonomish fshatare dhe të kri-jonte një sistem të ri, ku kulakët dhe pronarët e mëdhenj të tokave të ishin përsëri të favorizuar. Për rish-përndarjen e tokave u gjendën forma dhe mënyra të atilla që të rimëkëmbej kulakëria e vjetër pa shkaku-tuar turbullira të mëdha në vend. Shteti mori një varg masash kapitaliste, siç ishin, për shembull, shpërnda-rja e stacioneve të makinave e të traktorëve dhe shitja e tyre fshatarësisë së pasur që kishte mundësi t'i blente, vendosja e taksave të rënda për buqit. Fermat shtetërore u kthyen gjithashitu në ndërmarrje kapitaliste, ku u investuan edhe kapitale të huaja etj.

Nga kapitali i huaj përfituan shumë tregtarët dhe industrialistët e vendit, të cilëve iu bënë koncesione të mëdha.

Këto masa provonin jashtë çdo dyshimi se ky «socializëm» që po ndërtonte Jugosllavia, nuk ishte gjë tjetër veçse rruga e integrimit në kapitalizëm.

Kështu u përgatit terreni i futjes së kapitaleve të huaja në një masë e në një shkallë gjithnjë më të madhe në një ambient politik, ideologjik dhe organi-zativ shumë të përshtatshëm për kapitalizmin botëror, i cili, duke e ndihmuar regjimin titist, do ta përdorte atë si urë kalimi për depërtimin në vendet e tjera të demokracisë popullore.

Ky orientim politik, ideologjik dhe ekonomik i

Jugosllavisë titiste drejt kapitalizmit bëri që lufta e klasave atje të merrte tjetër drejtim e të zhvillohej jo si forcë lëvizëse e shoqërisë socialiste, por si forcë lëvizëse në luftën midis klasash kundërshtare, siç ndodh në çdo shtet kapitalist, ku sundon diktatura e borgjezisë. Luftën e klasave në Jugosllavi shteti borgjezo-revisionist titist e drejtoi kundër elementeve përparimtarë të klasës punëtore, kundër komunistëve që i rezistonin kursit tradhtar.

Centralizmi demokratik nuk vonoi të likuidohet edhe në fushën e administrimit ekonomik e shtetëror. Është e vërtetë se në Jugosllavi qenë bërë edhe shtetëzime të disa fabrikave, tregtia e jashtme ishte shpalillur monopol i shtetit dhe thuhej se gjoja zbatohet parimi i centralizmit demokratik në organizimin dhe në veprimtarinë e shtetit e të partisë. Por këto masa, që dukeshin me karakter revolucionar, nuk ishin as të plota as konsekutive. Centralizmi në Jugosllavi nuk kishte kuptimin e vërtetë leninist që gjithë jeta ekonomike e politike e shoqërisë të zhvillohej duke kombinuar drejtimin e centralizuar me iniciativën krijuar të organeve lokale dhe të masave punonjëse, por synonte krijimin e një force diktoriale të tipit fašist, që të ishte në gjendje t'u impononte nga lart popujve të Jugosllavisë vullnetin e regjimit në fuqi. Këto masa të fillimit, që reklamoheshin si prirje gjoja socialiste, me kalimin e disa vjetëve morën një drejtim të qartë antimarksist, kundërrevolucionar. Gjithë organizimi shtetëror dhe veprimtaria shtetërore në lëmin ekonomik morën tipare kapitaliste, në kundërshtim të hapët me eksperiencën themelore të ndërsa-

timit të socializmit në Bashkimin Sovjetik të Leninit e të Stalinit.

Në vitet e para pas 1948-s në veprimtarinë e shtetit jugosllav mund të themi se zbatohej parimi i centralizmit, për arsyen Federata e Jugosllavisë kishte barrë shumë të rënda dhe të vështira që nuk mund t'i zgjidhete duke qenë e decentralizuar. Momentet ishin të atilla që kërkonin të ruhej centralizmi, sepse në gjirin e Federatës ekzistonin republikat, që, duke pasur secila prej tyre korente politike nacionaliste të ndryshme, kërkonin të shkëputeshin prej saj. Por ky lloj centralizmi ka qenë centralizëm burokratik; planet ekonomike vndoseshen nga lart pa u diskutuar në bazë, nuk ishin të studiuara dhe nuk synonin një zhvillim harmonik të degëve të ndryshme të ekonomisë së republikave dhe krahinave të Federatës, urdhrat ishin arbitrarë dhe ekzekutoheshin verbërisht, prodhimet grumbulloheshin me forcë. Nga ky kaos, ku iniciativa e organeve lokale të partisë e të shtetit, si dhe iniciativa e masave punonjëse nuk dukeshin gjökundi, sigurisht që do të lindnin, sikundër lindën, mosmarrëveshje, të cilat u shtypën me terror e me gjak.

Një gjendje të tillë e stimulonin edhe shtetet kapitaliste, të cilat e kishin marrë nën sqetull regjimin titist që ta orientonin Jugosllavinë në drejtimin kapitalist. Duke përfituar nga kjo gjendje, imperialistët e ndryshëm rivalizonin kush e kush të mund të fuste duart më shumë në këtë shtet të bastarduar, në mënyrë që, tok me kreditë që jepnin, të impononin edhe pikëpamjet e tyre politike, ideologjike dhe organizative.

Kapitalistët e huaj, që e përkrahën grupin renegat

titist, e kishin të qartë se ky grup do t'u shërbente atyre, por e ndienin se ishte e nevojshme që, pasi të kapërcehej situata e turbullt kaotike, të krijohej në Jugosllavi një situatë më e qëndrueshme. Përndryshe ata nuk do të ishin të sigurt për investimet e tyre të mëdha që bënин dhe që do t'i shtonin më vonë.

Që të krijohej situata e dëshiruar në dobi të kapitalizmit, duhej të realizohej decentralizimi i drejtimit në ekonomi dhe të njiheshin e të mbroheshin me ligj të drejtat e kapitalistëve që investonin shuma të mëdha në ekonominë e këtij shteti.

Udhëheqja titiste e kishte të qartë se kapitalizmi botëror dëshironë që Jugosllavia, si një vegël në duart e tij, të ishte sa më e përshtatshmë për të mashtruar të tjerët. Rrjedhimisht ai nuk mund të pranonte një regjim të hapët fashist e gjakatar, siç e kishin vendo-sur antimarksistët Tito-Kardel-Rankoviç. Për këtë arsy, grupei Tito-Kardel, më 1967, mori masa dhe e likuidoi grupin e Rankoviçit, të cilin e bëri përgjegjës për të gjitha të zezat e sundimit titist deri në atë periudhë.

Me likuidimin e Rankoviçit, Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë nuk doli nga kriza e rëndë ku kishte hyrë. Ajo vazhdoi të trajtohej gjithnjë sipas pikëpamjeve të vjetra titiste, thelbi i të cilave ishte që Lidhja të ruante vetëm maskën «komuniste», por të mos luante një rol udhëheqës në veprimtarinë shtetërore, në ushtri, në ekonomi. Partisë titistët edhe emrin ia kishin ndryshuar, duke e quajtur Lidhja e Komunistëve, për t'i dhënë gjoja një emër autentik «marksist» të nxjerrë nga fjalori i Karl Marksit. Kësaj të ashtu-

quajture «Lidhje të Komunistëve» zyrtarisht i njohën vetëm të drejtën e edukimit. Por edhe ky rol edukues ishte i paqenë, për arsyen se shoqëria jugosllave, që nanurisej me propagandën e një politike dhe të një ideologjie gjoja marksiste-leniniste në djepin e së ashtuquajturës «Lidhje Socialiste e Jugosllavisë», u çordit në rrugën kapitaliste.

Megjithëse doli nga ilegaliteti, si rezultat i decentralizimit kapitalist, partia revizioniste jugosllave u shkri në atë farë pluralizmi ideologjik, që më vonë do të quhej sistem «demokratik». Qëllimi kryesor ishte që, pasi partia të shndërrohej në një parti borgjeze, të kristalizoheshin plotësisht tiparet kapitaliste të zhvillimit ekonomik të vendit.

Kështu u krijua në Jugosllavi trualli i përshtatshëm për lulëzimin e teorive anarkosindikaliste, kundër të cilave kishin luftuar Marks, Engels, Lenin dhe Stalini. Në këto kushte u sajua teoria pseudomarksiste-leniniste mbi sistemin politik të «vetadministrimit socialist», të cilën e ka trajtuar Kardeli në librin e tij.

U zgjata pak në anën historike të zhvillimit të Jugosllavisë në rrugën revizioniste, jo sepse këto probleme janë të panjohura për ne, por për të sqaruar më mirë falsitetin e mendimit «teorik» të Kardelit, i cili, duke qenë bashkëpunëtor i Titos në tradhtinë e madhe ndaj revolucionit e socializmit, nuk mund të mbajë tjetër pozitë veçse atë që t'i thotë të bardhës e zezë dhe kapitalizmin ta quajë socializëm. Tani, duke parë zhvillimin e palavdishëm ku e kanë futur vendin e tyre, këta renegatë përpiken të justifikojnë «teorikisht» situatën

kaotike që e krijuan vetë. Kështu shpjegohen edhe mendimet e errëta të Kardelit. Kaotik është realiteti jugosllav, konfuzë janë edhe «teorizimet» për të. Ndryshtë s'mund të jetë.

## 2. — Sistemi i vëtadministrimit në ekonomi

Teoria dhe praktika e vëtadministrimit jugosllav është një mohim i hapët i mësimave të marksizëm-leninizmit dhe i ligjeve të përgjithshme mbi ndërtimin e socializmit.

Thelbin e «socializmit vëtadministruar» në ekonomi e përbën ideja se gjoja socializmi nuk mund të ndërtohet duke i përqendruar mjetet e prodhimit në duart e shtetit socialist, duke krijuar pronën shtetërore si formën më të lartë të pronës socialiste, por duke e copëtuar pronën shtetërore socialiste në pronë të grupave të veçanta të punëtorëve, të cilët gjoja e vëtadministrojnë atë drejtpërdrejt. Marks i Engelsi, qysh në vitin 1843, thiksonin se

*«Proletariati e përdor sundimin e vët politik për të shkëputur nga duart e borgjezisë pak nga pak gjithë kapitalin, për të centralizuuar të gjitha veglat e prodhimit në duart e shtetit, domethënë të proletariatit të organizuar si klasë sunduese...»<sup>1</sup>.*

1. K. Marks e F. Engels, Vepra të Zgjedhura, vëll. I, f. 42. Tiranë, 1975.

Të njëjtën gjë ka theksuar edhe Lenini kur luftoi ash-për pikëpamjet anarkosindikaliste të grupit antiparti të «opozitës punëtore», që kërkonte dhiënien e fabrikave punëtorëve dhe drejtimin e organizimin e prodhimit jo nga shteti socialist, por nga një i ashtuquajtur «Kongres i prodhuesve», si përfaqësues i grupeve të punonjësve të veçantë. Këto pikëpamje Lenini i cilësonte

*«...në kundërshtim të plotë me marksizmin  
dhe komunizmin...»<sup>1</sup>.*

Ai vinte në dukje se

*«një shtrembërim shumë i madh i parimeve themelore të pushtetit sovjetik dhe heqje dorë plotësisht nga socializmi është çdo përligjje, e drejtpërdrejtë ose e tërthortë, e pronës së punëtorëve të një fabrike të veçantë ose të një profesioni të veçantë mbi prodhimin e tyre të veçantë, ose çdo përligjje e së drejtës së tyre për të dobësuar ose penguar urdhrat e pushtetit të përgjithshëm shtetëror»<sup>2</sup>.*

Qysh në qershor të vitit 1950, kur Titoja i paraqiti Asamblesë Populllore të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë «ligjin mbi vetadministrimin», duke zhvilluar pikëpamjet e tij revizioniste mbi pronën në «socializëm», midis të tjcrave ai tha: «Tani e tutje pro-

1. V. I. Lenin, Veprat, vell. 32, f. 283.

2. V. I. Lenin, «Mbi demokratizmin dhe karakterin socialist të pushtetit sovjetik».

na shtetërore e mjeteve të prodhimit, fabrikat, minierat, hekurudhat, kalojnë gradualisht në formën më të lartë të pronësisë socialiste; pronësia shtetërore është forma më e ulët e pronës shoqërore e jo më e larta...» midis «akteve më karakteristike të një vendi socialist», «është dhënia e fabrikave dhe e sipërmarrjeve të tjera ekonomike prej duarve të shtetit në duart e punëtorëve për t'i udhëhequr...», se kështu do të realizohet «parulla e aksionit të lëvizjes punëtore — Fabrikat punëtorëve»<sup>1</sup>.

Këto thënie të Titos ngjajnë si dy pikë uji me pikëpamjet reaksionare të «opozitës punëtore» anarko-sindikaliste, që demaskoi qysh në kohën e vet Lenini, por edhe me ato të Prudonit, i cili në punimin e vet «Teoria e pronës» pohonte se «produkti spontan i një njësie kolektive... mund të konsiderohet si triumfi i lirisë... dhe si forma më e madhe revolucionare që ekziston dhe që mund t'i kundërvihet pushtetit». Ose, ja ç'thoshte njëri prej krerëve të Internacionales së Dytë, Otto Baueri, në librin «Ruga drejt socializmit»: «Kush, pra, në të ardhmen do të drejtojë industrinë e shoqërizuar? Qeveria? Jo! Në qoftë se qeveria do të drejtonte të gjitha degët e industrisë pa përjashtim, ajo do të bëhej tepër e fuqishme kundrejt popullit dhe kundrejt përfaqësisë kombëtare. Një rritje e tillë e pushtetit qeveritar do të ishte e rrezikshme për demokracinë»<sup>2</sup>.

---

1. Fabrikat punëtorëve. Prishtinë 1951, f. 37, 19, 1.

2. Otto Bauer, «Ruga drejt socializmit», f. 18, Paris, viti 1919.

Në unitet me pikëpamjet e Titos, në librin e tij E. Kardeli thekson gjithashtu se «Shoqëria jonë është detyruar të veprojë kështu posa çshëtë përcaktuar për vetëqeverisje dhe për shoqërizimin vetëqeverisës të pronës shoqërore, përkundër përjetësimit të formës shtetopronare të marrëdhënieve socialiste prodhuese» (faqe 66)<sup>1</sup>. Kjo do të thotë se në Jugosllavi është vendosur sistemi i pronës private dhe nuk ekziston prona shtetërore socialiste, prona e gjithë popullit.

Krejt ndryshe ndodh në vendin tonë, ku kjo pronë e përbashkët socialiste drejtohet nga shteti i diktaturës së proletariatit me pjesëmarrjen e klasës punëtore dhe të masave punonjëse në forma të drejta, të centralizuara, të planifikuara nga poshtë e të orientuara nga lart.

Rruja e decentralizimit të mjeteve të prodhimit, sipas ideve anarkosindikaliste të vetadministrimit punëtor, në thelb, nuk është gjë tjetër veçse një mënyrë e rafinuar për të ruajtur dhe për të konsoliduar pronën private kapitaliste mbi mjetet e prodhimit, por në një formë të maskuar si «pronë e administruar nga grupet e punëtorëve». Në fakt të gjithë termat e ngatërruar e të errët që ka shpikur «teoricieni» Kardel në librin e tij, si «organizata themelore e punës së bashkuar», «organizata e përbërë e punës së bashkuar», «këshillat e punëtorëve të organizatës themelore ose të përbërë të punës së bashkuar», «bashkësitë ve-

1. Të gjitha citimet nga libri i E. Kardelit janë bërë sipas përkthimit në gjuhën shqipe prej redaksisë së botimeve të Prishtinës, më 1977. (Shënim i shtëpisë botuese «8 Nëntori» Tiranë.)

tëqeverisëse të interesit» etj., etj. dhe që janë ligjësuar edhe në legjislacionin e shtetit kapitalist jugosllav, nuk janë gjë tjeter veçse një fasadë e lustruar, prapa së cilës fshihet zhveshja e klasës punëtore nga e drejtë e pronësisë mbi mjitet e prodhimit, shfrytëzimi i egër i saj nga borgjezia.

Kjo pronë private ekziston në Jugosllavi jo vetëm në formë të maskuar, por edhe në formën e saj të zakonshme, në qytet dhe në fshat. Këtë e pranon edhe E. Kardeli në librin e vet kur thotë se «Rëndësi të vëçantë në shoqërinë tonë kanë edhe të drejtat e atilla sikurse janë... e drejta e pronës personale, respektivisht, në suaza të caktuara edhe e pronës private...» (faqe 177). Më kot Kardeli përpinqet ta zbutë efektin negativ që mund të bëjë pranimi i hapët i së drejtës së pronës private, qoftë kjo edhe në formën e prodhimit të vogël, i cili, siç thoshte Lenini, pjell çdo ditë e çdo orë kapitalizmin. Revisionistët jugosllavë kanë nxjerrë edhe ligje të posaçme për inkurajimin e ekonomisë private, ligje që u njohin të drejtën qytetarëve «të themelojnë ndërmarrje» dhe «të angazhojnë krahi pune». Në Kushtetutën jugosllave thuhet shprehimi: «privatët kanë të njëjtën pozitë ekonomiko-shoqërore, të njëjtat të drejta e detyrime si edhe punonjësit në organizatat ekonomiko-shoqërore».

Prona e vogël private sundon plotësisht në bujqësinë jugosllave dhe zë afér 90 për qind të sipërsaqes së tokës së punueshme. 9 milionë ha tokë i përkasin sektorit privat, ndërsa mbi 10 për qind ose 1,15 milionë ha — sektorit kapitalist monopolist të ashtuquajtur shoqëror. Mbi 5 milionë fshatarë në Jugosllavi janë

të angazhuar me pronën private të tokës. Fshati jugosllav as nuk është futur ndonjëherë në rrugën e transformimit të vërtetë socialist. Lidhur me këtë gjendje Kardeli nuk thotë asnjë fjalë në librin e vet dhe i shmanget trajtimit të problemit se si shtrihet sistemi i tij «vetadministrues» në bujqësi. Mirëpo në qoftë se ai pretendon se ndërton socializmin me anën e këtij sistemi, atëherë si është e mundur të harrojë «ta ndërtojë socializmin» edhe në bujqësi, që përfaqëson afro gjysmën e ekonomisë? Teoria marksiste-leniniste na mëson se socializmi ndërlohet si në qytet dhe në fshat jo mbi bazën e pronës kapitaliste shtetërore, të pronës gjoja të administruar nga grupet e punëtorëve apo të pronës private në formë të hapët, por vetëm mbi bazën e pronës shoqërore socialiste mbi njejet e prodhimit.

Në Jugosllavi lejohet prona private nga 10 deri në 25 hektarë tokë<sup>1</sup>. Por ligji jugosllav, që lejon shitblerjen e tokës, qiradhënien dhe hipotekimin e saj, shitblerjen e makinave bujqësore dhe punën e pajtuar në bujqësi, i ka krijuar mundësi klasës së re borgjeze të fshatit, kulakërisë, të shtojë në kurriz të fshatarëve të varfér sipërsaqet e tokave, njejet e punës, traktorët dhe kamionët dhe, si rrjedhim, të rritë e të intensifikojë shfrytëzimin kapitalist.

Aq thellë janë shtrirë marrëdhëni kapitaliste në prodhim në ekonominë jugosllave, saqë u është hapur fushë e lirë veprimi edhe kapitalistëve e firmave të

---

1. V. Vasiq. «Politika ekonomike e Jugosllavisë», bolim I Universitetit të Prishtinës, viti 1970.

huaja, që këto të investojnë e të shfrytëzojnë së bashku me borgjezinë vendase klasën punëtore dhe masat e tjera punonjëse jugosllave. Me të drejtë sistemi i vetadministrimit jugosllav mund të quhet një pushtet i kooperimit të kapitalizmit jugosllav me kapitalizmin amerikan dhe me kapitalistë të tjerë. Këta janë ortakë në pasuritë e Jugosllavisë në çdo gjë, në fabrika, në komunikacion, në hotele, në shtëpitë e bankimit, deri edhe në shpirtin e njerëzve.

Në qoftë se ekonomia jugosllave ka bërë disa hapa në zhvillimin e vet, kjo nuk i dedikohet aspak sistemit të vetadministrimit, siç përpinqen të reklamojnë revizionistët titistë. Në Jugosllavi janë derdhur në formën e investimeve, të kredive e të «ndihmave» kapitale të mëdha të botës kapitaliste, që përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të bazës materiale të sistemit kapitalisto-revisionist jugosllav. Vetëm borxhet arrijnë mbi 11 miliardë dollarë. Nga Shteti e Bashkuara të Amerikës Jugosllavia ka marrë mbi 7 miliardë dollarë kredi.

Borgjezia ndërkomëtare jo pa qëllimi e ka mbështetur me një bazë të tillë materiale e financiare sistemin «vetadministruar socialist» jugosllav. Patericat e kapitalit perëndimor i kanë shërbyer këtij sistemi që të mbahet në këmbë si model i ruajtjes së rendit kapitalist me etiketat pseudosocialiste.

Kapitalistët e huaj, me investimet e tyre, kanë ndërtuar në Jugosllavi objekte të shumta industriale, që nxjerrin prodhime nga më të mirat deri te më të këqijat. Prodhimet e mira, natyrisht, shiten jashtë shtetit, kurse brenda më pak. Megjithëse jashtë ek-

ziston një superprodhim i madh kapitalist dhe të gjitha tregjet janë të akaparuara nga ata kapitalistë që kanë investuar në Jugosllavi, këta përsëri i shesin mallrat e mira në tregjet e tyre me fitime kolosale, për arsyet se krahu i punës në Jugosllavi është i lirë, prodhimet dalin me kosto më të ulët në krahasim me vendet kapitaliste ku sindikatat, pak a shumë, luajnë njëfarë roli kërkues ndaj kapitalit për punëtorët. Mallin më të mirë që prodhojnë fabrikat në Jugosllavi e marrin shoqëritë shumëkombësore, të cilat veprojnë edhe në Jugosllavi. Por, përveç fitimit që nxjerrin në këtë rru-gë, kapitalistët e huaj investitorë zhvatin gjithash tu edhe fitime të tjera nga përqindjet e interesit të kapitaleve që kanë investuar në Jugosllavi. Këto fitime ata shpesh i marrin edhe si lëndë të para natyrore ose të përpunuara.

Demagogu Kardel në librin e tij flet shumë për sistemin vetadministrues, por mban heshtje të plotë për praninë dhe rolin shumë të madh të kapitalit të huaj për mbajtjen në këmbë të sistemit vetadminis-trues.

Në vendet borgjeze, thotë Kardeli, pushteti i vërtetë gjendet dhe «... manifestohet para së gjithash në lidhshmërinë e pushtetit ekzekutiv shtetëror me kartellet politike jashtë parlamentit...»

Krahas me shtimin e fuqisë së pushtetit të brendshëm jashtëparlamentar — vazhdon Kardeli — karakteristikë e marrëdhënieve bashkëkohore shoqërore në vendet kapitaliste me një shkallë të lartë të zhvillimit është edhe një fenomen i ri — krijimi i pushtetit jashtëparlamentar ndërkontinentar, respektivisht botëror-

(faqe 54). Me këtë gjë Kardeli do të vërtetojë se vet-administrimi jugosllav gjoja paska shpëtar nga një situatë e tillë. Kurse në fakt, siç e shpjeguam më lart, realiteti qëndron ndryshe: vet-administrimi jugosllav është një bashkadministrim kapitalist, jugosllav e i huaj. Kapitalistët e huaj, domethënë shoqëritë, koncernet dhe ata që kanë investuar në Jugosllavi vendosin po aq sa vendos edhe pushteti jugosllav mbi politikën dhe mbi zhvillimin e gjithanshëm të Jugosllavisë.

Në fakt, të ashtuquajturat ndërmarrje vet-administruese, të vogla ose të mëdha, janë të detyruara të mbajnë parasysh investitorin e huaj. Ky investitor ka me vete ligjet e tij, të cilat ia ka imponuar shtetit jugosllav, ka përfaqësuesit e tij direkt në këto ndërmarrje të përbashkëta, ka përfaqësuesit e vet ose influencën e tij në Federatë. Në fakt, Federatës, ndërmarrjes ose shoqërisë së përbashkët investitori u imponon vullnetin e tij, direkt ose indirekt. Pikërisht këtë kërkon ta fshehë vet-administrimi. Këtë kamuflash, këtë *tour de passe-passe*, siç thotë franczi, do të bëjë Kardeli, «për të vërtetuar» absurditetin që vet-administrimi jugosllav është një socializëm i vërtetë.

Por atë që ai përpinqet ta mohojë në libër, e pohon me fakte të shumta dhe të përditshme shtypi perëndimor, bile edhe agjencia jugosllave e lajmeve, TANJUG, e cila, më 16 gusht të këtij viti, njoftoi për një rregullore të re të Veçes Ekzekutive Federative që ka të bëjë me investimet e huaja në Jugosllavi. Në këtë rregullore zgjrohen akoma më shumë të drejtat e investuesve të huaj kapitalistë në Jugosllavi. «Sipas këtij

ligji, thekson kjo agjenci, partnerët e huaj, në bazë të marrëveshjes me organizatat e punës së shoqërizuar të vendit, mund të investojnë valutën, pajisjet, materialt gjysmë të gatshme e teknologjinë. Investuesit e huaj kanë të njëjtat të drejta si dhe organizatat e punës së shoqërizuar të vendit që i investojnë mjetet e tyre në ndonjë organizatë tjetër të punës së bashkuar».

Më poshtë TANJUG-u thekson se «parashikohet që me këtë rregullore interesimi (i të huajve) do të jetë më i madh, sepse ajo garanton sigurimin e veprimtarisë së përbashkët ekonomike me afat të gjatë. Përveç kësaj, tani praktikisht nuk ka fusha në të cilat të huajt nuk mund t'i investojnë mjetet e tyre, me përjashtim të sigurimeve shoqërore, të tregtisë së brendshme dhe të veprimtarisë shoqërore».

Më shumë se kaq nuk mund t'i shitet vendi kapitalit të huaj. Dhe pas këtij realiteti puro kapitalist, «komunisti» Kardel ka paturpësinë të pohojë se «... shoqëria jonë ka marrë një përmbytje dhe strukturë shoqëroro-ekonomike të vet shumë më të fortë, që ngrihet nga marrëdhëni et socialiste dhe vetëqeverisëse prodhuese...» të cilat «... bëjnë të mundshme dhe si-gurojnë që shoqëria jonë të zhvillohet gjithnjë më shumë në mënyrë të lirë, të pavarur dhe vetëqeverisëse...»! (faqe 7-8).

Në librin e Kardelit në plan të parë konsiderohet individi si elementi kryesor i shoqërisë, elementi që prodhon, elementi që ka të drejtë të organizojë dhe të ndajë prodhimin. Sipas tij, ky element, në sistemin e vetadministrimit, shoqërizon punën në ndërmarrje

dhe ushtron udhëheqjen e vet nëpërmjet të ashtuquajturve këshilla të punëtorëve, të cilët «zgjidhen» nga punëtorët dhe këta, gjoja, tok me funksionarët administrues të caktuar, rregullojnë të gjithë fatin e ndërmarrjes, të punës, të të ardhurave etj.

Kjo është forma tipike e ndërmarrjeve kapitaliste, ku në fakt sundon kapitalisti, i cili është i rrethuar nga një numër i madh funksionarësh e teknikësh që njojin gjendjen e prodhimit dhe organizojnë shpërndarjen e tij. Natyrisht, fitimet kryesore i merr kapitalisti, që e ka të tijën ndërmarrjen kapitaliste, domethënë ai përvetëson mbivlerën. Në vjetadministrimin jugosllav një pjesë e madhe e mbivlerës përvetësohet nga funksionarët, nga drejtoret e ndërmarrjeve dhe nga personeli inxhiniero-teknik, ndërsa «pjesën e luanit» e merr Federata ose republika për të përballuar rrogat e majme të të gjithë atyre funksionarëve të aparatit qendror, qoftë të Federatës, ose të republikës. Duhen fonde për të mbajtur në këmbë diktaturën titiste — ushtrinë, Ministrinë e Brendshme e Sigurimin e Shtetit, Ministrinë e Jashtme etj. që janë në duart e Federatës dhe që fryhen e zgjerohen vazhdimisht. Në këtë shtet federativ është zhvilluar një burokraci e madhe nëpunësish dhe udhëheqësish inproduktivë, të cilët paguhën me rroga shumë të larta, gjë që del nga djersa dhe gjaku i punëtorëve e i fshatarëve. Përveç këtyre, një pjesë e madhe e të ardhurave akaparohet për kapitalistin e huaj që ka investuar në këto ndërmarrje, i cili ka përfaqësuesin e vet në «këshillin administrativ» ose në «këshillin e punëtorëve», domethënë merr pjesë në udhëheqjen e ndërmarrjes. Kështu, në këtë sistem,

të quajtur «socializëm vetadministrues», punëtorët gjenden vazhdimesht në një shfrytëzim total.

Ingranazhi i «këshillave punëtorë» dhe i «komiteve të vetadministrimit» me komisionet e tyre është sajuar nga revolucionistët e Beogradit vetëm për t'u krijuar iluzionin punëtorëve se «duke u zgjedhur», duke marrë pjesë dhe duke diskutuar në këta organizma janë ata, gjoja, që vendosin për punët e ndërmarrjes, mbi pronën «e tyre». Sipas Kardelit, «... punëtorët në organizatën themelore të punës së bashkuar... qeverisin punën dhe veprimtarinë e organizatës së punës së bashkuar dhe mjetet e riprodhimit shoqëror..., vendosin mbi të gjitha format e bashkimit dhe të ndërlidhjes së punës së vet e të mjeteve, si dhe mbi të gjitha të ardhurat që i fitojnë me punën e përbashkët, ...ndajnë në pajtim me bazat dhe kriteret e caktuara në baza vëtëqeverisëse, të ardhurat për konsumin personal, të përbashkët dhe të përgjithshëm...» (faqe 160) etj., etj.

Të gjitha këto janë profka, sepse në kushtet kur në Jugosllavi sundon demokracia borgjeze, atje nuk ka liri të vërtetë mendimi e veprimi për punonjësit. Liria e veprimit në ndërmarrjet «vetadministruese» është false. Punëtori në Jugosllavi nuk drejton dhe nuk gëzon ato të drejta që i shpall me aq pompë «ideologu» Kardel. Vetë Titoja, në fjalën që mbajti kohët e fundit në aktivin drejtues të Sllovenisë, për të treguar se gjoja është realist dhe kundërshtar i padrejtësive të regjimit të tij, tha se vetadministrimi nuk pengon të rriten edhe të ardhurat e atyre që punojnë keq në kurriz të atyre që punojnë mirë, kurse drejtuesit e fabrikave, që janë fajtorë për humbjet, mund t'i bëjnë bisht për-

gjegjësisë duke zënë vende me përgjegjësi në fabrikat e tjera, pa pasur frikë se mund të qortohen nga dikush për këto faje që kryejnë.

Megjithëse në «teori» E. Kardeli i zhduku burokracinë dhe teknokracinë, zhduku rolin e një klase dominuese teknokratike, në realitet, në praktikë, ajo klasë u krijua me shpejtësi dhe gjeti fushë të gjerë të projë në këtë sistem gjoja demokratik, ku roli i njeriut punonjës na qenka «vendimtar». Në fakt, vendimtar është roli i asaj shtrese funksionarësh dhe borgjezësh të rinj që sundojnë në ndërmarrjen vetadministruese. Janë ata që bëjnë planin, që caktojnë investimet, të ardhurat e gjithsecilit, të punëtorit dhe të vetes; natyrisht, kërraba tërheq nga vetja e tyre. Janë krijuar të tillë ligje e rregullore që fitimet të jenë më të mëdha për udhëheqjen dhe të pakta pér punëtorët.

Në Jugosllavi, kjo shtresë e ngushtë njerëzish, të majmur nga djersa e mundi i punëtorëve, që merr vendimet në interesin e saj, u kthye në klasë kapitaliste. Kështu u krijua monopoli politik i marrjes së vendimeve dhe i ndarjes së të ardhurave nga elita në ndërmarrjet e vetadministrit socialist, kurse Kardeli i bie gjithnjë një avazi, sikur ky sistem politik, i shpikur nga titistët, jep kontribut në krijimin e kushteve pér realizimin real të të drejtave «vetëqeverisëse» dhe «demokratike» të punonjësve, të cilat ua njeh sistemi parimisht.

Formimin e klasës së re kapitaliste e ka inkurajuar pikërisht sistemi i vetadministrit. Këtë fakt të hidhur e ka pohuar edhe Titoja nëpërmjet një «kritike të ashpër» që gjoja u ka bërë shfrytëzuesve të punëto-

rëve, të gjithë atyre që drejtojnë dhe përsitojnë nga ky sistem «vetadministrues socialist». Në fjalime të shumta, sidon që është munduar të fshehë të zezat e sistemit të tij pseudosocialist, ai ka qenë i detyruar të pohojë krizën e madhe të këtij sistemi dhe polarizimin e shoqërisë jugosllave në të pasur e në të varfër. «Unë nuk e quaj pasurim atë që njeriu e fiton edhe në qoftë se nga fitimet e tij ka ndërtuar vilë pushimi, thotë ai. Por kur bëhet fjalë mbi qindra milionë e bile për miliardë, atëherë kjo është vjedhje... Këto nuk janë të ardhura të siguruara me djersë... Kjo pasuri po krijohet me spekulime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit... Tani, duhet të shikojmë ç'është bërë me ata që ndërtojnë shtëpi, një e kanë në Zagreb, të dytën në Beograd, të tretën diku në bregdet ose në ndonjë vend tjeter. Një i tillë nuk ka shtëpi të thjeshtë pushimi por vila të cilat i jep shumë mirë me qira. Përveç kësaj kanë jo nga një, por dy dhe tre vetura në familje...». Në një rast tjeter, për të treguar se gjoja është kundër krijimit të shtresave të pasura e të varfra në shoqëri, ai ka përmendur gjithashtu se vetëm në bankat jugosllave disa persona të pasur privatë kanë depozituar rreth 4,5 miliardë dollarë, pa llogaritur këtu sa kanë depozituar në bankat e huaja e sa mbajnë nëpër xhepa.

Duke shkruar për sistemin e fabrikuar nga revisionistët titistë, Kardeli është i detyruar të përmendë shkarazi nevojën e luftës «kundër formave të ndrysh-

---

1. Intervistë e Titos dhënë redaktorës së «Vjestnikut», tetor 1972.

me të deformimeve dhe tentativave të usurpimit të të drejtave vetëqeverisëse të punonjësve dhe të qytatërëve» (faqe 174). Rrugëdaljen nga këto «keqpërdorime» ai përsëri e kërkon brenda sistemit vetadministruesh, duke zgjeruar «mekanizmin përkatës të kontrollit shoqëror demokratik» (faqe 178).

Këtu lind pyetja: për cilën klasë e ka fjalën Kardeli, kur flet për «uzurpim të të drejtave vetëqeverisëse të punonjësve»? Ai, sigurisht, nuk e thotë, por fjalë është për klasën e vjetër e të re borgjeze, që i ka usurpuar pushtetin klasës punëtore, i ka hipur në zverk dhe e shfrytëzon deri në palcë.

Më kot përpinqet Kardeli t'i paraqesë «këshillat e punëtorëve», «organizatat themelore të punës së bashkuar» etj., etj. si shprehja më autentike e «demokracisë» dhe e «lirisë» së njeriut në të gjitha fushat shoqërore. «Këshillat punëtorë» s'janë gjë tjeter veçse organe krejt formale, mbrojtëse dhe zbatuese jo të interesave të punëtorëve, por të vullnetit të drejtuesve të ndërmarrjeve, sepse, duke u korruptuar materialisht, politikisht e ideologjikisht, ato janë bërë pjesëtare të «aristokracisë» e të «burokracisë punëtore», agjentura për të gënjiyer e për t'i krijuar iluzione të rreme klasës punëtore.

Realiteti jugosllav flet qartë për mungesën e demokracisë së vërtetë për masat. Dhe nuk mund të ndodhë ndryshe. Lenini theksonte se

*««Demokracia e prodhimit» është një term që jep rast për interpretime të shtrembra. Ai mund të kuptohet si mohim i diktaturës dhe i*

*drejtimit unik. Ai mund të kuptohet si një shtyrje e demokracisë së zakonshme ose si një largim prej saj»<sup>1</sup>.*

Nuk mund të kelë demokraci socialiste për klasën punëtore pa shtetin e saj të diktaturës së proletariatit. Marksizëm-leninizmi na mëson se mohimi i shtetit të diktaturës së proletariatit është mohim i vetë demokracisë për masat punonjëse.

Mohimi nga ana e revisionistëve jugosllavë i shtetit të diktaturës së proletariatit dhe i pronës shoqërore socialiste mbi të cilën ai mbështetet, i ka çuar ata në një drejtim të decentralizuar dhe pa plan unik shtetëror të ekonomisë. Zhvillimi mbi bazën e planit unik shtetëror të ekonomisë kombëtare dhe drejtimi i saj nga shteti socialist mbi bazën e parimit të centralizmit demokratik është një nga ligjet e përgjithshme dhe parimet themelore të ndërtimit të socializmit në çdo vend. Ndryshe ndodh si në Jugosllavi ku ndërtohet kapitalizmi.

Kardeli pretendon se punëtorët në organizatat e tyre vetadministruese kanë të drejta që «...të qeverisin punën dhe veprimtarinë e organizatës së punës së bashkuar...» (faqe 160), domethënë të ndërmarrjeve, pra ata mund edhe të planifikojnë gjoja prodhimin. Por si qëndron e vërteta? Punëtori në këto organizata as nuk drejton, as nuk e ndërton edhe atë të ashtuquajtur plan në bazë. Këto i bën borgjezia e re, udhëheqja e ndërmarrjes, kurse punëtorëve u jepet përshtypja

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vell. 32, f. 80.

se «këshillat punëtorë» gjoja bëjnë ligjin në këtë organizim «vetadministruës». Kjo ndodh edhe në vendet kapitaliste, ku fuqinë në ndërmarrjen private e ka kapitalisti, i cili ka teknokracinë e vet, teknokratët që drejtojnë, dhe në disa vende ka gjithashtu edhe përfaqësues të punëtorëve, të cilët kanë një funksion të papërfillshëm, aq sa t'u krijohet iluzioni punëtorëve se gjoja bëjnë pjesë edhe ata në drejtimin e punëve të ndërmarrjes. Por kjo është një gënjeshtë.

I ashtuquajturi planifikim që kryhet në ndërmarrjet vetadministruese jugosllave jo vetëm nuk mund të quhet socialist, por, duke u kryer sipas shembullit të të gjitha ndërmarrjeve kapitaliste, ai çon në të njëjtat pasoja që ekzistojnë në çdo ekonomi kapitaliste, siç janë anarkia në prodhim, spontaneiteti dhe një varg kontradiktash të tjera, që shfaqen në mënyrën më të hapur e të egër në ekonominë dhe në tregun jugosllav.

«...shkëmbimi i lirë i punës nëpërmjet prodhimit të mallrave dhe të tregut të lirë vetëqeverisës (nënvizimi është yni) në shkallën e tashme të zhvillimit shoqëroro-ekonomik, shkruan Kardeli, është kusht për vetëqeverisjen... Ky treg... është i lirë në atë kuptim që organizatat vetëqeverisëse të punës së bashkuar hyjnë lirisht dhe me sa më pak intervenime administrative në marrëdhënie të shkëmbimit të lirë të punës. Suprimimi i lirissë së këtillë patjetër çon kah përtëritja e monopolit shtetëroro-pronësor të aparatit shtetëror» (faqe 95).

Nuk ka mohim më të hapur se kaq të mësimeve të Leninit, i cili shkruante:

*«Ne duhet të përkrahim, neve na intereson të zhvillojmë një tregti «të rregullt», që tò mos i shmanget kontrollit të shtetit», «... sepse liri e shitjes, liri e tregtisë do tè thotë zhvillim i kapitalizmit...»<sup>1</sup> (nënvizimi është yni).*

Nga ekonomia politike e socializmit dihet se tregtia në socializëm, ashtu si edhe gjithë proceset e tjera të ri-prodhimit shoqëror, është një proces që planifikohet e drejtohet në mënyrë të centralizuar, që mbështetet në pronën shoqërore socialiste të mjetave të prodhimit dhe është vetë pjesë përbërëse e marrëdhënieve socialistë në prodhim. Mirëpo për revisionistin Kardel këto mësime janë krejt të huaja dhe kjo vjen nga mohimi që ai i bën rolit ekonomik të shtetit socialist dhe pronës socialistë. Tregu i brendshëm jugosllav është një treg tipik kapitalist i decentralizuar, ku shiten e blihen lirisht nga kushdo mjetet e prodhimit, gjë që është në kundërshtim me ligjet e socializmit. Për këto arsyesh TANJUG-u detyrohet të pranojë se në të gjithë tregun jugosllav sundojnë sipërmarrësit, ndërmjetësit dhe spekulantët. Në treg mbretërojnë kaosi, spontanciteti, luhatjet katastrofike të çmimeve etj. Sipas të dhënave të Institutit Federativ Jugosllav të Statistikave, çmimet e 45 prodhimeve më kryesore dhe të shërbimeve shoqërore në Jugosllavi janë ngritur 149,7 për qind për periudhën 1972-1977.

Për sa i përket shitjes së mallrave brenda vendit, fuqia blerëse në Jugosllavi është shumë e dobët, për

arsye të rrogave të ulëta të punonjësve dhe se, në bilancin e fundit të ndërmarrjeve, punëtorëve nuk u mbetet shumë për t'u ndarë. Ndërmarrja dëshiron t'i shesë ku të mundë e në mënyrë të pavarur ato që ka prodhuar, sepse udhëheqësit kryesorë, domethënë bosët, borgjezia e re, dëshirojnë të krijojnë fitime. Po nga t'i krijojnë këto fitime kur blerësi është i varfër? Atëherë janë gjetur forma të tjera, një ndër të cilat është shitja e mallrave me kredi. Shitja me kredi e plaçkave të fabrikuara nga këto ndërmarrje «vetadministruese» është një zinxhir tjetër që i hidhet në qafë punëtorit jugosllav, ashtu siç i hidhet punëtorit të vendeve kapitaliste nga i njëjti sistem kapitalist, por që në Jugosllavi e ka emrin «vetadministrim socialist».

Të njëjtat tipare karakterizojnë edhe tregtinë e jashtme jugosllave, ku nuk ekziston monopol shtetëror. Çdo ndërmarrje, sipas dëshirës së padronëve të saj, mund të lidhë kontrata e marrëveshje me çdo firmë, shoqëri shumëkombëshe apo shtet të huaj për të blerë dhe për të shitur lëndë të para e makineri, prodhime të gatshme, teknologji etj. Edhe kjo praktikë antimarksiste ka ndikuar që shteti jugosllav të jetë një vasal i kapitalit botëror, të futet thellë në krizën ekonomike e financiare që ka pushtuar gjithë botën kapitalisto-revisioniste, krizë kjo që manifestohet edhe në fusha të tjera.

Si revisionist i regjur, E. Kardeli, mohon rolin e shtetit socialist edhe në fusha të tjera, siç janë marrëdhëniet financiare dhe veprimtaritë me karakter të ndryshëm. Ai shkruan se «Marrëdhëniet në fushat në të cilat themelohen bashkësitetë vetëqeverisëse të inte-

resit realizohen, sipas rregullit, pa intervenimin e shtetit, domethënë... pa ndërmjetësimin e buxhetit dhe të masave të tjera administrativo-fiskale...» (faqe 167).

Në Jugosllavi, njëloj si dhe në vendë të tjera kapitaliste, është përhapur në shkallë të gjerë sistemi i dhënies së kredisë nga ana e bankave në vend të financimit buxhetor të investimeve për zhvillimin e forcave prodhuase dhe të aktiviteteve të tjera. Bankat janë bërë qendra të kapitalit financiar dhe janë pikërisht ato që luajnë një rol shumë të madh në ekonominë jugosllave në interes të borgjezisë së re revisioniste.

Pra, një sistem i tillë anarkosindikalist është vendosur në Jugosllavi dhe këtij i është dhënë emri «vetadministrimi socialist». Ç'i ka sjellë Jugosllavisë ky vetadministrim socialist? Të gjitha të këqijat. Në radhë të parë anarkinë në prodhim. Atje asgjë nuk është stabël, çdo ndërmarrje hedh në treg prodhimet e veta dhe zhvillohet një konkurrencë kapitaliste, sepse nuk ka koordinim, mbasi nuk është ekonomia socialiste ajo që udhëheq prodhimin. Vetë ndërmarrja lufton, në konkurrencë me të tjerat, për të siguruar lëndën e parë, tregun e shitjes dhe gjithçka tjetër. Shumë ndërmarrje po mbyllen për arsyet e mungesës së lëndës së parë, të deficiteve të mëdha që krijon ky zhvillim kaotik kapitalist, të shtimit të stoqeve për mungesën e fuqisë bleërëse dhe për arsyet e ngopjes së tregut me plaçka të demoduara. Në Jugosllavi paraqitet shumë e rëndë edhe gjendja e shërbimeve artizanale. Titoja, duke iu referuar kësaj çështjeje në aktivin drejtues të Sllovenisë, nuk e fshehu dot faktin që «Sot njeriu shpeshherë duhet të djersitet mirë për të gjetur, për shem-

bull, një marangoz ose artizan tjetër që do t'i rregullojë ndonjë gjë, dhe, kur e gjen, ai e rrjep në mënyrë të tillë saqë njeriut i ngrihen leshrat e kokës».

Pavarësisht se, siç vumë në dukje, prodhimet që dalin nga disa kombinate moderne janë të mira, Jugosllavisë i krijohet një situatë e vështirë, mbasi këtyre prodhimeve duhet t'u gjendet treg shitjeje. Për shkak të kësaj vështirësie, ngjet ajo që bilanci tregtar i jashtëm jugosllav është pasiv. Vetëm në 5 muajt e parë të këtij viti deficiti ka qenë 2 miliardë dollarë. Në Kongresin e 11-të të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, Titoja deklaroi se «deficiti me tregun perëndimor është bërë pothuajse i patolerueshëm». Afër 3 muaj pas këtij kongresi, ai deklaroi përsëri në Slloveni: «Vëçanërisht ne kemi vështirësi të mëdha në shkëmbimin tregtar me vendet e Tregut të Përbashkët Evropian. Këtu debalancimi në dëmin tonë është shumë i madh dhe në rritje të vazhdueshme. Për këtë duhet të bise-dojmë me to shumë seriozisht. Shumë prej tyre na premtojnë se këto gjëra do të rregullohen, se importimi nga Jugosllavia do të jetë më i madh, por nga të gjitha këto deri tani kemi pasur pak leverdi. Secili ia hedh fajin tjetrit». Dhe deficiti në shkëmbimet tregtare me botën e jashtme, që Titoja nuk e përmend në këtë fjalim të tij, në vitin 1977 i kaloi të katër miliardë dollarët. Kjo është një katastrofë për Jugosllavinë.

I gjithë vendi ndodhet në një krizë të pambaruar dhe masat e gjera punonjëse jetojnë në varfëri.

Shumë punëtorë jugosllavë janë pa punë, hidhen në rrugë ose emigrojnë jashtë shtetit. Këtë emigracion ekonomik, këtë fenomen kapitalist, Titoja jo vetëm e

ka njojur, por ka rekomanduar që të zhvillohet. Në një vend socialist nuk mund të ekzistojë papunësia, dhe shembulli më i qartë në këtë drejtim është Shqipëria. Ndërkaq në vendet kapitaliste, ku përfshihet, natyrisht, edhe Jugosllavia, ekziston dhe krijohet papunësia nga të gjitha anët. Kur në Jugosllavi ka mbi 1 milion të papunë dhe mbi 1,3 milionë emigrantë ekonomikë, që shesin krahun e tyre të punës në Gjermaninë Federale, në Belgjikë, në Francë etj., kur po shtohet me shpejtësi pasuria e individëve që kanë pozita qofstë në pushtet, qofstë në ndërmarrje e institucione, kur çmimet e sendeve të konsumit rriten çdo ditë e më shumë, kur ndërmarrjet e filialët e falimentuara numërohen me mijëra, vërtetohet ajo që sistemi i vet-administrimit jugosllav është një blof i madh. Dhe Kardeli pa pikë turpi arrin të shkruajë se «vetëqeveisja socialiste në kushtet tona është forma më e drejt-përdrejtë dhe shprehja e luftës për lirinë e punonjësit, për lirinë e punës dhe të krijimtarisë së tij, për ndikimin e tij vendimtar ekonomik dhe politik në shoqëri» (faqe 158).

Duke e thelluar më tej me llafologji bajate demagogjinë e tij të tipit borgjez, Kardeli arrin të gënjejë deri në atë shkallë sa të thotë: «Me garantimin kushtues dhe ligjor të të drejtave të punëtorëve në bazë të punës së tyre të shoqërizuar të kaluar shoqëria jonë i zgjeron më tutje dimensionet e lirisë së vërtetë të punëtorëve dhe të punonjësve në marrëdhëni matiale të shoqërisë» (faqe 162). E ç'ka parasysh ky apologjet i borgjezisë kur flet për «zgjerim të dimensioneve të lirisë së vërtetë të punëtorëve»? «Liranë»

për të qenë i papunë, «lirinë» pér të braktisur familjen e atdheun dhe pér të shitur fuqinë e krahut e të mendjes te kapitalistët e botës perëndimore, apo «lirinë» pér të paguar taksa, pér t'u diskriminuar dhe pér t'u shfrytëzuar egërsisht nga borgjezia e vjetër dhc e re jugosllave, si edhe nga ajo e huaj?

### 3. — Vetadministrimi dhe pikëpamjet anarkiste mbi shtetin. Çështja nationale në Jugosllavi

Në Jugosllavi nuk ekzistojnë organe të pushtetit shtetëror si përfaqësuese të vërteta të popullit. Atje ekiston vetëm sistemi burokratik i quajtur «sistemi i delegatëve», që paraqitet gjoja si bartës i sistemit të pushtetit, prandaj nuk zhvillohen zgjedhje deputetësh pér organet e pushtetit shtetëror. Këtë fakt titistët duan ta justifikojnë me arsyetimin se gjoja organet përfaqësuese janë shprehje e parlamentarizmit borgjez dhe e shtetit socialist sovjetik që, sipas tyre, paska qenë shndërruar nga Stalini në një institut të burokracisë e të teknokratizmit. Në Jugosllavi i është hequr vijë eksperiencës së sovjetëve të deputetëve punëtorë e fshatarë, të krijuar nga Lenini mbi bazën e eksperiencës së madhe të Komunës së Parisit, sepse këta janë quajtur nga revizionistët jugosllavë «forma organizimi shtetëror që krijojnë pushtet personal».

Duke e zhvilluar idenë revizioniste të «socializmit specifik» aty rreth viteve pesëdhjetë, titistët deklaruan botërisht se kishin hequr dorë përfundimisht nga siste-

mi shtetëror socialist dhe e kishin zëvendësuar atë me një biçim sistemi të ri, «socializmin vetadministruar», ku socializmi dhe shteti janë të huaj për njëri-tjetrin. Ky «zbulim» revisionist nuk ishte gjë tjetër veçse një kopjim i teorive anarkiste të Prudonit dhe të Bakuninit mbi «vetadministrimin punëtor» dhe «fabrikat e punëtoreve», që janë demaskuar me kohë, si dhe një falsifikim trashanik i ideve të vërteta të Marksit dhe të Leninit mbi shtetin e diktaturës së proletariatit.

Karl Marks ka shkruar:

*«Midis shoqërisë kapitaliste dhe asaj komuniste ndodhet periudha e transformimit revolucionar të shoqërisë së parë në të dytën. Kësaj periudhe i përgjigjet edhe periudha kalimtare politike, dhe shteti i kësaj periudhe nuk mund të jetë tjetër veçse diktaturë revolucionare e proletariatit»<sup>1</sup>.*

Sistemi politik i «vetadministrimit socialist» në Jugosllavi jo vetëm s'ka asgjë të përbashkët me diktaturën e proletariatit, por është kundër saj. Ky sistem është ndërtuar në shembullin e administratës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vetë Kardeli, duke folur për sistemin e vetadministrimit jugosllav ka shkruar: «...mund të thonim se ky sistem është pak më i afërm me organizimin e pushtetit ekzekutiv në Shtetet e Bash-

1. K. Marks e F. Engels, Vepra të Zgjedhura, vëll. II, f. 21, Tiranë, 1975.

kuara të Amerikës sesa me Evropën Perëndimore...» (faqe 235).

Pra, del qartë, se këtu nuk mohohet fakti që organizimi i qeverisë jugosllave është kopje e organizimit të qeverive kapitaliste, por ajo që mund të diskutohet është çështja: cila qeveri kapitaliste është imituar më tepër, ajo amerikane apo ndonjëra nga qeveritë e Evropës Perëndimore. Dhe këtij diskutimi i jep zgjidhje Kardeli kur thotë: është marrë si model organizimi i pushtetit ekzekutiv të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pikëpamjet e revizionistëve jugosllavë nibi shtetin janë plotësisht anarkiste. Dihet se anarkizmi kërkon zhdukjen e menjëherëshme të çdo lloj shteti, pra edhe të diktaturës së proletariatit. Edhe revizionistët jugosllavë e kanë zhdukur diktaturën e proletariatit dhe, për të justifikuar këtë tradhti, ata flasin për dy fazat e socializmit: «socializmin shtetëror» dhe «socializmin e vërtetë humanitar». Faza e parë, sipas tyre, përfshin vitet e para pas fitores së revolucionit kur ekziston diktatura e proletariatit, që shprehet në shtetin «etatist-burokratik» njësoj si në kapitalizëm. Faza e dytë është ajo e kapërcimit të shtetit «etatisto-burokratik» dhe e zëvendësimit të tij me «demokracinë direkte». Me këto pikëpamje titistët jo vetëm mohojnë nevojën e diktaturës së proletariatit në socializëm, por edhe i vënë kundër njëri-tjetrit nacionet shtet socialist, diktaturë e proletariatit dhe demokraci socialiste.

Ata nuk i përsillin mësimet e klasikëve të mark-sizëm-leninizmit se gjatë gjithë periudhës historike të kalimit nga kapitalizmi në komunizëm, shteti socialist

forcohet vazhdimisht, prandaj E. Kardeli shkruan se shoqëria në Jugosllavi bazohet gjithnjë e më pak në rolin e aparatit shtetëror. Sipas tij aktualisht në Jugosllavi shteti po shkon gjoja drejt zhdukjes.

Po me se e zëvendëson Kardeli rolin e aparatit shtetëror? E zëvendëson me «iniciativën e punëtorëve»! Ai shprehet: «... funksionimi i mëtejshëm i shoqërisë sonë do të bazohet gjithnjë më pak në rolin e aparatit shtetëror, e gjithnjë më shumë në fuqinë dhe në iniciativën e punëtorëve...» (faqe 8). Arsyetim absurd! Që të flasësh për iniciativën e punëtorëve, para së gjithash duhet që punëtorët të janë të lirë e të organizuar, të frysmezohen nga direktiva të qarta dhe të merren masa efikase për zbatimin e këtyre iniciativave. Kush merret në Jugosllavi me organizimin e punëtorëve dhe frysmezimin e tyre me direktiva të qarta? «Bashkësia vetadministruese» thotë E. Kardeli, duke arsyetuar në mënyrë abstrakte. Rolin kryesor në këtë farë bashkësie ai ia lë individit «në punën e bashkuar vetadministruese të interesave të tij». Se ç'do të thotë ky «bashkim vetadministrues» i interesave të individit, që vihet në qendër të shoqërisë jugosllave, asgjë nuk shpjegohet qartë, por ajo që spikat në këto idë është individualizmi borgjez, që ngre lart të drejtat absolute të individit në shoqëri dhe pavarësinë e plotë të tij nga shoqëria, vënien e interesave personalë mbi interesat e shoqërisë.

Sipas këtij «teoricieni», që i lejon vetes gjykime të tillë, forcimi i shtetit dhe i aparatit të tij është karakteristikë e formave «shtetëroro-pronare të marrëdhënive socialiste prodhucse...» (faqe 8), kurse në Ju-

gosllavi, thotë ai, në vend të shtetit do të zhvillohet gjithnjë e më shumë procesi i forcimit të rolit «vet-administrues» të njeriut punonjës. Pra, në një shtet të vërtetë socialist, ku zbatohen shkenca marksiste-leniniste dhe praktika revolucionare leniniste, sipas këtij «filozofji», njeriu nuk mund të jetë i lirë dhe zot i fateve të tij, por shndërrohet në një automat, kurse në vetadministrimin jugosllav njeriu punonjës marrka një rëndësi të madhe dhe pikërisht në këtë vetadiministrim, «në mekanizmin demokratik të delegimit të shoqërisë jugosllave» ai e kuptoka rolin e tij të madhi! Cilat klasa përfaqësojnë këto organe shtetërore, nga cila ideologji udhëhiqen, në cilat parime e kanë ndërtuar veprimtarinë e tyre dhe para cilit forum japid llogari? Natyrisht këto pyetje mbeten pa përgjigje të qarta, sepse çdo përgjigje e saktë në këtë drejtim do të hidhte dritë mbi sistemin politik kapitalist jugosllav.

Kardeli, pa bërë asnjë dallim se për çfarë shteti, partie apo sistemi e ka fjalën dhe duke sulmuar shtetin në përgjithësi si antinjerëzor, u qëndron besnik pozitave anarkiste, kur shkruan: «Njeriut nuk mund t'i sjellë lumturi as shteti, as sistemi, as partia politike. Njeriut mund t'i sjellë lumturi vetëm ai vetë» (faqe 8). Këtu dalin në pah mjaft qartë tendencat e spontaneitetit të teorisë antimarksiste të «vetadministrimit socialist», sipas së cilës klasës punëtore, për të arritur aspiratat e saj, nuk i duhet organizimi në parti e në shtet, se, me kalimin e kohës, edhe duke u endur nëpër errësirë, një ditë ajo do ta arrijë lumturinë që kërkon.

Për t'i dalë përpara pyetjes: kur nuk u dashka

shteti, atëherë përse nuk eliminohet ai në Jugosllavi, Kardeli ka shkruar: «Shteti... duhet të paraqitet si arbitër vetëm në ato raste kur nuk mund të realizohet marrëveshja vetëqeverisëse, kurse nga aspekti i interesave shoqërorë është e domosdoshme të merret vendimi» (faqe 23). Dhe për të vërtetuar se gjoja nevoja e arbitrimit të shtetit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndihet rrallë, thotë se «Shkëmbimi i lirë i punës ndikon esencialisht në pakësimin e antagonizmave në mes të punës fizike dhe asaj mendore. Puna mendore në marrëdhëniet e këtilla nuk është më superiore ndaj punës fizike, por vetëm një nga komponentet e punës së lirë të baslikuar dhe shkëmbimit të lirë të formave të ndryshme të rezultateve të punës» (faqe 24). Kur lexon këto fraza çdo njeriu i lind pyetja: Vallë përrandin shoqëror jugosllav e ka fjalën autorit? Kur qen kan pakësuar në Jugosllavi antagonizmat midis punës mendore dhe asaj fizike?!

Realiteti i zhvillimeve në Jugosllavi provon të kundërtën. Midis punës mendore dhe punës fizike ka dallime thelbësore që nuk mund të ngushtohen me fjalë. Është e çuditshme të flitet për pakësimin e antagonizmave midis punës mendore e punës fizike në shtetin jugosllav, kur dihet se atje vetëm diferenca e pagave midis punëtorit dhe intelektualit, pa folur për dallimet e tjera, ka arritur në raportin një me njëzet, në mos më tepër.

«Vetadministrimin në punën e bashkuar» Kardeli e konsideron si «...bazë e vërtetë materiale edhe përvetëqeverisjen në shoqëri, d.m.th. në bashkësitë shoqëroro-politike, të cilat ushtrojnë pushtetin shtetëror prej

komunes deri në Federatë, si dhe për realizimin e të drcjtave demokratike të njerëzve punonjës dhe të qytetarëve në qeverisjen e shtetit, respektivisht të shoqërisë. Vetëqeverisja është bazë materiale edhe për zhvillimin e punëtorit si person krijues në shfrytëzimin e mjeteve të gjithëmbarshme shoqërore...» (faqe 24), e plot fraza të tilla.

Duke dashur ta paraqesë të ashtuquajturin veta-ministrim si premisë materiale të lumturisë njerëzore që na qenka «zbuluar» nga kokat e mëdha në Jugosllavi, Kardeli përdor fraza të alambikuara dhe një gjuhë kishtare që tjerr shumë e në fakt nuk thotë asgjë. Ai radhit ide të kundërtë mbi «socializmin shkencor», përdor shprehje të gjata që t'u japë thënieve të tij një kuptim gjoja të thellë e filozofik.

Por si po realizohet në praktikë sistemi politik jugosllav? Duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, Kardeli është i detyruar të pohojë: «Në këtë pikëpamje në vetë sistemin ka tepër shumë pika të dobëta. Një varg i tërë dobësish në funksionimin e organizatave dhe të institucioneve të sistemit tonë politik me të drcjtë krijon bindjen se ende veprojnë burime të fuqishme të burokratizmit dhe të teknokratizmit, se administratën e kemi të ndërlikuar dhe se për këtë arsyе vërshon burokratizmi, se disa organe dhe organizata mbyllen në vettete, se ka shumë zbrastësi dhe dublifikime në punë, se janë të zhvilluara dobët format e komunikimit demokratik ndërmjet organeve vetëqeverisësc e shteti-lore dhe të tërë strukturës shoqërore, se kemi shumë mbledhje të zbrazëta dhe joproduktive, se mbledhjet dhe vendimet shpeshherë nuk i kemi njaft të përga-

titura në pikëpamje profesionale, se qytetari në luftë për të drejtat e veta shpeshherë i kalon me vështirësi pengesat administrative etj.» (faqe 193). Kur sistemi vetadministruesh është mbytur nga burokratizmi, kur organet shtetërore dhe administrative janë mbyllur në vete, marrin vendime pa vlerë dhe i kanë prerë urat me shtetasit që duan të qajnë hallet e shumta që kanë, atëherë cilil i duhet ky sistem, përvèç klikës së Titos? Si e qeveriskan veten shtetasit jugosllavë kur nuk i kapércejnë dot «pengesat administrative»? Me gjithë dëshirën e madhe të gjarprit për të mos i treguar këmbët e veta, me gjithë rezervat dhe rrumbullakosjet që bën ideologu titist për të fshchur të zezat e sistemit të tij, prapëseprapë edhe me aq sa pohon ai, e vërteta merret vesh.

Kardeli shkruan: «Edhe struktura e kuvendeve të delegatëve dhe mënyra e marrjes së vendimeve në to janë organizuar ashtu saqë, parimisht, sigurojnë rol prijës të punës së bashkuar në tërë sistemin e marrjes së vendimeve shtetërore» (faqe 24-25). Me këto fjalë ai do të bëjë një fokus për të treguar se gjoja «kuvendet e delegatëve», që në të vërtetë ngjajnë me kuvendet e krijuara nga sindikatat kapitaliste, ku punëtorët e sindikuar bëjnë llogje, mund të kryejnë funksionet e shtetit. Prandaj, sipas tij, është i tepërt shteti i dikaturës së proletariatit.

Këtu, natyrisht, nuk shtrohet çështja e zëvendësimit të emrit diktaturë e proletariatit, që i tmerron borgjezinë dhe revizionizmin, me një emër tjeter: «kuvendet e delegatëve». Jo, këtu është fjala për ndryshimin e karakterit klasor të shtetit socialist, me qëllim që

pushtetin të mos e ketë klasa punëtore, por borgjezia e re. Nuk është vështirë të merret vesh se këto qëndrime synojnë të justifikojnë rrugën e kthimit prapa në kapitalizëm dhe të përligjin, për aq sa është e mundur, tradhtinë e titistëve.

Që ta prezantojnë sistemin e tyre famëkeq të «vet-administrimit socialist» si të drejtë e të pranueshëm, titistët ia kundërvënë atë diktaturës borgjeze dhe diktaturës së proletariatit. Për titistët të gjitha sistemet e tjera politike, pa bërë dallim midis kapitalizmit e socializmit, konsiderohen «dogmatike». Pasi ëndërrimet e veta i quajnë «sistem socialist të vetadministrimit», përtë treguar epërsinë e sistemit të tyre, ata e krahasojnë këtë me rendin shoqëror kapitalist.

Natyrisht revisionistët jugosllavë nuk mund të mos e «qortojnë» sistemin politik parlamentar të shoqërisë borgjeze, që Kardeli e përcakton si sistem «shumëpartish», se ndryshe do të demaskoheshin si përkrahës të parlamentarizmit borgjez, që e kanë kritikuar me rrapëtësi Marksi dhe Lenini në kohën e tyre. Prandaj ata deklarojnë se është gabim që kjo formë e shtetit politik borgjez të konsiderohet se ka karakter universal dhe të përjetshëm. Dihet botërisht se tezën famëkeqe mbi universalitetin dhe përjetësinë e kapitalizmit të ideologëve borgjezë nuk është Kardeli që e «kritikon» i pari. Klasikët e marksizëm-leninizmit, duke hedhur poshtë pikëpamjet e socialdemokracisë, kanë provuar shkencërisht se sistemi kapitalist nuk ka aspak karakter universal e të përjetshëm, se ai është i destinuar të vdesë, se shteti kapitalist, që është pjellë dhe mburojë e këtij sistemi antipopullor, duhet shkatërruar që

nga themelet dhe, në vend të tij, të vendoset sistemi socialist i vërtetë, por jo një sistem i bastarduar, që të nis nga kapitalizmi e të kthen përsëri në kapitalizëm, siç është sistemi politik i vetadministrimit jugosllav.

Kardeli e «kritikon» sistemin parlamentar borgjez, por lehtë e butë, se i dhimbset, prandaj fill pas kritikës që bën, ngre në qìell e fetishizon kontributin e tij në zhvillimin demokratik të njerëzimit. Për ta zmadhuar këtë kontribut në një masë të atillë sa të zbehet tërësisht karakteri reaksionar i parlamentit të sotëm borgjez dhe për të treguar sidomos «lidhjen organike të parlamentarizmit dhe të të drejtave demokratike të njeriut», ai për herë të parë citon (ose më mirë të themi cungan) Marksin: «Regjimi parlamentar jeton prej diskutimit, atëherë si ta ndalojë diskutimin? Çdo interes dhe çdo institucion shoqëror këtu shndërrohen në mendime të përgjithshme dhe si mendime edhe shoshiten, e si atëherë ndonjë interes, ndonjë institucion të qëndrojë sipër mendimeve dhe si të imponojë si dogmë fetare?... Regjimi parlamentar lë çdo gjë që të vendosë shumica, atëherë si shumicat dërrmuese jashtë parlamentit të mos dëshirojnë të marrin vendime?».

Në kontekstin e librit, ky citat i Marksit është futur si pykë dhe prandaj është zor të shërbejë për të provuar sa dëshiron Kardeli. Ideja e Marksit, e shkëputur dhe e copëtuar në mënyrë të palejueshme, ashtu sikundër e ka cituar me djallëzi ky revizionist, vë në dyshim faktin e pamohueshëm që Marks ka qenë absolutisht kundër parlamentarizmit të shitur e të kalbur të borgjezisë.

Kjo orvatje e tij është pa sukses, sepse dihet bo-

tërisht qëndrimi i Marksit, i cili, duke kritikuar parlamentin borgjez dhe teorinë borgjeze të ndarjes së pushteteve, nuk ka thënë kurrë që të zhduken institucionet përfaqësuese dhe të hiqet dorë nga parimi i zgjedhjeve, sikurse u veprua në Jugosllavi, por ka shkruar që në shtetin proletar të ndërtohen dhe të veprojnë organe përfaqësuese të tilla që të mos janë «vende llafesh», po institacione të vërteta punc, duke u ndërtuar dhe vepruar si

*«...një korporatë pune, legislative dhe ekzekutive njëkohësisht»<sup>1</sup>.*

Parlamentarizmi borgjez ka marrë «forcë të madhe», sepse, sipas autorit të librit, praktika socialiste, duke përjashtuar Jugosllavinë, nuk paska qenë e aftë të zhvillojë më shpejt dhe në mënyrë më të gjerë forma të reja të jetës demokratike që t'u përgjigjen marrëdhënieve socialiste në prodhim. Formën e re të jetës demokratike, sipas Kardelit, e paska realizuar «vet-administrimi socialist», i cili e ka kaluar Rubikonin e pushtetit klasor të pronarëve dhe të drejtuesve teknokratë-monopolistë të kapitalit. Është për t'u çuditur, kur ai të gjitha përpjekjet e forcave demokratike përgjetjen e formave të demokracisë i quan si «konstruksione artificiale» të parlamentit borgjez, si orvatje përtë bashkuar «disa gjëra që nuk mund të bashkohen», kurse konstruksionet e «vetadministrimit socialist» ju-

1. K. Marks & F. Engels, Vepra të Zgjedhura, vell. I, f. 544, Tiranë, 1975.

gosllav, këto shartime të bastarduara të formave borgjezo-revisioniste të qeverisjes, i quan origjinale e socialiste! Në qoftë se ka blof në konstruksionin e qeverisjes, ai gjendet në radhë të parë në «vetadministrim» e sajuar sipas teorisë antimarksiste dhe antidemokratike të titistëve. Vetadministrimi jugosllav, pavarësisht nga deklaratat e shumta mashtruese që bëhen për të, është një kopjim i parlamentarizmit borgjez dhe i marrëdhënieve kapitaliste në prodhim, është një shtojcë kaotike e sistemit kapitalist botëror, e strukturës dhe e superstrukturës së këtij sistemi.

«Demokracia jonë socialiste, shkruan Kardeli, nuk do të ishte sistem i tërësishëm i marrëdhënieve demokratike pa zgjidhjen përkatëse të marrëdhënieve midis kombeve dhe kombësive të Jugosllavisë» (faqe 171). Megjithëse ishte rasti që ideologu revisionist të shpjetonte si e ka zgjidhur sistemi politik i «vetadministrit socialist» problemin e kombeve dhe të kombësive në Jugosllavi, ai i ka shkuar aq anash e nëpër të këtij problemi të madh, serioz e delikat për Federatën e tij, sa, duke lexuar librin prej 323 faqesh, njeriu me zor mban mend se është bërë fjalë diku edhe për kombet e kombësitë.

Si qëndron çështja e kombeve dhe e kombësive në Jugosllavi? Federata jugosllave ka trashëguar konflikte të thella në këtë fushë. Politika e kralëve serbomëdhenj dhe e qarqeve reaksionare shoviniste në Jugosllavi ka qenë e tillë që, historikisht, ka nxitur konflikte e armiqësi ndërmjet kombeve e kombësive.

Pas Luftës së Dytë Botërore Republika Federative e Jugosllavisë hodhi parullën «Bashkim — vëllazë-

rim», por ky slogan nuk mund të ishte i mjaftueshëm për të zgjidhur mosmarrëveshjet e trashëguara, prandaj konfliktet e vjetra, lakmitë e egra për sundim mbi të tjerët nuk u zhdukën.

Klika renegate e Titos, lidhur me tendencat centrifugiste të republikave e krahinave ndaj Federatës, nuk zhvilloi një politikë nationale marksiste-leniniste. Përkundrazi, marrëdhëniet ndërmjet kombësive mbeten si në kohën e kralëve dhe ndaj disa kombësive vazhdoi gjenocidi. Kjo politikë u ka shërbyer nxitjes së urrejtjes dhe grindjeve midis kombeve e kombësive të Jugosllavisë. «Bashkimi» dhe «vëllazërimi» i popujve, për të cilët flitet shumë në Jugosllavi, kurrë nuk është shtruar mbi themele të drejta të barazisë ekonomike, politike, sociale e kulturore të kombeve e të kombësive.

Pa arritur barazinë në këto fusha është e pamundur të zgjidhet drejt çështja nationale në Jugosllavi. Po bëhen tri dekada që «socializmi vetadministruar» përveç demagogjisë mbi «bashkësinë vetëqeverisëse të kombeve dhe të kombësive të tipit të ri», nuk ka sjeillë aspak realizimin e të drejtave sovrane të këtyre kombeve dhe kombësive të ndryshme në republikat dhe në krahinat e Jugosllavisë. Kështu, për shembull, krahina e Kosovës me një popullsi shqiptare gati tri herë më të madhe se popullsia e Republikës së Malit të Zi, në krahasim me viset e tjera të Jugosllavisë, ka një prapambetje të theksuar ekonomike, politike, sociale dhe kulturore. Edhe në republikat e mëdha ka dallime të palejueshme në krahasim me republikat e tjera në të tëra fushat e jctës. Kjo gjendje është pika

më e dobët që e lëkund nga themellet Federatën e revisionistëve jugosllavë. Shpresat për zgjidhjen e mos-marrëveshjeve të vjetra e të reja ndërnacionale në Jugosllavi janë pa perspektivë.

Duke e analizuar me objektivitet shkencor këtë situatë mjaft të vështirë e të turbullt, del konkluzioni i pakundërshtueshëm se çështja nationale në Jugosllavi nuk do të zgjidhet në qoftë se atje nuk do të zbatohet marksizëm-leninizmi, pra, në qoftë se atje nuk përmbyset rendi kapitalist i ashtuquajtur vetadministrues.

Këtë rrezik e ndiejnë renegatët titistë, prandaj, kur u duhet të zënë në gojë çështjet e kombeve dhe të kombësive, duan ta kapërcejnë hendekun me disa deklarata pompoze, pa hyrë në brendi të problemeve, ose kërkojnë dëshmi të rreme nga revisionistët e tjerë, siç bënë duke u dhënë publicitet të madh deklaratave të revisionistëve kinezë mbi zgjidhjen «marksiste-leniniste të çështjes nationale në Jugosllavi».

Me fjalë revisionistët mund t'i paraqesin si të duan marrëdhëni midis kombeve e kombësive në Jugosllavi, por e vërteta e hidhur për këtë problem do t'i tmerrojë ata edhe pas vdekjes.

Çështja nationale në Jugosllavi do të zgjidhet nga vetë popujt që përfshihen në Federatën aktuale dhe jo nga ata që, pavarësisht nga deklaratat, në fakt, vazhdojnë politikën reaksionare e shoviniste të paraardhësve të tyre.

Në vazhdim të gjykimeve të tij, duke bërë fjalë për politikën e shtetit jugosllav, revisionisti me dam-kë Kardel thotë se ajo «... nuk është më monopol i

politikanëve profesionistë dhe kartelc politike prapa perdes, por bëhet aktivitet i drejtpërdrejtë dhe marrje e drejtpërdrejtë e vendimive nga ana e vëlcqeverisësve dhe organeve të tyre...» (faqe 25). Ja, do të thotë Kardeli, tani e tutje mos na kritikoni më për tradhli të interesave të klasës, se punëtori jugosllav është zot i politikës së vendit dhe i mbrojtjes së interesave të tij vetadministruese dhe jo si në shtetet e tjera ku zotër janë politikanët profesionistë. Dhe këtu ai, me keqdashje, nuk bën dallimin midis vendit kapitalist e socialist, por i fut të törë në një thes, se kështu i vjen më mbarë për ta paraqitur të zezën të bardhë.

Ai e di se, për të realizuar ato qëllime të pandershme që i ka vënë vetes, duhen zvogëluar me çdo mënyrë shfaqjet që demaskojnë realitetin vetadministruesh. Prandaj faktin që punëtori jugosllav nuk ka mundësi të realizojë të drejtat e tij në fushën politike dhe ekonomike e redukton shumë dhe shpjegon se kjo vjen ....për shkak të një vargu arsyesh objektive dhe subjektive — e ndër to është, pa dyshim, edhe niveli relativist ende i ulët i arsimit dhc kulturës, si dhe i aplikimit të shkencës — punëtori ende nuk është në gjendje të dominojë, të orientojë dhe të kontrollojë në masë të plotë, në mënyrë të vetëdijshme e krijuese, të gjitha proceset që i imponon pozita e tij e këtillë shoqërore ekonomike» (faqe 27). Duket sheshit se këto që shkruhen janë një orvatje për të mbrojtur pozitat antipunëtore e antisocialiste. Aktualisht punëtori jugosllav nuk kuption asgjë nga kjo teori iluzore dhe nuk shikon të zbatohet në praktikë asnjë nga këto ide absurdë, false, të papranueshme prej tij.

Duke qenë pengesë, siç thotë Kardeli, niveli i ulët kulturor e shkencor i punëtorëve, rolin kryesor në shoqërinë vjetadministruese e luajnë njerëzit e arsimuar e të kualifikuar, që janë elita, e cila sundon në «bashkësinë socialiste». Në këto rrethana, në të shumtat e rasteve, vendimet do të merren pikërisht nga kjo elitë, nga elementi i borgjezisë së re, të kulturuar, që bën ligjin në Jugosllavi. Kush e ka fajin që shquhet elita dhe humbet roli i punëtorëve? S'ka asnjë dyshim se fajin e ka vetë sistemi shoqëror që lind klasën e re kapitaliste dhc i krijon asaj mundësitë të fuqizohet ekonomikisht në kurriz të punëtorëve e të arsimohet, ndërsa klasën punëtore e lë në nivel të ulët. Kardeli nuk mund të mos pranojë që, praktikisht, vendimet merren nga një shtresë relativisht e ngushtë njerëzish në Jugosllavi. Mirëpo ai nuk thotë asgjë që pikërisht kështu krijuhet monopol politik i elitës në marrjen e vendimeve dhe në ndarjen e të ardhurave në ndërmarrjet e vjetadministrimit socialist. Ky monopol politik, të cilat gjoja i ruhen dhe e luftojnë revolucionarët jugosllavë, është me mjekër në të ashtuquajturin sistem politik të vjetadministrimit socialist.

Në shoqërinë «vjetadministruese», siç shprehet Kardeli, «...në vend të marrëdhënieve të vjetra: punëtori — shteti — veprimtaritë shoqërore duhet të konstituohet në mënyrë të paevitueshme një marrëdhënie e re ndërmjet punëtorëve në prodhim të drejtë-drejtë dhc punëtorëve në veprimtaritë shoqërore» (faqe 23). Sipas tij, për ndërtimin e marrëdhënieve shoqërore nuk është rrugë e drejtë ajo e një regjimi socialist ku zbatohet socializmi shkencor, ku ekziston uniteti midis

punonjësve të prodhimit të drejtpërdrejtë dhe punonjësve të veprimtarisë shoqërore, ku ekziston një veprimtari e gjallë shoqëroro-politike dhe një organizim i tillë ekonomik, ku rolin kryesor e luajnë njerëzit punonjës të organizuar në shtetin e tyre socialist. Rruga e drejtë, sipas Kardelit, është ajo e ndërtimit të marrëdhënieve shoqërore «të reja» pa pjesëmarrjen e shtetit!

Këto idc janë shprehje e anarkizmit të kulluar. Të gjitha këto fraza lëshohen për të errësuar çdo gjë të mirë që ka sistemi i vërtetë socialist dhe për të mashtruar se gjoja në Jugosllavi ecet drejt unitetit të punëtorëve dhe të intelektualëve nëpërmjet «shkëmbimit të lirë të punës», që pakësoka, si me magji, antagonizmin.

Në «teorinë» e Kardelit nuk bëhet dhe nuk mund të bëhet fjalë për përbysjen me dhunë të shtetit kapitalist, për marrjen e fuqisë nga klasa punëtore dhe për vendosjen e diktaturës së proletariatit. Pavarësisht se ai citon Marksin që «pikërisht dhuna është për atë çka detyrohemë të përdorim në momentin e caktuar — që të konstituojë definitivisht pushtetin e punës», këtë gjë e bën për të argumentuar se gjoja Marksia paska anuar më tepër nga fitorja e revolucionit proletar me mjete paqësore, kurse dhunën e paska quajtur përjashtim dhe e paska kushtëzuar me disa rrethana të veçanta shoqërore. Dhe me të tilla arsyetime sofiste Kardeli kërkon të krijojë përshtypjen se klasa punëtore aktualisht mund t'i realizojë interesat e vet historikë jo me revolucion, por në aleancë me partitë e ndryshme politike të vendeve kapitaliste. Citimin djallëzor për ta vënë Marksin kundër Marksit

Ildhur me mundësinë e kalimit paqësor në socializëm, Kardeli e ka kopjuar nga paraardhësit e tij revisioniste, kundër të cilëve Lenini ka shkruar:

*«Referenca te thënia e Marksit... mbi mundësinë e kalimit paqësor në socializëm... është një argument prej sofisti, domethënë, po të flasim më thjesht, prej bataku, që gënjen të tjerët me anën e citateve dhe të referencave»<sup>1</sup>.*

Këto falsifikime i nevojiten Kardelit për t'u dhiënë dorën eurokomunistëve, me të cilët ai është në akord të plotë. Partitë revisioniste italiane, franceze dhe spanjolle kanë shpallur se gjoja do të arrijnë në socializëm nëpërmjet zhvillimit të demokracisë e të lirive borgjeze, me forcën e numrit të votave në zgjedhjet parlamentare. Aftësia e klasës punëtore, sipas eurokomunistëve do të shprehet në çështjen sa pozita kyç do të fitojë ajo në strukturën e shoqërisë e të pushtetit kapitalist, si edhe në qeverisjen e shoqërisë. Kështu, sipas tyre, do të bëhet i mundur shndërrimi i karakterit të marrëdhënieve në prodhim nga kapitaliste në «vetadministruese» ose «socialiste». Pikërisht në këtë çështje realizohet bashkimi i teorisë tittiste me teorinë e eurokomunizmit. Eurokomunistët janë të detyruar ta pranojnë pluralizmin politik borgjez evropian dhe unitetin në mes partive borgjeze, përtë arritur, gjoja nëpërmjet reformave, në realizimin

1. V. I. Lenin, Veprat, vell. 28, f. 107.

e shumë të drejtave për klasën punëtore dhe, nëpër këtë rrugë, të kalojnë pastaj në shoqërinë «socialiste». Këto aspirata të miqve të tij Kardeli i quan «ndryshime strukturore», të cilat duhet të ndikojnë patjetër që procesi të zhvillohet dhe të ndryshojë edhe pozitën, edhe rolin e vetë parlamentit.

Pra, teoria e Kardelit pretendon se në krizën e sistemit kapitalist, partitë «komuniste» të Evropës Perëndimore, duke ruajtur sistemin parlamentar, të cilit, siç thotë ai, nuk mund t'i mohohen arritjet demokratike, të gjejnë një mënyrë të përshtatshme për t'i siguruar klasës punëtore një aleancë me fuqitë më të gjera «demokratike». Me këtë farë aleance, sipas logjikës revizioniste, mund të krijohet një situatë më e favorshme «demokratike» e sistemit parlamentar dhe, më në fund, sistemi parlamentar «do të shndërrrohet», kushedi se si, në një fuqi vendimtare të popullit! Kjo është rruga që u cakton titizmi partive të tjera revizioniste për të marrë pushtetin në rrugë paqësore.

Mirëpo fuqinë në shtetet borgjeze e kanë në dorë kapitalistët, koncernet, kartellet kombëtare e shoqëritë shumëkombëshe. Këto forca të kapitalit mbajnë në duart e tyre kyçet kryesore të drejtimit të ekonomisë e të shtetit, ato bëjnë ligjin dhe nëpërmjet një procesi të rrenië demokratik emërojnë qeverinë, e cila është nën urdhrat e tyre dhe paraqitet si një administrator zyrtar i pasurive të tyre. Borgjezia nuk e ruan pushtetin e saj për t'ua dorëzuar eurokomunistëve, por për të mbrojtur interesat e saj klasorë, po të jetë nevoja edhe me gjak. Të mos shohësh këtë realitet, që e provon jeta çdo ditë, do të thotë të mbyllësh sytë

e të ëndërrosh ditën në diell. Në qoftë se eurokomunistët do të arrijnë të zënë një ose më shumë poste në qeverinë borgjeze, ata në fakt do të shkojnë atje si përfaqësues të kapitalizmit, sikurse edhe partitë e tjerë politike borgjeze, dhe jo si përfaqësues të proletariatit.

Pseudodemokracia borgjeze, parlamenti, që gjoja zgjedh qeverinë, nuk është gjë tjetër veçse një Marionetë në duart e pushtetit të kapitalit, që vepron «prapa perdes» dhe që në forma të ndryshme dikton çdo gjë nga jashtë. Këtyre formave të ndryshme të realizimit të pushtetit të vërtetë «prapa perdes» u japin nuanca partitë e ndryshme që përfaqësohen në parlament, si dhe sindikatat që gjoja luftojnë për të mbrojtur punëtorët. Në realitet, të gjitha partitë dhe sindikatat borgjezo-revisioniste në shtetin kapitalist, paravarësisht nga emrat që i vënë vetes, janë në vartësi të patronatit.

Kardeli u jep të drejtë eurokomunistëve kur këta e lidhin luftën e tyre politike për «socializëm» me mbrojtjen e institucioneve të pluralizmit të forcave politike, sepse kjo, siç shprehet ai, «... në situatën e tanishme të vendeve të Evropës Perëndimore është e vëtmja mënyrë reale e bashkimit të fuqive të vetë klasës punëtore, si dhe e lidhshmërisë së saj me fuqitë e tjera demokratike të popujve, e kjo është e vëtmja gjë që mund t'i forcojë esencialisht pozitat shoqërore dhe politike të klasës punëtore, d.m.th. ta aftësojë që edhe të mund ta ndryshojë shoqërinë e jo vetëm ta kritikojë» (faqe 41).

Duke shprehur lidhjet, solidaritetin dhe unitetin e

Lidhjes së «Komunistëve» të Jugosllavisë me eurokomunistët dhe me të gjitha partitë e tjera revizioniste që, në një mënyrë ose në një tjetër, në këtë ose në atë formë, mbrojnë kapitalizmin e luftojnë kundër revolucionit dhe socializmit të vërtetë, Kardeli thotë: «...kemi arsyë ta mbrojmë sistemin parlamentar dhe pluralizmin politik, kur e sulmojnë forcat reaksionare të shoqërisë borgjeze...» (faqe 61). «Ideologu» do të thotë se klasa punëtore dhe pseudokomunistët e Evropës Perëndimore kanë të drejtë të bashkohen me institucionet kapitaliste, me parlamentin dhe me qeverinë borgjeze, sepse nga ky bashkim dhe vetëm në këtë mënyrë klasa punëtore do të aftësohet për të ndryshuar shoqërinë!

Nga sa u parashtrua, del qartë se shoqëria vë-administruese jugosllave është për aleancën e ngushëtë ose për fuzionimin e kapitalizmit në socializëm, sepse kapitalistët aktualë nuk paskan kundërshtim që të ndërtohet një shoqëri e re ku klasa punëtore të aftësohet dhe të marrë plotësisht të drejtat demokratike vë-administruese. Pra, nuk është vështirë të merret vesh se autori i librit rekomandon të kalohet nga «shoqëria e konsumit», ku gjoja teknokratët kanë marrë fuqinë, në një shoqëri «vë-administruese ku individët shoqërizohen në punë të përbashkët» dhe ky kalim mund të quhet si fitore e socializmit! Në këto gjykime e qëndrime prej renegatësh të regjur nuk ka asgjë që t'i shembellejë socializmit të vërtetë shkençor. Si shërbëtorë besnikë të borgjezisë kapitaliste, tistët, me këto që shkruajnë, mohojnë revolucionin proletar dhe luftën e klasave. Duke pretenduar se «sho-

qëria e konsumit» mund të shndërrohet gradualisht, pa revolucionin me dhunë, por «me frymën e shenjtë» në socializëm, ata kërkojnë të çarmatosin proletariatin dhe të shpartallojnë partinë e tij marksiste-leniniste.

Në vendet kapitaliste, «zbulon» Kardeli, pushteti ekzekutiv është i lidhur me forca politike jashtë parlamentit, që veprojnë dhe imponojnë politikën e tyre. Edhe këtu ky nuk thotë asgjë të re përveçse përsërit si konstatim të tij atë ide që ka shprehur Lenini kur demaskoi me mjeshtëri falsitetin e demokracisë borgjeze. Të përvetësosh e të përsëritësh idetë e Leninit është një punë e shkëlqyer, por zotin Kardel nuk e ha meraku as për Leninin as për leninizmin. Ai u trembet edhe «politizimit» e «monopolit politik» të leninizmit, me gjithëse ia ka qejfi «të politizojë» të tjerët dhe t'i bëjë të besojnë se vërtet në kapitalizëm pushteti ekzekutiv manipulohet nga forcat jashtë organeve shtetërore, kurse në Jugosllavi Kryesia e RSFJ dhe Këshilli Ekzekutiv Federativ, që përbën qeverinë, i paskan shpëtuar për mrekulli këtij rreziku, sepse paskan ndarë kompetencat «në mënyrë precize» (faqe 235). Veç kësaj në Jugosllavi, gjithnjë sipas Kardelit, forca politike përgendrohet «... në kuvendin e delegatëve mirëpo jo, as në vetë atë por në ndërlidhjen e tij me tëré strukturën shoqërore» (faqe 235). Ky «kuvend delegatësh», për sa i përket «plotfuqishmërisë së kompetencave» të kujton të ashtuquajturat këshilla të vetë-qeverisjes lokale në vendet borgjeze, për të cilat Lenini ka shkruar me qesëndi se ato

«... do të mund të mbeten «autonome» vetëm në çështjet e parëndësishme, vetëm në çështjen e kallajisjes së kazanëve...»<sup>1</sup>.

Thuhet se në «vetadministrimin punëtor» «të deleguarit» shfaqin lirisht mendimet e tyre. Natyrisht, në teori, jo vetëm «të deleguarit», por edhe punëtorët i kanë të gjitha të drejtat, por në praktikë nuk gjëzojnë asgjë. Gjithçka në sistemin politik të «vetëqeverisjes» jugosllave vendoset nga lart dhe jo nga poshtë. Tashmë janë të njohura protestat e punëtorëve jugosllavë kundër pasurimit dhe korruptionit të drejtuesve, dalja e tyre me kërkesa për zhdukjen e ndryshimeve ekonomike e shoqërore, për eliminimin e ndërmarrjeve private, frenimin e korruptionit politik e moral, kundër dallimeve nacionale etj. Janë shkruar plot fraza të stërvizjatura në libër që, duke u lodhur së lexuari, njeriu t'i bëhet e besueshme ideja abstrakte se «në Jugosllavi ekziston vetëqeverisja socialiste», se atje «po mbretëron vetadministrimi punëtor», në një kohë kur punëtorët kanë hapëset e kashtës në dorë. Çelësat e qeverisjes së vendit në Jugosllavi i ka borgjezia e re jugosllave që vepron nga e djathta, duke u maskuar me sloganë të majta.

#### 4. — Sistemi i vetadministrimit dhe mohimi i rolit udhëheqës të partisë

Qëndrim antimarksist mbajnë revisionistët jugosllavë edhe ndaj rolit udhëheqës të partisë komuniste

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 10, f. 366.

në ndërtimin e socializmit. Sipas «teorisë» së Kardelit, partia nuk mund të udhëheqë asnjë veprim ekonomik ose administrativ, por ajo vctëm mund të ndikojë dhe duhet të ndikojë nëpërmjet punës edukative me punëtorët, që këta ta kuptojnë mirë sistemin socialist.

Mohimi i rolit të partisë komuniste në ndërtimin e socializmit dhe reduktimi i këtij roli në «faktor ideologjik» e «orientues» është në kundërshtim të hapët me marksizëm-leninizmin. Këtë tezë armiqtë e socializmit shkencor e «argumentojnë» duke preten-duar se udhëheqja e partisë qenka gjoja e papajtue-shme me rolin vendimtar që duhet të luajnë masat e prodhuesve, të cilat, sipas tyre, duhet të ndikojnë politikisht drejtpërdrejt dhe jo me anë të partisë komuniste, mbasi kjo do të shkaktonte «despotizëm burokratik»!

Në kundërshtim me këto teza antishkencore të këtyre armiqve të komunizmit, eksperienca historike ka treguar se roli udhëheqës e i pandarë i partisë revolucionare të klasës punëtore në luftën për socializëm e komunizëm është i domosdoshëm. Sikurse dihet, udhëheqja e partisë përbën një çeshtje me rëndësi jetike për fatet e revolucionit dhe diktaturën e proletariatit, ajo pasqyron një ligj të përgjithshëm të revolucionit socialist. Lenin thotë se

*«...diktatura e proletariatit nuk është e mundur të realizohet, veçse nëpërmjet partisë komuniste»<sup>1</sup>.*

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 32, f. 226.

Ndikimi politik i drejtpërdrejtë i masave punonjëse në shoqërinë socialiste nuk pengohet aspak nga partia komuniste, që përfaqëson klasën punëtore, interesat e së cilës nuk vijnë në kundërshtim me interesat e punonjësve të tjera. Përkundrazi, vetëm nën udhëheqjen e klasës punëtore e të pararojës së saj masat punonjëse marrin pjesë gjërisht në qeverisjen e vendit dhe në realizimin e interesave të tyre. Për problemet e rëndësishme, në një vend të vërtetë socialist, siç është Shqipëria, merret mendimi i drejtpërdrejtë i masave punonjëse. Shembuj të tillë ka aq shumë, sa nuk numërohen, duke filluar nga diskutimi dhe aprovimi i Kushtetutës e gjer te planet ekonomike etj., etj. «Despotizmi burokratik» është karakteristikë e shtetit kapitalist dhe nuk mund t'i atribuohet kurrë rolit udhëheqës të partisë në sistemin e dikaturës së proletariatit, e cila nga natyra e saj dhe nga karakteri klasor është rreptësisht antiburokratike.

Në vazhdim të shtjellimit të mendimeve revolucioniste mbi rolin e partisë, Kardeli shkruan se Lidhja e Komunistëve, «megjithëse duhet të luftojë që pozitat kryesore të pushtetit të jenë në duar të atyre fuqive subjektive, që janë në anën e socializmit dhe të vetëqeverisjes socialiste», ajo «... nuk mund të jetë parti politike klasore» (faqe 119). Ja çfarë partie kërkojnë revisionistët jugosllavë! Ata nuk duan, dhe në të vërtetë nuk kanë parti politike të klasës punëtore, por një organizatë borgjeze, një klub ku mund të futet e të dalë cilido, kur të dojë e si të dojë, mjafton të deklarojë se është «komunist», pa qenë nevoja të jetë i tillë. Natyrisht, kjo është një gjë normale për një

parti si Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë që s'ka gjë prej gjëje komuniste.

Parti dhe shtet joklasor nuk ka pasur dhe nuk do të ketë kurrë. Shteti dhe partitë janë produkt klasor. Kështu kanë lindur dhe kështu do të janë partitë dhe shtetet gjer në komunizëm.

Megjithëse rolin udhëheqës të Lidhjes së Komunistëve e përfytyron të likuiduar, prapëseprapë ai, për demagogji, nuk harron të thotë se kjo Lidhje, «me qëndrimet e saj të qarta (që në fakt s'i ka hiç të qarta, përkundrazi i ka të errëta e të turbullta), duhet të bëjë shumë për gjetjen e mjeteve të zgjidhjes së shumë problemeve, respektivisht për rrugët dhe format e zhvillimit të mëtejshëm të sistemit politik të vetëqeverisjes socialiste». Në qoftë se nuk mund t'i vijë lumturia popullit nga shteti dhe nga partia, ashtu siç shkruan renegati Kardel, atëherë përsë kërkohet që t'i jepen këto prerogativa Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë? Në qoftë se shoqëria e vëtadministrimit jugosllav nuk ka nevojë për udhëheqjen e një partie të vëtme politike, siç pretendohet, atëherë pse të ketë nevojë për udhëheqjen e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë?

Ndërsa Marksi është për një parti të vërtetë të klassës punëtore, që ta udhëheqë dhe ta bëjë këtë klasë të ndërgjegjishme për misionin e saj historik, sipas Kardelit proletariati mund ta çojë vendin përpara dhe të realizojë aspiratat e tij në mënyrë spontane, edhe pa rolin udhëheqës të partisë. Këtë ai e bën për të përligjur teorinë e vëtadministrimit, të asaj teorie

që është edhe për pluralizmin politik, domethënë për bashkimin në të ashtuquajturën Lidhje Socialiste të Popullit Punonjës të të gjitha forcave shoqërore, pavarësisht nga ndryshimet e tyre ideopolitike, edhe për një parti që s'ka kurrfarë vlerë komuniste, por që ai i vë tabelën e udhëheqjes në gjithë sistemin anti-marksist të vëtadministrimit.

Revisionisti Kardel i zë në gojë partitë perëndimore të kapitalit për burokratizmin e tyre. As këtu ai nuk ka zbuluar gjë-të re, se dihet që burokratizmi është në natyrën e kapitalizmit dhe përbën karakteristikën e tij. Por ai e denoncon burokratizimin e partive të tjera jo për t'i kritikuar ato, por për të fshehur burokratizmin e pastaj likuidimin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe zhveshjen e saj nga çdo prerogativë që i takonte. Zhvendosjen e partisë në bisht të ngjarjeve, të fenomeneve e të proceseve të jetës politike e shoqërore dhe shndërrimin e saj në parti të borgjezisë titistët e quajnë zhburokratizim dhe, për të fshehur tradhtinë, i kanë lënë si një bri vetëm emrin «Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë».

Për të dalluar nëse partia është ose jo komuniste, është ose jo parti e klasës punëtore, nuk mund të gjykohet nga emri që mban, por sidomos nga fakti se cilët janë ata që e udhëheqin dhe çfarë veprimtarie kryen ajo. Lenini thoshte:

*«...nëse një parti është me të vërtetë parti politike punëtore ose jo, kjo varet... edhe nga fakti se kush e udhëheq atë dhe cila është për-*

*mbajtja e reprimere të saj dhe e taktikës politike të saj»<sup>1</sup>.*

Dhe në të vërtetë Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë jo vetëm nuk ka shpëtuar nga burokratizmi, por ajo ka kohë që nuk ekziston më si parti e komunistëve jugosllavë. Fryrja e saj me aparate të shumta, me një numër të madh zyrtarësh dhe rrogëtarësh burokratë, njësoj si partitë revizioniste perëndimore ose partitë socialdemokrate, është një ndër faktorët që e kanë bërë atë jo vetëm të mos jetë më pararojë e klasës punëtore, por të jetë një parti kundër kësaj klase.

Sundim të klasës punëtore dhe parti të saj pararojë, si udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë, nuk ka në Jugosllavi. Sipas Kardelit, rezulton se në Jugosllavi Lidhja e Komunistëve nuk ka kurrsfarë të drejtë për udhëheqje politike në sistemin e pushtetit, sepse atje pushteti realizohet «...nëpërmjet sistemit të delegimit, kurse Lidhja e Komunistëve, si pjesë e sistemit vetëqeverisës, është një ndër faktorët më të rëndësishëm të ndikimit shoqëror në formosimin e vctëdijes së vëtëqeverisësve dhe të organeve të delegatëve» (faqe 73). Mendoj se nuk ka nevojë për shumë shpjegime. Mjaf-tojnë këto që shkruan renegati për t'u bindur se në Jugosllavi nuk ekziston diktatura e proletariatit si sundim politik i klasës punëtore dhe si udhëheqje shtetërore e shoqërisë nga ana e kësaj klase. Dhe përderisa atje nuk ekziston kjo diktaturë, nuk mund të bëhet

fjalë as për ekzistencën e partisë së klasës punëtore, por për një parti të borgjezisë.

Kardeli pretendon se «sistemi i një partie» në një vend socialist është një transformim specifik i sistemit politik borgjez dhe roli i një partie (këtu ai e ka fjalën për Partinë Bolshevike) është po ai i «sistemit shumëpartish», të pluralizmit politik borgjez me një ndryshim «të vogël» që në pushtetin politik, ku ka një parti, qëndrojnë në krye vetëm udhëheqësit e saj, kurse në pushtetin me shumë parti krerët ndërrohen. Ky mashtrues vë në një plan partitë borgjeze dhe partinë e bolshhevikëve, që e krijuan revolucionarët rusë me Leninin në krye. Për të udhëheqja e shtetit dhe e shoqërisë nga partia e vërtetë e komunistëve s'ka asnje ndryshim nga sundimi i borgjezisë nëpërmjet sistemit të shumë partive. Kjo provon edhe një herë tjetër se titistët, ashtu si borgjezia, i trajtojnë partitë politike dhe shtetin si institucione që gjoja qëndrojnë mbi klasat.

Në qoftë se klasa punëtore është kundër borgjezisë për jetë a për vdekje dhe të dyja këto klasa, për të mbrojtur interesat e tyre antagonistë e për të sunduar secila vetë në shoqëri, janë organizuar në parti politike, kjo nuk do të thotë që partia e klasës punëtore, partia marksiste-leniniste, nuk ka ndryshime nga partia borgjeze. Përkundrazi. Kur Partia Komuniste e Jugosllavisë u shndërrua në parti borgjeze, kjo nuk u bë aspak parti mbiklasore, por nga pararojë e klasës punëtore u kthye në vegël të borgjezisë, humbi vetëm karakterin klasor proletar, por jo karakterin klasor në përgjithësi, sepse u bë parti e klasës

së re borgjeze. Ndryshimi midis partisë komuniste dhe një partie borgjeze në udhëheqjen e shtetit nuk është «i vogël», por shumë i madh, i thellë, parimor, klasor që nuk mund të reduktohet në «rotacionin» e krerëve të tyre në pushtetin politik, siç pretendon ky renegat.

Me këto «teorizime» mbi «ndryshimin e vogël» të sistemit politik borgjez nga sistemi socialist dhe të partisë borgjeze nga partia marksiste-leniniste, revisionistët jugosllavë duan të thonë se rendja e tyre në drejtim të kapitalizmit nuk duhet t'u merret për ndonjë gjë të madhe. Është fare e qartë se revisionistët jugosllavë nuk mund të pasqyrojnë në teori pozita të ndryshme nga ato që kanë mbajtur në praktikë.

Duke llomotitur për «dobësitet e sistemit të një partie», pra duke dashur në këtë mënyrë të atakojnë ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit e të Stalinit, ai shkruan: «Në të paraqitet para së gjithash tendenca e bashkimit personal të kre-rëve të partisë me aparatin ekzekutiv shtetëror dhc, në këtë mënyrë, ai bëhet instrument i veprimit të tendencave teknoburokratike në shoqëri» (faqe 64).

Zotërinjtë revisionistë jugosllavë, «për t'i shpëtuar» këtij «teknoburokratizmi» dhe kësaj tendencë «të bashkimit personal të kre-rëve të partisë me aparatin ekzekutiv shtetëror të socializmit», që ua atribuojnë arbitrarisht bolshevikëve, kanë krijuar sistemin e tyre, që nuk është tjetër veçse një diktaturë e grupit titist. Në të ashtuquajturat kuvende të bashkësive vetadministruese dhc në aparatet e tyre ekzekutive, siç pohon vetë autori i librit, «... tash po paraqiten në mënyrë shumë të fuqishme tendencat buro-

kratiko-centriste» (faqe 232). Në Jugosllavi pushteti ekzekutiv manipulohet nga Titoja dhe nga klika e tij. Me gjithë sigurimet se gjoja nuk aspirojnë për pushtet, kryetari i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë është president i përjetshëm i shtetit jugosllav dhe të gjithë funksionarët me posë kyç në pushtet, ushtri, ekonomi, në politikën e jashtme, në kulturë, në organizatat shoqërore etj. mbajnë pozita të rëndësishme në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë. Tërë puna është se, ndërsa sulmojnë mësimet marksiste-leniniste mbi udhëheqjen e partisë proletare në shqërinë socialiste, revisionistët jugosllavë në praktikë përpilen të mbajnë fort në dorë frenat e pushtetit. E ashtuquajtura Presidencë e Jugosllavisë nuk u krijua atje për të sigruar udhëheqjen shtetërore kolegiale, as për të luftuar burokratizmin ku ajo është mbështetur, as për të mbrojtur shtetin jugosllav nga forcat sunduese jashtë tij, sikurse kemi dëgjuar të thuhet nganjëherë, por si një orvatje e dëshpëruar për të sigruar sundimin e titizmit pas vdekjes së Titos. Kjo tregon se jo vetëm në përmbajtje, por edhe në formë regjimi jugosllav s'është gjë tjetër veçse një pushtet kapitalist që shtyp popullin, duke u përpjekur të maskohet prapa sloganesh mashtruese.

Kardeli nuk mund ta fshijë atë periudhë të zezë në historinë e Jugosllavisë, kur, si pasojë e tradhtisë së udhëheqjes së Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe e vendosjes së diktaturës titiste, popujt e këtij vendi provuan në kurrit padrcjtësitë, dhunën e terrorin më të shfrenuar. Zëdhënësi titist, Kardeli, mundohet të kapërcejë errësirën me disa sloganë për t'u

mbushur mendjen popujve të Jugosllavisë që të mos ankohen për vuajtjet, pasi «Edhe revolucioni ynë socialist, në fazën e tij të parë, ka konstituar në një mënyrë të caktuar sistemin me një parti të demokratikë revolucionare, megjithëse kurrë në formën e tij «klasike» staliniste» (faqe 64-65). I marrtë të keqen ky renegat pa cipë «formës klasike staliniste», që ishte formë aq demokratike dhe socialiste, sa regjimi i Tito-Kardel-Rankoviçit jo vetëm nuk i afrohet gjëkundi, por është turp të krahasohet me të. Krimet e përbindshme në Jugosllavi nuk u kryen gjatë periudhës së miqësisë me Stalinin e me Bashkimin Sovjetik të kohës së tij, por pikërisht pas prishjes së kësaj miqësie dhe në kohën kur Jugosllavia mori hapur rrugën e vetadministrimit.

Aktualisht në Jugosllavi, sipas «teorisë» së Kardelit, qenka zhdukur «krejt» dhe «radikalisiert» bashkimi personal i organeve ekzekutive të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe i organeve ekzekutive të shtetit, sepse Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë nuk paska asnjë prerogativë për të realizuar pozitën e fuqisë udhëheqëse ideore e politike në shoqëri. Ajo ka vetëm atë rol që të ndikojë në masat.

Po si dhe për çfarë të ndikojë në masat kjo farë Lidhjeje, kur nuk ka asnjë prerogativë të udhëheqë? Për asgjë. Titoja, në një çast dëshpërimi, ka pohuar se «Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë është katan-disur në një organizatë amorfë, apolitike». Por Kardeli, që të mos u dalë boja fare titistëve, duke korrigjuar shefin e vjet, shkruan se gjoja «... Lidhja e Komunistëve është bërë një nga shtyllat më të fuqishme të de-

mokracisë së tipit të ri, — të demokracisë së pluralizmit të interesave vetëqeverisës» (faqe 65).

Në qoftë se vetadiministrimi jugosllav e ka zhveshur nga udhëheqja politike Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë, kuptohet se ky vetadiministrim vjetjeti i ka hequr rolin politik edhe klasës punëtore, për arsy se prerogativat e saj klasa punëtore mund t'i gjëzojë vëtëm nëpërmjet pararojës së vet, partisë komuniste. Në qoftë se pararojës së klasës i hiqen prerogativat udhëheqëse, është absurditet të pretendohet se klasa ushtron të drejtat që i takojnë. Në këto kushte, kuptohet, se si mund të «vetëqeverisin» në këtë farë demokracie «të tipit të ri» proletariati dhe masat e tjera punonjëse! Ja ç'thotë konkretisht për këtë çështje Kardeli: «Lidhja e Komunistëve nuk sundon me anë të monopolit politik, por se shpreh një formë specifike, por shumë të rëndësishme në pikëpamje shoqëroro-historike, të interesave të klasës punëtore, e me këtë edhe të interesave të të gjithë punonjësve dhe të shoqërisë — në sistemin e vëtëqeverisjes dhe të pushtetit të klasës punëtore dha të popullit punonjës, sistem që mbështetet në pluralizmin demokratik të interesave të subjekteve vëtëqeverisëse» (faqe 65-66).

Kjo frazeologji e fryrë dhe e ngatërruar s'tregon gjë tjetër veçse faktin e pakontestueshmë që partia në Jugosllavi është në bisht, se ajo ekziston vëtëm në kartë. Sido që formalisht mbron pozitën e forcimit të rolit të partisë, ashtu si e kupton ai këtë rol, prapë-serapë Kardeli nuk u ka shpëtuar dot pohimeve të tillë: «...Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë nuk është politikisht dhe në mënyrë krijuese nijaft e pra-

nishme... në tërë sistemin demokratik të vetëqeverisjes dhe në krijimin e politikës e të praktikës së organizatave të tjera shoqëroro-politike...» (faqe 263-264). Po atëherë ku është e pranishme Lidhja, kur s'qenka në drejtimet që duhej të ishte, kur në Jugosllavi, siç njoftoi kohët e fundit agjencia jugosllave e lajmeve TANJUG, dy të tretat e fshatrave nuk kanë fare organizata-bazë të Lidhjes së Komunistëve? Përgjigjen e mundimshme të kësaj pyetjeje nuk e jep dot Kardeli, por analiza konkrete e veprimtarisë praktike të saj na vërteton pa asnje dyshim se si «parti e komunistëve» nuk është e pranishme asgjékundi, ndërsa si parti e borgjezisë së re jugosllave dhe e diktaturës fashiste të Titos mund të ndodhët kudo.

Në këtë «socializëm vetadministruesh» jugosllav, që ka marrë përsipër ta trajtojë «teorikisht» Kardeli, Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë ka kurdoherë një pozitë specifike. Kjo pozitë specifike, që shikohet kudo në libër, mund të interpretohet si të duash, domethënë si pozitë specifike në edukimin e punonjësve, pozitë specifike në raport me proletariatin, pozitë specifike në të ashtuquajturin sistem të delegatëve, ku ajo nuk duhet të marrë pjesë dhe të drejtojë nga frika e «monopolit politik», e të tjera specifika. Kjo parti, me këto pozita specifike të pambarim, ka të drejtën që, në kuadrin e delegacionit të së ashtuquajturës Lidhje Socialiste të Popullit Punonjës të Jugosllavisë, të ketë delegacion të sajin në kuvende, me anë të të cilit bashkëpunon me delegacionet e tjera vetadministruese. Kjo tregon se Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë nuk ka asnjë fuqi të pavarur

politike dhe ka kohë që po shërben si një agjenturë e federalizmit anarkist jugosllav. Ajo ekziston për t'i dhënë satisfaksion kapitalit të huaj, që ka hedhur rrënë një në Jugosllavi, për ta sigruuar atë se vetadministri mi nuk e cenon sistemin e pronësisë private, se asnë parti, sido që të jetë, nuk do ta ndryshojë kursin e këtij shteti anarkosindikaliste.

Sipas E. Kardelit roli i individit në shoqëri është gjithçka, kurse klasa punëtore dhe partia e saj janë hiçgjë. Pararoja e klasës punëtore, sipas tij, nuk del të jetë partia marksiste-leniniste, por «bashkësitë vetë-qeverisëse», një organizim abstrakt ky, i sajuar për të treguar gjoja diçka të madhe, por që nuk ka kurr-farë jete të vërtetë. Klasa punëtore nga ky revizionist nuk përfytyrohet si klasa udhëheqëse e shoqërisë, por konfondohet me të gjithë punonjësit. I gjithë populli jugosllav, thotë ai, mund të quhet pararojë, natyrisht duke vënë në krye të kësaj «pararoje» njeriun, i cili «lirisht» (domethënë në mënyrë anarkiste) shpreh dhe realizon qëllimet e tij (në këtë shoqëri anarkiste). Nga këto arsyetime të Kardelit del qartë se klasa punëtore në Jugosllavi ka kohë që ka pushuar së vepruari e bashkuar, ajo e ka humbur rolin e klasës udhëheqëse në shoqërinë jugosllave. Duke i ikur nga duart partia dhe pushteti, klasa punëtore jugosllave jo vetëm nuk është në fuqi, por është vënë në pozitën e një klase që shfrytëzohet prej borgjezisë së re, e cila sundon mbi masat punonjëse nëpërmjet pushtetit shteleror që manipulon.

Për të shpëtuar ngaakuza se qëndrimi mohues ndaj rolit udhëheqës të partisë së klasës punëtore

është tradhti ndaj interesave të kësaj klase, tradhtari i njohur ka shkëputur nga «Manifesti i Partisë Komuniste» të Marksit dhe të Engelsit këto citate: «Komunistët nuk janë ndonjë parti e veçantë në krahasim me partitë e tjera punëtore», «ata nuk kanë kurrfarë interesash të veçuar nga interesat e tërë proletariatit», «ata nuk caktojnë kurrfarë parimesh të veçanta, në të cilat duan ta ngujojnë lëvizjen proleta». Me të tilla citate Kardeli do të krijojë përshtypjen sikur Marks dhe Engelsi paskan pasur mendimin se komunistët nuk kanë nevojë për parti të tyren, përderisa ajo nuk është një parti me karakteristika, interesa dhe parime të veçanta nga partitë e tjera punëtore. Çfarë renegati! Duke mos pasur asnjë fije ndërgjegjeje, ai e shikon proletariatin me syzet e antimarksistit socialdemokrat, si një masë amorfë që, gjoja, lufton për interesat e përgjithshëm, por që nuk ka asnjë param, asnjë drejtë klasor e revolucionar, asnjë program lufte si t'i fitojë të drejtat e tij!

Marks dhe Engelsi në kreun e dytë të veprës së komunizmit shkencor «Manifesti i Partisë Komuniste» kanë përcaktuar në mënyrë gjeniale misionin historik të partisë komuniste si pjesë e pandarë e klasës punëtore, si repart pararojë i saj etj., etj., por nuk kanë menduar kurrë që komunistët nuk duhet të kenë partinë e tyre. Përkundrazi, pikërisht që komunistët të kenë partinë e tyre, ata shkruan edhe Manifestin e kësaj partie, që është dokumenti i parë programatik shkencor i komunizmit.

## 5. — Pluralizimi politiko-ideologjik, «demokracia» dhe ndërtimi «socialist» në Jugosllavi

Me teorinë e tij Kardeli vë në plan të parë «pluralizmin e interesave të punonjësve» dhe në këtë pluralizëm thekson veçanërisht rolin e së ashtuquajturës Lidhje Socialiste të Popullit Punonjës që, sipas tij, është e aftë të bashkojë të gjitha fuqitë shoqërore, pa marrë parasysh diferençat në ideologji. Në të vërtetë «Lidhja Socialiste» është një shoqatë që ekziston vëtëm formalisht dhe nuk përfillet në Jugosllavi. Kjo e vërtetë i ka shpëtuar diku edhe Kardelit kur shkruan: «Besoj se nuk do ta teproj nëse them se nënçmimi i rolit shoqëror të Lidhjes Socialiste... është dukuri bukur e përhapur në Lidhjen e Komunistëve, madje jo vetëm në radhët e anëtarëve» (faqe 272-273). Duke bërë fjalë më tej për aktivitetin e kësaj «shoqate të të gjitha forcave të organizuara të shoqërisë», siç i thonë në Jugosllavi, Kardeli përsëri është i detyruar të përmendë formalizmin e saj, duke shkruar: «...Lidhja Socialiste problemet shpesh i zgjidh më shumë sa për sy e faqe, domethënë me rezoluta dhe deklarata, e më pak realisht...» (faqe 276). Mjaftojnë këto pohime, që Kardeli natyrisht i trajton thjesht si dobësi, për të provuar në mënyrë të pakontestueshme se ç'është kjo shoqatë pa shpirt.

Pluralizmi i «vetadministrimit socialist», sipas Kardelit shprehet në kuadrin e «Lidhjes Socialiste», që përbledhi në gjirin e vjet të gjitha tendencat «demokratike përparimtare» (të gjitha rrymat deri dhe

ato regressive), përfaqësuesit e të cilave kanë të drejtë të flasin e të vendosin për politikën e Jugosllavisë. Në realitet, përvçe klikës tiliste, askush tjetër nuk vendos në këtë front, që Kardeli e quan pluralizëm të interesave vëtadministruese, për të treguar se gjoja Jugosllavia nuk qenka për krijimin e shumë partive, por për një parti me kusht që kjo të mos jetë e vëtmja fuqi që të udhëheqë shoqërinë.

«Lidhja e Komunistëve e Jugosllavisë, thotë Kardeli, ka përgjegjësi të posaçme politike në shoqëri, të cilën — natyrisht — e ndan me të gjitha fuqitë e tjera socialiste shoqërore...» (faqe 74) dhe, për këtë arsyе të shpërndarjes së përgjegjësisë, në Jugosllavi ekzistoka «pluralizmi demokratik». Sipas tij del se «pluralizmi demokratik», pra jo pluralizmi i shumë partive, por pluralizmi në kuadrin e «Lidhjes Socialiste», që ruan edhe sistemin e një partie, është më i rekomandueshëm në Jugosllavi. Kjo ide, me fjalë të tjera, do të thotë se në kuadrin e së ashtuquajturës Lidhje Socialiste veprojnë «Lidhja e Komunistëve» edhe organizata të tjera «shoqërore politike», që «...janë krijesa të pavarura... në të cilat Lidhja e Komunistëve merr pjesë dhe bashkëpunon si pjesë e tyre përbërëse...» (faqe 207).

Pa u zgjatur mund të themi se ky «pluralizëm», sido që të quhet «pluralizëm demokratik» ose «pluralizëm i interesave të punonjësve», ose ndonjë lloj tjetër, në të vërtetë, ndryshon vetëm formalisht nga pluralizmi borgjez. Në qoftë se në shtetin kapitalist ka shumë parti, që veprojnë dhe ndikojnë në parlament, duke shprerur interesat e shtresave kryesore të bor-

gjecisë ose të ndonjë klase tjetër, edhe në Jugosllavi veprojnë gjithashtu Lidhja e Komunistëve dhe lidhje të tjera që nuk quhen parti, por organizata shoqërore-politike, të cilat përpinqen të shprehin interesat e borgjezisë së vogël, të aristokracisë punëtore etj., etj. dhe t'i mbrojnë këta interesa në shtetin kapitalist jugosllav. Për këto arsyе konkluzioni i revisionistëve jugosllavë se «sistemi ynë politik jo vetëm që nuk është sistem me një parti, por ai e përjashton sistemin e këtillë, sikurse e përjashton edhe pluralizmin e shumë partive të shoqërisë borgjeze» është një absurditet, një tezë e huajtur nga anarkistët e anarkosindikalistët, kundër të cilëve kanë luftuar ashpër Marks, Engels, Lenin dhe Stalini.

Teoria e mbrojtur nga Kardeli mbi «pluralizmin politik» do t'u vijë për shtat edhe Hua Kuo Fenit e Ten Hsiao Pinit lidhur me barazinë e të drejtave të partive të ndryshme në shtetin socialist, me kontrollin reciprok të tyre etj.

Duke shkruar me mburrje për drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetadministrimit socialist, Kardeli, për të mos e tepruar jashtë masës, nuk mund të mos pohojë se ka edhe ekzagjerime, ka edhe gabime, ka edhe të meta, sepse «në shumë sfera marrëdhëniet e reja ende nuk janë duke jetuar, as duke funksionuar në një mënyrë të kënaqshme» (faqe 26). Por edhe sikur të mos e pohonte ai, realiteti jugosllav provon çdo ditë se vetadministrimi çshtë futur në një rrugë pa krye, prandaj deklaratat e tij ngushëlluese për ta cilësuar vetadministrimin «sistemin më të kualifikuar socialist», nuk mund të besohen nga ata që e

njohin nga afër Jugosllavinë dhe sistemin e saj politik.

Sistemi politik i vetadministrimit në Jugosllavi është një maskim i pacipë i tradhtisë revisioniste ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj socializmit shkencor dhe komunizmit. Titistët jugosllavë, si antimarksistë, nuk kanë qenë dhe nuk janë për ndërtimin e socializmit, por për përjetësimin e kapitalizmit në forma të ndryshme. Ata përpinqen të sajognë «teori» nga më të ndryshmet me qëllim që procesi i kalbëzimit të rendit shoqëror kapitalist, meqenëse nuk mund të ndalet, të paktën të ngadalësohet. Për revisionistët jugosllavë socializmin mund ta ndërtojë çdo popull dhe çdo shtet pa u mbështetur në ligje e në parime të përgjithshme, pa ideologjinë marksiste-leniniste. Ata nuk pranojnë që socializmi të jetë një sistem i vetëm ekonomiko-shoqëror, por pretendojnë se mund të ekzistojnë lloje të ndryshme të socializmit. Duke abuzuar dhe duke shtrembëruar tezën e drejtë marksiste-leniniste të zbatimit në mënyrë krijuese të ideologjisë së klasës punëtore në kushtet e veçanta të çdo vendi, ata ngulin këmbë se për ndërtimin e socializmit nuk ekzistojnë ligje të përgjithshme për të gjitha vendet, por çdo vend, sipas dëshirës dhe mënyrës së tij, mund të ndërtojë një «socializëm» të ndryshëm nga të tjerët.

E vërteta është se për ndërtimin socialist kërkohet të mbahen parasysh doemos kushtet konkrete të çdo vendi, por socializmi në çdo vend mund të ndërtohet vetëm në bazë të marksizëm-leninizmit, në bazë të ligjeve e të parimeve të përbashkëta për të gjitha vendet, të cilave nuk mund t'u shmangesh në qoftë se

nuk dëshiron të përsundosh në kapitalizëm, si Jugosllavia.

Për të «argumentuar» tezën se çdo vend duhet të ndërlojë socializmin e tij specifik, revisionistët jugosllavë thonë, nëpërmjet Kardelit, se «vetadministrimi socialist, nuk mund t'u imponohet, për shembull, demokrative borgjeze të Evropës ose demokracisë amerikane», për arsyen se ato nuk i paskan arritur kushtet që ka arritur Jugosllavia. Në socializëm, sipas tyre, mund të shkohet dhe me pluralizmin politik të sistemit parlamentar perëndimor, por edhe pa një pluralizëm të tillë. Pra çdo vend, pa u mbështetur në asnjë eksperiencë, bile as në teorinë e socializmit shkencor të Marksit dhe të Engelsit, mund të ndërtojë socializmin e tij specifik. Megjithëkëtë, ata, duke e paraqitur vetadministrimin si sistemin më të mirë mbi dhe, mendojnë se ky sistem, pavarësisht nga rruga specifike që ndjek sëcili vend për ndërtimin e socializmit, mund të adoptohet e të zbatohet në shkallë ndërkombejtare!

I prirur nga subjektivizmi i tij dhe nga pasioni i shfrenuar kundër ekspericencës së ndërtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit e të Stalinit, Kardeli shfryr aq këq kundër kësaj eksperience dhe e humbet aq shumë ekuilibrin në gjykim, sa e quan proces reaksionar dhe të barabartë me pluralizmin politik të tipit evropian. Ja si shprehet ai: «Prandaj, tentativat që, për shembull, pluralizmi specifik politik i tipit evropian të imponohet atje ku nuk ekzistonë kushtet as kurrrfarë nevoje për një sistem të tillë, në të vërtetë kanë rol të njëjtë reaksionar

në proceset bashkëkohore shoqërore sikurse kanë edhe tentativat që ka ky apo ai «model» i socializmit t'u imponohet atyre vendeve që nuk kanë as kushte as nevojë për «model» të tillë» (saqe 49).

Tërë kjo tiradë nuk është gjë tjelër veçse lojë fjalësh, që ka vetëm një qëllim: të hedhë poshtë marksizëm-leninizmin dhe ligjet e përgjithshme të ndërtimit të shoqërisë socialistë, të mashtrojë masat dhe të përjetësojë sistemin kapitalist duke i vënë atij bojëra të ndryshme «socialiste». Kjo është arsyja që në cergën me titull: «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetadministrimit socialist» asnjëherë ai nuk bën fjalë për shkatërrimin e vërtetë të pushtetit të kapitalit.

Sipas këtij «ideologu të madh» jugosllav, ndërsa pluralizmi politik i parlamentarizmit borgjez është një sistem i tillë që e shndërron individin në një «qytetar politik abstrakt», e bën pasiv dhe e pengon këtë të jetë një eksponent i interesave konkretë të caktuar njerëzorë ose shoqërorë, në Jugosllavi, përkundrazi, qytetari nuk paska rrezik të shndërrohet në «qytetar politik abstrakt», sepse vetadministrimi e mësoka atë të mbrojë në radhë të parë interesat e tij konkrctë! Edhe kjo tezë, ashtu si tezat e tjera të Kardelit, është larg së vërtetës. Qytetari «i politizuar» i tij në vendet kapitaliste nuk qëndron me duar lidhur. Në këto vende atij vërtet ia kanë mohuar të drejtat, ligjet e kapitalit vërtet kanë mbyllur shtigjet për mbrojtjen e interesave të njeriut punonjës, por megjithatë punëtorët përpiken dhe luftojnë që të këputin prangat e skllavërisë kapitaliste. Mohimi i kësaj lufte që bën

klasa punëtore në kapitalizëm është kundër faktave.

Në rendin shoqëror kapitalist jo të gjithë njerëzit u binden politikës dhe normave të moralit borgjcz. Përkundrazi, shumica dërrmuese e pjesëtarëve të shoqërisë kapitaliste — proletariati dhe masat e tjera punonjëse të shtypura e të shfrytëzuara — jo vetëm nuk u binden politikës dhe moralit borgjez, por u kundërvihen dhe i kundërshtojnë në shumë forma e me shumë mjete. Kardeli nuk mund të mos i ketë dëgjuar këto, por ai shtrembëron faktet për të pohuar se gjoja në «socializmin specifik» të tij individi, njeriu, qytetari zë vendin kryesor dhe nuk «politizohet» nga partia, se ky individ konkret në sistemin politik të vetadministrimit, dhe vetëm në këtë sistem, mund t'i mbrojë fare lehtë interesat e tij konkretë! Po të jemi konsekuentë dhe të arsyetojmë gjer në fund sipas logjikës së Kardelit, atëherë duhet të pranojmë absurditetin që mbi 1 milion të papunë, të cilët numërohen në Jugosllavi dhe vuajnë nga uria, e kanë pësuar këtë fat jo nga faji i sistemit të «vetëqeverisjes», por nga vetë neglizhenca e tyre, sepse nuk paskan dashur të mbrojnë interesin konkret! Në Jugosllavinë «socialiste vetadministruese» punonjësit i kanë çarmatosur politikisht deri në atë shkallë saqë s'janë në gjendje të mbrojnë edhe të drejtat e tyre më të përgjithshme. Shumica dërrmuese e tyre janë kthyer me të vërtetë në njerëz të tillë që s'kanë tjetër merak veçse si të ruajnë vendin e punës, ose si të gjejnë një punë, kur s'e kanë, si t'c sigurojnë brenda ose jashtë vendit mjetet për të jetuar. Në të vërtetë shumë pak nga punonjësit interesohen q'është ky «sistem vetadministrues», q'është

«puna e bashkuar», ç'është «pluralizmi demokratik» etj. Ky është edhe një nga synimet e titistëve, që me shpikjen e «socializmit vetadministruar», punonjësit të marrin sa më pak pjesë në mbrojtjen e të drejtave të tyre, që ata të interesohen sa më pak për politikë, që ata të shohin vetëm interesin e tyre të ngushtë vetjak dhe t'i lënë mënjanë interesat e përbashkët klasorë.

Në sistemin e parlamentarizmit borgjez, sipas Kardelit, klasa punëtore «politizohet» në mënyrë të paevitueshme, sepse vetë sindikalizmi dhe lufta sindikale nuk i sigurojnë asaj rrugë drejt pushtetit politik. Më tej ai ka shkruar se një «polizim» i tillë e ndan klasën punëtore në parti dhe kështu, sipas tij, krijohet rreziku i ri, që «burokracia e partisë» të fillojë të veprojë në emër të klasës.

Eshtë e vërtetë se lufta në kuadrin e sindikalizmit nuk i siguron klasës punëtore pushtetin politik në vendet kapitaliste, prandaj punëtorët organizohen në parti politike për të mbrojtur interesat e klasës së tyre. Por Kardeli nuk e ka hallin të demaskojë sindikalizmin, as partitë e ndryshme «punëtore» që krijohen në Perëndim, me të cilat revizionistët jugosllavë janë në aleancë. Ai do të tregojë se që nga parlamentarizmi borgjez dhe partitë borgjeze e deri te partitë e tjera, komuniste, revizioniste dhe sindikatat, të gjitha njësoj e përqajnë punëtorin, prandaj, sipas tij, këto parti duhen likuiduar. Borgjezisë dhe revizionistëve nuk u prishet qejfi nga ky qëndrim i mikut të tyre, se ata e kuptojnë mirë që Kardeli e ka fjalën vetëm për likuidimin e partive të vërteta marksiste-leniniste,

kurse partitë e tjera, të borgjezisë, edhe mund të ekzistojnë, pasi këto parti, si atëherë kur ka një ose dy, edhe kur ka shumë, nuk bëhen pengesë në transformimin e rendit kapitalist në «rend socialist»!

Nuk duhet çuditur pse Kardeli shkruan tjetër gjë «në teori» për çështje që janë krejt ndryshe në praktikë. Me teorizimet që tjerr, sharlatani fsheh manipulimet e shumta që janë bërë në Jugosllavi për ta transformuar në shoqëri kapitaliste atë shoqëri që fillimisht, sa për t'u maskuar, kishte marrë njëfarë orientimi gjoja socialist. Megjithëse për shkak të pozitës që mbron, Kardeli nuk është dhe nuk mund të jetë konsekuent, në fakt ai është për sistemin parlamentar borgjez, të cilin ia do puna ta paraqesë në letër si të ndryshëm nga sistemi «specifik» jugosllav. Inkonsekuenca e tij vihet re kur ai nuk e hedh plotësisht poshtë atë sistem, por e quan demokratik, ku «...klasa punëtore dhe të gjitha fuqitë e tjera demokratike kryejnë rol të rëndësishëm progresiv historik kur luftojnë për forcimin e pozitës shoqërore të parlamentit dhe për zgjerimin e kompetencave të tij në krahasim me forcat e pushtetit jashtëparlamentar» (faqe 55).

Këto «teorizime» të Kardelit nuk synojnë aspak të demaskojnë tendencat që vihen re sot në zhvillimin e shtetit kapitalist, ku pushteti ekzekutiv (qeveria) zgjeron sa vjen e më shumë kompetencat e tij në kurriz të pushtetit legjislativ (parlamentit), duke përgatitur kështu kushtet për kalimin në vendosjen e fasizmit, kur borgjezia monopoliste ta shikojë këtë vendosje të domosdoshme. Ai nuk shqetësohet aspak nga rreziku i fashistizimit që kanos sot shumë shtete

kapitaliste, sepse edhe shteti i tij është në të njëjtën rrugë, prandaj kërkon që klasa punëtore të mos e kryejë misionin e saj historik duke përmbysur me revolucion pushtetin e borgjezisë, ashtu siç mësojnë Marksit e Lenini. Duke shkruar në favor të parlamentarizmit borgjez, pa dashur ai zbulon se titistëve në këtë drejtim u bëhen presione të forta, sidomos nga kapitali i madh amerikan dhe evropiano-perëndimor, që kanë investuar në Jugosllavi. Këto presione bëhen për të zhvilluar në Jugosllavi demokracinë borgjeze në shkallë më të gjerë, pra që të krijohen atje shumë parti: socialdemokrate, revizioniste, «komuniste» etj. Mirëpo, sido që revizionistët jugosllavë nuk janë kundër sistemit parlamentar me shumë parti, prapëseprapë, ata nuk duan të prishin atë sistem të tyre me një parti, që e kanë propaganduar si «vetëqeverisës», jo vetëm për arsy se kjo do t'i demaskonte, por më tepër nga frika e rrezikut që mund të krijohej për monopolin e titistëve në gjithë punët shtetërore, në ushtri, në UDB e në organizmat e tjerë shtypës, si edhe në organizmat mashtrues të përpunimit borgjez të njerëzve.

Kardeli, në të vërtetë, nuk e hedh poshtë atë që ai e quan «monopol politik» në qeverisjen e shoqërisës dhe për të cilin deklaron se është ruajtur si privilegji i krerëve të partive politike dhe i organeve ekzekutive të demokracisë borgjeze. Domethënë nuk hedh poshtë sistemin parlamentar dhe atë jashtëparlamentar, por shprehet kundër «mbeturinave të këlij sistemi» që paska trashëguar socializmi në fazat dhe në format e tij fillestare.

Kuptohet se Kardeli, pa e goditur formën e parlamentarizmit borgjez, kërkon ta ballafaqojë atë me organet shtetërore të shoqërisë së vërtetë socialiste. Këto idc duken edhe më qartë akoma kur ai shprehet se në kushtet kur janë të nacionalizuara mjetet e prodhimit, parlamenti pa «vctëqeverisje» të punëtorëve do të ishte njësoj sikurse edhe sistemi politik me një parti i socializmit, i bazuar në «formën etatiste të pronës shoqërore». Me sistem politik «në formën etatiste të pronës shoqërore» Kardeli ka parasysh pushtetin tonë të këshillave popullore, si edhe pushtetin sovjetik që vendosi Lenini në Bashkimin Sovjetik për të ndërtuar shoqërinë e re socialiste nён udhëheqjen e Partisë Bolshevikke.

Duke mohuar qëllimet e Revolucionit të Tetorit dhe punën e madhe që është bërë në Bashkimin Sovjetik disa vjet me radhë për ndërtimin e socializmit nён udhëheqjen e Leninit e më pas të Stalinit, revisionisti Kardel do të vërtetojë se gjoja Jugosllavia, e cila ka likuiduar pronën shoqërore «etatiste» dhe e ka kthyer në «pronë të shoqërizuar», nuk paska tradhtuar, sic e akuzojnë, por paska shpikur me të vërtetë një shtet «socialist», një «socializëm vetadministrues», që ndonëse «teorikisht» nuk e rekomandon për të gjithë, ia do zemra që të tërë ta ndjekin në praktikë.

«Sistemi i një partie» në Jugosllavi, sipas Kardelit, aktualisht nuk i përgjigjet më variantit të «socializmit specifik». Ai qe imponuar në fillim për arsyen të zhvilimit të revolucionit socialist, si element i strukturës fillestare të diktaturës së proletariatit, kurse tani cilësohen «... i papajtueshmë me marrëdhëniet shoqëro-

re-ekonomike dhe demokratike të vetëqverisjes socialiste dhe me pluralizmin e saj demokratik të interesave vetëqverisës» (faqe 63).

Me sistemin e sundimit shumëpartish të shoqërisë borgjeze revisionistët jugosllavë hiqen sikur s'janë dakord, por edhe udhëheqjen e shtetit e të shoqërisë nga një parti e vëlme politike e klasës punëtore ata nuk duan ta pranojnë, prandaj hiqen sikur kanë gjetur «të mesmen e artë», të ashtuquajturin «pluralizëm demokratik». E vërteta është se në sistemin e «vëlqe-verisjes» jugosllave ruhen edhe elemente të «sistemit me një parti», edhe elemente të «sistemit me shumë parti». Por ky sistem i çoroditur s'është gjë tjetër veçse një sistem kapitalist, një pjellë e shëmtuar e borgjezisë jugosllave për të sunduar masat punonjëse dhe për t'u maskuar me një fasadë «marksiste».

Për të njollosur Leninin dhe Stalinin, autori titist kërkon t'i ballafaqojë me njëri-tjetrin këta udhëheqës të mëdhenj të proletariatit botëror, «për të vërtetuar» se gjoja ata nuk paskan pasur koncepte të njëllojta mbi sistemin politik të shtetit socialist. Dhe ja si shpif: «Ndërmjet konceptit të Leninit dhe atij të Stalinit lidhur me sistemin politik të shtetit socialist ka ekzistuar një mospajtim i madh. Bazë dhe esencë e konceptit të Leninit lidhur me pushtetin e sovjetëve është demokracia e drejtëpërdrejtë...» (faqe 67).

Është botërisht e njojur se Stalini ka qenë një nxënës i zellshëm, një shok besnik dhe një bashkëpunëtor shumë i afërt i Leninit. Gjer më sot, përvèç armiqve, askush nuk ka guxuar t'ia kundërvërë Stalinin Leninit. Këto insinuata bëhen me qëllime armiqë-

sore, por lëvizja komuniste dhe punëtore ndërkombe-tare është mësuar me manovrat e revisionistëve, të cilët një herë deklaruan se ishin marksistë-leninistë, por «jostalinistë», tani orvaten të vënë Leninin kundër Marksit dhe diskutojnë nëse duhet të jenë vetëm «marksistë» apo edhe «leninistë». Kurse nesër, duke hequr krejtësisht maskat prej renegatësh e tradhtarësh, me siguri do të thonë se nuk janë as me Marksin. Do të sajognë për këtë edhe «teoritë» adekuate, të cilat mund të jenë gjithçka, por jokomuniste, joproletare.

Lenini ka folur si marksist i vërtctë për demokracinë socialiste, për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të masave punonjëse në qeverisjen e vendit dhe këto ide revolucionare ai i vuri në zbatim për disa vjet që qëndroi në udhëheqje të shtetit sovjetik. Pas tij Stalini vazhdoi të njëjtën rrugë. Por Lenini me demokraci sociale dhe me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të masave në qeverisje nuk kuptonte aspak dobësimin e shtetit të diktaturës së proletariatit e të rolit udhëheqës të Partisë Bolshevikke. Ai nuk ia ka kundërvënë asnjëherë demokracisë së vërtctë diktaturën e proletariatit, të cilën e ka përcaktuar si

*«...shtet demokratik në mënyrë të re (për proletarët dhe të varfrit në përgjithësi) dhe shtet diktatorial në mënyrë të re (kundër borgjezisë)»<sup>1</sup>.*

Këtej del mjaft evidente se Lenini nuk ka qenë dhe

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vell. 25, f. 483.

nuk mund të ishte kurri për zëvendësimin e diktaturës së proletariatit me këtë sistem vetadministruar, që sajuan revizionistët jugosllavë për t'u rikthyer në kapitalizëm.

Në kohën e Leninit e të Stalinit, në Bashkimin Sovjetik ishte në fuqi klasa punëtore, e cila nëpërmjet partisë së saj ka udhëhequr, drejtuar, planifikuar dhe zbatuar me sukses detyrat e ndërtimit të socializmit. Në Jugosllavi nuk e kanë përfillur fare rolin e madh të shitetit socialist, që ata e kanë identifikuar me të ashtuquajturin «sistem të delegatëve», i cili, siç pohon edhe Kardeli ka «...dobësi serioze në të gjitha drejtimet e funksionimit të tij» (faqe 213).

Edhe vetë Kardeli e kupton se referimi te Lenini për demokracinë nuk mund t'i shërbejë atij për të justifikuar sadopak vetadministrimin, prandaj me sofizma përpigjet t'u mbushë mendjen njerëzve se mendimi i Leninit «...nuk është përpunuar deri në konsekuencat e tij faktike... por është e qartë se esenca e tij është pikërisht demokracia e drejtëpërdrejtë, domethënë vetëqeverisja» (faqe 67). Kardeli «filozofon» dhe mungesën e argumenteve kërkon ta plotësojë me interpretime arbitrarë, fantastike, si i do qejfi atij. Ai kërkon t'u mbushë mendjen të tjerëve se Lenini e filloj mirë, por pastaj nuk pati rast ta zhvillonte më tej idenë e vetadministrimit, ashtu si do t'ua donte oreksi Titos dhe atij. Mendimi i shprehur nga Lenini, sipas të cilët proletariati do të udhëheqë, do të organizojë, do të drejtojë pushtetin e sovjetëve dhe do të qeverisë vendin nëpërmjet partisë së vet, ka qenë dhe është bazë e teorisë marksiste-leniniste. Pikërisht kësaj çështjeje thel-

bësore, me rëndësi teorike dhe praktike, titistët i shmangen dhe këtë devijim duan ta maskojnë, duke shtrem-bëruar tezat e drejta të Leninit.

Stalini, sipas titistëve, «... u përcaktua për një koncept të demokracisë indirekte, domethënë, në esencë përvetësoi sistemin klasik politik të shtetit borgjez dhe pluralizmin e tij politik, mirëpo i dha një partie atë rol, të cilin e ka sistemi me shumë parti në shtetin parlamentar borgjez» (faqe 68). Ata thonë se Stalini qenka larguar nga konceptet leniniste, pasi paska zbatuar një «demokraci indirekte», duke e drejtuar shtetin nëpër-injet një partie e cila u përnga jiste shumë partive borgjeze dhe aparenca e të sistemit parlamentar. Kjo është kritika «dërrmucse» që ky pseudomarksist u bën veprimtarisë dhe veprës së Josif Stalinit! Stalini, ashtu si Lenini, e ka parë demokracinë në prizmin klasor, si formë organizimi politik të shoqërisë, si një kusht politik për tërheqjen e masave në qeverisjen e vendit, për mbrojtjen dhe forcimin e diktaturës së proletariatit, për t'i prerë rrugën degjenerimit revisionist dhe restaurimit të kapitalizmit. Stalini, si marksist-leninist që ishte, me të drejtë ka qenë rreptësisht kundër kuptimeve të njëanshme, liberale dhe anarkiste të demokracisë dhe ka mbajtur qëndrim ndaj shthurjeve e spekulimeve mikroborgjeze mbi të drejtat dhe liritë që si-guron demokracia proleta. Dhe shumë mirë ka bërë. Revisionistët, përkundrazi, duan ta shndërrojnë edhe një teori, ashtu siç e kanë shndërruar në praktikë, demokracinë proleta në një demokraci borgjeze. Ja përsë ata janë kundër Stalinit.

Kritika kundër sistemit të vërtetë socialist nga

pseudomarksistët jugosllavë përligjet me pretekstin se gjoja aktualisht paskan ndryshuar nocionet «punëtor» dhe «klasë punëtore», se janë bërë ndryshime edhe në kuptimin e nocionit «qytctar». Sipas tyre «klasa punëtore» është bërë subjekt abstrakt politik, i cili nuk ushtron pushtet, por në emër të të cilit mund të ushtrohet pushteti». Pra, kjo do të thotë se në sistemin e vërtetë socialist nuk qenka klasa punëtore ajo që ushtron pushtetin, por është dikush tjetër që, në emër të saj, vepron mbi klasën. Ky është një mashtrim i madh, është një shtrembërim i paturpshëm i realitetit. Kësaj i thonë të qëndrosh në pozitat filozofike të idealizmit dhe të marrësh për të vërtetë jo atë që ekziston objektivisht, por atë që është në mendjen tënde.

Që këtej revizionisti Kardel del me idenë se punëtori, në marrëdhëni e prodhimit të rendit socialist, në marrëdhëni e tij me punëtorët e tjerë, në pozitën e tij shoqërore etj., etj., nuk vlen konkretisht asgjë! Dhe, sipas tij, kështu u krijoka «... dogmatizmi i pronës shoqërore si pronë shtetërore, e me këtë edhe domosdoshmëria e shtetit të centralizuar, e rolit udhëheqës të aparatit shtetëror dhe partiak..., kurse interesat klasorë dhe aspiratat e punëtorit konkret... diskreditohen, respektivisht kualifikohen si veprim jashtë ligjshëmërive të përgjithshme...» (faqe 70).

Ja, si i deformon Kardeli sistemin e vërtetë socialist dhe marrëdhëni e socialiste në prodhim të kohës së Leninit e të Stalinit dhe, rrjedhimisht, edhe ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Duke folur kundër centralizmit demokratik, rolit udhëheqës të partisë, formës shtetërore të pronësisë sociale etj., ai do të tregojë

«superioritetin» e sistemit të vetadministrimit, por në të vërtetë demaskon vetveten, duke dalë hapur në kundërshtim me idetë e pavdekshme të klasikëve të mark-sizëm-leninizmit për këto probleme kapitale. Në fakt, këto «akuza» që bën ai kundër nesh, kthehen në pohime kundër sistemit politik të vetadministrimit jugosllav. Realiteti jugosllav provon çdo ditë tani, dhe do të provojë akoma më mirë nesër, se ku i shpie Jugosllavinë, popujt e saj dhe klasën punëtore klika e Titos dhe e Kardelit.

Titistët thonë se sistemi i tyre është «vetadministrues». Po cilët janë ata që qeverisen vetë në Jugosllavi? Punëtorët apo fshatarët? As punëtorët as fshatarët. Këta janë aq të shtypur sa edhe shokët e tyre në vendet kapitaliste. Në sistemin vetadministrues sundojnë ata që janë në majë të piramidës, borgjezët e rinj, që i kanë hipur në kurri zullit duke përdorur etiketën e «komunistëve», por që në realitet nuk janë tjetër, veçse teknokratë borgjezë që drejtojnë pushtetin burokratik, etatist, fashist. Nga të tillë elementë përbëhen «kuvendet e delegatëve», organet shtetërore ekzekutive në sistemin e delegatëve etj.

Në sistemin e diktaturës së proletariatit, siç dihet, zënë një pozitë të veçantë dhe luajnë një rol të rëndësishëm organizatat e masave. Këto janë leva, nëpërmjet të cilave partia lidhet me masat dhe realizon sundimin politik të klasës punëtore dhe demokracinë socialiste. Organizatat shoqërore në socializëm janë përgjese të vijës së partisë proletare në masat, janë armë të fuqishme të revolucionit e të ndërtimit socialist, janë tribuna luftarakë, ku shpërthen mendimi populor.

Ato kanë për detyrë t'i edukojnë masat dhe t'i bëjnë të ndërgjegjshme e të afta që të marrin pjesë gjallërisht në ndërtimin socialist dhe në qeverisje.

Detyrat që u takojnë, si pjesë përbërëse të sistemit të diktaturës së proletariatit, këto organizata i kryejnë nën udhëheqjen e partisë së klasës punëtore, në kuadrin e veçorive të veta, të specifikave që kanë.

Organizatat shoqërore nuk mund të veprojnë të izoluara nga partia proletare, nga organizatat e tjera dhe nga shteti socialist. Po të pranohej e kundërta, atëherë teorikisht nuk do të kishte kuptim që këto të ishin elemente të një sistemi të vetëm dhe në praktikë do të shndërroheshin në organizma të vdekur, që nuk do të kishin asnjë qëllim dhe nuk do të kryenin asnjë detyrë në dobi të rendit shoqëror socialist.

Në Jugosllavi, ashtu si partinë dhe shtetin, edhe organizatat e masave i kanë trajtuar dhe vlerësuar nga pozita fund e krye anarkiste. Atje, në kundërshtim me idenë e Leninit se organizatat e masave janë:

*«... bashkëpunëtorët më të afërt dhe të domosdoshëm të pushtetit shtetëror...»<sup>1</sup>,*

është përkrahur ideja se bashkëpunimi i këtyre organizatave me shtetin socialist është një formë «etatizmi burokratik». Bile revisionistët jugosllavë i përfytyrojnë këto organizata në mënyrë të tillë që secila mund të projë e pavarur edhe nga partia. «Ne — thotë Kardeli — e kemi braktisur ka kohë botëkuptimin sipas të cilit

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 33, f. 202.

këto organiza<sup>ta</sup> janë i ashtuquajt<sup>ur</sup> transmision i Lidhjes së Komunistëve» (faqe 267). Këtu nuk është fjala aspak për atë që partia e vetme në Jugosllavi dhe shteti jugosllav, që janë në duart e borgjezisë, nuk kanë asnjë pushtet mbi këto organizata. Përkundrazi, titistët asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga manipulimi i masave nëpërmjet organizatave shoqërore, por pohimi i Kardelit e ka qëllimin gjetkë. Ai synon vetëm të minojë lidhjet e partive marksiste-leniniste me masat, kurse gjithë përvoja revolucionare tregon se lidhje të vërteta këto parti mund të krijojnë e të mbajnë vetëm me masat e organizuara në organizatat përkatëse të drejtuara nga partia proletare.

Dihet se me idenë mbi rolin udhëheqës të partisë marksiste-leniniste lidhet ngushtë ideja mbi ideologjinë e saj revolucionare, prandaj duke shkëputur organizat e masave nga kjo parti, do të thotë t'i shkëputësh ato nga ideologjia marksiste-leniniste dhe ta mbushësh boshllëkun me ideologjinë borgjeze revizioniste. Ky qëllim duket qartë kur Kardeli, duke folur për njeriun si anëtar i «Lidhjes Socialiste», ka shkruar: «... nuk është e thënë që pikëpamjet e tij ideologjike të janë gjithmonë dhe në çdo sferë në pajtim me ideologjinë e marksizmit...» (faqe 280). Kjo do të thotë që punonjësi jugosllav mund të udhëhiqet nga ide e botëkuptime borgjeze, feudale, fashiste etj., etj., duke pasur në këtë konfuzion ideologjik edhe përkrahjen e regjimit.

Fakti që organizatat e masave janë pjesë përbërëse të sistemit të diktaturës së proletariatit, nuk do të thotë që ato, nën maskën e «demokracisë» e të dhënies

së disa kompetencave «shtetërore», siç është vepruar në Bashkimin Sovjetik revizionist, të shndërrohen në «ortake» apo «shtojca» të aparatit shtetëror. Duke iu përbajtjatur me besnikëri marksizëm-leninizmit, partia e vërtetë e klasës punëtore duhet të jetë e vëmendshme që roli i organizatave shoqërore të mos zbehet, por të vijë gjithnjë duke u forcuar. Në Jugosllavi, siç shkruan Kardeli, vërehet fenomeni që organizatat-bazë të sindikatave «...janë bisht i organeve punëdrejtuese...» (faqe 295). Kjo ka ndodhur se janë përcaktuar nga pozita të shërembra roli i organizatave shoqërore, vendi i tyre në shoqëri dhe marrëdhëniet që duhet të kenë ato me partinë e me shtetin.

Në librin e Kardelit flitet në mënyrë të veçantë edhe për «Lidhjen Socialiste të Popullit Punonjës», për sindikatat, për «Lidhjen e Rinisë Socialiste» etj., për të cilat mund të shkruhej dhe të polemizohej gjatë. Por këtu nuk u futëm në hollësira, duke e gjuquar se do të ishte më mirë të thëksoheshin vetëm devijimet parimore të revizionistëve jugosllavë lidhur me organizimin, qëllimet dhe veprimtarinë e organizatave të masave.

Qëndrim reaksionar mbajnë revizionistët jugosllavë edhe në lidhje me rolin e fesë e të ideologjisë së saj. Sikurse dihet, ideologja fetare u ka shërbyer kurdoherë klasave shfrytëzuese për të shtypur e për të shfrytëzuar masat punonjëse. Ajo ka qenë një mjet për të kultivuar te njerëzit ndjenjën e pafuqishmërisë përballë vuajtjeve, fatkeqësive dhe mjerimeve. Ideologja fetare i trulloj njerëzit dhe paralizon veprimtarinë e tyre për të transformuar natyrën dhe shoqërinë. Prandaj Mark-

si, siç dihet, e ka krahasuar fenë me opiumin. Ai shkruante:

«Feja është psherëtima e krijesës së shtypur, zemra e një bote pa zemër... Feja është opium për popullin»<sup>1</sup>.

Pikërisht për rolin reaksionar që luan feja, atë e kanë përkrahur dhe e përkrahin klasat sunduese. Gjuha e kapitalistëve, e revizionistëve dhe e klerikëve reaksionarë, në esencë, është një. Partia marksiste-leniniste nuk mund të pajtohet me ideologjinë fetare dhe me ndikimet e saj. Baza teorike e politikës dhe e programit të partisë së vërtetë të klasës punëtore është filozofia marksiste-leniniste dhe jo idealizmi e feja. Lufta klasseore për ndërtimin e socializmit nuk mund të shkëputet nga lufta kundër fesë.

Në Jugosllavi feja është vlerësuar dhe trajtuar pa asnjë ndryshim, sikurse në shtetet e tjera kapitaliste. Helmimi i masave me ideologjinë e fesë atje është konsideruar vetëm një çështje private e tyre dhe partia e shteti kanë bërë sehir, sepse për ta feja «... nuk është kurrrfarë pengese që njeriu-fetar të inkuadrohet në mënyrë të barabartë në jetën socialiste të shoqërisë» (faqe 178). Kuptohet se çfarë socializëm i bukur është ky kur ideologjia fetare nuk vjen aspak në kundërshrim me të dhe kur, siç shkruan Kardeli, «Për shumicën dërrmuese të punonjësve-fetarë socializmi është bërë çështje e bindjes së tyre më të thellë...» (faqe

1. K. Marks e F. Engels, «Mbi fenë», f. 43. Tiranë, 1979.

179-180). Tani po dëgjojmë nga ky «filozof i madh» që klerikët me bindje të thella idealiste e fetare qen-kan dashuruar edhe me socializmin, me rendin sho-qëror që mbështetet në filozofinë marksiste, në ma-terializmin dialektik dhe historik! Në qoftë se i lexoj-në këto fraza të renegatit titist, jo vetëm punëtorët, komunistët dhe çdo njeri i ndershëm në botë do të habiten, por edhe klerikët do të qeshin, sepse deri sot as atyre nuk u ka shkuar ndër mend të thonë se e duan socializmin, të cilin e kanë mallkuar dhe e mallkojnë me gjithë shpirt. Duke u pajtuar edhe me ideologjinë fetare kuptohet akoma më qartë sa «mar-ksistë» janë revizionistët jugosllavë, sa «materialiste» është ideologjia e tyre, rrjedhimisht sa socialist është sistemi politik i vetadministrimit, që mbështetet në këtë ideologji.

Partia e Punës e Shqipërisë, ka zbatuar me konse-kuencë doktrinën marksiste-leniniste mbi shtetin e dik-taturës së proletariatit dhe mbi demokracinë socialiste, mbi rolin udhëheqës e të pandarë të partisë së klasës punëtore dhe mbi domosdoshmërinë e zhvillimit të luftës së klasave. Realiteti ynë historik vërteton në më-nyrën më bindëse se, kur zbatohen ligjet e përgjith-shme të marksizëm-leninizmit, duke mbajtur parasysh veçoritë e vendit, revolucioni fiton dhe procesi i ndër-timit të shoqërisë socialiste nuk mund të ndalet. She-mbulli i Shqipërisë i hedh poshtë të gjitha «teorizimet» e filozofëve kapitalistë dhe revizionistë kundër diktaturës së proletariatit, rolit udhëheqës të Partisë dhe zhvillimit të luftës së klasave.

Fitoret tona të mëdha në frontin e ndërtimit socialist ne ia detyrojmë në radhë të parë besnikërisë ndaj marksizëm-leninizmit. Në qoftë se ne kemi fituar kurdoherë mbi armiqtë tanç, kjo ka ndodhur pikërisht se ne kemi qenë parimorë, të ndershëm e revolucionarë të guximshëm.

Pikërisht pse praktika e ndërtimit socialist në Shqipëri ka mishëruar teorinë marksiste-leniniste, ajo është bërë objekt sulmesh nga armiqtë e kësaj teorie dhe ka tërhequr mbi vete zjarrin e tyre.

Ne do të ndeshemi me guxim me kundërshtarët e ideologjisë sonç, sepse, kur çështë fjala për të mbrojtur parimet marksiste-leniniste, ne nuk mund të bëjmë pazarllëqe e kompromise prej matrapazësh, siç duan të na imponojnë kapitalistët dhe revisionistët.

Lufta midis marksistë-leninistëve dhe tradhtarëve të ideologjisë së proletariatit vazhdon e do të vazhdojë gjersa në botë të jetë zhdukur revizionizmi, që lind e zhvillohet si agjenturë e borgjezisë dhe e imperializmit. Është detyra jonë, si marksistë-leninistë, të mbrojmë botëkuptimin revolucionar të klasës punëtore. Në kushtet aktuale, kur revizionizmit të vjetër i është shtuar edhe revizionizmi kinez kjo detyrë është bërë edhe më imperitive. Zbatimi me sukses i kësaj detyre kërkon që t'i njohim, t'i analizojmë e t'i demaskojmë teoritë e praktikat antimarksiste kundërrevolucionare të armiqve, të cilët, nën parullën e «zhvillimit krijues të marksizmit» dhe të «luftës kundër dogmatizmit», sulmojnë në radhë të parë doktrinën marksiste mbi dikaturën e proletariatit dhe mbi partinë e tipit të ri.

Shoqëria socialiste forcohet në luftë me armiqtë

e saj, prandaj nc, komunistët, duhet t'i qëndrojmë ballë për ballë kësaj lufte gjec në arritjen e fitores. Në jemi revolucionarë dhe mbrojmë rendin ekonomiko-shoqëror socialist, që është rendi i ri e më i përparuar në botë, kurse revisionistët janë reaksionarë, sepse gjunjëzohen dhe kapitullojnë përpara rendit të vjetër borgjez. E ardhmja është e zyrtë për kundërshtarët tanë dhe e lumtur për nc. Por e ardhmja nuk vjen vetvetiu, ajo duhet përgatitur vazhdimesht e me kujdes, me luftë në fushat politike, ideologjike, ekonomike, të mbrojtjes etj.

Libri i Kardelit, si dhe shumë të tjerë, që batojnë borgjezia dhe revisionizmi ndërkombëtar për të propaganduar idetë e tyre reaksionare, antimarksiste dhe antileniniste, duhen demaskuar me qëllim që komunistët, punëtorët dhe njerëzit përparimtarë, që nuk e njohin realitetin revisionist ose e njohin atë nga larg, të mos mashtrohien nga sloganet «e majta». Për të forcuar vigjilencën, për të qenë në lartësinë e misionit që na përket si komunistë, ne duhet të kujtojmë konstatimin e madh të Leninit se

*«Njerëzit... kurdoherë do të jenë viktima naive të mashtimit dhe të vetëmashtimit në politikë derisa të mësohen që prapa frazave, deklaratave dhe premimeve të ndryshme morale, fetare, politike dhe sociale të shohin interesat e këtyre ose atyre klasave»<sup>1</sup>.*

## MË PARË SE TË VEPROHET, DUILLEN BËRË MIRË LLOGARITË

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**3 nëntor 1978**

Në këtë takim shokët Hekuran Isai e Prokop Murra informuan për disa probleme të bujqësisë, përkatësisht për rrethet e Gjirokastrës e të Dibrës, ku kishin qenë.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Në Gjirokastër u ngrit edhe çështja e standardit të misrit, të cilit, sipas tyre, duke qenë akoma ai i vitit 1965, i ka kaluar koha.

Negativisht për standardin e misrit ndikon dhe mostërheqja e tij në kohë nga shokët e grumbullimit. Punonjësit e këtij sektori i kanë mundësitet që t'i bëjnë misrit një shërbim më të mirë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po pse nuk e bëjnë këtë punë shokët e grumbullimit? Nuk kanë koçekë ata për ta grumbulluar në kohë misrin?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Shokët e grumbullimit nuk e tërheqin misrin nga kooperativat, sepse duan që ai të ketë jo më shumë se 27 për qind lagështirë.

Por, që të arrijë misri në këtë përqindje lagështire, ai duhet të thahet në kooperativë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ku ta thajnë kooperativistët misrin, në arë??

Të gjitha këto probleme duhet të zgjidhen menjëherë. Organet kompetente, që janë ngarkuar me këtë punë, si Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve duhet të marrin masat përkatëse që gjëra të tillë të mos bëhen pengesë në punën e kooperativistëve. Natyrisht, standardi i misrit edhe mund të ndërrohet, por pasi të merren të gjitha masat e tjera që ndikojnë për keq në këtë drejtim.

Që të dyja, si kooperativa bujqësore dhe ndërmarrja e grumbullimit duan që ta jepin e ta marrin të tërë sasinë e misrit të shkoqur. Por, edhe po të mos e jepin kështu të tërë sasinë, kanë leverdi, sepse përfitojnë koçanin, të cilin e bluanë miell dhe e përdorin si ushqim për lopët. Këtu lind edhe mosmarrëveshja midis tyre, jo ma jep misrin të shkoqur, jo nuk ta jep të shkoqur, jo ta marr, jo nuk ta marr etj. Nga ana e kooperativave, me sa duket, kjo gjë nuk kuptohet si duhet, prandaj ato nuk marrin masa për t'ia dorëzuar grumbullimit të shkoqur. Po ta bëjnë këtë punë ato, ka mundësi që ndërmarrja e grumbullimit të thotë: «nuk e dua të shkoqur», për arsyen se edhe ajo e do koçanin. Nga qëndrimet që mbahen konkretisht kuptohet që këtu nuk lusfohet për të siguruar koçanin, sepse kujtojnë që ky nuk vlen asnjë grosh. Siç u thas edhe këtu, ato përpilen vetëm që ta kenë punën e tyre sa më të lehtë, se, sigurisht, shkoqja e misrit ka

ca vështirësi. Prandaj edhe ndodh që kooperativa u thotë shokëve të grumbullimit që ta marrin misrin të pashkoqur, kurse këta të fundit nuk e pranojnë. Këto qëndrime janë të çuditshme. Po përcë bëhet gjithë kjo zhurmë? Për hiçgjë. Nuk duhet të harrojmë edhe faktin që po të grumbullohet e gjithë sasia e koçanëve të misrit atëherë bëhen me dhjetëra mijë tonë, gjë që ka rëndësi, sepse në këtë mënyrë sigurohet një bazë e mirë ushqimore për lopët.

Për të gjitha këto, unë do të isha për atë që koo-  
perativistët misrin ta dorëzojnë të shkoqur.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Tani misri mund të shkoqet shpejt se ka edhe makineri për këtë punë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** More, po edhe sikur me dorë ta shkoqin mirë do të bëjnë, dhe ta mbajnë vetë koçanin. Mundet që ata, hëpërhc, të mos kenë makina që ta bluajnë koçanin për silazh, por fare mirë atë mund ta përdorin edhe për ngrohje, në vend të druve të zjarrit, meqenëse në zonën e Dropullit, për shembull, për të cilën u fol këtu, ndihet mungesa e tyre. Atje drutë vijnë aq larg, kur i thonë një fjale, nga anë e anës, kështu që për t'i sjellë ato deri në fshatra, duhen automjete. Po t'i përdorin koçanët për djegie, do të harxhojnë më pak dru, kështu, një pjesë e automjeteve, në vend që të sjellin drutë, mund të përdoren për tërheqjen e misrit nga kooperativa në depon e grumbullimit. E dini ju se çfarë përdornin më përpara në Dropull për t'u ngrohur? Ashtu si edhe në zonat e tjera që nuk kishin pyje pranë, edhe këtu, në vend të druve, për ngrohje, përdornin bajgat e lo-  
pëve, të cilat i thanin në mure. Ndaj, po të shikoje

muret e shtëpive të fshatarëve të këtyre anëve, ishin të tëra të mbuluara me bajga. Pra, plehun e lopëve atje nuk e përdornin për të pasuruar tokën me ushqim. Ndoshta atyre as që u shkonte atëherë mendja për një gjë të tillë. Kjo ishte edhe një nga arsyet që fshatarët e asaj zone në të kaluarën, merrnin një rendiment të ulët prej 4 apo 5 kuintalë misër për hektar. Kurse sot bëhet fjalë për gjëra që mund të zgjidhen fare lehtë. Bile, ndërmarrja e grumbullimit duhet ta marrë misrin me çmim më të lartë, përderisa kooperativa ia dorëzon atë me gjithë koçan.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Puna është sa t'ia ndiejnë lezeten. Në Shkodër, asnjë kooperativë nuk e dorëzonte misrin të pashkoqur, sepse koçanin e grinin dhe miellin e tij e përdornin si ushqim për bagëtinë, kështu që kishin leverdi.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Natyrisht, kooperativat bujqësore kanë leverdi të madhe nga kjo punë.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Më bënë përshtypje fjalët e kryetarit të köshillit të një fshati, i cili tha se në fshatra kemi shokë të mirë që dallohen në të gjithë rrëthin dhe kanë autoritet në masa, si Riza Vehipi<sup>1</sup>.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Riza Vehipi është burrë i moshuar.

Këta kuadro që janë të moshuar, por që gëzojnë autoritet në popull, mund t'i aktivizosh për probleme të ndryshme. Prandaj duhen mbajtur afër dhe, herë pas here, duhen vënë në korent për problemet që da-

---

1. Veteran nga Picari i rrëthit të Gjirokastrës.

lin, se tani ata nuk mund t'i vësh në krye që të drejtojnë ose t'i zgjedhësh në instanca të ndryshme të pushtetit. Është tjetër punë kur të tillë kuadro janë të rind, se ata mund t'i ngresh në përgjegjësi. Por, kur është fjala për njerëz si Riza Vehipi apo shokë të tjerë si ai, nuk mund të pretendosh shumë prej tyre, për arsyе se janë të moshuar.

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Kur u ktheva për Tiranë, kalova nga bregdeti, për t'u takuar me shokun Hysni [Kapo], i cili ndodhej në Vlorë për zgjedhjet. Para takimit me zgjedhësit shoku Hysni kishte qenë shumë mirë. Paradite kishte marrë pjesë në inaugurimin e pallatit të sportit, kurse në mbrëmje, në takim me zgjedhësit, pasi foli dy orë, nuk ndihej aq mirë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ta merr mendja që të rrahirat e pulsit do të rriten po të flasësh dy orë. Thuaji sa të duash Hysniut, ai prapë vazhdon të lodhet shumë. Ka bërë gabim që ka folur dy orë në atë takim. Po kur do të kthehet Hysniu?

**SHOKU HEKURAN ISAI:** Do të qëndrojë deri të dielën.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, le të rrijë sot e nesër atje që të pushojë.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Unë kisha diçka për rrëthin e Dibrës lidhur me bujqësinë. Problem serioz atje është edhe ujitja. Ky rrëth sipas shifrave të planit, del sikur ujit 70 për qind të sipërsfares së tokës arë, kurse në fakt, nuk ujitet as 50 për qind e saj.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Për këtë rrëth, edhe po të jetë 50 për qind e sipërsfares nën ujë, është shumë. Sigurisht, po të qe e mundur që ta kishin të

gjithë sipërsaqen nën ujë, kjo do të ishte një gjë akoma më e mirë.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Shokët e këtij rrjeti kanë marrë një iniciativë të mirë e po ndërtojnë rezervuarë të vegjël, duke grumbulluar ujërat e burimeve etj. Po ata nuk i raportojnë këto si shtesa të sipërsaqes së tokës nën ujë, se synojnë që me to të mbyllin deficitin e sipërsaqes së ujitshme që kanë raportuar mangët.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Vërtet, kjo është një iniciativë e mirë, por duhet të raportojnë në qendër për rritjen e sipërsaqes së tokës nën ujë. Po e rrite sipërsaqen e ujitshme, atëherë medoemos duhet të informosh. Këto shtesa të sipërsaqes së tokës nën ujë, që bëhen me ndërtimin e rezervuarëve të vegjël apo të mëdhenj, rrjeti nuk duhet t'i mbajë rezervë dhe pastaj të planifikojë të marrë prej tyre një rendiment prej 25 kuintalë misër për hektar. Jo, një gjë e tillë nuk duhet të ndodhë.

U tha këtu se tokat që mbillen me misër në zonat e larta, mund t'i mbjellim me thekër etj. Por duhet të përpinqemi që të mos themi gjithmonë: «Mund ta bëjmë kështu, mund ta bëjmë ashtu!». Ne, pasi ta kemi studiuar mirë problemin, duhet të themi: «Do të mbjellim thekër, do të mbjellim grurë, do të mbjellim patate» etj., se, po thamë «mund», ka rrezik të mos bëjmë gjë. Të thuhet në mënyrë të prerë që nga këto zona do të heqim kaq sipërsfaqe me misër e në vend të tij do të mbjellim këtë e atë bimë dhe do të matrim këtë rendiment, që kompenson kaq për qind të sasisë që do të merrnim po ta mbillnim me misër. Llo-

garitë duhen bërë mirë. Dhe që ta kenë të qartë dibranët këtë gjë, në kooperativat e këtij rrethi, në kohën kur hartohet plani, duhet të venë shokë nga drejtoria përkatëse e Ministrisë së Bujqësisë, me orientime të qarta. Atje pastaj të bëhet një diskutim i zjarrtë e llogari të sakta, se, po nuk u veprua kështu, nuk do të zgjidhet asgjë.

Për sa i përket kullimit të fushës së Bulqizës, unë mendoj se shokët kompetentë duhet të venë ta shikojnë gjithashtu në vend gjendjen. Misri nuk bëhet atje, sepse të stohtit, shiu e bora, fillojnë shpejt. Në rast se ia vlen (sepse, me sa di unë, kjo fushë nuk ka qenë shumë pjellore), po të ketë fonde, të jepet një ndihmë e vogël për bonifikimin e saj. Por, në qoftë se për këtë punë duhen fonde të mëdha, edhe mund të mos jepen, por këto të përdoren në vende të tjera, atje ku mund të merren rendimente më të larta. Po të jetë fjala vetëm për disa punime të vogla që duhen bërë në këtë fushë, atëherë kjo mund të bëhet nga vetë rrethi me aksion me goditje të përqendruar. Prandaj, shokët e rrethit të mos nxjerrin pretekste të ndryshme për të penguar punën, përkundrazi, të marrin masa që t'i sistemojnë sa më mirë tokat e t'i bëjnë ato sa më pjellore. Të shikojnë gjithashtu më mirë edhe mundësinë e mbjelljes së bimëve të ndryshme në ato toka që janë të njobura si pjellore.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Edhe në fushën e Maqellarës, në pjesën që ujitet, duhet të morret një rendiment prej 50 kuintalë misër për ha.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Patjetër që duhet t'i marrin këto rendimente. Por, për t'i realizuar këto

duhet organizuar mirë puna në brigadat e arave, për zgjedhjen e farërave. Gjithashtu duhet organizuar mirë kudo edhe kontrolli.

Natyrisht, çdo mbledhje ka rëndësinë e vet. Por, në mënyrë të vecantë, më duket mua, në mbledhjet që bëhen për problemet e bujqësisë rëndësi ka fakti që ato të konkretizohen në parim, në vija të përgjithshme e pastaj të merret vendimi, i cili duhet t'u shkojë kooperativave bujqësore para se të fillojnë punën për hartimin e planit. Është fare e lehtë t'i thuhet kësaj apo asaj kooperative se të zbresim 500 hektarë nga sipërfaqja që do të mbjellësh me misër. Por ç'janë këta 500 hektarë? Pra, në mbledhje duhet të argumentohet se për se bëhet kjo zbritje. Me fjalë të tjera, shokëve t'u bëhet e qartë pse bëhet ai ndryshim. Këto llogari të mos bëhen në zyrë, me një të rënë të kalemit, por të shkohet atje në brigadë e në sektor dhe të diskutohet konkretisht se sa hektarë duhen nga sipërfaqja e caktuar për t'u mbjellë me misër, sa duhet të zbriten në këtë sektor dhe sa duhen shtuar gjelkë; me se do të zëvendësohen ato dhe q'masa duhen marrë për sektorin tjetër etj.

Mendoj se është mirë që të praktikohet kudo një metodë e tillë pune. Kështu vlerësohet edhe puna e Ministrisë së Bujqësisë, e cila, duke e njobur gjendjen, di t'i ndajë forcat e saj për të ndihmuar bazën në hartimin e një planifikimi më të drejtë për bimët bujqësore, si dhe për zgjidhjen e kërkesave imediante. Kurse, ato kërkesa që mund të zgjidhen edhe pas dy apo tre vjetësh, të mbahen shönim e të kihen parasysh. Gjithashtu, për trajtimin e drejtë të këtyre gjëra

duhet edhe mobilizimi i Partisë. Kështu duhet të veprohet e jo vetëm t'u jepet urdhri: «Nisuni!». Po përsë duhet të nisen? Ata nuk duhet të shkojnë pa i sqa-ruar më parë këto gjëra.

E ngrita këtë çështje sepse më kanë sjellë një raport lidhur me vënien në jetë të studimit për rajo-nizimin e bimëve në Plasë. Kur kërkoj të më jepet raport për një problem, këtë e bëj me qëllim që të shkohet, të shikohet e të studiohet mirë, konkretisht në vend, se si është gjendja dhe të mendohet se ç'masa duhet të merren për ta vënë në jetë atë studim. Për shembull, një nga masat konkrete, më të vogla për këtë punë, është edhe problemi i ujitjes. Se mua nuk më vlen gjë po të më dërgohet raport për raport.

Bujqësia është një çështje shumë e gjerë. Ajo ka shumë hallka, të cilat janë të lidhura zinxhir me njëra-tjetrën. Në kodin agroteknik janë përcaktuar 10 pika, por unë mendoj se nuk janë vetëm ato probleme për bujqësinë, por janë edhe shumë të tjera. Ç'përfaqçojnë këto 10 pika? Mos vallë, po i mësove e i zbatove këto pika je në rregull me të gjitha punët e bujqësisë! Natyrisht, ato janë të domosdoshme për t'u zbatuar, por krahas tyre, ka edhe shumë çështje të tjera që duhen pasur parasysh nga të gjithë punonjësit e këtij sektori.

Një nga këto është edhe rajonizimi. Kushtet klima-terike të vendit tonë na kanë detyruar që ta rajoni-zojmë, për shembull, panxharin e sheqerit në rrethin e Korçës dhe kohët e fundit edhe në Elbasan. Ju nuk e dini, por në fillim, kur vendosëm të kultivonim në Korçë panxharin, kemi pasur rezistencë nga ana e fsha-

tarësisë, nga kooperativistët, për arsyen se ata nuk e kishin praktikën e punës për kultivimin e kësaj bime. Kështu që, në fillim, rendimenti i panxharit ishte shumë i ulët, 40 deri në 50 kuintalë për hektar, prandaj, nga kjo pikëpamje, kooperativistëve nuk u interesonte ta kultivonin. Por Partia nguli këmbë dhe krahas punës së madhe bindëse që u bë, u morën edhe disa masa e u arrit që tanjë atje të merren 300 deri 350 kuintalë për hektar, megjithëse mundësitet janë edhe për më shumë, deri në 400 apo 500 kuintalë për hektar, siç ka ndodhur në disa raste të veçanta. Me rendimentet që marrin sot kooperativistët, kanë leverdi, sepse marrin më shumë të ardhura.

Tani ne nuk mund të japim orientim që panxharsheqerin ta përhapim për ta kultivuar në të gjitha rrethet e zonave të ftohla, se, po ta bëjmë një gjë të tillë, në radhë të parë, do të na duhet që në këto zona të ndërtojmë fabrika sheqeri. Pra, më parë se të veprohet, kurdoherë duhen bërë mirë llogaritë. Kishte mendime, që panxhari të kultivohej edhe në Dibër, meqenëse ky rreth është në të njëjtin nivel me atë të Korçës, e kjo bimë mund të zhvillohet shumë mirë edhe atje. Kështu është, por, që të bëhej një gjë e tillë, duhej medoemos të parashikohej ndërtimi i fabrikës së sheqerit në këtë rreth, sepse nuk na leverdis që panxhari të transportohej me automjete nga Peshkopia në Korçë. Prandaj, duke u nisur nga këto arsyen, kultivimin e panxharit ne ia vumë për detyrë rrethit të Elbasanit. Sipërfaqja e mbjellë me panxhar në Elbasan është një shtojcë e asaj që mbillet në Korçë. Duke u ndërtuar hekurudha që lidh Elbasanin me Pë-

rrenjasin e Gurin e Kuq, u krijuan mundësi më të mira për ta transportuar atë më shpejt në Kombinatin e Sheqerit të Maliqit. Sipërfaqet që janë planifikuar të mbillen me panxhar në rrethin e Elbasanit kanë mundësi të ujiten. Edhe klima atje është e mirë, kështu që panxhari piqet më shpejt dhe hyn më parë në fabrikë pér përpunim. Në këtë mënyrë kemi vepruar ne edhe pér bimët e tjera.

Çështja e rajonizimit sa më të mirë të bimëve është një hallkë e rëndësishme pér bujqësinë tonë. Në qoftë se nuk e kryejmë në rregull këtë punë, atëherë nuk zbatojmë si duhet detyrën kryesore që ta bëjmë bujqësinë moderne. Gjithashtu, është e qartë se nuk mund të pretendosh të marrësh rendimente të larta, kur një brigade i vë pér detyrë të kultivojë 20 bimë të ndryshme. Këtë gjë disa akoma nuk po e kuptojnë si duhet. Edhe në qoftë se deri më sot është bërë diçka në këtë drejtim, ajo nuk është bërë në bazë të një studimi shkencor të një terreni konkret.

Mendoj se edhe Ministria e Bujqësisë nuk i është vënë si duhet kësaj pune që të nxjerrë konkluzione dhe të insistojë që ato të vihen drejt në jetë. Ajo të shikojë çdo vit, me kujdes të madh, edhe zgjerimin e masave të mëdha agroteknike që janë futur në bujqësi gjë që ka nxjerrë të domosdoshme zgjidhjen e një vargu problemesh. Ministria duhet ta ketë të qartë se ky përqendrim i madh i bimëve të ndryshme bujqësore kërkon më shumë punë, prandaj lind nevoja të përqendrohet edhe krahu i punës, gjë që mund të dojë bashkimin e brigadave. Mund të dojë, gjithashtu, t'u japim një çikë më shumë pleh, që, përvèç masave

agroteknike dhe mjeteve të ndryshme mekanike që kanë, t'i pajisim edhe me mjete të tjera etj., etj. Por si mund të sigurojë shteti mjete për kultivimin e orizit, në qoftë se këtë bimë e shpërndajmë në të gjithë Shqipërinë?! Që ta plotësojë këtë kërkesë, shtetit i duhet të sjellë 100 kombajna nga importi, por sot atij nuk i leverdis ta bëjë këtë, sepse ato kushtojnë shumë. Kurse, po ta përqendrosh mbjelljen e kësaj bime, ta zëmë, në tri rrethe, atëherë shteti është në gjendje të sigurojë, fjala vjen, tri apo gjashtë kombajna për brigadat e krijuara dhe kështu problemi zgjidhet. Në fillim mund të ngjasë ashtu siç ngjau në rrethin e Korçës për mbjelljen e panxharsheqerit që kooperativistët mund të mos jenë dakord e të rezistojnë. Por, duhet të punohet me ta që të binden, bile duhet të merren edhe disa masa që të mos ulet niveli i jetcsës së tyre, siç është futja e agroteknikës së përparuar në kultivimin e kësaj bime, si edhe disa masa të tjera shtetërore e në shkallë rrethi, me qëllim që nga kjo bimë kooperativa të mos marrë 4 kuintalë oriz për hektar, por 40, 50 apo 60 kuintalë. Dhe, kur të merren rendimente të tillë, puna do të ecë për bukuri se jo vetëm kooperativa ka më shumë fitime, kooperativistët do të marrin më shumë të ardhura, por edhe shteti do të zgjidhë nevojat për oriz.

Pikërisht këtë nuk është sa duhet disa shokë. Ministria thotë se ka vështirësi dhe kjo është e vërtetë. Por, a ka punë, e sidomos në fillim, që të mos hasë në vështirësi?! Çdo gjë ka vështirësi, por me një organizim dhe me një mobilizim më të mirë, ato ka-përcehen me sukses. Mua më duket se do të ishte më

e drejtë sikur këta shokë të thonë se nuk kanë organizim të mirë në punë. E them këtë se, shpesh, ata bëjnë një punë rutinë. Megjithëse puna e kuadrove drejtues tani është më e përparuar nga puna e më-parshme që bëhej në këtë ministri, përsëri ka rutinë, prapë nuk bëhet ajo punë që kërkohet sot. Këta shokë e shoqë që drejtojnë ministrinë, mundet që kanë hedhur hapa përpara, por atyre u duhet të hedhin edhe më shumë hapa përpara e pastaj të shohim nëse do të arrihen rezultatet e duhura. Dhe këtë ata duhet ta bëjnë mendoemos. Vetëm kështu mund të ecin punët, kur e di ç'kérkon dhe di ku ta çosh atë.

**SHOKU PROKOP MURRA:** Kur isha në kooperativën e Semanit më bëri përshtypje ky fakt: atje, në fasule marrin 25 kuintalë për hektar, kurse kooperativat e rrethit të Shkodrës 10 kuintalë. Po ministria që e di këtë, pse nuk merr masa që ta spostojë fasulen nga Shkodra e t'ua japim kooperativave të rrethit të Fierit ose të Lushnjës, dhe Shkodrës t'i japim orizin nga i cili merr 40 kuintalë për hektar?!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po si mund ta bëjnë këtë spostim këta shokë, kur nuk e kuptojnë dhe nuk e ndjekin orientimin e Byrosë Politike për studimin që është bërë për eksperiencën e Plasës?!

Për këto probleme të rëndësishme duhet të punohen si në kohë lufte, kur shtatmadhoria, që drejton veprimet luftarake, duhet të ketë përpara hartën në të cilën janë shënuar vendet se ku ka më shumë e ku ka më pak forca. Çdo mëngjes, ajo merr njofsimet se në cilin rajon ka filluar sulmi i armikut, me sa forca të blinduara, me kaq e aq forca këmbësorie, me kaq

forca ajrore e kështu me radhë. Shtatmadhoria, pasi i mbledh këto të dhëna, bën llogaritë: ne kemi kaq forca, me të cilat kemi zënë këtë territor, që na vihet detyrë ta mbrojmë me këto forca; do të tërhiqemi nga kjo zonë ose do të dërgojmë forca të tjera në ndihmë, për të mbajtur me çdo kusht territorin dhe kështu llogarit deri dhe gjërat më të vogla. Pra, edhe shokët e Ministrisë së Bujqësisë kështu duhet ta organizojnë punën, në këtë mënyrë, ndryshe nuk kanë gjë në vijë. Përderisa ka kooperativa si ajo që përmende ti, Prokop, që marrin 25 kuintalë fasule për hektar dhe ata të Shkodrës marrin 10 kuintalë, përsë të mos ia heqim fasulet rrëthit të Shkodrës? Natyrisht, kjo punë duhet të bëhet në mënyrë të studiuar se nuk është e drejtë të bëjmë spostime të bimëve bujqësore nga një rrëth në tjetrin pa e gjykuar mirë çështjen.

Se, po ta shikosh me vëmendje këtë problem, në pamjen e parë, duket që ne bëjmë mirë që ia heqim Shkodrës fasulen. Por, në të njëjtën kohë duhet të dinë edhe se ç'bimë do t'i japim Shkodrës për kompensim. Sigurisht, kjo siç thashë më lart nuk mund të bëhet me hamendje, pa e studiuar dhe pa bërë llogaritë, për të nxjerrë leverdishmérinë që do të kemi nga ky spositim. Pra, po të veprohet kështu, jemi dakord.

Por të kihet kujdes që ky studim të bëhet bashkë me shokët e rrëthit, se duhet të kemi respekt për ata, të kemi respekt për organizatën e Partisë atje. Forumet e larta, ministritë dhe institucionet qendrore, të kenë respekt për komitetet e Partisë të rretheve, për komitetet ekzekutive, për kryetarët e kooperativave bujqësore, për specialistët e bazës e për të gjithë puno-

njësit atje, sepse këta do të jenë njerëzit që do ta përpunojnë «brumin» për këtë çështje kaq të madhe. Prandaj, këtyre shokëve u duhet futur mirë në kokë kjo gjë, me qëllim që të ulen dhe ta studiojnë me kujdes dhe në mënyrë sistematike problemin që të dalin çdo vit me konkluzione. Ndoshta, sivjet, konkluzionet e tyre mund të mos jenë shumë të goditura e të plota. Megjithatë të përpinqemi që ato të zbatohen, se prapë janë më të mira. Kurse, vitin tjetër, shokët e bazës, duke i qëndruar si çekan mbi kokë këtij problemi, kur të shohin se duhet ndryshuar kjo apo ajo gjë, mendimin e tyre t'ia thonë Ministrisë së Bujqësisë, e cila e ndjek edhe vetë këtë problem, bie dakord me propozimin e bazës dhe kështu vendoset që të bëhet ndryshimi. Pra, siç thashë dhe më lart, të veprohet me llogari, tamam si në ushtri: dërgo një kompani këtu, dërgo një batalion në mbështetje të atij tjetrit; tërhiq këto forca nga ajo zonë e çoji më tej etj. Kështu të veprohet edhe në bujqësi. Në qoftë se nuk do të veprohet në këtë mënyrë, atëherë nuk mund të themi që ministria është një shtab i vërtetë drejtues, por vetëm sa për të bërë ca punë të vogla, hiq këtë e vër këtë etj.

Si shokët e Partisë, ashtu edhe shokët e pushtetit dhe specialistët në rrethe ta kuptojnë mirë se duhet luftuar që tokës t'i merret maksimumi. Mirëpo toka nuk mund të japë maksimumin, në qoftë se asaj nuk i bëhen shërbimet e duhura. Kjo nuk do të thotë që vetëm ta punosh tokën dhe ta bësh qilizmë, por edhe ta pasurosh me elementet e nevojshme. Për këtë duhen gjetur edhe bimët më të përshtatshme e farërat më të mira që jadin rendimente sa më të larta. Pastaj,

duhet të llogarisësh edhe mundësitë e krahëve të punës dhe të mjeteve të mekanizuara. Pasi t'i kesh bërë të gjitha këto llogari, të përcaktosh detyrat konkrete. Sigurisht, kjo gjë nuk bëhet një herë, por herë pas here, duke ndjekur procesin në zhvillim e kurdoherë në përparim. Këtë metodë pune duhet t'ua rekomandojmë punonjësve të sektorit të bujqësisë dhe të përpinqemi së bashku me ta që ta zbatojnë.

Atyre duhet t'ua bëjmë të qartë situatën që ta kupojnë mirë rëndësinë që ka zbatimi i detyrave në bujqësi dhe jo të thonë: «ta heqim qafe këtë bimë». Jo, ata nuk duhet ta shtrojnë kështu problemin, por të thonë edhe arsyen ose argumentin përsë e heqin këtë bimë. Në këtë rast arsyaja mund të jetë rendimenti i ulët që marrin me gjithë punën e madhe që bëjnë, prandaj mendojnë ta zëvendësojnë me një bimë tjeter, nga e cila mund të marrin rendiment më të lartë se një rrëth tjetër që e kultivon atë.

Pra, vetëm në qoftë se nisemi nga ky mendim, atëherë mund të themi se jemi në rregull. Çdo gjë duhet bërë e argumentuar. Në qoftë se një rrëth thotë «ta heqim qafe këtë bimë se nuk marrim gjë», po kështu edhe një apo dy rrethe të tjera mund të thonë të njëjtën gjë, atëherë ku do të vemi? Po të mos i mbjellim këto bimë, çfarë do të hajë populli? E theksoj që ky problem duhet kuptuar drejt nga të gjithë, edhe nga kuadrot e rrëthit, se ekziston tendenca: «Ma hiq këtë bela mua!». «Mirë, do të ta heq këtë «bela», mund t'u thuhet atyre, por do të të jap një «bela» tjetër shumë më të madhe, mbasi, në bazë të kushteve që ka toka e rrëthit tënd, ti do të kultivosh një bimë tjetër dhe kjo bë-

het për të mirën tënde dhe për të mirën e përgjithshme», t'i thuhet atij që ta shtron në atë mënyrë problemin.

Prandaj themi se puna e Ministrisë së Bujqësisë duhet të ngrihet në një nivel më të lartë. Kuadrot drejtues të bujqësisë duhet ta kuptojnë se është kohë e humbur në qoftë se lënë mënjanë problemet kryesore dhe merren me gjëra të vogla, të rëndomta dhe që nga kjo, në pamjen e jashtme, të duket sikur ata po punojnë. Ato probleme që janë shumë të thjeshta, mendoj se mund t'i zgjidhin vetë kuadrot tanë që punojnë në bazë, sepse tashmë janë me nivel të lartë kulturor e me horizont shumë të gjerë. Por fjala është për problemet kryesore, për të cilat duhen edhe konsultime. Duhet bërë ashtu sikurse the edhe ti, Prokop, që para se të përcaktohen detyra për pasurimin e tokës, ministria duhet të mbledhë gjithë shtabin, ku të bëjnë pjesë edhe specialistët më të mirë të pedologjisë, të kimisë etj. Aty mund të jepet një pasqyrë e qartë e përbërjes së tokës të rrethit të Shkodrës, për shembull, duke argumentuar shkencërisht çdo gjë. Në qoftë se i dërguari i ministrisë shkon atje dhe thotë disa fjalë të përgjithshme, atëherë specialisti që merr pjesë në atë mbledhje, nuk mund të bindet. Si specialist që është, ai mund të ngrihet dhe t'i thotë atij: «Pa më thuaj, për atë lloj toke që ti ke punuar për ta përmirësuar që nga viti 1970 e këtej, çfarë rezultatesh ka? Në qoftë se rezultatet e saj janë ngritur, unë të them se e ke pasuruar me të vërtetë këtë tokë, por, në rast se rezulton ndryshe, kjo do të thotë që ti nuk e ke pasuruar dhe ato që po na thua këtu në mbledhje, nuk janë gjë tjetër, veçse fjalë».

**SHOKU PROKOP MURRA:** Pastaj, për punët shkencore, ministria ka bërë dhe shpenzime, prandaj duhet parë se çfarë është arritur konkretisht.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po, po, në këtë mënyrë duhet vepruar. Bëhet kështu? Unë besoj se jo, se që ta besoj këtë duhet të ma argumentosh, që të bindem edhe unë. Patjetër që duhen dëgjuar më shumë, edhe specialistët e bazës. Specialisti jep mendime për problemet e mëdha që ka bujqësia, për të fshehtat e tokës etj., etj., e në këto raste në asnjë mënyrë nuk duhet të tregohemi pedantë. Ne duhet ta dëgjojmë më vëmendje dhe mund t'i themi edhe ndonjë konkluzion, si për shembull: «Kjo që më informove është një gjë shumë e mirë, por, për përmirësimin e tokës duhet të merren edhe këto e këto masa të tjera. Sot, në këto toka, merren 10 kuintalë fasule ose 15 kuintalë misër për hektar; por, ne a mund të marrim këtu 25 kuintalë fasule dhe 60 kuintalë misër për hektar? Po të mundim, dhe, duke bërë përpjekje, besoj se kemi mundësi t'i marrim këto rendimente, atëherë të shtrëngoj dorën e të them që e ke përmirësuar me të vërtetë tokën!»

Në këto gjëra duhet të kemi kujdes, se të vesh, siç thotë latini, *ex cathedra* e të shesësh mend, kështu nuk ecet.

*Botohet për herë të parë, sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

## **SIIFRYTËZIMI I PUSEVE TË BËHET NË MËNYRË SIIKENCORE**

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

**6 nëntor 1978**

Në shpimin e puseve të naftës të shkojmë shkallë-shkallë, sa të na sigurohen mundësitë teknike për të përcaktuar thellësinë dhe trashësinë e shtresës. Ne duhet të vërtetojmë medoemos edhe ekzistencën, edhe thellësinë e shtresës naftëmbajtëse, pra jo vetëm të dimë që gëlqerorët, në këtë ose në atë zonë, janë të ngopur me naftë, por edhe sa thellë është kjo. Natyrisht, nafta nuk kapet në të njëjtin nivel në të gjithë zonën dhe këtë e konstatojmë nëpërmjet puseve që venë në thellësi të ndryshme. Mirëpo, nc duhet të dimë që këtu, të supozojmë, në një sipërsaqe prej 10 000 metrash katrorë, kudo që të shpojmë, do të marrim naftë dhe për këtë të jemi të sigurt që, edhe në qoftë se nuk na del naftë në 2 000 metra thellësi, atëherë të shkojmë më poshtë.

Veç kësaj, kujdes i veçantë kërcohët për vënien në shfrytëzim të puseve të naftës. Për këtë duhen ma-

rrë të gjitha masat, se nuk dihet kur del nafta. Ne për këto gjëra kemi vuajtur, prandaj gjithçka duhet bërë medoemos gati dhe të merren masa me kohë.

Mendoj se si eksperienca e mirë, ashtu edhe e hidhur në nxjerrjen e naftës duhet të na shërbijnë përsot dhe për të ardhmen. Çfarë kemi konstatuar ne në këtë fushë? Kemi konstatuar plot gjëra të mira, por kemi konstatuar, gjithashtu, edhe të meta. Kemi marrë naftë, por këtë e kemi marrë me regjime jo shumë të përpunuara në baza shkencore dhe jo me parametrat e parashikuar. Neve, dikur, na kanë ardhur këtu edhe njostime nga punonjësit e sektorit të naftës, që vinin në dukje se puset ishin duke na u mbytur para kohe me ujë.

Të supozojmë se tash atje janë marrë të gjitha masat dhe çdo veprim është kryer mbi baza shkencore. Është një fenomen i zakonshëm që njihet nga të gjithë se uji, si më i rëndë, qëndron më poshtë se nafta; kjo qëndron lart dhe, për ta nxjerrë atë, përdoret një procedurë e tërë. Kur shfrytëzon pusin, në fillim të vjen naftë, pastaj naftë e përzier me ujë dhe më në fund vetëm ujë dhe kështu, vjen koha që pusi mbytet. Prandaj ne duhet ta kemi të qartë se kur ndodh mbytja e një pusi. Procesi është i qartë për shokët e sektorit të naftës, por nuk e di sa interesohen ata për këtë çështje.

Kur kam vajtur vetë në rajonet e naftës, kam gjetur atje librat e puseve. Nuk e di në qostë se i keni parë edhe ju, por ata janë jashtëzakonisht të bukur, më të bukur se diplomat që u jepen studentëve kur mbarojnë universitetin. Unë kam përshtypjen se mjaft nga kuadrot e sektorit të naftës nuk i studiojnë si duhet këto

dokumente me vlerë. Studimi i këtyre librave nuk duhet bërë veresie, ata duhet të studiohen dhe të ndiqen nga specialistët përkatës, por edhe nga matematicienë, ashtu sikundër biseduam, me kompjuter etj., etj., për arsy se llogaritë e sakta nuk bëhen kollaj. A bëhet kjo punë? A ekziston historiku i një fushe që është destinuar të studiohet e të shfrytëzohet? Mund të ekzistojnë këta libra, por nuk besoj që për ta të bëhet një punë e tillë. Mundet, që siç thoni ju, në ndonjë sektor naftë edhe të ketë filluar të bëhet. Por kjo të mos mbetet vetëm një fillim, por të bëhet një punë e mirë e vazhdueshme shkencore, se kështu duhet të punojnë ata kurdoherë.

Që shfrytëzimi i puseve të naftës të bëhet në mënyrë shkencore, për shembull, për një zonë, ne duhet të dimë historikun e secilit pus. Duhet të kemi historikun e zhvillimit të përditshëm, ose ditarin e përditshëm të çdo pusi dhe, mbi bazën e këtyre ditarëve, të kemi edhe ditarin e përgjithshëm për gjithë zonën. Dhe, kur flasim për ditar, e kam fjalën për një ditar me të vërtetë shkencor, të mbështetur mbi të gjitha të dhënrat, ku të shihet nëse vërtetohen parashikimet e projektit për shtresën apo nuk vërtetohen, nëse është vërtetuar sasia e naftës, kapaciteti naftëdhënës i puseve apo nuk është vërtetuar. Për të nxjerrë këto konkluzione, shikojmë sa naftë kemi marrë gjatë kësaj kohe (gjë që mund ta llogaritim, se i kemi të dhënrat e çdo dite), a është bërë shfrytëzimi sipas normave që kishim caktuar që më parë për nxjerrjen e naftës nga pusi etj. Pasi i bëjmë këto, shikojmë ku na ka dalë ujë më përpara, na ka dalë në atë pus ku ne e patëm sfor-

cuar më tepër nxjerrjen e naftës apo në një pus tjetër, ku, me gjithëse nuk pati sforcim, uji prapë na e mbyti pusin. Atëherë bëjmë llogaritë se në sa metra thellësi na doli ujë dhe gjejmë se na doli, ta zëmë, në pusin që u shpua 3 000 apo 3 500 metra thellë. Pra, historiku i një fushe të tërë naftë, që është jetike për vendin tonë, na ndihmon për të përcaktuar drejt regjimin e shfrytëzimit racional në atë zonë. Kjo punë duhet të bëhet nga gjeologët e naftëtarët tanë çdo vit, për të gjitha fushat e naftës.

Ju thatë se shokët e zonës së Vlorës e kanë një pasqyrë të tillë me të dhënrat përkatëse, të cilat i kanë studiuar dhe kanë nxjerrë konkluzione. I kanë ata këto konkluzione apo ua ka marrë era, apo i kanë si studime të pasistemuara dhe të ngatërruara? Se në çdo punë, dhe veçanërisht këtu, ne duhet të ecim me rregull, me kujdes e me llogari dhe jo vetëm duke bërë thirrje: oburra merr naftë sa të marrësh, oburra në sulm se nuk po e realizojmë planin apo po e realizojmë etj. Kjo është njëra anë e problemit. Por, krahas kësaj, duhet parë edhe ana tjetër, se si e kemi realizuar këtë plan, si e kemi trajtuar ne këtë pasuri në këto burime. Studiohen këto probleme apo nuk studiohen? I kemi nxjerrë të dhënrat mbi të cilat mund të bëhen studime apo jo? Dilet me konkluzione apo nuk dilet? Po të bëhen të gjitha këto gjëra, të sigurohen të dhënrat dhe këto të studiohen shkencërisht, atëherë jemi në gjendje të dalim në konkluzione më të drejta se çfarë duhet bërë.

Konkretisht, duzën e pusit nr. 17, për të marrë naftën e gazin, e kanë lënë 4 mm. Po përsë të mos e vë-

më me 6 mm ose përsë të mos lihet 4 mm derisa të përfundojë së shpuari edhe pusi tjetër, i cili duhcj të mbaronte me një interval prej dy apo tre muajsh, përtë parë se me çfarë intensiteti do të na dalë ai dhe pastaj të bëjmë krahasimin nëse po na del me të njëjtin intensitet apo jo? Po të jetë se del me këtë intensitet do të thotë që në këtë zonë forca e presionit të naftës është e madhe. Atëherë manovrojmë dhe e hapim ose e mbyllim rubinetin. Pra, më parë shikojmë e analizojmë të dhënrat e këtyre puseve, presionin në to, mënyrën si vjen nafta, sa për qind është gaz, sa përqind naftë dhe sa për qind është ujë. Të gjitha këto të dhëna shënohen në ditar dhe kështu me radhë veprohet më tej.

Në fushën e re të naftës që zbuluam, të vazhdohet puna me shpim e shfrytëzime në kushte të mira, në bazë të një studimi shkencor për të gjitha puset, duke ndjekur me kujdes çdo pus ditë për ditë. Po të konstatohet që në njërin prej tyre vjen pak ujë, atëherë menjëherë të shikohet gjendja edhe në puset e tjera, se mos edhe në to ka filluar të dalë ujë. Në qoftë se shihet që në puset e tjera nuk po vjen ujë, duhet të studiojmë arsyet. Kjo mund të ndodhë për arsyen se këto puse janë në një relief të tillë që kanë akoma shumë naftë, kurse tjetri, tek i cili ka dalë ujë, është më i thellë. Atëherë, ç'duhet të bëjmë? Shokët e sektorit të naftës e dinë më mirë se ne anën teknike, se, këto që dimë ne, nga ata i kemi mësuar. Prandaj, kur diku del ujë, nuk duhet të alarmohen dhe të thonë se na u mbyt pusi, ose të mos çajnë kokën fare dhe të lejojnë që uji

të hipë më lart, por të marrin masat e duhura që të përdorin «të famshmet» metoda intensifikuese.

Metodat intensifikuese zbatohen duke u mbështetur në metoda matematike dhe këtu hyjnë në punë kompjuterët. Specialistët e naftës bëjnë matjet për të parë se sa lart ngrihet uji, në ç'mënyrë ngrihet, sa është presioni i tij etj. Të gjitha këto të dhëna merren nga ky ose ai pus dhe pasi mblidhen të gjitha, vendoset për të përdorur metodat intensifikuese, të cilat përcaktojnë se çfarë presioni do të ketë nafta, ç'sasi uji do të jepet, kur do të jepet, jo sot, por mot etj., etj.

Shkenca është ekzakte, ajo nuk lejon subjektivizm. Letërsi mund të bësh sa të duash, edhe muzikë po të duash mund të bësh, se në letërsi e në muzikë autori fut ndjenjat e tij, shpirtin e tij, kurse shkenca është shkencë, ajo është ekzakte. Gjatë punës së shpimit të një pusi, ta zëmë, u gjet ujë. Atëherë duhet menduar dhe të bëhen llogaritë se sa mëtra është thellësia e ujit. Ose, kur vëmë pusin në shfrytëzim, duhen bërë llogaritë se ç'rczerva nafte ka ky pus dhe dërisa do ta hapim duzën e tij për të nxjerrë naftën. Pasi të bëhen llogaritë me saktësi, atëherë do t'i thuhet Qeverisë që, po të hapet fare duza, ta supozojmë se brenda tetë muajve do t'ia merrnim pusit të gjithë sasinë e naftës, kurse po të mos hapet plotësisht rubineli, pusi do të shfrytëzohet për një periudhë më të gjatë. Këtë e them nga eksperienca e hidhur e mëparshme. Atëherë «dua naftë, — bërtiste me hipokrizi Abdyl Këllezi, — prandaj duhet të nxirren 2 milionë e gjysmë tonë në vit», dhe na vinte këtu si nënkyryeministër e na njoftonte se nga këto apo ato vendburime 2 milionë e gjys-

më tonë naftë i kemi të siguruara<sup>1</sup>. Jo, në asnje mënyrë nuk duhet vepruar kështu! Për këto probleme nuk duhet të ketë imponim, po llogari, arsyetim dhe logjikë.

Mua më duket se nuk duhet larguar nga një pus pa marrë naftë, kur kjo, në fakt, është aty dhe na thotë: «shpo këtu, se këtu do të më gjesh, në mes të gëlqerorëve». Logjika e gjërave nuk na e lejon ta lëmë pusin, ndërkohë që shokët e sektorit të naftës venë ta gjejnë naftën në fundin e dynjasë dhe nuk mjafton kjo, po, gjatë shpimeve që bëjnë, puset u bien edhe në avari.

Vërtet është një gjësim i madh që zbuluan një fushë të re naftë, se nafta është një pasuri e madhe për ne, por është e domosdoshme që ajo të trajtohet me kujdesin më të madh dhe si duhet. Unë mendoj që, në përgjithësi, si Ministria e Industrisë dhe e Minierave ashtu edhe Drejtoria e Përgjithshme e Naftës dhe vetë naftëtarët duhet të kenë kujdes në këtë çështje. Kur mbarojmë punë në një pus, sonda të hiqet sa më parë dhe të dërgohet gjetkë. Të trcgohet kujdes edhe për demontim-transportim-montimin, për arsyen se këto procese në disa raste na hanë akoma shumë kohë, në vend që kjo punë të bëhet në një afat sa më të shkurtër, gjë që ka shumë leverdi. Edhe këtu të tregojnë zotësinë e tyre të gjithë kuadrot e sektorit të naftës.

Tani, të entuziazmuar nga ky sukses, s'duhet të na kapë euforia dhe oburra t'i thérresim këta kuadro në Qeveri që t'i përgëzojmë, t'u shtrëngojmë dorën e

---

1. Siç dihet, një nga drejtimet kryesore të veprimtarisë sabotuese e armiqësore në naftë ishte dhe vendosja e një regjimi barbar në shfrytëzimin e vendburimeve ekzistuese.

t'u themi «Ju lumtë! Ju lumtë, keni arritur një sukses» etj. Sigurisht që anët pozitive e sukseset duhet të vihen në dukje, por si kurdoherë me takt, sepse deri tani atyre u kemi tërhequr vërejtjen për një varg të metash të rënda që janë konstatuar. Në fakt, në sektorin e naftës janë bërë një varg veprimesh të gabuara, që na kanë kushtuar shumë shtrenjtë, prandaj tani që zbuluam këtë pus, t'u jepen kuadrove e naftëtarëve menjëherë lëvdata të mëdha, ose t'i dekorojmë edhe me titullin «Hero i Punës Socialiste», kjo nuk shkon. Jo, shokë, nuk duhet të veprojmë më kështu, por të veprojmë me shumë takt. Natyrisht, shokët e sektorit të naftës duhet edhe t'i inkurajojmë, por më parë duhet t'u kërkojmë që çdo gjë të bëhet në bazë të rregullave e të normave shkencore.

Këto janë disa mendime të miat. Në vija të përgjithshme mendoj se nuk e kam gabim që i ngrita këto probleme duke i lidhur dhe duke marrë për analogji edhe çështje të tjera. Se, të mendohet, ta zëmë, që puna në Kombinatin Metalurgjik është fare e lehtë, nuk është e drejtë, për arsy se edhe atje kemi të bëjmë me një punë nga më të ndërlikuarat që mund të ekzistojnë, që, po nuk u bë si duhet dhe me përpikëri, sjell pasoja të rënda. Të gjitha këto janë të lidhura. Kështu mund të thuhet edhe për punën që bëhet në sektorin e naftës. Këto janë probleme shkencore që duhen përballuar mirë dhe me forcat tona.

*Botohet për herë të parë, sipas tekstit të nxjerrë nga biseda e incizuar që gjendet në AQP*

## SIIQIPERIA ECËN E SIGURT PËRPARA PA IU TREMBUR SYRI

*Fjala në takimin me zgjedhësit e zonës  
elektorale Nr. 209 të Tiranës*

8 Nëntor 1978

Të dashur shokë dhe shoqe, zgjedhës dhe zgjedhëse,

Për mua është një rast shumë i gjuar e i bukur të takohem përsëri me ju, të dashur nëna e baballarë, motra e vëllezër, punëtorë, intelektualë, ushtarakë të forcave tona të lavdishme të armatosura, të rinj e të reja dhe të kuvendoj për problemet tona të përbashkëta, në pragun e një ngjarjeje historike përmbarë popullin e përpushtetin e tij, siç janë zgjedhjet e deputetëve për Kuvendin Popullor.

Gëzimi im është i madh, veçanërisht që takohem me ju sot, në këtë ditë të shënuar në historinë e lavdishme të popullit shqiptar, kur këtu në Tiranën e kuqe, pikërisht në lagjen tuaj, të dashur për çdonjërin nga ne, 37 vjet më parë u krijua Partia Komuniste e Shqipërisë, Partia që në krye të popullit e bashkë

me të, ngriti lart flamurin e lirisë e të përparimit shoqërор, flamurin e madh të demokracisë e të socializmit. Partisë sonë heroike ne i detyrojmë të gjitha fitoret, jetën e lumtur që gjëzojmë sot dhe të ardhmen e sigurt.

Situata te ne është revolucionare dhe optimiste. Ne rrojmë në një shoqëri socialiste të përparuar, të lirë dhe demokratike.

Kush e ka bërë shoqerinë tonë të ecë kaq përpara, që vendi ynë të ndryshojë saqen, që të ngrihet gjithë kjo industri, që bujqësia të përparojë, që arsimi dhe kultura të marrin përpjesëtime të pashembullta zhvillimi dhe të krijohen me dhjetëra mijë kuadro të lartë e të mesëm, dhjetëra mijë punëtorë të kualifikuar? Kush e ka bërë jetën tonë kaq të bukur, sa njerëzit, që nga fatosat e pionierët e deri tek ata që janë në moshë të shkuar, të ndihen kaq të gjuar?

Të gjitha këto realizime e kanë burimin te sistemi ynë ekonomiko-shoqërор, te diktatura e proleteriatit, tejeta jonë e lirë, demokratike, e pavarur dhe sovrane, te puna heroike e popullit tonë. Të gjitha këto të mira na i solli Partia e Punës e Shqipërisë, udhërrëfyesja e pagabuar, marksiste-leniniste e së ardhmes sonë të ndritur.

Në Shqipërinë socialiste masat punonjëse janë zot të vendit. Te ne realizohen me të vërtetë dhe në format më të përshtatshme liria dhe demokracia e plotë për punonjësit. Lidhur me këtë çështje unë kam folur në Këshillin e Përgjithshëm të Frontit Demokratik, prandaj këtu nuk do të zgjatem. Por dua të

theksoj se demokracia e gjerë për masat zhvillohet e përsoset vazhdimisht në procesin e ndërtimit të socializmit. Ajo është e lidhur me forcimin e ekonomisë socialiste, të pronës së përbashkët, me zhvillimin e harmonishëm të të gjitha degëve, me perfeksionimin e marrëdhënieve në prodhim. Ajo lidhet me forcimin e drejtimit të ekonomisë e të kulturës, në bazë të planit unik e të centralizuar, nga shteti i diktaturës së proletariatit sipas vijës, direktivave dhe orientimeve të Partisë.

Te ne, siç e dini, planet për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës bëhen nga poshtë-lart, nga masat e gjera punonjëse. Masat bëjnë propozime të shumta e me vlerë, bëjnë vërejtje e kritika për mosrealizimet, u sugjerojnë Komitetit Qendror të Partisë dhe Qeverisë mendimet e tyre krijuar. Kështu në çështjet jetike dhe kardinale shprehet në teori e në praktikë demokracia e vërtetë proletare. Këtë ndihmë të madhe masat punonjëse ia japid shtetit, se e duan këtë me gjithë shpirt, sepse njohin si fuqinë ekonomike të qendrës së tyre të punës, ashtu edhe fuqinë ekonomike të republikës, nëpërmjet orientimeve të qarta që u japid Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeverisë, jo vetëm kur hartohet plani, por vazhdimisht, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të tij.

Në vendet kapitaliste punëtori nuk njihet, dhe s'ka si të njihet, me drejtimet e zhvillimit të ekonomisë, në tërësi jo e jo, por as me ato të ndërmarrjes ku punon, për arsyen se ai është i lidhur me fabrikën sa për të kryer një punë si automat, vetëm një rrogëtar, një shitës i fuqisë së tij të krahut.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Bashkimin Sovjetik e për vendet e tjera revizioniste. Kështu, për shembull, në sistemin e vëtadministrimit jugosllav, i cili reklamohet si një sistem ku gjoja çdo gjë është në duart e punëtorëve, punëtori është i zhveshur nga çdo pushtet. Në ndërmarrjen që gjoja vëtadministron, punëtori, në fakt, nuk vendos për asgjë. Atje janë drejtori me shtabin e tij që vendosin për planin, për investimet, për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave, për atë se kush duhet të favorizohet e kush nuk duhet të favorizohet ctj. Punëtorët e ndërmarrjes vëtadministruese nuk kanë aspak dijeni për planin e republikës, as të ndërmarrjeve shoqe, sepse për këtë çështje ata nuk kanë asnjë interes. Ndërmarrjet atje konkurrojnë njëra-tjetrën, që të nxjerrin fitime për drejtuesit e tyre. Në këtë luftë që bëhet atje në fu-shën e prodhimit e të tregtisë, punëtorët nuk përsitojnë gjë, përkundrazi interesat e tyre minohen nga konkurenca dhe ndër ta përhapet fryma lokaliste e individualiste borgjeze.

Në Bashkimin Sovjetik, në Jugosllavi e në vendet e tjera revizioniste, të ashtuquajturat reforma në drejtimin e ekonomisë, decentralizimi i saj e faktorë të tjerë çuan në rivendosjen e kapitalizmit, në diserencimin dhe në polarizimin e shoqërisë. Kjo gjendje solli pasurimin e shtresave të larta, të të gjithë piramidës që sundon mbi proletariatin e popullin punonjës të këtyre vendeve, dhe çoi në varfërimin e masave punonjëse.

Edhe pse në ndonjë prej këtyre vendeve revizioniste, për të mashtruar masat punonjëse, ruhen aks-

ma disa forma, disa norma e disa tradita «socialiste», por të zhveshura krejt nga përbajtja marksiste-leniniste, pushteti mbahet me forcën e armëve, të terrorist e të përdorimit të dhunës. Ekonomia është në krizë, çmimet ngrihen përditë, jeta shoqërore degjeron, vërtetohen përleshje të masave popullore e të nacionaliteteve të ndryshme, me forcat represive të qeverive etj. Ja përse atje jetesa e masave popullore është kaq e varfër, si nga ana ekonomike, ashtu dhe nga ana shpirtërore.

### **Politika jonë e jashtme përpunitet me luftën dhe me aspiratat e proletariatit e të popujve**

Ndërtimi me sukses i socializmit në Shqipëri, vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë në të gjitha fushat kanë forcuar edhe pozitën ndërkombëtare të vendit tonë.

Qëndrimet parimore të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në fushën e politikës së jashtme janë të njoitura nga populli ynë dhe nga të gjithë popujt e botës. Politika e jashtme e shtetit dhe e Partisë sonë udhëhiqet nga parimet e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, ajo mbron interesat e lartë të atdheut tonë socialist, përkrah lëvizjen revolucionare të klasës punëtore dhe luftën e popujve për liri, pavarësi e sovranitet.

Partia jonë marksiste-leniniste dhe shteti ynë socialist janë në kundërshtim dhe në luftë të papajtu-

eshme me imperializmin, qoftë ky amerikan, sovjetik, kinez, japonez ose ndonjë tjetër. Ne jemi në kundërshtim me atë formacion ekonomiko-shoqëror ku baza dhe superstruktura shërbejnë për të shfrytëzuar e për të shtypur popujt. Politika jonë është e tillë sepse është politikë e parimeve proletare. Të ndjekësh zhvilimin e botës me syrin klasor proletar, do të thotë të mbrosh interesat e punonjësve, të jesh me të shtypurit, me ata që duan të përbysin botën e vjetër dhe ta zëvendësojnë këtë me një botë të re, ku njerëzit të rrojnë në liri të plotë dhe në demokraci të vërtetë. Ne jemi përkrahësit e revolucionit, të atij revolucioni që sjell ndryshime cilësore progresive në jetën e popujve dhe të mbarë njerëzimit. Qëndrimin tonë ne nuk e maskojmë me formula dhe nuk bëjmë koncesione në dëm të revolucionit, të socializmit dhe të çlirimit të popujve.

Politikën e Partisë së Punës të Shqipërisë e përkrahin, në radhë të parë, proletariati botëror, popujt dhe punonjësit e vendeve të ndryshme të të gjitha kontinenteve, sepse kjo politikë përputhet me luftën dhe me aspiratat e tyre.

Ndaj politikës së Shqipërisë dhe qëndrimeve të saj nuk janë të pandjeshme edhe shtetet kapitaliste e revisioniste, pavarësisht se vendi ynë është me territor dhë me popullsi të vogël. Kjo ndodh se politika e Shqipërisë socialistë është e drejtë, se zëri i saj dëgjohet e respektohet në botë. Prandaj ata përpinqen t'ua fshehin atë popujve të vendeve të tyre ose t'ua paraqesin të deformuar. Por ata nuk ia kanë arritur dhe nuk do t'ia arrijnë kurrë qëllimit të tyre.

Vendi ynë nuk ndjek një politikë të lëkundshme koniunkturale. Koniunkturat në arenën ndërkombe të shkaktohen nga instabiliteti dhe nga kalbëzimi i kapitalizmit, nga krizat ekonomike, politike dhe ushtarake, nga lëvizja e madhe revolucionare e popujve që luftojnë për t'u çliruar nga zgjedha e imperializmit dhe e socialimperializmit, nga shtypja e shfrytëzimi i kapitalit, nga sundimi i borgjezisë dhe i revizionizmit. Situatat që krijojnë i brejnë imperializmin e kapitalizmin nga brenda, krijojnë pasiguri për të nesërmen, prandaj qarqet sunduese, klikat në fuqi në botën borgjezo-revizoniste përpinqen t'u adaptohen atyre, të riforcojnë aleancat ekzistuese dhe të lidhin aleanca të reja të çdo natyre, të bëjnë një politikë koniunkturash. Duke i matur edhe qëndrimet e të tjerëve me kutin e vet, kapitalistët dhe revisionistët mendojnë se edhe vendi ynë, i pavarur nga ata, do të ndjekë politikën e tyre dhe do të futet në brazdat që hap kapitalizmi botëror me parmandën e tij të kalbur.

Armiqtë tanë gabohen kur mendojnë se vendi ynë, duke ndjekur një politikë të pavarur, qenka i izoluar dhe «ka mbetur në mes të rrugës», se «do t'i nderë dorën ndokujt që ta nxjerrë nga balta» etj. Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë nuk ka qenë e nuk do të jetë kurrë e izoluar, ajo nuk ka mbetur dhe nuk do të mbetet kurrë në mes të rrugës. Ajo ecën e sigurt përpara, e mbështetur në forcat e veta, ndërton, krijon, stërvitet e mbrohet pa iu trembur syri dhe, me shembullin e saj heroik, frysmezon e do të frysmezojë masat e shtypura të botës.

Qëndrimi i patundur i Shqipërisë në politikën e saj është i vendosur dhe i drejtë, pse ajo udhëhiqet nga teoria e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit. Politika jonë, duke u bazuar në kritere shkencore, i analizon drejt e realisht problemet e zhvillimit botëror, marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ngjarjet ndërkombëtare, proceset e fenomenet e lëvizjeve revolucionare dhe çlirimtare të popujve të botës dhe mban qëndrime të drejta.

Kapitalistët dhe revisionistët e kanë quajtur «anakronike» politikën e Shqipërisë dhe me të tilla etiketa të sajvara, që nuk gjejnë kurrë aprovin e popujve të botës, përpinqen ta bëjnë atë pa efekt në opinionin publik botëror. Pse bëhen këto përpjekje? Këto bëhen se politika jonë është politika e rendit të ri shoqëror, e socializmit, që e ëndërrojnë proletariati dhe të gjithë të shtypurit e botës, të cilët përbëjnë një forcë kolosalë të ngritur në këmbë. Kjo forcë është e tmerrshme për kapitalistët, monopolistët dhe ideologët e tyre, të struktur në partitë e shumta me emra të ndryshëm, që nga «demokrate» deri në «komuniste». Akoma më e tmerrshme do të bëhet ajo në të ardhmen. Ja përsë politika jonë u djeg atyre që janë kundër proletariatit dhe interesave të tij.

Drejtimet e politikës sonë, që mbron interesat e lartë të atdheut e të revolucionit, nuk mund të ndryshojnë nga të fryjë era, nga koniunkturat dhe nga rrethanat që krijuhen herë pas here. Natyrisht, rrethanat, kontradiktat dhe koniunkturat që krijuhen në botë, Partia dhe Qeveria jonë i ndjekin me kujdes të madh për t'i shfrytëzuar në interes të atdheut tonë

socialist e të popullit shqiptar, të revolucionit dhe të të gjithë popujve të botës.

Marrëdhëniet e shtetit tonë socialist me shtetet kapitaliste dhe revisioniste bazohen fort në kritere klasse revolucionare. Ne nuk kemi dhe nuk do të kemi marrëdhënie diplomatike me imperialistët amerikanë, me socialimperialistët sovjetikë dhe me shtetet fashiste, por me shtetet e tjera, me sistem shoqëror të ndryshëm nga yni, do të kemi marrëdhënie mbi bazën e barazisë, të respektimit të sovranitetit, të mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe të dobisë reciproke.

Shtetet, edhe pse mund të jenë të një natyre, kanë dallime në politikën e tyre dhe këto dallime duhen vërejtur me kujdes që të përcaktohen qëndrime të drejta. Nuk është me vend që të futen të gjitha shtetet në një thes ose të klasifikohen në «tri botë» dhe të predikohet aleanca e këtyre «tri botëve» kundër një pjesëtari të «botës së parë», socialimperializmit sovjetik. Ne, si marksistë-leninistë që jemi, kur flasim për botën dhe për shtetet e ndryshme të saj, gjykojmë sipas materializmit dialektik dhe historik e jo arbitrarisht, prandaj jemi kundër ndarjes që bën teoria revisioniste e «tri botëve».

Lenini, duke pasur parasysh rendin ekonomiko-shoqëror të vendeve të ndryshme, thoshte se ekzistonjë dy botë: socializmi dhe kapitalizmi. Por, siç namëson ai, sidomë që të gjitha shtetet kapitaliste i përkasin një formacioni ekonomiko-shoqëror, ka shtete kapitaliste të vogla, ka edhe shtete kapitaliste të fuqishme. Sipas ligjit të xhunglës, që ekziston në marrëdhëniet midis shteteve kapitaliste e revisioniste, «peshku i madh»

e «ha të voglin», prandaj «peshkut të vogël» i duhet të luftojë për ekzistencë dhe pikërisht në këto përpjekje shfaqen kontradiktat.

Republika jonë përpinqet t'i shfrytëzojë kontradiktat në interes të revolucionit dhe përkrah luftën kundër «peshkut të madh» me qëllim që ta dobësojë atë, të ndihmojë lëvizjen revolucionare të klasës punëtore dhe luftën e popujve për liri, pavarësi dhe përparim shoqëror.

Eshtë e qartë për Partinë tonë, për shtetin tonë socialist, për marksistë-leninistët, për proletariatin e për të gjithë popujt e botës që imperializmi, socialimperializmi, kapitalizmi botëror dhe reaksiioni i çdo natyre luftojnë të ruajnë sundimin mbi popujt, kurse popujt luftojnë për të hedhur tej zgjedhën e sundimitarëve të urryer dhe për të marrë fuqinë në dorë. Kjo eshtë një luftë e vazhdueshme që do të mbarojë me fitoren e popujve, e cila, natyrisht, nuk do të arrihet përnjëherë, pa sakrifika e pa gjak.

Luftërat nacionalçlirimtare janë të drejta, ato i mbështetin dhe i udhëheqin marksistë-leninistët dhe revolucionarët progresistë. Këto luftëra janë të domosdoshme për fitoren e pavarësisë kombëtare, për vendosjen e të drejtave dhe të lirive demokratike të vërteta, ato krijojnë kushte të favorshme dhe i hapin trugën revolucionit socialist. Duke përkrahur luftërat çlirimtare të popujve dhe revolucionin, në në asnjë mënyrë nuk mund të mbështetemi te njëri imperializëm për të luftuar një tjetër, nuk mund të mbështetim një fuqi kapitaliste botërore për të luftuar një fuqi tjetër kapitaliste botërore.

Tezat marksiste-leniniste të Partisë sonë për zhvillimin e sotëm botëror i ka vërtetuar dhe i vërteton koha. Nga ana tjeter, po provohet çdo ditë e më shumë se teoria e «tri botëve» është antimarksiste, reaksionare, në shërbim të imperializmit dhe të strategjisë së vetë Kinës si superfuqi, e cila synon të rindajë botën dhe jo të luftojë imperializmin e qëllimet e tij agresive. «Teoricienët» dhe përkrahësit e teorisë së «tri botëve» nuk mund t'u bëjnë thirrje proletariatit dhe popujve të së ashtuquajturës botë e tretë që të ngrenë krye kundër zgjedhës së borgjezisë reaksionare të vendit dhe shtypësve të huaj, që të ngrihen kundër luftës imperialiste. Ata nuk mund ta bëjnë kurrë këtë, sepse do të binin në kundërshtim me «teorinë» e tyre, e cila predikon bashkimin e proletariatit dhe të masave të shtypura të popullit me sundimtarët e tyre, me kapitalin që i shfrytëzon. Prandaj këtë «teori» proletariati dhe popujt jo vetëm nuk e besojnë, por e përbuzin dhe e hedhin poshtë me neveri.

Pikëpamja e Partisë sonë është se mbrojtësit e teorisë së «tri botëve» janë renegatë të marksizëm-leninizmit, janë armiq të rrezikshëm të popujve, sepse synojnë sabotimin e luftërave çlirimtare të popujve dhe të revolucionit proletar botëror. Ata kanë revizionuar teorinë e Marksit e të Leninit mbi përbajtjen e revolucionit, kanë mohuar ideologjinë që e çon atë në fitore, që i çon popujt drejt çlirimtimit, drejt një shoqërie të re socialiste, pa klasa shfrytëzuese.

Të njëjtën rrezikshmëri paraqesin edhe revizionistët jugosllavë, që mbrojnë e zhvillojnë teorinë e «botës së paangazhuar». Ndaj kujt janë të paangazhuar

këta pseudomarksistë? Ata hiqen si të paangazhuar ndaj pakteve, në një kohë që janë plotësisht të angazhuar me themeluesit e këtyre pakteve. Ata u shërbejnë atyre fuqive që udhëheqin paktet, sepse në sajë të tyre rrojnë dhe mbahen në pushtet. Këta zotërinj, ndërsa janë të paangazhuar ndaj revolucionit e luftrave çlirimtare, janë të angazhuar fund e krye me kundërrevolucionin dhe me shtypjen imperialiste. Të tillë «teoricienë» janë zjarrfikës të revolucionit, ata punojnë për të forcuar sundimin e imperializmit dhe pushtelin e kapitalit, duke përhapur ide false mbi nevojën për gjoja reforma strukturore, për reforma ekonomike, për metoda të reja gjoja komuniste të administrimit etj.

Kurse ne, marksistë-leninistët, jemi të angazhuar me revolucionin, jemi të angazhuar me popujt që luftojnë për të fituar lirinë, pavarësinë, sovranitetin, prandaj qëndrojmë të vendosur përkrah popujve që hidhen në luftërat revolucionare e nacionalçlirimtare për t'u çliruar nga çdo lloj zgjedhe. Ne jemi të angazhuar në luftën e përbashkët të popujve kundër imperializmit, socialimperializmit e reaksionit dhe si të tillë jemi në kundërshtim me «teoricienët» e «mosangazhimit», të cilët kërkojnë lëmosha nga imperialistët dhe janë për ruajtjen e statkuosë.

Revisionistët modernë, jugosllavë, sovjetikë, kinezë, eurokomunistë, socialdemokratët etj. bëjnë shumë llogje për gjoja marrëdhënie të barabarta ekonomike midis shteteve, për një rend të ri ekonomik botëror, për ndihmë ndaj vendeve të pazhvilluara etj., por në realitet të gjitha këto janë sloganë që lëshohen për të

ruajtur sundimin e kapitalit, për t'i zgjatur jetën kolonializmit e neokolonializmit. Kjo është një politikë hipokrite dhe ne nuk e fshchim qëndrimin tonë kundër saj. Po ta fshchim të vërtetën, do të bënim krim. Ne kurrë nuk bëjmë politikë me dy faqe dhe luftojmë deri në fund për të vërtetën. Ne i shohim gjërat ashtu siç janë dhe i quajmë me emrat që kanë. Veprojmë kështu, se e kemi gjykuar mirë që kauza jonë është e drejtë dhe e ndershme, prandaj kemi bindjen që ajo do të fitojë.

Ne e themi hapur, gjithashtu, se llafct e bukura rrëth problemeve të çarmatimit që thuhen në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në konferencat e Helsingit, të Beogradit e gjetkë, janë demagogji. Është njëloj sikur «të rrahësh ujë në havan», siç thotë populli ynë. Çarmatimi nuk mund të realizohet asnjeherë me dëshirën e imperializmit, i cili ka krijuar monopolin e armëve strategjike dhe epërsinë e armëve konvencionale, jo për t'u çarmatosur, por për të shtypur revolucionin e popujt, për të shpërthyer luftërat agresive. Shumë vjet më parë Stalini ka thënë:

*«Shtetet borgjeze armatosen dhe riarmatosen me tèrbim. Përse? Sigurisht, jo për muhabet, por për lustë. Dhe lusta u nevojitet imperialistëve, sepse ajo është mjeti i vetëm për rindarjen e botës, për rindarjen e tregjeve të shitjes, e burimeve të lëndëve të para dhe të sfcrave të përdorimit të kapitalit»<sup>1</sup>.*

Ky mendim i Stalinit është më se aktual edhe sot.

Çarmatimi do të arrihet vetëm kur popujt të ngrihen në revolucion, vetëm kur ata t'ua rrëmbejnë imperialistëve armët nga duart dhe t'i bëjnë këto të paefektshme. Po u arrit një situatë e tillë, atëherë imperializmi, forca e të cilit qëndron në këto armë, jep shpirt.

Në botën e sotme kapitali i madh ka thurur rrjetën e merimangës në të gjitha shtetet e botës, të cilat i ka robëruar nëpërmjet kredive, «ndihmave» etj. Ai ka krijuar dhe ushqen pikëpamjen se asnjë shtet në botë nuk mund të rrojë pa marrë kredi. Borgjezia dhe revizionizmi veprimin e drejtë të atij që nuk merr kredi për ndërtimin e vendit të vet, siç bën Shqipëria, e quajnë «jo të kohës, jashtë realitetit». Në të njëjtën kohë, ata konfondonë me qëllime të këqija kreditë e imperialistëve e të kapitalistëve me treqtinë që bëhet me leverdi reciproke dhe në të cilën nuk angazhohet, nga asnjëra palë liria, pavarësia e sovraniteti. Shqipëria socialiste treqtinë me vende të ndryshme e ka praktikuar e do ta praktikojë, pa marrë asnjë kredi nga të huajt.

Tjetër gjë është ndihma që i jepet një shteti socialist nga një shtet tjetër socialist. Kjo ndihmë duhet të jetë internacionaliste dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të shoqërohet nga qëllime të këqija dhe të synoje nënshtrimin e njërit ose të tjetrit shtet ndaj diktatit të nië të fortit ose të më të madhit. Një ndihmë që ndjek qëllime të tilla antimarksiste, nuk është internacionliste, por neokolonialiste e maskuar me petkun internationalist.

**Ndihmat midis vendeve socialiste janë reciproke.**

Ndihmat që na ka dhënë Bashkimi Sovjetik në kohën kur rronte Stalini ishin internacionaliste. Mua më ka pasë thënë Stalini personalisht, se kreditë që po ju jepim, nuk do t'i shlyeni menjëherë, sepse ju keni shumë nevojë të rimëkëmbni ekonominë e të merrni veten. Ai vepronte kështu sepse forcimi i Shqipërisë sociale u shërbente lëvizjes revolucionare dhe luftës së popujve. Ndërsa, siç e kanë provuar faktet, «ndihma» e revisionistëve jugosllavë e më pas ajo e hruščovianëve dhe e kinczëve nuk ka pasur këtë karakter. Përkundrazi, «ndihma» e tyre është udhëhequr nga qëllime të mbrapshta, ka synuar kthimin e Shqipërisë në një shtet vasal të Jugosllavisë, të Bashkimit Sovjetik dhe të Kinës. Këta «aleatë» ishin internacionalistë vetëm me fjalë dhe në kundërshtim me atë që thoshte Lenin si

*«Kryesorja nuk është që të «shpallësh» internacionalizmin, por të dish të jesh... internationalist me vepra»<sup>1</sup>.*

Ju e dini nga Letra që Partia dhe Qeveria jonë u dërguan partisë e qeverisë së Kinës, se udhëheqja revisioniste kineze në mënyrë brutale e armiqësore preu kreditë dhe ndihmat, tërroqi specialistët ekonomikë e ushtarakë nga vendi ynë dhe la pa plotësuar detyrimet për një numër veprash, që ishin kontraktuar me marrëveshje zyrtare. Këto vepra Kina ishte e detyruar, nga marrëveshjet e kontraktuara dhe nga normat ndër-

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vell. 24, f. 72.

kombëtare, t'i realizonte deri në fund. Tani, bile, ajo nuk dëshiron të zhvillojë me ne as tregti me leverdi reciproke.

Këto veprime të udhëheqësve kinezë fryshtohen nga një qëndrim antimarksist dhe shovinist i shtetit të madh, nga synimi për të dëmtuar çështjen e socializmit në Shqipëri. Sjellja e udhëheqësve kinezë ndaj vendit tonë dëshmon se edhe qëndrimet politike dhe ideologjike të tyre ndaj popujve të botës janë qëndrime hipokrite e të pabesa.

Qëndrimet e Partisë dhe të shtetit tonë ndaj Kinës kanë qenë kurdoherë të drejta, të hapcta, të sinqerta, miqësore. Kurse qëndrimet e udhëheqjes kinezë ndaj Shqipërisë, në sipërsaqe, dukeshin sikur ishin marksiste-leniniste, por, siç tregojnë faktet, që kur u vendosën kontaktet midis dy vendeve e deri më sot, ato nuk kanë qenë të tilla, nuk kanë qenë të sinqerta, dashamirëse dhe internacionliste.

Udhëheqja kinezë nuk i ka mbrojtur dhe nuk i ka zbatuar parimet marksiste-leniniste për ndërtimin e socializmit dhe për mbështetjen e çështjes së revolucionit e të çlirimt të popujve. Këtu e kanë burimin edhe qëndrimet e vazhdueshme jashtëzakonisht të turbullta e të koklavitura brenda në Kinë, si dhe ndryshimi i vazhdueshëm i strategjisë dhe i taktikës kinezë për problemet ndërkomëtare. Në politikën antimarksiste dhë pragmatiste të udhëheqjes kinezë e ka burimin edhe qëndrimi i saj armiqësor antishqiptar që çoi në prishjen e marrëdhënieve të miqësisë midis Kinës dhe Shqipërisë.

Në Letrën tonë vihet në dukje se Partia e Punës

e Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet normat që rregullojnë marrëdhëniet midis dy partive marksiste-leniniste dhe dy shteteve socialiste, sa herë kanë lindur mosmarrëveshje në marrëdhëniet me Kinën, vazhdimesht ka propozuar që të bisedohet dhe problemet që kishin dalë, të zgjidheshin në rrugën e një miqësie të sinqertë, pa i bërë ato publike. Partia jonë e ka bërë këtë duke kujtuar dhe duke shpresuar se bisedimet e hapëta shoqërore do të sillnin përfitime të dyanshme, në radhë të parë, përfitime ideologjike dhe politike.

Por udhëheqja kineze, Mao Ce Duni me shokë dhe ata që e udhëheqin aktualisht partinë dhe qeverinë e Kinës nuk kanë ndjekur dhe nuk kanë dashur të ndiqnin një procedurë të tillë marksiste-leniniste. Ata kanë refuzuar diskutimet për divergjencat që kanë ekzistuar me kohë midis nesh.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Shqipëria sociale u lidhën me Kinën jo pér pesë plaçka dhe jo pér tē marrë ca kredi, por pér një unitet revolucionar, pér një kauzë të madhe të përbashkët të njerëzimit: pér ndërtimin e forcimin e socializmit dhe luftën kundër imperializmit, socialimperializmit dhe gjithë reaksionarëve, kundër revizionizmit modern hrushovian dhe të të gjitha ngjyrave. Kjo ishte arsyja e madhe që na lidhte ne me Kinën dhe jo thjesht dhënia e kredive nga ana e saj vendit tonë.

Në një shkrim të botuar kohët e fundit, në shtypin kinez të Ilua Kuo Fenit dhe të Ten Hsiao Pinit, pretendohet se Mao Ce Duni ka thënë: «Ju lutem, ejani dhe më kritikoni ditën dhe natën. Pas kësaj unë do të

ulem dhe do të mendoj me gjakftohtësi, pa fjetur dy ose tri net. Pasi të reflektoj dhe të kem bërë pastrimin e ndërgjegjes, do të bëj sinqerisht autokritikën time.

Bukur kjo në «teori», po në praktikë? E kundërtë. Ne nuk i kemi kritikuar, veçse Mao Ce Dunit dhe udhëheqjes kineze u kemi shfaqur një varg mendimesh. Por fakt është se ata vërejtjet tona shoqërore i kanë marrë si kundërshtime antagoniste dhe vctë Mao Ce Duni është shprehur se nuk do t'u përgjigj atyre, pëarsye se «nuk dëshiron të bëjë polemikë» me ne.

Megjithëkëtë, Partia e Punës e Shqipërisë, kur shikonte se Kina po rrëshqiste gjithnjë e më thellë në batakun revisionist, vazhdonte t'i bënte udhëheqjes kineze vërejtjet e duhura shoqërore dhe të kërkonte diskutime e konsultime me të. Këto diskutime e konsultime u rcfuzuan vazhdimishit nga ana e saj. Për ne është më se e qartë se udhëheqësit kinezë vepronin kështu se ndodheshin në pozita të dobëta dhe nuk mund ta përballonin dot logjikën e fortë marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Ata nuk ishin pür biscdime e konsultime me ne, sepse donin që t'i pranonim pikëpamjet e diktatin e tyre pa asnjë diskutim. Udhëheqja kineze, siç e dini, bëri një sërë shantazhesh nëpërmjet Çu En Lait dhe shokëve të tij, që të na impononte një aleancë ushtarake me Jugosllavinë dhe me Rumaninë. Sigurisht, kjo aleancë planifikohet të realizonte qëllimet e Kinës kundër Bashkimit Sovjetik në pellgun ballkanik dhe të nxiste një luftë botërore imperialiste. Këtë orvatje të kinczëve ne e hodhëm poshtë. Por ata vazhduan të komplotonin kundër Shqipërisë socialiste, kundër Par-

tisë së Punës dhe udhëheqjes së saj. Këtë u përpoqën ta realizonin duke nxitur dhe duke organizuar veprimtarinë tradhtare e sabotuese të grupit puçist të Beqir Ballukut, Abdyl Këllezit, Koço Theodhosit e të tjerë, të cilëve Partia dhe populli ynë u treguan vendin. Kështu ne ua plasëm minat në duar kinezëve. Atëherë udhëheqësit kinezë nuk kishin ç'të bënin tjetër veçse të përdornin mjctin e fundit që menduan se do të bënte efekt të madh në Shqipëri dhe në botë: morën vendimin armiqësor arbitrar e të pabesë, prenë kreditë dhe tërroqën specialistët nga Shqipëria.

Me këtë akt që ndërmorën kundër nesh, udhëheqësit kinezë menduan të na përkulnin, menduan se ne do të mbeteshim si «peshku pa ujë» dhe nuk kishim se si të mos i ndernim dorën dikujt. Ky dikush, sipas tyre, do të ishte Bashkimi Sovjetik revizionist, ose imperializmi amerikan dhe kapitalistët e tjerë. Por ata dështuan dhe do të dështojnë në pikëpamjet e tyre antimarksiste. Shqipëria do të përparojë dhe do ta ndërtojë me forcat e veta socializmin dhe kurrën e kurrrës nuk do t'u shtrijë dorën as socialimperializmit sovjetik, as imperializmit amerikan dhe as çdo shteti tjetër kapitalist ose revizionist.

Hua Kuo Feni dhe Ten Hsiao Pini gjetën si «arsye» për luftë të hapët kundër Partisë sonë vijën e Kongresit të 7-të, ku kritikohej dhe hidhej poshtë e ashtuquajtura teori e «tri botëve». Ata na akuzuan se në Kongresin e 7-të janë sulmuar publikisht Kina dhe Mao Ce Duni. Në fakt, Kongresi i 7-të nuk sulmoi as Kinën, as Mao Ce Dunin, por ai demaskoi teorikisht dhe politikisht teorinë antimarksiste të «tri botëve», e

kujdo që të ishte, e Mao Ce Dunit ose e Ten Hsiao Pinit.

Në një kohë kur kjo «teori» kishte filluar t'i sillte një dëm të madh lëvizjes revolucionare në botë, kur udhëheqësit kinezë kërkonin t'ia impononin atë lëvizjes marksiste-leniniste si vijë të përgjithshme të saj, do të ishte e pafalshme që Partia e Punës e Shqipërisë dhe gjithë partitë e vërteta marksiste-leniniste të mos e kritikonin e të mos e demaskonin atë. Tanimë ishte bërë e qartë se në bazë të kësaj «teorie» qëndronin pikëpamjet shoviniste të shtetit të madh, të një shteti dhe të një partie që ecnin në rrugën antimarksiste, në rrugën socialimperialiste.

Kina, që hiqej si vend socialist, e futi veten në «botën e tretë» dhe këtë e bëri jo pa qëllim, jo pa arsyë. Arsyjeja kryesore është se ajo nuk ishte një vend me të vërtetë socialist dhe udhëheqja e saj nuk ishte një udhëheqje me një vijë marksiste-leniniste, ajo nuk synonte ndërtimin e socializmit të vërtetë në Kinë dhe nuk luftonte kundër kapitalizmit, kundër imperializmit, kundër socialimperializmit e reaksionit.

Kina e futi veten në «botën e tretë», me qëllim që ta dominonte këtë dhe të bëhej një fuqi e madhe kapitaliste, një superfuqi. Por, që të bëhej e tillë, asaj i duhej të konsolidonte influencën e vet në kontinent, në radhë të parë, influencën ideologjike dhe politike, e nëpërmjet saj të realizohet qëllimi i Kinës për të krijuar zona influence dhe për të gjetur tregje për vete. Ky qëllim reaksionar maskohej me sloganin se Kina është një vend socialist, se ajo lufton për çlirimin e popujve, dhe, që këta të çlironen, duhet të bash-

kohen me Kinën, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me gjithë kapitalistët e botës, për të luftuar armikun kryesor të njerëzimit, Bashkimin Sovjetik. Pra në vetvete, në teori dhe në praktikë, teoria e «tri botëve» është një teori kapitalisto-imperialiste.

Pse për Kinën armiku kryesor i njerëzimit është Bashkimi Sovjetik, kur dihet nga e gjithë bota se socialimperializmi sovjetik tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë armiqjtë kryesorë? Bashkimi Sovjetik socialimperialist është armiku kryesor për Kinën jo vetëm se ekonomikisht dhe ushtarakisht ka një potential të madh, por edhe sepse që të dy këto shtete janë në rivalitet për të gënjer e për të sunduar mbi popujt, duke u hequr si vende socialiste. Përveç kësaj, Kina ka edhe qëllime ekspansioni drejt Siberisë e pjesëve të tjera të Bashkimit Sovjetik, drejt Mongolisë, drejt Azisë Qendrore.

Natyrisht, këto qëllime nuk mund të realizohen pa luftë. Prandaj Kina, për t'u forcuar, zgjodhi si partnerë të saj Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kapitalizmin botëror, që janë në konkurrencë me socialimperializmin sovjetik. Kështu të dy, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Kina, mund të bëjnë «çiftin e fuqishëm» për të thyer Bashkimin Sovjetik dhe për të dominuar botën. Më pas, kur ta shohë të mundshme, Kina do të drejtohet edhe kundër imperializmit amerikan për të mbetur e vëtmja superfuqi imperialiste.

Kina, që aspiron të bëhet një superfuqi e re, vazhdon ta zhvillojë politikën e saj hegjemonë në të gjithë botën. Në këtë kuadër duhet parë edhe traktati që ajo nënshkroi me Japoninë, domethënë bashkimi i saj

me një fuqi hegemoniste, kundër një fuqie tjetër hegemoniste, Bashkimit Sovjetik. Ashtu si aleanca me imperializmin amerikan dhe me borgjezinë kapitaliste, edhe ky traktat, në këto kushte, nuk u sjell asnjë të mirë popullit kinez e popujve të tjerë. Përkundrazi, ai nxit luftën, ai ka karakter racist. Vetëm pak ditë pas nënshkrimit të traktatit kino-japonez, Ten Hsiao Pini u sugjeroi militaristëve të tërbuar japonezë që të forcojnë «fuqinë mbrojtëse» dhe të vazhdojnë të qëndrojnë nën «ombrellën bërthamore» të imperializmit amerikan, sepse një gjë e tillë na qenka me «përfitim reciprok», për të dy vendet, për Japoninë dhe për Kinën!

Po kështu vizita e Hua Kuo Fenit në Rumani dhe në Jugosllavi është vazhdim i planit të udhëheqjes kinaze, të Çu En Lait me shokë, për të krijuar, ose për të nxitur blloqe shtetesh kundër socialimperializmit sovjetik dhe sidomos për të shkaktuar provokacione në Evropë, ku ajo dëshiron të zhvillohet lufta e tretë botërore, në të cilën të përleshen e të shkatërrohen Bashkimi Sovjetik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet evropiane, ndërsa Kina të shpëtojë nga ky konflagacion. Një veprim i tillë, që nxit luftërat imperialiste botërore, të cilin Lenini në kohën e tij e ka quajtur kriminal, është jo vetëm antimarksist, por edhe i parealizueshëm. Është i parealizueshëm se kapitalizmi botëror dhe imperialistët nuk mbeten t'i mësojë Kina se kur, qysh dhe ku duhet ta bëjnë luftën. Ata kanë vetë planet e tyre djallëzore.

Vetëm njerëz pa mend në kokë mund të bien brenda në intrigat e udhëheqjes kinaze dhe, për pasojë,

të shkaktojnë katastrofë. Kësaj katastrofe ne, marksistë-leninistët, duhet t'i kundërvëmë jo vetëm vigjilencën, por edhe veprimet tona aktive, për të mos lejuar shpërthimin e saj, sepse ajo bie në kurriz të popujve. Popujt janë ata që i paguajnë me gjakun e tyre synimet ekspansioniste të një grushti kapitalistësh, qofshin këta amerikanë, sovjetikë, gjermanë, japonezë ose kinezë. Planet e luftës nuk mund të shkatërrohen në rast se popujt nuk ua bëjnë të pamundur jetën imperialistëve dhe kapitalit, në qoftë se ata nuk ngrihen në revolucion dhe nuk luftojnë kundër fashizmit dhe gjithë nxitësve të luftës.

Vizita e Hua Kuo Fenit në Beograd vërteton se Kina nuk ka qenë dhe nuk është një vend socialist, se ajo nuk është udhëhequr dhe nuk udhëhiqet nga ideologjia marksiste-leniniste. Udhëheqja kineze ideologjikisht puqet plotësisht me revizionizmin jugosllav. Ajo po përpinqet ta bojatisë titizmin me kërmecë kinez, ashtu siç patën bërë e vazhdojnë të bëjnë edhe revizionistët hruçhovianë, eurokomunistët e të tjera. Titoja, nga ana e tij, me «zëmërgjerësi» e ktheu fletën e librit dhe tha se lash po hapet një faqe e re në marrëdhëniet në mes Kinës dhe Jugosllavisë. Sigurisht, miqësia midis tyre do të zhvillohet në interes të kapitalizmit në këto dy vende dhe në interes të kapitalizmit botëror.

Shqipëria, me qëndrimin e saj marksist-leninist ndaj politikës kineze, u thotë popujve të Jugosllavisë dëhe popujve të tjera të Ballkanit të jenë vigjilentë ndaj intrigave të udhëheqjes kineze, ashtu sikurse të jenë vigjilentë edhe ndaj intrigave dhe komploteve të imperialistëve amerikanë, të socialimperialistëve sovje-

tikë, sepse realizimi i këtyre komplateve, do t'u shkaktojë popujve fatkeqësi të mëdha.

Kryetari i revizionistëve kinezë dhe mik i gjeneralëve e i mareshalëve, Hua Kuo Feni, gjatë vizitës së tij në Jugosllavi na erdhi afër kufijve tanë për të kurdisur intriga kundër Shqipërisë socialiste dhe vendevë të tjera të Ballkanit.

Përveç të tjerave, ai luajti edhe rolin e provokatorit ndaj kombit shqiptar. Ai na e gjeti të zgjidhur «shumë bukur dhe në rrugën marksiste-leniniste» çështjen e pakicave kombëtare shqiptare në Jugosllavi, të kurdisur nga junkeri Bismark, nga Bikonsfildët dhe lord Grejët, traktatet e fshehta të të cilëve kundër Shqipërisë i demaskoi dhe i çori Lenini. Hua Kuo Feni «harroi» se shqiptarët që banojnë në Jugosllavi, si nga madhësia e tokave të tyre, ashtu edhe nga numri i popullsisë janë sa dy republika bashkë të Jugosllavisë dhe më shumë. Ata janë një popull i vetëm, por i kanë hallakatur në dy republika dhe në një krahinë autonome, pse ashtu i leverdiste «zgjidhjes së drejtë marksiste-leniniste», siç e çmoi Hua Kuo Feni. Duam t'i themi zotit Hua Kuo Fen se miqtë, që e pritën, nuk ia trenguan varfërinë dhe mungesat e të drejtave konstitucionale, që nuk ua japid shqiptarëve, veçanërisht në Maqedoni, ku ai e gjeti me vend ta ngrinte këtë problem.

Ne i themi atij, gjë që duhet ta ketë kuptuar tashmë, se shqiptari nuk duron as zgjedhë dhe as diktate, se ai nuk frikësohet as nga shantazhet. Popullin shqiptar mos e zemëroni, ai është i durueshëm, por, kur zemërohet shqiptari, merr zjarr e flakë edhe stralli.

Hua Kuo Feni në fjalimin që mbajti në banketin kryesor përpëra Titos dhe zyrtarëve të lartë jugosllavë, nuk e përmendi marksizëm-lininizmin, dhe nuk kishte pse ta përmendte, se nuk beson në të. Por ai nuk përmendi as teorinë e «tri botëve», as qenien e Kinës në «botën e tretë», kurse mburri vazhdimesht «lëvizjen e të paangazhuarve». Këtë gjë nuk e bëri për kompliment ndaj Titos, i cili hiqet si udhëheqës i «botës së paangazhuar», por sepse Kina është Hua Kuo Feni synojnë të zënë vendin e parë në «lëvizjen e të paangazhuarve», pas vdekjes së Titos. Por edhe këto llogari udhëheqjes revizioniste të Kinës do t'i dalin të gabuara.

Sidoqoftë, qëllimet e Kinës do të demaskohen, por ato janë shumë të rrezikshme, po aq të rrezikshme sa edhe ato të Bashkimit Sovjetik, të Shtetev të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera kapitaliste. Partia e Punës e Shqipërisë vepron drejt kur demaskon teoritë dhe veprimtarinë antimarksiste të udhëheqjes kincze, që ka në bazë të ashtuquajturën maocedunide, e cila nuk mund të jetë dhe as që ka qenë kurrë marksiste-leniniste. Këtë gjë ne po e pohojmë dhe e pohojmë me fakte, me fakte teorike dhe konkrete.

Ne duam dhe luftojmë që popujt e botës dhe proletariati botëror të mos gënjen nga sloganë të tillë si «bota e tretë», «bota e paangazhuar», por për luftën e tyre ngadhënjimtare kundër kapitalizmit botëror, kundër shtypjes dhe skllavërimit nga kolonialistët e neokolonialistët të mbështeten te Marksit, Engelsi, Lenini dhe Stalini.

Shokë,

Në marrëdhëniet tona me botën e jashtme Partia dhe Qeveria janë kanë ndjekur dhe ndjekin një politikë të hapët dhe korrekte. Kur partnerët tanë janë marksistë-leninistë të vërtetë, atëherë marrëdhëniet me ta zhvillohen në rrugën e miqësisë, të bashkëpunimit vëllazëror dhe të ndihmës reciproke. Me shtetet kapitaliste e revisioniste ne zhvillojmë marrëdhënie tregtare e kulturore me leverdi reciproke, me kusht që të respektohen barazia, sovraniteti dhe mosndërhyrja në punët e brendshme. Marrëdhëniet tregtare me këto vende nuk mund të influencojnë në asnje mënyrë në politikën dhe në ideologjinë tonë marksiste-leniniste.

Një vend kapitalist mund të mos dojë të bëjë tregti me vendin tonë socialist. Ky fakt nuk na detyron ne që të ndërrojmë as ngjyrën, as politikën, as ideologjinë. Në qoftë se nuk dëshiron njëri, ka të tjera vende kapitaliste me të cilat ne mund të bëjmë tregti.

Qëndrimet tona politike dhe ideologjike ndaj shteteve kapitaliste e revisioniste i kemi përcaktuar qartë, ne luftojmë kundër ideologjisë, politikës, metodave dhe veprimeve të tyre, ashtu siç luftojnë edhe ata kundër marksizëm-leninizmit, kundër revolucionit, kundër socializmit. Ne përkrahim lëvizjet çlirimtare, solidarizohemi dhe bashkëpunojmë me partitë marksiste-leniniste për të ndihmuar revolucionin proletar dhe luftën nacionalçlirimtare, por nuk ndërhyjmë as me diversion, as me sulm të armatosur.

Përveç marrëdhënieve tregtare, ne kemi edhe ma-

rrëdhënie kulturore me shumë vende të botës dhe duam t'i zhvillojmë më tej këto. Kultura përparimtare botërore duhet të përvetësohet, por ne nuk jemi për t'i hapur portat çdo «kulture». Në Shqipërinë socialiste interesat e socializmit dhe të revolucionit kërkojnë përhapjen e asaj kulture përparimtare që i shërben edukimit komunist e të gjithanshëm të punonjësve dhe që ndihmon afrimin dhe miqësinë me popujt. Ne nuk bëdhim nëpër «njëqind lule» e «një qind shkolla», as nuk kalojmë nga njëri ekstrem në tjetrin lidhur me vlerësimin e arritjeve të artit e të kulturës përparimtare botërore. Ndaj kulturës përparimtare botërore Partia na mëson të mos jemi ksenofobë.

Natyrisht, eksperiencia dhe kultura e madhe progresiste botërore, të zgjedhura me kujdes, janë thesare të vyera që duhen shfrytëzuar nga të gjithë. Ka rëndësi të theksohet se ne e kemi për detyrë jo vetëm të marrim nga kultura e huaj, por të përhapim edhe kulturën tonë. Ne e çmojmë kulturën përparimtare të të tjerëve, por duhet të punojmë që edhe ata të njihen e të vlerësojnë thesaret e kulturës sonë të lashtë e të sotme socialiste.

Armiqtë na akuzojnë sikur gjoja kemi mbyllur portat e komunikimit kulturor e shkencor me botën! Kjo nuk është e vërtetë. Për kulturën përparimtare dhe për shkencën e vërtetë botërore ne i kemi portat kurdoherë të hapura, se jemi të interesuar për progresin. Por, siç kemi deklaruar ngaherë, nuk do t'i plotësojmë kurrë dëshirat e atyre që kërkojnë të hapim portat për kulturën e degjeneruar dhe dekadente, siç u përpoq të bënte armiku i Partisë, Fadil Paçrami, i cili

mohonte dhe luftonte traditat e shëndosha të letërsisë e të artit tonë kombëtar dhe inkurajonte e përkrahte përhapjen e ndikimeve e të shfaqjeve të huaja moderniste. Partia e Punës e Shqipërisë dhe shteti ynë i diktaturës së proletariatit rrinë zgjuar në këtë drejtim, ata dinë si të mbrohen, si ta ndajnë shapin nga sheqeri, prandaj nuk u prishet puna se ç'thonë keqdashësit për ta.

Duke qenë për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare e kulturore me shtetet e tjera, duke shprçhur dëshirën për marrëdhënie miqësore e me dobi reciproke me to, kjo nuk do të thotë se ne duhet të heqim dorë nga parimet dhe nga qëndrimet tona. Pretendimi i revizionistëve jugosllavë, i revisionistëve të tjerë dhe i kapitalistëve se, për hir të të tillë marrëdhënieve, ne nuk duhet t'i demaskojmë, për sa kohë që ata nuk na sulmokan ne, është absurd. Nuk është aspak e vërtetë që ata nuk na sulmojnë. Sulmi i tyre kundër nesh, kundër socializmit, kundër Marksit, Engelsit, Leninit, Stalinit dhe diktaturës së proletariatit është i qartë e i vazhdueshëm. Në qoftë se ata i njohin vetes të drejtën të mbrojnë idetë e tyre dhe të bëjnë politikën e tyre, përsë qahen kur edhe ne ushtrojmë të drejtat tona për të mbrojtur idetë dhe për të bërë politikën tonë?

Në marrëdhëni tona me shtetet kapitaliste e revizioniste merren parasysh gjithashtu edhe qëndrimet konkrete të këtyre shteteve me vendin tonë. Duke u nisur nga këto qëndrimet, ne dallojmë ato që janë dashamirëse ndaj nesh, që janë për atrim miqësor dhe për shkëmbime tregtare e kulturore normale me vendin tonë. Me të tillë shtete, si vendet nordike dhe Austria, Belgjika, Franca, Holanda, Zvicra etj., marrëdhë-

niet tregtare të shtetit tonë ka mundësi të zhvillohen me leverdi reciproke dhe marrëdhëniet kulturore të zhvillohen më mirë. Ne jemi të interesuar që popujt e këtyre vendeve të njihen me politikën e Partisë dhe të shtetit tonë, si edhe me arritjet në ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Po kështu na intereson që edhe në të njohim popujt e tyre, vlerat e mira që ata kanë krijuar, që të rritet simpatia reciproke në mes popujve tanë.

Midis shteteve kapitaliste ka edhe të tilla që në të kaluarën kanë pasë yepruar kundër lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë. Ndaj këtyre shteteve Shqipëria qëndron vigjilente, se edhe situata në disa prej tyre nuk është e qetë, atje janë gjallëruar elementët fašistë, që i kanë shkaktuar dëme të mëdha popullit shqiptar në të kaluarën. Ne mendojmë, dhe kjo është një gjë e ligjshme, se ato shtete që kanë detyrime ndaj Shqipërisë, duhet t'i shlyejnë sa më parë, në qoftë se duan të normalizojnë marrëdhëniet me ne.

Me Italinë ne do të vazhdojmë të bëjmë tregti me leverdi reciproke, do të zhvillojmë edhe marrëdhëniet kulturore, por faktet historike na detyrojnë që t'i vëzhojmë me vigjilencë të madhe të gjitha ngjarjet që ndodhin atje dhe që rrezikojnë edhe vendin tonë.

Me udhëheqjen revisioniste jugosllave ne kemi kontradikta të papajtueshme ideologjike e politike, prandaj qëndrojmë kurdoherë vigjilentë ndaj politikës së saj. Megjithëkëtë, mbi bazën e respektimit të sovranitetit, të mosndërhyrjes, të fqinjësisë së mirë e të leverdisë reciproke, ne jemi për vazhdimin normal të marrëdhënieve tregtare dhe kulturore me Jugosllavinë. Me popujt e Jugosllavisë ne duam të rrojmosh në miqësi dhe

në të drejtat tona. Pikëpamjet tona nç ua themi hap-tazi atyre, qëllimet tona kanë qenë dhë do të jenë kurdoherë të mira. Deklaratat tona nuk lëvizin.

Me Greqinë kemi marrëdhënie miqësore. Me popullin grek kurdoherë kemi dashur dhe duam të rrojmë në fqinjësi të mirë. Qeveria aktuale greke i është përgjigjur dëshirës sonë që në kufijtë e të dy vendeve të ekzistojë qetësia. Ky qëndrim realist i tyre është i mirë. Po zhvillohen në mënyrë të kënaqshme marrëdhëniet në fushën e tregtisë e të kulturës. Ne jemi gati të ecim në këtë rrugë, që është në të mirën e të dy popujve tanë dhe dëshirojmë të jemi kurdoherë miq të sinqertë me njëri-tjetrin. Populli shqiptar konstaton se edhe populli grek është për këtë miqësi.

Edhe me Turqinë kemi marrëdhënie miqësore, marrëdhënie të mira tregtare e kulturore, të cilat dëshirojmë që të ecin akoma më përpara. Me kënaqësi kemi konstatuar se populli dhe autoritetet turke kanë pritur me entuziazëm e me përzemërsi shfaqjet e ansambleve tona artistike në vendin e tyre, të cilat forcojnë miqësinë në mes popujve.

Një miqësi tradicionale lidh vendin dhe popullin tonë me vendet dhe popujt arabë. Marrëdhëniet tona me ta zhvillohen në rrugë normale. Ne përkrahim luf-tën e tyre të drejtë e të vendosur për çlirimin e tokave të pushtuara nga Izraeli, përkrahim luftën e drejtë e heroike të popullit arab palestinez për të fituar të drejtat e tij kombëtare.

Shteti i Izraelit është një shtet i fabrikuar nga sionizmi dhe imperializmi ndërkombëtar, në kurrit të popujve arabë dhe veçanërisht të atij palestinez.

Të tentosh të grumbullosh diasporën e shekujve dhe të likuidosh një komb e një kombësi mijërvjeçare, duke kriuar një diasporë të re dhe një tirani «moderne», të praktikosh gjenocidin, të zhdukësh të drejtat dhe liritë e një kombi nën pretekstin e një kombësie të dyshimtë, kjo dënohet nga kombet dhe nga popujt përparimtarë të botës dhe shpejt osc vonë mëria do të kthehet në një luftë të përgjakshme nacionalçlirimtare, siç po ngjet me popullin heroik palestinez.

Nuk mund të fshihen persekutimet dhc mizoritë që u bëhen kombeve osc pjesës së një kombi, siç është rasti i arabëve dhe i palestinezëve, duke i mbuluar këto veprime të dënueshme, e që bien erë shtypje, me përralla false si «irredentizëm», «shovinizëm», «nacionalizëm». Populli shqiptar, që në shkuj ka luftuar tiraninë, do të mbrojë kurdoherë liritë dhe të drejtat e popujve dhe vëçanërisht të popullit vëlla palestinez. Populli shqiptar nuk shkel të drejtat e kurkujt, por të tijat dhe të atij që ka të drejtë i mbron me këmbëngulje, me guxim dhe me trimëri.

Popujt arabë ndodhen vazhdimisht përballë agresionit sionisto-imperialist dhe komploteve të egra e shumë të rrezikshme të të dyja superfuqive e fuqive të tjera imperialiste. Tash po bëhen përpjekje të gjithashme për t'i përqarë ata më thellë, për t'i hedhur kundër njëri-tjetrit, sepse vetëm këshlu mund të realizohen më mirë qëllimet hegemoniste të imperialistëve në krejt rajonin e Lindjes së Mesme dhe të sigurohen kufijtë e atij që sionizmi ndërkombëtar e quan «Shteti i madh izraelit», që nafta e vendeve të Lindjes së Mes-

me të vazhdojë të grabitet nga monopolet e mëdha amerikane, sovjeteve etj.

Por popujt arabë, që kanë tradita të lashta kulturore e që në shekuj kanë luftuar me trimëri për lirinë e pavarësinë e tyre, do të dinë t'i përballojnë situatën e reja dhe me siguri do të shpartallojnë çdo komplot antiarab, do të forcojnë unitetin e vet e, mbi këtë bazë luftarake, do ta shpien përpëra luftën e tyre deri në fitoren e plotë mbi armiqjtë sionistë e imperialiste.

Partia dhe populli ynë, ashtu si në të kaluarën, janë solidarë dhe përkrahin luftën e drejtë dhe përpjekjet e guximshme të popujve të Afrikës, të Azisë e të Amerikës Latine kundër imperializmit, socialimperializmit, kolonializmit e neokolonializmit, kundër dallimit racial, shfrytëzimit e shtypjes, për çlirimin kombëtar e shoqëror, për forcimin e pavarësisë e të sovranitetit të tyre. Ne përkrahim luftën çlirimtare të popujve të Zimbabvesë, të Namibisë e të Azanisë kundër regjimeve raciste e ndërhyrjeve imperialiste.

Populli shqiptar dënon intrigat e komploteve që thuren nga socialimperialistët kincë kundër popullit vietnamez. Ne mendojmë se konflikti midis Vietnamit e Kambozhias, midis dy popujve vëllezër, duhet të zgjidhet në rrugën e bisedimeve dhe pa ndërhyrje nga jashtë, në interes të pavarësisë e të sovranitetit të dy vendeve.

## Përparimi i ekonomisë e i kulturës sonë rrit mirëqenien e punonjësve dhe forcon mbrojtjen e atdheut

Të dashur shokë dhe shoqe,

Zhvillimi i forcave prodhuase, përsosja e marrëdhënieve socialiste në prodhim dhe metodat e drejtimit e të administrimit të pasurisë së popullit kanë bërë që ekonomia janë të përparojë vazhdimesht, të ngrihen mirëqenia e masave punonjëse dhe niveli i tyre arsimor e kulturor.

Dy degët kryesore dhe vendimtare të ekonomisë sonë socialiste, industria dhe bujqësia, janë zhvilluar në atë nivel sa janë në gjendje të plotësojnë nevojat e masave punonjëse në mënyrë të kënaqshme.

Industria janë është moderne. Që të vihej ajo në lëvizje, shtetit socialist i është dashur të ndërtojë, krahas uzinave të ndryshme, një varg hidrocentralesh dhe termocentralesh, të cilat janë futur dhe po futen në shfrytëzim të plotë.

Ndërtimi i hidrocentraleve ka arritur në atë shkallë, sa jo vetëm ka krijuar bazën e nevojshme energjetike, por i ka aftësuar shumë edhe punëtorët, teknikët dhe inxhinierët, të cilët janë plotësisht në gjendje të ndërtojnë hidrocentrale të fuqishme, që planifikohen për t'u bërë me forcat tona. Këtë punë shteti ynë do ta vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim që energjia elektrike të shtohet dhe kështu të shfrytëzohen të gjitha mundësitë hidroenergjetike të vendit.

Industria jonë e rëndë është fuqizuar dhe po ecën përpara. Ky fakt ka rëndësi shumë të madhe, pse dihet që zhvillimi i saj u jep gjithë degëve të ekonomisë mundësi për përparimin e shpejtë të tyre. Ky sukses është arritur duke u mbështetur në forcat tona të brendshme, materiale dhe njerëzore. Industria e rëndë, siç dihet, në radhë të parë konsiston në nxjerrjen dhe në përpunimin e mineraleteve. Mineralet e ndryshme, që nga nafta deri te kromi e te polimetalet, janë një pasuri e madhe e vendit tonë. Këtë pasuri, që i sigroron ekonomisë lëndët e para tepër të çmucshme e të pazëvendësueshme, ne e shfrytëzojmë në mënyrë rationale. Aktualisht në vendin tonë janë zbuluar minrale për disa dekada. Ne do të zbulojmë burime të tjera mineralesh, me të cilat nëntoka jonë është e pasur, si për sa u përket rezervave e cilësisë, ashtu edhe për sa i përket shumëllojshmërisë së tyre dhe do të hapim perspektiva akoma më të mëdha që ato, në të ardhmen, të përpunojen të tëra në vend. Kështu do të ngrihet e do të forcohet më tej industria dhe do të shtohet eksporti, që do të sjellin fuqizimin e atdheut tonë socialist dhe të mbrojtjes së tij të sigurt nga çdo rrezik.

Populli i di minierat e shumta që janë hapur në të gjitha anët e vendit. Ai, tok me specialistët e ndryshëm, merr pjesë vetë dhe ndihmon në kërkimin e në zbulimin e mineraleteve. Shqipëria është një nga vendet e pakta naftëmbajtëse në Evropë, është një vend që ka një pasuri të madhe kromi, bakri e shumë minerale të tjera. Për nxjerrjen e këtyre pasurive punojnë me dhjetëra mijë punëtorë e specialistë, të cilët kanë fituar dhe vazhdojnë të fitojnë aftësi të veçanta në zbulimin

dhe në përpunimin e mineraleve. Është një sukses i madh që e gjeson popullin, kur ky sheh se bijtë e tij, me duart dhe me mendjet e tyre të shkathëta, nxjerrin nga nëntoka pasuritë e mëdha të vendit dhe i kthejnë këto në vlera të çmueshme për mirëqenien e tij. Përparimi dhe lulëzimi i ekonomisë socialiste kërkojnë, veç të tjerave, njojuri teknike dhe shkencore, disiplinë të lartë, ndërgjegje të pastër, durim dhe pjekuri, prandaj Partia ka shtruar detyrën që njerëzit të mësojnë vazhdimesht, të përvetësojnë mirë diturinë dhe shkençën dhe t'i zbatojnë ato në mënyrë racionale dhe në interesin e përgjithshëm.

Krahas nxjerrjes së mineraleve, ne kemi ndërtuar edhe kombinate e fabrika të ndryshme, që i përpunojnë këto minerale. Kemi ngritur, në radhë të parë, industriën e hekur-nikclit, që pjesërisht ka përfunduar dhe ka hyrë në prodhim, pjesërisht akoma jo, për arsyet e vështirësive që na krijoi veprimi i pabesë e armiqësor i udhëheqjes kineze ndaj vendit tonë. Por Partia ka marrë të gjitha masat që kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë» të ndërtohet plotësisht.

Me forcat tona kemi ndërtuar po ashtu fabrika të tjera për përpunimin dhe pasurimin e mineraleve. Të gjitha këto degë të industrisë do t'i shumëfishojmë në bazë të lëndëve të para që njohim, të rezervave aktuale dhe të atyre që do të krijojen në të ardhmen. Perspektivat janë të atilla që të kemi bakrin dhe hekurin tonë, që na duhen për industrinë e ardhshme, të kemi çimento më shumë, të kemi traktorë më shumë, të kemi sheqer më shumë etj.

Tok me këto fabrika dhe kombinate, ne kemi ngriti

tur gjithashiu një industri të përparuar e të fuqishme mekanike, e cila është në gjendje të mirëmbajë fabrikat që kemi ndërtuar, t'i modernizojë ato më tej dhe të prodhojë fabrika e linja të plota të reja. Ne planifikojmë të ndërtojmë plotësisht fabrika të reja me forcata tonë.

Partia dhe pushteti kanë krijuar dhe kanë edukuar një klasë punëtore të ndërgjegjshme, të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, e cila, nën drejtimin e Partisë, udhëheq shoqërinë në rrugën e socializmit. Përtatë kryer më mirë misionin e saj historik, është e domosdoshme që klasa punëtore t'i përvetësojë si duhet teorinë marksiste-leniniste dhe mësimet e Partisë, këshillat dhe udhëzimet e saj dhe t'i zbatojë ato në jetë. Ajo duhet të kuptojë se forcimi dhe pastërtia e ndërgjegjes, veprimet e guximshme në platformën politike, ekonomike e të mbrojtjes kanë një rëndësi të veçantë për unitetin e kombit tonë përpara valës së madhe armiqësore dhe korruptucse të imperialistëve dhe të revisionistëve në botë.

Bujqësia është sektori tjetër, shumë i rëndësishëm dhe bazë, i ekonomisë sonë. Ajo përparon e lulëzon, sepse për zhvillimin e saj në rrugën socialiste Partia ka zbatuar vijën leniniste të kolektivizimit. Sikurse e dini, ne arritëm të bëjmë bukën në vend, të realizojmë rendimente të larta në grurë, në misër dhe në kultura të tjera bujqësore. Rendimentet në prodhimin bujqësor do të shkojnë duke u rritur për arsyen të bashkimit të tokave, të organizimit të punës kolektive, të ngritjes politiko-ideologjike të kooperativistëve, të mekanizmit të madh të punimeve, të përdorimit të plehrave kimike,

të shërbimeve, të zhvillimit të blegtorisë etj. Këta faktorë kanë kriuar dhe do të krijojnë më shumë mundësi në të ardhmen për zhvillimin e pandalshëm të bujqësisë sonë socialiste.

Në fshatin tonë kooperativist në radhë të parë është formuar botëkuptimi i shëndoshë mbi rëndësinë e madhe të pronës së përbashkët dhe mbi nevojën e mbrojtjes dhe të zhvillimit të saj. Forcimi i një botëkuptimi të tillë ka rëndësi të madhe politike dhe ekonomike. Të gjitha vendimet e Partisë dhe të shtetit tonë, në lidhje me bujqësinë, kanë në themel të tyre mësimet e Leninit e të Stalinit mbi organizimin dhe mbi forcimin e kooperativave dhe nxitjen e interesimit të kooperativistëve për këtë organizim. Çdo gjë në kooperativat bujqësore është organizuar në atë mënyrë, që prona e përbashkët socialiste të zotërojë në fshat dhe të ndikojë në psikologjinë, në mendimin e në veprimin e kooperativistëve. Statuti i kooperativave bujqësore lejon edhe një sipërfaqe të vogël oborri kooperativist në përdorim personal, si dhe një numër të kufizuar kafshësh. Ekzistenca e këtij oborri dhe e këtyre kafshëve, aktualisht, nuk e pengon ecjen e bujqësisë drejt përparimit.

Rrugën e kolektivizimit revisionistët modernë e kanë braktisur, se ajo i pengonte në rivendosjen e kapitalizmit në fshat. Revisionistët janë futur në rrugën e krijimit të pronës së madhe të borgjezisë së pasur fshatare. Në Poloni nuk janë kriuar kurrë kooperativa të vërtcta bujqësore, kurse në fshatin jugosllav ato janë prishur me kohë, duke ia lëshuar vendin pronës së madhe kapitaliste.

Ne, të moshuarit, i kemi parë dhe i mbajmë mend bujqësinë e Shqipërisë dhe bujkun shqiptar në mjerim, tokat moçalishte e të mbetura djerr, kemi parë kur merrej një rendiment që nuk i kalonte 5-6 deri 8 kuintalë drithë për hektar dhe kur nuk mbillej asnje bimë industriale. Tash, kudo që të hedhësh sytë, kudo që të vësh këmbën, nuk shikon veçse tokë të punuar, të mbjellë, të lulëzuar, të pyllëzuar, nuk shikon veçse bagëti të shëndoshë etj.

Të rintjtë, që e shohin këtë natyrë të fshatit kaq të bukur dhe bujqësinë kaq të përparuar, duhet të mos harrojnë se baballarët, nënët, vëllezërit dhe motrat e tyre kanë derdhur djersën rrëke për t'i kthyer këto fusha, këto kodra e male në toka pjellore dhe kanë derdhur gjak për t'i mbrojtur. Prandaj nuk mjaftojnë vetëm kënaqësia e ligjshme dhe respekti i madh për të moshuarit e për veprën e tyre, por duhen krijuar e nxitur edhe ndjenjat luftarake dhe dashuria për punë të palodhur në fshat. Vajtja e qytetarit për të punuar në fshat, është një detyrë patriotike në shërbim të atdheut e jo një sakrificë. Tek i riu dhe e reja shqiptare duhet të formohet ndjenja e krenarisë dhe e gjëzimit për punën në fshat. Të rintjtë duhet të kenë vullnet dhe dëshirë për t'i ngulur këmbët në fshatin tonë të kolektivizuar dhe për të derdhur atje djersë e dituri që të vazhdojnë punën e brezave të mëparshëm më me forcë dhe të arrijnë rezultate akoma më të mëdha, që të modernizohet prodhimi e të sigurohen rendimente më të larta.

Partia dhe pushteti popullor nuk i mohojnë interesat personalë të njerëzve, përkundrazi, këta interesa,

kur nuk vijnë në kundërshtim me ligjet dhe me rregullat e bashkëjetesës socialiste, mbrohen në kuadrin e interesit të përgjithshëm. Interesi i përgjithshëm është ai që duhet të mbizotërojë, të qëndrojë mbi interesin personal, sepse në këtë mënyrë gjithsecili do të përmirësojë gjendjen ekonomike, kulturore dhe do të spastrojë ndërgjegjen e tij nga çdo mbeturinë e huaj. Një punë e tillë edukative, e gjerë, që njerëzit të mos ia kundërvënë interesin personal interesit të përgjithshëm, është e domosdoshme të zhvillohet vazhdimit në procesin e ndërtimit të ekonomisë socialiste.

Shokë dhe shoqe,

Për formimin e njeriut të ri me ndërgjegje dhe me botëkuptim të pastër proletar, me ndjenjën e dashurisë proletare për shokun, është dashur një luftë e madhe politike, një edukatë e shëndoshë ideologjike dhe morale. Por puna dhe lufta që kemi bërë gjer tanë, kurrë nuk mund të quhen të rjaftueshme. Një fabrikë mund të ngrihet nga njerëzit për një kohë të caktuar dhe të futet në prodhim, por për çështjen e ndërgjegjes dhe të ngritjes së njeriut të ri në atë shkallë që kërkon Partia, duhet një punë e vazhdueshme politike, ideologjike, për arsy se mbeturinat në ndërgjegjen e njerëzve ruhen për një kohë të gjatë, ato janë të lidhura me ndjenjën e pronës private dhe me ekzistencën e ndikimit korruptues të rrethimit kapitalisto-revisionist.

Ne jemi krenarë për rininë tonë heroike, që ecën

sipas mësimeve të Partisë dhe derdh të gjitha energjitet e veta në fabrika, në ara, në shkolla, në radhët e Ushtrisë Popullore, në të gjithë sektorët e jetës së vendit. Djemtë dhe vajzat e Shqipërisë ata që rritin dhe plotësojnë armatën e madhe të klasës sonë punëtore, të fshatarësise kooperativiste dhe të inteligjencies popullore janë e ardhmja e atdheut, prandaj Partia dhe gjithë shoqëria kujdesen në mënyrë të veçantë që ata të rriten ideologjikisht të shëndoshë dhe politikisht të pastër.

Në një shkallë shumë të lartë e ka ngritur Partia nivelin arsimor e kulturor të popullit tonë. Është një fitore e madhe, që dëshmon për kujdesin e veçantë të pushtetit popullor, fakti që tani shumë fshatra kanë shkollë të mesme dhe mjaft qytete kanë institute të larta e filiale të universitetit. Në këto shkolla, që i kanë ngritur vetë, mësojnë dhe japid mësim djemtë dhe vajzat e popullit, bijtë dhe bijat e tij.

Përparime të papara janë arritur në fushën e artit, në letërsi, muzikë, kinematografi, picturë, teatër etj. Një pasqyrë e qartë e dashurisë që ka populli për artin e tij, si dhe e pasionit me të cilin ai e kultivon atë, ishte Festivali Folklorik i Gjirokastrës. Nëpërmjet këngës dhe valles së tij të bukur populli shprehu gëzimin për jetën e re, dashurinë për Partinë, besimin në të ardhmen.

Zhvillimi i ekonomisë e i kulturës ka sjellë ngritjen e vazhdueshme të mirëqenies së popullit. Në shoqërinë tonë socialiste njerëzit rrojnë të gëzuar në familjet e tyre dhe në gjirin e shoqërisë.

Ne me kënaqësi vëmë re që populli ynë po shto-

het. Shqipëria është vendi që ka rritjen më të madhe të popullsisë në Evropë, ajo është vendi i lindjeve të shumta dhe i vdekjeve të pakta. Pushteti populor ka marrë të gjitha masat që përqindja e rritjes së popullsisë të shtohet. Vendin ynë është i begatë dhe me burimet e pashtershme të ekonomisë së tij është në gjendje të mbajë akoma miliona njerëz.

Në vendet rreth e rrrotull nesh, në të gjithë botën ka me miliona të papunë, miliona të tjerë s'kanë ç'të hanë, ka me qindra mijë njerëz, që dalin nga kasolleth ose nga shtëpitë në mëngjes dhe nuk janë të sigurt nëse do të kthehen në mbrëmje.

Mbi punonjësit në botën kapitalisto-revizoniste bien taksa të rënda që majmin borgjezinë dhe sundimtarët, të cilët bëjnë një jetë përrallore, atje ngrihen çmimet, zhvleftësohet paraja, shtohen mjerimi dhe urla, degjenerohet shoqëria. Këto pasoja u ka sjellë punonjësve regjimi i urryer i kapitalit në kalbëzim dhe i revizionizmit.

Krejt ndryshe është pasqyra e gjendjes në vendin tonë. Në Shqipëri nuk ekzistojnë më taksat. Te ne njerëzve u janë krijuar kushte që të mësojnë, të pushojnë, të mjekohen e të kurohen falas. Shteti ka marrë përsipër kryerjen e shumë shërbimeve pa pagesë, me qëllim që të ardhurat e shtetasve të çlironen nga çdo cungim.

Dyqanet tona janë plot me mallra të manifakturës, të industrisë, me mallra ushqimore etj. Çmimet asnjëherë nuk janë ngritur në vendin tonë, kurse në vendet kapitaliste e revizioniste ndodh e kundërtat. Qiratë e banesave te ne janë fare simblike. Pushteti populor

në çdo veprimtari që kryen synon të mirën e popullit, rritjen e mirëqenies dhe të nivelistës së tij. Kjo gjendje shumë e mirë ne na inkurajon e na i shton akoma më tepër forcat që të ecim përpara në rrugën e përparimit e të socializmit, ku na udhëheq Partia.

Këtë situatë kaq të mirë të vendit tonë e shohin edhe miqtë, edhe armiqqtë. Miqtë gjëzohen për arritjet tona dhe ne i falënderojmë për dashamirësinë e tyre. Kurse armiqqtë, që gjykojnë sipas koncepteve të tyre kapitaliste e revisioniste, nuk mund ta kuptojnë situatën tonë. Ata nuk e duan përparimin e vendit tonë, as regjimin që e ka sjellë këtë përparim, për arsyet se zhvillimi dhe sistemi ynë janë pasqyrë e qartë e perspektivës për popujt që duan liri, pavarësi e sovranitet të vërtetë. Në të njëjtën kohë, meqenëse realiteti ynë mohon sistemin kapitalist, ata na luftojnë me propagandë, përpiken të na luftojnë me diversion e me çdo mënyrë. Në këto rrethana ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë, ta forcojmë dhe ta zhvillojmë ekonominë tonë në mënyrë që ajo të bëhet një pasqyrë akoma më e ndritshme e rendit të vërtetë socialist.

Në kushtet aktuale konkrete të vendit tonë, forcimi i vazhdueshëm i mbrojtjes së atdheut, duke u mbështetur në forcat tona, merr një rëndësi të veçantë. Për të përmbushur detyrën e tij sublime, populli ynë është organizuar në forcat e armatosura dhe stërvitet ushtarakisht. Ne kemi zbatuar me besnikëri mësimet e Leninit për shkrirjen e ushtrisë me popullin, me qëllim që çdo ushtar të jetë qytetar e çdo qytetar të jetë edhe ushtar. Në përpunimin e Artit Ushtarak Popullor Partia është bazuar në shkencën ushtarake

marksiste-leniniste, në eksperiencën e luftërave të popullit tonë e veçançrisht të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimitare, si dhe në eksperiencën e luftërave të popujve të tjerë.

Mbrojtja e atdheut është e lidhur ngushtë me zhvillimin e ekonomisë dhe ky zhvillim është i lidhur ngushtë me ngritjen politiko-ideologjike të njerëzve, me kalitjen e ndërgjegjes së tyre, me organizimin e lartë dhe disiplinën e rreptë në punë, ashtu siç e kërkojnë normat e Partisë dhe ligjet e shtetit tonë. Për ta forcuar gjithnjë e më shumë mbrojtjen e vendit, kërcohët që nivelin e përgatitjes ushtarake të të gjitha strukturave ta mbajmë gjithmonë në shkallë të lartë dhe ta përsosim çdo ditë e më tepër.

Populli ynë, i përgatitur ushtarakisht, është plotësisht i aftë të mbrojë atdheun në rast se e sulmojnë agresorët. Ai është i bindur se do të dalë me siguri fitimtar mbi armiqëtë, për arsy se udhëhiqet nga Partia e tij marksiste-leniniste, për arsy se, kur është fjala për të mbrojtur tokën, nderin, dinjitetin, lirinë dhe pavarësinë e tij, shqiptari nuk e kursen gjakun. Ky qëndrim shembullor dhe heroik i popullit tonë zë një vend të rëndësishëm në historinë e luftërave të popujve për liri.

Studiuesit dhe historianët e ndryshëm kanë shkruar se Skënderbeu, duke i njojur virthitet e trimërisë e të sakrificës të bashkëluftëtarëve të vet, u pati thënë atyre se asnje armik dhe asnje sulm i kundërshtarit nuk do të ishte në gjendje t'i dëmtonte, në rast se ata do të ishin të lidhur e të bashkuar. Dhe me të vërtetë kështu ka ndodhur. Shqiptarët, të bashkuar, sido që

ishin një popull i vogël, përballuan forcat e mëdha të Perandorisë Osmane, duke dhënë kështu një kontribut me vlerë në mbrojtjen e qytetërimit evropian.

Partia, duke vlerësuar forcën e madhe të unitetit, që në muajt e parë të krijimit të saj, hodhi themelet e bashkimit luftarak të popullit shqiptar, i cili, në luftë kundër pushtuesve nazifashistë, solli çlirimin e plotë të Shqipërisë dhe fitoren e revolucionit populor. Sot uniteti i popullit tonë heroik, i realizuar nën udhëheqjen e Partisë, është çelikosur më tepër se kurrë, ai përbën një nga faktorët bazë për të mbrojtur socializmin dhe atdheun socialist.

Sukseset e arritura, veçanërisht në forcimin e ekonomisë sonë, nuk duhet të na krijojnë ato ndjenja të vetëkënaqësisë, që i bëjnë njerëzit të mendojnë, se më mirë nga kaq s'kemi ku të shkojmë. Jo, ky qëndrim nuk është i rekomandueshëm. Zhvillimi nuk duhet të na pengojë që të shkojmë se kemi edhe të meta e mungesa në punën tonë. Kemi edhe detyra që duhej t'i realizojm, po nuk i kemi realizuar. Mosrealizimet kanë disa arsyet, të cilat duhet t'i shohim me seriozitet. Dobësitë që do të vërejimë nga ky shikim, t'i ndreqim dhe të metat të mos i përsëritim. Vetëkënaqësia dhe të kënaqurit me pak janë kurdoherë pengesë në rrugën e zhvillimit. E mira, thotë populli, nuk ka fund, prandaj rrugën drejt përmirësimeve në të gjitha drejtimet në asnje mënyrë nuk duhet ta kufizojmë. Që t'ia arrimë së mirës, përparimit të vazhdueshëm, duhet që të gjithë punonjësit, të organizuar në Parti dhe në Frontin Demokratik, t'i përvishen punës më shumë se kurdoherë që të realizohen planet e shtetit për zhvillimin

e ekonomisë, të kulturës, të arsimit dhe të mbrojtjes.

Të gjitha këto detyra imperative na i imponon lufta për ndërtimin e socializmit, dëshira e zjarrtë për ruajtjen e lirisë, pavarësisë dhe sovranitetit të popullit tonë, nevoja për të mbrojtur demokracinë më të përpunuuar, që shtetasit tanë të janë njerëzit më të lirë që mund të ekzistojnë në botë. Kurrë të mos harrojmë se lufta janë ka rëndësi të madhe jo vetëm për forcimin e brendshëm, po ka gjithashtu shumë rëndësi edhe për faktin se shërben si shembull i një vendi të vetëm që ndërton socializmin në epokën e kalbëzimit të imperializmit dhe të marshimit përpara të revolucioneve proletare e të luftërave nacionalçlirimtare të popujve.

Por në punën tonë, në gjëzimet tona, të mos harrojmë armikun e brendshëm dhe të jashtëm. Të dy këta armiq janë kurdoherë në unitet me njëri-tjetrin. Bashkimi i tyre e ka bazën në dëshirën për të goditur Shqipërinë sociale dhe Partinë e Punës të Shqipërisë. Armiqtë kurdoherë kanë bashkëvepruar, por kanë dështuar dhe kurdoherë do të dështojnë para unitetit të popullit me Partinë.

Dështimi i tyre është rezultat i forcës së unitetit, i gjendjes sonë ekonomike, morale dhe politike të fuqishme, është rezultat i vijës së drejtë të Partisë dhe i zhvillimit me konsekuençë të luftës së klasave. Derisa ekzistojnë mbeturinat e klasave shfrytëzuese dhe rrethimi imperialist e revisionist, në çfarëdo forme që ai paraqitet, lufta e klasave nuk pushon për asnjë moment. Prandaj nuk i lejohet currkujt që të harrojë jo vetëm teorikisht, por as praktikisht rrezikun që na kanoset nga armiq. Sëcili të jetë vigjilent kudo, në

jetë e në punë, pse armiqjtë e jashtëm e të brendshëm bëjnë propagandë dhe përpinqen që ajo të zërë vend e të konkretizohet në veprimitari armiqësore kundër pushtetit popullor e socializmit.

Vigjilencë revolucionare nuk do të thotë sektarizëm. Partia dhe shteti ynë i diktaturës së proletariatit, në gjykimin e njerëzve, e bëjnë qartë dallimin midis atyre që janë të lidhur me popullin dhe që në punë e sipër bëjnë gabime pa qëllime armiqësore, dhe atyre që janë të deklasuar, ose që s'janë të tillë, por kanë degjeneruar dhe me veprimet e tyre dëmtojnë atdheun socialist. Ndaj të parëve përdoren metodat e bindjes dhe të edukimit, kurse ndaj këtyre të fundit diktatura e proletariatit godet me drejtësinë dhe me rreptësinë e saj.

Ne shqiptarët jemi njerëz të fortë dhe ndihemi të lumtur e të gëzuar kur punojmë dhe luftojmë. Sëcili prej nesh e kupton si duhet mendimin revolucionar, krijimin revolucionar, punën revolucionare dhe luftën revolucionare. Shqiptari është banor i maleve, i bjeshkëve dhe i fushave të gjera pjellore, ai e do shumë ajrin e pastër e të freskët, por i urren batakun dhe kënetën, i urren mashtruesit e gënjeshtarët. Është e njohur botërisht se kur jep besën dhe lidh miqësinë me mikun e vërtetë, shqiptari lë kokën dhe këtë e ka bërë për të mbrojtur të vërtetën dhc të drejtën, që i ka pasur dhe i ka në natyrën e tij. Këtë natyrë të mrekullueshme të njerëzve tanë ne e shohim çdo ditë në punën dhe në jetën e tyre, e shohim në heroizmin, në kurajën dhe në patriotizmin e tyre, e shohim edhe

në kohën e zgjedhjeve për deputetë të instancave të ndryshme të pushtetit shtetëror.

Në ditën e zgjedhjeve, në fytyrat e njerëzve tanë shprehen gëzimi dhe lumburia për jetën e bukur sozialiste, në sytë e tyre, që shkëlqejnë si të shqipces, shihet vendosmëria e pafund për mbrojtjen e fitoreve të arritura. Si lumë vërshojnë zgjedhësit përpara kutive të votimit, për të shprehur dashurinë dhe përkrahjen e tyre të pakufishme për pushtetin popullor dhe Partinë. Këtë dashuri e përkrahje e provojnë edhe rezultatet e shkëlqyera në votimet për kandidatët e Frontit Demokratik.

Në vendet kapitaliste, duke u habitur nga rezultatet e zgjedhjeve tona, bëjnë pyetjen: Ka në Shqipëri njerëz që nuk e duan regjimin në fuqi? Ata, duke gjykuar për ne sipas pikëpamjeve të tyre borgjeze, nuk mund të konceptojnë që shumica dërrmucse e popullit tonë është e lidhur me shtetin e vet të diktaturës së proletariatit, që është më demokratiku dhe më përparimtari që mund të ketë në botë. Socializmi i ka sjellë popullit shqiptar aq të mira sa nuk do t'ia sillte asnjë rend tjetër. Në këto rrëthana, edhe një pjesë e atyre pak zgjedhësve, që mund të jenë kundër rendit tonë socialist, duke u tërhequr përpara forcës së madhe të popullit, që është absolutisht me pushtetin e tij, e sheh se është e kotë të votojë kundër Frontit Demokratik. Te ne nuk ka asnjë fije pengese për shprehjen e lirë të vullnetit në votime, përkundrazi, liria është e plotë dhe e siguruar me ligj.

Partia dhe organizatat e Frontit Demokratik organizojnë një fushatë të madhe për zgjedhjet në organet

e ndryshme të pushtetit shtetëror. Propaganda e gjiltër e Partisë, e organizatave të masave synon forcimin e unitetit dhe të aleancës midis klasës punëtore dhe fshatarësisë kooperativiste. Aleanca e këtyre dy klasave mike, nën udhëheqjen e Partisë, ka krijuar këto të mira materiale dhe shpirtërore, këtë lumturi, që i gëzon gjithë populli pa përjashtim. Askush s'ka privileje në vendin tonë.

Për arsyë se në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk ka më klasa antagoniste me interesat e papajtueshmët midis tyre, për arsyë se të ne janë zhdukur e ndalohen prona private e shfrytëzimi i njeriut prej njeriut, prandaj edhe në fushatën e zgjedhjeve nuk ka një lundër të xhunglës si në vendet kapitaliste e revisioniste. Votimet të ne nuk manipulohen nga njerëz ose nga parti, që mendojnë për pasurimin e grupeve borgjeze kapitaliste, por ato fyrnëzohen nga Partia e proletariatit, që ka për qëllim të ngrejë miqëgenien ekonomike, nivelin kulturor e arsimor të popullit, që ka për qëllim forcimin e astësisë mbrojtëse, ruajtjen e lirisë dhe të pavareësisë.

Në këtë situatë të shkëlqyer revolucionare që sundon në mbarë vendin tonë, në atmosferën e këtij vrulli të madh masiv që ka shpërthyer kudo për plotësimin e detyrave të Kongresit të 7-të historik të Partisë, të plenumeve të fundit të Komitetit Qendror, si dhe për arritjen e objektivave të planit të gjashtë pesëvjeçar, secili prej neshi e ndien veten krenar për rrugën e lavdishme që kemi bërë dhe për atë që do të bëjmë akoma drejt lulëzimit të mëtejshëm të atdheut.

Pjesëmarrja në zgjedhje dhe votimi njëzëri për

kandidatët e Frontit Demokratik do të jenë një shprehje tjetër e aprovimit të zjarrtë të vijës së përgjithshme të Partisë nga masat punonjëse, e madhështisë së unitetit të popullit rrëth Partisë, e besimit të patundur për ta çuar gjithnjë përpëra revolucionin tonë fitimtar. Ato do të kontribuojnë pör forcimin e mëtejshëm të pozitave ndërkombëtare dhe të prestigjit të Shqipërisë socialiste në botë.

Shokë dhe shoqe,

Ju falënderoj nga zemra që patët mirësinë të aproponi kandidaturën time për deputet për Kuvendin Popullor të zonës suaj elektorale. Ju jam shumë mirënjohës për vlerësimin dhe për nderin e madh që më bëni mua, anëtarit të Partisë sonë të dashur, birit dhe vëllait tuaj, që, bashkë me ju, punoj si një luftëtar i çështjes së madhe të ndërtimit të shoqërisë socialiste dhe të mbrojtjes së atdheut tonë të shtrenjtë.

Besimi i madh që shprehët ju ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, me rastin e aproviimit të kandidaturës sime, më ka prekur shumë. Ju siguroj se do të luftoj si gjithnjë për t'u shërbyer pa u lodhur atdheut, Partisë dhe popullit, se bashkë me ju do të vë të gjitha forcat e mia për të përmبushur me nder detyrën e lartë e me përgjegjësi të deputetit të Kuvendit Popullor, se do të përpinqem t'ju përfaqësoj denjësisht në organin më të lartë të pushtetit shtetëror dhe të meritoj besimin tuaj të madh.

Duke ju falënderuar edhe një herë për konside-

ratën tuaj ndaj personit tim, më lejoni të thërres nga zemra:

Rroftë populli shqiptar!

Rroftë Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë!

Rroftë Partia e Punës e Shqipërisë dhe Komiteti i saj Qendror!

Lavdi marksizëm-leninizmit!

*Botuar për herë të parë në  
gazeten «Zëri i popullit»  
nr. 270 (9443), 9 nëntor 1978*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha «Raporte e sjanimeve  
1978-1979», f. 138*

# KUNDER FORMALIZMIT NË LËVIZJEN E KUADROVE

Shënim

11 nëntor 1973

Hekurani [Isai] më vuri në dijeni se në datën 14 do të bëjë një mbledhje me sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve që merren me problemet organizative, ku do të shtrojë disa probleme. Ai më tha, gjithashtu, se u ka dërguar shokëve të rretheve një material të gjatë prej rrëth 50 faqesh. I bëra disa vërejtje dhe i rekomandova që të evitohet dërgimi i materialeve kaq të gjata gjë që i rëndon shokët. Duhet pasur parasysh, i theksova, që sekretarët e komiteteve të Partisë të rretheve janë shokë të përgatitur e me eksperiençë, prandaj problemet që u shtrohen dhe detyrat që u ngarkohen duhet që t'u jepen të qarta dhe të shkurtra.

Çështja që do të trajtohet në këtë mbledhje ka të bëjë me shpërndarjen e anëtarëve të Partisë. Këtë problem ne nuk e ngremë pér herë të parë, por e kemi shtruar vazhdimisht. Kemi theksuar, bile se dhe atje ku nuk kemi organizatë partie, kjo duhet të krijohet. Ne kemi kudo elementë të shëndoshë, që i kanë të

gjitha kushtet pér t'i pranuar në Parti e që mund ta forcojnë organizatën që kjo të jetë në gjendje ta udhëheqë më mirë ndërmarrjen ose edhe çdo qendër pune që mbulon. Pér këtë çështje ndihmon edhe lëvizja e disa komunistëve nga një ndërmarrje në një ndërmarrje tjeter, por kurdoherë duke u ruajtur profilin dhe pa u krijuar shqetësime në jetën e tyre shoqërore e familjare.

Një problem tjeter është edhe shpërndarja e komunistëve në prodhim. Siç thashë, Partia e ka shtruar vazhdimesht këtë problem, por tani duhet kuptuar se ka ndryshuar situata. Të kemi parasysh, i thashë Hekuranit, që komunistët të mos shkojnë në prodhim sa pér t'u quajtur se vajtën. Të bëhet kujdes që të mos kalohet në ekstremin tjeter e të nënvleftësohen vendet që nuk kanë të bëjnë me prodhimin, domethënë detyrat në administratë. Ta transferosh një financier nga një kooperativë ose nga një ndërmarrje me rëndësi dhe ta dërgosh në prodhim, në një punë jashtë profilit të tij, është një gabim i madh, pse financat në çdo sektor e në çdo ndërmarrje, kanë rëndësi të madhe. Prandaj të heqësh një komunist që është kompetent në profesion, pér arsy se figuron në kartelë në shtyllën «intelektual» ose «nëpunës» dhe ta dërgosh në prodhim, do të thotë ta dëmtosh atë sektor të rëndësishëm, sepse drejtimin e tij po e lë pa një njeri të zotin. Kjo është një lëvizje mekanike dhe e dëmshme.

Në rast se duhet të lëvizet një kuadër, dhe ne duhet ta aplikojmë këtë praktikë, qarkullimin e tij ta bëjmë, por në një vend ku, në përgjithësi, t'i ruhet profili, kur ai është i zoti, se ne kemi nevojë pér këtë.

Eshtë e gabuar, për shembull, që një mjek komunist, psikiatër ose kirurg, meqenëse është i sferës joprodhuese ta çosh të punojë në një kooperativë, në prodhim. Një gjë e tillë nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë.

Prandaj në këto drejtime duhet të ecet me kujdes dhe sipas situatave. Në qoftë se në administratë ekziston një numër i caktuar e i nevojshëm komunistësh, por që janë edhe kompetentë, ne mund ta konsiderojmë normale një situatë të tillë. Por, në qoftë se shohim që ka teprim në këtë drejtim, atëherë të marrim masa dhe të çojmë në prodhim gjithë ata që kanë hyrë kontrabandë në administratë sa për të zënë «qoshe të ngrohta». Një masë e tillë është e drejtë.

Në vendet kyç e mira do të jetë që të vendosen komunistë, si dhe elementë të ndershëm e patriotë. Këtë orientim ne e kemi dhënë vazhdimisht dhe duhet ta zbatojmë. Por, siç e theksova dhe më lart, jo të heqim komunistin sa për ta hequr e të vëmë në vend të tij një shok tjetër, që nuk është komunist, por që nuk është në gjendje ta kryejë detyrën, vetëm për faktin se duhet të ruajmë përqindjen e komunisteve në prodhim. Një veprim i tillë është i gabuar.

Njerëzit që punojnë në administratë ta kuptojnë drejt rolin e tyre. Të marrim, për shembull, rojat e depove, të kooperativave apo të ndërmarrjeve të industrisë etj., etj. Ideja e përgjithshme është që këta mund të mos jenë komunistë, por unë mendoj se nuk është e drejtë të shtrohet problemi gjithmonë këshlu. Ka depo ku roja mund të mos jetë anëtar partie, po ka edhe depo të tjera ku është e domosdoshme që rojat

të jenë komunistë dhe bile shumë të mirë, të vendsur, me tru në kokë, të shkathöt e të gjallë. Ata nuk duhet të jenë si disa pleq të moshuar që dinë vetëm të mbajnë pushkën, të pinë cigare tërë ditën dhe natën, kur të tjerët venë e i vjedhin depon, ia shtrojnë me gjumë dhe as që bëhen merak se ç'bëhet brenda në depo. Sigurisht që të tillë roja neve nuk ka ç'na duhen, edhe sikur të jenë komunistë.

Në qoftë se në një depo nuk vendosim komunistë, si ata që thashë më parë, mund të zgjedhim edhe njërez të paorganizuar në Parti, por që janë të ndershëm, të zotë, të rinj, të zgjuar e që dinë të përdorin mirë edhe pushkën. Një njeri i tillë, me siguri që depon do ta ruajë jo vetëm nga jashtë, por edhe nga brenda. Domethënë ai, fjala vjen, do t'i kontrollojë vazhdimisht mallrat; do të ketë kujdes të kthejë grurin që të ajroset, të shohë thasët se mos i kalben nga lagështira, të kontrollojë sheqerin që të mos marrë lagështi e të prishet etj. Kjo punë do edhe kokë, por do edhe forcë fizike. Pra, që të ruash depon nga jashtë e nga brenda, do jo vetëm zgjuarsi, vigjilencë e trimëri, por dhe ndërgjegje të lartë, prandaj duhet kuptuar mirë rëndësia që ka çdo vend pune dhe domosdoshmëria për të caktuar aty shokë të organizuar apo të paorganizuar në Parti.

Në qoftë se nuk i kuptojmë këto çështje kështu, atëherë direktivat e orientimet do të zbatohen në mënyrë mckanike. Kur thuhet, si zakonisht, se 80 për qind e komunistëve punojnë drejtpërdrejt në prodhim, do të jemi të kënaqur, kurse po të raportohet se vetëm 73 për qind janë në prodhim, mund të ketë njerez që

të thonë se nuk është bërë si duhet detyra, prandaj «oburrani, hiqni disa komunistë nga administrata e çojini në prodhim», pavarësisht se ata mund të jenë aq të nevojshëm në detyrën që kishin, duke vënë në vend të tyre njerëz të paaftë. Të heqësh nga administrata komunistë me kapacitet dhe me eksperiencë, për të vetmen arsyse se gjoja këta duhet të venë në prodhim, nuk do t'i shërbente punës.

Punonjësit e administratës, në përgjithësi, ne duhet t'i mësojmë që të mos janë njerëz të zyrave, vetëm të letrave se pastaj ata do të bëhen burokratë. Të jesh një administrator i mirë, financier ose llogaritar i zoti etj., etj. kjo parashikon edhe kontrollin e llogarive në praktikë, në prodhim, pra, do të të duhet të shkosh edhe në bazë, të verifikosh nëse janë zbatuar drejt apo jo nga punonjësit përkatës detyrat e dhëna. Domethënë në punën administrative, po ta kryesh siç duhet atë, përfshihet edhe punë fizike e lodhje, gjë që e lufton elementin burokratik, e freskon, e gjallëron, e ndihmon dhe e forcon kuadrin dhe nuk e lë të myket në zyra. Një punë e tillë është e dëmosdoshme që t'u kërkohet punonjësve të administratës.

*Botohet për herë të parë së pas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# PËR PRANIMET NË PARTI KËRKOHET STUDIM I THELLË DHE PUNË PARAPRAKE

*Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSII*

**15 nëntor 1973**

Probleme të tilla të rëndësishme, siç është ai i shpërndarjes së forcave të Partisë, mund të shikohen herë pas here. Kryesorja në këtë punë është që të mos krijohen shqetësime në organizatat e Partisë, si rezultat i përpjekjeve për të zbatuar orientime kategorike, formale e pa vend, të dhëna nga ky apo ai kuadër drejtues, siç ishin, për shembull, përqindjet që kërkonte më parë sektori i Statutit.

Çështja tani shtrohet që të çohen komunistë nga organizata të forta për dy apo për tre vjet në organizatat e dobëta për të forcuar gjendjen atje. Ky problem mund të duket i thjeshtë për t'u zgjidhur, por nuk është kështu. Hap plot telashe kjo punë, pse njerëzit pyesin: cilët komunistë do të dërgohen tani. Po familjet e atyre që dërgohen larg? Prandaj çdo lëvizje e komunistëve duhet menduar e studuar mirë, lëvizjet që nuk janë të domosdoshme duhen evituar.

Për këtë ka rëndësi që komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë, të punojnë me mend e me kujdes për pranimet në Parti, duke pasur parasysh orientimet e përgjithshme të Partisë.

Në këto purë nuk duhet nisur thjesht nga fakti se në ç'raport i kemi komunistët me punonjësit dhe, kur ky raport nuk është siç e kërkojnë disa pa u themuar, atëherë, oburra të shtohet numri i komunistëve. Kështu, për shembull, në qoftë se në një repart kemi dy komunistë dhe gjykojmë që ky numër komunistësh për atë kolektiv është i mjaftueshëm, atëherë pse u dashka të pranojmë dhe pesë të tjerë? Natyrisht, tërë jetën nuk do të rrimë në atë gjendje, me kalimin e kohës, te kolektivi i repartit me siguri do të lindë nevoja për shtimin e radhëve të Partisë. Dhe pranime do të bëhen edhe atje, por kjo të bëhet jo për të rritur përqindjen, po për të forcuar punën dhe përt'i dhënë Partisë gjak të ri. Një gjë e tillë tani përtani, në repartin që morëm si shembull, s'ka përse të bëhet, kur shikojmë se atje ka komunistë shumë të zotë, ka punëtorë të palodhur e njerëz të sakrificës; ka mobilizim të madh për realizimin e detyrave dhe vëniej në jetë të porosive të Partisë.

Për forcimin e organizatave-bazë, Partia, në radhë të parë, duhet t'i kushtojë vëmendje punës së pranimeve. Ajo duhet ta studiojë mirë gjendjen, pra kur duhet të bëjë pranime, ku ndihet nevoja më shumë që të pranohen të rinj në radhët e Partisë etj. Një organizatë-bazë partie që punon mirë (apo një komitet partie) e di se kur dhe ku duhet të bëjë pranime dhe, duke e ditur këtë, ajo punon më përpara për

të përgatitur njerëz që ta meritojnë anëtarësinë në Parti. Domethënë organizata që ka 5-6 ose 10 komunistë duhet të mbajë asër, të shikojë, të kontrollojë, të ndihmojë politikisht e ideologjikisht në mënyrë të veçantë ata punonjës që në një moment, e gjen të domosdoshme t'i pranojë në Parti, se e shikon që duhet forcuar organizata me njerëz të rinj, se është zgjruar puna e Partisë dhe puna e pushtelit. Kësaj i thonë të punosh për përgatitjen e kuadrit. Të gjithë kuadrot e Partisë duhet të jenë në pararojë, prandaj nga radhët e masave punonjëse më parë ne përgatilim anëtarë partie, pastaj sekretarë të organizatave-bazë, anëtarë të komiteteve të Partisë e këshlu me radhë. Mirëpo një punë e tillë paraprake nuk bëhet kudo mirë nga organizatat-bazë të Partisë.

Nuk e di si ecën puna me rekomandimet nga rinia, se, për sa u përket të rinjve, që do të pranojnë në Parti, rekomandimi më i mirë është ai që u jepet nga organizata e rinisë. Bëhet apo nuk bëhet kjo gjë? Pyes, sepse nuk na është raportuar ndonjëherë në mënyrë të veçantë për këtë problem. Edhe në qoftë se bëhet, të na thuhet si e jep rekomandimin organizata e rinisë, e jep ashtu kot apo në bashkëpunim me organizatën-bazë të Partisë? Për shembull, organizata e rinisë në një repart ushtarak punon për këtë qëllim nën drejtimin e Partisë me kuadrot ushtarakë, që janë akoma në organizatën e rinisë, por që dallohen për kapacitetin, vendosmërinë, energjinë, besnikërinë dhe ngritjen e tyre politike dhe ideologjike. Këta ajo ia rekomandon Partisë që të mbajë parasysh se në organizatën e rinisë të një reparti ndodhen dy,

tre apo katër kuadro që dallohen për përgatitje të mirë politike, ushtarake, për gatishmërinë në kryerjen e detyrave etj., etj. Prandaj, kur ajo ta shikojë të arsyeshme që të pranojë anëtarë partie nga radhët e organizatës së rinisë, të mos harrojë atë që dallohen.

Ata që pranohen në radhët e Partisë nuk vijnë të gjithë nga organizata e rinisë, sepse një numër të rinjsh apo të rejash kur mbushin moshën nuk bëjnë më pjesë në organizatën e rinisë, por janë anëtarë të organizatës së bashkimeve profesionale. Në këtë rast, organizata-bazë e Partisë për atë që do të pranojë në radhët e saj duhet të marrë edhe mendimin e organizatës profesionale, të organizatës së gruas, por në të njëjtën kohë edhe vetë ajo duhet ta ndjekë nga afër punën e qëndrimin e tij në qendrën e punës e kudo.

Ka shumë të rinj e të reja që dëshirojnë të hyjnë në Parti. Ka edhe që nxiten nga prindërit dhe njerëzit e tyre të afërt. Dikush, për shembull, i thotë djalit të vet, ose një shok i thotë shokut që të bëjë lutjen për të hyrë në Parti. Natyrisht, ky është mendimi i tyre, por këtë gjë njërit apo tjetrit duhet t'ia thotë organizata-bazë. Pse? Sepse kjo e di dhe është në gjendje ta çmojë nëse një person i plotëson kushtet për t'u pranuar në Parti apo jo.

Partia ka nevojë për gjak të ri. Kur organizata-bazë u thotë të rinjve të bëjnë lutje për të hyrë në Parti, ajo natyrisht nuk merr asnjë zotim, që do të pranohet apo nuk do të pranohet ai që bën lutjen; kjo gjë do të bëhet në bazë të të gjitha normave dhe rregullave të Partisë. Asnjërit nuk i është ndaruar të bëjë lutje, pavarësisht se organizata-bazë e

Partisë ua ka vënë syrin disave. Çështja e pranimeve diskutohet në organizatë, ku të gjithë ata që kanë bërë lutje analizohen një nga një. Mirëpo organizatës i duhet të pranojë vetëm pesë komunistë ndër ata pesëdhjetë që i kanë kushtet për t'u pranuar në Parti. Atëherë shikohet se nga këta cilët janë pesë më të mirët. Organizata ka një listë të tërë me emra të rejash e të rinjsh të dalluar, por në të nuk figurojnë emrat e disave nga ata që kanë bërë lutje për pranim dhc që e meritojnë të hyjnë në Parti. Ky fakt është e domosdoshme t'i tërheqë vëmendjen organizatës-bazë. Ajo duhet të ndalet e të shikojë shumë probleme që kanë lidhje me këtë çështje.

Sa më mirë ta bëjë organizata-bazë punën për pranimet, aq më e bazuar do të jetë edhe puna që do të bëjë komiteti i Partisë për këtë qëllim. Ky nuk duhet të bëjë një punë formale për pranimet, siç kam dëgjuar të veprohet në disa raste, por të studiojë me kujdes të madh e me kohë materialet e cilitdo kandidati që do të pranohet. Të mos grumbullohen shumë veta njëherëshi për t'u pranuar, sepse atëherë nuk do të bëhet një punë e mirë. Ditën e pranimit më shumë se 20 veta shihet të rrinë para derës së komitetit, duke pritur të hyjnë se do të pranohen në Parti. Dhe shpesh pyetjet që u bëhen atyre që do të pranohen janë për nene të Statutit. Po ai që nuk e di këtë apo atë nen, nuk duhet të pranohet në Parti?! Si mund të mendohet një gjë e tillë, kur kandidati ka cilësi të tjera shumë të mira? Kësaj i vjen erë shablonizëm.

Në qoftë se ndiqet një rrugë me të vërtetë revolucionare në pranimet nga organizatat, atëherë në

komitet do të shkojë me të vërtetë ajka e të rinxje dhe e të reja ve. Dhe kuptohet, në këto raste çështja është më e thjeshtë edhe për komitetin dhe puna e Partisë bëhet më mirë.

Si pranimet, edhe shpërndarja e forcave në Parti, nuk janë çështje thjesht mekanike, një rregullim raportesh e përqindjesh, por probleme që kërkojnë studim të thellë e punë paraprake. Kjo të mbahet kur doherë parasysh se ka ndodhur që ndonjë komiteti partie i është thënë në mënyrë të prerë: Nuk e keni mirë raportin komunistë dhe jokomunistë, prandaj shtojeni numrin e komunistëve. Në qoftë se nuk keni mundësi vëtë, atëherë kërkon, për shembull, nga Komiteti i Partisë i Rrethit të Elbasanit të udhëzojë organizatën e Kombinatit Metalurgjik për të pranuar 10 apo 20 punëtorë në Parti, me qëllim që të dërgohen pastaj në Rubik. Mirëpo nuk është e rekomandueshme që, pa qenë nevoja, të ngresh punëtorët, që pranojen anëtarë partie, nga Elbasani ku janë vendosur me familjet e tyre dhe t'i çosh në Rubik. Kur është nevoja edhe mund të çohen, por vetëm atëherë kur në një qendër pune çështë krijuar me të vërtetë një situatë kritike. Megjithatë, po t'i vihet veshi me kohë kësaj punë, nuk ka pse të ndihet nevoja për të dërguar komunistë, si shembulli që morëm, nga Elbasani në Rubik, sepse edhe në këtë të fundit i kanë mundësitë të pranojnë 5 apo 6 komunistë punëtorë. Nuk ka pse të pranojen në Parti punëtorët e Fierzës, që pastaj, oburra t'i çojmë nga Fierza në Lushnjë! Nesër do të vijë koha që prej andej ata të shkojnë në Koman ose në ndonjë vepër tjetër të madhe. Po pse të bëhet një

lëvizje e tillë? E theksoj edhe një herë, që një lëvizje e tillë e komunistëve nuk ka përse të bëhet, kur nuk e kërkojnë nevojat.

Pra, fjala është që të kuptohet mirë nga Partia se problemi i pranimeve në Parti është një procedurë e tërë shkencore. Për këtë duhet të ecet jo kuturu, po më studime të thella, duke menduar për sot dhe për nesër. Pranimet dhe lëvizja e komunistëve nuk duhen bërë në mënyrë mekanik, pse thotë njëri apo tjetri, se pastaj menjëherë lindin çështje që duhen rregulluar, lindin probleme, krijohen dhe shqetësime te njerëzit. Prandaj këto gjëra udhëheqja e Partisë në bazë duhet t'i kuptojë në thellësinë dhe në gjerësinë e tyre ideologjike revolucionare dhe t'i punojë mendja që të mund të zbërthejë mirë e deri në fund një orientim të dhënë.

Në qoftë se shokët e Partisë në bazë nuk e vrasin mendjen për këto probleme, në qoftë se ata nuk e studiojnë me hollësi dhe me objektivitet gjendjen, po vetëm marrin masa mekanike për të qenë në rregull me përqindjen që u kërkohet, atëherë një punë e tillë do të jetë me pasoja. Nga këta shokë duhet të kuptohet mirë se çështja nuk shtrohet që të jesh formalisht mirë me përqindjet ose me raportet, por që të krijohen raporte e përqindje të tillë që t'i shërbejnë Partisë. Nuk është e vështirë të rregullosh përqindjet përnjëherë, kur të diktohet ta bësh këtë. «Të jemi ne në rregull me sektorin e Statutit», thoshin disa dhe vepronin kot më kot. Por nga një ecuri e tillë Partia dëmtohet, në vend që të bëhen hapa përpara.

Formalizmi në zgjidhjen e problemeve të Partisë është i dëmshëm. Për pranimin e anëtarëve të rinj në

radhët e Partisë ka një varg çështjesh që duhen pasur parasysh kudo, sidomos në fshatra, ku organizatat-bazë ka shumë raste që gati përbëhen nga familje të një apo të dy fiseve, gjë që ndikon në krijimin e tarafeve e të sëmundjeve të tjera të rrezikshme.

Në qytete gjendja paraqitet pak më ndryshe. Në një familje mund të janë shtatë komunistë, por ata nuk janë që të gjithë në një organizatë, siç ndodh në fshatra. Por edhe kjo çështje duhet parë me kujdes. Për mendimin tim nuk është e thënë që të tërë anëtarët e një familjeje të futen në Parti, megjithatë njërin ose tjetrin anëtar të kësaj familjeje është organizata-bazë e Partisë që e pranon në radhët e saj, kur ai e meriton.

Por edhe në fshat, në qoftë se ndiqen drejt kriteret në punën e pranimeve, në rast se punohet mirë për përgatitjen e njerëzve për në Parti, në rast se rekomandimet etj., etj. bëhen mbi baza të shëndosha, atëherë Partia forcohet.

Që komitetet e Partisë të punojnë mirë, duhet të kenë, për shembull, edhe evidencën e rekomandimeve që janë bërë nga anëtarë partie të caktuar për njërin ose tjetrin person dhe që kanë dalë të gabuara. Nga analiza e rekomandimeve që janë dhënë për njerëz të cilët nuk e kanë merituar pranimin në Parti diskutohet për shkaqet e dhënies së tyre nga komunistët, të cilët mund t'i kenë bërë ato të shtyrë nga fisi, nga akraballëku, nga sentimentalizmi, pra, nga pikëpamje dhe qëndrime jo të shëndosha. Kuptohet, të ndihmosh një kushërin tënd, një njeri që e ke të afërt, pra, ta përgatitësh atë, ta bësh të devotshëm, t'i bësh pyetje,

ta orientosh e ta nxitësh të studiojë etj., kjo është një gjë e mirë dhe ke të drejtë të japësh rekomandim për të. Në këtë rast rekomandimin e jep me përgjegjësi. Një gjë e tillë, sigurisht, nuk ndalohet. Por komitetet duhet të shikojnë gjendjen se si u del ky hesap, ç'rezulton nga këto rekomandime, sepse mund të dalë që në 100 rekomandime 10 mund të mos kenë qenë të mira. Atëherë si e konsiderojnë ata këtë? Në të kaluarën mund të ketë pasur raste që në 100 rekomandime 20 të kenë qenë fare pa vend, kurse tashti është përmirësuar gjendja. Por ka gisht organizata-bazë apo nuk ka, e ka ndjekur apo nuk e ka ndjekur ajo këtë problem? Nga analiza që mund t'i bëhet punës në një rrëth, mund të rezultojë se, pavarësisht që rezultati doli i mirë, organizata të mos e ketë ndjekur fare çështjen e rekomandimeve.

Pra, gjatë studimit të këtyre problemeve në tërësi dalin shifrat, nga të cilat nxirren konkluzionet. Dhe që këto të janë të drejta dhe punonjësi i aparatit të Partisë të punojë në rrugë partic, organizata duhet t'i ndjekë çështjet në mënyrë të vazhdueshme.

Veç kësaj, qoftë për pranimet, qoftë për kuadrot, një rol të madh luajnë njëcrëzit që punojnë në sektorët e Statutit e të kuadrit pranë komiteteve të Partisë. Qëndrimet sektare që mbahen në disa raste nga punonjës të këtyre sektorëve krijojnë shqetësime te kuadrot, deri te kuadrot e lartë që kanë bërë luftën, që kanë qenë partizanë dhe që sot punojnë mirë atje ku janë caktuar.

Edhe kur është e nevojshme dhe ekzistojnë mundësitë për të marrë disa komunistë këtej e për t'i dërt-

guar gjetkë, duhet vepruar me partishmëri, se vërtet vendos organizata-bazë, por në ndonjë rast lëvizjen e dikton drejtori për ta hequr qafe, sidomos komunistin që e kritikon. Kështu më shkruante njëri në një letër: «Shoku Enver, më kanë hequr nga puna ku isha për arsyen se i kam bërë përgjegjësit një kritikë. Të lutem të vijë njeri dhe ta shikojë se si qëndron puna». Fakt është se këto shfaqje, edhe pse jo shpesh, ndodhin, prandaj Partia duhet t'i ketë sytë hapur kurdoherë. Natyrisht, ne nuk mund të themi se çdo gjë do të ecë në mënyrë ideale në gjithë Partinë, në gjithë këta komunistë. Po kur Partia konstaton veprime të tillë nga disa kuadro drejtues, ajo duhet të mbajë menjëherë qëndrim ndaj tyre.

Ajo që dua të vë në dukje tash, gjë që e kam thënë edhe herë të tjera, është që të kuptohet se çështjet organizative të Partisë janë çështje shkencore që kërkojnë studim të thellë e të vazhdueshëm. Në qoftë se bëjmë studime për një varg problemesh dhe për çështjen e Partisë, që është udhëheqësja e gjithë këtij vendi, udhëheqësja e të gjitha këtyre krijimeve, realizimeve e konkretizimeve në fusha nga më të ndryshmet e jetës, nuk bëjmë një punë të thellë shkencore, atëherë nga të katër anët do të na dalin vështirësi. Pse? Sepse të metat që vihen re në këtë ose atë ndërmarrje, për shembull, do të krijojnë një situatë të rëndë. Në qoftë se organizata-bazë e Partisë do të jetë e fortë, vështirësitet do të kapërcehen më me lehtësi. Të meta do të ketë në punë, për këtë nuk ka asnje dyshim, por një organizatë e shëndoshë përnjëherë e merr situatën në dorë dhe i vë gjërat në vend.

Partinë ne e kemi shumë të fortë, ky është realiteti. Disa gjëra që vihen re këtu e atje nuk mund të themi se janë sëmundje. Jo! Megjithatë, Partia duhet t'i ketë parasysh edhe këto.

*Esouar për herë të parë,  
me ndonjë shkurtim, në  
librin: Enver Hoxha, «Për  
Partinë» (Përmbledhje ve-  
prash), vëll. 3, f. 421*

*Etohet sipas librit:  
Enver Hoxha «Për Partinë»  
(Përmbledhje veprash),  
tëll. 3, f. 421*

# PLENUMET PUNOJNE NË MËNYRË REVOLUCIONARE KUR ZBATOHEN DETYRAT

*Nga tiseda në takimin ditor të sekretarëve  
të KQ të PPSH*

24 nëntor 1978

Për problemet që trajtoi në këtë bisedë shoku Enver Hoxha, mori shkas nga informimi që bëri shoku Prokop Murra, i cili kishte qenë i deleguar në mbledhjen e plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës, që u zhvillua ato ditë.

Anëtarët e plenumit duhet t'i vënë rëndësi të madhe mbledhjes së plenumit, se ka prej tyre që venë në këto mbledhje sa për të shkuar radhën. Atje shtohen probleme, bëhen diskutime, kurse disa prej tyre vetëm dëgjojnë ose bëjnë, siç u tha këtu, ndonjë diskutim standard, bëjnë autokritikë, se janë përpjekur për t'i kapërcyer të metat dhe premtojnë me llafe se puna tash e tutje do të ecë mirë. Ata mendojnë se me kaq ka mbaruar puna për ta, dhe prandaj pas mbledhjes së plenumit nuk luftojnë për vënien në jetë të detyrave e të vendimeve që merren atje. Po sa janë ata në korent të problemeve? Po të gjykojmë drejt,

përderisa nuk shqetësohen, saqë të japid alarmin për mosrealizimin e detyrave e të vendimeve, do të thotë se nuk janë sa duhet në korent.

Anëtarët e plenumit janë të shpërndarë në sektoër të ndryshëm të rrëthit, megjithatë ata duhet të jenë mirë në dijeni jo vetëm për problemet atje ku punon secili, por edhe për të tjerat, të dinë realizimet e mosrealizimet, të mirat dhe të këqijat, t'i njojin nga afër njerëzit, të dinë ç'duhet bërë, ç'duhet kritikuar e ç'duhet lavdëruar në mbledhje etj. Dhe mundësitë për këtë janë të shumta, që nga bisedat e lira me punonjës të ndryshëm e deri në vizita për t'u njojur nga afër me punët.

Në këtë mënyrë anëtarë i plenumit do të jetë në gjendje të diskutojë konkretisht për problemet që merr në analizë plenumi në këtë apo në atë rast.

Një punë e tillë përgatitore nga ana e anëtarëve të plenumit, në përgjithësi, nuk vlerësohet sa duhet. Natyrisht, anëtarë i plenumit mund të diskutojë ose të mos diskutojë në mbledhje, por rëndësi ka që ai të vejë i përgatitur atje për problemin që do të analizohet. Njëri mund të përgatitë edhe tri-katër faqe me shkrim, për të vënë në dukje disa anë pozitive të punës që bëhet për realizimin e detyrave, se edhe kjo ka rëndësi. Mund të flasë edhe një tjetër pa qenë i përgatitur me shkrim, për anën tjetër të problemit, duke bërë kritika konstruktive e duke dhënë mendime se si duhet punuar më mirë në të ardhmen. Kështu, do të bëhet një diskutim luftarak dhe të gjithë shokët drejtues të rrëthit do të kenë preokupacion të madh për mbarëvajtjen e punës.

Nuk duhet të bëhen mbledhje plenumi për të thënë që u bë mbledhje plenumi. Në qoftë se nuk punohet për realizimin e detyrave të caktuara, mbledhja është bërë formalisht. Plenumet punojnë në mënyrë revolucionare atëherë kur zbatohen detyrat në fabrika, në ara e kudo. Mbledhjet e plenumit, atje ku nuk ka luftë për zbatimin e detyrave të planit, nuk janë të efektshme. Vetëm në qoftë se anëtarët e plenumit i qepen punës për zbatimin e vendimeve që merren në mbledhje, dhe për këtë qëllim venë të punojnë atje ku i cakton plenumi, atëherë mund të themi se një mbledhje e tillë ka vlerë. E theksoj edhe një herë, nuk duhet të mblidhet plenumi formalisht, si një qëllim në vetvete, për shembull, të bëhet një mbledhje plenumi se është në plan për t'u bërë. Po ç'rëndësi do të kishte kjo mbledhje, kur kooperativat i lënë të gjitha prodhimet në fushë?! Përse do të mblidhej plenumi, për të dëgjuar një raport? Ç'vlerë ka një mbledhje e tillë dhe kujt i shërben?

Cili është qëllimi i mbledhjes së plenumit të komitetit të Partisë? Që të caktojë detyra dhe anëtarët e forumit e gjithë komunistët të punojnë ditë e natë, në krye të masave, për t'i realizuar ato. Në Korçë, për shembull, janë bërë gjithë ato shpenzime për ujitten. Nëpër të tëra kodrat e fushat, që nga Prespa dhe deri në Vithkuq, janë ndërtuar plot basene, por ujin nuk e përdorin mirë. Pse nuk «u lahet koka» njerëzve që përgjigjen për këtë neglizhencë? Përdorimi i mirë i ujit ndikon drejtpërdrejt në rritjen e rendimentit të kulturave bujqësore, prandaj nuk duhej të mos u vihej në dukje kjo dobësi shokëve të Korçës. Ata duhej të

jepnin llogari pse nuk ua vënë veshin atyre 1 000 hektarëve që janë mbjellë me patate dhe pse nuk marrin masat e nevojshme që planin, medoemos, ta realizojnë dhe bile ta tejkalojnë. Nuk di hollësira si zgjidhen këto probleme nga rrethi, por ai rrëth që ka më shumë ujë, mendoj që edhe në patate, edhe në panxhar, edhe në misër, në grurë e në çdo bimë tjeter duhet të marrë më shumë prodhim se një rrëth tjetër, që ka mungesë uji. Megjithatë, në mbledhjen e plenumit, ai që mban raportin ngrihet e thotë se në fushë nuk i vihet rëndësi patates! Po atëherë kujt i vihet rëndësi, në qoftë se nuk i vihet rëndësi këtyre çështjeve? Mos ka shumë kuadro që marrin lejen në verë? Nuk them që kuadrot të mos venë në plazh e të mos shëtitin, por edhe të pushojnë të gjithë çdo vit në verë, nuk është e drejtë, se, në radhë të parë, duhet puna, duhet të kryhen deri në një detyrat nga ana e tyre, duke marrë për këtë qëllim, në kohën e duhur, të gjitha masat e nevojshme. Ne kemi thënë që pushimet të bëhen gjatë gjithë vitit dhe në përgjithësi, ata që drejtojnë në bazë janë shokë të rinj, prandaj shumë mirë mund të pushojnë edhe në dimër, me përjashtim të ndonjërit që ka nevojë e i rekombinohet plazhi nga ana e mjekut. Këto gjëra t'i mendojnë kuadrot drejtues në rrëth, të cilët duhet të kenë merak për drejtimin e punës.

Kur shkohet në plenumet e komiteteve të Partisë të rretheve, në qoftë se vihet re qysh në fillim që nuk bëhen analiza të thella dhe debate për problemet që merren në shqyrtim, atëherë i deleguari mund të bëjë vërejtjen se ato që thuhen nuk ndihmojnë për forci-

min e punës, nuk tregojnë ndjenjë të thellë të përgjegjësisë për problemet që shtrohen. Që kjo mbledhje t'i vlejë Partisë, t'i vlejë punës së saj, duhet t'i vërë mirë pikat mbi i, siç i thonë një fjale, duhet të diskutojë me përgjegjësi, mbarë e prapë, për të nxjerrë në shesh shkaqet e vërteta pse nuk janë realizuar detyrat e planit etj., etj. Po të veprohet kështu mendoj se mbledhja e plenumit do të bëhet luftarake, anëtarët e plenumit do ta analizojnë thellë gjendjen dhe do të mobilizohen për realizimin e detyrave.

Në rrethe ka njerëz që dinë mirë ç'duhet bërë për të marrë rendimente të larta në të gjitha bimët bujqësore. Bile ata i dinë më mirë nga ne këto gjëra, por e keqja është se disa prej tyre nuk kanë organizim të shëndoshë të punës, që t'u kërkojnë llogari deri në një të tjerëve për zbatimin e detyrave. Më duket se këtu duhet ngulur më tepër këmbë kur shkohet në bazë. Nuk ka arsy, fjala vjen, të këshillojmë Illo Priftin, që tashti është në pension, për problemet e bujqësisë. Ne i njohim shumë më pak se ai problemet e bujqësisë, prandaj s'kemi ç't'i themi. Por, përsa u përket problemeve të tjera që ndikojnë në realizimin e detyrave, për ato do t'ju japim këshilla, do t'ju themi që nuk e keni organizuar mirë punën, nuk keni disiplinë në brigada etj. Dhe në qoftë se nuk merrni masa për disiplinën, nuk vini kontroll për farën etj., etj., atëherë nuk keni gjë në vijë, megjithëse të tëra ato ç'duhen bërë për pataten, për shembull, ju i dini. Pra, siç e theksova, shokët e rretheve duhen mësuar, këshilluar e ndihmuar në ato drejtime që kanë nevojë.

Eksperiencën e mirë të punës së Partisë në rrethe ne duhet ta kemi parasysh kurdoherë, se ajo na shërben shumë dhe të luftohet rutina, prirja për t'i mbuluar ose për t'i kapërcyer lehtë të metat e dobësitë me shprehje të tillë, si «e kam thënë», «ia kam përmendur» etj. Shfaqje të tillë janë shumë të këqija, prandaj kundër tyre duhet të luftojmë, që ta kapërcjmë këtë stil e metodë të dobët pune.

Ne duhet të bëjmë ç'është e mundur për revolucionarizimin e metodës së punës të organeve të Partisë dhe të pushtetit. Kjo ka rëndësi të madhe dhe pikërisht kësaj duhet medoemos t'ia arrijmë, se çështjet teknike, çështjet politike dhe deri në një përqindje të madhe edhe çështjet ideologjike, shumë i kuptojnë, por jo të gjithë i zbatojnë në mënyrë revolucionare. Kjo kërkon, së pari, organizim të mirë të punës, së dyti, kontroll të vazhdueshëm të zbatimit të detyrave dhe, së terti, sigurimin e mjeteve të prodhimit, të veglave, të farës së mirë, të lëndës së parë etj., etj. Për këto ne do t'i këshillojmë vazhdimisht shokët e bazës që jo vetëm t'i kenë parasysh, por t'i përvishen mirë punës për t'i vënë në jetë.

Mund të ngjasë edhe kështu: U zhvillua plenumi, vajti ky apo ai shok nga Tirana dhe u bëri një kritikë shokëve të rrethit, por, pas gjithë këtyre, gjendja prapë vazhdon të jetë po ajo, atëherë duhen studiuar më thellë shkaqet: vjen kjo sepse njerëzit nuk e prishin rehatin apo për arsyen të tjera? Prandaj ka rëndësi që të ndiqet zbatimi i porosive të dhëna.

Në qoftë se shkohet në plenumet e rretheve me këtë frysë dhe me këta objektiva, që u thanë këtu,

atëherë vajtja dhe marrja pjesë në to ka rëndësi dhe i shërben punës së Partisë. Natyrisht, njëri apo tjetri, që shkon atje nga qendra, mund dhe të mos e dijë në detaje gjendjen e punëve në rrethin që vete, por di disa gjëra kyç dhe pikërisht për ato shkon. Ç'do t'i thonë ata, ai do t'i dëgjojë me vëmendje, por pastaj do t'u thotë fjalën e tij, duke vënë theksin në ato të meta e dobësi që ndikojnë në mosrealizimin e planit.

Nuk është nevoja t'u flasim shumë kuadrove për rëndësinë e realizimit të planit, se ata janë shokë të ngritur politikisht e ideologjikisht, edhe teknikisht nuk janë keq, përkundrazi, janë të përgatitur, prandaj themi se të gjitha mundësitë i kanë që të organizojnë një luftë të vendosur për të realizuar planin në çdo zë e në çdo tregues. Këtë gjë e vërteton tash së fundi shembulli i Fierit dhe i Lushnjës. Shokët e këtyre rrëtheve ne i kritikuam seriozisht, kur konstatuam se prodhimet i kishin lënë në fushë dhe nuk e kishin organizuar mirë punën. Po të mos kishim bërë kështu, kjo gjendeje do të vazhdonte akoma edhe sot në të dy këto rrëthe. Kurse tani, pasi u shkundën nga rutina, na kanë thënë se për dy apo tri ditë do t'i përfundojnë vjetjet. Prandaj, më duket, shokët e rrëtheve kanë nevojë të nxiten e të ndihmohen.

Plani bëhet nga baza. Këtë e kemi thënë shumë herë, bile me zë të lartë, që organet qendrore të mos ndërhyjnë vend e pa vend. Kur shokëve të rrëthitet u imponohet, fjala vjen, mbjellja e duhanit nga ministria dhe janë të bindur se nuk i kanë kushtet për të marrë rendimente të mira në këtë bimë, kjo duhet parë. Rre-

thi, kur i ka bërë të gjitha përpjekjet dhe është shkundur nga puna rutinë, të përqendrojë forcat për të marrë rendimente më të mëdha në disa bimë të tjera bujqësore. Në këtë mënyrë do t'i dyfishohen të ardhurat edhe kooperativës, cdhe shtetit. Sigurisht, kur ministria shikon dhe bindet që në duhan, për shembull, Korça apo cilido rrëth tjetër, merr pak rendiment, duhet t'ia heqë nga plani. Në vend që të mbjellë duhan, në ato toka, Korça më mirë le të mbjellë misër që ka leverdi sikur të marrë edhe 25 kuintalë për hektar. Veçse këto gjëra duhen bërë me mend, se vërtet mund t'i shkurtohet sipërfaqja e mbjellë me duhan, por ama vlerën e këtij prodhimi Korça duhet ta kompensojë, bile edhe më shumë, me misër ose me ndonjë prodhim tjetër. Për këtë duhet t'u kërkohet llogari deri në një shokëve të rrëthit.

Për këto çështje duhet treguar kujdes, se nuk luhet me bimët vjetore nëpër ara, nëpër fusha. Natyrisht, edhe kushtet atmosferike luajnë rol në realizimin e prodhimeve bujqësore, por kryesorja janë shërbimet dhe organizimi i punës për to. Këtu ne duhet të mbajmë parasysh ecjen, dhe kjo ecje është pozitive. Kështu, për shembull, për panxharin kemi ecur përpara, por ky përparim duhet parë me kujdes se mund të marrim panxhar më shumë dhe sheqer më pak, ose panxhar diçka më pak, por sheqer më shumë dhe alkool më pak. Për të gjitha këto çështje duhet të bëhen mirë llogaritë. Panxhari i madh, për shembull, që nuk ka sheqer shumë, na jep melas, që ne, natyrisht, nuk e hedhim poshtë, por e përdorim si ushqim për bagëtinë, kurse panxhari i vogël është

më shumë i sheqerosur, prandaj duhet të shikohet me kalem në dorë se cili nga këta na leverdis më shumë. Në qoftë se do të interesohemi për panxharin, do të shohim se bota këto probleme i ka zgjidhur, prandaj edhe sheqer marrin më shumë, edhe bërsi u mbeten më shumë, edhe sasia e panxharit rritet. Të tilla probleme duhen studiuar me seriozitet dhe t'u shkohet deri në fund.

*Botuar për herë të parë në  
librin: Enver Hoxha «Raporte e fjalime  
1978-1979», f. 188*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha «Raporte e fjalime  
1978-1979», f. 188*

**T R E G U E S I T**



## TREGUESI I LËNDËS

### A

*Aftësia prodhuese, shfrytëzimi i saj — 99-101, 104-105, 107, 111, 146-150.*

*Aleanca e klasës punëtore me fshatarësinë — 457.*

*Anarkizmi, kritika e pikëpamjeve anarkosindikaliste nga klasikët e marksizëm-leninizmit — 303-304, 325, 326.*

*Armatimi, demagogjia imperialisto-revisioniste për qar-*  
*matimin — 422, 423.*

*Armiqtë, veprimtaria armiqësore dhe lufta kundër tyre —*  
5-6, 54, 65, 98, 122, 123-124,  
136-137, 199, 228-229, 407-408,  
420, 436, 451, 454-455.

*Arsimi në RPSSh — politika*  
*dhe kujdesi i Partisë për ar-*  
*simin; programet dhe tekste*  
*shkollore — 114-115, 190-191.*  
*Arti përparlmtar botëror —*  
189-190.

### B

*Bashkimi Sovjetik (1917—1953)*

— 18, 61, 155-156, 207, 424.

*Bashkimi Sovjetik, socialismi imperializmi sovjetik*

— shkaqet e lindjes së re-  
vizonizmit në BS; likuidimi i diktaturës së pro-  
letariatit, rivendosja e  
kapitalizmit — 25-26, 61,  
62, 413;

— politika e jashtme, lidh-  
jet me ShBA dhe me  
shtetet e tjera kapitaliste  
— 89, 253.

*Baza dhe superstruktura ka-*  
*pitaliste — 49, 71.*

*Baza dhe superstruktura so-*  
*cialeste — roli përektues i*  
*bazës ndaj superstrukturës —*  
49-50.

*Baza materialo-teknike, shfry-  
tëzimi i saj — 99-101, 104-105,*  
107.

*Blegtoria në RPSSh — politi-  
ka e Partisë dhe ndihma e*  
*shtetit për zhvillimin e bleg-  
torisë; bagëtitë e oborreva*  
*kooperativiste. Baza ushqimo-  
re, foraqjeret — 112, 263-279,*  
385-386.

*Borgjezia; borgjezia e re në*

*vendet revizioniste* — 23-24, 56-59, 62, 63-64, 67, 71, 154-155, 163, 308, 314-316, 339, 342-343.

*Bujqësia në RPSSh* — politika e Partisë dhe ndihma e shtetit për zhvillimin e bujqësisë; *bujqësia* — bazë e ekonomisë

— 108-113, 211-212, 445-446; — organizimi i punës në bujqësi — 394-401, 482-484;

— rajonizimi dhe struktura e degëve të saj; specializimi, përqendrimi, rendimentet e kulturave bujqësore. Kodi agroteknik — 272-284, 390-401, 482-483;

— toka, sistemimi dhe rritja e pjellorisë së saj; hapja e tokave të reja. Ujitja; plehrat organike dhe ato kimike — 110-112, 272, 282, 383-389, 390, 398;

— drithërat; patatja. Bimët industriale (panxharsheqerl, duhani) — 165, 273, 274-275, 276, 281, 392-393, 483-484;

— fidanët; farërat; bimët mjekësore — 40-41, 279-280, 282;

— punonjësit, specialistët dhe kuadrot e bujqësisë.

Studimet shkencore në bujqësi — 274, 277-278, 400-401.

**D**

*Dekorimet* — 117, 121.

*Demokracia borgjezo-revizioniste* — 55-65, 68-72, 73.

*Diktatura e proletariatit dhe demokracia socialiste; sistemi politik i diktaturës së proletariatit dhe roli udhëheqës i Partisë; roli i organizatave të masave. Klasikët e marksizëm-leninizmit për këtë problem* — 48-49, 50-55, 66, 67-68, 72, 234-235, 316-317, 325, 326, 333-334, 359, 372-373, 374, 376-377, 378-379, 411-412.

*Drejtimi dhe organizimi i ekonomisë* — centralizmi demokratik dhe drejtimi unik në ekonomi — 66, 412.

**E**

*Edukimi komunist; rrugët dhe mjetet e edukimit komunist* — 53, 92, 448.

*Efektiviteti i ekonomisë* — 112, 149-150, 152, 281, 385-386.

*Ekonomia në vendet kapitaliste e revizioniste* — 302-303,

306-307, 312-314, 318-324,  
413-414.

*Ekonomia popullore* — politika e Partisë për zhvillimin ekonomik të vendit; shfrytëzimi i rezervave të brendshme. Kooperimi — 46-47, 66, 92-94, 95, 96-116, 150-151, 211-212, 442-448.

*Engels, Fridrih* — 20, 28, 49, 59, 193, 199, 207, 208, 224, 226, 235, 286, 301, 302, 359, 362, 364, 417, 434, 437.

*Enver Hoxha* — të dhëna autobiografike — 14, 17, 117-118, 183, 193, 194-195, 222-223, 232, 233-234, 235-236, 243, 458-459.

*Epoka jonë* — përcaktimi leninist i epokës sonë — 418-419.

*Etnegrafia* — 182-183, 187-188.

*Europa, «Europa e Bashkuar»* — 253, 257-258, 326, 431, 443, 450.

## F

*Feja dhe ideologjia fetare; roli reaksiونar i tyre; qëndrimi i partisë marksiste-leniniste ndaj fesë* — 379-381.

*Folklori* — 180-184, 185-189, 190-191, 365-366, 449.

*Fronti Demokratik i Shqipërisë* — roli dhe detyrat e tij

për forcimin e pushtetit popullor — 45-46, 73-79.

*Fuqia punëtore; zënia me punë e të gjitha forcave të reja; sistemimi, shpërndarja e fuqisë punëtore* — 101-102.

## G

*Greqia; qëndrimi ndaj Shqipërisë* — 129, 133-134, 138, 242. *Grumbullimet* — politika e Partisë për grumbullimin e produkteve bujqësore e blegtorale; ndërmarrjet e grumbullimit — 384-387.

## II

*Historia e Shqipërisë* — trajtimi materialist-dialektik i saj — 11-12, 14-16, 185-186, 452-453.

## I

*Imperializmi* — karakteristika, tipare; vendi historik i imperializmit, imperializëm në kalbëzim, paslindangësia e zhdukjes së tij — 61, 258-262; — strategja dhe taktikat e imperializmit, politika e luftës dhe e agresionit; aleancat, bloqet — 239-240, 251-262, 416, 422-423, 440-441; — kapitalizmi monopolist

shtetëror; eksportimi i kapitaleve dhe roli i shtetit në eksportimin e kapitaleve; shoqëritë shumëkombësore — 69-72, 307-311, 312-313, 321;

— lufta e popujve të botës kundër imperializmit — 259-260, 419.

*Industria e lehtë dhe ushqimore* në RPSSh — 109-110.

*Industria e rëndë* në RPSSh — zhvillimi i saj; shpërndarja përpjesëtimore e industrisë; përpunimi i lëndëve të paratë vendit — 393-394, 443-445;

— industria mekanike, prodhimi në vend i pjesëve të këmbimit, i makinave e fabrikave; industria elektrike — 107, 112, 140-152, 442, 444-445;

— industria minerale; metalurgjia — 6, 7, 100, 103, 443;

— punëtorët, specialistët dhe kuadrot — 8-8, 413-444.

*Interesi i përgjithshëm* dhe ai vjetjak — 51-52, 417-448.

*Internacionalizmi proletar* — 414, 419, 421, 422, 435.

*investimet* — përdorimi me efektivitet i tyre — 93, 104-106, 112.

*Israeli; regël e imperializmit amerikan; politika e luftës*

dhe e pushtimeve — 84-85, 242, 243, 244, 439-440.

## J

*Jugosllavia, revisionistët jugosllavë; teoria dhe praktika e tyre për kalimin në kapitalizëm; vetadministrimi; thelibë anarkosindikaliste i tij* — 207-208, 301-302;

— Partia Komuniste e Jugosllavisë, vija e saj gjatë Luftës Nacionaçlirimitare dhe pas çlirimt — 286-290, 291, 293-295;

— qëndrimi ndaj borgjezisë kombëtare dhe ndërkombëtare; agjenturë e imperializmit, lidhjet me imperializmin anglez, amerikan etj. — 287, 289-290, 296-298;

— kontradiktat me BS të kohës së Lenin-Stalinit, me lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe me Kominternin — 287-288, 289, 290-292, 352, 353-354, 355, 364-365, 370-371, 373-374;

— sistemi i vetadministrimit në ekonomi, mohimi i pronës socialiste dhe vendosja e pronës private mbi mjetet e produktionit — 302-324;

- zhvillimi i kapitalizmit në Jugosllavi, reformat në ekonomi; shpërndarja e produktit, mbivlera; zhvillimi i kapitalizmit në fshat — 292-293, 297, 293-299, 306-307, 312-313, 320, 413;
- depërtimi, investimet e kapitaleve të huaja, veprimi i shoqërive shumë-kombësore; ndërthurja e interesave të fuqive të huaja në Jugosllavi — 296-299, 299-300, 303-311, 313;
- zhvillimi i paplanifikuar dhe i decentralizuar i ekonomisë jugosllave; mohimi i centralizmit demokratik dhe i funksionit ekonomik të shtetit — 317-318, 320, 321-322;
- anarkia, konkurrenca, tregu i brendshëm dhe tregu i jashtëm; fuqia blerëse, papunësia, emigracioni ekonomik, Polarizimi i shoqërisë jugosllave — 318-323, 366-367;
- sistemi i vëtadministrimit dhe mohimi i rolit të shtetit; mohimi i diktaturës së proletariatit, zë-vendësimi i saj me shtetin revisionist; pikëpamjet anarkiste mbi shtetin, qëndrimi ndaj shtetit borgjez, parlamentarizmit borgjez dhe pluralizmit politik — 295, 297-298, 312-313, 316-317, 324-346, 365-366, 367-369;
- politika dhe sistemi politik; roli i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe i organizatave të masave në të; teorizimet mbi «pluralizmin demokratik» — 330-332, 337-340, 345-346, 351-352, 353-358, 360-363, 369, 371, 373, 377-379;
- mohimi i demokracisë e i centralizmit demokratik, veprimi i centralizmit burokratik dhe i diktaturës së borgjezisë — 298-299, 300, 316-318;
- sistemi i vëtadministrimit dhe mohimi i rolit udhëheqës të partisë komuniste; degjenerimi i PKJ, reduktimi i rolit të saj në faktor ideologjik — 61, 62, 289-290, 294-295, 300-301, 347, 348-359;
- gjendja e klasës punëtore në Jugosllavi; demagogjia e revisionistëve jugosllavë për rolin udhëheqës të klasës punëtore

- 294, 313, 314-318, 320, 322-324, 327, 337-340, 346, 356, 358, 376;
- klasa e re borgjeze në Jugosllavi — 312-316, 317-318, 320, 346, 358, 376;
- gjendja e brendshme, lufta e grupeve për push-tet; lufta e klasave në Jugosllavi — 295-296, 297-298, 299, 300;
- çështja nacionale, qëndrimi ndaj Kosovës dhe popullsisë tjetër shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 287-288, 335-337;
- qëndrimi armiqësor ndaj marksizëm - leninizmit, socializmit dhe revolucionit; mohimi i ligjeve të përgjithshme dhe absolutizmi i kushteve konkrete — 286, 292-294, 339-342, 343-346, 353-350, 363-367;
- pikëpamjet individualiste, anarkiste; pikëpamjet për klasën punëtore, për diktaturën e proletariatit dhe për demokracinë sociale; qëndrimi ndaj fesë — 327-328, 358, 365, 366, 371, 372, 373-374, 375, 380-381;
- qëndrimi armiqësor ndaj

PPSh dhe RPSSh — 291-292, 296.

## K

- Kapitalizmi — karakteristika të përgjithshme dhe ligje të zhviliimit të tij — 50-51, 55-67, 69-72, 114, 140, 203, 312-321, 342-343, 350, 361-362, 367, 368-369, 412-414, 418-419, 423;*
- ndërhyrja e kapitaleve të huaja në vende të ndryshme të botës; shfrytëzimi i masave punonjëse — 57-58, 67, 68, 73, 307-318, 322-324, 339, 412-414, 450;
- lufta e popujve të bolës kundër sistemit kapitalist; pashmangësia e zhdukjes së tij — 69, 332-333, 419.

*Këshillat nacionalçlirimtarë — 72.*

*Këshillat popullorë — komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rrethive; seksionet, detyrat e tyre — 10, 24, 174, 385.*

*Këshilli i Ministrave (Qeveria), Kryesia e Këshillit të Ministrave. Kryeministria — 9, 30-31, 41, 43, 47, 90, 137, 169, 171, 173, 176, 278, 283, 412, 424.*

Kina, revizionizmi kinez, Partia Komuniste e Kinës; vija oportuniste, politika e jashtme demagogjike, pragmatiste, hegemoniste — 39, 155-156, 199-200, 201-202, 241-243, 237, 425, 430-431;

- zhvillimi i kapitalizmit në Kinë, depërtimi i kapitaleve të huaja — 100-161, 229, 237-250, 254;
- gjendja e brendshme; lufta e grupeve për pushimet, Revolucioni Kultoror — 21, 22, 159-160, 202-203, 204, 237, 245-246, 250;
- qëndrimi ndaj vendeve fqinje, synimet ekspansioniste ndaj Vietnamit e Kamboxhias; lidhjet me Japoninë — 240-241, 251-255, 430-431;
- synimet ndaj Ballkanit; marrëdhëniet me revizionistët jugosllavë dhe rumunë — 209-210, 242, 427, 431-433;
- tradhtia ndaj marksizmit-leninizmit, demagogjia për ndërtimin e socializmit — 153-154, 204, 208-209;
- qëndrimi ndaj Bashkimit Sovjetik (1917-1953), ndaj Kominternit dhe ndaj

Stalinit e veprës së tij — 229;

- strategjia dhe taklikat, synimet dhe përpjekjet për t'u bërë superfuqi; lidhjet me imperializmin amerikan e shtetet e tjera kapitaliste; marrëdhëniet, kontradiktat me revizionistët sovjetikë — 155-157, 202, 209, 220, 230, 238, 239, 242-243, 244-245, 253, 251-253, 253, 429-431;
- marrëdhëniet, qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPSSH — 91-92, 96, 97-98, 103-106, 162, 200-201, 210-211, 231, 210-211, 424-425, 426, 427-429, 433.

*Klasa punëtore në Shqipëri; roli udhëheqës, edukimi ideo-politik i saj* — 445.

*Klasa punëtore në vendet borgjezo-revisioniste* — 28, 55, 61, 162-163, 317-318, 322-324, 412-413.

*Klasat dhe lufta e klasave në socializëm; lufta kundër sektarizmit në zhvillimin e lusës së klasave* — 454-455.

*Klasat, lufta e klasave në kapitalizëm; partitë politike në vendet borgjezo-revisioniste* — 55-58, 60, 61-62.

*Kolektivizimi socialist — politika e Partisë për transformacionin e strukturave sociale*

- mimin socialist të fshatit; epërsia e pronës kolektive mbi atë private — 416-418.
- Kompetencat, përgjegjësitetë* — 4, 30-34, 165-169.
- Kontrolli dhe kërkesa e llogarisë* — 10, 34-35, 178-179, 278, 391.
- Konrolli i Partisë, i shtetit dhe i klasës punëtore* — 41-42, 67.
- Kooperativat bujqësore* — politika e Partisë për forcimin e gjithanshëm të tyre dhe për konsolidimin e rendit kooperativist — 416;
- tufëzimi i bagëtive në bazë të parlamentit të vullnetarizmit; shpërndarja e produkteve blegtorale — 264-271;
  - organizimi i punës; statuti i kooperativave bujqësore, kuadrot — 187-188, 385-386, 446.
- Kosova dhe popullsia tjeter shqiptare që banon në trojet e reta në Jugosllavë; politika shqiponoste, shkombëtarizuesë e revolucioniste jugosllavë ndaj saj* — 126, 127-128, 129, 130-131, 132, 134-135, 138-140, 142, 283, 336.
- Kostoja e prodhimit* — detyrat për uljen e saj — 103.
- Kreditë, ndihmat ndërmjet shteteve; kuptimi marksist-le-*
- ninist i tyre — 94, 423-424.
- Kuadrot, specialistët* — politika e Partisë me kuadrin — 9-10, 148-149;
- detyrat e tyre; shfrytëzimi i përvojës së kuadrore të vjetër — 283, 387-388;
  - marrëdhëniet kuadërmasë; qarkullimi i kuadrove, lufta kundër të metave në qarkullimin e kuadrove — 173-179, 461-464;
  - kuadrot e Partisë — 467.
- Kultura në RPSSh* — përbajtja dhe forma — 180, 181.
- Kultura përparimtare botërore* — 436-437.
- Kushtetuta dhe ligjet në vendet borgjezo-revizoniste* — 50, 60, 73.
- Kushtetuta e RPSSh* — 50, 51, 66, 72.
- Kuvendi Popullor, Presidiumi i Kuvendit Popullor* — 45, 54-55, 121.

**L**

- Lenin, Vladimir Ilit* — 18, 20, 23, 49, 52, 55, 56, 58, 61, 62-63, 69, 70, 71-72, 162, 163, 198, 199, 207, 208, 224, 226, 229, 235, 266, 299, 301, 303, 304, 306, 310-317, 318-319,

324, 325, 332, 341, 345-346,  
347, 350-351, 352, 353, 362,  
364, 369, 370, 371, 372-373,  
374, 375, 377, 383, 417, 418,  
420, 424, 431, 433, 434, 437,  
446, 451.

*Letërsia dhe artet në RPSSh*  
— 449;

— politika e Partisë në fu-  
shën e letërsisë dhe të  
arteve — 128-189;  
— përbajtja dhe forma,  
karakteri kombëtar. Tra-  
dita dhe novatorizmi —  
180-183, 185-189, 190, 191-  
193;

— lufta kundër ndikimeve  
dhe shfaqjeve borgjezo-  
-revizioniste në letërsi  
dhe në art — 436-437;  
— shkrimitarët, artistët, ta-  
lentet e reja — 191-193.

*Lëvizja komuniste marksiste-  
-leniniste ndërkombe të*

— marrëdhëniet, shkëmbimi  
i mendimeve dhe i  
përvojës ndërmjet parti-  
ve marksiste-leniniste.  
Domosdoshmëria e forcim-  
it të unititetit dhe e luf-  
tës së tyre kundër re-  
vizionizmit kinez — 27,  
153-162, 199-200, 206, 213-  
-214;

— lindja e elementeve re-  
vizionistë, përkrahës të

revizionistëve kinezë —  
17-19, 22-26.

*Ligjet në RPSSh* — njohja,  
zbatimi i tyre — 72-73.

*Luftë Antifashiste Nacional-  
çlirimtare e popullit shqiptar;*  
mësimet, rëndësia — 197-198.  
*Luftërat, shkaqet dhe shkak-  
tarët e shpërthimit të luftë-  
rave; përpjekjet e popujve e  
të partive marksiste-leniniste  
për mënjanimin e luftës —*  
85, 258, 431.

## M

*Marksizëm-leninizmi* — armë  
dhe busull për udhëheqje e  
veprim; karakteri universal  
dhe vitaliteti i tij — 49, 50-  
-51, 55, 69, 123, 197, 224, 226,  
259, 307, 332-334, 364, 417,  
440, 451.

*Marks, Karl* — 20, 23, 49, 52,  
55, 57, 69, 73, 162, 193, 199,  
207, 208, 224, 226, 229, 235,  
236, 300, 301, 302, 325, 332,  
333, 334, 340, 349, 359, 362,  
364, 369, 372, 379-380, 417,  
420, 434, 437.

*Masat popullore: roli i ma-  
save dhe i individit në histori*  
— 11-12, 16, 185-186, 198-  
-199.

*Mbështetja në forcat e reja* —  
5, 77, 97, 98, 106, 115, 150-

-151, 152, 231, 423, 428, 443.  
*Mbrojtja e atdheut; forcimi i galishmërisë luftarake të ushtrisë, të popullit dhe të gjithë vendit për mbrojtje* — 48, 114, 451-452.

*Ministratë dhe kuadrot e tyre; kompetencat, përgjegjësitë, metoda dhe stili në punë* — 4, 30-31, 106, 397-399;  
 — Ministria e Punëve të Brendshme — 135-136, 142;  
 — Komisioni i Planit të Shtetit — 90, 106, 111-112;  
 — Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 408;  
 — Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore — 325;  
 — Ministria e Bujqësisë — 34, 111-112, 265, 266, 271, 274, 276, 278, 390, 391, 394, 395-396, 397, 400, 432, 433;  
 — Ministria e Tregtisë së Jashtme — 9, 30, 33-34, 35-36, 38, 44.

*Mirëqenia në shoqerinë tonë socialiste; treguesit e rritjes së saj* — 48, 419-451.

## N

*Nafta — shfrytëzimi i puseve të naftës; metodat shkencore, specialistët* — 402-409.

*Ndërtimet — politika e Partisë në fushën e ndërtimeve; ndërtimi i hidrocentraleve dhe objekteve të tjera industriale. Kuadrot, specialistët, inxhinierët* — 8-9, 95-96, 105-106, 103, 442-443.

*Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — politika e Partisë për ndërtimin e socializmit në bazë të ligjeve të marksi-zëm-leninizmit* — 49, 51-52, 53-55, 67, 72-73, 97, 139, 152, 211-213, 317, 318, 411-412, 416-417, 438;  
 — zhvillimi i pandërprerë dhe konsolidimi i shoqërisë socialiste; Rëndësia ndërkombëtare e ndërtimit socialist — 48, 77, 231-232, 451, 454;  
 — zhdukja e shfrytëzimit të njeriut prej njeriut; roli i socializmit në zhvillimin e gjithanshëm të tij — 67-68, 73, 232, 457.

## O

*Organet dhe repartet e Ministrisë së Punëve të Brendshme — roli udhëheqës i Partisë. Forcat e Kufirit, kushtetët; Sigurimi i Shtetit* — 132-134, 135-136, 141-142.

*Organet shtetërore dhe ato ekonomike* — 54-55, 115, 264.

*Organizata-bazë e Partisë; byroja dhe sekretari, deputatë e tyre* — 145, 168-169, 466-467;

- organizatat-bazë të Partisë në dikastere dhe në bazë — 30, 41-42, 177-178;
- organizatat-bazë të Partisë në rrethet kufitare — 142.

*Organizimi dhe drejtimi* — 95, 106, 178.

## P

*Paga — politika e Partisë në fushën e pagave* — 52-53.

*Palestina — lufta e popullit palestinez për të fituar lirinë, pavarësinë dhe të drejtat e veta* — 85-86, 87-88.

*Partia e Punës e Shqipërisë* — rija, vendimet, direktivat, ndërtimi dhe jeta e brendshme

- themelimi i PKSh, rruga historike e saj — 223-224, 410-411;
- rija e saj në Lustën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist të vendit — 12, 31, 47-48, 51-52, 75, 114-115, 170, 224-225, 226-227, 474;
- forcimi organizativ, uni-

teti në Parti — 222-223, 232-233, 474;

- rija, vendimet, direktivat; njohja dhe zbatimi i tyre — 2, 4, 8-9, 32, 47, 94-95, 107, 137, 169, 170-178, 264-265, 270;
- karakteristikat e Partisë, besnikëria ndaj marksi-zëm-leninizmit — 51, 94-95, 162, 193, 223-225, 226-227; .

— pranimet në Parti, kriteret e pranimit; rekomanimet, rekomanuesit — 465-474;

— shpërndarja, lëvizja e forcave të Partisë — 460-461, 465-466, 470-471;

— puna e Partisë, metoda dhe stil i saj në punë; ndihma e kontrollit për bazën — 33-34, 171, 266, 479-480, 481-482;

— puna e Partisë me njerëzit, qëndrimi ndaj njerëzve që gabojnë — 8-9, 129.

*Partia e Punës e Shqipërisë*

— organet udhëheqëse qendore dhe në rrethe

- Kongresi VII i PPSH (1-7 nëntor 1976) — 47, 90, 92, 100, 103, 235, 428-429, 457;
- Komiteti Qendror, Byroja Politike — 4, 30, 38,

- 43, 98, 108, 115, 134, 261, 265, 270, 396, 412;
  - aparati i KQ — 31, 33, 36, 273;
  - komitetet dhe aparatet e Partisë në rrethe; sekretarët — 9-10, 42, 174, 460, 473;
  - Komitetet e Partisë në rrëfshet kufitare — 126-127, 132;
  - Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës — 163;
  - plenumet, anëtarët e tyre; detyrat e tyre për ndjekjen dhe zbatimin e vëndimeve — 476, 478-481.
- Partia Komuniste e Shqipërisë — politika e fashme*
- analiza marksiste-leniniste e situatës ndërkom-bëtare, mbrojtja dhe zbatimi krijues i marksizëm-leninizmit — 226-227, 381-383;
  - lufta e saj kundër imperializmit, socialimperializmit, revolucionizmit e reaksionit dhe përkrahja për popujt që luftojnë për liri — 66, 80-82, 227-228, 230-231, 261, 414-415, 421, 441;
  - marrëdhëniet dhe përkrahja për partitë marksiste-leniniste — 196-
  - 197, 227-228, 230;
  - qëndrimi parimor ndaj Kinës dhe PK të Kinës, demaskimi i revisionizmit kinez — 122-123, 153-162, 205, 229-230, 424-426, 434;
  - demaskimi i revisionizmit jugosllav dhe sovjetic — 207-208, 210, 235-353.
- Partia Komuniste e Britanisë së Madhe — 17-19, 22-23, 24-25, 26-27, 28.*
- Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Australisë; përkrahja e saj për revisionistët kinezë — 19, 24.*
- Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Brazilit — 196.*
- Partia Komuniste (marksiste-leniniste) e Kilit — 24.*
- Partia Komuniste (revisioniste) e Spanjës — 65.*
- Partitë dhe shteti, karakteri klasor i tyre; partia e klasës punëtore, karakteri i saj proletar — 349, 352-353.*
- Përvoja e përparuar, përgjithësimi i saj — 279.*
- Planifikimi i ekonomisë popullore — metodologjia, parime të planifikimit: ndihma dhe kontrolli — 9-10, 30-31, 66-67, 92-93, 96-97, 115, 211;*
- pjesëmarrja e masave në planifikim; lufta për re-*

- alizimin e planeve në bujqësi dhe në kooperativat bujqësore — 92-94, 170-171, 277-284, 389-391, 412, 482;
  - plani i 6-të (1976—1980) dhe i 7-të (1981—1985) pësëvjeçar — 90-116, 211;
  - lufta kundër gabimeve e të metave në planifikim dhe në realizimin e planeve — 30-31, 165-168, 170.
- Politika e Jashtme e RPSSh — parimet themelore të saj; rritura e prestigjit dhe i autoritetit të PPSH dhe RPSSh në botë. Të huajt për Shqipërinë — 48, 76-82, 124, 138-140, 227-228, 414-418, 422, 435-436, 437-439, 451;*
- marrëdhëniet me vendet fqinje dhe me vendet e tjera; qëndrimet e drejta parimore ndaj tyre — 75-82, 134, 138, 438-439, 440;
  - marrëdhëniet dhe qëndrimi marksist-leninist ndaj Kinës — 162, 201-202, 424, 425-427;
  - solidariteti dhe përkrahja për luftërat çlirimtare të popujve të Afrikës dhe të Amerikës Latine; qëndrimi ndaj konfliktit kamboxhiano-vietnamez — 441;
  - marrëdhëniet dhe qëndrimi parimor marksist-leninist ndaj Kosovës dhe popullsisë tjetër shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi — 127, 129-132, 135, 139, 140-142;
  - lufta kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit — 227.
- Populli shqiptar — cilësitë, traditat patriotike e revolucionare; roli i tij në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist — 48, 94-95, 183-184, 213, 223-224, 225-226, 228, 433, 440, 455-456.*
- Popullsia — demografia — 449-450.*
- Prodhimi material, riprodhimi i zgjeruar socialist; rritura e pandërpërre e prodhimit material; cilësia — 34, 98-116.*
- Prona në kapitalizëm; pikëpamjet borgjezo-revizioniste mbi karakterin e pronës private — 302-305, 306-307.*
- Prona në RPSSh — rëndësia, kuptimi dhe qëndrimi socialist ndaj saj; klasikët e marksizëm-leninizmit për pronën socialiste — 173, 263-266, 302-304, 306-307;*
- oborri kooperativist — 267.*

*Propaganda, agjencitë e lajmeve dhe shtypi borgjezo-rezisionist — 17, 18-23, 58, 63, 68-69, 89, 135, 138-139, 162, 205-206, 207, 285, 290, 323-324, 383, 415-416, 417, 421-422, 426-427.*

*Propaganda, agitacioni; përmbytja, format, mjetet. Propaganda për botën e jashime — 13-16, 123, 129-132, 162, 206, 207, 270-271, 383.*

*Pushteti popullor — formë e diktaturës së proletariatit; pjesëmarrja e masave në qeverisjen e vendit — 50, 52, 72-73, 171;*

— shkatërrimi i pushtetit të vjetër dhe ngritja e pushtetit të ri — 66, 67-68.

## R

*Reformizmi, thelbë i tij — 64-65.*

*Regjimi i kursimit — kursimi i drurit si lëndë djegëse — 386-387.*

*Rendimenti i punës — kushitet dhe faktoret për tritjen e pandërprerë të tij — 102-103.*

*Revizionizmi modern, pluralizmi politik dhe ideologjik; thelbë dhe strategjia e tij — 60-61, 64, 446;*

— lufta e rezisionistëve modernë kundër marksizëm-

-leninizmit dhe klasikëve të m-l — 371-372, 382-383.

*Revolucioni socialist proletar dhe luftërat nacionalçlirimtare të popujve — 64, 196-197, 199, 260-261, 419;*

— revolucioni me dhunë si kusht për kalimin nga kapitalizmi në socializëm — 65-66;

— domosdoshmëria e rolit udhëheqës të partisë komuniste, klasikët e marksizëm-leninizmit për këtë problem — 65, 348;

— lufta kundër shtrembërlimeve oportuniste lidhur me forcat lëvizëse në revolucion — 27-28.

*Revolucioni tekniko-shkencor, zhvillimi dhe thellimi i tij; grupet e punës — 102, 106-108, 173, 174;*

— mekanizimi, përqendrimi, përsosja e proceseve teknologjike. Studimet shkencore — 143-148, 171-176.

*Rinia — roli i saj në ndërtimin socialist të vendit — 417, 448-449.*

## RR

*Rrethimi, bllokada e presioni imperialisto-rezisionist dhe lufta përballimin dhe çar-*

*Jen e tyre* — 30, 39, 448, 454, 455.

**S**

*Socializmi* — ligje, parime, tipe dhe veçori të përgjithshme të tij — 140, 200-207, 319-320, 322-323, 339-340, 347-348, 376, 380;

— epërsia e sistemit socialist mbi atë kapitalist — 49-50, 456.

*Stalin, Josif Visarionovic* — 18, 23, 25, 29, 43, 50-51, 61, 97, 155-156, 193, 199, 204, 208, 210, 224, 226, 229, 235, 286, 288, 299, 291, 293, 299, 301, 324, 353, 355, 362, 364, 370, 371, 372, 373, 374, 375, 417, 422-423, 424, 434, 437, 446.

*Shtimujt moralë* — 171.

*Supersuqitë* — përpjekjet e tyre për hegemoni në botë — 256.

**SH**

*Shkencë në RPSSh* — politika dhe kujdesi i Partisë për shkencën — 144-145, 174, 175, 176; — masivizimi i shkencës, lidhja e saj me jetën dhe

me praktikën — 149, 400, 407-408;

— organizimi dhe drejtimi i punës shkencore — 149, 151-152, 172-173; — institucionet shkencore dhe punonjësit shkencorë; studimet shkencore — 143-152, 172, 174, 274-275, 397-398, 400, 403-404.

*Shtctet e Bashkuara të Amerikës* — politika e jashtme hegemoniste; aleancat, bashkëpunimi me Kinën, me BS, dhe me shtctet e tjera kapitaliste — 84-85, 251-252, 254, 256;

— strategjia, taktitat; përpjekjet për të ruajtur dhe vendlodhur sundimin mbi vendet e Lindjes së Mesme, të Afrikës, të Amerikës Latine etj. — 83-85, 88, 87-89, 255-256, 257.

*Shteti borgjez, sistemi parlamentar borgjez* — 69-70, 342-343, 361-362, 368-369.

*Shteti socialist* — 49, 52.

*Shtypi në RPSSh* — 13-16.

**T**

*Teoritë borgjezo-revizoniste* dhe kritika ndaj tyre — 163, 204-206;

- teoritë për ndryshimin e natyrës së imperializmit, përpjekjet për të mohuar teorinë leniniste mbi imperializmin — 162-163;
- teoritë e revisionistëve kinezë për «tri botët», për mbështetjen në njërin imperializëm për të luftuar tjetrin etj. — 154, 156-158, 418, 420-421, 428-430, 434;
- teoritë e eurokomunistëve mbi rrugën paqësore parlamentare për në sozializëm — 210, 341-344;
- teoria e revisionistëve jugosllavë për botën e «paangazhuar» — 420-421.

*Të ardhurat kombëtare, rrugët për tritjen e tyre; akumulimi socialist, norma e akumulimit, fondi i akumulimit. Ligji i akumulimit socialist — 101-106, 108-116.*

*Tregtia e brendshme — furnizimi i popullit — 109-110.*

*Tregtia e jashtme — parimet themelore në fushën e tregtisë së jashtme — 37, 43, 93-94, 423, 435-436;*

- eksporti-importi; zëven-dësimi i mallrave të importit me ato të vendit — 8, 9, 33-36, 39-41, 42-43,

- 103, 110, 113-114;
- organizimi i punës, realizimi i kontratave — 31, 33-36, 38-39;
- organet e tregtisë së jashtme dhe punonjësit e tyre — 30, 37, 43, 44.

## U

*Uniteti i popullit, uniteti Partitit-popull — 46, 54, 232-233, 453, 454.*

*Ushtria Nacionalçirimitare Shqiptare; Shtabi i Përgjithshëm — 14-15.*

## V

*Vështirësitet, lufa për kapërcimin e tyre — 8, 29-30, 92-94, 97-98, 212-213, 228, 231, 232.*

*Vigjilencia revolucionare — 23, 27, 80, 128, 131-134, 137-138, 140, 383, 431-432, 437, 438, 451, 454-455.*

## Z

*Zgjedhjet në vendet kapitaliste — 56-57, 456.*

*Zgjedhjet për Kurendin Popullor — 45-49, 82, 410, 456-458.*

## TREGUESI I EMRAVE

### A

Alia, Ramiz — 17, 18, 19, 145,  
147, 172, 185, 194, 211, 219,  
263, 275, 280-281.

Agolli, Dritëro — 216.

Amazonas, Zhaoao — 194, 195-  
-196, 207, 212, 213.

Arruda, Diogenes — 195.

Asad, Hafëz el — 88.

Avdalli, Xhevat — 216, 219.

### B

Bah, Johan Sebastian — 189.

Bajrami, Avdi — 216.

Bakunin, Mihail — 210, 325.

Balluku, Beqir — 68, 428.

Bauer, Oto — 304.

Begin, Menahem — 83, 86, 88,  
89.

Bismark, Oto — 433.

Buda, Aleks — 144.

Buharin, Nikolai — 18, 20.

### C

Caldaris, Kostandin — 134.

### C

Çani, Elmaz — 218.  
Çerçill, Uinston — 287, 289.  
Çu En Lai — 153, 154-155,  
157, 201, 202, 211, 427, 431.

### D

Daija, Tish — 191.  
Desio, Dineas Agiar — 195.  
Dizrael, Benjamin (Lordi Bl-  
konsild) — 433.

### DH

Dhima, Mihal — 218, 219.

### F

Fundo, Kristaq — 215.

### G

Garibaldi, Xhüzepe — 189.  
Gorkic, Milan — 288.

Gradeci, Sulo — 218.  
Grei, Eduard — 433.

**J**

Jonuzi, Sadik — 220.

**GJ**

Gjikondi, Ela — 216.  
Gjikondi, Vangjel — 216.  
Gjilas, Milovan — 289.  
Gjura, Ali — 220.

**K**

Kapo, Hysni — 169-170, 219,  
265, 266-267, 268, 271, 273-  
-274, 275, 277, 279, 282, 283-  
-284, 388.

**H**

Hoxha, Nexhmije — 118, 194,  
217.  
Hekel, Ernst — 203.  
Hill, Eduard — 19, 24.  
Hitler, Adolf — 256.  
Hoxha, Ermal — 194.  
Hoxha, Nedin — 29, 32, 33, 36,  
38, 42, 44.  
Hoxha, Shpati — 194.  
Hoxha, Valbona — 194.  
Hrushov, Nikita — 24, 25, 155,  
244.  
Hua Kuo Fen — 23, 24, 26,  
153, 155, 160, 204, 209-210,  
237, 238, 239, 242, 250, 362,  
426, 428, 431, 432, 433, 434.  
Hysein, Sadam — 88.  
Hysi, Neshat — 219.

**I**

Isai, Hekuran — 1, 41, 42,  
117, 181, 272-273, 276, 282,  
384-385, 387, 388, 460.  
Iden, Anton — 244.

Kardel, Eduard — 208, 235,  
289, 291, 292, 293, 294, 295, 300,  
301, 302, 305, 306, 307, 309-  
-310, 311-312, 313, 314, 315-  
-316, 317, 318, 319, 320-321,  
323, 325-326, 327-331, 332, 333,  
334-335, 337-341, 342, 343-  
-345, 347, 348, 349-350, 351,  
352, 353-357, 358-359, 360-  
-361, 362, 364-365, 366, 367-  
-371, 373, 375-376, 377-378,  
379, 380-381, 383.

Karter, Xhimi — 83, 86, 88,  
89, 135, 253.

Këllezi, Abdyl — 66, 407, 428.

Kërthi, Pandi — 117, 121.

Kim Ir Sen — 207.

Kolaneci, Dritan — 194.

Kondi, Qazim — 217.

Konfuci — 229.

Kroi, Haxhi — 117-121, 122,  
125.

**L**

Lako, Miha — 215.

Li Hsien Nien — 211.

**L** Lin Biao — 17, 20, 21, 22,  
158, 202.

**Liu Shao Ci** — 247.

**LL**

**Lleshi, Haxhi** — 13.

**M**

**Murra, Prokop** — 29, 36, 165,  
167, 168, 171-172, 175, 277-  
-278, 279, 384, 386, 387, 388,  
389, 390, 396, 397, 400, 401,  
476.

**Manushi, Violeta** — 216.

**Mao Ce Dun** — 17, 18, 19, 21,  
22, 23, 24, 25, 26, 123, 153,  
154-155, 156-157, 158, 159,  
160, 161, 162, 200, 201, 202-  
-203, 204-205, 206, 207, 209,  
229, 239, 245, 247, 426-427,  
428, 429.

**Metaksas, Joanis** — 134.

**Mihajloviç, Drazha** — 289.

**Morava, Stamata** — 117, 121.

**N**

**Naser, Gamal Abdel** — 243.

**Nedić, Milan** — 289.

**Nikson, Riçard** — 156, 157.

**Nushi, Kozma** — 118.

**O**

**Osmani, Adem** — 220.

**Osmani, Sabrije** — 220.

**P**

**Paçrami, Fadil** — 436-437.

**Papakristo, Sotir** — 216.

**Pin De Hua** — 202.

**Prifti, Ilo** — 480.

**Prudon, Pjer** — 210, 304, 325.

**R**

**Rali, Stavri** — 117, 121.

**Rankoviç, Aleksandër** — 289,  
290, 291, 292, 293, 294, 295,  
300, 355.

**Reka, Shpresa** — 219-220.

**S**

**Skënderbeu, Gjergj Kastrioti**  
— 452.

**Sadat, Anvar el** — 83, 86, 88,  
89.

**Saud, Ben Abdel Azis** — 89.

**Stojadinoviç, Milan** — 289.

**Subashiç, Ivan** — 289.

**Sun Jat Sen** — 246.

**SH**

**Shehu, Feçor** — 136.

**Shehu, Mehmet** — 15-16, 173.

**T**

- Tartale, Hulo — 117, 121.  
 Ten Hsiao Pin — 23, 24, 26,  
   153, 155, 157, 160, 202, 205-  
   -206, 237, 238, 240-241, 247,  
   248, 249, 250, 362, 426, 428,  
   429, 431.  
 Tito, Josip Broz — 131, 138,  
   139, 140, 208, 210, 214, 242,  
   287, 288, 289, 290, 291, 292,  
   293, 294, 295, 296, 300, 301,  
   303-304, 305, 313, 314-315,  
   321-322, 331, 336, 354, 355,  
   357, 373, 376, 432, 434.  
 Truja, Jorgjia — 216.

**TH**

- Theodhosı, Koço — 66, 428.  
 Theohari, Polikseni — 219.  
 Thomai, Themie — 38.

**V**

- Vagner, Rikard — 189.  
 Vehipi, Riza — 387.  
 Vens, Sajrus — 88.  
 Verdi, Xhiuzep — 189.  
 Vu Teh — 202, 247.

**X**

- Xoxe, Koçi — 292.

**XH**

- Khajanka, Llazar — 145, 146-  
   -147, 148, 149, 150.

**Z**

- Zela, Vaçe — 191.  
 Zogu, Ahmet — 188, 190.

## TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

### A

- Afrikë — 244, 245, 251, 441.  
Akademia e Shkencave e RPSSh — 151-152, 176.  
Algjeri — 88, 244.  
«Allez à l'enfer» (kënga ~) — 189.  
Amerika Latine — 441.  
Ansambli i Këngëve dhe i Valleve Popullore i RPSSh — 134.  
Arabia Saudite — 84, 86, 88, 242, 243, 257.  
ASEAN (Organizata e Vendeve të Azisë Juglindore) — 255, 256.  
Asoshtejt Pres (agjencia e lajmeve ~) — 83.  
Australi — 255.  
Austri — 437.  
Azi — 242, 251, 254, 255, 256, 258, 430, 441.

### B

- Ballkan — 210, 242, 432.  
Belgikë — 135, 323, 437.  
Beograd — 432.

Brazil — 195.  
Britania e Madhe — 28, 209, 238, 244, 252, 253, 287.

Bulgizë (fusha ~, Dibër) — 390.  
Bullgari — 292.

### C

CIA (Agjencia Qendrore e Shërbimit Informativ në ShBA) — 259.  
Cisjordani — 85, 86, 87.

### Ç

Çekoslovaki — 292.  
Çermenikë (Librazhd, Elbasan) — 15.  
«Ç'kanë malet që rënkojnë» (kënga ~) — 188.

### D

Dibër — 13, 15, 127, 272, 273, 274, 276, 280, 390, 393.

- Dibër e Madhe (Jugosllavi) — 129.  
 «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vëtadministritës socialist» (libri ~, E. Kardel) — 208-209, 285-286, 301, 305, 306, 309, 311, 335, 346, 353-357, 379, 383.
- Durrës — 165.
- DH**
- «Dhí Uërkér» (gazeta ~) — 17, 18, 23, 25.

- Grupi folklorik i Kolonjës — 183.  
 Grupi folklorik i Tropojës — 183.

**GJ**

- Gjermani — 256.  
 Gjermania Perëndimore (RF e Gjermanisë) — 238, 252-253, 323.  
 Gjirl Persik — 84.  
 Gjirokastër — 134.

**E**

- Egjipt — 84, 86, 87, 244.  
 Elbasan — 34, 165, 168, 302, 393.  
 Emiratet e Gjirit Persik — 86, 243.

**F**

- Festivali i Tretë Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës (1978) — 183, 191-192, 449.  
 Fier — 170, 482.  
 Filipine — 241.  
 Francë — 86, 209, 238, 243, 252, 253, 323, 437.

**G**

- Golan (Siri) — 85.  
 Goli Otok (Jugosllavi) — 295.

**II**

- Hekurudha Elbasan—Përrenjas—Guri i Kuq — 393-394.  
 Hidrocentrali i Fierzës [Hidrocentrali «Drita e Partisë»] — 47, 96, 187.

- Hidrocentrali i Komanit [Hidrocentrali «Enver Hoxha»] — 96, 470.

Holandë — 437.

- HSINHUA (Agjencia Kina e Re) — 19, 246.

Hungari — 292.

**I**

- «Imperializmi dhe revolucion» (E. Hoxha, vepra ~) — 17, 20, 23, 213.  
 Indi — 256-257, 258.

Instituti i Folklorit [Instituti i Kulturës Popullore], Tiranë — 181, 190.

Instituti i Kërkimeve Bujqësore, Lushnjë — 144, 166.

Instituti i Studimeve Marksiste-leniniste pranë KQ të PPSh, Tiranë — 172.

Internacionalja e Tretë Komuniste (Kominterni) — 18, 229, 288.

Irak — 84, 86, 243.

Iran — 243.

Itali — 129, 190, 288.

## J

Japoni — 89, 209, 249, 254-255, 256.

Jemeni i Jugut — 84.

Jemeni i Veriut — 84.

Jordan (lumi ~) — 87.

Jordani — 84, 86, 87, 88.

## K

Kalaja e Dodës (Dibër) — 273, 274, 276.

Kamboxhia — 206, 208, 241.

«Karmanjola» (kënga ~) — 189.

KGB (Komiteti i Sigurimit të Shtetit në BS) — 259.

Kinostudio «Shqipëria e re» — 220.

KIODO (agjencia japoneze e lajmeve ~) — 205, 241.

Kombinati i sheqerit «8 Nënëtori» i Maliqit, Korçë — 146, 281, 394.

Kombinati i Tekstileve, Berat — 34.

Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë», Elbasan — 6, 7, 8, 47, 187, 444.

Komuna e Parisit (18 mars 1871—28 maj 1871) — 52-53, 324.

Kooperativa Bujqësore e Bashkuar e Donofrosës, Berat — 279.

Kooperativa Bujqësore e Tipit të Lartë e Plasës [Ndërmarrja bujqësore «Enver Hoxha»], Korçë — 392, 396.

Korçë — 112, 165, 274, 281, 392, 395, 478.

Krujë — 165.

Kukës — 127, 128.

## L

Laos — 241.

Liban — 84, 85.

Libi — 88, 244.

Liceu Kombëtar i Korçës [Shkolla e mesme e përgjithshme «Raqi Qirinxhi»] — 215.

- Lindja e Largme — 254.  
 Lindja e Mesme — 89, 242,  
     243-244, 251, 257, 440-441.  
 Londër — 289.  
 Lushnjë — 165, 166, 168, 482.

**M**

- Malajzi — 242.  
 Mali i Zi — 126, 127, 129, 135,  
     140, 288, 336.  
 Mallakastör (Fier) — 220.  
 «Manifesti i Partisë Komuni-  
     nistë» (K. Marks—F. Engels,  
     veprat ~) — 359.  
 Maqedoni — 126, 127, 129,  
     135, 140, 288, 433.  
 Marok — 88.  
 Marsejë (Francë) — 189.  
 Martanesh (Mat) — 15.  
 Marrëveshja e Kemp-Dejvli-  
     dit (shtator 1978) — 83, 86, 87,  
     88, 89.  
 Mat — 165, 277.  
 Mbledhja e partive komuniste  
     e punëtore në Moskë (1957) —  
     200.  
 Mongoli — 255, 430.  
 Myzeqe — 191.

**N**

- NATO (Organizata e Trakta-  
     tit të Atlantikut Verior) —  
     252, 253, 254, 257, 296.

- Ndërmarrja Bujqësore e Le-  
     vanit, Fier — 279.  
 Negev (shkretëtira ~) — 86.  
 Nikaragua — 135.

**O**

- Oqeania — 255.  
 Oqeani Paqësor — 251, 254,  
     255.  
 Organizata e Kombeve të Ba-  
     shkuara — 422.

**P**

- Pakistan — 257.  
 Pekin — 200, 250.  
 Perandoria Osmane — 453.  
 Peshkopi — 128, 393.  
 Pogradec — 17, 18, 280, 281.  
 «Politika ekonomike e Jugo-  
     slavisë» (libri ~, V. Vasiq)  
     — 307.  
 Poloni — 85, 446.  
 Provansë (Francë) — 189.

**R**

- Radiotelevizioni Shqiptar —  
     193, 220.  
 Revolucioni i Madh Socialist  
     i Totorit (1917) — 286, 370.  
 «Rodon Shimbun» (gazeta ~)  
     — 207.  
 Rumani — 85, 210, 427, 431.

## RR

Rripi i Gazës — 85, 86, 87.  
 «Rruja drejt socializmit» (Il-bri ~, O. Bauer) — 304.

## S

SALT (Traktati për Kufizimin e Armëve Strategjike) — 253.

Sarandë — 165.

Sen Klu (Francë) — 189.

Siberi (Bashkimi Sovjetik) — 255, 430.

Sinal (gadishulli ~) — 85, 87.

Singapor — 241.

Siri — 84, 86, 88, 244.

Slloveni — 313, 321, 322.

Suez (kanall ~) — 244.

## SH

Shkodër — 397, 400.

Shqipëria e Jugut — 129.

Shqipëria e Veriut — 129.

## T

Tajlandë — 241.

Tajvan — 89.

TANJUG (Agjencia Telegra-

fike e Jugosllavisë së Re) — 310-311, 319, 357.

«Teoria e pronës» (punimi ~, P. Prudon) — 304.

Tibet (Kinë) — 257.

Tiranë — 34, 118, 144, 410.

TPE (Tregu i Përbashkët Evropian) — 239-240, 252.

Traktati i Varshavës — 253.

Traktati kino-japonez i mi-qësisë dhe i bashkëpunimit (gusht 1978) — 254-255, 430.

Tropojë — 127, 128, 183, 280.

Turqi — 242, 243.

## U

UDB (Drejtoria e Sigurimit Shtetëror në Jugosllavi) — 130, 290, 292, 294, 295, 369.

Universiteti i Tiranës [Universiteti i Tiranës «Enver Hoxha»] — 44.

«Ushtima e maleve» (gazeta ~) — 13.

Uzina «Enver» [Kombinati i autotraktorëve «Enver Hoxha»], Tiranë — 3.

Uzina mekanike «Dinamo», Tiranë — 3.

Uzina «Traktori» [Kombinati i autotraktorëve «Enver Hoxha»], Tiranë — 112.

**V**

Vlorë — 165, 405.

«Vetadministrimi jugosllav — teori dhe praktikë kapitaliste» (E. Hoxha, vepra ~) — 207-  
-208.

Vietnam — 206, 208, 241.

«Visaret e kombit» (vëllimet folklorike ~) — 190.

**Z**

Zvicër — 437.

**ZH**

«Zhenminzhibao» (gazeta ~) — 17, 19.

## LËNDA

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 68-TË .....	V-IX
JEMI TË PËRGATITUR PËR KOHË LUFTE, KUR STËRVITEMI E PUNOJME MIRE NË KOHË PA-QEJE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (1 shtator 1978) .....	1—10
SUBJEKTIVIZMI DHE KULTI I PERSONIT JANË KURDOHERË SHUMË TË RREZIKSHËM — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (4 shtator 1978) .....	11—28
PËR EKSPORT-IMPORTIN TË MENDOJNË TË GJITHË, NË QENDËR DHE NË BAZË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (8 shtator 1978) .....	29—44
DEMOKRACIA PROLETARE ëSHTË DEMOKRACIA E VËRTETË — Fjalim i mbajtur në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë (20 shtator 1978) .....	45—82
TRE POLITIKANË DHE PROBLEMET E LINDJES SË MESME — Shënime (22 shtator 1978) .....	83—89
HARTIMIN E PLANIT DHE REALIZIMIN E TIJ TA SHOHIM TË LIDHUR NGUSHTË ME SITUATAT — Diskutën në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (25 shtator 1978) .....	90—116

PËRVJETORËT E LINDJES SË SHOKËVE JANE FESTA TË GËZUESHME — Fjala në takimin e organizuar me rastin e ditëlindjes së shokut Haxhi Kroj dhe të disa shokëve të tjera, punonjës të aparatit të KQ të PPSH (26 shtator 1978) .....	117—125
PËR RUAJTNEN E KUFIRIT DUHET PUNUAR VAZHDIMISHT ME NJERËZIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 shtator 1978) .....	126—142
PROJEKTET E STUDIMET KANE VLERË KUR NDIQET EDHE ZBATIMI I TYRE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 shtator 1978) .....	143—152
SI I SHIKOJNË DISA PARTI KOMUNISTE TË AMERIKËS LATINE GABIMET DHE FAJET E MAO CE DUNIT — Shënime (29 shtator 1978) .....	153—164
PËR MOSREALIZIMET NË BUJQËSI KANE PËRGJEGJËSI TË GJITHË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (7 tetor 1978). .	165—179
FOLKLORIN TA RUAJMË DHE TA PASUROJMË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (10 tetor 1978) .....	180—184
PUNONJËSIT E ARTIT TA PËRVETËSOJNË E TA PËRPUNOJNË THESARIN E POPULLIT DHE TIA JAPIN PËRSERI ATIJ — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (13 tetor 1978) ...	185—193
JETA DHE LUFTA JONË JANE TË LIDHURA NGUSHTE ME JETËN DHE LIRINË E POPUJVE — Nga biseda me shokun Zhao Amazonas dhe udhëheqës të tjera të Partisë Komuniste të Brazilit (15 tetor 1978)	194—214

NE TE GJITHË JEMI USHTARË TE PARTISE — Nga biseda gjatë darkës në Pallatin e Brigadave me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes (16 tetor 1978) .....	215—221
PRANE ÇDO KOMUNISTI RREH ZEMRA TRIME E POPULLIT TONË TE MREKULLUESHËM — Fjala në darkën e dhënë në Pallatin e Brigadave me rastin e 70-vjetorit të ditëlindjes (16 tetor 1978) .....	222—238
POLITIKA E «KATER MODERNIZIMEVE» — POLITIKE SUPERFUQIE — Shënime (17 tetor 1978) ...	237—250
DY SUPERFUQITE DHE PRETENDENTËT E TJERE PËR HEGJEMONI BOTËRORE RREZIKOJNË PUJT — Shënime (21 tetor 1978) .....	251—262
TUFËZIMI I BAGËTIVE TE OBORRIT, TE BËHET VULLNETARISHT, ME BINDJE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (30 tetor 1978) .....	263—284
VETADMINISTRIMI JUGOSLLAV — TEORI DHE PRAKTIKE KAPITALISTE — Kundër pikëpamjeve antisocialiste të E. Kardelit, të shprehura në librin: «Drejtimet e zhvillimit të sistemit politik të vetadministrimit socialist» (tetor 1978) .....	285—383
— Një vështrim i shkurtër historik rrugës së revisionistëve titistë .....	286
— Sistemi i vetadministrimit në ekonomi .....	302
— Vetadministrimi dhe pikëpamjet anarkiste mbi shtetin. Çështja nationale në Jugosllavi .....	324
— Sistemi i vetadministrimit dhe mohimi i rolit udhëheqës të partisë .....	348
— Pluralizmi politiko-ideologjik, «demokracia» dhe ndërtimi «socialist» në Jugosllavi .....	360

MË PARË SE TË VEPROHET, DUHEN BËRË MIRË LLOGARITË — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (3 nëntor 1978) .....	384—401
SIIFRYTËZIMI I PUSEVE TË BËHET NË MËNYRË SHKENCORE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (6 nëntor 1978) .....	402—409
SHQIPËRIA ECËN E SIGURT PËRPARA PA IU TREMBUR SYRI — Fjala në takimin me zgjedhësit e zonës elektorale Nr. 209 të Tiranës (8 Nëntor 1978)	410—459
KUNDER FORMALIZMIT NË LËVIZJEN E KUADROVE — Shënimë (11 nëntor 1978) .....	460—464
PËR PRANIMET NË PARTI KËRKOHET STUDIM I THELLË DHE PUNË PARAPRAKE — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (15 nëntor 1978) .....	465—475
PLENUMET PUNOJNË NË MËNYRË REVOLUCIONARE KUR ZBATOHEN DETYRAT — Nga biseda në takimin ditor të sekretarëve të KQ të PPSH (24 nëntor 1978) .....	476—484
Treguesi i ländës .....	487
Treguesi i emrave .....	503
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	507

---

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1989